Komuna e Rahovecit ka 36 vendbanime, ku zona urbane mbulohet me 100% ndërsa pjesa rurale është e mbuluar në 26 fshatra me gjithsej mbi 80 km ndriçim publik deri në fund të vitit 2021. Në vitin 2022 janë të planifikuara të mbulohen me ndriçim publik edhe 9 vendbanime që janë aktualisht pa të. Distanca në mes të shtyllave të ndriçimit publik të instaluar është 25 deri 35 metra.

Telekomunikacioni

Nga gjithsej 36 vendbanime sa ka komuna e Rahovecit, vetëm 5 vendbanime kanë qasje direkte në rrjetin e telefonisë fikse, ndërsa me telefoni mobile është i përfshirë i gjithë territori.

Kapaciteti momental është i mjaftueshëm edhe për periudhën e ardhshme 10 vjeçare, mirëpo është e rëndësishme që të bëhet shtrirja e rrjetit në aspektin fizik në vendbanimet e tjera, të cilat janë më të mëdha për nga numri i popullsisë. Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse ekzistuese mundëson qasje të mbi 47.5% të popullsisë.

Grumbullimi dhe menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimi aktual nga operatori më i madh është KRM “Eko Regjioni” njësia në Rahovec, e cila sipas shënimeve ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme dhe atë 100% të zonën urbane dhe rreth 27% në zonat rurale. Operatori tjetër “Ekodrinia", shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Infrasturktura e transportit dhe transporti

Territori i komunës ka një rrjet rrugor prej 456.12 km rrugë të të gjitha kategorive. Rrugët nacionale dhe regjionale janë të asfaltuara dhe në gjendje të mirë.

Gjendja e trafikut është relativisht në nivel të kënaqshëm në rrugët periferike të komunës, ndërsa sa i përket atyre brenda qytetit ka pak vështirësi në zhvillimin normal të qarkullimit të mjeteve. Kjo bëhet edhe më e vështirë kur kemi parasysh praninë e madhe të motokultivatorëve dhe mjeteve bujqësore. Konfiguracioni i terrenit është kodrinor dhe karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve në disa lagje të qytetit. Si rezultat i kësaj rrugët janë shumë të ngushta dhe përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

Modaliteti dominues i transportit është transporti rrugor. Rrjeti i rrugëve lokale nuk është në tërësi i kategorizuar. Për pasojë, qarkullimi është i vështirësuar (në periudha të caktuara) dhe ka nevojë për krijimin e parkingjeve të reja, në veçanti në zonat me dendësi të madhe si Qendra e Qytetit. Zona e bizneseve dhe industrisë karakterizohen me rrjet më të rregullt të rrugëve dhe me profil më të gjerë se në zonat tjera, ka qasje të mirë dhe komunikacion të rrjedhshëm. Transporti i pamotorizuar nuk është adresuar në mënyrë sistematike si model i lëvizshmërisë në tërë komunën. Trotuaret, shtigjet për këmbësorë dhe biçikleta janë adresuar deri në një masë, kryesisht bazuar në investimet primare në rrugë. Transporti ndër-urban ofrohet nga operatorët privat, ndërsa transporti urban nuk ekziston.

1.3.7. INFRASTUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

SHËNDETËSIA DHE PËRKUJDESJA SOCIALE – SFIDAT

- Ofrimi i shërbimeve shëndetësore në zonat e thella rurale;
- Mirëmbajtja e standardit të shërbimeve në objektet shëndetësore;
- Akomodimi i kërkesave për strehim për persona të ri-atdhesuar;
- Buxheti i pamjaftueshëm për të përmbushur kërkesat për asistencë sociale; dhe
- Zbutja e varfërisë dhe papunësisë.

INSTITUCIONET ARSIMORE – SFIDAT

- Shkalla jo e mjaftueshme e përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor;
- Ndërlidhje jo e mjaftueshme e Arsimit për Aftësimin Profesional me kërkesat e tregut të punës;
- Mungesa e kushteve të mjaftueshme për kryerjen e punës praktike nëpër shkolla (punëtoritë, mjetet e konkretizimit, laboratorët); dhe
- Zvogëlimi i numrit të nxënësve dhe numrit të paraleleve.

ADMINISTRATA PUBLIKE - SFIDAT

- Sigurimi i hapësirave / kushteve për punë për funksionimin e bashkësive lokale.

KULTURA

Shtrirja hapësinore e objekteve të kulturës është e mirë, mirëpo ka nevojë për plotësim dhe përmirësim të infrastrukturës ekzistuese në përgjithësi. Objektet ekzistuese kulturore i plotësojnë kushtet për qasjen e personave me nevoja të veçanta. Jeta kulturore dhe artistike në komunën e Rahovecit kryesisht zhvillohet në qytetin e Rahovecit, ku edhe ndodhet numri më i madh i objekteve të kulturës dhe në fshatra: Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc, Drenoc dhe Hoçë e Madhe.

Janë të njohura eventet kulturore si ai i vjeljes së rrushit "Hardh Fest", Festivali kombëtar i folklorit - "Anadrinia Jehon" i cili mbahet në fshatin Dejn, "Festivali i Specit" në Krushë të Madhe, festivali i këngës popullore "N'RAHOVEC E KEM KONAKUN" – Rahovec.

1.3.8. ASETET E TRASHËGIMISË KULTURORE

- Menaxhimi i zhvillimeve brenda dhe rreth perimetrit të zonës mbrojtëse të monumenteve të trashëgimisë kulturore;
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i aseteve të trashëgimisë kulturore në funksion të turizmit dhe zhvillimit ekonomik; dhe
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave të trashëgimisë natyrore në funksion të turizmit dhe zhvillimit ekonomik.

1.3.9. VENDBANIMET

Qyteti i Rahovecit paraqet qendrën administrative, ekonomike e kulturore për të gjithë territorin e komunës. Koncentrimi i zhvillimeve ka qenë më i madh në qytet, ndërsa më i shpërqendruar dhe i pa balancuar në zonat rurale. Në vitet e fundit vërehet një trend i shtuar i migrimit të brendshëm nga i cili është orientuar në zonën urbane të komunës. Pasojë e këtij zhvillimi të pa balancuar në mes të zonës rurale dhe urbane, është humbja relativisht e madhe e tokës bujqësore në komunë.

Qyteti i Rahovecit i takon tipit të grumbulluar të vendbanimit, me sipërfaqe të ndërtuar prej 249.95Ha apo 51.95% nga e gjithë sipërfaqja e zonës urbane.

1.3.10. BANIMI

Banimi pothuajse në tërësi është i karakterit individual, pasi që në vetë zonën urbane ka numër të vogël të banesave të karakterit kolektiv. Më shumë se 97,8% e banesave janë në pronësi private (banim me një njësi), ndërsa 2.2% janë në pronësi publike (banimi me shumë njësi). Në kuadër të ndërtesave me banim social është 1 objekt, i cili ende nuk është në funksion. Sa i përket ndërtesave të banimit në bashkëpronësi, një pjesë e tyre janë të ndërtuara në vitet e mëhershme dhe disa pas luftës. Para luftës janë ndërtuar 19 ndërtesa të banimit me shumë njësi (223 njësi banimi), ndërsa pas luftës janë ndërtuar 6 ndërtesa të banimit me shumë njësi (75 njësi banimi).

Në vendbanimet që ndodhen afër qendrave urbane dhe atyre afër rrugëve vërehen tendencat e zhvillimit linear, duke i përcjellë vijat komunikatave. Për këtë arsye, objektet e banimit si dhe ato të bizneseve, shtrihen përskaj rrugëve nacionale.

Numri më i madh i objekteve të banimit është ndërtuar në hapësirat më të rrafshëta urbane dhe rrjedhimisht ajo është edhe hapësira më e banuar. Për nga cilësia e materialit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtuar dhe pajisjeve në hapësirat e banimit, vlerësohet se kjo zonë gjithashtu disponon me një fond banesor mjaft cilësor. Si në çdo qytet tjetër, edhe në Rahovec ka raste të ndërtimeve pa leje, të cilat shkaktojnë probleme mjedisore, hapësinore dhe në ofrimin e shërbimeve komunale.

Ndërsa, sa i përket banimit social, sipas grumbullimit të të dhënave nga Qendra për Punë Sociale për numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve nëna me asistencë sociale dhe analizave të bëra, tek këto familje na paraqitet shkallë e lartë e varfërisë. Këto të dhëna, tregojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës.

Sa i përket dendësisë së banorëve për vendbanim vërehet se dendësia më e lartë e popullsisë nuk është në qytetin e Rahovecit, por në vendbanimin Krushë e Madhe me 447b/km², e më pas vjen qyteti i Rahovecit me 328b/km².

Gjithashtu, vendbanimet tjera të cilat kanë dendësi të madhe janë: Xërxa me 316b/km², Ratkoci me 321b/km², Celina me 333 b/km², Nashpalla me 344 b/km², Bellacërka (Fortesa) me 207 b/km², etj.

1.3.11. SHFRYTËZIMI I TOKËS

Komuna e Rahovecit ka një sipërfaqe prej 275.89 ha, nga e cila 26.4% janë pyje, livadhe dhe kullosa 14.6%, tokë bujqësore 45.5%, zonat e vreshtave 8.1%, zonat e ndërtuara 4.5%, varreza 0.2% si dhe sipërfaqe të degraduar 0.7%.

1.3.12. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

VIZONI

"Rahoveci komunë liderë në mbrojtje të trashëgimisë kulturore e natyrore si dhe zhvillim të hovshëm në bujqësi, ndërmarrësi dhe arsim"

QËLLIMET:

Qëllimi 1 –Përmirësimi i mirëqenies sociale;

Qëllimi 2 – Përmirësimi i nivelit të shërbimeve shëndetësore;

Qëllimi 3 – Përmirësimi i nivelit të arsimit;

Qëllimi 4 – Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndërtesave të kulturës;

Qëllimi 5 – Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion;


Qëllimi 6 – Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike;

Qëllimi 7 – Ofrimi i banimit të qëndrueshëm;

Qëllimi 8 – Rritja e densitetit në qendrën komunale;
Qëllimi 9 – Zhvillimi i vendbanimeve në mënyrë kompakte;
Qëllimi 10 - Zhvillimi i bujqësisë, blegtorisë, vreshtarisë dhe kapaciteteve përpunuese;
Qëllimi 11 – Zhvillimi i kapaciteteve turistike;
Qëllimi 12 – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe industrisë së lehtë;
Qëllimi 13 – Zhvillimi i transportit dhe infrastrukturës së mobilitetit;
Qëllimi 14 - Menaxhimi adekuat me ujëra;
Qëllimi 15 – Menaxhim adekuat i mbeturinave;
Qëllimi 16 – Mbrojtja e mjedisit;
Qëllimi 17 – Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera; dhe
Qëllimi 18 – Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore e natyrore.

1.3.13. KONCEPTI I ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Skenari i përcaktuar



Ky koncept si i preferuar ka përcaktuar për zhvillimin e komunës së Rahovecit, për qëllim kryesor ka zhvillimin e tërë hapësirës komunale, bazuar në shfrytëzimin racional të të gjitha mundësive dhe resurseve lokale, si dhe në ruajtjen e vlerave mjedisore për gjenerata të ardhshme.

Zhvillimi policentrik ka për qëllim shpërndarjen e aktiviteteve brenda vendbanimit ose disa vendbanimeve, ndërtimin, rehabilitimin dhe pajisjen me infrastrukturë të nevojshme, qasje në transport, qasje të mirë në shërbime sociale dhe krijimin e kushteve të favorshme për punë dhe rekreacion në të gjitha vendbanimet.

Rrjeti i vendbanimeve dhe hierarkia brenda tij në Qendër Urbane si dhe në 6 Nënqendra, që do të jenë bartëse të zhvillimit, në varësi të potencialeve dhe rolit që e merr secili vendbanim në zhvillim ekonomik, social dhe ofrim të shërbimeve.

Ndërlidhja e Qendrës Urbane me Nënqendrat krijon korridore potenciale të zhvillimit të bizneseve përgjatë akseve të rrugëve regjionale si: Rahovec – Xërxë – Gjakovë (R-110); Rahovec – Krushë e Madhe (R-204), si dhe lidhja rrugore e Nënqendrave: Krushë e Madhe – Xërxë – Ratkoc – Çifllak (R-111).

Rahoveci si qendër komunale, si zonë urbane bashkë me vendbanimin e afërt Bernjakë, do të ofrojnë shërbime sociale dhe publike të nivelit komunal, ndërsa do të mbështesë edhe zhvillimin ekonomik komunal.

Efektet konkrete të këtij zhvillimi janë:

- Zhvillim i balancuar në mes qytetit dhe zonave rurale të komunës;
- Qendrat sekondare; Opterushë, Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc, Drenoc dhe Çifllak zhvillohen vazhdimisht;
- Ato duhet të sigurojnë tokë të mjaftueshme për banim, industri të lehtë dhe tregti;

- Në vendbanimet me funksione qendrore duhet të vendosen shërbimet kryesore publike: administrata publike, shkollat dhe qendrat shëndetësore;
- Qendrat duhet të ofrojnë shërbime dhe produkte të nevojshme për përdorim afatshkurtër dhe afatmesëm;
- Qendrat sekondare do të jenë nyje të rrjetit të infrastrukturës rrugore lokale;
- Qendrat sekondare dhe lokale u ofrojnë të gjitha vendbanimeve tjera shërbime institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale;
- Zonat rurale fitojnë perspektiva zhvillimore në bazë të qendrave sekondare dhe resurseve natyrore që disponojnë;
- Fluksi i largimit të banorëve nga fshatrat do të zvogëlohet ose edhe do të ndërpritet; dhe
- Zonat e rrafshëta zhvillojnë bujqësinë moderne, ndërsa në viset kodrinore-malore zhvillohet blegtoria dhe turizmi.

Zona bujqësore

Në konceptin e zhvillimit hapësinor kjo zonë është element i rëndësishëm strukturor në zhvillimin afatgjatë të komunës. Parimi themelor i zhvillimit të kësaj zone është shfrytëzimi racional i tokës bujqësore dhe kufizimi i zhvillimeve të cilat kanë ndikimin negativ në mjedis dhe e rrezikojnë potencialin e saj zhvillimor.

Zhvillimi i ardhshëm i kësaj tërësie hapësinore bazohet në intensifikimin e prodhimtarisë bujqësore (vreshtaria dhe perimtaria e pemëtaria) dhe blegtorale, ngritjen e pikave për grumbullimin dhe distribuimin e produkteve bujqësore, si dhe kapaciteteve të vogla përpunuese në kuadër të ekonomive bujqësore.

Nën-qendrat: Opterush, Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc, Drenoc dhe Çifllak do të vazhdojnë të ofrojnë shërbime administrative, publike dhe sociale për popullatën e zonës. Në këto qendra duhet të ofrohen edhe shërbime tregtare për konsum të përditshëm dhe periodik si dhe të transportit.

Zona duhet ta ruaj karakterin rural dhe zgjerimi i fshatrave duhet të kufizohet në nivel të nevojave për shtim natyror të popullsisë, në funksion të ruajtjes së tokës bujqësore. Zhvillim më intensiv planifikohet në nën-qendra, në kuadër të kufijve të përcaktuar të zgjerimit.

Zona ekonomike do të duhej të funksionojë nga prodhimi vetanak i energjisë që për këtë zonë do të sjellë avantazh të madh në krahasim me zonat tjera.

Zona ekonomike është planifikuar të jetë në Pjesën Veri-Lindore të Qytetit të Rahovecit duke vazhduar në pjesën Veriore dhe Veri-Lindore të fshatit Hoçë e Madhe, vazhdon në pjesën Veriore të fshatit Zaqishtë, dhe përfundon deri në fshatin Opterush. E gjithë kjo zonë është e shtrirë përgjatë rrugës Rahovec - Suharekë dhe ka një sipërfaqe prej 196.54Ha.

Zonë tjetër Ekonomike planifikohet të ketë edhe në lokalitete tjera, është në procedurë themelimi i Zonës Ekonomike në fshatin Krushë e Madhe në një sipërfaqe prej 100 Ha. Njëkohësisht, është duke u analizuar edhe hapësira prej 70 ha në fshatin Xërxë, që është e shtrirë përgjatë rrugës Xërxë – Gexhë, afër Kanionit të Drinit të Bardhë, po ashtu varësisht prej llojit të pronësisë së tokës do të trajtohet në mënyrë specifike secili vendbanim i komunës së Rahovecit.

Shfrytëzimi i tokës

Harta e shfrytëzimit të tokës përcakton llojin e shfrytëzimit të tokës bazuar në vizion, qëllime dhe objektiva. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës në mënyrë direkte rrjedh nga koncepti i zhvillimit.

Në komunën e Rahovecit, në bazë të kushteve fiziko-gjeografike, dallohen dy tërësi kryesore hapësinore për nga morfologjia e terrenit dhe faktorët tjerë natyror, ndërsa në bazë të këtyre faktorëve kushtëzohet edhe niveli zhvillimor në hapësirë. Pra, dallohet hapësira e rrafshët me tokë bujqësore të cilësisë së lartë dhe hapësira kodrinore - malore me pyje e kullosa.

Hapësira kodrinore-malore, në anën veriore të komunës, paraqet ambient të përshtatshëm për pushim dhe rekreacion si dhe aktivitete tjera me karakter ekonomik, si blegtori, etj.

Hapësira veriore e komunës dallohet me karakteristika tjera natyrore dhe të aktiviteteve, dendësi të vogël banimi, ambient të qetë dhe të pastër. Mbrojtja, zhvillimi dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe potencialeve të kësaj zone, mundëson hapjen e perspektivës për zhvillimin e komunës, me theks të veçantë në turizëm.

Zona Fushore, pjesa jugore e komunës ofron mundësi të mira për sektorin e agrikulturës, zhvillimin e bizneseve, vendbanimeve dhe infrastrukturës moderne. Vlerat e kësaj tërësie hapësinore ia shton lumi Drini i Bardhë me disa degë të tija që kalojnë në anën jugore.

Zona fushore paraqet perspektivë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, ku dominon agrobiznesi si dhe aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe shërbyese.

Kjo zonë, karakterizohet me zhvillim të gjithmbarshëm të llojit të përzier, me përqendrim të madh të popullsisë, aktivitete tregtare-industriale, të cilat qëndrojnë ngushtë të lidhura edhe me zhvillimin e komunikacionit e transportit, si dhe zhvillimit të përgjithshëm të bujqësisë, por njëkohësisht edhe me ndikime të theksuara mjedisore.


Qyteti i Rahovecit ofron mundësi për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Ndërsa në zonat rurale propozohet ofrim i shërbimeve dhe infrastrukturës me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së jetës. Kjo do të reflektohet në ngritjen e standardit jetësor të popullsisë dhe hapjen e mundësive të reja për zhvillim në fshat.

Në këtë rast, rëndësi të veçantë ka përcaktimi i pikave më të përshtatshme dhe të favorshme për ofrimin e shërbimeve, ndërsa kjo do të reflektohet në koncentrimin e popullsisë e jo në dezintegrim të saj. Me formimin e disa qendrave sekondare dhe lokale do të zvogëloheshin distancat mes banimit dhe shërbimeve.

Vizioni për Rahovecin përcakton një orientim dhe zhvillim të qartë të ardhshëm. Parimet për zhvillim dhe mbrojtje, formulojnë bazën për përcaktimin e kushteve për çështjet e shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit.

Zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i bazuar në vendime adekuate. Në PZHK-në për Rahovec, toka për zhvillim dhe rregullim është e destinuar për këto lloje të shfrytëzimit:

- Vendbanime,
- Korridore të gjelbërimit,
- Rekreacion,
- Toka bujqësore,
- Kullosa dhe livadhe,
- Pyje,
- Lumenjtë.



1.3.14. KORNIZA STRATEGJIKE

Gjatë hartimit të PZHK-së janë marrë parasysh të gjitha dokumentet relevante të cilat kanë ndikim në orientimin strategjik të komunës së Rahovecit. Rëndësi e veçantë në këtë aspekt i është kushtuar prioriteteve strategjike të "Planit Hapësinor të Kosovës 2010-2020+", i cili në të njëjtën kohë ka shërbyer si bazë për orientimin strategjik të PZHK-së paraprake të Rahovecit, por edhe të planeve tjera hapësinore.

Duhet të ceket që janë marrë për bazë të gjitha strategjitë sektorale, lokale, rajonale dhe qendrore, varësisht prej sektorit dhe implikimeve të tyre në hapësirë. Shumica prej tyre janë listuar më poshtë.

1.3.15. STRATEGJITË SEKTORIALE AFATSHKURTRA, AFATMESME DHE AFATGJATA NË NIVEL LOKAL DHE QENDROR

Strategjitë që përfshihen në Planin Hapësinor të Kosovës, strategjia e zhvillimit hapësinor 2010-2020+:

- Plani zhvillimor komunal 2011-2020;
- Plani lokal për veprim në mjedis 2019-2024;
- Strategjia kombëtare për zhvillim 2016-2021 (SKZH); dhe
- Plani pesë - vjeçar i menaxhimit të mbeturinave për komunën e Rahovecit 2016-2021.

STRATEGJITË QË PËRFSHIHEN NË PLANIN HAPËSINOR TË KOSOVËS, STRATEGJIA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR 2010-2020

Në kuadër të "Planit Hapësinor të Kosovës", në bazë të strukturave hapësinore të zhvillimit që i përcakton ky plan, Komuna e Rahovecit bën pjesë në "Zonën e Verdhë".

Vizioni për Zonën e Verdhë:

"Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agroindustriale, tregtare, shërbyese dhe turistike."




Figura 1 PHK Strategjia e zhvillimit hapësinor – Kopshti i Kosovës

Qëllimet e përgjithshme për zonën e verdhë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese.
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brenda-urbane, ndër-urbane me 6 hapësirat e tjera dhe më gjerë në rajon, përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja e zhvillimeve për arsim bashkëkohor e përkrahës të kërkesave të tregut.
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ.
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë.
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik.

Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agroindustriale dhe turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

1.3.16. STRATEGJITË PREJ PLANEVE TË MËPARSHME KOMUNALE

1.3.16.1. PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I RAHOVECIT 2011-2020

PZHK-ja paraprake e komunës së Rahovecit 2011- 2020, është ndarë në 5 faza, ku faza e 4^{të} është ajo e strategjisë për veprim dhe implementim. Kjo fazë formulon pakon e strategjive dhe veprimet për realizimin e qëllimeve brenda kornizës hapësinore, afatet kohore, implikimet financiare dhe kornizën institucionale.

Këto faza janë të lidhura me planifikim urban dhe aktivitetet zhvillimore në zonën urbane dhe rurale, mobilitet dhe infrastrukturë, komunikim, menaxhim të informatave dhe hulumtime të mëtutjeshme.

Planifikimi Rregullues Urban

Strategjitë e fushës së zhvillimit urban kanë konsistuar në hartimin e Planeve Rregulluese Urbane përmes të cilave do të implementohej Vizioni i PZHK-së.

Së pari duhet bërë hartimi i planit zhvillimor urban, përmes të cilit do të përcaktoheshin kahjet zhvillimore të qytetit të Rahovecit dhe strategjitë për veprim. Pastaj, për ta realizuar një funksionalitet më të mirë të vendbanimeve është shumë me rëndësi të hartohen Harta Zonale Komunale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme për Zonën Qendër.

Qëllimi i këtyre planeve është orientimi i zhvillimit të ardhshëm përbrenda dhe përreth zonave përkatëse duke iu përshtatur karakterit të veçantë të secilës qendër.

Komuna do të bëjë investime në këto qendra sekondare dhe ato do të zhvillohen me qëllim të parandalimit të zgjerimit të pakontrolluar.

Zgjidhje për ndërtimet ilegale dhe vendbanimet joformale

Nevojitet bashkëpunimi me akterët vendimmarrës me qëllim të shmangies së problemeve në raport me tokën publike. Diskutimet e ndërsjella janë të domosdoshme në mënyrë që të gjenden zgjidhje për sigurimin e infrastrukturës teknike dhe sociale.

Rregullimi i vendbanimeve joformale është pjesë e standardeve për Kosovën të hartuara nga PSSP-ja. Andaj, Plani Zhvillimor Komunal dhe Urban duhet që në procesin e planifikimit t`i përfshijë vendbanimet joformale dhe të merret me joformalitetin në përputhshmëri me udhëzimet e publikuara nga MMPHI-ja. Veprimet e lartshënuara janë të nxjerra nga udhëzuesit për rregullimin e vendbanimeve joformale

Ruajtja e cilësisë së tokës

Ndërtimet e pa kontrolluara, mbetjet e amvisërisë, mbetjet ndërtimore, mbetjet industriale, përdorimi jo i drejtë i plehrave kimike dhe pesticideve, mënyra e përdorimit të tokave, shkarkimi i ujërave të zeza, fatkeqësitë natyrore, siç janë vërshimet, etj., ndikojnë drejtpërsëdrejti në cilësinë e tokës.

Duke marrë parasysh një varg problemesh që shkaktohen nga faktori njeri duhet marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes nëpërmjet ekspertëve të fushave bujqësore.

Masat parandaluese:

- Organizimi i seminareve nga fusha e bujqësisë;
- Kontrolli i mbetjeve të natyrave të ndryshme;
- Kontrolli i përdorimit të plehrave dhe pesticideve; dhe
- Kontrolli dhe mënyra e përdorimit të tokave.

Mbrojtja dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i trashëgimisë natyrore dhe kulturore

Komuna, së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duhet të përgatis planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore. Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të ketë efekte negative ndaj këtyre vlerave si:

- Në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të hartojë planin rregullues për trashëgiminë historike, me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë historike-kulturore.
- Komuna, në bazë të kërkesave të përpiloj planin rregullues për pikën turistike në gjeomonumentin ,,Kanioni i Urës së Fshejtë".
- Komuna, në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës do të hartoj planet rregulluese për bregun e lumit si hapësirë publike që të mbrojë vlerën e peizazhit të lumit ,,Drini i Bardhë".
- Komuna, në bashkëpunim me MKRS-në, të inicioj me akt të veçantë vënien nën mbrojtje të lokaliteteve arkeologjike.
- Restaurimi i objekteve kulturo-historike.
- Pjesës së vjetër të qytetit - kërkohet ruajtja e bërthamës së qytetit.
- Restaurimi dhe mirëmbajtja e Teqesë Halveti.
- Përmbledhje e këngëve të Sheh Maliqit - Publikimi i këtyre përmbledhjeve në Katalogun Turistik të Qytetit (forma e shkurtuar).
- Përmbledhje e dorëshkrimeve Sheh Ilmi Maliqit, Publikimi i këtyre përmbledhjeve në Katalogun turistik të qytetit (forma e shkurtuar).
- Restaurimi, mbrojtja dhe ruajtja e Objekteve të trashëgimisë ortodokse si dhe urbanizimi.

1.3.16.2. PLANI LOKAL PËR VEPRIM NË MJEDIS 2019-2024

PLVM-ja është një pikë fillestare për zhvillimin e një komuniteti të qëndrueshëm. Ky plan ndihmon që bashkësia të ketë ekzaminuar dhe adresuar në mënyrë adekuate çështjet kryesore mjedisore që ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe në shëndetin e ekosistemeve.

PLVM-ja përfshin zhvillimin e vizionit të komunitetit, vlerësimin e çështjeve mjedisore, përcaktimin e prioriteteve, identifikimin e strategjive më të përshtatshme për adresimin e problemeve kryesore dhe zbatimin e veprimeve me qëllim të arritjes së përmirësimeve reale mjedisore dhe shëndetësore.

Gjithashtu, PLVM-ja nxit bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit vendor dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Qëllimet e Planit Lokal për Veprim në Mjedis

Zgjidhja e problemeve mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë akterët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve sipas një Plani Veprimi.

- *Zhvillon shoqërinë civile* nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet që përfaqësojnë interesa të ndryshme, përfshirë autoritetet vendore, përfaqësuesit e OJQ-ve, komunitetin shkencor.
- *Rrit aftësitë e qeverisjes vendore dhe komunitetit* për paraqitjen e elementeve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plani-Veprimi.
- *Rrit shkëmbimin e informacioneve në nivel lokal* nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga planet e mëparshme të komuniteteve, nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të

zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.

- *Ofron zgjidhje konkrete për problemet e komunitetit* me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime, që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv. Duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

Objektivat specifike të planit

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për komunën e Rahovecit ka për synim:

- Zbutjen e degradimit mjedisor, duke lidhur në mënyrë efektive proceset kryesore të planifikimit të zhvillimit në komunë;
- Pozicionimin e komunës si akter kyç për identifikimin dhe bashkëpunimin me burimet e mundshme kombëtare dhe lokale të financimit për projektet prioritare komunale;
- Përmirësimin e kushteve të jetesës duke siguruar mbështetje financiare për projektet prioritare komunale;
- Transparencë në pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore;
- Integrimin e metodës së qasjes mebazë gjinore për të identifikuar dhe vendosur prioritetet mjedisore në komunitetet lokale, dhe
- Krijimin e kapaciteteve të forta për të zhvilluar dhe zbatuar PLVM-në dhe për identifikimin dhe shfrytëzimin e opsioneve të financimit.

1.3.16.3. STRATEGJITË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM 2016-2021

Menaxhimi i qëndrueshëm i mbeturinave

Rritja e ekonomisë dhe mirëqenies mundëson rritje të mundësive për konsum të mallrave, e për rrjedhojë edhe e shton sasinë e mbeturinave. Mbetjet nga konsumi në njërën anë shkaktojnë presion mbi mjedisin, duke e dëmtuar ekosistemin në rast se menaxhohet dobët grumbullimi dhe deponimi, por nëse riciklohen mund të jenë edhe aset për zhvillimin ekonomik, duke u përdorur si lëndë e parë nga industritë. Për momentin në Kosovë mbetjet janë bërë problem mjedisor dhe në anën tjetër nuk janë kthyer në shërbim të zhvillimit industrial përmes riciklimit.

Shkaqet

Vetëm rreth 60% të mbeturinave në Kosovë grumbullohen. Përveç kësaj, nuk ka ndonjë aktivitet të organizuar për ndarjen e mbeturinave për ripërdorimin/riciklimin dhe trajtimin e tyre. Përjashtim bën sektori privat i cili e bën mbledhjen, ndarjen në lloje, trajtimin fizik dhe eksportimin e mbeturinave. Hedhja e mbeturinave kryesisht bëhet në deponitë rajonale/komunale (ekzistojnë gjithsej 8 deponi), shumica e të cilave nuk veprojnë/operojnë në pajtim me standardet mjedisore, por ndodhin edhe hedhje në vende të papërshtatshme dhe të pakontrolluara (deponi ilegale). Rreth 40% të mbeturinave të mbetura hidhen në mënyrë të paligjshme ose digjen.

Zgjidhjet e mundshme

SKHZ-ja do të mundësojë menaxhimin më efikas të mbeturinave në Kosovë duke investuar në infrastrukturën e menaxhimit, konsolidimin e kompanive publike për mbledhje, kontraktimin e operatorëve ekonomik për menaxhim mbeturinash), rritjen e vetëdijes dhe stimulimit të riciklimit, si dhe krijimin e rrjeteve grumbulluese për trajtimin e ujërave të zeza.

Aktivitete konkrete

- Ndërtimi i infrastrukturës për menaxhimin e mbeturinave komunale, të ngurta, të ndërtimit, industriale dhe të rrezikshme dhe të lymit nga ujërat e ndotura.
- Konsolidimi i kompanive publike për mbledhjen e mbeturinave si dhe kontraktimi i operatorëve ekonomikë përmes partneriteteve publiko-private për menaxhimin e mbeturinave (në fushën e deponimit, trajtimit dhe riciklimit).
- Rritja e ndërgjegjësimit publik dhe reduktimi gradual i sasisë së mbeturinave të prodhuara si dhe stimulimi i ri-përdorimit ose riciklimit dhe përdorimi i produkteve të trajtimit të mbeturinave.
- Implementimi i projekteve për zvogëlimin e rreziqeve mjedisore dhe shëndetësore nga mbeturinat (trajtimi i mbeturinave të rrezikshme, rehabilitimi i vendeve të ndotura/kontaminuar, eliminimi i deponive ilegale, etj.).
- Ndërtimi i qendrave për trajtimin e mbeturinave në këto komuna: Gjilan, Ferizaj, Prizren, Shtërpcë, Rahovec, Gjakovë, Shtime, Lipjan, Drenas, Suharekë, Kaçanik dhe Viti).

1.3.16.4. PLANI PESË - VJEÇAR I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE PËR KOMUNËN E RAHOVECIT 2016-2021

Caku i punimit të Planit është vendosja e sistemit të qëndrueshëm afatgjatë në menaxhimin e mbeturinave në nivel të Komunës, në mënyrë që të përmirësoj cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor. Shfrytëzimit racional të burimeve dhe respektimin e parimeve moderne në menaxhimin e mbeturinave, me pjesëmarrje të koordinuar të gjitha akteve të menaxhimit të mbeturinave.

Synimet

Komuna synon që përmes planit të menaxhimit të mbeturinave të arrijë:

- Vendbanime të pastra, mjedise të shëndetshme për banorët;
- Promovimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të trajtimit të mbeturinave;
- Përfshirja me shërbim të tërë zonës përmes tarifës së përballueshme si dhe rritje të inkasimit;
- Të definohen caqet e menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal në harmoni me legjislaturën kombëtare;
- Të definohet sistemi optimal i menaxhimit të mbeturinave; dhe
- Të definohen investimet e përgjithshme financiare dhe investimet në pjesët prioritare të planit të cilat duhet të zbatohen menjëherë.

Objektivat

- Vendosja e sistemit institucional për menaxhim me mbeturina.
- Krijimi i sistemit financiar për MM-në.
- Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave.
- Promovimi i minimizimit të mbeturinave përfshirë mbylljen e deponive ilegale.
- Përkrahje për ri-organizimin e komunitetit.
- Zhvillimin e pilot projekteve me qëllim të realizimit të 3R-konceptit (Riciklim, Reduktim dhe Ripërdorim).

2. PROFILI KOMUNAL

2.1. HISTORIKU I ZHVILLIMIT

Pas përfundimit të Luftës në qershor të vitit 1999 Kosova ka hyrë nën administrimin ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara. UNMIK-u shtriu ndikimin e vet edhe në qeverisjen lokale, ku sipas Nenit 3 të rregullores së vet Nr. 2000/45, komunave ju ndanë rolet dhe përgjegjësitë, si dhe rolin në ofrimin e kushteve themelore bazike për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.

Procesi i decentralizimit në Kosovë qartësoi edhe kompetencat për vetëqeverisje lokale. Në bazë të LIGJIT NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE në Kreun III Kompetencat komunale, Neni 15 Parimi i subsidiaritetit – Komunat ushtrojnë kompetencat e tyre sipas parimit të subsidiaritetit dhe Neni 16 – Komuna ushtron kompetenca vetjake, të deleguara dhe të zgjeruara në përputhje me ligjin. Organet komunale janë: Kuvendi që është organi më i lartë në komunë dhe Kryetari që kryen udhëheqjen komunale të ekzekutivit.

Rahoveci është qytet dhe komunë në pjesën jug-perëndimore të Kosovës. Përafërsisht ka diku 276 km² dhe është vendbanim i 56,208 banorëve, sipas statistikave të ASK-së të vitit 2020. Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës. Në bazë të hulumtimeve arkeologjike mund të konkludojmë se në territorin e komunës së Rahovecit janë zbuluar disa fakte arkeologjike, të cilat tregojnë se këto vise janë përplot me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire (E. Çershkov). Kështu p.sh në fshatin Retijë janë gjetur dy epitafe-pllaka mermeri nga koha romake ku është bërë skalitja e tekstit latin, në njërën pllakë qëndron ky mbishkrim *"D(is) ma(anibus) Aur(elia) Catulla vixit annis XX Popaj F(iliae) b(ene) M(erenti)"*. Në pllakën e dytë është shënuar teksti sa vijon: *"D(is) M(anibus) Scerviae-dus Sita es Vix(it) an(nis) XXX interfectus a llatromibus si ta Dasi p(pater) f(ilio) p(iissimo) et Sibi et Caiae Dasi coniugi b(ene) m(erenti) Vius F(aciendum) C(uravit)"*. M. Krasniqi në punimin e tij mbi Rahovecin thekson se përveç këtyre epitafeve, pllakave të mermerit në ngastrën e fshatit të përmendur Retijë, është gjetur edhe një pllakë e thyer nga koha Romake ku është skalitur teksti *...et Sitae F(ilio) sumi cor(niculario) c(o) hor(tis) pri(mae)Dardanorum V(i) ixit an(nis) XXX b(ene) m(erenti) P(osuit)*. Edhe gjatë mesjetës në shek. XIV (me 1348) Rahoveci përmendet si vend i cili kufizohet me disa fshatra përreth si territor vreshtar. Po i cekim disa vendbanimet të cilat përmenden e këto janë: Shtavica, Bërnjakë, Krusha, Kobillogllava, Babindoli, Pojata e Mullabazëve, Hoça, Maja e Shkodranit, Bjeshka e Shkozës (M. K.). Po ashtu Rahovecin mund ta gjejmë edhe në hartat e vjetra të vitit 1689. Në pjesën e dytë të shekullit XVIII, Rahoveci përmendet si qytezë, në vitin 1770 si qytezë "Ravac" por ka edhe emra të tjera që gjinden në harta të vjetra siç janë: Rahuaz, Rahuiz, Rahova, Ravaz, Rahovce, etj., ndërsa në vitin 1911 për herë të parë shkruhet në hartë si Orahovac sipas J. Cvijiqit.





Figura 2 Struktura organizative e komunës së Rahovecit

2.2. ORGANIZIMI ADMINISTRATIV DHE QEVERISJA E KOMUNËS SË RAHOVECIT


Komuna e Rahovecit ka një sipërfaqe prej 275.89 km², në të cilin territor shtrihen 34 fshatra me 2 vendbanime dhe me vetëm një qendër urbane.

Territori i komunës së Rahovecit ndahet në 34 zona kadastrale dhe të gjitha vendbanimet (fshatrat) janë me nga një zonë kadastrale, me përjashtim të 3 zonave: Retijë që në vete përfshinë dy vendbanime (Retijë dhe Reti e Poshtme), Zona kadastrale Çifllak që përfshin edhe vendbanimin e Saroshit si dhe zona kadastrale Dejnë që në vete përfshin edhe vendbanimin e Babocit.


Nr.	Zona Kadastrale	Nr.	Vendbanimi	Nr.	Zona Kadastrale	Nr.	Vendbanimi
1.	Bellacërkë	1.	Bellacërkë	18.	Nashpall	20.	Nashpall
2.	Bërnjakë	2.	Bërnjakë	19.	Opterush	21.	Opterush
3.	Bratatin	3.	Bratatin	20.	Pastaselë	22.	Pastaselë
4.	Brestoc	4.	Brestoc	21.	Pataqan i Epërm	23.	Pataqan i Epërm
5.	Celinë	5.	Celinë	22.	Pataqan i Poshtëm	24.	Pataqan i Poshtëm
6.	Çifllak	6.	Çifllak	23.	Petkoviq (Guri i Kuq)	25.	Petkoviq (Guri i Kuq)
		7.	Sarosh	24.	Polluzhë	26.	Polluzhë
7.	Dabidol	8.	Dabidol	25.	Radostë (Malësi e Vogël)	27.	Radostë (Malësi e Vogël)
8.	Dejnë	9.	Dejnë	26.	Rahovec	28.	Rahovec
		10.	Baboc	27.	Ratkoc	29.	Ratkoc
9.	Drenoc	11.	Drenoc	28.	Retijë	30.	Retijë
10.	Gexhe	12.	Gexhe			31.	Reti e Poshtme
11.	Hoçë e Madhe	13.	Hoçë e Madhe	29.	Sapniq	32.	Sapniq
12.	Hoçë e Vogël	14.	Hoçë e Vogël	30.	Senoc	33.	Senoc
13.	Kaznik	15.	Kaznik	31.	Vrajak	34.	Vrajak
14.	Kramovik	16.	Kramovik	32.	Xërxë	35.	Xërxë
15.	Krushë e Madhe	17.	Krushë e Madhe	33.	Zatriq	36.	Zatriq
16.	Mrasor	18.	Mrasor	34.	Zaqishtë	37.	Zaqishtë

17.	Nagavc	19.	Nagavc				

Tabela 1 Zonat kadastrale në komunën e Rahovecit



Harta 1 Harta e ndarjeve administrative në komunë



Harta 2 Klasifikimi i vendbanimeve

Ndërsa, sa i përket organizimit administrativ të komunës së Rahovecit, ai është i organizuar në një qendër komunale si dhe me 7 qendra të tjera lokale.

1.	Rahovec	Rahovec, Bërnjakë
2.	Çifllak	Çifllak, Dabidol, Mrasor, Kramovik, Petkoviq, Polluzhë, Sarosh
3.	Ratkoc	Ratkoc, Radostë, Dejnë, Baboc, Vrajak, Bratatin,
4.	Drenoc	Drenoc, Zatriq, Kaznik, Pastaselë, Senoc, Nashpall, Pataqan i Epërm
5.	Xërxë	Xërxë, Gexhe, Bellacërkë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm
6.	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe, Celinë, Nagavc
7.	Hoçë e Vogël	Hoçë e Vogël, Hoçë e Madhe, Brestoc
8.	Opterush	Opterush, Zaqishtë, Retijë, Reti e Poshtme

Tabela 2 Organizimi aktual administrativ komunal

2.3. KARAKTERISTIKAT E PËRGJITHSHME TË KOMUNËS

2.3.1. POZITA GJEOGRAFIKE


Territori i komunës së Rahovecit zë një sipërfaqe prej 275.89 km², që shtrihet në regjionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Në veri kufizohet me Komunën e Klinës me distancë rreth 45 km, në V-L me Komunën e Malishevës rreth 16 km, në J-L me komunën e Suharekës rreth 17 km dhe atë të Mamushës, në J me Komunën e Prizrenit 25 km, dhe në P me komunën e Gjakovës 28 km dhe në largësi nga kryeqendra e Kosovës (Prishtina) rreth 60 km.

Ekzistojnë lidhje të mira në mes komunave dhe në Lindje të komunës kalon magjistralja Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren – Pejë.

Territori i komunës shtrihet në hemisferën në mes shkallës 42^0 e 30’ dhe 42^0 e 50’ të gjerësisë gjeografike veriore dhe ndërmjet 20^0 e 21’ dhe 20^0e 55’ të gjatësisë gjeografike lindore. Vendbanimet në komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 m Krushë e Madhe deri në 920 m. lartësi mbidetare Zatriqi.




Harta 3 Pozita Gjeografike e komunës



Harta 4 Harta e Rahovecit në raport me Kosovën

Për nga lartësia mbidetare, këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshore, kodrinore dhe malore. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lugina ose rrafshina janë të lartësive mbidetare prej 310m – 350 m, ku bëjnë pjesë këto vendbanime; Xërxa, Bellacërka, Gexha, Radosta (Malësia e Vogël), Ratkoci, Dejnë, Dabidoli, Çifllaku, Nagaci, Hoça e Vogël dhe Retija.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m, që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senoci, Pastasela, Polluzha, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Opterusha, Zaqishta, Pataqani i Poshtëm, Pataqani i Epërm, Nashpalla, Bratatini, Baboci, Vrajaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshinave). Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600m – 1000 m, e këto janë: Zatriqi, Kazniku dhe Drenoci.



Harta 5 Harta e hipsometrisë së terrenit

2.3.2. VEÇORITË MJEDISORE

Klima dhe sasia e të reshurave - Në territorin e komunës së Rahovecit mbizotëron klimë kontinentale me ndikim mesdhetar. Reshjet vjetore në Rahovec arrijnë në 765 mm dhe temperatura mesatare e ajrit është 11,8 °C. Muaji më i nxehtë është korriku me një temperaturë maksimale prej 38,5 °C, ndërsa në dimër muaji më i ftohtë është zakonisht muaji shkurt, me një temperaturë minimale prej – 14,5 °C.

Erërat - Më së shpeshti fryjnë erërat e veriut (11,8%), veri-lindja (62%), dhe perëndimi (50%), ndërsa më së paku fryjnë erërat e lindjes (17%), jugut (14%) dhe jug-lindja (4%)

Hidrografia - Në komunën e Rahovecit rrjeti hidrografik është relativisht i mirë. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe njerëzore. Rrjetin hidrografisë së komunës së Rahovecit e përbëjnë disa qindra burime, puset, burime rrjedhëse dhe të qëndrueshme dhe përroskat.

Lumi Drini i Bardhë - Edhe pse nuk buron në komunën e Rahovecit, të gjitha përroskat dhe lumenjtë derdhen në të. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedhë me një gjatësi prej 30 km dhe pjesën më të madhe është edhe si kufiri administrativ i komunave siç janë: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës.

Lumenjtë - përroskat të cilat derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Drinas, Rimnik, Polluzhë, Hoçë, etj. Për shkak të konfiguracionit të terrenit lugina e Drinit në komunën e Rahovecit sillet 2 deri 5 km. Ndërsa gjerësia mesatare e shtratit të lumit është prej 50 deri 100 m., thellësia e shtratit të lumit është 1 deri 5 m. Hapësira e parë shtrihet prej Gradishit (Gexhës) deri te Kramoviku, në një gjatësi prej 15 km. Hapësira e dytë shtrihet prej Gradishit (Gexhës) deri në jug-lindje ndërmjet fshatrave Xërxë, Bellacërkë, Celinë dhe Krushë e Madhe dhe ndryshe quhet Anadrinia e Ulët.

Flora - Sipërfaqet bujqësore, si sipërfaqe të rëndësishme ekonomike paraqesin bazë të rëndësishme natyrore për Komunën e Rahovecit. Kushtet klimatike janë të volitshme, sidomos numri i madh i ditëve me diell gjatë sezonit veror si dhe ujitja me anë të pipave për kulturat lavërtarë (speca, domate, patate, bostan, qepë, etj.) si dhe kultivimi i hardhisë së rrushit dhe pemëve. Sipërfaqet bujqësore përfshijnë një sipërfaqe prej 13.998 ha dhe sipërfaqet janë të mbjella me këto kultura: gruri, elbi, tërshëra, misri, etj. Sipërfaqet më pjellore janë rrafshi i Anadrinisë duke filluar prej Mrasorit e gjerë në Krushë të Madhe e që më së shumti në këto toka kultivohen perimet, ndërsa në pjesët tjera kultivohen hardhia e rrushit (vreshtat) dhe pemë të ndryshme, siç që janë: molla, dardha, kumbulla, pjeshka, arra, kajsia, etj. Duke pasur klimën e përshtatshme si dhe llojet e tokave, në këtë territor më së miri kultivohet hardhia e rrushit. Sipërfaqet e mbjella me vreshta janë në sektorin privat 2.500 ha dhe në sektorin shtetëror 993 ha, ndërsa tani 640 ha, ku sipërfaqe prej 353 ha janë reduktuar për shkak të vjetërsisë dhe pasojave të luftës.

Vreshtat e komunës së Rahovecit si dhe prodhimet e rrushit janë të njohura jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë. Prodhimet e tyre janë eksportuar në shtetet e perëndimit, ndërsa tani nuk eksportohet dhe është problemi kryesor i bujqve që merren me këtë veprimtari.

Fauna - Përgjatë territorit të komunës së Rahovecit në gjatësi prej 30 km rrjedh shtrati i lumit Drini Bardhë si dhe shumë përrenj dhe përroskat që derdhen në këtë lum, që ka rëndësi të madhe ekonomike dhe në të gjenden numër i madh i llojeve të peshqve. Në Drinin e Bardhë ka më së shumti bërcak, mustak, rapuli, marule, krap, ngjala dhe trofta, e cila lajmërohet kohë pas kohe. Përpos peshqve ka edhe bretkosa, gaforre përrenjsh dhe gjarpërinj të ujit. Në ekonomitë familjare kultivohen gjedhe, kuaj, dele si dhe shpezë. Në territorin e komunës janë prezentë edhe shtazët e egra siç janë: dhelpra, ujku, lepuri, derri i egër me numër të madh dhe që tani edhe bëjnë dëme të mëdha në kulturat bujqësore, e që tani nuk lejohet gjuetia nga UNMIK-u dhe KFOR-i. Në territorin e komunës së Rahovecit, shpezët më të njohura janë këto: fëllënza, sorra, harabeli, pata e egër, korbi, bylbyli, pëllumbi, kumria, skifteri (gjeraqina), shqiponja, pula e egër dhe lejleku gjatë stinës verore e posaçërisht përgjatë rrjedhjes së lumit Drini i Bardhë. Gjendja e tanishme e ekuilibrit biologjik-ekologjik e komunës së Rahovecit ka kushte të përshtatshme për zhvillimin e saj.

2.3.2.1. KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE

Territori i Komunës së Rahovecit ka llojllojshmërinë e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet me numër të madh të grupeve të llojeve të tokës, e në përbërjen e saj ka 8 lloje dhe 21 nënlloje, në formë të një mozaiku. Me përjashtim të tokave skeletore, tokat tjera janë nga substratet e bartura. Ato janë formuar pjesërisht nga sedimentet liqenore dhe rrjedhjeve të ujërave. Prezenca e llojeve të ndryshme të tokave ofron mundësi për zhvillimin e kulturave të shumëllojshme.

Në këtë rast është me rëndësi ndikimi i njeriut në shfrytëzimin e tokës gjë që shpeshherë mund të shprehet negativisht nëse nuk i përshtatet lloji i kulturave llojit të tokës, sepse shfrytëzimi jo racional shkakton erozion dhe shkatërrim të tokave.

Në bazë të hulumtimeve në terren dhe hulumtimeve laboratorike të tokave në komunën e Rahovecit dallohen këto lloje:

Tokat Aluvijale – kanë rëndësi të madhe për bujqësi në territorin e komunës së Rahovecit. Ky lloj i tokave është i përqendruar në luginën e lumit Drini i Bardhë. Këto toka janë formuar në tarracat lumore të vjetërsisë aluviale. Duke u larguar nga shtrati i lumit këto toka ndryshojnë përbërjen duke i'u shtuar sasia e humusit. Këto toka janë të klasit të I^{rë} të bonitetit dhe bëjnë pjesë në tokat me produktivitet të lartë bujqësor.

Gjatë vërshimeve dheu bartet me erozion, kështu që këto sipërfaqe duhet sanuar me masa gjegjëse hidroteknike. Në bazë të hulumtimit laboratorik dhe në terren këto toka ndahen në nënllojet të tokave aluviale: rëra, rëra deltinore, rëra argjilore.

Aluvijumi Rënor - këto toka shtrihen përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë, ndërmjet fshatrave Kramovik dhe Gexhe.

Aluvijumi Argjilor - më së shumti është përqendruar në tërë gjatësinë e lumit të Drinit të Bardhë i cili kalon në territorin e komunës.

Tokat Deluviale – kanë pjesëmarrje të vogël në komunën e Rahovecit.

Tokat Deluviale Deltinore - shtrihen rreth këtyre fshatrave: Kaznik, Drenoc, Rahovec dhe Zatriq.

Aluviumi dhe deluvijumi deltinor – këto toka posaçërisht janë të përqendruara në luginat e ngushta të përrenjve, përroskave në pjesët kodrinore të komunës. Sipërfaqet kryesore të kësaj toke janë të përqendruara në parcela kadastrale të këtyre fshatrave: Bërnjakë – Rahovec, Bellacërkë – Sapniq, Opterush – Reti e Poshtme.

Tokat livadhore – deltinore - sipërfaqet e tokës livadhore-deltinore shtrihen kryesisht në luginën e Drinit të Bardhë.

Rendëzinat – zënë sipërfaqe të konsiderueshme të komunës dhe posaçërisht në viset kodrinore-malore. Karakteristikë e këtyre tokave është thellësia e vogël e shtesës prej 50 cm dhe e pasur me humus (5 – 15%) ndërsa më së shumti janë të mbuluar me pyje dhe kullosa. Boniteti i këtyre tokave është i klasit të IV^{të} dhe VI^{të} dhe kërkojnë masa të posaçme për mbrojtjen nga erozioni. Rendimentet janë të ulëta dhe kërkojnë masa përmirësuese në mënyrë që të mundësojnë një prodhim të sigurt dhe racional.

Në komunën e Rahovecit janë prezentë edhe këto nënlloje të tokave:

- Rendzinë e hinjtë – kafe me substratet gëlqerorë të butë;
- Rendzinë tipike – në substratate gëlqerore;
- Rendëzinë e hinjtë – me substratet gëlqerore;
- Rendzinë tipike – mbi serpentine;
- Rendzinë e hinjtë – kafe mbi serpentine; dhe
- Rendzina tipike dhe e hinjtë - kafe në serpentine.

Këto llojet shtrihen ose janë në pjesët veri-perëndimore të komunës, rreth këtyre fshatrave: Drenoc, Zatriq, Kaznik, Petkoviq, Mrasor, etj.

Tokat Smonicë. Ky tip i tokës përfshinë pjesën dërmuese të territorit të komunës së Rahovecit. Këto toka, së bashku me tokat aluvijale, paraqesin, sipërfaqet bujqësore të kësaj komune.

Smonicat e eroduara - Sipërfaqet e këtyre tokave shtrihen në lindje të Rahovecit. Në pjesët kodrinore erozioni ka bartë pjesën më të madhe të tokës humusore. Këto toka janë të thellësisë mesatare dhe të cekëta, me përbërje argjilore, me përbërje karbonatike të ndryshuar, me reaksion neutral e të dobët alkal, me përmbajtje të zvogëluar të humusit si dhe me përbërje të ndryshuar të formës aktive të fosforit dhe kaliumit. Këto sipërfaqe nuk mund të përdoren për të gjitha kulturat bujqësore. Këto sipërfaqet janë të bonitetit të klasës III^{të} dhe IV^{të}. Në territorin e kësaj komune dallohen këto nënlloje:

Smonicë e pa karbonizuar - Areali kryesor me Smonicë të pa karbonizuar shtrihet rreth fshatrave: Polluzhë, Dejnë, Bratatin, Dabidol.

Smonicë në proces të kafenjëzuar dhe Smonicë e kafenjëzuar - Përfshinë një pjesë të vogël të komunës në veri-perëndim, ndërmjet fshatrave Kramovik dhe Petkoviq te Saroshi e tjerë. Areali kryesor i kësaj toke shtrihet në parcelat kadastrale të këtyre fshatrave: Nashpall, Sapniq, Bërnjakë, Retijë dhe komunën kadastrale të Rahovecit.

Smonicë e lesivuar me pseudoglej - Sipërfaqet kryesore shtrihen në perëndim të territorit të komunës, në lindje të fshatrave Dabidol, Dejnë, Ratkoc dhe Radostë (Malësi të Vogël).

Smonicë e eroduar - Në territorin e kësaj komune paraqiten së bashku me tokat të lesivuara, me proces të kafenjëzuar. Sipërfaqet kryesore në këtë nënlloj të smonicës të eroduar janë rreth këtyre fshatrave: Pataqan i Epërm, Pataqan i Poshtëm, Bernjakë, Retijë, Nagavc, Celinë, etj.

Tokë e Kuqe mbi formacionet gëlqerore - Kompleksi kryesor i këtyre tokave ndodhet në lindje të komunës, rreth fshatrave Opterush dhe në Zatriq.

Toka e Kuqe e cekët mbi formacione gëlqerore -Përfshinë një sipërfaqe të vogël ne komunën e Rahovecit dhe atë në veri-lindje të fshatit Opterush.

Toka e kuqe e kafenjëzuar mbi formacione të forta - Ky lloj i tokave paraqitet vetëm në Gradishtë te Ura e Shenjtë dhe zë sipërfaqe të vogël.

Tokë e kuqërremte rrënore, deltinor mbi sendimentet të kuqërremtë - Ky lloj i tokës është e përqendruar në vetëm disa hektarë në jug-lindje të Rahovecit, rreth fshatit Hoçë e Madhe. Paraqitet në pjesët kodrinore dhe atë në lartësitë mbidetare rreth 500 m.

Tokë e kuqe kafe e lesivuar mbi sedimentet e kuqërremte - Kjo lloj toke është e koncentruar në sipërfaqet e komunës së Rahovecit, rreth fshatit Krushë e Madhe.

Tokë e kafenjtë deltinore mbi argjilë liqenore - Kjo lloj toke përfshinë pjesët prej malit të Shkozës dhe duke zbritur kah Drini i Bardhë, posaçërisht përshin sipërfaqet e konsiderueshme kah jugu dhe jug-lindje e Rahovecit dhe Hoçës së Madhe deri te Bellacërka dhe Celina. Lartësia mbidetare e këtyre tokave është rreth 450 m.

Shkëmbinjtë ultra bazik - Kjo tokë nuk ka rëndësi të madhe për bujqësi për komunën e Rahovecit. Përshin sipërfaqe të vogël dhe atë rreth fshatit Drenoc dhe Zatriq. Kjo hapësirë është e mbuluar me pyje dhe kullosa.

Tokë pseudogleje – podzol - Në territorin e komunës së Rahovecit kjo lloj toke përfshin sipërfaqe të vogël në jug-perëndim të komunës dhe atë në fshatin Xërxë.

Tokë pseudogleje – argjilore - Kjo lloj toke përfshin pjesën më të vogël të komunës dhe atë rreth fshatit Kramovik.

Shkëmbinjtë - Sipërfaqe nën shkëmbinjtë ka posaçërisht në pjesët kodrinore-malore të komunës, rreth fshatit Kaznik dhe Zatriq. Këto janë sipërfaqe joproduktive.[1]

Një pasqyrë më e qartë mbi shtrirjen e llojeve të tokave është paraqitur në tabelën në vijim:

	Lloji i tokës (% e sipërfaqes së tërësishme)							
Vendbanimi	Tokë Aluviale	Tokë Deluviale	Rendzina	Smonic	Tokë e Kuqe	Argjila Liqenore	Shkëmbinjtë Ultra bazik	Shkëmbinjtë
Rahovec		10	35	40	15			
Bellacërkë (Fortesë)	15	40		20		15		
Bërnjakë		20	80					
Bratatin			100					
Brestoc	18			15	40	27		
Celinë		20		30		50		

[1]Data GIS consulting Nëntor 2011

Çifllak	50	50						
Dabidol	30	40		30				
Dejnë	30	40		30				
Drenoc		45	18	12			25	
Gexhe	20	40		30	10			
Hoçë e Madhe				20	30	50		
Hoçë e Vogël								
Kaznik		25	20		18		17	20
Kramovik	10		60	20			10	
Krushë e Madhe	30	40		10	20			
Mrasor	10		80	10				
Nagavc	10			80		10		
Nashpall				100				
Opterush		20	08	35	15	30		
Pastaselë		30		50	20			
Pataqan i Epërm				100				
Pataqan i Poshtëm		10		90				
Petkoviq (Guri i Kuq)		10	50	40				
Polluzhë				100				
Radostë (Malësia e Vogël)	30	35		35				
Ratkoc	30	20		50				
Reti e Poshtme		20		80				
Retijë		20		80				
Sapniq		10		90				
Senoc		30		50	20			
Vrajakë				100				
Xërxë	20	60					20	
Zatriq			90					10
Zaqishtë		10		35	20	35		

Tabela 3 Karakteristikat pedologjike nëpër vendbanime

Klasën dominuese të kësaj toke në këtë n1jësi e përbëjnë Rendizanat substrakt gëlqeror dhe sepertine me pjesëmarrje prej 22.8%, duke u përcjellë nga tokat e kuqe të cekëta dhe kafenjëzuara mbi gurë gëlqeror të fortë me pjesëmarrje 30% si dhe tokat e kafenjta me pjesëmarrje prej 29%.

Nr.	Emërtimi i llojit të tokës	Pjesëmarrja	Sip. në Ha
1.	Litosol mbi formacione shkëmbijsh ultra bazik (serpentinet)	0.24	18.17
2.	Litosol mbi formacione shkëmbinjsh gëlqeror të thukur	0.53	40.94
3.	Aluvium zallore	1.20	92.2
4.	Aluvium teltyrore	1.81	139.25
5.	Deluvium teltyrore	6.85	526.68
6.	Aluvionale-devulionale-telturore	0.33	25.68
7.	Tokë Livadhe Telturore	0.19	14.97
8.	Rendzine e hijt-kafe mbi substrakt qëlqeror të butë	0.65	50.18
9.	Rendzine tipike mbi substrakt qëlqeror të fortë	18.90	1.454.14
10.	Rendzine e hijt-kafe mbi substrakt qëlqeror të fortë	21.37	1.644.23
11.	Rendzine tipike mbi serpentinë	15.45	1.188.52
12.	Rendzine e hijt-kafe mbi serpentinë	11.57	889.71
13.	Smonicë e pa karbonizuar	1.31	101.1
14.	Smonicë në proces të kafenjëzimit	4.82	371.12

15.	Smonicë e kafenjëzuar	0.38	29.26
16.	Smonicë e lesivuar me pseudoglej	0.00	0.26
17.	Smonicë e eroduar	0.61	46.77
18.	Tokë e kuqe e cekët mbi formacion gëlqerorë të fortë	2.29	175.91
19.	Tokë e kuqe mesatarisht e thellë mbi formacion gëlqerorë të fortë	1.68	128.92
20.	Tokë e kuqrrimt-kafe e lesivuar mbi sendimente të kuqërrimit	2.37	181.97
21.	Tokë e kafenjtë argjilore mbi argjile liqeni	1.05	80.55
22.	Tokë e kafenjtë mesatarisht e thellë |-½ mbi supstrat ultra bazik	3.77	289.67
23.	Tokë pedzollake-pseudoglej	0.34	26
24.	Pseudoglej argjilore	0.27	20.91
25.	Shkëmbinj	2.02	155.41
Totali		100	7.692.52

Tabela 4 Klasifikimi i tokave


Klasa dominuese sipas tabelës së mësipërme, janë tokat e tipit Rendzina, të cilat marrin pjesë me rreth 68% të sipërfaqes së tërësishme.

2.3.2.2. BONITETI

Në bazë të hulumtimeve dhe analizave të bazuara në Atlasin e Hidroekonomisë së Kosovës, shkalla e shtrirjes së bonitetit është si vijon:

BONITETI		
Klasa e Bonitetit	Sip në ha	%
2	3,807	13.8
3	17,690	64.2
4	1,560	5.7
5	485	1.7
6	191.5	0.7
7	3,816	13.9
Gjithsej	27,589	

Tabela 5 Boniteti



Harta 6 Harta e boniteti të tokës

2.4. DEMOGRAFIA

Zhvillimi demografik është një fushë mjaft komplekse dhe me rëndësi të veçantë për planifikim dhe zhvillimin e përgjithshëm të një vendi. Parashikimi demografik për të ardhmen është llogaritur duke analizuar vlerat e rritjes-zvogëlimin e popullsisë sipas regjistrimeve zyrtare, rrethanat që ndikuan në ngritje apo rënie, si dhe të dhënat nga Agjencia e Statistikave të Kosovës mbi shtimin natyror, nataliteti dhe mortaliteti si komponenti themelor që ndikon drejtpërdrejtë në rritjen demografike dhe veçanërisht strukturën sipas grup-moshës, ka një rëndësi të veçantë në sferën e planifikimit hapësinor të territorit, jo vetëm për faktin që na mundëson me njohjen e gjendjes ekzistuese, mirëpo mundëson edhe planifikimet hapësinore të territorit. Komuna e Rahovecit, sikurse edhe Kosova në përgjithësi, ende ka popullatë në moshë të re, mirëpo tendencat e ndryshimeve demografike po shkojnë drejt zvogëlimit të grup-moshave të reja dhe rritjes së moshës së mesme, posaçërisht grup-moshës së tretë të popullsisë. Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Rahovecit kishte gjithsej 56,208 banorë rezident, gjersa sipas Vjetarit të Vlerësimit të Popullsisë 2022 të ASK-ës, gjatë vitit paraprak kanë jetuar 55,391 banorë rezident. Shtrirja e popullatës në komunë është më shumë në zonë rurale sesa urbane, me 15,892 banorë në zonën urbane (28.7%) dhe 40,316 (71.3%) në zonat rurale.

Nr.	Komuna	Gjithsej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2020)	Shtimi natyror	Bilanci i migrimeve	Rritja e përgjithshme	Gjithsej popullsia dhe shtimi natyror (31.12. 2021)
1.	Deçan	42,480	275	-265	10	
2.	Gjakovë	94,334	590	-2,097	-1,507	**92,827**
3.	Gllogoc	61,145	794	-1,218	-424	**60,721**
4.	Gjilan	77,145	485	-4,112	-3,627	**73,518**
5.	Dragash	33,947	87	-552	-465	**33,482**
6.	Istog	41,181	216	-278	-62	**41,119**

7.	Kaçanik	34,672	316	-321	-5	34,667
8.	Klinë	40,490	423	-738	-315	40,175
9.	Fushë Kosovë	39,948	484	-1,175	-691	39,257
10.	Kamenicë	27,948	69	-1,851	-1,782	26,166
11.	Mitrovicë	69,331	535	-1,628	-1,093	68,238
12.	Mitrovicë e V.	11,994	-7	-105	-112	11,882
13.	Leposaviq	13,202	-28	-293	-321	12,881
14.	Lipjan	57,928	673	-1,144	-471	57,457
15.	Novobërdë	7,158	-1	-87	-88	7,070
16.	Obiliq	18,218	201	-1,155	-954	17,264
17.	Rahovec	57,047	528	-2,184	-1,656	55,391
18.	Pejë	98,601	472	-1,802	-1,330	97,271
19.	Podujevë	82,022	996	-2,496	-1,500	80,522
20.	Prishtinë	218,781	1,542	-1,306	236	219,017
21.	Prizren	194,581	1,300	-2,075	-775	193,806
22.	Skenderaj	52,714	563	-691	-128	52,586
23.	Shtime	27,449	330	-825	-495	26,954
24.	Shtërpcë	6,621	-41	-77	-118	6,503
25.	Suharekë	58,195	683	-2,512	-1,829	56,366
26.	Ferizaj	106,286	1,092	-1,715	-623	105,663
27.	Viti	47,896	394	-817	-423	47,473
28.	Vushtrri	62,925	548	-2,459	-1,911	61,014
29.	Zubin Potok	6,664	-14	-45	-59	6,605
30.	Zveçan	7,290	-55	-43	-98	7,192
31.	Malishevë	57,261	893	-2,276	-1,383	55,878
32.	Junik	6,383	21	-45	-24	6,359
33.	Mamushë	5,874	75	-139	-64	5,810
34.	Hani i Elezit	10,090	81	-60	21	10,111
35.	Graçanicë	12,230	-81	9	-72	12,158
36.	Ranillug	3,737	-31	-8	-39	3,698
37.	Partesh	1,699	-16	-8	-24	1,675
38.	Kllokot	2,719	-1	-13	-14	2,705
Gjithsej		1,798,186	14,391	-38,606	-24,215	1,773,971

Tabela 6 Shtesa e Popullsisë në Komunat e Kosovës

Përgjatë një dekade dallohet që Kosova ashtu sikundër Komuna e Rahovecit nuk kanë pasur rritje të popullsisë krahasuar me ritmet në vitet e kaluara. Kjo situatë na bën të kuptojmë se kemi të bëjmë me zvogëlim të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune.

Vitet	Numri i popullsisë
Regjistrimi 1948	20,350
Regjistrimi 1953	22,687
Regjistrimi 1961	26,839
Regjistrimi 1971	35,215
Regjistrimi 1981	46,459
Vlerësimi i 1991 (vlerësim i bërë nga Komuna)	59,877
Regjistrimi i vitit 2011	56,208
Vlerësimi i Vjetarit 2022	55,391

Tabela 7 Numri i popullsisë rezidente të Rahovecit ndër vite 1948-2011


Nëse bëjmë një krahasim të lëvizjes së numrit të popullsisë nëpër vite të regjistrimit kemi këto rezultate. Në vitin 1948 Rahoveci kishte 20,350 banorë, ndërsa të dhënat e fundit tregojnë se numri i banorëve në komunë sillet rreth 56,208 banorë, që do të thotë se për këtë periudhë kohore (62 vjeçare) numri i popullsisë është rritur për më shumë se tre herë.

2.4.1. STRUKTURAT E POPULLSISË

Struktura e popullsisë është e lidhur ngushtë me lëvizjen natyrore dhe mekanike të popullsisë. Kjo strukturë mund të shqyrtohet nga aspekti biologjik, ekonomik, social, nacional, fetar, etj.

2.4.1.1. MOSHA DHE STRUKTURA GJINORE E POPULLSISË

Struktura e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë ka rëndësi jashtëzakonisht të madhe për zhvillimin demografik dhe ekonomik të një vendi, si për të tanishmen ashtu edhe për të ardhmen. Nga këto struktura kanë ndikuar shumë faktor demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Rahovecit në aspektin e zhvillimit demografik ka veçoritë e saj edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Deri në vitet e 90-ta në komunën e Rahovecit ka dominuar plotësisht tipi progresiv I popullsisë, ku shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit kanë ndikuar drejtpërdrejtë në krijimin e këtij tipi të popullsisë. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëherë edhe me ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Ndryshimi i rrethanave socio-ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta, kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëkohësisht edhe ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, grafikun me poshtë i popullsisë në komunën e Rahovecit kishte bazë të zgjeruar me dominimin e grup-moshave 0 deri 19 vjeç. Gjatë analizës së të dhënave demografike për vitin 2011, kur komuna e Rahovecit ka bërë edhe regjistrimin e popullsisë, vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë.



Grafikoni 1 Popullsia në Komunën e Rahovecit sipas grup – moshës dhe gjinisë, 2011 (ASK)

Të dhënat për grup-moshën janë marr nga vlerësimi i ASK-së 2011 në këtë analiza vërejmë re se grup-mushatë me të reja të popullsisë në Rahovecit 0-9 dhe 10-20. Nga grafiku i popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 9 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup-moshën 10 deri 19 vjeç dhe 20 deri 29 vjeç.

Grup mosha	1981	%	1991	%	2011	%	Indeksi 1981/2011
0-4	235,912	14.9	263,302	13.5	149,735	8.6	63.5
5-9	221,376	14	238,690	12.2	160,916	9.2	72.7

10-14	198,699	12.5	228,537	11.7	176,926	10.2	89.1
15-19	172,284	10.9	213,281	10.9	174,932	10.1	101.5
20-24	140,052	8.8	187,693	9.6	161,467	9.3	115.3
25-29	111,499	7	162,378	8.3	141,268	8.1	126.7
30-34	92,034	5.8	131,835	6.7	130,542	7.5	141.8
35-39	76,214	4.8	104,208	5.3	124,912	7.2	163.9
40-44	73,758	4.7	86,227	4.4	108,142	6.2	146.6
45-49	64,328	4.1	71,768	3.7	94,988	5.5	147.7
50-54	55,533	3.5	69,403	3.5	80,625	4.6	145.2
55-59	35,975	2.3	59,264	3.1	65,539	3.8	182.2
60-64	29,302	1.8	49,748	2.5	53,048	3	181.1
65-69	26,235	1.7	30,593	1.6	44,056	2.5	167.9
70-74	22,291	1.4	22,762	1.2	33,807	1.9	151.7
75+	23,901	1.2	36,507	1.7	38,922	2.2	162.8
Gjithsej	158,4440	100	1,956,196	100	1,739,825	100	1.09

Tabela 8 Trendi i lëvizjes së numrit të popullsisë e Kosovës sipas grup moshave 1981-2011

Grup moshat e reja (20-39 vjet) në raport me vitin 1981 ka treguar rritje për 138,390 persona dhe zvogëlim për -27,925 persona krahasuar me 1991, ndërsa pjesëmarrja në popullsinë e përgjithshme është rritur 26.6 (1981) në 32.1% (2011), ndërsa në raport me vitin 1991 është zvogëluar për -4.8%. Popullsia e grup moshave të pjekura të moshuara (40-59 vjet) kanë treguar tendencë të vazhdueshme të rritjes për 119700 persona në raport me 198.[2]

2.4.1.2. STRUKTURA ETNIKE E POPULLSISË

Në aspektin etnik komuna e Rahovecit ka një ka një popullsi mjaft homogjene ku mbi 95% e popullsisë janë shqiptarë.

	Shqiptarë	Serbë	Turq	Boshnjakë	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Të tjerë	Preferojnë të mos	Nuk janë në dispozicion
Rahovec	55,166	134	2	10	84	404	299	11	15	83
%	98.15%	0.24%	0.00%	0.02%	0.15%	0.72%	0.53%	0.02%	0.03%	0.15%

Tabela 9 Pjesëmarrja e etniteteve në komunë (ASK 2011)

Sipas të dhënave nga regjistrimi zyrtar i ASK-së i bërë në vitin 2011, i cili është regjistrimi i fundit zyrtar për komunën e Rahovecit, popullsia shqiptare dominon me 98.15% ndërsa etnitetet tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël, Serbet me 0.24% dhe Romët me 0.15%, etj.

2.5. KAPACITETET FINANCIARE TË KOMUNËS

Përmbledhje e financimit komunal për vitin 2019-2023

	2019	2020	2021	2022	2023
Totali i buxhetit	13,658,895.00	14,735,819.00	14,216,590.00	15,864,235.00	16,282,825.00
Të hyrat Vetanake	1,168,767.00	1,156,841.00	1,061,093.00	1,318,177.00	1,429,019.00
Huamarrja	168,618.00	-	-	-	-
Granti	12,321,510.00	13,578,978.00	13,155,497.00	14,546,058.00	14,853,806.00
Granti i përgjithshëm	5,231,296.00	5,843,393.00	5,433,657.00	5,706,916.00	5,974,793.00

[2] Behrami S., Bajraktari F.,(2015). "The demographic aging process in Kosovo- perspectives and challenges", 18th International Information Society – IS 2015 Multiconference", Facing Demographic Challenges. Volume B. Ljubljana , Slovenia.

Granti për Shëndetësi	1,686,240.00	1,889,703.00	1,951,048.00	2,590,376.00	2,603,328.00
Granti për Arsim	5,380,480.00	5,820,978.00	5,745,764.00	6,223,738.00	6,250,657.00
Këshilli i Hoçës së Madhe	23,494.00	24,904.00	25,028.00	25,028.00	25,028.00
Huamarrja në Arsim	33,719.00				
Huamarrja në Shëndetësi	134,899.00				

Tabela 10 Projeksionet e të Hyrave Vetanake Komunale 2021 -2023 dhe realizimi 2019-2020

Realizimi i THV në 2019	Realizimi i THV në 2020	Planifikimi për 2023	Planifikimi për 2024	Planifikimi për 2025
1,308,518.37	1,395,667.65	1,061,093.00	1,318,177.00	1,429,019.00

Tabela 11 Realizimi dhe planifikimi i të Hyrave Vetanake Komunale 2021 -2023 dhe realizimi 2019-2020

2.5.1. KAPACITETET INVESTIVE

Në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara nga Qarkorja Buxhetore Komunale 2019/01 të lëshuar nga Ministria e Financave në pajtim me LIGJI NR. 03/L-048 PËR MENAXHIMIN E FINANCAVE PUBLIKE DHE PËRGJEGJËSITË, Komuna e Rahovecit ka hartuar Kornizën afatmesme buxhetore komunale. Korniza afatmesme buxhetore komunale përcakton sektorët prioritar të zhvillimit të komunës në tri vitet e ardhshme, si dhe ofron projeksionet lidhur me mënyrën në të cilën buxheti i komunës do të bëj përmbushjen apo përkrahjen e prioriteteve, si dhe parashikimet rreth performancës ekonomike të komunës.

Në bazë të planifikimit të bërë nga viti 2021 grandet qeveritare për komunën e Rahovecit si tërësi do të shënojnë rritje prej 4,16% në vitin 2022. Rritja e Grandit Qeveritar do të jetë 4.16% në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, ndërsa të hyrat vetanake në vitin 2022 do të kenë një rritje prej: 27.27% në krahasim me vitin 2021.

Nga viti 2022-2024 parashihet një rritje prej 13.05% në tërësi, sipas të dhënave të prezantuara në tabelën 2 më poshtë, në Grandin qeveritar parashihet të ketë rritje prej 12.49% ndërsa në të hyrat vetanake 19,67% kjo rritje kryesisht bazohet në të dhënat e përgjithshme për rritjen buxhetore që planifikohet në nivel të Qeverisë Nacionale, siç parashihet me qarkoren 2022/01 (KASH 2022-2024).

Komuna e Rahovecit vazhdon të dominohet në buxhetin total të saj nga transferet qeveritare të cilat edhe në tre vitet e ardhshme do të përbëjnë afërsisht 90% të buxhetit total të komunës.

Financimi nga donatorët e jashtëm dhe të brendshëm do të vazhdojnë edhe gjatë vitit 2022-2024 në shumë fusha si në arsim, shëndetësi, infrastrukturë, urbanizëm dhe mjedis, zhvillimin ekonomik, etj.

Sipas rekomandimeve të Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar të komunikuara përmes Qarkores Buxhetore Komunale 2022/01 komunat do të kenë edhe në të ardhmen fleksibilitet në shpërndarjen e të hyrave vetanake komunale në strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2022, duke përjashtuar kategorinë Paga dhe Mëditje.

Projeksionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2022 paraqiten sipas kategorive ekonomike:

- Pagat dhe Mëditjet: 7,872,844.00 €
- Mallrat dhe Shërbimet 1,735,000.00 €
- Shpenzimet Komunale 270,000.00 €
- Subvencionet dhe Transferet 360,000.00 €
- Shpenzimet Kapitale 4,815,816.00 €

TOTALI: 15,053,660.00 €.

2.5.2. INVESTIMET KAPITALE

Kjo kategori e shpenzimeve do të shënojë rritje në vitin 2022, për 12.33% krahasuar me vitin 2021. Një pjesë e madhe e tyre planifikohet të financohet nga të hyrat vetanake të komunës. Pjesëmarrja e investimeve kapitale në totalin e shpenzimeve të komunës në vitin 2022 dhe tutje pritet të jetë mesatarisht: 31.99%.




Tabela 12 Korniza Buxhetore Komunale 2022-2024, në euro.

	Përshkrimi	2021	2022	2023	2024
			(plani)	(vlerësimet)	(vlerësimet)
1	**TË HYRAT TOTALE KOMUNALE**	**14,216,590.00**	**15.053.660.00**	**15.813.281.00**	**16.582.931.00**
	Të hyrat vetanake	1,061,093.00	1.350.548.00	1.458.405.00	1.522.116.00
	Grandet dhe transferet qeveritare	13,155,497.00	13.703.112.00	14.354.876.00	15.060.815.00
2	**SHPENZIMET TOTALE KOMUNALE**	**14,216,590.00**	**15,053,630.00**	**15,813,251.00**	**16,782,883.00**
	Shpenzimet rrjedhëse	**10,830,050.00**	**10,237,844.00**	**10,832,487**	**11,209,237.00**
	Pagat dhe mëditjet	7,622,634.00	7,872,844.00	8,266,487.00	8,679,798.30
	Mallrat dhe shërbimet	1,715,477.00	1,735,000.00	1,805,000.00	1,857,439.30
	Shpenzimet komunale	280,500.00	270,000.00	281,000.00	282,000.00
	Subvencionet	311,000.00	360,000.00	380,000.00	390,000.00
3	**Shpenzimet Kapitale**	**4,286,979.00**	**4,815,816.00**	**5,080,794.00**	**5,373,693.40**
	Huamarrja e jashtme	0.00	0.00	0.00	0.00

Siç u përshkrua më lart, sipas Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) 2022-2024, parashihet që buxheti vjetor i Komunës të jetë rreth 15,053,660.00 €/vit (viti 2022), ndërsa për vitin 2023 buxheti i planifikuar është 15,813,281.00 € dhe për vitin 2024 planifikohet një buxhet prej 16,582,931.00 €.

Një strukturë e tillë e buxhetit, dëshmon që edhe më tej Komuna e Rahovecit do të mbetet kryesisht në nivel të plotësimit të nevojave elementare, atë të mbulimit të pagave për punonjësit e sektorit publik në nivel komunal (administratë, shëndetësi, arsim) dhe të mbulimit deri në një masë të nevojave sociale dhe infrastrukturës teknike. Bazuar në këtë nivel, është vështirë e pritshme, që përmes buxhetit komunal të ndikohet në mënyrë të theksuar në rritje të punësimit dhe zhvillim komunal të qëndrueshëm.

Nga ana tjetër varësia e theksuar nga grantet qendrore qeveritare, dëshmon për një pozitë të vështirë të qëndrueshmërisë financiare të Komunës. Ashtu siç u përshkrua më lart mbi 90% të burimeve të hyrave komunale vijnë nga niveli qendror. Komuna duhet të punojë edhe më tutje në drejtim të fuqizimit të kapaciteteve për rritje të arkëtimit të hyrave vetanake të komunës, me theks të veçantë të Tatimit në Pronë.

2.6. ZHVILLIMI EKONOMIK

Një zhvillim inicial fillon pas viteve të 60-ta, por deri në përfundim të shekullit XX zhvillimi ekonomik dhe shoqëror në komunën e Rahovecit sikurse edhe në tërë Kosovën karakterizohej me tre probleme të mëdha: struktura jo e volitshme e ekonomisë, aftësia e dobët akumuluese dhe papunësia.

Në vitet e 80-ta dhe të 90-ta komuna e Rahovecit sikurse edhe tërë Kosova u shndërrua në koloni dhe zonë të okupimit klasik serb.

Krahas këtyre rrethanave të zhvillimit ekonomik, edhe struktura ekonomike në komunën e Rahovecit ka karakteristikat e veta.

2.6.1. EKONOMITË LOKALE DHE FAMILJARE

Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomik, social, demografik, etj.

Siç dihet, ekzistojnë dallime sipas komunave në Kosovë sa i përket madhësisë së familjes. Komuna e Rahovecit kryesisht karakterizohej me numër të madh të anëtarëve të familjes, që është karakteristikë për vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale. Ky fenomen ka filluar të ndryshojë viteve të fundit, ku trendi i numrit të anëtarëve në familje është duke u zvogëluar.

Nr. i anëtarëve	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	Total
Gjithsej ekonomi familjare	144	339	494	1,033	1,516	1,332	900	581	453	1,429	8,221

Tabela 13 Numri i ekonomive familjare varësisht nga numri i anëtarëve të familjes (ASK 2011)

Në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve për numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare në komunën e Rahovecit, rezulton se ekonomi familjare me 5 anëtarë në familje ka më së shumti, ndërsa ajo me vetëm një anëtarë është në numër shumë më të vogël.

Ekonomi familjare me 1 - 3 anëtarë ka mjaft pak dhe kjo është një dëshmi se, me gjithë transformimet socio-ekonomike dhe të tjera, proceset e modernizimit të shoqërisë në komunën e Rahovecit nuk kanë qenë të fuqishme për të kushtëzuar ndryshime rrënjësore në përbërjen e ekonomive familjare përmes shthurjes së ekonomive të zgjeruara tradicionale familjare në të ashtuquajtura familje nukleare, siç ka ndodhur në vendet e tjera të zhvilluara.

2.6.2. PUNËSIMI DHE PAPUNËSIA

Papunësia është një ndër problemet me të cilën më së shumti po përballet shoqëria kosovare. Sipas ASK-së në vitin 2020 shkalla e papunësisë në Kosovë është më e larta në rajon. Kjo shkallë e lartë e papunësisë është 25.7%. Vlerësohet se 1/3 e popullsisë së Kosovës është nën moshën 16 vjeç, ndërkaq rreth 59.5% e popullsisë janë në moshë pune. Sipas të dhënave aktuale të drejtorisë përkatëse komunale, në komunën e Rahovecit shkalla e papunësisë është rreth 28.4%.

Gjinia	Numri i të punësuarve	%
Meshkuj	7,591	89.44%
Femra	896	10.56%
Gjithsej	8,487	100.00%

Tabela 14 Numri i të punësuarve sipas gjinisë (ASK 2011)

Edhe pse nuk ka të dhëna të sakta për shkallën e papunësisë, hulumtimet e ndryshme vlerësojnë se papunësia është e lartë.

Nr.	Vendbanimi	Nr. i ndërmarrjeve tregtare	Nr. i të punësuarve	Ndërmarrjet Private	Ndërmarrjet Shoqërore
1.	Bellacërkë (Fortesë)	38	67	38	
2.	Bërnjakë	2	280	2	
3.	Bratatin	2	1	1	
4.	Brestoc	4	4	4	
5.	Celinë	9	9	9	
6.	Çifllak	16	25	16	
7.	Dabidol	3	3	3	
8.	Dejnë	15	26	15	
9.	Drenoc	12	11	12	
10.	Gexhe	9	23	9	
11.	Hoçë e madhe	-	-	-	5 punëtorë PTK
12.	Hoçë e vogël	10	9	10	
13.	Kaznik	-	-	-	
14.	Kramovik	20	29	20	
15.	Krushë e Madhe	86	150	86	5 punëtorë PTK
16.	Mrasor	-	-	-	
17.	Nagavc	5	5	5	
18.	Nashpall	1	1	1	
19.	Opterush	11	9	11	
20.	Pastaselë	2	4	2	
21.	Pataqan i Epërm	1	1	1	
22.	Pataqan i Poshtëm	4	4	4	
23.	Petkoviq (Guri i Kuq)	3	2	3	
24.	Polluzhë	6	7	6	
25.	Radostë (Malësi e Vogël)	6	8	6	
26.	Rahovec	699	1,398	699	70 punëtorë “Ambienti”
27.	Ratkoc	69	114	69	
28.	Reti e Poshtme	-	-		
29.	Retijë	4	4	4	
30.	Sapniq	4	4	4	
31.	Sarosh	-	-	-	
32.	Senoc	7	13	7	
33.	Vrajakë	2	2	2	
34.	Xërxë	121	275	121	
35.	Zatriq	1	1	1	
36.	Zaqishtë	4	5	4	

Tabela 15 Numri i bizneseve dhe të punësuarve sipas vendbanimeve

Në tabelat e mëposhtme janë të paraqitura numri i bizneseve tregtare dhe numri i të punësuarve në komunën e Rahovecit përpos vetë qytetit.

Nd. industriale/ Nr. i të punësuarve	Nd. Ushqimore/ Nr. i të punësuarve	Nd. Ndërtimore/ Nr. i të punësuarve	Drurit/ Nr. i të punësuarve	Industri e metaleve dhe kimike/ Nr. i të punësuarve	Degët tjera të industrisë
	1/7				
	2/20				

12/351		2/17	1/4	2/22	6
4/140	1/70	30/100	10		

Tabela 16 Bizneset tregtare dhe numri i të punësuarve

Numri i bizneseve të regjistruara për periudhën (viti 2000 – Prill 2018), të shprehur në numër si dhe në vendbanime paraqitet kjo gjendje:

Nr.	Përshkrimi	Shprehur në numër
1.	Biznese të regjistruara : 2000 –dhjetor 2021	3,390
2.	Biznese Aktive	2,966
3.	Biznese Pasive	249
4.	Biznese të shuara për : 2000 – 29.05.2018	384
5.	Numri i punëtorëve, për Biznese Aktive:	5,618
6.	Numri i punëtorëve, për Biznese Pasive:	365
7.	Numri i punëtorëve për biznese të shuara:	679

Tabela 17 Regjistrimi i bizneseve në periudha

Nr.	Emri i biznesit	Vendi	Nr.	Emri i biznesit	Vendi
1.	"Kzone" shpk	Xërxë	24.	Hajrush Isma BI	Rahovec
2.	"Beni-H" shpk	Kramovik	25.	"Haxhimustafarchitecture" shpk	Rahovec
3.	"Harley Hous" shpk	Xërxë	26.	Albine Nurshaba BI	Rahovec
4.	Afrim T. Gashi BI	Dabidol	27.	Sabahate Mazreku BI	Retijë
5.	Valon Korenica BI	Rahovec	28.	Kapllan Morina BI	Senoc
6.	Briton Morina BI	Bellacërkë	29.	Nasip Popaj BI	Bellacërkë
7.	Merita GJ. Hoti BI	Ratkoc	30.	Lirie Berisha BI	Dejnë
8.	Esma Bytyqi BI	Rahovec	31.	Bekim Beqiraj	Guri i Kuq
9.	Luan Durguti BI	Rahovec	32.	Mahmut Shala BI	Zaqishtë
10.	"Globi Consulting" shpk	Ratkoc	33.	Hysen Bytyqi BI	Dejnë
11.	Veton Jupa BI	Rahovec	34.	Ruzhdi Morina BI	Senoc
12.	Buad Mazreku BI	Rahovec	35.	Besnik Bytyqi BI	Dejnë
13.	Gjelil Durguti BI	Rahovec	36.	"Ermiri" shpk	Rahovec
14.	"A.I.S Consulting" shpk	Rahovec	37.	Bujar Morina BI	Rahovec
15.	Ntsh" Xoni Petrol"	Ratkoc	38.	Hajdar Hoti BI	Rahovec
16.	Elisa Sokoli BI	Rahovec	39.	"Morina World Travel" shpk	Rahovec
17.	Arjete Haxhialiu BI	Rahovec	40.	Ntp "Cali"	Rahovec
18.	Emira Pista BI	Rahovec	41.	Ntp "Landi"	Rahovec
19.	Dafina Hasku BI	Rahovec	42.	"Cenbaza Group" shpk	Rahovec
20.	Bekim Salihi BI	Rahovec	43.	Nuredin Ramsha BI	Rahovec
21.	Muhamed Shabandula BI	Rahovec	44.	"Dali Dekor" shpk	Rahovec
22.	"Pria Home" shpk	Bërnjakë	45.	"Stone Castle Resort" shpk	Bërnjakë
23.	Sahare Gashi BI	Xërxë	46.	Ntsh "Euron"	Opterush
			47.	Dpt "Çlirimi"	Xërxë

Tabela 18 Emrat e bizneseve dhe vendi i tyre

Ndërsa sipas statistikave të fundit të ASK-së të vitit 2020 numri i ndërmarrjeve të reja në Rahovec gjatë vitit 2019 janë:

Gjithsej	A Bujqësi, pyltari dhe peshkatari	B Xehetari dhe gurëthyes	C Prodhim	D Furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar	E Furnizim me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash dhe aktivitete revitalizimi të tokës	F Ndërtimtari	G Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	H Transport dhe ruajtje	I Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	J Informacion dhe komunikim	K Aktivitete financiare dhe sigurimit	L Aktivitete të patundshmërisë	M Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	N Aktivitete administrative dhe mbështetëse	O Administratë publike dhe mbrojtje: sigurim social detyrueshëm	P Arsim	Q Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	R Art, zbavitje dhe rekreacion	S Aktivitete të shërbimeve tjera
130	0	1	42	1	-	12	32	5	15	2	0	0	7	5	0	0	1	0	7

Tabela 19 Ndërmarrjet e reja të regjistruara gjatë vitit 2019 (ASK 2020)

2.6.3. VARFËRIA


Edhe përkundër trendit të rritjes ekonomike, edhe në këtë kohë ka familje të cilat jetojnë në varfëri pasi që jetojnë me social.

Viteve të fundit, varfëria në komunën e Rahovecit, është në norma më të ulëta, pasi që ekonomia në këtë komunë ka filluar të rimëkëmbet. Po ashtu, rëndësi të veçantë në mirëqenien e qytetarëve të kësaj komune kanë edhe remitencat, si të hyra pothuajse të rregullta nga mërgimtarët tanë që jetojnë dhe veprojnë në diasporë. Si kategori me varfëri më të theksuar janë familjet që jetojnë me social.

Ekonomikisht aktive	Të punësuar	Të papunësuar, ka punuar më parë	Të papunësuar, nuk kanë punuar kurrë më parë	Të papunësuar, presin të fillojnë punën në të ciën janë pranuar	Ekonomikisht jo aktiv	Total
14,402	8,487	1,989	3,828	98	25,725	40,127

Tabela 20 Popullsia mbi moshën 15 vjeçare dhe statusi aktual i gjendjes ekonomike (ASK 2011)

Sipas hulumtimeve të bëra nga organizata të ndryshme përkatësisht UNDP-së, shkalla e përgjithshme e varfërisë në komunën e Rahovecit është 73.54%. Kemi këtë paraqitje të varfërisë:




Grafiku 1: Shkalla e varfërisë UNDP

Sipas hulumtimit të lartpërmendur 12.35% e popullsisë së kësaj komune jetojnë me një dollar në ditë për person, 69.57% e popullatës jeton me dy dollarë në ditë për person, në varfëri ekstreme jetojnë 10.86% e popullsisë dhe me varfëri të përgjithshme jetojnë 72.20% e popullsisë.

Ndërsa, pas grumbullimit të të dhënave nga Qendra për Punë Sociale për numrin e popullsisë me asistencë sociale, familjeve dhe kryefamiljarëve nëna me asistencë sociale dhe analizave të bëra na paraqitet shkallë e lartë e varfërisë ekstreme. Këto të dhëna, na ndihmojnë sadopak në paraqitjen e gjendjes ekzistuese të popullsisë për secilin vendbanim të komunës.

Sipas të dhënave del se në komunën e Rahovecit ekzistojnë 2,581 persona apo 590 familje që jetojnë me asistencë sociale, që nënkupton se kjo pjesë e popullsisë jeton në varfëri ekstreme. Ndërkaq, varfëria e përgjithshme përfshinë një përqindje më të madhe të popullsisë.

Me shkallë më të lartë të varfërisë është e prekur gjinia mashkullore me 75%, kurse me asistencë sociale 25% janë kryefamiljare nëna. Kjo shkallë e lartë e varfërisë është e shtrirë gjerësisht në tërë territorin. Për me tepër shih grafikonin:



Grafiku 2: Popullsia me asistencë sociale

Vendbanimet që kanë përqindje më të vogël të popullsisë me asistencë sociale janë Bellacërka, Nashpalli, Radosta, Sapniqi, Zaqishta, Polluzha, Krusha e Madhe, Kramoviku, Brestoci dhe Bratatini. Ndërsa vendbanimet me përqindje më të madhe të popullsisë me asistencë sociale janë: Kazniku, Senoci, Zatriqi, Petkoviqi dhe Dabidoli.

Në shkallën e lartë të varfërisë kanë ndikuar një mori faktorësh: shkatërrimet e luftës, shkalla e lartë e papunësisë, niveli i ulët i zhvillimit ekonomik, të ardhurat e vogla për kokë banori, arsimimi i pamjaftueshëm, etj. Të gjitha këto kanë bërë që ky problem të jetë kaq madhor.

Bazuar edhe në të dhënat statistikore (ASK 2011) tregojnë qartë shkallën e varfërisë në komunë.

Puna (përfshirë punën në pronën, biznesin e tij apo të familjes)	Patundshmëri, investime (qira, interes)	Pension	Ndihma sociale	Transfere tjera (përfitime nga papunësia, sëmundja dhe lehonie, bursë)	Remitanca (të ardhura nga familjarët në shtet tjera)	Mbështetje nga persona tjerë	Burime tjera
21791	159	2662	1683	120	4014	23849	1930

Tabela 21 Burimi kryesor i jetës (ASK 2011)

Njerëzit në kategoritë e mëposhtme ka të ngjarë të jetojnë në varfëri: të papunët, ata në punë me orar të reduktuar ose punë të pasigurta, të moshuarit, të sëmurët, të paaftët, si dhe anëtarët e familjeve të mëdha ose të familjeve me një prind, pensionistët, familjet me kryefamiljare nëna, etj. Papunësia e lartë e viteve të fundit pas '99 nuk duket se mund të bjerë në të ardhmen e afërt, ndërsa papunësia e tej zgjatur po i shtyn gjithnjë e më shumë familjet drejt varfërisë.

2.6.4. SEKTORËT EKONOMIKË DHE STRUKTURAT E TYRE

Duke marrë parasysh kushtet e favorshme topografike, klimatike dhe agro-ekologjike, puna në bujqësi, vreshtari dhe verari përbën aktivitetin themelor ekonomik në Rahovec në të gjitha aspektet duke përfshirë prodhimin, burimin e të ardhurave dhe punësimin.

2.6.4.1. BIZNESET DHE VEPRIMTARITË E TYRE

Komuna e Rahovecit është një komunë relativisht e zhvilluar ekonomikisht, zhvillimi i së cilës kryesisht vjen nga zhvillimi i bujqësisë, veçanërisht vreshtarisë. Komuna e Rahovecit me tërë historinë e pasur në prodhim të verës dhe tokën pjellore ka potenciale të mëdha për zhvillime në të ardhmen. Edhe pse industria e verës është vetëm një pikë në sektorin e bujqësisë së Kosovës, është potencial i suksesshëm në tregjet evropiane.

Zhvillimi ekonomik i Komunës së Rahovecit ka pjesëmarrje të rëndësishme në zhvillimin ekonomik të Kosovës. Kjo komunë është një qendër e vogël tregtare dhe ekonomike. Zhvillimi ekonomik i komunës është i orientuar me së shumti në bujqësi, vreshtari dhe perimekulturë.

Në fund të vitit 2014, në komunën e Rahovecit funksiononin 1,768 biznese, prej tyre 1,515 biznese në pronësi të meshkujve, kurse 250 në pronësi të femrave.[3]

Ndërsa në vitin 2020 në një studim të bërë për pasojat e shkaktuara të pandemisë COVID-19, statistikat e ARBK-së tregojnë për 3,223 biznese aktive në Komunën e Rahovecit, në listën e taksave komunale të Komunës ishin 1,982 biznese, kurse evidencat e ARK-së ishin për rreth 1,723 biznese aktive në komunë, duke e marrë parasysh edhe ekonominë joformale prej 30% (bazuar në të dhënat e shumë institucioneve si BB, FMN dhe raporte të ndryshme të besueshme për ekonominë joformale).

Më poshtë jepet një pasqyrë për 10 vitet e kaluara të ndërmarrjeve të regjistruara dhe të shuara brenda vitit të caktuar. Shohim së viti më i suksesshëm me krijimin e ndërmarrjeve të reja ishte viti 2016 me 246 ndërmarrje, pastaj viti 2013 me 212 ndërmarrje të reja, kurse si vitet më pasive ishin viti 2012 dhe 2020.

Indikatori	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Nr. i bizneseve të regjistruara	178	116	212	168	167	246	142	162	130	118	178
Nr. i bizneseve të shuara	7	115	19	25	42	97	48	52	52	33	59

Tabela 22 Numri i bizneseve të regjistruara dhe të shuara në Rahovec ndër vite (Burimi: Instituti GAP)

Duke pasur parasysh se Komuna e Rahovecit është një komunë jo e madhe, me 275.89 km² dhe me një numër relativisht të vogël të bizneseve, mund të themi se numri i ndërmarrjeve të shuara në vit është i madh dhe ka ndikim në përformancën e ekonomisë së komunës.

Në korrik të vitit 2021, në Komunën e Rahovecit ishin aktive 1,953 biznese. Përkundër pandemisë, numri i bizneseve në këtë komunë ka shkuar duke u rritur. Në sektorin privat në Komunën e Rahovecit janë të punësuar 3,440 persona.

[3] https://advocacy-center.org/wp-content/uploads/2018/09/Strategjia-per-grate-ndermarrese-ne-komunen-e-Rahovecit-2017-2022.pdf




Figura 3 Bizneset aktive dhe numri i të punësuarve në Rahovec ndër vite (Burimi: Instituti GAP)

Në çdo vit numri i bizneseve të reja është shumë më i madh se numri i bizneseve të shuara. Përveç 3,440 të punësuarve në sektorin privat në territorin e Komunës së Rahovecit, në sektorin publik në këtë komunë janë të punësuar edhe 1,184 persona.

Në komunën e Rahovecit veprojnë 1,000 biznese private, dhe veprimtaria e tyre është prodhuese, industriale, shërbyese dhe tregtare.[4]

Numri i ndërmarrjeve të regjistruara në TM1 2022 ishte 41, prej tyre 25 individuale dhe 16 jo-individuale.

	Bujqësi, pylltari dhe peshkatari	Xehetari dhe gurëthyes	Prodhim	Ndërtimtari	Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	Transport dhe ruajtje	Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	Informacion dhe komunikim	Aktivitete profesionale, shkencore dhe teknike	Aktivitete administrative dhe mbështetëse	Shëndetësi njerëzore dhe aktivitete të punës sociale	Art, zbavitje dhe rekreacion	Aktivitete të shërbimeve tjera	Gjithsej:
Të regjistruara	2		2	6	12	2	3	2	3	2	3	1	3	41
Të shuara		1		2	1		2						2	8

Tabela 23 Numri i ndërmarrjeve të regjistruara dhe të shuara në Rahovec, TM1 2022

Në vitin 2021 numri i ndërmarrjeve të regjistruara ishte 174, ku më së shumti kishte ndërmarrje prodhuese, ndërmarrje akomoduese dhe tregtare, pastaj ndërmarrje ndërtimore. Në vitin 2020 kishte 103 ndërmarrje të reja të regjistruara, një numër për 40.8% më i vogël se viti pasues, dhe në këtë vit me më së shumti ndërmarrje printe sektori i ndërtimtarisë, prodhimit dhe tregtisë.

[4] Plani Zhvillimor Komunal Rahovec 2018-2022 - Draft




Figura 4 Lloji dhe numri i ndërmarrjeve të regjistruara në dy vitet e fundit në Rahovec (Burimi: ASK)

Ndërsa, ndërmarrje të shuara në vitin 2020 ishin gjithsej 33, ku më së shumti që kishin mbyllur aktivitetet e veta ishin ndërmarrjet që merreshin me tregti, aktivitete të shërbimeve të ndryshme dhe prodhim. Në anën tjetër, në vitin 2021, ndonëse numri i ndërmarrjeve të reja ishte më i madh se viti paraprak, edhe numri i ndërmarrjeve të shuara ishte po ashtu dukshëm më i madh me gjithsej 59 ndërmarrje të shuara. Sektori i këtyre ndërmarrjeve të shuara i takon tregtisë, akomodimit, prodhimit, transportit e kështu me radhë, por të cilat janë në numër shumë të vogël.




Figura 5 Lloji dhe numri i ndërmarrjeve të shuara në dy vitet e fundit në Rahovec (Burimi: ASK)

Si përfundim, bazuar në llojin e krijimit dhe shuarjes së ndërmarrjeve, shihet se lëvizjet më të mëdha janë në sektorët e industrisë së prodhimit, tregtisë dhe ndërtimtarisë, dhe më pak ndërmarrje të sektorit të bujqësisë, dhe shërbimeve profesionale. Ndonëse në Komunën e Rahovecit aktivitetet bujqësore janë mjaftë të shpeshta, ky sektor nuk hyn në grupin e ndërmarrjeve që kanë numrin më të madh, ndonëse kanë lidhje të drejtpërdrejt me to përmes furnizimit me lëndë të parë.

2.6.4.2. EKONOMITË FAMILJARE

Komuna e Rahovecit kryesisht karakterizohet me numër të madh të anëtareve të familjes, që është karakteristikë për vise të pa zhvilluara dhe kryesisht rurale. Në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve për

numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare në vitin 2011në komunën e Rahovecit, del se mesatarja e madhësisë së familjes është 7.7 anëtar.

Ekonomi familjare me 1-3 anëtar ka mjaft pak dhe kjo është një dëshmi se, me gjithë transformimet socio-ekonomike dhe të tjera, proceset e modernizimit të shoqërisë në komunën e Rahovecit nuk kanë qenë të fuqishme për të kushtëzuar ndryshime rrënjësore në përbërjen e ekonomive familjare përmes shthurjes së ekonomive të zgjeruara tradicionale familjare në të ashtuquajtura familje nukleare, siç ka ndodhur në vendet e tjera të zhvilluara.

Në vitin 2020 Komuna e Rahovecit kishte të regjistruara rreth 3,000 ekonomi familjare, madhësia e të cilave ka rënë, dhe kjo vjen si rrjedhojë e migrimit dhe emigrimit, por edhe për arsye të nivelit të zhvillimit të standardit jetësor.

2.6.4.3. PUNËSIMI DHE PAPUNËSIA

Popullsia në moshë pune në Komunën e Rahovecit sipas statistikave numëron 36,984 individë në vitin 2021.[5] Kur e krahasojmë këtë shifër me vlerësimin e popullsisë për vitin 2020 që ishte 56.885 banorë[6], i bie që 65% e popullsisë së komunës është në moshë pune. Nga ky numër 50.3% janë meshkuj dhe 49.6% femra. Pjesa më e madhe e popullsisë në moshë pune i takon moshës 25-39 me 6,515 banorë, ku 59.6% janë meshkuj dhe 50.3% janë femra.

Grupmosha	Meshkuj	Meshkuj (%)	Femra	Femra (%)	Totali
15-24	6,094	52.3%	5,539	47.6%	11,685
25-39	6,515	59.6%	6,611	50.3%	13,186
40-54	4,325	49.3%	4,438	50.6%	8,812
55-64	1,565	48.1%	1,688	51.8%	3,301
Totali	18,499	50.3%	18,276	49.6%	36,984

Tabela 24 Popullsia në moshë punë në Rahovec, 2021

Të papunë të regjistruar në vitin 2021 ishin 1,043 individë, prej tyre 52.9% meshkuj dhe 47.0% femra. Sipas nivelit të edukimit më së shumti të papunë ka në kategorinë “Arsim i mesëm profesional” (viti 2020) dhe më së paku me nivel master të edukimit. Profesionet elementare kanë numrin më të madh të të papunëve, pasuar me punonjësit e zejeve dhe profesioneve të ngjashme, ndërsa numri më i vogël i të papunëve sipas profesioneve i takon kategorisë “Punëtorët e aftësuar në bujqësi, pylltari dhe peshkatarë”, dhe “menaxherë dhe operatorë dhe instalues në fabrika dhe makina”.

Papunësia më e lartë është e shprehur tek femrat në të gjitha kategoritë, me një diferencë në përqindje prej 14.61% në mesatare. Numri i punëkërkuesve total në vitin 2020 ishte 4,440, kurse në vitin 2020 ky numër ishte ulur për 20.97%, që kishte rënë në 3,509.[7]

[5] Barometri i Tregut të Punës në Kosovë

[6] ASK, 2021

[7] BTPK




Figura 6 Të papunët e regjistruar në Rahovec (Burimi: BTPK)

Në vitin 2016 në Komunën e Rahovecit vepronin 1000 biznese private, me veprimtari prodhuese, industriale, shërbyese dhe tregtare. Të punësuar në këto subjektet ekonomike në atë kohë ishin 3.501 individë, apo thënë ndryshe, në 1.000 banorë të aftë për punë rreth 110 të punësuar në ekonomi.[8]

Nr.	Vendbanimi	Nr. i bizneseve tregtare	Nr. i të punësuarve	Bizneset tregtare	Nr.	Vendbanimi	Nr. i bizneseve tregtare	Nr. i të punësuarve	Bizneset tregtare
1.	Bellacërkë	38	67	38	19.	Opterush	11	9	11
2.	Bërnjakë	2	280	2	20.	Pastaselë	2	4	2
3.	Bratatin	2	1	1	21.	Pataqan i Epërm	1	1	1
4.	Brestoc	4	4	4	22.	Pataqan i Poshtëm	4	4	4
5.	Celinë	9	9	9	23.	Petkoviq	3	2	3
6.	Çiflak	16	25	16	24.	Polluzhë	6	7	6
7.	Dabidol	3	3	3	25.	Radostë (Malësi e Vogël)	6	8	6
8.	Dejnë	15	26	15	26.	Rahovec	699	1398	699
9.	Drenoc	12	11	12	27.	Ratkoc	69	114	69
10.	Gexhe	9	23	9	28.	Reti e Poshtme	-	-	-
11.	Hoçë e Madhe	-	-	-	29.	Retijë	4	4	4
12.	Hoçë e Vogël	10	9	10	30.	Sapniq	4	4	4
13.	Kaznik	-	-	-	31.	Sarosh	-	-	-
14.	Kramovik	20	29	20	32.	Senoc	7	13	7
15.	Krushë e Madhe	86	150	86	33.	Vrajakë	2	2	2
16.	Mrasor	-	-	-	34.	Xërxë	121	275	121
17.	Nagavc	5	5	5	35.	Zatriq	1	1	1
18.	Nashpall	1	1	1	36.	Zaqishtë	4	5	4

Tabela 25 Numri i bizneseve sipas vendbanimeve në Rahovec, 2016

Sa i përket sektorit publik, përgjatë nëntë viteve të fundit ka pasur ngritje të lehta të numrit të të punësuarve. Përderisa në vitin 2011 ishin 115 individë si të punësuar civilë, në vitin 2019 numri ishte rritur në 161. Në vitin 2020 raportet janë që nuk ka pasur asnjë të punësuar shtesë në këtë sektor.

Indikatori	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Të punësuarve në komunë si shërbyes civilë	115	129	129	135	141	146	151	156	161	0

Tabela 26 Të punësuarit civil në komunë (Burimi: Instituti GAP)

[8] Plani Zhvillimor Komunal Rahovec 2018-2022 - Draft

Të dhënat aktuale për punësimin për Komunën e Rahovecit mungojnë, por duke u nisur nga statistikat e numrit të bizneseve në komunë, themi se rrjedhimisht edhe numri më i madh i të punësuarve ekziston në po këto sektorë të njëjtë: në sektorin e prodhimit, akomodimit dhe shërbimeve hoteliere, ndërtimtarisë, si dhe në kategorinë D, që nënkupton furnizim me energji elektrike, gaz avull dhe ajër të kondicionuar.

2.6.4.4. PASOJAT EKONOMIKE NGA PANDEMIA COVID-19

Në një studim të bërë nga Komuna e Rahovecit për vlerësimin e dëmeve ekonomike të shkaktuara nga Covid-19 për periudhën mars-qershor 2020[9] vlerësohet se dëmi i përgjithshëm për periudhën 13 mars deri më 30 qershor 2020 ishte rreth 37 milion euro. Nga kjo shumë, rreth 33 milion euro ishin humbje të shkaktuara të bizneseve të komunës si dhe të ekonomive familjare të cilat merren me kultivimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, kryesisht blegtorale. 3 milion euro ishte dëmi i shkaktuar për shkak të pezullimit apo humbjes së vendeve të punës, e përllogaritur si vlerë e pagave të papaguara. Humbjet nga taksat dhe tatimet e pa-inkasuara për shkak të ndërprerjes së aktiviteteve ekonomike ishin 600 mijë euro, kurse humbje të tjera të ndryshme ekonomike janë vlerësuar që kanë arritur shumën rreth 920 mijë euro.

	Humbjet në ekonomi	Humbjet e bizneseve	Punësimi i papaguar	Taksa dhe tatime	Humbje të tjera
Vlera në Euro	36,979,464	32,728,369	3,075,449	614,958	918,771

Tabela 27 Vlerësimi i humbjeve në Komunën e Rahovecit nga Covid-19, skenari bazë

Nga analizat e bëra nga ky hulumtim sektori i gastronomisë dhe akomodimit ishte sektori më i dëmtuar me humbje të përgjithshme mbi 7.15 milion euro, ku restorantet kishin peshën më të madhe të dëmit me 3.4 milion euro, kafeteritë me 2.9 milionë dhe hotelet me rreth 1 milion euro të humbura.

Ndërtimtaria dhe tregtimi i materialit ndërtimor kishte pësuar humbje shumë të mëdha po ashtu, me rreth 5.3 milion euro. Vetëm bizneset konsiderohet se kanë humbur 4.7 milion euro. Sektori i industrisë së përpunimit ka pasur humbje rreth 7.8 milion, ndonëse nuk ishte ndaluar me masa administrative të drejtpërdrejta, por vetëm me ndalim qarkullimi. Tregtia e tekstilit, ku përfshihet tregtia me shumicë dhe pakicë, ka pasur humbje të mëdha, përfshirë edhe humbjet në substancë. Kjo humbje llogaritet të jetë prej 2.75 milion euro.

Sektori i shërbimeve dhe veprimtarive tjera ekonomike, ky hyjnë shërbimet profesionale dhe veprimtaritë e specializuara, kanë pësuar rreth 8.8 milion euro humbje të bizneseve, për vetëm në tremujorin mars-qershor 2020.

Sa i përket sektorit të bujqësisë dhe ekonomive familjare, dëmi i pësuar ishte rreth 3.1 milion euro, kjo për shkak të ndalim qarkullimit dhe ndërprerjes së tregut, ku fermerët nuk mund t'i tregtonin produktet e tyre.

Sektorët	Humbjet në ekonomi	Humbjet e bizneseve	Zhvlerësimi i mallit	Punësimi i papaguar	Taksa/ Tatime	Humbje të tjera
Gastronomi dhe akomodim	7,155,735	5,805,585	-	914,595	128,273	307,230
Ndërtimtari	5,314,869	4,709,186	360,000	366,952	233,481	190,290
Tregtia e tekstilit	2,516,400	2,178,420	1,043,500	263,172	28,824	45,984
Industria e përpunimit	7,800,776	7,519,727	-	184,680	22,239	74,130
Blegtoria dhe ekonomia familjare	3,133,783	3,133,783	-	-	-	-
Veprimtari të tjera	3,216,556	2,825,200	-	420,000	5,292	20,580
Shërbimet	7,325,135	6,082,213	984,000	904,210	187,791	265,128
Totali	36,463,254	32,254,114	2,387,500	3,053,609	605,900	903,342

Tabela 28 Vlerësimi i humbjeve në Komunën e Rahovecit nga Covid-19 sipas sektorëve ekonomik

[9] Vlerësimi Ekonomik i Ndikimit të Pandemisë COVID-19 në Ekonominë e Rahovecit, Korrik 2020

2.6.4.5. INDUSTRIA PËRPUNUESE

Fillimi i viteve të gjashtëdhjeta të shekullit njëzet është periudha kur në Rahovec vendosen bazat e përpunimit të rrushit dhe fillimit të kalimit nga përpunimi tradicional i rrushit dhe i prodhimit të verës e rakisë në prodhimin industrial me metoda dhe teknologji bashkëkohore. Metoda moderne e vreshtarisë në këtë anë ka qenë e shfaqur që nga krijimi i kompleksit të parë të punishtes gjigante të verës "Rahovec" në vitin 1953. Ndërtimi i këtij bodrumi, ka ndikuar në rritjen e sipërfaqeve me vreshta si dhe janë shtuar edhe varietetet e rrushit duke e rritë dominimin e sorteve industriale, apo siç quhet ndryshe rrushi i verës. Kështu, vreshtaria, së bashku me industrinë e verës, u bënë shtylla kryesore e zhvillimit të ekonomisë së Rahovecit.[10]

Përpos industrisë së përpunimit të rrushit, në vitet e gjashtëdhjeta e kanë zanafillën edhe disa fabrika prodhuese të cilat për afro një gjysmë shekulli kanë qenë shtylla kryesore e punësimit dhe zhvillimit për banorët e komunës së Rahovecit. Industria për përpunimin e grurit, prodhimin e miellit, bukës dhe pjekurinë “Sillosi” në Xërxë është një tjetër gjigant i zhvillimit, i cili është themeluar dhe ka filluar me punë në vitin 1969, dhe njëkohësisht ka qenë njëra ndër fabrikat më të mëdha për prodhimin e miellit, me kapacitete të bluarjes prej 200 tonë në 24 orë.

Industria e masave plastike “18 Nëntori” në Rahovec dhe njësinë në Xërxë ishte një shtyllë tjetër e rëndësishme e zhvillimit të Rahoveci dhe të vendit në tërësi. Kjo industri ka startuar me punë në vitin 1959, me kapacitet të prodhimit prej 7500 tonë. Pos këtyre tre gjiganteve të prodhimit, në komunën e Rahovecit kanë zhvilluar aktivitet prodhues edhe disa fabrika më të vogla, siç janë, “Termosistemi”, “Ekoplasti” dhe “1 Maji”, të cilat gjithashtu kishin një rëndësi të veçantë në zhvillimin ekonomik, përmes programeve shumë atraktive të prodhimit. “Termosistemi” merrej me prodhimin e këmbyesve të nxehtësisë, “Ekoplast” me përpunimin e mbetjeve plastike “riciklimin e mbeturinave plastike”, kurse “1 Maji” me prodhimin e materialit ndërtimor “pllakave të mermerit”.

Regjioni i Rahovecit mbetet prodhuesi më i madh i rrushit të gjitha llojeve; sipërfaqet më të mëdha shtrihen në territorin e kësaj komune, gjithashtu edhe kultivimi i perimekulturave është i koncentruar në këtë regjion.

Sektori i industrisë përpunuese është ndër sektorët më të mëdhenj në Komunë e Rahovecit, me biznese prodhuese dhe përpunuese të suksesshme, të cilat bëjnë edhe eksportimin e produkteve të tyre jashtë Kosovës. Këto eksporte përfshijnë industrinë e miellit, industrinë e prodhimit të frigoriferëve, prodhimin e elementëve të plastikës (dyer, dritare, elemente të kuzhinës, dhe pajisjeve të ndryshme të amvisërisë), prodhimin e verës dhe distilerive të ndryshëm, industrisë së përpunimit të telit, rrjeteve, metaleve, gypave të ndryshëm, zdrukthëtarëve dhe përpunuesve të tjerë të drurit.[11]

Aktualisht në Republikën e Kosovës operojnë 23 kompani të licencuara nga MBPZHR që merren me përpunimin e rrushit dhe produkteve tjera nga rrushi dhe vera, nga ky numër 17 kompani operojnë në Komunën e Rahovecit.[12] Përpos që numri më i madh i kompanive të licencuara për përpunim të rrushit janë në territorin e Komunës së Rahovecit, edhe bartësit kryesorë të prodhimit të verës dhe produkteve të tjera të rrushit janë në komunën e Rahovecit. Kështu, sipas një vlerësimi të MBPZHR, bartës të prodhimit dhe eksportit janë tri kompani: “Stone Castle Vineyards & Winery” Sh.p.k – Rahovec, NTP “ Haxhijaha”– Rahovec, dhe “Agrokosova – Holding” Sh.p.k. – Suharekë.

Njëkohësisht këto kompani janë edhe eksportuesit kryesorë të verës në nivel vendi.

Duke qenë se ndërmarrjet për prodhimin e verës janë ndërmarrjet prodhuese me numrin më të madh në komunë, po i paraqesim ato më poshtë në formë tabelare në nivel komunal dhe në nivel vendi.

[10] Ibrahim Kryeziu, Zhvillimi Ekonomik Lokal në Republikën e Kosovës, Komuna e Rahovecit, 2021

[11] Vlerësimi Ekonomik i Ndikimit të Pandemisë COVID-19 në Ekonominë e Rahovecit, Korrik 2020

[12] Ibrahim Kryeziu, Zhvillimi Ekonomik Lokal në Republikën e Kosovës, Komuna e Rahovecit, 2021

Nr.	Ndërmarrja	Vendi	Kapaciteti lit/vit
1.	"Stone Castle Vineyards & Winery"	Bërnjakë	13 mi
2.	NTP"Haxhijaha"- Bodrumi i Vjetër	Rahovec	6.5 mil
3.	NTP. "Muja"- Eko vena	Rahovec	300.000
4.	Shpk "Rahoveci"- NBT	Rahovec	-
5.	Shpk. "Biopak" – Iliria	Rahovec	2.2 mil
6.	NTP "Agro-alf"- Shulina	Rahovec	-
7.	NTP "Raho Wine"	Rahovec	200.000
8.	NTP "Daka"	Rahovec	40.000
9.	N.T.SH. "BAHHA"	Rahovec	
10.	NTP "Sefa"	Rahovec	200.000
11.	"Kosova Wine". Sh.p.k	Rahovec	-
12.	N. P.T "Altini"	Rahovec	-
13.	P.T.P "Hočanska Vina"	Hoçë e Madhe	-
14.	"Sunny Hills "Sh.p.k	Rahovec	-
15.	"Tradita" sh.p.k	Rahovec	-
16.	T.P.P. " Vinarija Manitaševič"	Hoçë e Madhe	-
17.	NPT "Astro Vera"	Rahovec	-

Tabela 29 Ndërmarrjet prodhuese të verës në Komunën e Rahovecit

Ndërsa, nga statistikat e fundit të vendit prodhimi i verës nga ndërmarrjet prodhuese në Kosovë qëndron kështu:

Nr.	Kompanitë prodhuese të licencuara	Verë e bardhë/hl	Verë e kuqe/hl	Verë Rose/hl	Rrush për destilim/hl
1.	"Stone Castle Vineyards & Winery" Shpk	19,837	14,588	349	1,127
2.	"Sunny Hills" Shpk	10,169	9,870	-	-
3.	"Bodrumi i vjetër" Shpk	5,004	4,957	-	-
4.	"Biopak" Shpk	2,978	6,242	-	718
5.	"Ilirian Winery and Wineyards" Shpk	8,590	-	-	669
6.	"Muja" NPT	1,201	2,159	-	-
7.	"Agrokosova Holding QMI" Shpk	1,347	1,407	-	-
8.	"Suhareka Verari" Shpk	592	1,302	-	-
9.	"Besa Winery" Shpk	793	-	-	-
10.	"Kosova Wine" Shpk	102	457	-	2
11.	"Cana Wine" Shpk	61	252	-	8
12.	"Gzim Vuçitërna" BI	-	307	-	25
13.	"Agro-alf" NTP	28	253	-	5
14.	"Bahha" NPT	31	228	-	259
15.	"Sefa" NTP	30	206	-	53
16.	"Rahoveci" Shpk	26	173	-	12
17.	"Tradita" NPT	23	125	-	-
18.	"Noster Fructus" D.O.O.	119	27	-	13
19.	"Daka" NTP	29	85	-	7
20.	"Hočanska Vina" NTP	9	89	-	-
21.	"Albatros" NPSH	-	61	-	-
22.	"Dea" Shpk	12	40	-	17
23.	"Raho Wine" NPT	-	31	-	1
24.	"Rahvera AB" NTP	18	12	-	-
25.	"Astra - Vera" NPT	-	18	-	1

26.	"Dardania Wine" Shpk	-	16	-	-
27.	"Agro Vita" Shpk	-	16	-	-
28.	"Albana Shehu" BI	-	15	-	-
29.	"Vinica Brkic"	-	10	-	-
30.	"Rezidenca" NPT	-	-	-	14
	Gjithsej	50,997	42,946	349	2,933

Tabela 30 Prodhimi i verës sipas kompanive në Kosovë, 202013

2.6.4.6. ZONA EKONOMIKE

Komuna e Rahovecit ka parcelën e caktuar për ndërtimin e Zonës Ekonomike – Park industrial. Pëlqimi për krijimin e kësaj zone është dhënë në qershor të vitit 2018, ndërsa ndërtimi është akoma në proces. Prona e paluajtshme në të cilën themelohet Zona Ekonomike në fshatin Opterushë, është pronë e komunës së Rahovecit dhe ka sipërfaqe prej 34,89.83ha.

Gjatë vitit 2019, është bërë rrethimi i një hapësire të kësaj zone por, duke pasur për bazë buxhetin e limituar të komunës së Rahovecit, nuk është arritur të bëhen investime të tjera.

Kjo zonë ekonomike agro-industriale paraqet rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të komunës dhe është përparësi e madhe për bizneset për faktin se do të mund të zhvillohen veprimtari të ndryshme ekonomike, përmes investimeve të huaja dhe vendore, duke mundësuar kështu edhe hapjen e vendeve të reja të punës.



Figura 7 Lokacioni i Parkut Industrial – Zonë Ekonomike në Opterushë14

[13] Departamenti për Vreshtari dhe Verëtari, përpunuar nga DAESB – MBPZhR

[14] https://www.google.com/search?q=zona+ekonomike+Opterushe&rlz=1C1GCEA_enXK936XK936&source=lnms&tbm=isch&sa=X&ved=2ahUKEwjwwOH11MP4AhXlSvEDHah1A-kQ_AUoAXoECAEQAw&biw=1920&bih=969&dpr=1#imgrc=GdhPe8eXeKDolM

2.6.4.7. INDUSTRIA E PËRPUNIMIT TË DRURIT

Industrinë e përpunimit të drurit e përbëjnë një numër i konsiderueshëm i ndërmarrjeve në Komunën e Rahovecit, ndonëse nuk ka evidenca të qasshme për të treguar gjendjen e këtij sektori në vlera statistikore. Produktet kryesore të bizneseve janë mobilje shtëpiake si produkt kryesor, kuzhina, dyer dhe dritare, zdrukthëtari si dhe produkte të tjera të drurit. Pjesa më e madhe e tyre janë mikro-ndërmarrje, me një pronar ose bashkëpronar. Pothuajse të gjitha ndërmarrjet e blejnë lëndën e parë, dhe një numër shumë i vogël i prodhon materialet e tyre.

Në Kosovë, nga viti 2010 deri më 2013 janë regjistruar rreth 400 kompani të reja në sektorin e drurit, mesatarisht 100 biznese të reja të regjistruara në vit. Prodhimi i kuzhinave dhe mobileve është aktiviteti më i regjistruar -50% të bizneseve të reja të regjistruara në sektor. Përpunimi i drurit kryesisht dominohet nga bizneset mikro dhe të vogla.

2.6.4.8. TURIZMI

Turizmi është më pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire.

Turizmi rekreativ shtrihet në kanionin e Drinit të Bardhë. Turizmi kulturor ekziston në trashëgimi kulturore/arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, shpella, hamame, trashëgimi arkitekturore dhe fetare në Hoçën e Madhe. Në qendër të qytetit janë të vendosura monumentet historike të ndërtuara mbi 400 vite: Teqeja e Madhe –Helvetive, Teqeja Rufai; Teqeja Melami; Sahat Kulla e ngritur në vitin 1791; pesë xhamitë si dhe teqetë tjera, si në qytet ashtu edhe në rrethinë.

Fshati Hoçë e Madhe që është në jug të qytetit të Rahovecit, i njohur për vreshtat dhe verërat e tij, ka një sërë objektesh të trashëgimisë kulturore dhe fetare. Në vitin 1198 Duka i madh Stevan Nemanja dhuroi prodhimet e regjionit, manastirit të Hilandarit (Mt. Athos)., ndërsa në mesjetë kjo zonë u bë qendër e madhe komerciale dhe kulturore. Në të gjenden 12 kishat: kisha e Shën Nikollës, Shën Xhonit, Shën Stefanit (shek. XIV), kisha e së Dielës së Shenjtë, kisha Shën Parasku, Shën Ana, Shën Lluka dhe Shën Pjetri (shek. XVI), Shën Virgjina dhe Shën Elia. Të veçanta për vizita turistike janë dhe depot e mëdha të verës në qendër të fshatit me fuqitë e larta deri në 5metra dhe të gjera 4m.

Kompleksi përkujtimor “Maja e Shkodranit” është një vend nga i cili mund të shihet i gjithë Rahoveci por edhe një pjesë e Rrafshit të Dukagjinit. Ky vend ka karakter të turizmit malor dhe historik, ngase ndërlidhet me luftën e fundit të shtetit tonë, në të cilin vend kanë rënë për liri katër ushtarë, tre prej të cilëve ishin nga Komuna e Rahovecit. Kompleksi është i qasshëm me vetura dhe ka edhe shtegun për çiklistë.

Në Komunën e Rahovecit ekzistojnë edhe një numër hotelesh dhe restorantesh të bukura të cilët mirëpresin numër të kënaqshëm të turistëve vendor dhe të huaj, ku vizita kryesore e turistëve janë vreshtat e dhe fabrikat prodhuese të verërave.

2.6.4.9. RESURSET NËNTOKËSORE

Komuna e Rahovecit ka tokë shumë të pasur me shumë resurse minerale dhe pasuri nëntokësore. Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thëngjilli).

Gurët dekorativë: - gjenden në afërsi të fshatit Drenoc, në një largësi prej 5,5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat mendohet të jenë rreth 207.386 m³. Shtresat e lezolitit dekorativ janë sipërfaqësorë, të mbuluar me shtresë humusi prej 0,5m.

Gurët gëlqerorë: - gjenden në Hudhrat e Danit, një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km larg tij. Ato shtrihen në formë blloqesh me trashësi që varion nga 0,3 në 2 metra, dhe janë 1,5 metra poshtë

sipërfaqes së tokës. Gurët gëlqerorë paraqiten në ato të kuq dhe murrmë. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerorëve mendohet të ketë një volum prej 382.913m³.

Azbesti: -Shtresat e lezolitit të azbestit janë të përqendruara në afërsi të fshatit Rudin/Pastaselë në perëndim të Rahovecit, në një largësi prej 8km. Në bazë të hulumtimeve (janë bërë 4 shpuarje) është përcaktuar sipërfaqja e shtresës prej 100.000 m² dhe mendohet që rezerva të kapë shifrën prej 10,000,000 Ton. Kjo e dhënë është e përafërt dhe kërkon hulumtime të hollësishme gjeologjike.

Kobalti, Nikeli dhe Bakri: -Në rrethinën e Gurit të Kuq janë konstatuar shtresa të xeheroreve të Nikel-Kobaltit. Përbërja mesatare e këtij xeherori sipas hulumtimeve të bëra vite më parë për mineralin në formë të ngurtë është Nikeli 0,18%, Kobalti 0,13% dhe Bakri 2,73%. Sasia e rezervave të këtij xeherori nuk dihet.

Kromi - mendohet të gjendet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradishtë, lugina e përroit Rimnik, Delja, Shipi në Zatriq, Sharnica mbi Qëndresë, Drenoci, Guri i kuq, Kazniku, etj.

Thëngjilli- gjendet në lokalitetet e Hoçës së Madhe, Krushës, përroit të Nagacit, Drinasi, etj. Për të përcaktuar sasinë e rezervave dhe cilësitë kalorifike të thëngjillit duhen bërë hulumtime të thella gjeologjike. Së fundi, sipas Komunës ekziston mundësia që të gjenden shtresa naftëmbajtëse në territorin e Komunës së Rahovecit. Vendndodhja e tyre mendohet të jetë në fshatin Kramovik dhe përgjatë rrjedhjes së Drinit të Bardhë deri në Krushën e Madhe.

2.6.4.10. INFRASTRUKTURA ENERGJETIKE

Komuna e Rahovecit është mirë e mbuluar me rrjet të energjisë elektrike, megjithatë është evidente nevoja për rritjen e kapaciteteve të tij. Rrjeti përbëhet nga linjat e tensionit të lartë, të mesëm, të ulët dhe trafo stacioneve.

Sa i përket gjendjes së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, në zonën urbane të qytetit, për shkak të dendësisë së konsumatorëve, gjithnjë e më shumë vërehet nevoja për zëvendësimin e kabllove ajrore me kabllo nëntokësore, hap ky i cili jo vetëm që do të përmirësonte sigurinë e qytetarit, por do të përmirësonte edhe pamjen e tërë qytetit. Sa i përket konsumit energjetik, për shkak të mungesës së auditimeve, qoftë për sektorin e konsumatorëve publik, qoftë për atë privat, nuk ekzistojnë të dhëna në bazë të të cilave do të mund të vlerësohej niveli i konsumit dhe gjendja e efiçiencës me të cilën shfrytëzohet energjia në komunë.

Ndërsa në lidhje me situatën me ngrohje, në qytet nuk ekziston rrjeti i ngrohjes qendrore dhe për ngrohjen e hapësirave në ndërtesat rezidenciale shfrytëzohet kryesisht biomasa (drunjtë) dhe energjia elektrike, kurse në stokun e ndërtesave publike, përveç biomasës, për ngrohje shfrytëzohen edhe nafta dhe thëngjilli.

Komuna e Rahovecit në vitin 2015 ka publikuar "Planin Komunal për Efiçiencë të Energjisë 2015-2020[15]". Nëpërmjet realizimit të masave të parapara në këtë plan, komuna ka synuar të arrijë cakun e kursimit prej 27% të konsumit energjetik total deri në vitin 2020. PKEE planifikonte t'i shërbente Komunës së Rahovecit në reduktimin e shpenzimeve për shërbime energjetike dhe në identifikimin e Komunës si një komunë e cila mbështetë dhe promovon efiçiencën e energjisë. Përgjegjëse që t'i realizojë masat e parapara në këtë PKEE ka qenë vet Komuna në bashkëpunim me institucionet relevante, ku realizimi do të bëhej nëpërmjet regjistrimit vjetor të konsumit energjetik dhe planifikimit të projekteve EE. Fondet për realizimin e asaj që ishte paraparë në këtë plan, planifikohej të siguroheshin nëpërmjet granteve dhe investimeve kapitale nga ana e vetë Komunës.

2.6.4.11. INFRASTUKTURA HEKURUDHORE

Pozita gjeografike e komunës së Rahovecit, i mundëson që të kalojnë rrugë të rëndësishme të cilat i mundësojnë komunikim të mirë dhe mjaft efikas me pjesë e tjera të vendit si dhe me nivel ndërkombëtar.

[15] "Plani Komunal për Efiçiencë të Energjisë 2015-2020", Rahovec, 2015

Infrastruktura rrugore në Komunën e Rahovecit është e mirë dhe e zhvilluar. Në Lindje të komunës kalon magjistralja Prizren – Pejë dhe hekurudha Prizren-Klinë-Pejë-Fushë Kosovë.

Rrjeti hekurudhor është i karakterit regjional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regjional, i cili zhvillohet në linjën Fushë Kosovë – Klinë - Prizrenin - kalon nëpër territorin e komunës së Rahovecit. Vija hekurudhore kalon direkt nëpër 12 fshatra të komunës së Rahovecit, përkatësisht ka qasje direkte në këtë rrjet: kalon nëpër fshatrat Mrasor, Kramovik, Çifllak, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhe, Xërxë, në komunën kadastrale të Bellacërkës, Celinë dhe Krushë e Madhe. Në këtë vijë hekurudhore bëhet transporti i mallrave dhe udhëtarëve. Stacioni kryesor që shfrytëzohet veçanërisht për transport të mallrave është në fshatin Xërxë dhe shfrytëzohet nga kompanitë e dy komunave, Gjakovës dhe Rahovecit. Distanca Xërxë-Gjakovë është 13km dhe Xërxë- Rahovec është 10km.

2.6.4.12. BUJQËSIA

Bujqësia në komunën e Rahovecit ka një perspektivë të madhe për zhvillim, duke pasur për bazë kushtet klimatike, tokësore, sistemet e ujitjes si dhe traditën e popullsisë që merret me bujqësi. Përveç kësaj është e zhvilluar mjaft mirë edhe industria ushqimore. Komuna e Rahovecit posedon 18,620 ha sipërfaqe të strukturave të ndryshme siç janë:

Shfrytëzimi i tokës Bujqësore	Sipërfaqja (ha)
Toka në pronësi	14,042.40
Toka e marrë me qira	3,023.65
Toka e dhënë me qira	719.63
Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës së përbashkët	2,274.34
Gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore	14,461.58
Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore e marrë me qira	2,829.98
Gjithsej sipërfaqja e tokës për shfrytëzim	18,620.76

Tabela 31 Sipërfaqet e kulturave bujqësore sipas kategorive[16] (ASK)

Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe prodhues të organizuar në ndërmarrje bujqësore. Bujqësia vazhdon të jetë një ndër sektorët me potencial të madh e të rëndësishëm në rritjen e ekonomisë dhe sigurisë së ushqimit në komunën e Rahovecit. Sektorë i cili vazhdojnë të kenë kushte të favorshme trend të rritjes sidomos në kulturat si: perimekulturë, vreshtari dhe drithërat.

Vitet e fundit në komunën tonë kultivohen rreth 1700 ha me perime ku, kultura e specit është bima primare e cila zë sipërfaqe më të madhe sa i përket kultivimit me rreth 695 ha, qepa me rreth 150 ha e pas kësaj vjen shalqiri me 165 ha, si dhe kulturat tjera në sipërfaqe më të vogël. Duke filluar nga pozita gjeografike, lartësia mbidetare, relievi dhe kushtet e tjera klimatike, komuna e Rahovecit ka një pozitë mjaft të përshtatshme për kultivimin e hardhisë së rrushit, rreth 2,323 ha me hardhi të rrushit janë të mbjella vetëm në komunën e Rahovecit, ku prej tyre 73% janë me rrush të verës, ndërsa 27% me rrush të tryezës.

Po ashtu, në komunën e Rahovecit sipërfaqe të konsiderueshme të mbjelljeve bujqësore zë edhe sektori i drithërave. Në sipërfaqen totale prej 5,141.59 ha, të kultivimit të drithërave. Kultura kryesore të kultivuara janë e grurit, misri elbi, thekra, tërshëra, etj.

Bujqësia si një sektor shumë i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik në komunën e Rahovecit gjen një shtrirje në gjithë territorin ku përfaqësohet me një numër të konsiderueshëm të ndërmarrjeve bujqësore të profileve të ndryshme. Të gjitha ndërmarrjet bujqësore janë në pronësi private.

[16] Drejtoria e punës dhe kadastrit

Në komunën tonë veprojnë edhe 3 mullinj për grumbullimin dhe përpunimin e grurit, siç janë Sillosi në Xërxë, Mulliri në Rahovec dhe mulliri në Çifllakut.

Nr.	Mulli të Miellit	Vendi	Kapaciteti (ton)
1.	M & Sillosi	Xërxë	200,000
2.	Vetoni	Rahovec	40,000
3.	Burimi	Çifllak	45,000
	Gjithsej		285,000

Tabela 32 Ndërmarrjet bujqësore të përpunimit të drithërave në komunën e Rahovecit[17]

Vitet e fundit është në dukje trendi i rritjes së numrit të kompanive për përpunimin e perimeve të produkteve bujqësore perimtari. Edhe fokusi i DBPZHR-së është fuqizimi i këtyre kompanive që ndikojnë direkt në eliminimin e problemeve me shitjen e produkteve perimore.

Nr.	Fabrika	Prodhimi dhe përpunimi	Kapaciteti vjetor (kg)	Kërkesa për lëndë të parë
1.	"KB Krusha"	Përpunimi i perimeve	1,500,000	Perime të ndryshme
2.	"Apetiti Group:	Përpunimi i perimeve	500,000	Perime të ndryshme
3.	"Agro Krusha"	Përpunimi i perimeve	500,000	Perime të ndryshme
4.	Agro Celina	Grumbullimi i perimeve	2,000,000	Perime të ndryshme
5.	Vigani Food	Përpunimi i perimeve	200,000	Perime të ndryshme

Tabela 33 Kapacitetet përpunuese të pemëve dhe perimeve në komunën e Rahovecit

Në sektorin e bujqësisë janë të angazhuar një numër i madh i të punësuarve, sipas ASK-së numri i të punësuarve në këtë sektor është mbi 29,457 punëtor të rregullt si dhe një numër i madh i atyre sezonal nga e cila kuptojmë se bujqësia është një sektor shumë i rëndësishëm në sigurimin e jetesës të një numri të madh të ekonomive familjare.

Lloji i fuqisë punëtore	Nr. Punësuarve
Bartës i ekonomisë	5,380
Anëtarët e familjes së bartësit	11,171
Të punësuarit e rregullt në ekonomitë familjare bujqësore dhe bizneset individuale	70
Të punësuarit e rregullt në subjektet juridike bujqësore	143
Fuqia punëtore jo familjarë, që nuk punon rregullisht (punëtorët sezonal)	12,477
Fuqia punëtore, që nuk është e punësuar drejtpërdrejt nga ekonomia bujqësore (punëtorë të kontraktuar)	216
Gjithsej	29,457.00

Tabela 34 Numri i të punësuarve në sektorin e bujqësisë (ASK)

Vendbanimi	Ekonomi bujqësore nr.	Vendbanimi	Ekonomi bujqësore nr.
Bellacërkë	272	Opterush	190
Bratatin	61	Pastaselë	104
Brestoc	164	Pataqan i Epërm	59
Celinë	187	Pataqan i Poshtëm	170
Çifllak	144	Petkoviq	63
Dabidol	56	Polluzhë	102
Dejnë	118	Radostë (Malësi e Vogël)	267
Drenoc	182	Rahovec	1,761
Gexhe	65	Ratkoc	321
Hoçë e Madhe	95	Reti e Poshtme	26
Hoçë e Vogël	147	Retijë	82
Kaznik	30	Sapniq	129

[17] DBPZHR dhe DP

Kramovik	66	Senoc	88
Krushë e Madhe	394	Vrajakë	130
Mrasor	8	Xërxë	177
Nagavc	74	Zatriq	49
Nashpall	20	Zaqishtë	111

Tabela 35 Ekonomitë bujqësore sipas vendbanimeve

Kushtet pedo-klimatike janë të përshtatshme për kulturat bujqësore dhe mundësitë e mëdha të ujitjes, të cilat bëjnë të mundur që në Rahovec të kultivohen me sukses të gjitha kulturat bujqësore si: kulturat lavërtarë, pemët, vreshtat, e po ashtu ka kushte edhe për zhvillimin e blegtorisë dhe shpeztarisë. Përderisa edhe industria ushqimore është duke u zhvilluar në aspektin e modernizimit dhe ngritjes së kapaciteteve.

Vreshtaria- Vreshtaria është një ndër sektorët më të zhvilluar të bujqësisë në komunën e Rahovecit, ky sektorë gjen një shtrirje të madhe të sipërfaqes kultivuese me mbi 2,293 ha, të ndarë në dy kultura si rrush për tryezë dhe verë. Përveç kultivimit të rrushit në sipërfaqe në komunën e Rahovecit kjo kulturë gjen edhe përpunimin nga një numër i konsiderueshëm i përpunuesve tash më edhe të njohura si brende botërore: Stone Castle, Kosova Wine, Bodrumi i Vjetër, etj.

Vreshtat - Gjithsej	Nr. i ekonomive bujqësore	2,594
	Sipërfaqja (ha)	2,322
	Numri i hardhive	7,958,710
Vreshta - rrush për tryezë	Nr. i ekonomive bujqësore	1,512
	Sipërfaqja (ha)	624.00
	Numri i hardhive	2,331,787
Vreshta - rrush për verë	Nr. i ekonomive bujqësore	1,594
	Sipërfaqja (ha)	1,698
	Numri i hardhive	5,626,923

Tabela 36 Sipërfaqet e mbjella me vreshta



Figura 8 Pamje nga vreshtat dhe spërkatja e tyre

Drithërat - Kjo lëmi e bujqësisë është mjaft e përhapur dhe e preferuar në komunë, me kulturat kryesore si gruri, misri, elbi, thekër, etj., dhe me sipërfaqet prej 2,006 ha grurë, 1,578 ha misër dhe 122 ha tërshëre.

	Prodhimi (sipërfaqja/ ha)		
	2020	2021	2022
Grurë	1,929	1,041	2,006
Misër	1,602	901.43	1,578

Elb	2.61	12.64	4.05
Thekër	2.62	0	0
Tërshëre	48.93	63.68	122.04
Tritikale	20	20	20
Gjithsej	**3,605.16**	**2,038.75**	**3,730.09**

Tabela 37 Sipërfaqet e mbjella me drithëra (DBPZHR-ASK)

Perimekultura - Viteve të fundit ka marr hov kultivimi i perimeve në ambient të mbyllur (sera), që ka rezultuar në shtim të dukshëm të sipërfaqeve me sera. Deri më sot ekzistojnë një numër i konsiderueshëm i serave të ndërtimeve të ndryshme, nga ai më i thjeshtë i drurit e deri te ato të modernizuara. Po ashtu perimtaria kultivohet me një sipërfaqe të madhe edhe në fushë të hapur, ku kultura kryesore janë speci, domatja, trangulli, qepa shalqiri dhe lakra.

	Prodhimi (sip/ ha)		
	2020	2021	2022
Patate	227	126.46	166.35
Lakër	99.43	86.07	144.2
Fasule	1.55	0.21	0.46
Spec	830.46	657.83	695.3
Kunguj	18.07	12.8	11.82
Kunguj Misiri	319.46	214.39	302.84
Qep	188.9	191.89	149.76
Hudhër	33.47	21.08	25.56
Shalqin	205.36	178.04	164.68
Pjepër	56.61	52.62	100.24
Gjithsej	**1,980.31**	**1,541.39**	**1761.21**

Tabela 38 Sipërfaqet e mbjella me perime (DBPZHR dhe ASK)

Pemëtaria - Komuna e Rahovec ka kushte të volitshme klimatike—tokësore, shumë të favorshme për kultivimin e pemëve. Më së shumti kultivohen kumbullat, mollët, arrat dhe lajthia. Kjo veprimtari ka filluar të ringjallet, dhe momentalisht ekzistojnë sipërfaqe të konsiderueshme të mbjella me pemë.

	Prodhimi (Ha)		
	2020	2021	2022
Mollë	10.01	8.15	8.96
Kumbull	40.65	38.69	54.86
Dardhë	6.58	7.43	6.63
Lajthi	4.94	9.9	10.77
Arrë	30.08	57.88	73.9
Mjedër	1.01	0.71	0.53
Manaferra	0.66	0	0
Dredhëza	0.66	2.51	2.72
Vreshta	2,406	2,342	2,323
Gjithsej	**2,500.59**	**2,467.27**	**2,481.37**

Tabela 39 Sipërfaqet e mbjella me pemë (DBPZHR ASK)

2.6.4.13. BLEGTORIA[18]

Momentalisht fondi i bagëtisë mbahet kryesisht për qumësht, për majmëri (mish) dhe produkte të tjera. Ekzistojnë më se 4,315 ekonomi bujqësore të cilat kultivojnë kafshë dhe shpend për nevoja familjare.

[18] DBPZHR dhe ASK

Gjithashtu ekzistojnë ferma të mesme dhe ato komerciale. Nuk ekziston ndonjë kapacitet, i cili do të kishte funksionuar për përpunimin e produkteve blegtorale. Por, ekziston vetëm forma e thjeshtë e përpunimit.

Sektori i blegtorisë ka një fond të konsiderueshëm të gjitha llojeve të kafshëve shtëpiake edhe atë: 16,567 krerë, gjedhe 3,063 krerë, dele 13,226 krerë, dhi 278 krerë dhe mbi 59,425 shpendë.

Lloji	Koncentrimi (nr.)		
	2020	2021	2022
Lopë	2,598	2,335	1,938
Mëshqerra	300	250	230
Viça	1021	931	895
Dele mbarështimi	8,886	8,142	7,226
Qengja	7,000	6,500	6,000
Capa	50	55	30
Dhi	834	864	248
Gjithsej	20,689	19,077	16,567

Tabela 40 Struktura e bagëtisë në komunën e Rahovecit (ASK)

Lloji	Koncentrimi (nr.)		
	2020	2021	2022
Gjela	300	320	325
Pula	74,300	43,360	59,100
Brojler (zogj për mish)	/	/	/
Gjithsej	74,600	43,680	59,425

Tabela 41 Struktura e shpezëve në komunën e Rahovecit (ASK)

2.6.4.14. BLETARIA

Kosova ka kushte mjaftë të përshtatshme për t`u marrë me bletari, sidomos Rrafshi i Dukagjinit. Në këtë rajon, bletarët ekzistojnë mbi 130 lloje të bimëve mjaltëdhënëse me vegjetacion nga pranvera e hershme deri në vjeshtën e vonshme. Kjo ka mundësuar prodhimin e mjaltit cilësor të cilin bletarët ia kanë arritur që edhe ta eksportojnë.

Për sa i takon kushteve klimatike, që konsiderohen ndër faktorët kryesorë për mbajtjen por edhe zhvillimin e bletarisë, Rrafshi i Dukagjinit ofron kushte mjaft të mira për kultivimin e bletarisë. Uji dhe bimësia janë të kualitetit të lartë dhe fatbardhësisht në këtë rajon nuk kultivohen kulturat industriale të cilat do të ndikojnë negativisht në cilësinë e mjaltit.

Komuna e Rahovecit ka një numër të konsiderueshëm të bletareve të cilët merren në mënyrë intensive me kultivimin dhe rritjen e bletës.

Numri i ekonomive bujqësore	Numri
147	3,992

Tabela 42 Numri i koshereve të bletëve

2.6.4.15. PËRSHTATSHMËRIA E TOKËS BUJQËSORE (BONITETI) [19]


Në bazë të hulumtimeve dhe analizave të bazuara në Atlasin e Hidroekonomisë së Kosovës, shkalla e shtrirjes së bonitetit është si vijon.

Klasa e Bonitetit	Sipërfaqja në ha	%
2	3,807	13.8
3	17,690	64.2
4	1,560	5.7

[19] EULUP

5	485	1.7
6	191.5	0.7
7	3,816	13.9
Gjithsej	**27,589**	

Tabela 43 Përshtatshmëria e tokave bujqësore



Harta 7 Përshtatshmëria e tokave bujqësore (bonitet)

2.6.4.16. RREGULLIMI I TOKËS BUJQËSORE (KOMASACIONI)[20]

Punët me komasacion të tokave bujqësore në Kosovë kanë filluar në vitin 1983 në disa zona kadastrale të komunës së Rahovecit, ndërsa në vitin 1985 kuvendi i KSA Kosovë ka aprovuar programin për realizimin e punimeve të komasacionit për tokat bujqësore. Ky proces ka prekur edhe komunën e Rahovecit në 8 zona kadastrale dhe sipërfaqe 3,566 ha.

Vendbanimi	Sipërfaqja (ha)	Viti i themelimit
Bellacërkë (Fortesë)	491	1987
Xërxë	273	1987
Celinë	189	1987
Krushë e Madhe	664	1987
Dejnë	167	1987
Dabidol	157	1987
Çifllak	237	1987
Kramovik	128	1987
Celinë	202	2008
Bellacërkë (Fortesë)	543	2008

[20] Drejtoria Kadastrit dhe Pronës dhe drejtoria për punë gjeodezike dhe fotogrametrike në Prishtinë

Dejnë	162	2008
Dabidol	133	2008
Xërxë	220	2008

*Tabela 44 Zonat me komasacion në Komunën e Rahovecit *Burimi DKP-KSA*

2.6.4.17. UJITJA E TOKËS BUJQËSORE [21]

Sistemi i ujitjes që mbulon një pjesë të konsiderueshme të pjesës perëndimore të komunës së Rahovecit është KRU "Radoniqi-Dukagjini" si dhe ujitjet individuale nga disa burime tjera apo përroska. Nga sistemi i ujitjes, ujiten edhe tokat bujqësore në komunat tjera siç janë: Gjakova dhe Prizreni. Lumenjtë dhe përroskat e ndryshme që kalojnë në Rahovec, mundësojnë që toka të ujitet me rënie të lirë, me thithjen e ujit motor pompa dhe me thithjen e ujit nga puset që furnizohen me ujëra tokësor.

Vendbanimi	Sipërfaqja (ha)	Vendbanimi	Sipërfaqja (ha)	Vendbanimi	Sipërfaqja (ha)
Gexhe	98.88	Krushë e Madhe	532.51	Bellacërkë	532.79
Kramovik	52.50	Xërxë	329.65	Çifllak	323.60
Dejnë	159.60	Celinë	202.29	Radostë	349.49
Dabidol	125.67	Ratkoc	349.80		

*Tabela 45 Sipërfaqet e ujitura në Komunën e Rahovecit *Burimi DKP-KSAK*

2.6.4.18. PYLLTARIA

Përveç sipërfaqeve bujqësore dhe vreshtarë, komuna e Rahovecit është e njohur edhe për tokat pyjore. Sipërfaqja totale e tokës pyjore në komunën e Rahovecit është 7,692 ha me një njësi menaxhueshme e ndarë në katër rajone: Kaznik, Zatriq, Rahovec dhe Opterushë.

Nr.	Njësitë pyjore	Sipërfaqe	Llojet e drunjtëve
1.	Kaznik	2,052.6 ha	Pishë, Shkozë, Bungu
2.	Zatriq	3,029.6 ha	Shkozë, Bungu
3.	Rahovec	1,227.7 ha	Pishë, Shkozë, Bungu Haloret
4.	Opterush	1,129.7 ha	Shkozë, Bungu
5.	Çifllak -Xërxë - Krushë	252.4 ha	Shkozë, Bungu

Tabela 46 Sipërfaqja pyjore në Komunën e Rahovecit

Në komunën e Rahovecit duke pasur parasysh shkallën e rritjes së rrezikut nga zjarret në pyje gjatë këtyre viteve të fundit jemi detyruar të marrim masa për mbrojte nga zjarri pasi që është rrezik permanent shkatërrimi i florës dhe faunës.

Fauna jonë është e pasur me lloje të ndryshme, si: rrëqebulli, dhelpra, derri i egër, ariu, lepujt, si dhe zogjtë shtegtar së bashku me foletë e tyre që ndodhen në komunën tonë e posaçërisht në pyje të larta.

Sektori i pylltarisë konsiderojmë që duhet të përfshijë edhe pyjet së bashku me tokat pyjore në territorin e komunës tonë, sepse janë tri aspekte me prioritet:

- aspekti ekonomik;
- aspekti social; dhe
- aspekti mjedisor.

Në pjesën qendrore të NJM në Zatriq gjendet pika më e lartë me lartësi mbi nivelin e detit 1013 m vendi i quajtur ,,Gradishte" ndërsa vendi më i ulët po në NJM tek lumi ,,Drini i Bardhë" me lartësi mbidetare 359 m. Sipërfaqja e tërësishme pyjore e tanishme është 7,692 ha.

Nr.	Tokë Pyjore	Sipërfaqe në Ha

[21] KRU "Radoniqi-Dukagjini"

1.	Pyllëzime Artificiale	37.10
2.	Pyll cungishte	4,560.90
3.	Shkurre dhe sipërfaqe jo prodhuese	3,094.00
	Gjithsej	7,692.00

Tabela 47 Sipërfaqet aktuale pyjore sipas llojit të mbjellave

2.6.4.19. LLOJET E DRURIT (TRUNGJET-KATEGORIZIMI I TYRE)

Shpërndarja e llojeve të drurit është e dominuar nga lloje të qarrit, bungut dhe shkozës.

Llojet dominuese është lloji i shkoza me pjesëmarrje prej 44% të vëllimit të përgjithshëm, qarri 39%, bungu 10%, llojet e gjethoreve 4%, pisha e zezë 3%, e vëllimit të përgjithshëm.

Duke marrë në konsideratë kushtet natyrore dhe përbërjen pedologjike të tokës këto pyje ofrojnë kushte relativisht të mira për pyjet e dushqeve.

2.6.4.20. BLEGTORIA DHE SHPEZTARIA[22]

Industria e blegtorisë konsiderohet lëmi tjetër kyçe e bujqësisë në Rahovec.

Ka karakter ekstensiv, pasi që kultivohet në numër të vogël nga fermerët. Rriten tri lloje të gjedheve, ku raca më e shpeshtë quhet Busha e cila është më pak produktive në qumësht se të tjerat por që theksohet te fermat tradicionale. Në fermat me karakter të prodhimit intensivë kryesisht dominojnë racat: Holstein dhe Simental.

Prej blegtorisë mbarështohen: gjedhet, delet, dhitë, buallicat, etj. Kohëve të fundit ka tendencë të kalimit të kësaj dege të bujqësisë në blegtori intensive, me përmirësimin e racës së gjedhit, me racë simentale, montafone, etj. Për mbarëvajtjen e blegtorisë në komunën e Rahovecit kujdesen veterinerët e licencuar nga AUV.

Nga të dhënat në tre vitet e fundit nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural të Komunës së Rahovecit, kemi: Gjedhe të imta rreth 10,000; Gjedhe të trasha 2,500 dhe shpezë 50,000 sosh.

Shpeztaria është po ashtu e karakterit ekstensiv dhe përveç pulës e cila kultivohet në numër më të madh, llojet tjera të shpezëve janë më pak, përderisa disa prej tyre mund të hasen në natyrë në formë të egër. Sipas kërkimeve tona jo të plota, mesatarja e pulave për familje sillet rreth 10 pula për çdo familje. Vitet e fundit ka filluar kultivimi intensiv i shpeztarisë, ku janë ndërtuar disa ferma moderne me standarde bashkëkohore të pulave, si në fshatrat Celinë, Krushë e Madhe, Opterush, Çifllak, etj.

2.6.4.21. ZHVILLIMI I INDUSTRISË DHE BIZNESEVE[23]

Sektori i industrisë në Komunën e Rahovecit, bazohet kryesisht në industrinë agro-industriale, përpunimin e rrushit dhe të grurit, industrinë e plastikës, ndërtimtarisë, teknologjinë përpunuese të metaleve, teknologjive për ngrohje dhe ftohje, artizanale, tregti, shërbime, etj. Pas luftës, ndërmarrjet e vogla kanë shfaqur tendencën për shfrytëzimin dhe përpunimin e gurit, rërës, zhavorrit dhe argjilës, evidente me një shkatërrim jo-selektiv të resurseve.

Duke e pasur parasysh nivelin e përgatitjes profesionale dhe shpirtin ndërmarrës, shumë individë kanë filluar me biznese individuale dhe familjare duke trasuar rrugën për një të ardhme dhe duke u bazuar në ekonominë e tregut, si e vetmja perspektivë zhvillimore.

[22] Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020

[23] Programi komunal tre vjecar per banim 2014-2016

Rritja e bizneseve kërkon dhe qasje të re, si nga ana e themeluesve të tyre, sistemi bankar, institucionet të cilat duhet të merren më seriozisht lidhur me qasjen e përkrahjes, sidomos me infrastrukturë si dhe me legjislacion, i cili do të jetë i favorshëm për investuesit potencial.

Ruajtja e shpirtit ndërmarrës duhet të stimulohet dhe konsiderohet si vlerë për ekonominë kosovare. Për zhvillimin e ardhshëm, duhet t'i kushtohet kujdes i veçantë ruajtjes dhe zgjerimit të këtij lloji të aktiviteteve ekonomike, të cilët kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, si dhe në kualitetin e jetës urbane.

Në sektorin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme ekziston një asistencë e konsiderueshme e organizatave vendore dhe ndërkombëtare, të cilat janë përkushtuar për stabilizim dhe profesionalizim të ekonomisë. Organizatat ofrojnë asistencë për të zhvilluar prodhime të reja, si dhe tregun për to. Përkrahja gjithashtu vjen edhe nga institucionet gjegjëse të nivelit institucional me qëllim të krijimit të një mjedisi favorizues për zhvillimin ekonomik. Kjo i referohet, sikur është përmendur më parë, arsimimit profesional, certifikimit të standardeve profesionale, standardeve për kualitet në menaxhim, prodhimtarisë, prodhimeve, etj.

Të gjitha këto aktivitete kontribuojnë në stabilizimin e NVM-ve si bazë e rëndësishme e ekonomisë së Kosovës, gjegjësisht qytetit të Rahovecit, duke sjellë sa më shumë prodhime kosovare në treg dhe duke ofruar mundësi të reja punësimi.

Gjendja ekonomike e bujqve është mjaft e rëndë. Përpos tregut të reduktuar, kemi të bëjmë me një import të pakontrolluar dhe joselektiv të produkteve bujqësore gjë që i sjell prodhuesit tanë të pemëve dhe perimeve në pozitë mjaft të rëndë.

2.6.4.22. RESURSET MINERALE

Në territorin e Komunës së Rahovecit ka rezerva të gurit dekorativ dhe minerale si krom, azbest, nikel, kobalt, bakër dhe qymyr guri (thëngjilli).

Gurët dekorativë - gjenden në afërsi të fshatit Drenoc, në një largësi prej 5,5 km nga qyteti i Rahovecit. Rezervat mendohet të jenë rreth 207,386 m³. Shtresat e lezolitit dekorativ janë sipërfaqësorë, të mbuluar me shtresë humusi prej 0,5 m.

Gurët gëlqerorë - gjenden në Hudhrat e Danit, një vend në veri-perëndim të qytetit të Rahovecit 8 km larg tij. Ato shtrihen në formë blloqesh me trashësi që varion nga 0,3 në 2 metra, dhe janë 1,5 metra poshtë sipërfaqes së tokës. Gurët gëlqerore paraqiten në ato të kuq dhe murrmë. Gëlqerorët e kuq paraqesin më shumë interes ekonomik. Rezerva e gurëve gëlqerorëve mendohet të ketë një volum prej 382,913 m³.

Azbesti - Shtresat e lezolitit të azbestit janë të përqendruara në afërsi të fshatit Rudin/Pastaselë në perëndim të Rahovecit, në një largësi prej 8 km. Në bazë të hulumtimeve (janë bërë 4 shpuarje) është përcaktuar sipërfaqja e shtresës prej 100,000 m² dhe mendohet që rezerva të kapë shifrën prej 10,000,000.00 Ton. Kjo e dhënë është e përafërt dhe kërkon hulumtime të hollësishme gjeologjike.

Kobalti, Nikeli dhe Bakri - Në rrethinën e Gurit të Kuq janë konstatuar shtresa e xeheroreve të Nikel-Kobaltit. Përbërja mesatare e këtij xeherori sipas hulumtimeve të bëra vite më parë për mineralin në formë të ngurtë është (Nikeli 0,18%, Kobalti 0,13% dhe Bakri 2,73%). Sasia e rezervave të këtij xeherori nuk dihet.

Kromi - mendohet të gjendet përgjatë luginës së Drinit të Bardhë në një sipërfaqe rreth 60 km² dhe përkatësisht në lokalitetet Qëndresë, Gradishtë, lugina e përroit Rimnik, Delja, Shipi në Zadriq, Sharnica mbi Qëndresë, Drenoci, Petkoviqi (Guri i kuq), Kanzniku, etj.

Thëngjilli - gjendet në lokalitetet e Hoçës së Madhe, Krushës, përroit të Nagacit, Drinasi, etj. Për të përcaktuar sasinë e rezervave dhe cilësitë kalorifike të thëngjillit duhen bërë hulumtime të thella gjeologjike.

Së fundi, sipas Komunës ekziston mundësia që të gjenden shtresa naftëmbajtëse në territorin e Komunës së Rahovecit. Vendndodhja e tyre mendohet të jetë në fshatin Kramovik dhe përgjatë rrjetës së Drinit të Bardhë deri në Krushën e Madhe.

2.6.4.23. GJENDJA EKZISTUESE E RESURSEVE DHE SHËRBIMEVE TURISTIKE[24]

Turizmi është më pak i zhvilluar, edhe pse Rahoveci është njëri ndër qytetet më të vjetra të Kosovës, me relikte të vendbanimeve të dikurshme antike, të cilat rrjedhin nga epoka e hershme romako-ilire.



Figura 9 Shtëpi tradicionale, fillimi shek. 19-të



Figura 10 Shën Xhoni, shek. 14-të

Në përgjithësi zona e Dukagjinit është përplot me trashëgimi arkitekturore, shpirtërore, fetar, etnologjike, etj. Po ashtu resurse për një turizëm rekreativ ekzistojnë në kanionin e Drinit të Bardhë.

Turizmi kulturor kryesisht mund të jetë i bazuar në trashëgimi kulturore/arkitekturore: shtëpitë tradicionale, turizëm kulturor arkeologjik, shpella, hamame, trashëgimi arkitekturore dhe fetare në Hoçën e Madhe, e cila tashmë është edhe e mbrojtur me pakon e Ahtisarit nga e cila derivon dhe Ligji për Mbrojtjen e Zonave të Veçanta të Mbrojtura dhe në hartim e sipër përderisa flasim është Ligji për Hoçën e Madhe.

Në qendër të qytetit janë të vendosura monumentet historike të ndërtuara mbi 400 vite:

Teqeja e Madhe – Helvetive, Teqeja Rufai, Teqeja Melami, Sahat Kulla e ngritur në vitin 1791, pesë xhamitë si dhe teqet tjera si në qytet ashtu edhe në rrethinë.

Në fshatin Hoça e Madhe, në jug të qytetit të Rahovecit, të njohur për vreshtat dhe verërat e saj, objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Në vitin 1198 Duka i madh Stevan Nemanja dhuroi prodhimet e regjionit, manastirit të Hilandarit (Mt. Athos)., përderisa kjo zonë në mesjetë u bë qendër e madhe komerciale dhe kulturore. Në të janë 12 kishat: Shën Nikolla, Shën Xhoni, Shën Stefan – shekulli i 14^{të}, Kisha e Dielës së Shenjtë, Shën Parasku, Shën Ana, Shën Lluka dhe Shën Pjetri – shekulli i 16^{të}, Shën Virgjina dhe Shën Elia.

[24] Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020



Figura 11 Kulla e Sahatit – Rahovec 1791



Figura 12 Xhamia e Kasumit



Figura 13 Teqja Helveti



Figura 14 Teqja Melami Rahovec 1887



Figura 15 Shën Lluka shek. 16-të



Figura 16 Shën Nikolla shek. 14-të



Figura 17 Kanioni atraktiv në Drinin e Bardhë



Figura 18 Ura e Fshejtë

Po ashtu, duhet të cekim se te Ura e Fshejtë është zonë turistike me kanionin atraktiv Eupegjenik të lumit Drini i Bardhë. Në afërsi të kanionit janë të ngritura 5 kamp-shtëpiza si dhe restauranti.

2.7. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

2.7.1. FURNIZIMI ME UJË

Furnizimi me ujë për qytetarët e komunës së Rahovecit bëhet nga Liqeni i Radoniqit i cili menaxhohet nga KRU "Gjakova", ndërsa furnizimi në disa fshatra të komunës së Rahovecit bëhet përveç nga KRU "Gjakova" edhe nga burimet kolektive në disa fshatra. Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm në zonën e shërbimit të KRU Gjakova është: **1,124,821.332 m** apo **1,124.80** kilometra, të regjistruara në ArcMAP.

Emërtimi	Materiali dhe Ø	Gjatësia/m
Gjakova II via Xërxë/Ura Terezive	GRP ø 800	7061.06
Xërxë - Rez. Rahovec I	GRP ø 800	573.33
Rez. Rahoveci I SP Rahovec II	Çelik ø 400	2203.67
Rez. Rahoveci I - Rahovec II	PE ø 225	2365.43
Rez. Rahoveci I - Rahovec II	PE ø 225	2365.43

Rez. III Hoça Madhe	PE ø 110	1600.37
Ndarja Bellacërkë deri Celinë	AC ø 400	1600.37
Celinë – Krushë e Madhe	AC ø 350	2025.46
Krushë e Vogël	AC ø 250	584.93
Xërxë - Gexhe	AC ø 300	3217.75
Gexhe – Radostë (Malësi e Vogël)	AC ø 300	888.69
Radostë (Malësi e Vogël) - Ratkoc	AC ø 250	3257.33
Krushë e Vogël - Bregdri	AC ø 250	1810.67

Tabela 48 Pasqyrë e gypsjellësve kryesorë të sistemit të furnizimit me ujë nga KRU Gjakova

Burimet e furnizimit – Komuna e Rahovecit, furnizohet me ujë nga liqeni akumulues i Radoniqit me kapacitet 117 milion m^3. Përpos Liqenit të Radoniqit, fshatrat e Komunës së Rahovecit si: Hoça e Madhe, Snoc, Drenoc dhe Opterush, furnizohen nga burimet e ujit nëntokësor. Dezinfektimi bëhet me klor të gaztë duke aplikuar paraklorinimin dhe pasklorinimin.

Burimet e ujit	Kapaciteti i prodhimit	Kapaciteti i shfrytëzuar (prodhimi)	
	(m^3/vit)	(m^3/vit)	(m^3/ditë)
Pus në Drenoc	90,000	21,600	59,178
Pusi në Senoc	70,000	30,000	82,191
Burimi në Hoçë të Madhe	75,000	21,600	59,178
Burimi në Opterush	90,000	27,600	75,616
Prodhimi Total	325,000	100,800	276,163

Tabela 49 Kapacitetet aktuale të furnizimit me ujë në komunë të Rahovecit

Pra qytetarët e komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm në tre forma:

- Sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi i KRU Gjakova;
- Sistemet e vogla -ujësjellësit lokal (sistem të pompimit);
- Puset individuale.

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit e sidomos gjatë periudhës së nxehtë kur në shumë raste uji pijes keqpërdorët edhe për ujitjen e tokave

Sistemi i furnizimit me ujë në komunën së Rahovecit menaxhohet nga KRU "Gjakova", ndërsa furnizimi për qytetin dhe fshatrat e komunës së Rahovecit bëhet përveç nga KRU "Gjakova" edhe nga burimet e disa fshatrave.

Burimet e qytetit dhe vendbanimeve të Rahovecit janë të paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Emërtimi	Lartësia mbidetare	Lit./sek.	Temp.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8	13
Burimi i Zatriqit	920	5	13
Burimi i Opterushës	400	20	13
Burimi i Zaqishtit	415	15	13
Burimi i Hoçës së Madhe	420	10	14
Burimi i Sopotit	380	6	13

Tabela 50 Mënyra e furnizimit me ujë në komunën e Rahovecit

Bazuar në gjendjen e tanishme sistemi i furnizimit për qytetarët e komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm bëhet në tre forma dhe atë përmes:

- Sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi i KRU Gjakova;
- Sistemet e vogla -ujësjellësit lokal (sistem të pompimit); dhe

- Puset individuale.

Emri i stacionit të pompimit	Fuqia Instaluese (kW)	Nr. i pompave	Viti i instalimit	Gjendja aktuale
SP 'Rahovec"I	Q=252m³/h; P=132kw Q=37m³/h; P=64kw	2+2	1985	Mirë
SP 'Rahovec"II	Q=64m³/h; P=37kw	2	1985	Jo e mirë
SP Pataqan	Q=37m³/h; P=18kw	2	2004	Mirë
SP Pataqan 1-2	Q=32m³/h; P=15kw	2	2004	Mirë
SP Vrajakë	Q=12m³/h; P=5.5kw	2	2006	Jo e mirë
SP Bratatin	Q=1.5m³/h; P=1.5kw	2	2005	Mirë
SP Drenoc	Q=10m³/h; P=7.5kw	1	2006	Mirë
SP Senoc	Q=4.9m³/h; P=5.5kw	1	2006	Mirë
SP Opterush	Q=30m³/h; P=22kw	1	2006	Mirë
Hoçë e Madhe	Q=5.0m³/h; P=7.5kw	1	2006	Mirë

Tabela 51 Kapaciteti i stacioneve të pompimit

Emërtimi	Kapaciteti rezervuese, m^3
Rezervuari në Rahovec I	1,500
Rezervuari në Rahovec II	2,500
Rezervuari në Pataqan I	180
Rezervuari në Pataqan II	120
Rezervuari në Pataqan II	105
Rezervuari në Vrajakë	70
Rezervuari në Bratatin	50
Rezervuari në Rahovec III	250
Rezervuari në Rahovec IV	600
Rezervuari në Opterush	315
Rezervuari në Drenoc	300
Rezervuari në Polluzhë	400
Rezervuari në Senoc	300
Rezervuari në Hoçë e Madhe	200

Tabela 52 Rezervuarët dhe kapaciteti i furnizimit në Komunën e Rahovecit

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit e sidomos gjatë periudhës së nxehtë kur në shumë raste uji i pijes keqpërdorët edhe për ujitjen e tokave.


Mënyra e furnizimit me ujë në komunën e Rahovecit				
Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Sistemi	Menaxhimi
1.	Rahovec	15,892	Publik	KRU Gjakova
2.	Bellacërkë	2,270	Publik	KRU Gjakova
3.	Bërnjakë	40	Publik	KRU Gjakova
4.	Bratatin	396	Publik	KRU Gjakova
5.	Brestoc	1,288	Publik	KRU Gjakova
6.	Celinë	1,903	Publik	KRU Gjakova
7.	Çifllak	1,292	Publik	KRU Gjakova
8.	Dabidol	799	Publik	KRU Gjakova
9.	Dejnë	1,757	Publik	KRU Gjakova
10.	Drenoc	1,587	Pompim-Pusi	KRU Gjakova
11.	Gexhe	660	Publik	KRU Gjakova
12.	Hoçë e Madhe	124	Publik	KRU Gjakova
13.	Hoçë e Vogël	1,166	Publik	KRU Gjakova

14.	Kaznik	164	Individual	
15.	Kramovik	1,125	Publik	KRU Gjakova
16.	Krushë e Madhe	4,473	Publik	KRU Gjakova
17.	Mrasor	191	Individual	KRU Gjakova
18.	Nagavc	743	Publik	KRU Gjakova
19.	Nashpall	220	Publik	KRU Gjakova
20.	Opterush	1,911	Natyror	Nga burimi i fshatit sistem të pompimit autonom
21.	Pastaselë	1,011	Publik	KRU Gjakova
22.	Pataqan i Epërm	533	Publik	KRU Gjakova
23.	Pataqan i Poshtëm	1,077	Publik	KRU Gjakova
24.	Petkoviq (Guri i Kuq)	731	Publik	KRU Gjakova
25.	Polluzhë	808	Publik	KRU Gjakova
26.	Radostë (Malësi e Vogël)	2,346	Publik	KRU Gjakova
27.	Ratkoc	3,791	Publik	KRU Gjakova
28.	Reti e Poshtme	234	Publik	KRU Gjakova
29.	Retijë	771	Publik	KRU Gjakova
30.	Sapniq	996	Publik	KRU Gjakova
31.	Sarosh	6	Publik	KRU Gjakova
32.	Senoc	687	Natyror-Pusi	KRU Gjakova
33.	Vrajakë	838	Publik	KRU Gjakova
34.	Xërxë	3,184	Publik	KRU Gjakova
35.	Zatriq	535	Burim vetanak	Nga burimi i fshatit me kaptazh dhe sistem pompash
36.	Zaqishtë	659	Burim vetanak	Nga burimi i fshatit sistem të pompimit autonom
Totali		5,6208		
1.	Me ujësjellës	45,528	81%	
2.	Pa ujësjellës	8,993	16%	
3.	Sistem të pompimit	1,687	3%	

Tabela 53 Mënyra e furnizimit me ujë në Komunën e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka rrjet shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 29 vendbanime dhe që kanë qasje në ujësjellës kolektiv.

Bazuar në gjendjen aktuale dhe të paraqitur në tabelën e mësipërme mund të shihet se 81% e popullatës së Rahovecit kanë qasje në sistemin e ujësjellësit kolektiv të cilat menaxhohen nga KRUGJ, derisa vetëm 19% e popullatës nuk kanë qasje në këtë sistem. Aktualisht sistemi i ujësjellësit dhe kanalizimit (të ujërave të zeza



dhe ujërave të shiut) në komunën e Rahovecit menaxhohet nga KRU Gjakova. Furnizimi i komunës se Rahovecit me ujësjellës bëhet nga KRU Gjakova.

Grafiku 3- Format e furnizimit me ujë dhe përqindja e tyre

Sistemi i ujësjellësit të KRU Gjakova e furnizon me ujë qytetin e Rahovecit dhe vendbanimet Ratkoc, Radostë, Gexhe, Xërxë, Bellacërkë (Fortesë), Bërnjakë, Krushë e Madhe, Celinë, Brestoc, Hoçë e Vogël, Hoçë e Madhe , Dejnë, Nashpall, Sapniq, Pataqan i Epërm, Pataqan i Poshtëm, Reti e Poshtme, Vrajakë dhe Nagavc, dhe tash së fundi edhe fshatrat Dabidol, Çifllak, Kramovik, Polluzhë dhe Pastaselë. Në këtë sistem që kanë qasje të gjithë banorët prej 56,414 sa ka komuna e Rahovecit ose 87% të popullatës së përgjithshme në komunë furnizohen menaxhohen nga KRU Gjakova ndërsa 10% furnizohen nga burime të fshatit që menaxhohen nga KRU Gjakova. Pjesa prej 3% furnizohen nga burime individuale.

Nga ky sistem, në bazë të sasive të ujit, që momentalisht janë në dispozicion, konsumimi mesatar ditor për 1 banor vlerësohet të jetë përafërsisht 200-250 litra në ditë. Krahasuar me nivelet e BE-së, konsumimi i ujit për kokë banori është i mirë. Përkundër këtij kapaciteti të madh të ujit nga KRU Gjakova, gjatë muajve të verës shfaqen probleme në furnizim me ujë sidomos në pikat kritike të sistemit (zonat e larta dhe pikat e largëta). Arsyet kryesore për probleme të tilla konsistojnë në faktin se humbjet e ujit në sistemin distributor janë në një shkallë mjaft të lartë-rreth 57%. Problem në vete paraqet edhe keqpërdorimi i ujit të pijes, të cilin e shfrytëzojnë për ujitje. Faktorët tjerë që ndikojnë në këtë shkallë të lartë vlerësohet të jenë: kyçje ilegale, mos matja e saktë e ujit, etj. Këto humbje paraqesin ndryshimin ndërmjet sasisë së prodhuar dhe sasisë së faturuar të ujit. Inkasimi për vitin 2010 vlerësohet të jetë 65-70%. Trajtimi i ujit të pijes bëhet me sistemin e dezinfektimit/klorizimit. Aktualisht klorizimi bëhet me klor të gazët. Cilësia e ujit për pije nga ujësjellësi i Rahovecit kontrollohet nga IRSHP-Prizren. Frekuenca dhe numri i pikave të testimit përcaktohet në përputhshmëri me standardet e parapara me IA 2/99. Shpërndarja e ujit bëhet përmes rrjedhjes së lirë me gravitacion.

Furnizimi në vendbanimet tjera rurale - Pjesa e tjetër e popullatës, e cila nuk është e kyçur në ujësjellësin kolektiv e KRU Gjakova, furnizohen me ujë nga puse të cekëta dhe të pambrojtura (7-8m thellësi dhe shtylle ujore 2-3m). Këto puse të pambrojtura nuk janë të ndërtuara sipas standardeve për puse higjienike. Kjo tregon se uji në puse është sipërfaqësor me mundësi të madhe të ndotjes dhe me keqësimin e cilësisë së ujit për pije. Nga aspekti shëndetësor këto puse janë faktor rreziku permanent dhe e rëndon situatën epidemiologjike.

Parametrat për banorë	
Përqindja e rritjes së popullsisë [%]	1.6
Periudha e shfrytëzimit [vite]	30
Koeficienti ditor i jo njëtrajtshmërisë kd	1.6
Koeficienti orar i jo njëtrajtshmërisë ko	1.8
Aktivitete tregtare	10%
Humbjet e Ujit	8%

Tabela 54 Parametrat për banorë

Koeficienti ditor i jo njëtrajtshmërisë kd	1
Koeficienti orar i jo njëtrajtshmërisë ko	1


Tabela 55 Koeficienti ditor i jo njëtrajtshmërisë

				Për banorë		
Vendbanimet	Numri i përdoruesve	Periudha Projektuese	Norma e përdorimit [l/ban/ditë]	Prurja Maksimale ditore Qmaxdit [m³/ditë]	Prurja mesatare në sekondë Qmessek [l/sek]	Prurja maksimale në sekondë Qmaxsek [l/sek]
Rahovec	15,892	25,586	200	8,188.00	94.77	170.57
Bellacërkë (Fortesë)	2,270	3,655	150	878.00	10.16	18.28
Bërnjakë	40	65	150	16.00	0.19	0.33
Bratatin	396	638	150	154.00	1.78	3.19
Brestoc	1,288	2,074	150	498.00	5.76	10.37

Celinë	1,903	3,064	150	736.00	8.52	15.32
Çifllak	1,292	2,081	150	500.00	5.79	10.41
Dabidol	799	1,287	150	309.00	3.58	6.44
Dejnë	1,757	2,829	150	679.00	7.86	14.15
Drenoc	1,587	2,555	150	614.00	7.11	12.78
Gexhe	660	1,063	150	256.00	2.96	5.32
Hoçë e Madhe	124	200	150	48.00	0.56	1.00
Hoçë e Vogël	1,166	1,878	150	451.00	5.22	9.39
Kaznik	164	265	150	64.00	0.74	1.33
Kramovik	1,125	1,812	150	435.00	5.03	9.06
Krushë e Madhe	4,473	7,202	150	1,729.00	20.01	36.01
Mrasor	191	308	150	74.00	0.86	1.54
Nagavc	743	1,197	150	288.00	3.33	5.99
Nashpall	220	355	150	86.00	1.00	1.78
Opterush	1,911	3,077	150	739.00	8.55	15.39
Pastaselë	1,011	1,628	150	391.00	4.53	8.14
Pataqan i Epërm	533	859	150	207.00	2.40	4.30
Pataqan i Poshtëm	1,077	1,734	150	417.00	4.83	8.67
Petkoviq (Guri i Kuq)	731	1,177	150	283.00	3.28	5.89
Polluzhë	808	1,301	150	313.00	3.62	6.51
Radostë (Malësi e Vogël)	2,346	3,777	150	907.00	10.50	18.89
Ratkoc	3,791	6,104	150	1,465.00	16.96	30.52
Reti e Poshtme	234	377	150	91.00	1.05	1.89
Retijë	771	1,242	150	299.00	3.46	6.21
Sapniq	996	1,604	150	385.00	4.46	8.02
Sarosh	6	10	150	3.00	0.03	0.05
Senoc	687	1,107	150	266.00	3.08	5.54
Vrajakë	838	1,350	150	324.00	3.75	6.75
Xërxë	3,184	5,127	150	1,231.00	14.25	25.64
Zatriq	535	862	150	207.00	2.40	4.31
Zaqishtë	659	1,061	150	255.00	2.95	5.31
Gjithsej	56,208	90,492	150	21,719.00	251.38	452.46

Tabela 56 Normat e përdorimit

Norma e shpenzimeve për Rahovec është marrë Q=200l/b/d, ndërsa për vendbanime të tjera është marrë Q=150l/b/d.



Harta 8 Harta e rrjetit të ujësjellësit - Furnizimi me ujë të pijshëm

2.7.2. SISTEMI I KANALIZIMIT

Në komunën e Rahovecit, shumica e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim të ujërave të zeza, ndërsa mungon trajtimi i ujërave të zeza.


Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet se ndodhin rrjedhje të mëdha. Njohuria e sistemit të kanalizimeve në të kaluarën kryesisht u mbajt nga operatorët e sistemit shumica e të cilëve nuk janë më në dispozicion për të ndihmuar me detajet e vendndodhjes së sistemit apo funksionimit të tij. Prandaj, informacioni është jo i plotë dhe duhet bërë shumë punë për të rimarrë atë njohuri.

Sa i përket mbulueshmërisë së vendbanimeve me rrjet të kanalizimit, në Komunën e Rahovecit janë paraqitur në tabelën në vazhdim.

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Kanalizim
1.	Rahovec	15,892	PO
2.	Bellacërkë	2,270	PO-pjesërisht
3.	Bërnjakë	40	PO
4.	Bratatin	396	PO
5.	Brestoc	1,288	PO
6.	Celinë	1,903	PO
7.	Çiflak	1,292	PO
8.	Dabidol	799	PO
9.	Dejnë	1,757	PO
10.	Drenoc	1,587	PO
11.	Gexhe	660	PO
12.	Hoçë e Madhe	124	PO
13.	Hoçë e Vogël	1,166	PO
14.	Kaznik	164	JO
15.	Kramovik	1,125	PO
16.	Krushë e Madhe	4,473	PO
17.	Mrasor	191	PO
18.	Nagavc	743	PO
19.	Nashpall	220	PO
20.	Opterush	1,911	PO
21.	Pastaselë	1,011	PO
22.	Pataqan i Epërm	533	PO
23.	Pataqan i Poshtëm	1,077	PO
24.	Petkoviq (Guri i Kuq)	731	PO
25.	Polluzhë	808	PO
26.	Radostë (Malësi e Vogël)	2,346	PO
27.	Ratkoc	3,791	PO
28.	Reti e Poshtme	234	PO
29.	Retijë	771	PO
30.	Sapniq	996	PO
31.	Sarosh	6	PO
32.	Senoc	687	PO
33.	Vrajakë	838	PO
34.	Xërxë	3,184	PO
35.	Zatriq	535	PO
36.	Zaqishtë	659	PO
Totali		56,414	
1.	Me Kanalizim	53,980	95,69%

2.	Pjesërisht	2,270	4,02%
3.	Pa Kanalizim	164	0,29%

Tabela 57 Vendbanimet e komunës së Rahovecit që kanë qasje në kanalizim



Grafiku 4 Qasjet në kanalizim

Nga tabela e mësipërme shihet se 53,980 banorë kanë qasje në kanalizim ose 95,69% e popullsisë së komunës së Rahovecit, me kanalizim pjesërisht të vendosur janë 2,270 ose 4,02% dhe pa kanalizim janë 164 banorë ose 0,29%.

Nga shihet se një përqindje e madhe e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim, por shkarkimi i këtyre kanalizimeve është kryesisht pa trajtim adekuat dhe janë të derdhura në lumenj ose përroska.

Sistemi i kanalizimit të ujërave të ndotura, gjendja e rrjetit të kanalizimit dhe mungesa totale e trajtimit të ujërave të ndotura, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës e po ashtu edhe për mjedisin në tërësi.

Të gjitha kanalizimet ekzistuese pikë shkarkimin e tyre e kanë në lumenj ose në përroska, pa asnjë trajtim paraprak, përveç fshatit Kramovik në të cilën është ndërtuar impianti, i cili trajton ujërat e zeza dhe më pas shkarkohen në Lumin Drini i Bardhë.

Në territorin e Komunës së Rahovecit është në funksion Impianti i sistemit Lagun në fshatin Kramovik.

Për shkak të konfiguracionit të terrenit nuk mund të përfshihen të gjitha vendbanimet me një kolektor dhe të trajtohen në një impiant por duhet të parashihen 3 kolektorë dhe 3 impiante për trajtimin e ujërave fekale, që shkarkohen në lumin Drini i Bardhë dhe lumenjtë tjerë.

Ndërtimi i kolektorëve do të ndikojë pozitivisht në krijimin e një ambienti më të pastër dhe njëkohësisht plotësohet edhe kushti evropian për largim të ujërave të ndotur në lumenj.

Kolektori kryesor që parashikohet të ndërtohet është në Krushë të Madhe, ndërsa kolektori i dytë llogaritet të ndërtohet në Gexhe.

Rrjeti i kanalizimeve duhet në vazhdimësi të rregullohet në vendet ku sistemi është vjetërsuara si dhe duhet të shqyrtohen nevojat për zgjerim të kanalizimit edhe në vendbanime në parcela të reja.

2.7.3. UJITJA E SIPËRFAQEVE BUJQËSORE

Një ndër elementët më të rëndësishme, pas përcaktimit të tokës dhe kultivimit të një kulture bujqësore është mënyra e ujitjes. Ujitja është faktor bazë në rritjen e sasisë së prodhimit bujqësor; përmirësimin e cilësisë së prodhimit; shtimin e të ardhurave; uljen e shpenzimeve. Ajo kryhet kur toka dhe bimët kanë nevojë për ujë. Për këtë merren masa paraprake që uji të mos mungojë në momentet më të rëndësishme bio-

fiziologjike të bimës së kultivuar dhe të plotësoj kërkesat e saj, në fazat kritike të rritjes dhe të zhvillimit. Mënyrat e ujitjes së bimëve janë të ndryshme dhe viteve të fundit kanë avancuar, falë përmirësimeve të sistemeve të ndryshme.

Në praktikën bujqësore sistemet e ujitjes që përdoren më shumë janë:

- sistemi i ujitjes me rrjedhje të lirë,
- sistemi i ujitjes në formë shiu dhe
- sistemi i ujitjes së lokalizuar.

Kushtet më të volitshme për bimë, ku lagështia mundëson tretjen e materialeve ushqyese, kurse toka gjithashtu ajroset (përmirësohet me nitrate dhe oksigjen) përveç kësaj ndikon në temperaturën e tokës dhe në mikroklimë.

Sipas kohës ujitja bëhet në Pranverë, Verë, dhe në Vjeshtë.

Sipas zhvillimit të bimëve ujitja mund të bëhet në periudhën e vegjetacionit dhe në periudhën para vegjetacionit.

Ujitja e një toke me kultura varet nga klima dhe regjionet, vetitë e tokës, lloji i bimëve që mbillen dhe lartësia e rendimentit që dëshirojmë. Uji për ujitje do të shfrytëzohet në masë të nevojshme sipas sasive që disponojmë duke u bazuar edhe në kushtet tjera agroteknike, faktorët klimatik që ndikojnë në ujitje si: reshjet, temperaturë, era, avullimi, shkëlqimi i diellit-ndriçimi.

Ujitja e vendbanimeve të komunës së Rahovecit bëhet kryesisht nga kompania KRU GJAKOVA, gjegjësisht nga Rezervuari në “Rezine”, gjithashtu ujitja është bërë edhe nga burimet e vendbanimeve në Opterush dhe Zaqishtë ku ujiten fshatrat: Opterush, Zaqishtë dhe Retijë, mirëpo në këto vendbanime rrjeti i sistemit të ujitjes është jo-funksional.

Në vazhdim është paraqitur tabela me vendbanime që kanë sistemin e ujitjes:

Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Sistemi i ujitjes
1.	Rahovec	15,892	
2.	Bellacërkë (Fortesë)	2,270	PO
3.	Bërnjakë	40	PO
4.	Bratatin	396	Pjesërisht
5.	Brestoc	1,288	
6.	Celinë	1,903	PO
7.	Çifllak	1,292	PO
8.	Dabidol	799	PO
9.	Dejnë	1,757	PO
10.	Drenoc	1,587	
11.	Gexhe	660	PO
12.	Hoçë e Madhe	124	
13.	Hoçë e Vogël	1,166	
14.	Kaznik	164	
15.	Kramovik	1,125	PO
16.	Krushë e Madhe	4,473	PO
17.	Mrasor	191	
18.	Nagavc	743	Pjesërisht
19.	Nashpall	220	
20.	Opterush	1,911	
21.	Pastaselë	1,011	
22.	Pataqan i Epërm	533	
23.	Pataqan i Poshtëm	1,077	

24.	Petkoviq (Guri i Kuq)	731	
25.	Polluzhë	808	
26.	Radostë (Malësi e Vogël)	2,346	PO
27.	Ratkoc	3,791	PO
28.	Reti e Poshtme	234	
29.	Retijë	771	
30.	Sapniq	996	PO
31.	Sarosh	6	PO
32.	Senoc	687	
33.	Vrajakë	838	
34.	Xërxë	3,184	PO
35.	Zatriq	535	
36.	Zaqishtë	659	
Totali		56,208	
1.	Me Ujitje	21,922	39%
2.	Pa Ujitje	34,286	61%

Tabela 58 Sistemi i ujitjes sipas vendbanimeve

Nga tabela e mësipërme shihet se 14 fshatra kanë sistem të ujitjes në tokat bujqësore nga KRU "Radoniqi-Dukagjini", 2 fshatra kanë sistem të pjesshëm të ujitjes në tokat bujqësore, dhe 20 fshatra nuk kanë sistem të ujitjes në tokat bujqësore. Në disa vendbanime është punuar projekti, pritet të bëhet edhe ndërtimi dhe të rritet përqindja e vendbanimeve me sistem të ujitjes.

Emri i vendbanimit – fshatit.	Kompania e ujitjes -apo burimet tjera për ujitje, si lumenj, puse, etj.	Kulturat e ujitura – Të shënohen llojet e kulturave të ujitura, p.sh.veç misri, patatja, etj.	Sipërfaqet e ujitura (ha).	Çmimi për ha.
Rahovec	K.R.U,,Radoniqi,,-Dukagjini.	Perime, kultura lavërtarë dhe foragjere	35.00	€144.00
Celinë	-/-	-/-	185.00	-/-
Gexhe	-/-	-/-	98.00	-/-
Radostë (Malësi e Vogël)	-/-	-/-	345.00	-/-
Ratkoc	-/-	-/-	330.00	-/-
Çifllak	-/-	-/-	152.00	-/-
Dejnë	-/-	-/-	120.00	-/-
Dabidol	-/-	-/-	80.00	-/-
Kramovik	-/-	-/-	90.00	-/-
Polluzhë	-/-	-/-	20.00	-/-
Bellacërkë (Fortesë)	-/-	-/-	197.00	-/-
Xërxë	-/-	-/-	197.00	-/-
Krushë e Madhe	-/-	-/-	530.00	-/-
Nagavc	-/-	-/-	23.00	-/-
Pataqan i Poshtëm	-/-	-/-	7.00	-/-
Sapniq	-/-	-/-	62.00	-/-
Gjithsej			2,888.00	

Tabela 59 Të dhënat për sipërfaqet e Ujitura në vitin 2021

Nr.	Kulturat bujqësore	Sipërfaqe në ha.
1.	Misër	1,602.00 ha
2.	Spec	830.00 ha
3.	Patate	227.00 ha
4.	Shalqin ,pjepra	262.00 ha
5.	Qepë, hudhër	221.00 ha

6.	Lakër, lulelakër	109 ha
7.	Tranguj	11 ha
8.	Karrota	12 ha
9.	Domate	18 ha
10.	Të tjera	20 ha
	T o t a l i	3,312.00 ha

Tabela 60 Sipërfaqet e Kulturave bujqësore (lavërtarë, perime) të ujitura gjatë vitit 2021

Bujqësia në Udhëzim Administrativ në aspektin e zhvillimit ekonomik, bazuar në ligjin e tokave bujqësore Nr. 02/-L-26 është:

Toka bujqësore – është tokë e shfrytëzuar për kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore si: arë, fidanishte, pemishte, vreshta, livadhe, kullota, hudhra, peshku dhe moçale si dhe tokat që nuk janë për qëllime bujqësore, por që shfrytëzimi optimal është prodhimi bujqësor, duke marrë parasysh vetitë natyrore dhe kushtet ekonomike.

Toka bujqësore e punueshme – është ajo e cila përdoret për kultivimin e kulturave bujqësore, pemishte, vresht dhe livadhe.

Toka bujqësore të pa punueshme janë kullotat, hurdhe peshku dhe moçale.

Klasifikimi i tokës bujqësore është si në vijim:

- Klasifikimi sipas përshtatshmërisë
- Klasifikimi sipas zonave agroekologjike
- Klasifikimi sipas mënyrës së shfrytëzimit
- Klasifikimi sipas sistemit të ujitjes.

- Klasifikimi sipas përshtatshmërisë – është toka e klasës së parë(shumë e mirë), toka e klasës së dytë(e mirë), toka e klasës së tretë(mbi mesatare), toka e klasës së katërt(mesatare), toka e klasës së pestë (nën mesatare),tokë e klasës gjashtë(e dobët), tokë e klasës shtatë(shumë e dobët), tokë e klasës së tetë(e pa përshtatshme).

- Klasifikimi sipas zonave agroekologjike është drithëra, fruta, perime, serra, vreshta, livadhe dhe kullota, pyje për prerje si dhe kultivimi i peshkut në ujë të freskët.

- Klasifikimi sipas mënyrës së shfrytëzimit është si në vijim: tokë bujqësore e kultivuar(arë, fidanishte, pemishte dhe vreshta), tokë bujqësore jo e kultivuar/djerrinë dhe tokë bujqësore me aktivitete mbështetëse.


- Klasifikimi sipas sistemit të ujitjes është si: tokë bujqësore me sistem të ujitjes në sipërfaqe- brazda**,** tokë bujqësore me sistem të ujitjes me spërkatje, tokë bujqësore me sistem të ujitjes me pika, tokë bujqësore me sistem të ujitjes nëntokësor dhe toka bujqësore me sistem të ujitjes të kombinuar.

E rëndësishme te bujqësia është edhe mbrojtja e tokës bujqësore, e cila duhet të mbrohet nga: Erozioni, fragmentimi dhe ndërtimi.

- Mbrojtja nga erozioni i tokës bujqësore nga efektet e dëmshme të erozionit dhe kontrolli i përmbytjeve në zonën e erozionit ndërmerren masat kundër- erozive si: ndalimi i përkohshëm ose i përhershëm i lëvrimit në livadhe dhe kullosa dhe tokave të tjera bujqësore për shkak të konvertimit të tyre në tokë të punueshme me kulturat bujqësore, prezantimi i kulturave bujqësore me rotacion, kultivimi i plantacioneve shumëvjeçare, ngritja e ndërtesave specifike, përmirësimi i teknikave për trajtimin e tokës bujqësore, ngritjen dhe kultivimin e brezave bujqësore për mbjelljen e bimëve drunore shumëvjeçare, ndalimin e kullotave ë bagëtive në një kohë të caktuar, ndalimin e prerjes së pyjeve dhe plantacioneve pyjore mbi tokë të rrezikuar dhe masa të tjera mbrojtëse.

- Mbrojtja nga fragmentimi ndahet në masat kundër-fragmentuese në: toka e punueshme bujqësore e konsoliduar, sipërfaqja e së cilës është ⩽1.00 ha, nuk mund të fragmentohet në parcela dhe kjo masë mbrojtjeje respektohet në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe toka e punueshme bujqësore, sipërfaqja është ⩽0.50ha, të mos mund të fragmentohet tutje dhe kjo masë mund të përcaktohet në dokumentet e planifikimit.

Rregullimi i tokës bujqësore bëhet nëpërmjet konsolidimit dhe përmirësimi i pjellorisë së tokës bujqësore nëpërmjet meliorimit.



Harta 9 Harta e rrjetit të kanalizimit – Qasja në rrjetin e kanalizimit

2.7.4. DRENAZHIMI (KULLIMI)

Vendbanimet e komunës së Rahovecit përveç ujitjes kanë edhe sistemin e drenazhimit të sipërfaqeve bujqësore.

Për të marrë maksimumin e prodhimit nga një bimë duhet që asaj ti krijojmë kushte të favorshme rritjeje, që një nga këto është dhe ujitja e saj. Por duke e ujitur më shumë sesa që duhet bimën ose uji që vjen nga shiu, etj., krijon në tokë një sasi më të madhe lagështire nga ç ’kërkohet nga bima. Për të larguar këtë lagështi dhe për ti krijuar bimës zonën e tokës së përafruar aty ku rrënjët e bimës marrin ajër, ne bëjmë kullimin e tokave që nuk është gjë tjetër, veçse largimi i ujërave sipërfaqësor të krijuara nga shiu dhe i ujërave nëntokësorë kur ka me anën e një sistemi kanalesh kullues.

Zakonisht për ruajtje të tokave bujqësore nevojiten dy lloje të kanaleve, Kanalet për evakuim të ujit dhe kanalet për kullim të ujit.


Në komunën tonë kemi disa pika kritike që atakohen nga vërshimet dhe ujërat e rrëmbyeshëm, ku gjendjen më të rënduar e kanë vendbanimet: Bellacërkë (Fortesë), Xërxë, Celinë dhe Krushë e Madhe e po ashtu edhe vendbanimet: Kramovik, Çifllak, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë (Malësi e Vogël), Gexhë.

Territori i komunës së Rahovecit i nënshtrohet zonës me të reshura intensive të shiut me një mesatare vjetore 650-700 lit/m2, ndërsa kur kësaj i shtohet edhe masa relativisht e madhe e shkrirjes së borës, atëherë, është evidente se vërshimet janë dukuri mjaft e pranishme në territorin e komunës që reflektohen me pasoja të theksuara, sidomos gjatë sezonës Vjeshtë-Dimër.

2.7.5. RRJETI ELEKTRO-ENERGJETIK

Rrjeti elektro-energjetik në Komunën e Rahovecit është përmirësuar pas përfundimit të projektit për ndërtimin e **TS 110/35/10(20)Kv,** i cili ndodhet në dalje të Rahovecit në drejtimin e Xërxës, dhe linja **110kV** nga Theranda në Rahovec.

Në figurë është paraqitur linja e re 110 kV nga Theranda deri në Rahovec



Linja kabllovike 35kV fillon nga TS 110/35/10(20)kV – Rahovec dhe furnizon trafostacionet ekzistuese: **TS 35/10(20)kV – Rahovec** dhe **TS 35/10(20)kV – Xërxë**.

Gjithashtu edhe linjat kabllovike të reja nga **TS I RI 110/35/10(20)kV** deri te **35/10(20)kV** kanë ndihmuar në përmirësimin e situatës elektro-energjetike.

- Situata elektro-energjetike në komunën e Rahovecit është mjaft e mirë sa i përket furnizimit me energji elektrike. Në disa zona të caktuara rrjeti duhet të përmirësohet dhe të shtohen kapacitetet energjetike duke shtuar numrin e transformatorëve 10(20)/0.4kV.


Pra rrjeti i energjisë elektrike i tensionit të lartë dhe të mesëm në komunën e Rahovecit është mjaft mirë i mbuluar, shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, edhe pse në disa pjesë të caktuara të komunës nevojitet shtimi i kapaciteteve, pra transformatorë të rinj, në mënyrë të përmirësimit të mëtejmë të rrjetit elektrik. Nga gjithsej 36 km, sa ka gjatësi rrjeti energjetik i tensionit të lartë, 34.3 km e rrjetës energjetike gjendet në zonën e kopshteve. Në përgjithësi kërkohet që kapaciteti i rrjetës energjetike në të gjitha drejtimet të ketë rritje, përkatësisht duhet të vazhdohet rritja e kapacitetit të rrjetit energjetik nga 10 kV në 20 kV.

Rrjeti i tensionit të mesëm 10(20) kV elektro-energjetik në komunën e Rahovecit, kapacitetet në kV, trafo individuale dhe kolektive, duken si në tabelën e mëposhtme:


Drejtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti në kV	Trafot	Individuale	Kolektive	Nr. Konsumatorëve
Drejtimi i Qytetit 1	10 kV	4		4	1,197
Drejtimi i Qytetit 2	10 kV	5		5	1,422
Drejtimi i Nëntori 2	10 kV	1	1		1
Drejtimi i Nëntori 3	10 kV	2	2		2
Drejtimi i Komunës	10 kV	4		4	941
Drejtimi i Hidro-sistemi	10 kV	20	20		34
Drejtimi Shkolla e mesme	10 kV	2		2	623
Drejtimi i Shkozës	10 kV	14	11	3	200
Drejtimi i Opterushës	10 kV	26	4	22	1,539

Drejtimi i Pataqanit	10 kV	24		24	1,077
Drejtimi i Stone Castle	10 kV	1	1		6
Drejtimi i Bodrumit	10 kV	4	3	1	42
Drejtimi i Bellacërkës (Fortesës)	10 kV	8		8	985
Drejtimi i Ratkocit	10 kV	19	3	16	1,035
Drejtimi i Dejnit	10 kV	34	6	28	985
Drejtimi i 18 Nëntorit	10 kV	2	2		2
Drejtimi i Silosi 1	10 kV	1	1		1
Drejtimi i Silosi 2	10 kV	1	1		1
Drejtimi i Xërxës	10 kV	18	13	5	450
Drejtimi i Matreksit	10 kV	3	2	1	23
TOTALI	1	193	70	123	9,942

Tabela 61 Rrjeti Elektroenergjetik dhe kapaciteti



Harta 10 Harta e rrjetit elektroenergjetik



Harta 11 Harta e sipërfaqeve me potencial të gjenerimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme

2.7.5.1. PËRMIRËSIMI I ENERGJISË ELEKTRIKE

Këto kapacitete supozohet se në një të ardhme të afërt nuk do të jenë të mjaftueshme, prandaj propozohet shtimi i kapaciteteve elektro-energjetike.

Propozimi i shtimit të kapaciteteve elektro-energjetike në të ardhmen të bëhen sipas supozimeve në tabelën e mëposhtme:

Drejtimi i rrjetit energjetik	Kapaciteti i propozuar në kV	Numri i trafo stacioneve të propozuar	Statusi Fizik
Drejtimi i qytetit I	20 kV	2	Përmirësim solid
Drejtimi i qytetit II	20 kV	1	Përmirësim solid
Drejtimi i Komunës	20 kV	1	Përmirësim solid
Drejtimi Shkolla e Mesme	20 kV	1	Përmirësim solid
Drejtimi i Opterushës	20 kV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Pataqanit	20 kV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Bellacërkës (Fortesës)	20 kV		Përmirësim solid
Drejtimi i Shkozës	20 kV		Përmirësim solid
Drejtimi i Ratkocit	20 kV	2	Përmirësim selektiv
Drejtimi i Dejnit	20 kV		Përmirësim selektiv
Drejtimi i Xërxës	20 kV		Përmirësim selektiv
TOTALI		7	

Tabela 62 Rrjeti i energjisë elektrike, sipas kapaciteteve të propozuara

Përveç shtimit të transformatorëve nevojitet edhe përmirësimi i rrjetës elektrike të tensionit 10(20)kV si dhe 0.4kV. Në zonat rurale duhet të bëhet ndërrimi i shtyllave elektrike të drurit me ato të betonit, kurse në zonën e qytetit një pjesë e rrjetit është e përmirësuar me vendosjen e kanaleve nëntokësore të kabllove 10(20) kV që lidh nënstacionin elektrik 35kV me nënstacionet 10/0.4 kV.

Zëvendësimi i përçuesve të zhveshur me kabllo ajrore në zonat rurale dhe me kabllo nëntokësore në zonat urbane gjithashtu duhet të kryhet brenda një periudhe sa më të shkurtër.

Rrjeti primar dhe sekondar i energjisë elektrike në komunën Rahovecit është paraqitur në hartën e mëposhtme.

2.7.5.2. NDRIÇIMI PUBLIK

Komuna e Rahovecit ka 36 vendbanime, ku zona urbane mbulohet me 100% ndërsa pjesa rurale është e mbuluar me 26 fshatra me gjithsej mbi 80km ndriçim publik deri në fund të vitit 2021. Në vitin 2022 janë të planifikuara të mbulohen edhe me 9 vendbanime që janë aktualisht pa ndriçimin publik. Distanca në mes të shtyllave të ndriçimit publik është 25 deri 35 metra.

2.7.6. TELEKOMUNIKACIONI

2.7.6.1. TELEFONIA FIKSE

Lidhjet kryesore të telekomunikacionit për komunën e Rahovecit me qytetet tjera dhe jashtë komunës janë kabllot optike PTK dhe të operatorëve privat të telekomunikimeve. Rrjeti i kabllove optike dhe telekomunikimeve të PTK-së menaxhohet nga njësia e PTK-së në Rahovec, e cila ka vetëm një objekt postar dhe ka centralin e lidhur me fibër optik. Kapaciteti total i centralit të postës së Rahovecit është gjithsej 6,000 çifte 24, prej të cilave 250 shfrytëzohen, ndërsa pjesa tjetër është e pa shfrytëzuar.

Nga gjithsej 36 vendbanime sa ka komuna e Rahovecit, vetëm 5 vendbanime kanë qasje direkt në rrjetin e telefonisë fikse.

Kapaciteti momental është i mjaftueshëm edhe për periudhën e ardhme 10 vjeçare, mirëpo është e rëndësishme që të bëhet shtrirja e rrjetit në aspektin fizik në vendbanimet e tjera, të cilat janë më të mëdha

për nga numri i popullsisë. Shtrirja e rrjetit të telefonisë fikse ekzistuese mundëson qasje të mbi 47.5% të popullsisë.

Total banorë komuna e Rahovecit	56,414 (100%)
Pop. Me qasje në tel. fikse	33,957 banorë
% e pop. me qasje në tel. fikse	(47.5%)

Tabela 63 Pjesëmarrja e popullsisë në rrjetin e telefonisë fikse

Nga tabela mund të shohim se rrjeti i telefonisë fikse në komunën e Rahovecit është i shtrirë në 13.9% të vendbanimeve me gjithsej 47.5% të popullsisë. Nga kjo mund të konstatojmë se pjesëmarrja e popullsisë në nivel të komunës nuk është e kënaqshme dhe se ky rrjet mbulon një pjesë të vogël të vendbanimeve, por kryesisht me numër të madh të popullsisë.

2.7.6.2. TELEFONIA MOBILE

Mbulueshmëria me rrjet të telefonive mobile në Rahovec është mjaft mirë dhe mund të thuhet se të gjitha vendbanimet e Rahovecit kanë qasje në shërbimet e telefonisë mobile, të cilat ofrohen nga dy operatorët e licencuar nga ART-ja. Të dy operatorët mobil i kanë të shpërndara antenat individuale në lokacione të ndryshme të komunës. Numri i antenave të vendosura nga operatorët mobil sipas vendbanimeve dhe operatorëve në tërë territorin e komunës është 12.

2.7.6.3. SHËRBIMET POSTARE


Mbulohen nga Posta që është pjesë e PTK-së dhe gjithashtu nga kompanitë private të cilat kryejnë shërbime si posta të shpejta dhe të ngjashme.

2.7.6.4. SHËRBIMET E INTERNETIT

Ekzistojnë disa operatorë të cilët bëjnë shpërndarjen e shërbimeve të internetit në komunën e Rahovecit. Territori i komunës nuk është i mbuluar plotësisht me shërbime të internetit. Kryesisht nuk janë të mbuluara viset malore dhe disa pjesë të vendbanimeve rurale. Kryesisht interneti në zonat rurale është i shpërndarë në nivel të internet kafe-ve, të cilat ofrojnë shërbime në vendbanime të ndryshme si dhe kanë qëllime komerciale. Operatorët me ndikim më të madh, që ofrojnë shërbime të internetit në komunën e Rahovecit janë:

1. PTK - nëpërmjet telefonisë fikse;
2. IPKO – ofron shërbime të internetit nëpërmjet antenave (individuale);
3. KUJTESA - ofron shërbime të internetit nëpërmjet antenave (individuale); dhe
4. ART Motion.

RRJETI I TELEKOMUNIKACIONIT



Harta 12 Harta e rrjetit të telefonisë mobile

2.7.6.5. RADIOTELEVIZIONI

Rrjeti i Radiotelevizionit në komunën e Rahovecit është i shpërndarë pothuajse në tërë territorin e komunës. Ekzistojnë disa forma të shfrytëzimit të valëve radio-televizive të ndara në dy grupe:

1. Radio televizionet Nacionale – RTK, RTV21, KTV,T7, KANAL10, KLAN KOSOVA, ATV, TV DUKAGJINI.
2. Radio - lokale – Radio Aktiv.
3. Radio televizionet nëpërmjet antenave Satelitore.
4. Radio televizionet nëpërmjet sistemeve kabllore.

2.7.7. GRUMBULLIMI DHE MENAXHIMI I MBETURINAVE[25]

2.7.7.1. OPERATORËT E MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Operator i autorizuar nga komuna e Rahovecit, respektivisht nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës është Ndërmarrja Publike "Ekoregjioni"[26] me njësinë e saj "Ambienti", që mbulon një pjesë të territorit të Rahovecit. Pjesëmarrja e komunës së Rahovecit në këtë ndërmarrje është 8%, ndërsa përveç "Ekoregjionit", në Rahovec operon edhe kompania private "Ekodrinia", e cila po ashtu mbulon një pjesë të territorit të komunës. Veprimtaria primare e operatorëve është grumbullimi dhe transporti i mbeturinave komunale, si dhe shërbime dytësore si: menaxhimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike, pastrimin e rrugëve, pastrimin e borës, si dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta publike.

Kompania shërben tre kategori të konsumatorëve, respektivisht konsumatorët shtëpiak, bizneset dhe institucionet. Konsumatorët shtëpiak ndahen sipas mënyrës se si e pranojnë shërbimin, në konsumatorë shtëpiak të cilët pranojnë shërbimin derë më derë dhe konsumatorë të pajisur me kontejnerë. Bizneset ndahen në biznese të vogla dhe të mesme, të cilat pranojnë shërbimin pa kontrata dhe bizneset e mëdha me kontrata të veçanta të shërbimit. Bizneset e vogla dhe të mesme një pjesë e tyre shërbehen me mënyrën derë më derë dhe pjesa tjetër është e pajisur me kontejnerë të veçantë. Bizneset me kontrata janë të pajisura me kontejnerë të veçantë. Institucionet janë kategori e tretë e konsumatorëve dhe hiq ndonjë zyre të vogël të OJQ, avokatie apo të ngjashme, zakonisht janë me kontratë të veçantë dhe të shërbyer me kontejnerë të veçantë.

Periudha kohore e grumbullimit të mbeturinave zakonisht zhvillohet nga ora 07:00 – 14:00.

Për procedurën dhe metodologjinë e caktimit të tarifave, kompania ka aplikuar tarifat që kanë qenë sipas modelit të ZRRUM-it (2006), të ndryshuara dhe aprovuara nga Bordi i Drejtorëve në Qershor të vitit 2012, të cilat ende janë në fuqi. Mekanizmi i inkasimit për momentin në amvisëri dhe biznese të vogla bëhet përmes Inkasantëve dhe arkës ndihmëse, por ka raste që bëhet edhe nëpërmjet llogarisë rrjedhëse nga konsumatori. Kurse tek bizneset e mëdha dhe institucionet, inkasimi bëhet përmes arkës dhe llogarive rrjedhëse.

Numri total i klientëve të kompanisë "Ekoregjioni"-NJO "Eko Regjioni" dhe "Ekodrinia" për vitin 2020 dhe përditësimet e fundit në Shtator të vitit 2021, ka qenë rreth 9130 dhe kjo ka ndryshuar nga muaji në muaj sipas arkëtimeve:

Shtrirja zonale e amvisërive dhe bizneseve (klient) të cilat janë të përfshira në shërbimin e menaxhimit të mbeturinave sipas kompanisë "Ekoregjioni" dhe "Ekodrinia" janë:

- Zona Urbane: e cila i takon vetëm Rahovecit si qytezë – 3,072 klientë; dhe
- Zona Rurale : zonat e mbetura të rrethinës – 6,064 klientë

[25] Plani pesë - vjeçar Ii menaxhimit të mbeturinave për komunën eRahovecit2016 – 2021

[26]E cila operon në: Prizren, Rahovec, Suharekë, Malishevë dhe Dragash

NJO "Eko Regjioni" ka të punësuar gjithsej 51 punonjës. Kompania tjetër "Ekodrinia" ka 9 punëtorë.

Mbeturinat e mbledhura nga konsumatorët dërgohen për deponim final në deponinë sanitare në Landovicë që menaxhohet nga Kompania për Menaxhimin e Mbeturinave të Kosovës (KMDK) – Prishtinë. Pagesa për deponimin permanent bëhet tek Deponia Sanitare në Landovicë, ku edhe bëhet matja përkatëse.

Kapaciteti ruajtës i mbeturinave me kontejnerët ekzistues është rreth 25 ton. NJO "Eko Regjioni" posedon 7 kamion kompaktorë, 1 kamion me cisternë, 2 kamion me rimorkio, 3 traktorë.

"Ekodrinia" posedon 3 kamionë 12, 11 dhe 6 tonesh, një kamionetë dhe një cisternë 15,000L.

2.7.7.2. MENAXHIMI I MBETURINAVE


Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 20-30 ton, kurse sipas raporteve të dy kompanive që operojnë në Komunën e Rahovecit, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët. Pavarësisht mbulueshmërisë prej 100%, prapë se prapë haset në deponi ilegale si dhe hedhje e mbeturinave në mënyrë të pa kontrolluar, po ashtu janë të evidentuara edhe "hot-spotet" (pikat e ndjeshme) të ndikimeve mjedisore në këtë komunë me theks të veçantë në sektorin e mbeturinave, sipas raportit për mbeturinat i botuar më 2014, i cili është përgatitë nga Agjencinë për Mbrojtje të Mjedisit i Kosovës (AMMK). Komuna e Rahovecit cilësohet të ketë ndikim prej 3-5ha të hapësirës komunale të mbuluar me deponi ilegale. Komuna e Rahovecit i eliminon të gjitha deponitë ilegale të mbeturinave.

Arsyet kryesore për grumbullimin jo të plotë të mbeturinave janë të ndryshme, si:

- Niveli i ulët i vetëdijes në mesin e banorëve;
- Kapacitetet e kufizuara të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave;
- Mos pagesa e një pjese të përfituesve të shërbimit;
- Mos zgjidhja e çështjes së mbeturinave ndërtimore (demolimeve);
- Problemi i pazgjidhur i menaxhimit të mbeturinave nga mbetjet shtazore; dhe
- Shkalla e ulët dhe in formale e ndarjes dhe riciklimit.

Aktualisht, operatori më i madh është KRM "EKO Regjioni", e cila sipas shënimeve ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% të zonës urbane dhe rreth 27% në zonat rurale. Kurse operatori tjetër "Ekodrinia", shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Me gjithë përparimet e shënuara, disa kategori të mbeturinave paraqesin një sfidë jo të lehtë për komunën, në veçanti mbeturinat ndërtimore/demolimet, mbeturinat shtazore, etj.



Harta 13 Harta e menaxhimit të mbeturinave

2.7.7.3. MBETURINAT NDËRTIMORE/DEMOLIMET:

Komuna e Rahovecit ka deponi legale për deponimin e materialeve inerte. Kjo deponi gjendet rreth 5km nga qyteti i Rahovecit. Në raste të caktuara hedhja e pakontrolluar e këtyre mjeteve mund të krijojë deponi të egra dhe hedhjen e mbeturinave të ndryshme nga ana e banorëve dhe bizneseve. Përpos kësaj, nuk ekziston lidhja në mes të dhënies së lejeve ndërtimore dhe sistemit të monitorimit të hedhjes së mbeturinave.

2.7.7.4. MBETURINAT NGA MBETJET SHTAZORE:

Menaxhimi i mbetjeve shtazore në komunën e Rahovecit nuk është në harmoni me dispozitat respektive, në rend të parë për shkak të mungesës së impiantit të trajtimit të mbetjeve shtazore. Në komunë ekzistojnë 8 subjekte që merren me prodhimin, përpunimin dhe konservimin e mishit, prej tyre 3 mishtore dhe 5 thertore. Me disa prej tyre operatori aktual ka kontrata të shërbimit dhe i grumbullon mbeturinat, ndërsa një pjesë e subjekteve i hedh këto mbeturina në formë ilegale. Për më shumë, edhe mbeturinat me prejardhje shtazore që grumbullohen nga ana operatorit të licencuar nuk është e qartë si trajtohen meqë deponia regjionale nuk pranon që ky lloj i mbeturinave të deponohet në këto lokacione të veçanta.

2.7.7.5. STRATEGJIA DHE PLANI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Kjo strategji parasheh financimin e ndërtimit të impiantit të mbetjeve shtazore, i cili do të parashihte rregullimin e menaxhimit të mbetjeve të kësaj natyre në nivel të Kosovës, përfshirë këtu edhe Komunën e Rahovecit.

Realizimi i këtyre projekteve që parashihet të realizohet në periudhën projektuese do të kontribuonte në menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave komunale.

Vlen të theksohet se një deponi e tillë është duke u ndërtuar dhe financuar nga zyra e BE-së në Kosovë, ku do të ketë për qëllim, grumbullimin e të gjitha mbetjeve të kafshëve nga i gjithë territori i Kosovës.

Me ndërtimin e kësaj deponie, do të përfitojë edhe komuna e Rahovecit, ku do t`i obligojë banorët/aktivitetet të cilat merren me këtë aktivitet t`i deponojnë këto mbetje në deponinë adekuate dhe jo në deponi të egra.

Sa i përket mbetjeve të rrezikshme, në komunën e Rahovecit nuk ka ndonjë aktivitet që do të kontribuonte substancialisht në ngritjen e ndikimit në mjedis nga këto mbetje. Trajtimi i mbetjeve të rrezikshme përfshirë këtu mbeturinat kimike-industriale dhe ato medicinale do të kontribuonte në përmirësimin e mjedisit dhe minimizimin e mundësisë së kontaminimit të tokës dhe burimeve ujore nëntokësore. Largimi efektiv i mbeturinave ndërtimore dhe mbetjeve shtazore do të rezultonte në lirimin e ngarkesës për operatorët që grumbullojnë dhe bartin mbeturinat komunale. Po ashtu menaxhimi i tyre i duhur, do evitonte shkakun për hapjen e deponive të egra, siç po ndodh në periudhën e tanishme.

2.7.7.6. PLANIFIKIMI I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Synimet e përgjithshme PLMM

PLMM paraqet dokumentin bazë, me të cilin organizohet procesi i menaxhimit të mbeturinave në nivel të Komunës. Komuna e Rahovecit është e përcaktuar që të përmirësojë gjendjen e menaxhimit të mbeturinave dhe në këtë drejtim ka parashtruar objektiva specifike, që janë pjesë integrale e këtij plani. Ato përfshijnë shtrirjen e shërbimeve, parandalimin, minimizimin dhe riciklimin e mbeturinave si dhe eliminimin e hedhjes së mbeturinave në hotspote apo deponi ilegale, por në vendin e përcaktuar. Objektivat janë të ndarë në dy etapa, respektivisht në periudhën 2016-2018 dhe 2018-2021, si dhe planin e ri të menaxhimit të mbeturinave 2022-2027.

Komuna synon që përmes planit të menaxhimit të mbeturinave të arrijë:

- Vendbanime të pastra, mjedise të shëndetshme për banorët;
- Promovimin dhe mbështetjen e aktiviteteve të trajtimit të mbeturinave;
- Përfshirja me shërbim të tërë zonës përmes tarifës së përballueshme si dhe rritje të inkasimit;
- Të definohen caqet e menaxhimit të mbeturinave në nivel komunal në harmoni me legjislaturën kombëtare;
- Të definohet sistemi optimal i menaxhimit të mbeturinave; dhe
- Të definohen investimet e përgjithshme financiare dhe investimet në pjesët prioritare të planit, të cilat duhet të zbatohen menjëherë.

Objektivat

1. Vendosja e sistemit institucional për menaxhim me mbeturina;
2. Krijimi i sistemit financiar për MM-në;
3. Krijimi i procesit të kontraktimit për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave;
4. Promovimi i minimizimit të mbeturinave përfshirë mbylljen e deponive ilegale;
5. Përkrahje për ri-organizimin e komunitetit; dhe
6. Zhvillimin e pilot projekteve me qëllim të realizimit të 3R-konceptit (Riciklim, Reduktim dhe Ripërdorim).

Caqet

Plani synon të menaxhojë me mbeturinat nga ekonomitë familjare (amvisëritë dhe nga bizneset afariste), dhe mbeturinat komunale.

- Shkalla e mbulueshmërisë së shërbimit të grumbullimit do të thotë shkalla e popullsisë së shërbyer me popullsinë e përgjithshme.
- Shkalla e grumbullimit do të thotë shkalla e sasisë së mbeturinave të grumbulluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruar.
- Shkalla e hedhjes ilegale do të thotë shkalla e mbeturinave të hedhura ilegalisht duke përfshirë hedhjen jo të duhur brenda zonës pa shërbim me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.
- Shkalla e deponimit final do të thotë shkalla e mbeturinave të deponuara në deponitë e licencuara dhe ato të pa licencuara (hedhja ilegale) me sasinë e përgjithshme të mbeturinave të gjeneruara.
- Shkalla e riciklimit do të thotë sasia e mbeturinave të ricikluara me sasinë e përgjithshme të gjeneruar.

Duhet theksuar se të dhënat e paraqitura në tabelën e mësipërme janë hartuar duke u bazuar në të dhënat e grupit punues, si dhe përmes modelit kompjuterik, që shërben që të bëhen supozime për periudhat e ndryshme duke matur trendët paraprake.

Është me rëndësi të potencohet fakti se duke pasur parasysh se Planit aktual për menaxhim të mbeturinave i ka skaduar afati në vitin 2021, tani është në proces hartimi i planit të ri për menaxhimin e mbeturinave për periudhën 2022-2027.

2.7.7.7. ZONAT E SHËRBIMIT

Ndarja zonale e komunës së Rahovecit




Figura 19 Zonimi i territorit të komunës së Rahovecit për qëllime të menaxhimit të mbeturinave

Për qëllime të organizimit të menaxhimit të mbeturinave është krijuar sistemi i zonimit të territorit.

Zonimi i territorit është bazuar në kriteret:

- Shpërndarja proporcionale e zonave të drejtimeve dhe linjave të operimit të menaxhimit të mbeturinave;
- Shpërndarja në bazë të numrit të banorëve;
- Shpërndarja në bazë të numrit të amvisërive; dhe
- Shpërndarja në bazë të numrit të objekteve.

Zona e synuar për Planin Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave është e gjithë zona administrative e komunës së Rahovecit. Zona që synohet të arrihet me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në kuadër të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave janë disa familje të fshatrave të zonës së 2 (ngjyra e hapur) ku synohet të futen në sistem edhe 533 ekonomi familjare shtesë ku deri tash në një mënyrë apo tjetrën nuk kanë qenë pjesë e sistemit të menaxhimit të mbeturinave, detajet e fshatrave dhe gjenerimit të mbeturinave mund të shihen në tabelën e mëposhtme së bashku me synimin për mbulueshmëri gjatë implementimit të këtij plani:

Lokalitetit	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Ekonomi Familjare	Ekonomi Familjare/Të Mbulura	Ekonomi Familjare/Pa Mbulura	Gjen.Mbet.në Vit-Ton	Mbet. Jo-të. Menaxh.
Nashpall	Zona 2	7	6-9	32	22	10	40	13
Senoc	Zona 2	7	6-9	101	69	32	125	39
Polluzhë	Zona 2	11	9-12	162	60	102	147	93
Gexhë	Zona 2	12	9-12	165	68	97	120	71
Kaznik	Zona 2	13	12-40	24	8	16	24	16
Bratatin	Zona 2	21	12-40	58	24	34	58	34
Dabidol	Zona 2	21	12-40	138	36	102	117	86
Sarosh	Zona 2	23	12-40	2	1	1	1	0
Petkoviq	Zona 2	28	12-40	183	56	127	107	74
Mrasor	Zona 2	32	12-40	28	15	13	28	13
Total				892	359	533		439

Tabela 64 Lokalitetet të cilat nuk marrin shërbim të plotë të MM

Pra synohet që të rritet mbulueshmëria për fshatrat e kësaj zone dhe të futen në sistem të menaxhimit të mbeturinave edhe 439 tonë mbeturina vjetore, siç edhe mund të shihet nga tabela e mëposhtme:

Kategoria	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Ekonomitë Familjare	-	393	140	-	-	-	533
Numri i Lokaliteteve	-	8	2	-	-	-	10
Numri i banorëve	-	2,116	140	-	-	-	2,256
Mbeturinat e Gjeneruara (Në TON)	-	352	87	-	-	-	439

Tabela 65 Implementimi i MM -Kategoritë kryesore për periudhën 2016-2021

Zona	Viti/Implementimi	2016	2017	2018	2019	2020	2021	Total
Nashpall	2017		10					10
Senoc	2017		32					32
Polluzhë	2017		102					102
Gexhe	2017		97					97
Kaznik	2017		16					16
Bratatin	2017		34					34
Dabidol	2017		102					102
Sarosh	2017		1					1
Petkoviq	2018			127				127
Mrasor	2018			13				13
Total		-	393	140	-	-		533
Lokalitetet		-	8	2	-	-		10

Tabela 66 Implementimi i MM - Ekonomitë Familjare

2.7.7.8. ZONIMI I TERRITORIT

Kategoria	Numri
Numri i banorëve	56,208
Numri i ekonomive familjare	8,676
Sipërfaqja në km²	276
Gjenerimi i mbeturinave (e përllogaritur)	10,611

Tabela 67 Veçoritë gjenerimit të mbeturinave

Mbulimi me shërbime të MM	Numri	Në %
Mbulimi me shërbime të MM (ekonomi familjare)	8,143	93.9%
Mos mbulimi me shërbime të MM (ekonomi familjare)	533	6.1%

Tabela 68 Veçoritë gjenerimit të mbeturinave

Kategoria -Zonimi	Zona 1	Zona 2	Total
Numri i Lokalitetit	14	22	36
Mesatarja në km	7.90	15.64	24
Sipërfaqja në km²	144	132	276
Numri i ekonomive lokale	6,282	2,394	8,676
Nr. e ekon. fam. /ofrohen shërb. MM	6,282	1,861	8,143
Shkalla e mbulimit me shërb. MM	100%	77.7%	93.9%
Numri i Popullatës	34,658	21,550	56,208
Numri i popullatës në %	61.7%	38.3%	100%
Gjen. mbetu. në vit	7,099	3,512	10,611
Gjen. mbetu. në vit në %	66.9%	33.1%	100%

Tabela 69 Veçoritë gjenerimit të mbeturinave sipas zonave

Kategoria	Popullata	%	Sip. km²	%	Mbeturinat	%
Urbane	15,892	28.3%	49	17.8%	3,596	33.9%
Para Urbane	4205	7.5%	39	14.0%	952	9.0%
Rurale	21,670	38.6%	102	37.0%	3,955	37.3%
Rurale e Thellë	14,441	25.7%	86	31.2%	2,108	19.9%
Totali	**56,208**	**100%**	**276**	**100%**	**10,611**	**100%**

Zona	Nr. lokalit	Mesa. km	Sip. km²	Nr. Ekonomive Familjare	Nr. i popullatës	Gjen. i mbet. në vit
Urbane	14	7.90	144	6,282	34,658	7,099
Para Urbane	22	15.64	132	2,394	21,550	3,512
Totali	**36**		**276**	**8,676**	**56,208**	**10,611**

Tabela 70 Tabelat përmbledhëse e veçorive të zonës – KK Rahovec

2.7.7.9. ZONIMI I BAZUAR NË KRITERET PËR VLERËSIMIN E ZONËS NË SEKTORIN E MENAXHIMIT TË MBETJEVE

Zonat e përcaktuara për Menaxhimin e Mbeturinave –KK Rahovec

Zona 1	Zona 2	Total
Nr.Lokalitetet 14	Nr.Lokalitetet 22	Nr.Lokalitetet 36
38.9%	61.1%	100.0%
Popullata 34,658	Popullata 21,550	Popullata 56,208
61.7%	38.3%	100.0%
Sipërfaqja km² 144	Sipërfaqja km² 132	Sipërfaqja km² 276
52.2%	47.8%	100.0%
Ekon.Familjare 6,282	Ekon.Familjare 2,394	Ekon.Familjare 8,676
72.4%	27.6%	100.0%
Ofrohen sher.MM-Ekon.Familiare 6,282	Ofrohen sher.MM-Ekon.Familiare 1,861	Ofrohen sher.MM-Ekon.Familiare 8,143
77.1%	22.9%	100.0%
Mbulimit me Sher.MM 100.0%	Mbulimit me Sher.MM 77.7%	Mbulimit me Sher.MM 93.9%

Kategoria	Zona 1	Zona 2	Total	Në %
Urbane	49	-	49	17.8%
Para Urbane	31	8	39	14.0%
Rurale	55	47	102	37.0%
Rurale e Thellë	10	76	86	31.2%
Total	**144**	**132**	**276**	**100.0%**
Në %	52.2%	47.8%	100.0%	

Tabela 71 Zonat përcaktuara e MM e bazuar në km²

Kategoria	Zona 1	Zona 2	Total	Në %
Urbane	3,596	-	3,596	33.9%
Para Urbane	592	359	952	9.0%
Rurale	2,764	1,191	3,955	37.3%
Rurale e Thellë	147	1,962	2,108	19.9%
Total	**7,099**	**3,512**	**10,611**	**100.0%**
Në %	66.9%	33.1%	100.0%	

Tabela 72 Zonat përcaktuara e MM e bazuar në gjenerimin e përllogaritur të mbeturinave

2.7.7.10. SHPËRNDARJA E EKONOMIVE FAMILJARE E BAZUAR NË ZONAT E PËRCAKTUARA DHE KOMPANITË OFRUESE TË SHËRBIMEVE TË MENAXHIMIT TË MBETURINAVE

Operatori	Zona 1	Zona 2	Total	Në %
Ekodrinia	540	1,861	2,401	29.5%
NJP "Ambienti	5,742	-	5,742	70.5%
Total	**6,282**	**1,861**	**8,143**	**100.0%**

Tabela 73 Shpërndarja e ekonomive familjare e bazuar në zonat e përcaktuara dhe kompanitë ofruese të shërbimeve

Zona 1- e bazuar në kriteret e përcaktuara të zonimit

Nr.	Zona	Rurale Urban	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Nr. Banorëve	Nr. i ekono. fam. në komunë	Gjenerimi I MM
1.	Rahovec	Urbane	Zona 1	1.0	0-3	15,892	3,072	3,596
2.	Krushë e Madhe	Rurale	Zona 1	10.0	9-12	4,473	779	816
3.	Xërxë	Rurale	Zona 1	9.3	9-12	3,184	288	581
4.	Bellacërkë	Rurale	Zona 1	7.0	6-9	2,270	252	414
5.	Opterush	Rurale	Zona 1	8.1	6-9	1,911	332	349
6.	Celinë	Rurale	Zona 1	11.8	9-12	1,903	357	347
7.	Brestoc	Para Urbane	Zona 1	4.3	3-6	1,288	265	291
8.	Hoçë e Vogël	Para Urbane	Zona 1	5.5	3-6	1,166	224	264
9.	Retijë	Rurale e Thellë	Zona 1	12.9	12-40	771	124	113
10.	Nagavc	Rurale	Zona 1	7.5	6-9	743	158	136
11.	Zaqishtë	Rurale	Zona 1	7.1	6-9	659	165	120
12.	Reti e Poshtme	Rurale e Thellë	Zona 1	16.4	12-40	234	124	34
13.	Hoçë e Madhe	Para Urbane	Zona 1	4.8	3-6	124	60	28
14.	Bërnjakë	Para Urbane	Zona 1	4.9	3-6	40	-	9
Total						34,658	6,200	7,099

Tabela 74 Zona 1 - e bazuar në kriteret e përcaktuara të zonimit

Zona 2 - e bazuar në kriteret e përcaktuara të zonimit


Nr.	Zona	Rurale Urban	Zona	Distanca KM	Rangu Km.	Nr. Banorëve	Numri i ekono. familjare në komunë	Gjenerimi I MM
1.	Drenoc	Para Urbane	Zona 2	5.7	3-6	1,587	161	359
2.	Pataqan i Poshtëm	Rurale	Zona 2	11.0	9-12	1,077	103	197
3.	Pastaselë	Rurale	Zona 2	9.2	9-12	1,011	83	185
4.	Sapniq	Rurale	Zona 2	9.7	9-12	996	90	182
5.	Polluzhë	Rurale	Zona 2	11.2	9-12	808	162	147
6.	Senoc	Rurale	Zona 2	7.2	6-9	687	101	125
7.	Gexhe	Rurale	Zona 2	11.6	9-12	660	165	120
8.	Zatriq	Rurale	Zona 2	10.3	9-12	535	42	98
9.	Pataqan i Epërm	Rurale	Zona 2	6.2	6-9	533	52	97
10.	Nashpall	Rurale	Zona 2	7.0	6-9	220	32	40
11.	Ratkoc	Rurale e Thellë	Zona 2	17.0	12-40	3,791	380	553
12.	Radostë (Malësi e Vogël)	Rurale e Thellë	Zona 2	12.3	12-40	2,346	206	343
13.	Dejnë + Baboc	Rurale e Thellë	Zona 2	19.0	12-40	1,757	116	257
14.	Çifllak	Rurale e Thellë	Zona 2	23.0	12-40	1,292	104	189
15.	Kramovik	Rurale e Thellë	Zona 2	25.5	12-40	1,125	93	164
16.	Vrajakë	Rurale e Thellë	Zona 2	20.0	12-40	838	72	122
17.	Dabidol	Rurale e Thellë	Zona 2	20.9	12-40	799	138	117
18.	Petkoviq (Guri i Kuq)	Rurale e Thellë	Zona 2	28.3	12-40	731	183	107
19.	Bratatin	Rurale e Thellë	Zona 2	20.7	12-40	396	58	58
20.	Mrasor	Rurale e Thellë	Zona 2	32.0	12-40	191	28	28
21.	Kaznik	Rurale e Thellë	Zona 2	13.0	12-40	164	24	24
22.	Sarosh	Rurale e Thellë	Zona 2	23.3	12-40	6	2	1
				15.6		21,550	2,394	3,512

Tabela 75 Zona 2 - e bazuar në kriteret e përcaktuara të zonimit

Zonat e bazuara në kriteret e përcaktuara të zonimit

Zona	Nr. Banorëve	Numri i ekono. familjare në komunë	Gjenerimi I MM
Zona 1	34,658	6,282	7,099
Zona2	21,550	2,394	3,512
Total	56,208	8,676	10,611

Tabela 76 Zona e bazuara në kriteret e përcaktuara të zonimit



Harta 14 Harta e infrastrukturës teknike

2.8. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

2.8.1. SHTRIRJA DHE GJENDJA E RRUGËVE EKZISTUESE

Komuna e Rahovecit shtrihet në mesin e rrugëve nacionale Gjakovë – Prishtinë dhe Gjakovë – Prizren, si dhe atyre regjionale Malishevë – Gjakovë dhe Rahovec – Suharekë.

Territori i komunës është relativisht i madh i cili ka një rrjet rrugorë prej 527.00 km rrugë të të gjitha kategorive.

Gjendja e trafikut është relativisht në nivel të kënaqshëm në rrugët periferike të komunës, ndërsa sa i përket atyre brenda qytetit ka pak vështirësi në zhvillimin normal të qarkullimit të mjeteve, e kjo bëhet edhe më e vështirë kur kemi parasysh praninë e madhe të motokultivatorëve dhe mjeteve bujqësore motorike. Konfiguracioni i terrenit është kodrinor ku karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj i kemi edhe rrugët shumë të ngushta, të cilat përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

Shumica e këtyre rrugëve janë të asfaltuara, mirëpo nuk kanë trotuare për lëvizjen e këmbësorëve. Për nga aspekti i mobilitetit, rrugët në këto lagje mund të cilësohen si të rrezikshme duke mos u ofruar siguri të mjaftueshme të gjithë pjesëmarrësve në trafik.

Komuna përveç trafikut rrugor ka edhe atë hekurudhor, e cila e lidh Prizrenin – Fushë Kosovën, mirëpo aktualisht kjo linjë është jashtë funksionit.

Në komunën e Rahovecit ekziston niveli i katër kategorive të rrugëve (të klasifikuara në Kosovë), duke filluar prej rrugëve nacionale e deri tek ato të pa kategorizuara.

Rrjeta e rrugëve në komunën e Rahovecit përbëhet nga:

- Rrugët nacionale – M9.1 (Gjakovë - Prishtinë).
- Rrugë regjionale - (R-107 Prizren-Gjakovë, R-117 Rahovec-Suharekë, R-111 Xërxë.
- Ratkoc-Kramovik, R-204 Rahovec- Krushë e Madhe, R-110 Malishevë- Rahovec –Xërxë.
- Rrugë lokale (rrugët të cilat i lidhin 34 zona kadastrale me gjithsej 36 vendbanime, duke përfshirë edhe rrugët që lidhin lagjet më të rëndësishme të vendbanimeve).
- Rrugë të pa kategorizuara (të cilat lidhin lagjet e fshatit si dhe i lidhin të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen aktivitete socio-ekonomike).

Nr.	Përshkrimi	Gjatësia në km	%
1.	Rrugë nacionale	4,5km	0,86%
2.	Rruge regjionale	64.37km	12,26%
3.	Rruge urbane	184.25km	35.1%
4.	Rruge lokale	188.67 km	35,93%
5.	Rruge të pa kategorizuara	83.2km	15,85%
TOTALI		524.99km	100%

Tabela 77 Rrjeti i rrugëve në komunën e Rahovecit

Nga totali i përgjithshëm i rrugëve 524.99 km, sa janë në komunën e Rahovecit sipas gjatësisë, rrugë nacionale janë 4.5km, rrugë regjionale 64.37 km, rrugë lokale 188.67km, rrugë urbane 184.25 km dhe rrugë të pa kategorizuara janë gjithsej 83.2 km.

2.8.1.1. RRUGË NACIONALE M9.1

Nëpër territorin e komunës së Rahovecit kalon rruga e rëndësishme në nivel nacional, e cila i lidhë Prishtinën - Gjakovën dhe me Shqipërinë e Veriut (nëpërmjet Qafës së Morinës), që cilësohet si rrugë nacionale. Kjo rrugë në komunën e Rahovecit ka një gjatësi prej 4.5 km, si dhe kalon në dy komuna kadastrale.

Komunat kadastrale (vendbanimet) në të cilat kalon rruga nacionale M9.1 janë: Kramovik, Mrasor.

Pozita e mirë gjeografike i ka mundësuar kësaj komune lidhje shumë të mira të komunikacionit rrugor dhe hekurudhor. Gjithashtu e karakterizon atë me komunikacion mjaft të dendur, si në transportin e mallrave, po ashtu edhe atë të udhëtarëve.

Rruga nacionale e cila shtrihet në territorin e komunës është e asfaltuar dhe menaxhohet nga MTPT. Sipërfaqja e tokës e cila shfrytëzohet nga aktivitetet e rrugës nacionale është gjithsej 4.5 ha. Gjendja e rrugës nacionale në komunën e Rahovecit, në përgjithësi është e mirë.

Karakteristikë e kësaj rruge është shtrirja e urave (mbikalime) në raport me hekurudhën dhe me rrugë që e lidh Gjakovën me Klinën.

2.8.1.2. RRUGË REGJIONALE

Rrugët e kësaj kategorie i mundësojnë komunës së Rahovecit lidhje shumë të mirë në nivel regjional dhe kanë shtrirje në pesë drejtime me gjatësi prej 64.37km. Gjithashtu këto rrugë janë të asfaltuara dhe menaxhohen nga MMPHII:

a) Rruga R-107, Prizren – Xërxë - Gjakovë – me një gjatësi prej 11 km.
b) Rruga R-110, Malishevë – Rahovec - Xërxë me një gjatësi prej 16.3 km.
c) Rruga R-111, Xërxë – Ratkoc - Kramovik me gjatësi prej 17 km.
d) Rruga R-117, Rahovec - Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë me gjatësi prej 7.6 km.
e) Rruga R-204, Rahovec – Krushë e Madhe me gjatësi prej 12.4 km.

Rruga regjionale R-107, Prizren – Xërxë - Gjakovë i mundëson komunës së Rahovecit lidhje të mirë me komunën e Prizrenit dhe të Gjakovës dhe rrugët regjionale R111 që lidhet me komunën e Klinës. Kjo rrugë i lidhë vendbanimet mjaft të rëndësishme si (Krushë e Madhe, Celinë, kalon në komunën kadastrale të fshatit Bellacërkë dhe Xërxë). Kjo rrugë ka gjatësi 11 km në territorin e komunës së Rahovecit.

Rruga regjionale R110, – krijon lidhje të mira në mes të komunës së Rahovecit dhe Malishevës dhe pastaj nëpërmjet kësaj rruge lidhet edhe me Prishtinën (Rahovec - Malishevë – Prishtinë) – kalon në pjesën qendrore të komunës së Rahovecit e deri të kufiri komunal i Malishevës. Kjo rrugë ka gjatësi prej 16.3 km dhe i prekë komunat kadastrale të: Xërxës, Bellacërkës, Bërnjakut dhe komunën kadastrale të qytetit të Rahovecit).

Rruga regjionale R111, Xërxë – Ratkoc - Kramovik - shtrihet kryesisht në pjesën perëndimore të komunës me gjatësi prej 17 km. Nëpërmjet kësaj rruge komuna e Rahovecit ka qasje në nacionalen Gjakovë - Prishtinë dhe me komunën e Klinës.

2.8.1.3. RRUGË URBANE

Konsiderohen rrugët të cilat i lidhin lagjet e qytetit të Rahovecit, gjithsej rrugë urbane në qytetin e Rahovecit kemi 184.25 km.


2.8.1.4. RRUGË LOKALE

Konsiderohen rrugët të cilat i lidhin të gjitha vendbanimet e komunës duke u nisur nga qendra e vendbanimit dhe rrugët e tjera të rëndësishme të cilat mundësojnë lidhje të mira me to. Gjithsej rrugë lokale në komunën e Rahovecit janë 188.67 km.

2.8.1.5. RRUGË TË PA KATEGORIZUARA

Konsiderohen të gjitha sipërfaqet të cilat shfrytëzohen për realizimin e aktiviteteve bujqësore, socio-ekonomike dhe të tjera si në brendësi të vendbanimeve, po ashtu edhe në sipërfaqet e tjera të komunave kadastrale. Gjithsej rrugë të kësaj kategorie në tërë territorin e komunës së Rahovecit janë 83.2 km. Kjo kategori e rrugëve nuk është e asfaltuar, mirëpo rrugët të cilat shfrytëzohen për lidhjen e hapësirave në

brendësi të vendbanimeve, si dhe ato të cilat i lidhin vendbanimet në thellësi të komunës, përkatësisht të viseve malore janë të shtruara me rërë dhe zhavorr. Ndërsa rrugët e tjera të kësaj kategorie janë rrugë të cilat shfrytëzohen për aktivitete bujqësore.



Harta 15 Harta e infrastrukturës teknike

2.8.2. RRJETI HEKURUDHOR

Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regjional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regjional i cili e lidh Prizrenin - kalon në territorin e komunës së Rahovecit dhe e lidhë Klinën me Fushë Kosovë). Kjo linjë hekurudhore është një binarësh me gjatësi prej 10.4 km. Komunat kadastrale të cilat preken nga rrjeti hekurudhorë, përkatësisht kanë qasje direkt në këtë rrjet janë gjithsej 12, duke filluar nga (Mrasor, Kramovik, Çifllak, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë, Gexhe, Xërxë, në komunën kadastrale të Bellacërkës, Celinës dhe Krushës së Madhe).

Duke u nisur nga ky fakt mund të konstatojmë se rrjeti hekurudhor, i cili është mjaft i hershëm në këtë komunë është edhe si indikator për zhvillimin e vendbanimeve më të rëndësishme të komunës. Rrjeti hekurudhor është i një rëndësie të veçantë, jo vetëm për komunën e Rahovecit por edhe tjerat sepse ndihmon në transportimin e mallrave dhe udhëtarëve. Linja hekurudhore për momentin nuk është në funksion dhe si rrjedhojë nuk ka qarkullim të udhëtarëve dhe mallrave përmes saj.

2.8.3. URAT

Të gjitha urat, e identifikuara në tërë territorin e komunës së Rahovecit, i takojnë dy kategorive të komunikacionit:

- Komunikacionit rrugor; dhe

- Komunikacionit hekurudhor.

2.8.3.1. URAT NË KOMUNIKACIONIN RRUGOR

Nga 16 ura të cilat janë të ndërtuara në rrjetin rrugor të komunës, 3 prej tyre shtrihen në rrugë nacionale dhe 7 në rrugë regjionale.

Urat e tjera shtrihen në rrugë lokale dhe ato të pa kategorizuara të cilat kanë gjatësi prej 5 deri 20 m. Në përgjithësi janë në gjendje të mirë. Disa prej tyre kanë qenë të dëmtuara gjatë luftës së viteve 1009/1999, mirëpo janë rindërtuar pas luftës.

2.8.3.2. URAT NË RRUGË MAGJISTRALE

Konfiguracioni i terrenit ka imponuar që në gjithsej 6.2 km rrugë nacionale në komunën e Rahovecit, të ndërtohen 3 ura mjaft të rëndësishme për komunikacionin e rrugës nacionale (Kramovik 2, Mrasor 1). Urat kryesore dhe më të rëndësishme në këtë kategori të rrugëve janë ato në fshatin Kramovik, njëra prej tyre mbi lumin Drini i Bardhë me gjatësi prej 131 m, e tjetra mbi hekurudhë me gjatësi 100m.




Urat e tjera kryesisht konsiderohen të vogla me gjatësi prej 1 deri 10m, dhe shtrihen në rrugët lokale dhe të pa kategorizuara. Në përgjithësi janë në gjendje mesatarisht të mirë, me përjashtim të disa urave të cilat karakterizohen me gjerësi të vogël dhe të pa mjaftueshme.

2.8.3.3. URAT NË RRUGË REGJIONALE

Janë të vendosura në të dy drejtimet e rrugëve regjionale, një është e vendosur në rrugën regjionale Rahovec - Xërxë – Gjakovë (përkatësisht në komunën kadastrale të Xërxës me gjatësi prej 65 m, mbi lumin Drini i Bardhë (Ura e fshejtë) tjerat në komunën kadastrale të Ratkocit me 20 metra, dhe tjetra 15 m, dhe në komunën kadastrale të Çifllakut me gjatësi 18 metra në rrugën regjionale Xërxë – Ratkoc - Kramovik.

2.8.3.4. URAT NË KOMUNIKACIONIN HEKURUDHOR

Në rrjetin hekurudhor të komunës së Rahovecit janë të ndërtuara gjithsej 4 ura, prej të cilave 1 në komunën kadastrale të Mrasorit, 1 në Çifllak, 1 në Ratkoc, 1 në komunën kadastrale të Bellacërkës (Fortesës).

2.8.3.5. TUNELET

Karakteristikë e komunikacionit hekurudhor është tuneli në mes të vendbanimit Gexhe dhe Xërxë (tuneli në komunën kadastrale të Gexhës dhe të Xërxës me gjatësi prej 730 m të ndërtuara në rrjetin hekurudhor).

2.8.3.6. SIGURIA NË TRAFIK

Siguria në trafik në komunën e Rahovecit përkatësisht në zonën urbane, sipas konceptit të mobilitetit, mund të llogaritet e nivelit të lartë. Kjo për faktin se ka një infrastrukturë rrugore adekuate për automjete, ndërsa në nivel mesatar për lëvizje të mjeteve të pa motorizuara si për këmbësorë, ashtu edhe për çiklistë. Zona urbane karakterizohet me hapësire për ndërtime të trotuareve të reja për këmbësorë, për shkak se nuk ka pasur mundësi të ndërtimit të tyre. Në këto lagje rrugët janë shumë të ngushta në shumicën prej tyre

zhvillohet trafiku në dy kahe dhe e bën shumë të vështirë edhe të rrezikshëm lëvizjen e këmbësoreve. Këto rrugë shfrytëzohen shumë, sidomos nga nxënësit për të shkuar në shkolla sepse lëvizja në këmbë është e vetmja mënyrë e lëvizjes për këto nevoja ditore, pasi që transport urban nuk ka të organizuar brenda qytetit.

Rrethrrotullimi në hyrje të qytetit, rruga regjionale Xërxë – Malishevë




Është duke ekzekutuar rruga me 4 korsi, nga Xërxa deri në rrugën transite mbi Rahovec.

Kryqëzimi në rrugën nacionale Prizren – Gjakovë, fshati Xërxë.




Ky kryqëzim është planifikuar të ndërtohet nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. Është planifikuar të ndërtohet rreth rrotullimi dhe nënkalimi.





Kryqëzimi në rrugën nacionale Gjakovë – Prishtinë



Kryqëzimi në rrugën regjionale Rahovec – Krushë e Madhe, ku është rregulluar rreth rrotullimi.



Disa rrugë të lagjeve që janë të rrezikshme për zhvillimin e komunikacionit të automjeteve dhe të këmbësorëve.





2.8.3.7. SHTRIRJA DHE KATEGORIA E RRUGËVE TË PLANIFIKUARA NGA NIVELI QENDROR

Aktualisht, në qytetin e Rahovecit përveç rrugës kryesore, e cila e përshkon qendrën e qytetit, janë ndërtuar edhe rrugë unazore të qytetit si rruga transite mbi Rahovec, rruga Hamovc - Rahovec.

Me ndërtimin e këtyre rrugëve është lehtësuar qarkullimi i lirë i automjeteve, si në zonën urbane, po ashtu edhe jashtë zonës urbane.





2.8.3.8. LINJA TRANSPORTUESE NDËRKOMUNALE BRENDA KOMUNËS, URBANE DHE RURALE

Trafiku urban në komunën e Rahovecit, përkatësisht në zonën urbane, tash për tash nuk ekziston.

Ka të organizuar trafikun urbano – periferik dhe atë ndër-urban. Të gjitha itineraret janë të caktuara nga disa rregullore të nxjerra nga kuvendi komunal.

Transporti urbano – periferik organizohet me autobusë nga kompani private, ku gjendja e mjeteve në disa raste nuk është në nivelin e duhur, linjat kryesisht shfrytëzohen për transportin e nxënësve.

Linjat e transporti Urbano - Periferik janë këto:

- Pastaselë - Rahovec – Pastaselë , (me stacionet në: Pastaselë, Senoc dhe Drenoc);
- Pataqan i Poshtëm – Pataqan i Epërm – Sapniq- Bellacërkë (Fortesë) – Nashpall – Rahovec, me stacionet në: P. i Epërm, Nashpall, P. i Poshtëm, Sapniq dhe Bellacërkë (Fortesë))
- Rahovec – Opterush – Rahovec, (me stacionet në: Rahovec, H.Madhe, Zaqishtë, Opterush dhe Retijë);
- Rahovec – Xërxë – Ratkoc – Bratatin, (me stacionet në: Rahovec, Bërnjakë, Bellacërkë (Fortesë), Xërxë, Gexhe dhe Radostë (Malësi e Vogël)); dhe
- Rahovec – Xërxë – Ratkoc, (me stacionet në: Rahovec, Bërnjakë, Bellacërkë (Fortesë), Xërxë, Gexhe dhe Radostë (Malësi e Vogël)).

Linjat ndër-urbane kanë një qasje të mirë dhe shpeshtësia e tyre është në nivelin e duhur. Komuna ka stacion të autobusëve që me rregullore është paraparë që të gjitha linjat duhet të nisen dhe të përfundojnë në këtë stacion. Mirëpo, një shqetësim tjetër është se operatorët e autobusëve nuk e respektojnë dhe ndalen edhe në pjesët tjera të qytetit, si për zbritjen e udhëtareve, ashtu edhe për marrjen e tyre. Kjo ndodh sidomos në zonat atraktive në qendër, apo në afërsi të shkollave. Aktualisht, janë planifikuar nënstacione për vend ndalje të autobusëve si brenda qytetit po ashtu edhe në vendbanime më të mëdha të komunës.

2.8.4. SHFRYTËZIMI I RRUGËVE NGA AUTOMJETET, KËMBËSORËT, BICIKLETAT DHE MËNYRAT TJERA TË TRANSPORTIT

2.8.4.1. TRAFIKU PËR KËMBËSORË

Shtigjet e këmbësorëve janë pothuajse pjesa më e rëndësishme e infrastrukturës, sidomos për zonat urbane, kur dihet që shumica e lëvizjeve ditore bëhet në këmbë, mirëpo pa e anashkaluar edhe nevojën për rrugët që i lidhin fshatrat. Në komunën e Rahovecit gjendja me trotuare qëndron mirë, sepse është investuar vit pas viti. Qyteti ka një terren kodrinor me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve që karakterizohen me rrugë të ngushta, të cilat janë të asfaltuara në tërësi. Sidomos gjatë periudhës së dimrit kemi një gjendje shumë të rrezikshme për lëvizje të këmbësorëve, duke pasur parasysh edhe pjerrtësitë në këto rrugë.

2.8.4.2. TRAFIKU PËR ÇIKLISTË

Në qytetin e Rahovecit janë planifikuar shtigjet për çiklistë në disa segmente të rrugëve, të cilat kanë hapësirë të mjaftueshme për ndërtimin e tyre. Në të ardhmen, nëse qyteti vazhdon të rritet në pjesën e rrafshët, është mirë që të parashihet dhe të inkorporohet edhe kjo formë e transportit.

2.8.4.3. LËVIZJA E PERSONAVE ME NEVOJA TË VEÇANTA

Komuna e Rahovecit përkatësisht zona urbane kanë një infrastrukturë adekuate, e cila do t`u mundësonte njerëzve me nevoja të veçanta një qasje të lehtë dhe një lëvizje të lirë.

Mirëpo, edhe pjesët e qytetit ku ka trotuare i plotësojnë kriteret, përkatësisht janë punuar pjerrësitë për të krijuar qasje më të lehtë.

2.8.5. HAPËSIRAT EKZISTUESE PËR PARKIM[27]

Qyteti i Rahovecit ka hapësira publike apo private, të cilat mund të shfrytëzohen për parkingje. Në zonën e qendrës së qytetit ka hapësira, mirëpo jo të mjaftueshme për krijimin e parkingjeve. Ekzistojnë edhe disa parkingje në pjesën e poshtme të qytetit afër tregut, të cilat janë duke u shfrytëzuar maksimalisht nga qytetarët. Në territorin e komunës janë 85 parkingje publike dhe private me gjithsej 2,048 vend parkingje.








2.8.6. SINJALIZIMI HORIZONTAL DHE VERTIKAL

Të gjitha shënimet e cekura më lart për nga aspekti i sigurisë janë të lidhura drejtpërsëdrejti me sinjalizimin adekuat.

Gjatësia e rrugëve të pajisura me sinjalizim horizontal dhe vertikal është 396.93km. Janë të pajisura me sinjalizim horizontal dhe vertikal rreth 87% e rrugëve, pasi që kemi edhe kompani të kontraktuara për mirëmbajtje si dhe në zgjerimin e sinjalizimit nëpër rrugët e reja të pa sinjalizuara.

Në zonën urbane kemi sinjalizim adekuat sidomos në pjesë të qytetit ku janë ndërtuar rrugët e reja, e po ashtu ka edhe në vende rurale.

[27] Plani i mobilitetit Urban për komunën e Rahovecit 2016-2020



Harta 16 Harta e transportit

2.9. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

2.9.1. QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Në komunën e Rahovecit funksionon Qendra për Punë Sociale (QPS), si institucion profesional i Komunës, e cila përbëhet nga personeli profesional me kualifikim përkatës si nëpunës të shërbimeve sociale. QPS-ja është përgjegjëse për ushtrimin e kompetencave ligjore për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Në kuadër të QPS-së vepron organi i kujdestarisë që kryen detyrat që kërkohen nga dispozitat ligjore të aplikueshme. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale kryen shërbime sociale dhe familjare brenda territorit të Komunës përmes aktiviteteve të Qendrës për Punë Sociale.

Viti i themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri i banorëve	Zyrtar të përgjithshëm	Zyrtar të specializuar	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Vend parkingje për vizitor	Vend parkingje për zyrtar
1979	Tërë Komuna	61	11	11	0.0342	0.00241	0.03179	2	5

Tabela 78 Veçoritë hapësinore të Qendrës për Pune Sociale në Rahovec

Në Komunë të Rahovecit aktualisht 244 pranojnë ndihmë sociale, ku numri më i madh i tyre janë delikuent të mitur.

Personat në nevojë- kategoritë #	Numri i personave
Fëmijë pa përkujdesje prindërore	1
Fëmijë me sjellje asociale	28
Delikuent të mitur	118
Persona me marrëdhënie të çrregulluara në familje	14
Persona të moshës së shtyrë	1
Institucionet shëndetësore të nivelit parësorë, kapacitetet hapësinore, 2021	0
Persona me aftësi të kufizuara mendore	30
Persona me sëmundje mendore	2
Persona me rrezik nga shfrytëzimi ose abuzimi	4
Viktima të dhunës në familje	46
Viktima të trafikimit me qenie njerëzore	0
Persona me varësi nga alkooli ose drogat	0
Kategori të tjera.	0

Tabela 79 Numri i personave që pranojnë ndihmë sociale

QPS-ja ka hartuar planin strategjik të zhvillimit të shërbimeve sociale në Komunën e Rahovecit 2016-2019. Në këtë plan janë përcaktuar objektivat kryesor: 1. Fëmijët me aftësi të kufizuar, 2. Personat me sëmundje mendore, 3. Personat të moshuar dhe pa përkujdesje familjare, 4. Avancimi i strehimit familjar dhe 5. Ngritja e resurseve dhe kushteve të punës për ofrimin e shërbimeve sociale në QPS.

2.9.2. SHËNDETËSIA

Sistemi shëndetësor në Kosovë pas përfundimit të luftës në vitin '99, u ballafaqua me vështirësi të shumta në çështje organizative, infrastrukturë si dhe në përkrahje financiare. OBSH-ja, Banka Botërore, Bashkimi Evropiane, zyra Japoneze, Ministria e Shëndetësisë dhe Komuna e Rahovecit, si dhe organizatat tjera ndërkombëtare me investimet e tyre luajtën rol të rëndësishëm në zhvillimin e sistemit shëndetësor.

Gjatë kësaj periudhe pothuajse të gjitha objektet shëndetësore të dëmtuara gjatë luftës janë rinovuar dhe shumë objekte të reja janë ndërtuar. U ofruan ndihma në pajisje dhe aparatura mjekësore moderne të

nevojshme dhe u organizuan trajnime në lëmi të ndryshme të mbrojtjes shëndetësore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve kualitative dhe të leverdishme të kujdesit shëndetësor primar.

Angazhimi i strukturave vendore, edhe pse me shumë vështirësi, si dhe përkrahja dhe bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare sot e ngrenë konceptin e mjekësisë familjare në Kosovë, të paktën në pasurimin e njohurive teorike, në nivel të njëjtë me të gjitha vendet e tjera të rajonit. Gjithashtu edhe në Strategjinë shëndetësore të Kosovës 2005-2015, mjekësia familjare është sektor mjaft me rëndësi në zbatimin e synimeve dhe prioriteteve shëndetësore kryesore nga Ministria e Shëndetësisë.

Në komunën e Rahovecit shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore.

Në sektorin publik, kujdesi primar shëndetësor është i organizuar në 16 objekte shëndetësore:

- QKMF - 1 Qendër Kryesore të Mjekësisë Familjare në qytetin e Rahovecit.
- QMF - 7 Qendra e Mjekësisë Familjare në: Ratkoc, Bellacërkë (Fortesë), Çifllak, Drenoc, Krushë e Madhe, lagjja e Arrave dhe Opterush.
- AMF - 7 Ambulanca të Mjekësisë Familjare në: Lagja e Epërme, Hoçë e Madhe, Zaqisht, Brestoc, Radostë, Polluzhë dhe Xërxë.
- Qendra për punë sociale.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) në Rahovec, si bartëse e kujdesit primar, është e vendosur në qytetin e Rahovecit dhe ka gjendje fizike të kënaqshme. Kjo qendër mbulon me shërbime territorin e Rahovecit dhe fshatrat përreth. Në këtë institucion janë të punësuar gjithsej 87 punonjës, 28 mjekë dhe 59 infermierë - teknikë.

Institucioni	Viti i themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri i banorëve	Mjek të përgjithshëm (nr.)	Mjek në specializim (nr.)	Mjek të specializuar (nr.)	Farmacist (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e gjelbër (ha)	Sipërfaqja (m^2)	Etazhiteti (P)	Vend parkingje për vizitor	Vend parkingje për zyrtar
QKMF e re	2020	Avdullah Bugari	15892	2		5	1	0.535	0.22		2200	P+1	21	2
QKMF e vjetër	1971	Avdullah Bugari		3					0.33		3358	P+3		
QMF te arra	2015	Rahovec						0.031	0.012	0.019	120	P	3	1
AMF - lagja epërme	2001	Rahovec						0.25	0.067	0.183	155	P		
QMF - Ratkoc	1975	Ratkoc	3791	2					0.02		670	P	4	1
QMF - Çifllak	2000	Çifllak	1292	1				0.105	0.038	0.067	200	P	3	1
QMF- Drenoc	2001	Drenoc	1587	1				0.05	0.014	0.036	383	P	3	1
QMF – Opterush	1990	Opterush	1911	1				0.22	0.03	0.19	140	P+1	4	1
QMF - Bellacërkë	2006	Bellacërkë	2270	1				0.2	0.06	0.14	305	P	3	1
QMF - Krushë e Madhe	1980	Krushë e Madhe	4473	2				0.08	0.017	0.063	609	P		
AMF - Brestoc	2012	Brestoc	1288					0.085	0.016	0.069	175	P	5	1
AMF – Radostë	2014	Radostë	2346	2				0.111	0.014	0.097	160	P	4	1
AMF – Polluzhë	2006	Polluzhë	808					0.023	0.015	0.008	190	P	3	1
AMF – Zaqishtë	2006	Zaqishtë	659					0.105	0.24		158	P	3	1
AMF – Xërxë	2011	Xërxë	3184	1				0.17	0.018	0.152	240	P	3	1
AMF - Hoçë e Madhe	1989	Hoçë e Madhe	124								180	P	3	1

Tabela 80 Veçoritë e institucioneve shëndetësore të nivelit parësor, regjistri sipas vendbanimeve

Sipas formulës së OBSH 1 = 2000-2500 banorë, QKMF Rahovec ka nevojë edhe për: 15 mjekë familjar, 18 infermier, 4 stomatolog dhe 5 asistent stomatologjie.

QKMF disponon me pajisjet dhe aparaturë medicinale kryesisht funksionale e blerë nga komuna. Rëndësia e pajisjeve në diagnozë dhe në kapacitetin e trajtimit të pacientëve është e madhe, por, edhe mjaftë e kushtueshme. QKMF edhe përkundër kostos ka nevojë për investime dhe atë kryesisht në sektorin e diagnostikës. Dhomat e intervenimeve në MF dhe kujdestari kanë: Defibrilator, Ekg, Aspirator, O2 aparate, Inhalator Set për intervenime reanimuese, 4 QMF dhe 1 AMF kanë Ekg. Ordinancat e mjekëve janë të pajisura me aparate bazike, këtu duhet cekur ndihmën e radhës në vitin 2018 nga AQH për 8 ordinanca me të gjitha aparatet e paraparë për mjekun familjar, dhe 1 Ekg 12 kanalesh mjaftë të sofistikuar.


Në komunën e Rahovecit ekziston një Qendër e Mjekësisë Familjare e stacionuar në qytet (përkujdeset për rreth 20 141 banorë bashkë me QMF dhe AMF që janë në qytet ku janë të punësuar 123 punëtorë. Nr. i telefonit pa pagese është 0800 11 008) në përbërjen e së cilës funksionojnë 7 QMF dhe 7 AMF:

- *QMF Ratkoc* punon me dy ndërrime. Përkujdeset për shëndetin e rreth *6,347* banorëve (orari i punës 07:00-21:00).
- *QMF Krushë e Madhe* punon me dy ndërrime. Përkujdeset për shëndetin e rreth *8,285* banorëve (orari i punës 07:00-21:00).
- *QMF Bellacërkë* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth *4,343* banorëve (orari i punës 07:00-14:00).
- *QMF Drenoc* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth *4,737* banorëve (orari i punës 07:00-14:00).
- *QMF Çifllak* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth banorëve *3,345* (orari i punës 07:00-14:00).
- *QMF Opterush* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth *2,916* banorëve (orari i punës 07:00-14:00).
- *AMF Xërxë* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth *3,184* banorëve (orari i punës 07:00-14:00).
- *AMF Hoçë e Madhe* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth *124* banorëve (orari i punës 07:00-14:00).
- *AMF Zaqishtë* nuk punon për shkak të zonimit, pacientët e Zoqishtit vizitat mjekësore i kryejnë në Opterush.
- *AMF Polluzhë* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth *3,184* banorëve (orari i punës 07:00-14:00).
- *AMF Brestoc* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth *1,288* banorëve (orari i punës 07:00-14:00).
- *AMF Radostë* punon me një ndërrim. Përkujdeset për shëndetin e rreth *2,346* banorëve (orari i punës 07:00-14:00).

KUADRI	LLOJI	NR
SPECIALIST	SPEC I MJEKËSISË FAMILJARE	4
	PEDIATËR	2
	UROLOG	1
	GJINEKOLOG	1
	MJEK PA SPECIALIZIM	12
	PEDODONT	1

	STOMATOLOG	6
MJEK NE SPECIALIZIM	MJEK FAMILJAR	4
	PEDIATËR	1
	GJINEKOLOG	1
	EMERGJENCË	1
	BIOKIMI	1
	RADIOLOGJI	1
	FARMACIST	1
KUADRI I LARTË MEDICINAL	INFERMIER TË PËRGJITHSHËM	2
	TEKNIK I RADIOLOGJISË	1
	TEKNIK LABORANTE	2
KUADRI I MESEM MEDICINAL	INFERMIER TË PËRGJITHSHËM	41
	TEKNIK FARMACIE	4
	TEKNIK RADIOLOGJIE	1
	TEKNIK LABORANTE	3
	ASISTENT STOMATOLOGJIE	1
	MOTËR GJINEKOLOGJIKE	13
	MOTËR PEDIATRIKE	2
STAFI JOMEDICINAL	STAF ADMIN FAKULTET	2
	STAF ADMIN SH MESME	2
	SHOFERA	10
	SHTËPIAK	1
	RROBALARËSE	1

Tabela 81 Numri i të punësuarve në institucione shëndetësore të nivelit parësor



Harta 17 Harta e institucioneve shëndetësore

2.9.3. ARSIMI

Arsimi dhe edukimi janë themel i një shoqërie të shëndoshë, të cilat garantojnë të ardhme të sigurt shoqërore, ekonomike, kulturore dhe politike në vend. Vitet e '90-ta, ishin të rënda për arsim në gjuhën shqipe në Kosovë për arsye të largimit të dhunshëm nga objektet shkollore. Siç dihet, gjatë periudhës 90 - 99, në Kosovë u organizua sistemi paralel i arsimit, funksionimi i të cilit, edhe pse në rrethana robërie, ruajti sistemin e arsimit nga asimilimi i gjithmbarshëm. Lufta e fundit në Kosovë la pasoja të mëdha në infrastrukturën shkollore. Pas vitit 1999, institucionet kosovare bënë përpjekje në realizimin e programeve mësimore bashkëkohore. Në vitin 2002, këto institucione krijuan një model të ri për sistemin arsimor në vend, modelin bashkëkohor.

Struktura e re ofron edukimin parashkollor, 5 vite të arsimit fillor, pasuar nga 4 vite të shkollimit të mesëm të ulët dhe 3 apo 4 vite të shkollimit të mesëm të lartë.

Modeli 5+4+3 po zëvendëson strukturën e mëparshme 4+4+4. Me strukturën e re arsimi i obligueshëm është zgjatur për një vit nga 8 vite sa ishte në 9 vite.

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (çerdhja ku përfshihen grup moshat e fëmijëve 0-3 vjeç dhe 3 – 5 vjeç, klasat parashkollore, ku përfshihen fëmijët e moshës 5 - 6 vjeçar), arsimin fillor (klasat I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasat VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasat X – XII).

Numri i objekteve shkollore është gjithsej 42, duke përfshirë edhe çerdhet dhe shkollat e mesme të larta. Në procesin edukativo-arsimor në të gjitha nivelet e shkollimit janë të angazhuar rreth 837 punëtorë, prej të cilëve janë 726 mësimdhënës. Numri i nxënësve është gjithsej 10,833, që do të thotë se kemi një raport prej 15 nxënës /mësimdhënës (edukator/e).

2.9.3.1. ARSIMI PARASHKOLLOR

Çerdhe dhe kopshte – Qyteti i Rahovecit posedon 1 çerdhe publike dhe 1 çerdhe private. Ndërkohë pothuajse janë të gatshme për t`u vënë në funksion edhe 3 çerdhe të reja publike të financuara nga Komuna, 1 çerdhe në Krushë të Madhe, 1 çerdhe në Xërxë dhe 1 çerdhe në Ratkoc.

Emri i institucionit	Viti i themelimit	Lagja/ zona gravituese	Meshkuj	Femra	Edukatore (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Sipërfaqja e ndërtesës kryesore (m²)	Sipërfaqja e klasave (m²)	Sipërfaqja e gjelbëruar (ha)
Çerdhja "Tulipanët"	1984	Tërë komuna	84	70	6	0.3585	0.1735	0.185	1,735	650	0.10

Tabela 82 Veçoritë e institucionit të vetëm parashkollor në Rahovec

2.9.3.2. ARSIMI FILLOR DHE I MESËM I ULËT

Në tërë territorin e komunës, arsimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 37 objekte shkollore ku mësimet i ndjekin rreth 7,923 nxënës. Mesatarisht rreth 3 m² hapësirë e brendshme shkollore i takojnë një nxënësi në këtë nivel.

Me hapësira shkollore të pamjaftueshme ishin këto vendbanime: Drenoc, Hoça e Vogël, Krusha e Madhe, Pastaselë, Ratkoc, Vrajakë /Bratatin. Mirëpo, në vitet e fundit në këto vendbanime janë ndërtuar objekte të reja shkollore sipas standardeve bashkëkohore, të cilat kanë hapësira të mjaftueshme.

Pjesa dërmuese e vendbanimeve mësimin zhvillonin në dy ndërrime, ndërsa tani, shumica e shkollave mësimin e zhvillojnë në një ndërrim sepse janë ndërtuar objekte të reja shkollore, të cilat kanë hapësira të mjaftueshme për të zhvilluar procesin mësimor në një ndërrim. Sa i përket kualifikimit të mësimdhënësve, mund të thuhet se mesatarisht në të gjitha shkollat fillore të komunës, mbi 90% të personelit arsimor kanë

kualifikim adekuat në vendin e tyre të punës. Raporti nxënës/mësimdhënës në këto hapësira shkollore sillet rreth 14 nxënës mesatarja për 1 mësimdhënës me dallime të theksuara nga njëra shkollë në tjetrën.

Vendbanimet #	Emri i institucionit	Viti i themelimit	Lagja/ zona gravituese	Meshkuj	Femra	Mësimdhënës	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e gjelbëruar (ha)	Vend parkingje për vizitor	Vend parkingje për zyrtar
Rahovec	"Isa Boletini"	1935	Xhelal Hajda	582	522	58	0.56	0.48	0.08	0	0
Rahovec	"Bekim Sylka"		Sheh Myhedini	232	205	43	0.29	0.18	0.11	0	0
Rahovec	"Sadedin Hajda"	1990	Rahovec	114	111	15	0.85	0.73	0.12	0	0
Rahovec	"Gëzim Hamza-Piktori		Rahovec	213	196	28	0.20	0.08	0.12	0	0
Bellacërkë	"Liria"	1974	Bellacërkë	114	100	18	0.88	0.26	0.62	1	1
Sapniq	"Sapniqi"	1979	Sapniq	51	46	11	0.30	0.07	0.23	1	1
Pataqan i Poshtëm	"Dëshmorët e Lirisë"	2002	Pataqan i Poshtëm	56	67	14	1.08	0.08	1	0	0
Xërxë	"Hamëz Thaçi"	1946	Xërxë	210	189	26	1.30	0.12	1.18	1	1
Radostë (Malësi e Vogël)	"Skender Kastrati"	1980	Radostë (Malësi e Vogël)	124	124	43	2.35	0.30	2.05	1	1
Gexhe	"Skender Kastrati"		Gexhe	34	22		0.54	0.04	0.50	1	1
Ratkoc	"4 Dëshmorët"		Ratkoc	249	227	29	1	0.38	0.62	1	1
Vrajakë - Bratatin	"Tre Dëshmorët"	1956	Vrajakë-Bratatin	79	56	15	3.25	0.15	3.10	0	0
Dejnë	"Rudolf Walther"	2001	Dejnë	96	102	29	0.72	0.12	0.60	1	1
Dabidol	"Rudolf Walther"	2001	Dabidol	44	49		0.29	0.04	0.25	0	0
Çifllak	"Rilindja"	1970	Çifllak	73	93	13	2	0.11	1.89	1	1
Kramovik	"Mustafë Ibishi"	2002	Kramovik	89	91	11	1.94	0.24	1.70	1	1
Polluzhë	"Sylejman Vokshi"	1996	Polluzhë	48	39	11	1	0.09	0.91	1	1
Pastaselë	"Milaim Krasniqi"	1997	Pastaselë	75	76	16	1.93	0.13	1.80	1	1
Kaznik	"Milaim Krasniqi"	1997	Kaznik	3	3		0.13	0.03	0.10	0	0
Drenoc	"Vëllezërit Frashëri"	1984	Drenoc	136	124	19	1	0.09	0.91	1	1
Senoc	"Vëllëzërit Frashëri"	2006	Senoc			6	0.30	0.07	0.23	0	0
Zatriq	"Dëshmorët e Zatriqit"	2008	Zatriq	19	20	22	0.34	0.06	0.28	0	0
Krushë e Madhe	"Bajram Curri"	1926	Krushë e Madhe	260	233	40	1.19				
Celinë	"Faik Konica"	1995	Celinë	113	105	24	0.50	0.14	0.36	1	1
Hoçë e Vogël	"Heronjtë e Kosovës"	1973	Hoçë e Vogël	151	106	25	0.38	0.15	0.25	1	1
Zaqishtë	"Haki Stërmilli"	1937	Zaqishtë	29	20	23	0.81	0.12	0.69	1	1
Retijë	"Haki Stërmilli"	1980	Retijë	30	31		0.63	0.07	0.56	0	0
Reti e Poshtme	"Haki Stërmilli"	1985	Reti e Poshtme	8	9		0.30	0.05	0.25	0	0
Opterush	"Lidhja e Prizrenit"	1996	Opterush	99	80	19	0.78	0.18	0.60	1	1
Pataqan i Epërm	"Sakip Bellaqa"	2015	Pataqan i Epërm	53	51	12	0.98	0.06	0.92	0	0
Nagavc	"Nesimi Elshani"	2016	Nagavc	55	36	13	0.38	0.06	0.32	0	0
Petkoviq (Guri i Kuq)	"31 Marsi"	2016	Petkoviq (Guri i Kuq)	75	61	13	0.97	0.08	0.89	0	0

Tabela 83 Veçoritë e institucioneve arsimore fillore dhe të mesme të ulëta

Në 22 shkolla fillore të mesme të ulëta mësimi zhvillohet në dy ndërrime.

Emri i shkollës	Lokacioni	Gjithsej m²	Nr i klas.	Numri i ndërrimeve	Nr. i nxënësve
SHFMU "Faik Konica"	Celinë	1,042	33	2	199
SHFMU " Bajram Curri"	Krushë e Madhe	1,002	30	2	473
SHFMU "Dëshmorët e Lirisë"	Pataqan i Poshtëm	812	12	2	122
SHFMU "Dëshmorët e Zatriqit"	Zatriq	300	9	2	39
SHFMU "Gëzim Hamza-Piktori"	Rahovec	780	16	2	344
SHFMU "Haki Stërmilli"	Zaqishtë	404	12	2	41
SHFMU "Haki Stërmilli"	Retijë	244	7	2	69
SHFMU "Hamëz Thaçi"	Xërxë	1,344	28	2	363
SHFMU "Heronjtë e Kosovës"	Hoçë e Vogël	1,040	20	2	233
SHFMU "Isa Boletini"	Rahovec	2,798	31	2	971
SHFMU "Katër Dëshmorët"	Ratkoc	1,711	32	2	428
SHFMU "Milaim Krasniqi"	Pastaselë	804	14	2	137
SHFMU "Rudolf Walter"	Dejnë	1,277	19	2	193
SHFMU "Rudolf Walter"	Dabidol	176	4	2	79
SHFMU "Sadedin Hajda"	Rahovec	700	14	2	215
SHFMU "Skënder Kastrati"	Gexhe	413	8	2	60
SHFMU "Tre Dëshmnorët"	Vrajak	451	11	2	136
SHFMU "Vëllezërit Frashëri"	Drenoc	872	22	2	231
SHFMU "Vëllezërit Frashëri"	Pataqan i Epërm	79	3	2	85
SHFMU "31 Marsi"	Petkoviq (Guri i Kuq)	140	4	2	137
SHFMU "Bekim Sylka"	Rahovec	1,407	21	2	403
SHFMU "Nesimi Elshani"	Nagavc	704	11	2	80

Tabela 84 Shkolla fillore të mesme të ulëta në të cilat mësimi zhvillohet në dy ndërrime

Në 10 shkolla fillore të mesme të ulëta mësimi zhvillohet në një ndërrim.

Emri i shkollës	Lokacioni	Gjithsej m²	Nr i klas.	Numri i ndërrimeve	Nr. i nxënësve
SHFMU "Rilindja"	Çifllak	1,193	18	1	145
SHFMU "Haki Stërmilli"	Reti e Poshtme	115	4	1	11
SHFMU "Lidhja e Prizrenit"	Opterush	1,270	13	1	179
SHFMU "Liria"	Bellacërkë (Fortesë)	516	10	1	219
SHFMU "Mustafë Ibishi"	Kramovik	2,480	14	1	160
SHFMU "Mustafë Ibishi"	Mrasor	82	4	1	0
SHFMU "Sfetozar Markoviq"	Hoçë e Madhe	283	9	1	40
SHFMU "Skënder Kastrati"	Radostë (Malësi e Vogël)	576	12	1	230
SHFMU "Sulejman Vokshi"	Polluzhë	350	7	1	79
SHFMU "Vuk Karaxhiq"	Rahovec			1	40

Tabela 85 Shkolla fillore të mesme të ulëta në të cilat mësimi zhvillohet në një ndërrim

2.9.3.3. ARSIMI I MESËM I LARTË

Përfshin tre vite të shkollimit për nxënësit e moshave prej 15 deri 18 vjeç. Në komunën e Rahovecit janë 4 shkolla të mesme: 2 në Rahovec, 1 në Krushë të Madhe dhe 1 në Ratkoc. Në këto shkolla numri i nxënësve që i ndjekin mësimet është 2,331 nxënës, me një kuadër të mësimdhënësve prej 146 që janë të angazhuar në procesin edukativo - arsimor. Kualifikimet e personelit arsimor në këto katër shkolla të mesme sillet rreth 97% të kualifikuar dhe 3% të pakualifikuar përkatës.

Raporti nxënës/mësimdhënës në shkollat e mesme të larta është 16.3. Mësimi zhvillohet në dy ndërrime vetëm në një SHML në Rahovec, pra në SHML ”Xhelal Hajda-Toni” dhe në atë të Ratkocit, ndërsa në shkollën e mesme të lartë të Krushës së Madhe “Ukshin Hoti” dhe në SHMLP “Selajdin Mullaabazi-Mici” në Rahovec mësimi zhvillohet në një ndërrim.

Në Shkollën e Mesme të Lartë në Ratkoc problem serioz është mospërputhja e orareve të udhëtimit të autobusëve me orarin mësimor në të dyja ndërrimet. Kështu që, është shumë e nevojshme që të bëhet një marrëveshje ndërmjet kompanive të autobusëve dhe institucioneve komunale, DKA-së dhe institucioneve të tjera, që të përshtatet orari i udhëtimit për nxënësit që vijojnë procesin mësimor në këtë shkollë. Për shkak të kësaj, Shkolla e Mesme e Lartë “12 Maji” nuk ishte në gjendje të mbajë orar të plotë mësimor në të dy ndërrimet, ashtu siç është paraparë me nga 45 minuta orë mësimore dhe me nga 7 orë maksimale në ditë. Mirëpo, me rënien e numrit të nxënësve, tani kjo shkollë mban mësim me një ndërrim dhe me orar të plotë mësimor. Drejtoria Komunale e Arsimit vazhdimisht është interesuar të rregullojë çështjen e udhëtimit të nxënësve dhe ka bërë zgjidhje për bartjen e nxënësve që vijojnë mësimet nga fshatrat e largëta. Deri më tani ekzistojnë 7 linja bartëse të nxënësve, udhëtimin(bartjen) e të cilëve e financon Drejtoria Komunale e Arsimit.

Vendbanimet #	Emri i institucionit	Viti i themelimit	Lagja/ zona gravituese	Nxënës Meshkuj	Nxënëse Femra	Mësimdhënës	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e gjelbëruar (ha)	Vend parkingje për vizitor	Vend parkingje për zyrtar
Rahovec	"Xhelal Hajda-Toni	1961	Rahovec	264	322	39	0.56	0.31	0.25	0	0
Krushë e Madhe	"Ukshin Hoti"	2008	Krushë e Madhe	98	63	26	0.65	0.37	0.28	0	0
Ratkoc	"12 Maji"	2007	Ratkoc	142	111	42	2.00	0.37	1.63	0	1
Rahovec	"Selajdin Mullaabazi-Mici"	2013	Rahovec	218	151	45	0.76	0.60	0.16	0	0

Tabela 86 Veçoritë e institucioneve arsimore të mesme të larta

Në 1 shkollë të mesme të lartë mësimi zhvillohet në dy ndërrime.


Emri i shkollës	Lokacioni	Gjithsej m²	Nr i klas.	Numri i ndërrimeve	Nr. i nxënësve
SHML”"Xhelal Hajda-Toni"	Rahovec	4,960	25	2	573

Tabela 87 Shkolla e mesme e lartë në të cilën mësimi zhvillohet në dy ndërrime

Në 3 shkolla të mesme të lartë mësimi zhvillohet në një ndërrim.

Emri i shkollës	Lokacioni	Gjithsej m²	Nr i klas.	Numri i ndërrimeve	Nr. i nxënësve
SHML "Ukshin Hoti"	Krushë e Madhe	1,000	18	1	210
SHML ”12 Maj”	Ratkoc	2,700	19	1	280
SHMLP ”Selajdin Mullaabazi-Mici	Rahovec	6,776	18	1	344

Tabela 88 Shkollat e mesme të larta në të cilat mësimi zhvillohet në një ndërrim




Harta 18 Harta e institucioneve arsimore

2.9.4. ADMINISTRATA PUBLIKE

Objektet e shërbimeve administrative në komunë janë të shpërndara në disa objekte:

- K.K. Rahovec;
- Gjykata komunale;
- Posta;
- Stacioni policor;
- Zjarrfikësit;
- Zyra komunale për punësim;
- Zyra e vendit;
- Qendra për punë sociale; dhe
- Instituti i Verarisë.



Harta 19 Harta e institucioneve kulturore, shtetërore dhe hapësirave rekreative

Objekti i Administratës është kryesisht në shërbim të pajisjes së qytetarëve me dokumente të gjendjes civile. Shërbimet ofrohen edhe në mënyrë elektronike.

Shpërndarja hapësinore dhe qasja në objektet e administratës publike është e mirë. Gjendja fizike e objekteve është relativisht e kënaqshme. Në zonat rurale, shërbimet themelore administrative ofrohen në Zyrat e Vendit të vendosura në: Drenoc, Çifllak, Ratkoc, Xërxë, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Hoçë e Madhe, dhe Opterush.

2.9.5. KULTURA

Jeta kulturore dhe artistike në komunën e Rahovecit kryesisht zhvillohet në qytetin e Rahovecit, ku edhe ndodhet numri më i madh i objekteve të kulturës, por edhe në fshatra.

Janë të njohura ngjarjet kulturore si ai i vjeljes së rrushit "Hardh Fest" si dhe ai i ansamblit të valleve dhe këngëve burimore "Anadrinia Jehon".

Festa e vjeljes organizohet çdo vjeshtë afër shtëpisë së Verërave. Dita e parë i kushtohet hapjes së festivalit rreth mesditës nga fjalimi i zyrtarëve shtetëror si dhe kryetarit të komunës, përfaqësuesit të Ministrisë së Bujqësisë dhe përfaqësuesve të delegacioneve të miqve. Është karakteristike se tufa e parë e rrushit pritet simbolikisht duke zyrtarizuar kështu hapjen e të korrave. Festa, shfaqje dhe ekspozita të artistëve lokal organizohen pranë shtëpisë së verës dhe në qendrën e qytetit të Rahovecit gjatë gjithë fundjavës.

Tjetër eveniment mjaft i rëndësishëm i muzikës folklorike shqiptare është festivali "Anadrinia Jehon". Ai fillon në javën e dytë të muajit Maj, në kuadër të "Javës së dëshmorëve dhe heronjve të Komunës së Rahovecit" dhe organizohet në fshatin Dejnë. Ky festival ka për qëllim mbledhjen e adhuruesve të folklorit nga të gjitha trojet Shqiptare, për të ruajtur dhe kultivuar traditën Shqiptare.

Shtrirja hapësinore e objekteve të kulturës në kuadër të zonës urbane është e mirë, mirëpo ka nevojë për plotësim dhe përmirësim të infrastrukturës ekzistuese në përgjithësi. Objektet ekzistuese kulturore i plotësojnë vetëm pjesërisht kushtet për qasjen e personave me nevoja të veçanta.

Shtëpitë e kulturës – janë të organizuara në zonën urbane dhe në ato rurale, ku përpos në Rahovec janë edhe në fshatrat si: Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc dhe Drenoc.



Figura 20 Shtëpia e Kulturës "Mensur Zyberaj" - Rahovec



Figura 21 Festivali i specit - Krushë e Madhe





Figura 22 Shtëpia e Kulturës

Muzeu i qytetit - i përmbush nevojat e komunitetit për nevojën e një muzeu për tërë komunën e Rahovecit, ka lokacion qendror dhe është lehtë i qasshëm nga të gjithë banorët.



Shtëpia muze "Ukshin Hoti"- Është shtëpia e veprimtarit dhe patriotit shqiptar të kohës tonë Ukshin Hoti. Ky objekt vihet në mbrojtje dhe vendoset që të jetë shtëpi muze në ditëlindjen e 70-ë të tij, ndërsa në ambientet e saj janë ekspozuar fotografi dhe disa nga mjetet e punës së tij. Veprimtari Ukshin Hoti derisa ishte në Burgun e Dubravës, është zhdukur nga forcat serbe dhe nuk dihet asgjë për fatin e tij.



					Ndërtesa kryesore	Zyra	Salla ekspozuese	Salla audio-vizuele		

Vendbanimet #	Institucioni	Viti I themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri I zyrtareve (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lire (ha)	Sipërfaqja (m^2)	Etazhiteti (P)	Sipërfaqja (m^2)	Numri (nr.)	Sipërfaqja (m^2)	Numri (nr.)	Sipërfaqja (m^2)	Ulëse (nr.)	Vend parkingje për vizitor	Vend parkingje për zyrtar
Rahovec, Qyteti	Qendra Kulturore "Mensur Zyberaj"	1961	Rahovec	4	0.2	0.1	0.1	50	1	50	1					0	0
Rahovec, Qyteti	Biblioteka " Sulejman Krasniqi"	2010	Rahovec	2	0.2	0.02	0.1	150	2	16	2	150	1			2	2
Krushë e Madhe	Shtëpia e Kulturës " Muhamed Malsori"	1952	Krushë e Madhe	1	0.23	0.03	0.2									2	10
Hoçë e Madhe	Shtëpia e kulturës	1972	Hoçë e Madhe	1				100	1	20	2	100	1			4	4
Rahovec, Qyteti	Muzeu i qytetit	2010	Rahovec	1	0.1	0.03	0.07	80	1	16	2	80	1	0	0	1	4
Ratkoc	Shtëpia e Kulturës" Jajah Hoti"	2012	Ratkoc	0	0.83	0.03	0.8	200	1	70	3	200	1			5	10
Xërxë	Shtëpia e Kulturës	2017	Xërxë	0	0.23	0.03	0.2	170	1	90	5	170	1			5	15
Drenoc	Shtëpia e Kulturës "Feim dhe Bedrush Gashi"	2017	Drenoc	0	0.34	0.04	0.3	150	1	60	4	150	1			2	4
Rahovec, Qyteti	SHL KOSOVA	2001	Rahovec	0	0.43	0.03	0.4									0	0
Rahovec, Qyteti	Kulla e Sahatit Rahovec	1791	Rahovec	0	0.54	0.04	0.5										
Krushë e Madhe	Shtëpia Muze "UKSHIN HOTI"	2013	Krushë e Madhe	0				200	1	50	3	2	1				

Tabela 89 Veçoritë e institucioneve kulturore

2.9.6. OBJEKTET E RINISË, SPORTIT DHE REKREACIONIT

Në Rahovec janë aktive shumë klube sportive të futbollit, basketbollit, hendbollit, boksit, karatesë, etj. Aktivitetet sportive zhvillohen në kuadër të objekteve sportive që janë të shpërndara si në zonën urbane po ashtu edhe në atë rurale. Në Rahovec gjenden një numër i konsiderueshëm i objekteve si: stadiumi i qytetit , palestra e sportit "Mizahir Isma" e ndërtuar dhe hapur në vitin 2019, stadiumi i qytetit „ JAHJA DANUZA" – Rahovec si dhe Fusha e Futbollit - KF. Rahovecit.







Figura 23 Fusha e tenisit në Rahovec

Disa vendbanime të komunës së Rahovecit dhe lagjeve të qytetit nuk kanë fusha të hapura sportive, të cilat do të mund të shfrytëzohen nga komuniteti, sidomos atyre në pronësi publike.

Vendbanimet #	Institucioni	Viti i themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri i zyrtarëve (nr.)	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Sipërfaqja e ndërtuar (ha)	Sipërfaqja e lirë (ha)	Vendparkingje për vizitor	Vendparkingje për zyrtar
Rahovec	Stadiumi "Jajah Danuza"	1931		10	1	0.9	0.1	100	5
Rahovec	Fushë Sportive	2020	Lagja Epërme	0	0.5	0.48	0.02	12	3

Rahovec	Fusha Tenisit	2021	Te shkolla Mesme "Xhelal Hajda"	0	0.05	0.04	0.01	10	2
Drenoc	Fushë Sportive	2014	Drenoc		0.5	0.45	0.05		
Kramovik	Fushë Sportive	2021	Kramovik		0.2	0.15	0.05		
Dejnë	Fushë Sportive	2021	Dejnë	3	1	0.95	0.05		
Ratkoc	Fushë Sportive	2011	Ratkoc		1	0.95	0.05		
Radostë	Fushë Sportive	2012	Radostë		1	0.95	0.05		
Gexhe	Fushë Sportive	2022	Gexhe		0.2	0.15	0.05		
Xërxë	Fushë Sportive	2008	Xërxë	5	1	0.95	0.05		
Celinë	Fushë Sportive	2022	Celinë		1	0.92	0.08		
Krushë e Madhe	Fushë Sportive	2015	Krushë e Madhe	2	1	0.9	0.1		
Krushë e Madhe	Palestër Sportive	2017	Krushë e Madhe	2	1	0.9	0.1		
Hoçë e Vogël	Fushë Sportive	2012	Hoçë e Vogël		1	0.95	0.05		
Retijë	Fushë Sportive	2021	Retijë		1	0.95	0.05		
Opterush	Fushë Sportive	2015	Opterush		1	0.95	0.05		
Hoçë e Madhe	Fushë Sportive	2017	Hoçë e Madhe		1	0.95	0.05		
Rahovec	Palestër Sportive "Mizahir Isma"	2019	Rahovec		0.7	0.6	0.1	500	10

Tabela 90 Veçoritë e institucioneve dhe hapësirave sportive

2.9.7. HAPËSIRAT PUBLIKE DHE TË GJELBËRTA

Hapësirat publike dhe të gjelbërta urbane si elemente të rëndësishme janë qenësore për secilin qytet. Ato janë pjesë e rëndësishme e qytetit, e zgjerojnë diversitetin ekologjik dhe janë elemente strukturore dhe funksionale që i bëjnë qytetet më të jetueshme. Ato përdoren për rekreacion aktiv ose pasiv, ndërkohë që efektet e tyre të shumëfishta (shëndetësore, sociale, estetike, kulturore, etj.) e përmirësojnë cilësinë e jetës. Hapësirat publike dhe të gjelbërta në zonat urbane janë në një konkurrencë të vazhdueshme me ndërtimet duke rrezikuar të humbet nga kërkesat e ndërtimit. Në vitin 2020 komuna ka hapur tender ndërkombëtar për Sheshin Qendror të Qytetit të Rahovecit. Dhe në bazë të projektit fitues, arkitektët kanë paraparë që Sheshi Qendror i Qytetit të jetë një hapësirë e këmbësorëve dhe çiklistëve i ndërlidhur me parkun, ndërsa veturat me numër të limituar të kenë qasje vetëm në raste emergjente, për mirëmbajtje e logjistikë ose gjatë organizimit të ndonjë ngjarjeje të veçantë. Parashihet edhe ndërtimi i Qendrës së Komunitetit në lokacionin e tregut, që do ta ndajë sheshin e vogël "Hardhia" me Sheshin Qendror të Qytetit. Gjithashtu parashihet edhe një objekt garazhues që do ta zbusë nevojën e parkingut publik. Parashihen edhe hapësira të reja të gjelbërta dhe mbrojtja deri në maksimum e atyre hapësirave të që tashmë ekzistojnë.

Vendbanimet #	Hapësira	Viti i themelimit	Lagja/ zona gravituese	Numri i banorëve	Sipërfaqja e parcelës (ha)	Vendparkingjet (nr.) për vizitor	Vendparkingjet (nr.) për zyrtar	Siperfaqja e gjelbëruar (ha)
Rahovec	Parku i Qytetit	2000	Rahovec	20	10	20	1	7
Ratkoc	Parku në Qendër të fshatit	2005	Ratkoc	3500	5	7	2	3
Krushë e Madhe	Parku në Qendër të fshatit	2022	Krushë e Madhe	3000	2	5	1	3
Drenoc	Parku në Qendër të fshatit	2010	Drenoc	1500	4	2	1	2
Radostë (Malësi e Vogël)	Parku në Qendër të fshatit	2012	Radostë (Malësi e Vogël)	1500	3	4	2	4
Petkoviq (Guri Kuq)	Parku në Qendër të fshatit	2020	Petkoviq (Guri Kuq)	1000	4	10	1	1

Tabela 91 Veçoritë e hapësirave publike dhe të gjelbërta

VSM - Sugjeron disa veprime operacionale konkrete si dhe përfshirja e tyre në planifikim:

- Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbërta në Rahovec duke përfshirë edhe projektin për dislokimin e stadiumit dhe këtë hapësirë të dedikuar për park, të vazhdohet edhe më tej për gjetjen e lokacioneve të tilla duke e përmbushur së paku minimumet e hapësirave të gjelbërta për kokë Banori 9 m^2:
- Krijimi i parqeve në zonat e reja të banimit në distanca të arritshme për banorë 500-1000 m distancë.

2.9.8. OBJEKTET FETARE

Komuna e Rahovecit ka popullatë të tre besimeve: myslimane, katolike dhe ortodokse dhe secili nga këta i kanë objektet përkatëse për kryerjen e ritualeve fetare. Numri më i madh i objekteve fetare të komunitetit mysliman në komunë janë 24 xhami, dhe 3 teqe.

Ndërsa komuniteti katolik dhe ai ortodoks kanë gjithsej 10 kisha dhe 1 manastir. Shumica e kishave janë të vjetra dhe janë objekte të trashëgimisë nën mbrojtje. Ato gjenden në Hoçë të Madhe.

Nr.	Emërtimi i Xhamisë	Lokacioni	Gjendja Xhamisë	Viti i ndërtimit
1.	Xhamia e Sokolit	Rahovec	E mirë	1824
2.	Xhamia e Kasumit	Rahovec	E mirë	1826
3.	Xhamia e Qamil Kasapit	Rahovec	E mirë	Shek. XX-të
4.	Xhamia e Kadirit	Rahovec	E mirë	1750

Tabela 92 Xhamitë në qytet

Nr.	Fshati	Gjendja e xhamisë	Viti ndërtimit
1.	Hoçë e Vogël	E mirë	1650
2.	Pastaselë	E mirë	1840
3.	Krushë e Madhe	E mirë	Nuk ka
4.	Drenoc	E mirë	1810
5.	Celinë	E mirë	1912
6.	Xërxë	E mirë	Shek. XVII
7.	Bellacërkë (Fortesë)	E mirë	Shek. XIX
8.	Zatriq	E mirë	1764
9.	Retijë	E mirë	1945
10.	Bellacërkë	E mirë	1810

Tabela 93 Xhamitë në fshatra

Nr.	Emri i Teqesë	Lokacioni	Gjendja e Teqes
1.	Teqja e Madhe - Halveti	Rahovec	E mirë
2.	Teqja e Madhe – Rifai	Rahovec	E mirë
3.	Taqja e tarikatit - Melami	Rahovec	E mirë
4.	Teqja e Shejh Halitit	Hoçë e Vogël	E mirë

Tabela 94 Teqet


Nr.	Emri i Tyrbes	Lokacioni	Gjendja e Tyrbes
1.	Tyrbja e Sheh Sylejmanit	Rahovec	E mirë
2.	Tyrbja e Sheh Iljazit	Rahovec	E mirë
3.	Tyrbja e Sheh Ibrahit	Hoçë e Vogël	E mirë
4.	Tyrbja e Sheh Halitit	Hoçë e Vogël	E mirë
5.	Tyrbja e Dervish Latifit	Radostë (Malësi e Vogël)	E hapur
6.	Tyrbja e Sheh Fetahut	Dejnë	E mirë
7.	Tyrbja e Dervish Shabanit	Dejnë	E mirë
8.	Tyrbja e Dervish Ibrahimit	Dejnë	E mirë
9.	Tyrbja e Shyt Alisë	Kramovik	E mirë

10.	Tyrbja e Ushtarit të Panjohur	Petkoviq (Guri Kuq)	E mirë
11.	Tyrbja e Haxhi Zymerve	Petkoviq (Guri Kuq)	E mirë
12.	Tyrbja e Muharem Dervishit	Polluzhë	E mirë
13.	Tyrbja e Dervish Hysenit	Celinë	E mirë
14.	Tyrbja e Dervish Ahmatit dhe Avdisë	Pataqan i Poshtëm	E mirë
15.	**Tyrbja e Vogël**	**Pataqan i Poshtëm**	E mirë

Tabela 95 Tyrbet

Nr.	Emri i Kishës	Lokacioni	Gjendja e kishës
1.	"Kisha e Shën Kollit "	Hoçë e Madhe	E mirë
2.	"Kisha e Shën Llukes"	Hoçë e Madhe	E mirë
3.	"Kisha Shën Ilija"	Hoçë e Madhe	E mirë
4.	"Kisha e Shën Stafanit''	Hoçë e Madhe	E mirë
5.	**"Kisha e Anës"**	**Hoçë e Madhe**	E mirë


Tabela 96 Kishat Ortodokse Serbe



Harta 20 Harta e institucioneve fetare


2.9.9. VARREZAT

Numri total i varrezave në komunë është 38, me sipërfaqe totale me rreth 70.58 ha. Ato ndahen sipas komuniteteve fetare në myslimane me sipërfaqe totale rreth 69.63 Ha, ndërsa vetëm 0.95 Ha i përkasin komuniteti katolik dhe atij ortodoks. Vlen të theksohet se në qytetin e Rahovecit është duke u zvogëluar sipërfaqja e varrezave dhe paraqitet nevoja për krijimin e sipërfaqeve të reja për varreza.



Harta 21 Harta e sipërfaqes së varrezave

HARTA E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE DHE SOCIALE



Harta 22 Harta e infrastrukturës publike dhe sociale

2.10. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Në përgjithësi, gjendja e natyrës dhe e mjedisit në zonën rurale të Kosovës, por edhe e Rahovec, vlerësohet më e mirë sesa ajo urbane. Edhe në këtë zonë sistemi i menaxhimit të mjedisit si uji, ajri, toka, mbeturinat dhe përgjithësisht kujdesi për natyrën, ka nevojë të përmirësohet duke përcjell për nevojat evropiane.

Gjendja e përgjithshme mjedisore e qytetit të Rahovecit nuk mund të cilësohet ndryshe, veçse një gjendje jo e kënaqshme si në gjithë Republikën e Kosovës, qoftë në pjesët urbane, rurale apo përreth zonave industriale. Qasja akoma e ultë në kanalizime, furnizimi me ujë të pijshëm sanitar, ujërat urbane, industriale pa trajtim adekuat, menaxhim i kufizuar i mbeturinave, ndotja e ajrit, zhurma e lartë, emetimeve të antenave të telefonisë mobile, kujdesi jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa e vendeve për pushim e rekreacion, janë indikator kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësim të mjedisit në Qytetin e Rahovecit.

Gjendja e mjedisit në komunën e Rahovecit nuk është edhe aq e mirë. Degradimi i tij është rezultat i ndërtimeve të pakontrolluara në zonat e mbrojtura të natyrës ashtu edhe jashtë tyre, infrastrukturës jo adekuate, shtimit të numrit të automjeteve dhe importimit të mjeteve motorike të vjetërsuara në Kosovë, importi i vajrave dhe derivateve të kualitetit të dobët (me sasi të lartë të sulfurit), deponimi joadekuat i tyre, ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza, prerjes së pakontrolluar të pyjeve, akumulimit të plehrave urbane si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesës së riciklimit dhe trajtimit të ujërave të zeza.

Sektori i bujqësisë ndikon mjaft shumë në degradimin e mjedisit. Bujqësia si degë e ekonomisë, është bartëse e zhvillimit ekonomik në komunën e Rahovecit dhe si e tillë duhet t`i kushtohet vëmendje e posaçme si nga udhëheqësit komunale ashtu edhe ato shtetërore.

Kushtet pedo-klimatike janë të përshtatshme dhe mundësitë e mëdha të ujitjes, bëjnë të mundur që në Rahovec të kultivohen me sukses të gjitha kulturat bujqësore si: drithërat, pemët, vreshtat, perimet e po ashtu ka kushte edhe për zhvillimin e blegtorisë dhe shpeztarisë. Përderisa edhe industria ushqimore përpunuese është duke u zhvilluar në aspektin e modernizimit dhe ngritjes së kapaciteteve, por Rahoveci si komunë njihet kryesisht si prodhuese e madhe e rrushit dhe perimeve.

Pjesa më e madhe e banorëve në komunën tonë merren me kultivimin, grumbullimin dhe përpunimin e perimeve si dhe kultivimin e kulturave lavërtarë dhe vreshtarisë.

Prioritetet që duhet t`i jepen bujqësisë janë:

- Transformimi i fermave të vogla familjare në ato të mëdha komerciale,
- Shfrytëzimi i praktikave më të mira bujqësore dhe aplikimi i tyre, (mbrojtje e integruar e bimëve, farëra cilësore me potencial të lartë prodhues, etj.).
- Ofrimi i mbështetjes institucionale,
- Ofrimi i shërbimeve këshillimore dhe përkrahjes teknike

Sipas shënimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës komuna e Rahovecit ka 13.600 hektarë tokë bujqësore. Sipërfaqet e tokës bujqësore të cilat shtrihen përgjatë shtratit të lumit Drini i Bardhë në lartësi mbidetare prej 310 – 350 m, janë toka aluviale me pjellori të lartë në të cilat kultivohen kulturat bujqësore intensive, siç janë kulturat perimore (speci, domatja, patatja, trangulli, shalqiri, karota e tjera) por edhe kulturat lavërtarë ku dominojnë gruri dhe misri. Në zonat kodrinore në lartësi mbidetare prej 350 – 600 m dominon toka e tipit Smonicë ku kryesisht kultivohen kulturat lavërtarë pranverore dhe vjeshtore, kulturat shumëvjeçare (vreshtat dhe pemishtet) , ku bëjnë pjesë edhe kullosat.

Ndërtimi e objekteve të banimit, atyre hoteliere, pompat e benzinës si dhe objektet tjera industriale kanë ndikuar shumë në zvogëlimin e sipërfaqeve të tokave bujqësore. Një dukuri tjetër që ndikon në degradimin

e tokave bujqësore është edhe eksploatimi i zhavorrit në tokat bujqësore, kryesisht përgjatë lumit Drini i Bardhë. Nëse vazhdon ky trend i ndërrimit të destinimi të përdorimit të tokave, kjo do të shkaktojë edhe zvogëlimin e prodhimtarisë bujqësore.

Struktura e të mbjell urave kryesore në Rahovec:

- Grurë - 2,400 ha
- Misër – 2,100 ha
- Perime - 3,000 ha
- Vreshta – 2,168 ha

Në 11 zona kadastrale të komunës shtrihet edhe sistemi i ujitjes, me të cilin menaxhon Kompania Regjionale e Ujitjes KRU ,,GJAKOVA", me seli në Gjakovë nga i cili sistem në Rahovec ujiten 2.658,63 ha tokë të punueshme bujqësore, ku kryesisht ujiten perimet (speci, domatja, lakra, shalqinj, pjepri, qepa, etj.) misri dhe kulturat foraxhere (jonxha, misri për silazh apo livadhet).

Infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje nga rreziqet hidrometeorologjike në vitet e fundit në territorin e komunës tonë nuk funksionojnë. Para luftës, ky sistem ka funksionuar për mbrojte nga breshëri sidomos në dy pika, ku efekti i mbrojtjes ka qenë evident. Kjo mbrojtje ka qenë kryesisht për mbrojtje nga breshëri. Mirëpo, infrastruktura e ndërtuar për mbrojtje nga vërshime nuk ka. E që për të ardhmen duhet menduar.

2.10.1. NDOTJA E AJRIT

Ajri i pastër është me rëndësi vitale për shëndetin e njeriut dhe të mjedisit. Mirëpo zhvillimi i hovshëm dhe i pakontrolluar ekonomik, sidomos zhvillimi industrial dhe trafiku ndikojnë në përkeqësimin e cilësisë së ajrit dhe mjedisit si rezultat i shkarkimeve të ndryshme në ajër, ujë dhe tokë.

Qytetin e Rahovecit e karakterizon një trafik i dendur, me numër të madh automjetesh, që brenda ditës qarkullojnë nëpër qytet. Mungesa e vendeve të mjaftueshme për parkim, automjete të vjetra dhe dendësia e qarkullimit, drejtpërdrejtë ndikojnë në ndotjen e ajrit dhe kanë ndikim në shëndetin e popullatës.

Ndotja e ajrit nga shfrytëzimi i mineraleve/gurthyesve në zonat periferike të qytetit dhe vendet rurale janë një burim tjetër i madh i ndotjes së ajrit në zonat përreth tyre por edhe më gjerë.

Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe ngrohja e shtëpive apo banesave kolektive gjatë sezonit të dimrit e sidomos përdorimi i thëngjillit apo lëndëve tjera djegëse, cilësia e të cilave nuk është e kontrolluar. Përdorimi i gazit natyral në amvisëri është ende i kufizuar. Trendi i ndërhyrjeve për përmirësimin e izolimeve të objekteve ekzistuese apo objekteve të reja të banimit pritet të japin efektet pozitive në zvogëlimin e përdorimit të energjisë për ngrohje.

Aplikimi i burimeve alternative të energjisë, si panelet diellore, apo përdorimi i burimeve tjera energjetike ka një ndikim mjaft të mirë në përmirësimin e cilësisë së ajrit por ky trend po shënon rritje shumë të ngadaltë.

Institucioni i mandatuar për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës (IHMK).

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Nr.03/L-025, Ligjit i mbrojtjes së ajrit nga ndotja, Nr.03/L-160 dhe Ligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike, Nr.02/L-79, IHMK është i obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës.

Por në territorin e komunës së Rahovecit nuk ka pika monitoruese të cilësisë së ajrit, andaj në një të ardhme të afërt do duhej të vendosen instrumente monitoruese në disa pika. Mungesa e të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit si pasqyrim i plotë i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit pamundëson edhe marrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parandalimin e ndotjes.

Cilësia e rrugëve dhe problemet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe pamjaftueshmërinë e tyre si dhe mungesa e vend-parkimeve kontribuojnë gjithashtu në rritjen e sasisë së pluhurit dhe të ndotësve tjerë

në ajër nga automjetet. Në zonat rurale ndikim negativ në cilësinë e ajrit krahas rrugëve të pa asfaltuara kanë edhe guroret dhe minierat të cilat në territorin e Rahovecit janë në numër. Një burim specifik i ndotjes së ajrit në përgjithësi në Kosovë por edhe në Rahovec është djegia e mbeturinave, gomave dhe hamulloreve në ara të korrura.

Burimet kryesore të ndotjes

- Niveli i lartë i përqendrimit të emetimeve të pluhurit, pluhurit fluturues, thërrmijave të pluhurit, bloza, SO2 dhe Nox, si rezultat i trafikut të dendur, cilësia jo e mirë e karburanteve dhe ngrohjes sezonale ndikojnë drejtpërsëdrejti në ndotjen e ajrit në qytet por edhe në gjithë hapësirën e komunës së Rahovecit;
- Lirimi i gazrave serë (CO2, SO2, Nox) nga djegia e mbeturinave nëpër kontejner apo jashtë tyre, djegia e gomave dhe hamulloreve pas korrjeve, dhe aktivitete të operatorëve ekonomikë brenda dhe jashtë qytetit.
- Cilësia e rrugëve dhe problemet që lidhen me shfrytëzimin, mirëmbajtjen e pamjaftueshme të tyre dhe të parkingjeve që kontribuojnë në rritjen e sasisë së pluhurit dhe të shkarkimeve në ajër nga automjetet nga djegia e karburanteve.

Ndotja e ajrit nga shfrytëzimi i mineraleve/gurthyesve në zonat periferike të qytetit dhe vendet rurale, janë një burim tjetër i madh i ndotjes së ajrit në zonat përreth tyre por edhe me gjerë.

Një burim tjetër i ndotjes së ajrit është edhe ngrohja e shtëpive apo banesave kolektive gjatë sezonit të dimrit e sidomos përdorimi i thëngjillit apo lëndëve tjera djegëse, cilësia e të cilave nuk është e kontrolluar. Përdorimi i gazit natyral në amvisëri është ende i kufizuar. Trendi i ndërhyrjeve për përmirësimin e izolimeve të objekteve ekzistuese apo objekteve të reja, japin efekt pozitiv në zvogëlimin e përdorimit të energjisë për ngrohje që rrezikon cilësinë e ajrit.

2.10.2. NDOTJA E UJIT

Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe joadekuat të menaxhimit të tyre. Behet shkarkimi i ujërave të zeza pa trajtim paraprak, me një ndikim negativ në cilësinë e ujit si dhe në jetën bimore dhe shtazore. Pasojat e kësaj ndotje mund të shkojnë edhe më tej duke shkaktuar ndikime negative në tokë dhe në ajër.

Rrjedhja e ujërave më të ndotura që përshkojnë territorin e qytetit të Rahovecit dhe vendbanimeve përreth janë Rimniku, Duhllo, Sapniq, Bellaja si rrjedhojë e hedhjes së mbeturinave dhe shkarkimit të ujërave të zeza. Shfrytëzimi i zhavorrit kryesisht nga shtrati i lumit Drini i Bardhë është veprim shumë negativ, i cili krahas dëmtimit të peizazhit, dëmton edhe biodiversitetin e lumit dhe përreth tij. Shfrytëzimi i zhavorrit nga shtretërit e lumenjve apo ngushtimit të shtratit të tyre me ndërtime buzë bregut apo hedhjes së mbetjeve ndërtimore, çrregullon rrjedhën e tyre dhe për pasojë kemi edhe vërshime të vendbanimeve dhe tokave bujqësore përgjatë këtyre rrjedhave pothuaj çdo vit në pranverë apo vjeshtë kur rritet intensiteti i reshjeve të shiut apo shkrirja e hovshme e borës.

Ndotjet industriale nga operatorë si Veraria dhe Termoventi si dhe operatorë tjerë më të vegjël, gjithashtu kontribuojnë në ndotjen e burimeve ujore.

Mungesa e infrastrukturës për trajtimin ujërave sanitare apo industriale të shkarkuara në trupa ujore edhe në të ardhmen do të jetë burim i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë si burime që përdorin për nevoja të qytetarëve. Një burim tjetër i ndotjes është edhe hedhja e mbeturinave urbane apo atyre ndërtimore në shtretër të lumenjve apo afër rrjedhave të tyre.

Lumenjtë dhe rrjedhat tjera ujore në Rahovec janë pjesë e pellgut ujorë të lumit Drini i Bardhë. Komuna e Rahovecit është e pasur me burime natyrore dhe ka rrjet hidrografik relativisht të dendur. Kjo paraqet pasurinë natyrore të komunës dhe një ndër kushtet për ekzistencën e botës bimore dhe aktiviteteve

njerëzore. Rrjetin hidrografik të komunës së Rahovecit e përbëjnë disa lumenj dhe ujë rrjedha/ përrenjtë, qindra burime natyrore dhe ujërat nëntokësor.

Lumi më i madh që kalon në territorin e komunës së Rahovecit është Drini i Bardhë. Edhe pse nuk buron në komunën e Rahovecit, ai është ujëmbledhës të gjitha rrjedhave dhe lumenjve të komunës. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedh me një gjatësi prej 30 km dhe pjesën më të madhe është edhe si kufi administrativ i komunave: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës.

Lumenjtë-përroskat që derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Drinas, Rimnik, Polluzhë, Hoçë, etj.

Lumi Drini i Bardhë në Anadrini ka prerë masivin gëlqeror Gradishin ashtu që ka formuar Grykën (Kanionin) eupegjenik atraktiv në gjatësi prej 450 m. Në kanion është ndërtuar Ura e Fshejtë e cila është e gjatë 70 m dhe thellësia prej harkut deri te shtrati i ujit është 30 m.



Foto 11 Kanioni i Drinit dhe Ura e Fshejtë

Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë të Madhe në lartësi mbidetare 420 m dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, por para fshatit Brestoc bashkohet me përroskën e Babindollit dhe disa burimet të tjera dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë dhe është e gjatë 3 km prej fshatit Bellacërkë (Fortesë) deri te fshati Rogovë.

Lumi Duhllo buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhllo, Vrella dhe Sopoti) dhe në kilometrin e 4 bashkohet me lumin e Rimnikut. Në harta topografike ky lum është i shënuar me emrin Gjegoja, që do të thotë për popullin e kësaj ane është i pa njohur.

Lumi Rimnik buron në rrëzë malet Gërgavicë dhe në rrjedhjen e tij i merr disa burime të tjera. Ky lum ka rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimnik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me lumin Duhllo dhe në fshatin Bellacërkë (Fortesë) bashkohet me lumin e Sopniqit dhe formojnë lumin Bellaja.


Lumi Sopniq burimin e ka në rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nashpall, Sopniq. Ky lum gjatë stinës së verës ka pak ujë dhe shtrati i tij është kryesisht i thatë dhe mund të quhet si Lumi i Thatë. Vlen të përmenden edhe disa lumenj -përroska siç janë: i Drinasit, Kramovikut, Polluzhës e tjera.

Në tabelën vijuese pasqyrohet rrjeti hidrografik i disa burimeve ujore me karakteristika fizike të tyre. [Burimi PZHK].

Emërtimi	Lartësia mbidetare	Lit./sek.	Temp.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8	13
Burimi i Zatriqit	920	5	13

Burimi i Opterushës	400	40	13
Burimi i Zaqishtit	415	15	13
Burimi i Hoçë e Madhe	420	10	14
Burimi i Sopotit	380	6	13

Tabela 97 Rrjeti hidrografik i ujërave sipërfaqësorë në komunën e Rahovecit



Harta 23 Harta hidrografike e komunës së Rahovecit




Figura 24 Ngushtimi i shtratit në Bellacërkë (Fortesë)



Figura 25 Shkarkimi i ujërave të zeza dhe mbeturinave

2.10.3. NDOTJA E TOKËS

Si çdo resurs tjetër natyror edhe toka duhet trajtuar seriozisht dhe në mënyrë të integruar për një zhvillim të qëndrueshëm. Trajtimi i integruar, kërkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore në një mënyrë të përforcuar reciprokisht. Administrimi efikas i tokës, rritja e madhësisë së fermës përmes rregullimit të tokës, mbrojtja e tokës bujqësore nga degradimi i mëtejshëm, mbrojtja e mjedisit dhe arritja e zhvillimit të qëndrueshëm është një sfidë e madhe jo vetëm për Rahovecin. Tokat sikur në shumicën e komunave të Kosovës kryesisht në pjesët urbane dhe zonave përreth, shfrytëzohen kryesisht për aktivitete jo bujqësore, siç janë ndërtimet për qëllime banimi apo objekte afariste dhe industri, ndërsa në zonat rurale toka kryesisht shfrytëzohet për aktivitete bujqësore.

Gjatë viteve të fundit, është arritur një përparim i madh, megjithatë degradimi i tokës në zonat rurale dhe përreth zonave urbane si rrjedhojë e zgjerimit të pa kontrolluar urban, ndotja mjedisore dhe dëmtimet në burimet natyrore janë vetëm disa nga problemet që duhet trajtuar për një menaxhim të mirë të këtij resursi jetik në të ardhmen.

Megjithatë, duhet gjetur një ekuilibër midis nivelit të shfrytëzimit të tokës dhe mbrojtjes së mjedisit. Vonesat në përshtatjen e këtij trajtimi të integruar dhe vazhdimësia me veprimtari, të cilat e dëmtojnë së tepërmi mjedisin, rrezikojnë shëndetin publik dhe pakësojnë cilësinë e jetës, dhe dërgojnë në një rritje të madhe të kostos së përgjithshme të zhvillimit ekonomik.

Degradimi i tokës është një nocion kompleks i cili ngërthen në vete edhe shumë përbërës të tokës (toka, uji, bimësia, shkëmbinj, ajër, klimë, reliev), të cilët ndryshojnë në aspektin negativ. Nga aspekti bujqësor degradimi i tokës në përgjithësi nënkupton rënien e përkohshme ose të përhershme të kapacitetit prodhues të tokës dhe rënies së vlerës ekonomike si resurs. Nga aspekti i ndotjes degradimi nënkupton futjen e përbërësve negativ kimik të cilët shkaktojnë jo vetëm uljen e kapacitetit prodhues por edhe efektet negative në shëndetin e njeriut ndërsa nga aspekti i peizazhit degradimi i tokës nënkupton edhe pamjen e keqe të sipërfaqes së tokës dhe erozionin.

Llojet e degradimit të tokave janë:

- Erozioni i shkaktuar nga uji apo era;
- Ulja e pjellorisë si pasojë e zvogëlimit të materies organike, degradimit të vetive fizike, zvogëlimit të materieve ushqyese, ndotjeve (plehra, pesticide, me ujë të ndotur);
- Sedimentimi i shkaktuar nga vërshimet përmes bartjes së materieve të ndryshme nga uji;
- Ulja e nivelit të ujit nëntokësorë si pasojë e shfrytëzimit të madh të ujërave nëntokësorë;
- Zhveshja nga vegjetacioni i tokave si pasojë e prerjeve të pyjeve, ndërrimit të destinimit të tokës me çka shkaktohet erozioni;
- Ndërtimet në tokë bujqësore, në veçanti në tokë me komasacion.

Ndërsa, shkaktarët kryesor në degradimin e tokave janë: shfrytëzimi jo adekuat i tyre; ndërrimi i destinimi të përdorimit; përdorimi i pa kontrolluar i pesticideve dhe plehrave artificiale; ndotja e ujërave sipërfaqësorë; hedhja e mbeturinave jashtë deponive sanitare; shfrytëzimi i pa kontrolluar i resurseve natyrore (pyjet, ujërat, gurëve dhe zhavorrit, mineraleve, etj.).

Në rastin konkret në komunën e Rahovecit ndotja dhe degradimi i tokave është pasojë e ndotjes së lumenjve nga shkarkimet e ujërave të ndotura dhe të pa trajtuara që për pasojë ka ndotjen e ujërave nëntokësorë e me këtë edhe ndotjen e tokave përreth.

Gjithashtu deponitë ilegale janë një tjetër burim i ndotjes dhe degradimit të tokave në komunën e Rahovecit.

Një formë tjetër mjaft prezentë e degradimit të tokave është edhe urbanizimi i pa kontrolluar, i cili ka qenë i shprehur sidomos në periudhën e pas luftës në zonat përreth qytetit por edhe në disa lagje në brendi të qytetit. Për të ilustruar këtë dukuri mjafton të nënvizohet fakti se në komunën e Rahovecit por edhe në shumicën e qyteteve të Kosovës, sot kemi ndërtime pa leje duke shkaktuar një kaos urbanistik dhe probleme në furnizim me ujë të pijshëm, shërbime të kanalizimit, menaxhim të mbeturinave dhe zhdukjen e hapësirave të gjelbëruara dhe atyre publike.

Duke pasur parasysh faktin se substancat e rrezikshme janë të pranishme në komunitetet anekënd botës, kryesisht në zonat industriale dhe gjatë transportimit nëpërmjet autostradave, hekurudhave dhe kanaleve të ujërave. Aksidentet, duke përfshirë këtu zjarret, eksplodimet dhe rrjedhjet, që e shkaktojnë lirimin e këtyre substancave, mund t`i dëmtojnë shumë shëndetin e njeriut, pronën dhe mjedisin e tij.

Ekspozimi i njeriut ndaj substancave të rrezikshme mund të shkaktojnë lëndime, madje edhe vdekje, të një numri të madh njerëzish. Ky ekspozim mund të ndodh drejtpërsëdrejti, me anë të ekspozimit të syrit, me kontakt në lëkurë, me inhalim, gjatë kapërdije, ose si rezultat i ndotjes së ujit a të dheut, që mund të ndikojnë në prodhimin e ushqimit.

Popullata e rrezikuar në rast aksidenti (ose "publiku potencialisht i goditur") është kryesisht, ose në zonën industriale, ose shumë afër saj, pranë rrugëve të transportit, edhe pse popullata mund të goditet edhe me anë të ujit të ndotur ose të prodhimeve ushqimore. Rrallëherë ndodh që popullata e ekspozuar të jetë më larg nga vendi i fatkeqësisë.

Për qëllime të këtij kursi, të lidhur me parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj aksidenteve teknologjike, vëmendja përqendrohet tek aksidentet në pajisjet e instaluara të palëvizshme, që përmbajnë substanca të rrezikshme dhe që mund t`i godasin njerëzit, pasurinë ose mjedisin edhe pse shumë prej tyre ndodhin gjatë transportit. "Pajisjet e instaluara të palëvizshme", - në kuptim të gjerë, - përkufizohen si uzina ose vende që prodhojnë, përpunojnë, përdorin, trajtojnë, ruajnë ose hedhin substanca të rrezikshme. Kështu, pajisjet e instaluara të palëvizshme përfshijnë uzinat e prodhimit të substancave të rrezikshme dhe vendet e tjera industriale, në të cilat përdoren ose përpunohen substancat e rrezikshme; depot që përmbajnë këso substancash; vendet ku hidhen këto substanca, etj.

Degradimi i tokës është një nocion kompleks i cili ngërthen në vete edhe shumë përbërës të tokës (toka, uji, bimësia, shkëmbinj, ajër, klimë, reliev), të cilët ndryshojnë në aspektin negativ. Nga aspekti bujqësor degradimi i tokës në përgjithësi nënkupton rënien e përkohshme ose të përhershme të kapacitetit prodhues të tokës dhe rënies së vlerës ekonomike si resurs. Nga aspekti i ndotjes degradimi nënkupton futjen e përbërësve negativ kimik të cilët shkaktojnë jo vetëm uljen e kapacitetit prodhues por edhe efektet negative në shëndetin e njeriut ndërsa nga aspekti i peizazhit degradimi i tokës nënkupton edhe pamjen e keqe të sipërfaqes së tokës dhe erozionin. Shkaktarët kryesor në degradimin e tokave janë, shfrytëzimi jo adekuat i tyre, ndërrimi i destinimit të përdorimit, përdorimi i pa kontrolluar i pesticideve dhe plehrave artificiale, ndotja e ujërave sipërfaqësore, hedhja e mbeturinave jashtë deponive sanitare, shfrytëzimi i pa kontrolluar i resurseve natyrore (pyjet, ujerat, gurëve dhe zhavorrit, mineraleve, etj.). Në rastin konkret në komunën e Rahovecit ndotja dhe degradimi i tokave është pasoje e ndotjes së lumenjve nga shkarkimet e ujërave të ndotura dhe të pa trajtuara që për pasojë ka ndotjen e ujërave nëntokësorë e me këtë edhe ndotjen e tokave përreth. Gjithashtu deponitë ilegale janë një tjetër burim i ndotjes dhe degradimit të tokave.

2.10.3.1. BIODIVERZITETI

Llojllojshmëria apo biodiversiteti i monumenteve natyrale të karakterit botanik në komunën e Rahovecit dhe peizazhet janë mjaft të pasura si rrjedhojë e klimës mesdhetare nëpërmjet luginës së Drinit të Bardhë që janë të shpërndara gjithandej në territorin e komunës dhe si të tilla konsiderohen si vlera natyrore të trashëgimisë.

Pyjet dhe tokat pyjore si habitatet më të pasura shtrihen në veri-perëndim të komunës një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 10,800 ha, nga e cila 6,065 ha janë të mbuluara nga pyjet, ndërsa pjesa tjetër e zonës malore është e zhveshur. Degradimi i pyllit është një fenomen si në shumë pjesë të Kosovës, veçanërisht prerjet ilegale, ku rreth 2,200 hektarë të pyllit në regjistrin e komunës rezultojnë si të dëmtuar. Pyjet janë një habitat i mirë për rritjen dhe zhvillimin e llojeve të ndryshme të drunjëve dhe shkurreve si dhe kafshëve të egra andaj dëmtimi dhe degradimi i tyre ndikon drejtpërdrejt në dëmtimin e biodiversitetit.

Në pyjet kodrinore dominojnë shumë specie të përziera. Dallohen nga drurët gjetherënës si lisi i Turqisë, dhe me rreth 80% bung, ah dhe shkozë. Përhapje më të kufizuar kanë lloje të tjera si limoni (Tili kordata) dëllinja, hiri i zi, etj. Lloje të tjera të ulëta janë gjithashtu të pranishme, lloje të shkurreve, si : thana, murrizi, si dhe Corylus-it në zonat e fierit të lartë.

Rreth 15% e territorit total të komunës përbëjnë livadhet dhe kullotat apo përafërsisht 4,208 ha që gjithashtu janë një habitat i mirë i shumë specieve bimore dhe organizmave shtazor. Është një bazë e mirë për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore, veçanërisht në zonat malore si kullota. Këtu rriten bimët e njohura si çaji i malit, kantariumi, kamomili, luleshtrydhet, etj. Fauna është shumë e pasur me specie që nuk janë vetëm karakteristikë e kësaj hapësire. Në pyje jetojnë ujqit, dhelprat, lepuri, iriqi, gjarpri i ujit, etj. Llojet e peshqve janë të shumta, në Drinin e Bardhë jetojnë 18 lloje, ndërsa më të zakonshmet janë: mustaku, ngjala, krapi, trofta ylber, etj.

2.10.3.2. NDOTJA NGA ZHURMA

Sa i përket ndotjes nga akustike nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme.

Fakti që përmes territorit të komunës kalon rruga Magjistrale M-9.1 Gjakovë – Klinë, si dhe rrugët regjionale ,: Rruga R-107 , Prizren-Xërxë- Gjakovë – me një gjatësi prej 11 km, Rruga R-110, Malishevë – Rahovec-Xërxë me një gjatësi prej 16.3 km, Rruga R111 , Xërxë –Ratkoc-Kramovik me gjatësi prej 17 km, Rruga R117 , Rahovec-Opterush – deri në kufirin e KK të Suharekë me gjatësi prej 7.6 km, Rruga R204, Rahovec – Krushë e Madhe me gjatësi prej 12.4 km. Kjo do të thotë se komuna është e ndikuar nga zhurma.

Gjithashtu ndotësit tjerë janë veprimtaritë përpunuese/industriale siç janë fabrikat e betonit/çimentos pranë vendbanimit dhe gërmimet grumbulluese (gurthyesit) brenda territorit të komunës.

2.10.4. SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Në kohën kur po jetojmë, kemi një zhvillim të teknikës dhe teknologjisë bashkëkohore-industrisë, ndërmjet arritjeve të jashtëzakonshme të shkencës që mundësojnë jetë më të mirë, të sigurt dhe më të shëndoshë dhe vdekjes, e shkatërrimeve të shoqëruara me të ashtuquajturat "rreziqeve të natyrës dhe teknologjisë". Paradoksi, aq më tepër, është i ndërlikuar me faktin se as vetë teknologjia nuk është pa rreziqe dhe kjo solli raste të reja emergjente nga rreziqet e "shkaktuara nga njeriu", që dalin nga dështimi i sistemeve teknologjike. Pra, njerëzit tani janë në rrezik jo vetëm nga ngjarjet ekstreme gjeofizike, por edhe nga shpërthimet fizike, nga lirimi i materieve toksike. Sa më shumë duhet të inkurajohet vetëdijesimi lidhur me fatkeqësitë, për shkak se fatkeqësi të reja ndodhin vazhdimisht.

- Proceset teknologjike të shkaktuara nga njeriu me ndikim në ekonomi:
- Aksidentet e transportit
- Shpërthimet dhe zjarret në objekte industriale
- Lirimi aksidental i gazrave helmuese
- Avaritë në industri,
- Rrënimi i objekteve publike ose i strukturave tjera, etj.

Ekzistojnë dy përkufizime në lidhje me fatkeqësitë:

- Fatkeqësi të mëdha ose të papritura
- Ngjarjet e befasishme katastrofike që shkaktojnë dëme të mëdha materiale, humbje dhe shqetësime.

Por ka edhe shumë përkufizime të tjera për fatkeqësinë. Shumica e këtyre përkufizimeve përpiqen t`i pasqyrojnë karakteristikat, si vijon:

- Çrregullimet në veprimtari normale. Këto çrregullime, zakonisht janë të rënda, por që mund të jenë edhe të papritura, të befasishme dhe të përhapura kudo;
- Pasojat njerëzore, siç janë: humbjet e jetëve, vuajtjet nga lëndimet dhe pasojat e rënda në shëndet;
- Pasojat në strukturën ekonomike (industri) si: shkatërrimet ose dëmtimet në sistemin e ekonomisë, në ndërtesa, në komunikime, në prodhim e shërbime qenësore.

Fatkeqësitë, zakonisht, vlerësohen në bazë të përmasave të kriterit të viktimave dhe dëmeve materiale. Ajo që shkakton "dëmtime" kur nuk është definuar saktësisht. Është e pothuaj e pamundshme që çdo herë të bëhet vlerësim i saktë i dëmeve në ekonomi. Krahas dëmeve të drejtpërdrejta në pasuri, dëmet e tjera afatgjata (të tërthorta) shpesh herë i tejkalojnë të drejtpërdrejtat.

Nga llogaritja del që rreziku është në kufijtë e mesëm. Atëherë, shkalla e rrezikshmërisë është rrezik i mesëm dhe duhet një veprim i nevojshëm për intervenim.

Goditja

- Një numër i kufizuar i objekteve të goditura nga mundësia e shpërthimit të zjarrit dhe detonimit,
- Zhvendosje e lokalizuar e 7 familjeve nga 2 ditë deri në një (1) javë,
- Mbështetje personale e mjaftueshme nga niveli lokal,
- Çrregullim i qarkullimit rrugor në nacionalen Xërxë – Bellacërkë (Fortesë) – Rahovec,
- Funksionim normal i komunitetit.

Banorët	Familjet	Hendikep	Femra	Meshkuj	Nxënës	Pleq	Të mirat materiale	Infrastruktura kritike	Dëmet ekonomike Kostoja (€)
3,881	25	2	636	662	700	37	Dëmtim i pompës së derivateve të naftës	Dëmtim i Rrugës Nacionale Rahovec-Xërxë	1.300.000

Tabela 98 Fatkeqësitë e shkaktuara nga objektet ekonomike

2.10.4.1. PËRMBYTJET

Zonat që mund të goditen më së shumti: Fshatrat - Bellacërkë (Fortesë), Sapniq, Krushë e Madhe, Celinë, Çifllak, Dejnë, Xërxë, Gexhe, Radostë, Ratkoc dhe pjesa jugore e qytetit të Rahovecit (Nën qyteti).

Vërshimet janë uji i tepërt i shtratit i cili del nga lumi apo përroi dhe derdhja e ujërave të tepërta në fushën e afërt lumore, brigjeve të ulëta. Vërshimet janë rreziku më i shpeshtë i ambientit por edhe i objekteve në ato sipërfaqe të vërshuara. Por, ka raste që ato marrin edhe jetën e njerëzve. Arsyeja qëndron në shtrirjen e gjerë gjeografike të lumit – përrenjve të vërshuar nga përmbytja e derdhjeve të ujit, si rrjedhim i shirave intensive në brigje të ulëta.

Në territorin e komunës sonë, vërshimet janë rreziku më i shpeshtë i ambientit.


Vërshimet, zakonisht shkaktohen nga përmbytja e derdhjeve të ujit, si rrjedhim i shirave intensive, dhe ngushtimit të shtratit të përroit të mbushura me material të ngurtë .

Vërshime mund të jenë:

- Vërshimi i lumit,

- Vërshime të shpejta nga përrenjtë,
- Vërshimi nga lëkundja (shpërthimi) i mundshëm të digës – nivelit të liqenit Radoniqi.

Nuk ka shenja shumë të dallueshme ndërmjet vërshimeve të lumenjve, vërshimeve të shpejta, vërshimeve lymore dhe vërshimeve nga çarja e digës. Shiu, zakonisht, në këto raste ka shtrirje të gjerë dhe është i rreptë. Niveli i vërshimeve mund të jetë i lartë dhe ndikohet nga veçoritë topografike.



Harta 24 Harta e zonave potencialisht të rrezikuara nga vërshimet

Sipas shënimeve statistikore që kemi për të reshurat e shiut mund të konstatojmë që sasia mesatare vjetore e të reshurave është afër 87,98 mm/m², kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV – IX) afër 56,17 mm/m², mirëpo kjo është variabile varësish nga viti. Është bërë rregullimi i shumë shtretërve të lumenjve dhe përroskave në komunën e Rahovecit. Rregullimi i shtratit të lumit Duhllo në Rahovec, dhe rregullimi i shtretërve të përrenjve në fshatra: Opterush, Pataqan dhe Radostë. Janë duke u rregulluar shtretër të lumenjve në fshatrat: Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagavc, Krushë e Madhe dhe Bellacërkë (Fortesë). Rregullimi i kanaleve të kullimit në fshatrat: Sapniq, Celinë, Dejnë.

2.10.4.2. FATKEQËSITË NË PENDA HIDROAKUMULUESE

Rrezik real të përmasave më të mëdha për një pjesë të territorit të komunës së Rahovecit paraqet dëmtimi i pendës hidroakumuluese të KRU Gjakovë (ish Hidrosistemit Radoniqi). Kjo digë në gjatësia prej L=770m, dhe lartësi 61m.

Matja e parë bëhet në muajin Maj kur baseni është me kapacitet të plotë (456,00 NNm V=117.792.633m³) të ujit dhe në muajin Shtator kur uji arrin nivelin më të ulët si pasojë e shpenzimit më të madh gjatë muajve të verës.

Gjendja momentale e digës bazuar në matjet gjeodezike dhe gjeomekanike tregon se trupi i pendës është në kufijtë e lejuar sipas projektit e gjithsesi edhe deformimet e saj janë në kufijtë e lejuar.

Vet konstrukti i digës së ndërtuar ka përmbajtje të qëndrueshme ndërtimore e cila sipas vlerësimeve të ekspertëve-projektuesve të kësaj dige mund të përballojë lëvizje sizmike të tokës deri në 9 shkallë të Rihterit.

Me dëmtimin e mundshëm të digës së Radoniqit vala vërshuese drejtpërdrejtë rrezikon këto fshatra (me këto karakteristika të dinamikës së përmbytjeve):

	Vendbanimi	Distanca nga diga në metra	Koha e arritjes së valës së ujit	Nr. i banorëve për evakuim
1.	Zhdrellë	1,400	1min, 20sek	215 KK Gjakovë
2.	Bec	5,100	5min, 40 sek	1057 KK Gjakovë
3.	Vraniq	8,000	10min	233 KK Gjakovë
4.	Doblibare	12,800	16min, 40sek	780 KK Gjakovë
5.	Ratkoc	10,000	20min	3791KK Rahovec
6.	Radostë	16,000	32min	2346KK Rahovec
7.	Gexhe	23,800	40min	660KK Rahovec
8.	Ura e Fshejtë		49min	
9.	Bishtazhin		50min	780 KK Gjakovë

Tabela 99 Fatkeqësitë në penda hidroakumuluese

2.10.4.3. EROZIONI

Erozionet janë- ndryshimet e vazhdueshme që pëson sipërfaqja e dheut nga veprimi i ujërave, i akullit dhe i erës. Shembjet e dheut janë – lëvizja teposhtë e vëllimeve të mëdha të materialeve të sipërfaqes nën ndikimin e gravitacionit që paraqet një lloj të rëndësishëm të rreziqeve të ambientit, veçanërisht në terrenet malore por edhe kodrinore. Shembjet e shpejta shkaktojnë humbje njerëzish dhe dëme tjera, kurse shembjet e lehta kanë më pak pasoja në humbje të njerëzve dhe dëmeve tjera materiale. Varësisht nga materiali dominues, këto lëvizje zakonisht mund të ndahen në:

- shembje gurësh; dhe
- shembje dheu.

Lëvizjet masive mund të nisen nga ndonjë aktivitet sizmik ose vullkanik (ose nga ndonjë dridhje tjetër e fortë) ose nga ndonjë ndodhi atmosferike. Në këtë shkallë, ky rrezik shtrihet në zona ndërveprimi të zhvillimeve të brendshme dhe të jashtme të Tokës. Meqenëse komuna e Rahovecit nuk ka ndonjë lartësi të madhe. Territori i komunës së Rahovecit karakterizohet me pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët kapin një hapësire prej 6905 /ha, të territorit të kësaj komune. Këto sipërfaqe shtrihen kryesisht në pjesën Lindore dhe Jug-lindore, përkatësisht në lokalitetet Kramovik, Çiflak, Sarosh, Dabidol, Dejnë, Ratkoc, Radostë (Malësi e Vogël), Gexhe, Xërxë, Bellacërkë (Fortesë), Celinë, Nagavc, Krushë e Madhe. Këto sipërfaqe shtrihen në reliev të ulët përgjatë shtratit të lumit të Drinit të Bardhë dhe janë kryesisht toka aluviale deluviale dhe livadhore.

Territoret me erozion të dobët kapin sipërfaqe 8118.4 ha. Shtrihen në pjesën qendrore të komunës dhe përfshijnë vendbanimet, Rahovec, një pjesë Brestoc, një pjesë Hoçë e Vogël, Bërnjakë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe i Epërm, Nashpall, Vrajakë, Bratatin, Drenoc, një pjesë, Senoc, Pastaselë, Polluzhë, Petkoviq (Guri Kuq), etj. Erozioni i mesëm shtrihet në sipërfaqe prej 11350/ha. Ka shtrirje të madhe në hapësirë. Ky lloj erozioni shtrihet kryesisht në Veri dhe në Perëndim të komunës. Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Rahovecit kapin sipërfaqe prej 581.6 ha. Ka shtrirje në pjesën Jug-Lindore të komunës. Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet Hoçë e Madhe, Hoçë e Vogël dhe Brestoc.

Kategoria erozive	Sip. (Ha)
Sipërfaqet pa erozion	831.7
Erozion shumë i dobët	6905.0
Erozion i dobët	8,118.4
Erozion i mesëm	11,350.0

Erozion shumë i fortë	581.6

Tabela 100 Shkalla e erozionit në komunë

2.10.4.4. RRËSHQITJET E TOKËS

Shprehja shembje përfshin shumicën e lëvizjeve teposhtë të gërmadhave dheu e gurësh, që ndahen nga shtresa e poshtme, si pjesë e fortë e pjerrësisë nga zona e zhvendosur ose nga sipërfaqja e çarë. Lloji i lëvizjes, që mund t`i përfshijë: rënien, rrëshqitjen dhe rrjedhjen, varet shumë nga natyra e mjedisit gjeologjik, duke përfshirë edhe fuqinë e materialit, konfiguracionin e pjerrësisë dhe shtypjen e të çarave të ujit.

Llojet e ndryshme të shembjes lëvizin teposhtë me shtrirje të gjerë të shpejtësisë. Shumë shembje me lëvizje të shpejtë mund të paraqesin rrezik të madh për jetë, sepse ato mund t`i zhbëjnë vendbanimet ose t`i dëmtojnë rrugët shpejt dhe me këtë japin një "mësim" të vogël. Shembjet me lëvizje të lehtë gradualisht mund të shkaktojnë rritje e sasisë së dëmit, por lëvizjet e parashikuara mund të priten.

2.10.4.5. ORTEKËT DHE SHPATET E PJERRËTA

Orteku është grumbull bore që rrëshqet teposhtë maleve. Ortekët po ashtu quhen edhe rrëshqitje bore. Ortekët e borës janë rrjedhim i një "lufte" të pa barabartë ndërmjet trysnisë në një pjerrësi. Orteku paraqitet kur trysnia (e gravitetit), që provon ta shtyjë borën teposhtë, ia kalon fuqisë (nga lidhja e topave të borës) së mbështjellësit të borës. Ortekët shkatërrojnë strukturat e ndërtuara, rrugët, kabllot dhe linjat e komunikimit, kur bora rrëshqet nga lartësitë e mëdha ose duke i groposur ato. Ortekët janë rreziqe kryesore në shumë vise malore.

Faktorët që shkaktojnë ortekun:

- kushtet atmosferike
- temperatura
- pjerrësia e këndit (topografia)
- shtresa e borës
- drejtimi i erës
- bimësia
- gjendja e përgjithshme e grumbullit të borës.

Fuqia e grumbullit të borës është e ndërlidhur me dendësinë e borës dhe me temperaturën e tij. Krahasuar me gjërat tjera të ngurta, shtresat e borës kanë aftësi të rrallë për t`iu përballuar ndryshimeve të mëdha të dendësisë. Kështu, shtresa e depozituar me një dendësi origjinale 100 kg/m³ mund të dendësohet deri 400 kg/m² gjatë dimrit, më së shumti i nevojshëm për peshën e mbishtresave të borës, të tretjes së trysnisë dhe rikristalizimit të akullit. Kur temperaturat rriten dhe kur në grumbull ka ujë të shkrirë, rritet rreziku i lëvizjes së borës.

Frekuenca e ortekut është e ndërlidhur me këndin e pjerrësisë. Ortekët lirohen zakonisht në pjerrësinë në kufirin e zonës malore që rri matanë erës ekzistuese (në pjerrësinë ku nuk fryn era grumbullohet bora që vjen prej drejtimit nga fryn era ose malet). Ortekët fillojnë të lëvizin vetëm në ndonjë pyll mesatarisht të dendur apo të zhveshur. Të gjithë ortekët e ndjekin një shteg të ortekëve, që përmban tri elemente:

- zonën e nisjes, ku fillimisht bora çahet,
- shtegun e ortekut ose rrugën aktuale që e ndjek, dhe
- zonën e zbrazjes, ku bora ngadalësohet dhe ndalet.

Ortekët përbëhen nga dy pjesë: të sipërmen dhe të poshtmen. Në ortek pjesa e sipërme e borës është më e shpejtë sesa pjesa e poshtme, kështu që pjesa e sipërme mbështillet me pjesën e poshtme dhe bëhen edhe


vetë pjesë e poshtme e borës, duke e humbur shpejtësinë për shkak të drurëve dhe të pengesave të tjera. Pjesa e poshtme e mëparshme rrotullohet mbi pjesën e sipërme të vjetër dhe bëhet pjesë e sipërme.

Ka raste ku ortekët tentojnë të paraqiten përsëri në të njëjtin vend, prandaj rreziku për rastin tjetër mund të vërehet sipas njohjes së shtigjeve të mëhershme të ortekëve në reliev.

2.10.4.6. TËRMETET

Pasi rajoni i komunës së Rahovecit gjendet në qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit ku reliefi është rrafshinë – luginor – kodrinore – malore, nga një tërmet eventual i goditur, varësisht nga shkalla e goditjes do të jetë edhe me pasoja të ndryshme.

Në bazë të një harte sizmologjike të Kosovës, territori i komunës sonë gjendet në zonën me intensitet maksimal në mes 7º dhe 8º (shkallë) të Rihterit. Tërmeti mes 7º e 8º të intensitetit është shkatërrues, do të dëmtonte këto zona: Rahovecin me zonën, luginën e lumit Drini Bardh dhe Malësinë e Zatriqit. Tërmeti i tillë mund të shkaktoj fatkeqësi të mëdha deri te dëmtimi i pendës së liqenit artificial " Radoniqi". Po të ndodh një tërmet i tillë për rajonin e Anadrinisë e më gjerë, do të shkaktohej katastrofë natyrore d.m.th., një vërshim me dimension të gjerë të paparashikuar në vendbanime e fusha buzë lumit Drini Bardhë.



Harta 25 Harta sizmologjike

2.10.4.7. SIPËRFAQET E RREZIKUARA NGA ZJARRI

Zjarret që përhapen shpejt është shprehje e përgjithshme për zjarret e pakontrolluara.

Zjarret e shpejta shfaqen si rezultat i veprimeve të njëkohshme të tre faktorëve themelorë:

- Lënda ndezëse (të gjitha llojet e bimësisë)
- Kushtet atmosferike
- Zanafilla e ndezjes.

Në përgjithësi, temperaturat e larta dhe thatësia që e përcjellin një periudhë aktive të rritjes së bimësisë, i krijojnë kushtet më të mëdha të rreziqeve. Kjo do të thotë se shumica e zonave të rrezikshme janë të prirë të kenë klimë mesdhetare dhe kontinentale.

Meqenëse zjarret e shpejta kryesisht janë rreziqet rurale, gjithmonë shkaktohen dëme në ekosistem. Pas një ndodhie të madhe, drurët e malit dhe ushqimi i kafshëve mund të shkatërrohen, stallat e shtazëve dëmtohen dhe vështirësohet jeta me të madhe për një kohë.

Zjarret janë klasifikuar në disa grupe:

- zjarret aksidentale (shpërthimet, aksidentet në trafik)
- zjarret nga pakujdesia (kalimtarët, turistët, lojërat e fëmijëve, deponitë e bërllokut, etj.)
- zjarret malore
- zjarret fushore
- zjarret të qëllimta.

Përcaktimi i shkallës së rrezikshmërisë së pyjeve dhe tokave pyjore nga zjarret, bëhet sipas nr. të poenëve të nxjerrë nga kriteret specifike sipas llojeve të drunjëve të grumbullit pyjor dhe karakteristikave tjera.


Nr.	Shkalla e rrezikshmërisë	Nr. i poenëve
I.	Shumë e madhe	> 480
II.	E madhe	381 – 480
III.	Mesatare	281 – 380
IV.	E vogël	< - 280

Tabela 101 Shkalla e rrezikshmërisë nga zjarret

Legjenda e paraqitjes së grumbullit pyjor sipas llojeve të drunjëve e që paraqesin shkallën e rrezikshmërisë adekuate, është:

Nr.	Shkalla e rrezikshmërisë	Ngjyra në hartë
I.	Shumë e madhe	E kuqe
II.	E madhe	E kuqërremtë
III.	Mesatare	E verdhë
IV.	E vogël	E gjelbër

Tabela 102 Shkalla e rrezikshmërisë të drunjëve



Harta 26 Harta e rrezikshmërisë se vendbanimeve nga zjarret

2.11. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE

Komuna e Rahovecit së bashku me disa komuna të Kosovës janë të pasura me lokalitete dhe monumente arkeologjike të trashëgimisë natyrore e kulturore.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, respektivisht Departamenti i Trashëgimisë Kulturore është institucioni përgjegjës për futjen nën mbrojtje të monumenteve në territorin e Kosovës.

Lista e Trashëgimisë Kulturore përpilohet nga ana e Qendrave regjionale për Trashëgimi Kulturore (QRTK), që janë në varësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit. Dhe gjatë hulumtimeve të bëra është hasur në dy lista të cilat më pas kurorëzohen me listën zyrtare.

Lista e Objekteve të Evidentuara - paraqet listën e monumenteve të evidentuara nga përgjegjësit e QRTK-ve në Kosovë, me rastin e hulumtimit në terren.

Në Komunën e Rahovecit gjenden gjithsej 70 objekte të evidentuara gjatë viteve 2002-2003.

Lista e Monumenteve nën mbrojtjen e trashëguar nga periudhat e mëparshme - (nga pushteti Jugosllav) - e cila është bartur direkt në listën e mbrojtjes. Nga kjo listë në Komunën e Rahovecit gjenden 9 lokalitete në kategorinë Trashëgimia Arkeologjike dhe 1 monument në kategorinë Trashëgimia Arkitekturore.

Lista e Trashëgimisë Kulturore në Mbrojtje të Përkohshme - paraqet listën zyrtare të miratuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Në listën e fundit të Trashëgimisë Kulturore nën Mbrojtje të Përkohshme (2020-2021) në komunën e Rahovecit janë përfshirë monumentet e trashëgimisë arkeologjike, lokalitetet arkeologjike dhe monumentet e trashëgimisë arkitekturale në vazhdim. Duhet pasur parasysh se kjo listë zyrtare e MKRS-së plotësohet çdo vit dhe ky plotësim duhet të reflektohet edhe në vendimmarrjen komunale dhe atë qendrore lidhur me planifikimin hapësinor.

Kategoria: Trashëgimia Arkeologjike.

Emërtimi	Periudhat	Vendi	Nr. Unit në Databazë
Kisha e Shortarisë (Manastiri i Zaqishtit)	Mesjetë	Zaqishtë	003126
Kisha Bërnjakë	Mesjetë	Bërnjakë	003132
Rrënojat e kishës mesjetare	Shekulli XVI-XVII	Opterush	004669

Tabela 103 Monumentet/Ansamblet arkeologjike

Emërtimi	Periudhat	Vendi	Nr. Unit në Databazë
Kisha varrezore e Shën Nikollës	Mesjetë	Hoçë e Madhe	0031/28
Kisha varrezore e Shën Gjonit	Mesjetë	Hoçë e Madhe	0031/29
Lokaliteti Arkeologjik romak në Pozhigë	Romake	Bellacërk	003009
Gërmadhat e Kishës "Shpëtimi i Shenjët"	Mesjetë	Opterush	003134
Gërmadhat e Gjytetit	Parahistori, Antikë	Zatriq	003017
Gërmadhat e kishës së Shën Llukës	Mesjetë	Hoçë e Madhe	003000
Kështjella	Antikë e Vonë	Gexhe	002995
Varrezë Mesjetare	Mesjetë	Vrajakë	003427
Varrezë Mesjetare	Mesjetë	Celinë	003428
Terma-Banjo Romake	Shek.I-IV	Çifllak	003429
Vendbanim parahistorik dhe romak në vendin e quajtur "Maqine"	Parahistori	Rahovec	004184
Vendbanim neolitik i Opterushës	Parahistori	Opterush	004185
Tuma dhe vendbamim në Pastaselë	Parahistori	Pastaselë	0041081
Vendbanim neolitik në Pastaselë	Parahistori	Pastaselë	004182
Vendbamim romak në Pastaselë	Romake	Pastaselë	004183
Vendbanim romak i Senocit	Romake	Senoc	004186
Kështjella në Gexhe	Parahistori-antikitet i vonë	Gexhe	002995

Tabela 104 Lokalitetet Arkeologjike/Rezervatet

Kategoria: Trashëgimia Arkitekturore

Emërtimi	Periudhat	Vendi	Nr. Unit në Databazë
Teqja Halveti	Shek. XIX	Rahovec	001774
Kullë-Shtëpi e Qamil Vuçiternës	Shek. XX	Rahovec	001789
Kulla e Hajrulla Qantës	Shek. XVIII	Rahovec	001791
Kroni i Vjetër	Shek. XVIII	Rahovec	001792
Teqja e Melamive	Shek. XIX	Rahovec	001793
Kulla e Sahatit	Shek. XVIII	Rahovec	001768
Xhamia e Kasumit	Shek. XIX	Rahovec	001772
Xhamia e Sokolit	Shek. XVIII	Rahovec	001773
Xhamia e Zatriqit	Shek. XVIII	Zatriq	001798
Konaku i Manastirit të Deçanit	Shek. XVIII	Hoçë e Madhe	003412
Shtëpia e familjes Spasiq	Shek. XIX	Hoçë e Madhe	003413
Xhamia e Pastaselës	Shek. XIX	Pastaselë	001083

Kulla e Ismet Cmegës	Shek. XIX-të	Rahovec	003414
Minarja e Xhamisë së fshatit	Shek. XVIII-të	Drenoc	001805
Xhamia e Xërxës	Shek. XVIII-të	Xërxë	001806
Ura e Gurit	Shek. XIX-të	Bellacërkë (Fortesë)	003415
Xhamia e Kasumit	Shek. XIX-të	Rahovec	001769
Xhamia e Sokolit	Shek. XVIII-të	Rahovec	001772
Rrënojat e xhamisë së fshatit Brestoc	Shek. XVI	Brestoc	001763
Tyrbja e Dervish Avdiut dhe Ahmatit	Shek. XVIII-XIX	Rahovec	004124
Kulla e Mehmet Pashës	Shek .XIX	Opterush	001767
Shtëpia Muze – Ukshin Hoti	Shek. XX	Krushë e Madhe	004308
Kullë	Shek. XIX	Kramovik	004508
Kroi i Gurit në Rahovec	Shek. XIX	Rahovec	004760

Tabela 105 Monumentet/Ansamblet arkitekturore

Emërtimi	Periudhat	Vendi	Statusi	Nr. Unit në Databazë
Fshati Hoçë e Madhe	-	Fshati Hoçë e Madhe	LZVM	-

Tabela 106 Fusha e konservimit arkitekturor

Në bazë të UDHËZIMIT ADMINISTRATIV MMPHI-NR.08/2017 MBI NORMAT TEKNIKE TË PLANIFIKIMIT HAPËSINOR, konkretisht Kapitulli II, pika 6, Zonat dhe sipërfaqet e mbrojtura përfshijnë perimetrin e vend shtrirjes së monumentit të trashëgimisë kulturore të përcaktuar për mbrojtje dhe zonës mbrojtëse së tij në radius prej 50 metra (për trashëgiminë arkitekturore) dhe 100 metra për trashëgiminë arkeologjike nga perimetri. Ky obligim ligjor zbatohet në PZHK-në dhe në dokumentet tjera të planifikimit hapësinor për komunën e Rahovecit.

Lista e Objekteve Sakrale

Në bazë të të dhënave komunale objektet sakrale që janë në vendbanimet e komunës së Rahovecit janë:

Nr.	Lokacioni	Objekti	Viti i ndërtimit	Vërejtje
1.	Rahovec	Xhami e vjetër tani e re	1606	Ndërtimi i ri 2000-2005
2.	Rahovec	Xhami e vjetër tani e re	1720	2006-2008
3.	Rahovec	Xhamia e Kasumit	1826	
4.	Rahovec	Xhamia e Haxhi Qamil Kasapit	1994/96	
5.	Rahovec	Xhamia e Sokolit	1824	
6.	Xërxë	Xhami	1797	
7.	Bellacërkë (Fortesë)		1810	
8.	Krushë e Madhe		XIX-XX	
9.	Celinë		1919	
10.	Hoçë e vogël		1920	
11.	Brestoc		1598	2007-2008
12.	Opterush		1860	
13.	Retijë		1945	
14.	Reti e Poshtme		1947	
15.	Drenoc		1710	
16.	Pastaselë		1820	
17.	Zaqishtë		1990	
18.	Nagavc		1997	
19.	Radostë (Malësi e Vogël)		2004-2005	
20.	Ratkoc			
21.	Petkoviq (Guri i Kuq)			

Tabela 107 Objektet sakrale

Nr.	Lokacioni	Objekti	Viti i ndërtimit
1.	Rahovec	Teqe e Melamive Qarshi	XIX
2.	Rahovec	Teqe e Helvetive	1732
3.	Rahovec	Teqe e Rufaive	XX

Tabela 108 Teqet dhe lokacionet e tyre

Nr.	Lokacioni	Objekti	Viti i ndërtimit
1.	Rahovec	Tyrbe	
2.	Pataqan i Poshtëm	Tyrbe	XVIII
3.	Polluzhë	Tyrbe	XIX
4.	Hoçë e Vogël	Tyrbe	
5.	Dejnë	Tyrbe	
6.	Dabidol	Tyrbe	

Tabela 109 Tyrbet dhe lokacionet e tyre

Nr.	Lokacioni	Objekti
1.	Rahovec	Kishë - 1
2.	Bërnjakë	Kishë - 1
3.	Hoçë e Madhe	Kishë - 7
4.	Zaqishtë	Kishë - 1

Tabela 110 Llojet e objekteve sakrale sipas vendbanimeve

2.11.1. MONUMENTET NATYRORE[28]

Llojllojshmëria e monumenteve natyrore të karakterit botanik, hidrologjik, gjeomorfologjik të Komunës së Rahovecit, si dhe peizazheve të ndryshme natyrore, që kanë përhapje në territorin e komunës konsiderohen vlera të trashëgimisë natyrore.

Në territorin e komunës së Rahovecit shtrihet një pjesë e sipërfaqes së zonës së mbrojtur të Kanionit të Drinit të Bardhë te Ura e Fshejtë, monument natyror me karakter hidro- gjeomorfologjik që është shpallur në vitin 1986, me sipërfaqe 126.5 ha dhe Parku regjional i Mirushës 198.77 ha në vitin 1983, monument natyre me ujëvara të njëpasnjëshme.


Për shkak të vlerave natyrore janë propozuar për mbrojtje edhe këto monumente të natyrës:

1. Kaznik – Trungu i Frashërit (Francinus excelsior)
2. Kaznik – Trungu i Shpardhit (Quercus frainneto)
3. Drenoc – Trungu i Shpardhit (Quercus frainneto)
4. Nagavc – Trungu i Bungut (Quercus petraea)
5. Bratatin – Trungu i Qarrit dhe Trungu i Vidhit (Quercus cerri & Ulmus minor), Trungu i Shpardhit (Quercus frainneto)

Burime të ujit 2 (burime), çerdhe për zogj gjahu 1, Moçalishte 1, Monumente natyrore 1, Varrezat e dëshmorëve/Lapidar 1.

Janë hasur edhe gjurmë të kafshëve të egra të mëdha, grabitqarë të ariut dhe ujkut, shpezë grabitqarë, drunjë të vjetër, puse të ujit për pije, etj.

[28]Plani Zhvillimor Komunal 2011-2020



Harta 27 Harta e trashëgimisë natyrore dhe kulturore

2.11.2. PARQET KOMBËTARE, SIPËRFAQET E MBROJTURA DHE ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA BRENDA TERRITORIT TË KOMUNËS

Sa i përket zonave të veçanta të mbrojtura për komunën e Rahovecit duhet respektuar dhe zbatuar: Ligji Nr. 03/L-039 PËR ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA. Në këtë komunë janë dy zona që kanë karakter të veçantë të mbrojtjes:

1. Manastiri i Zaqishtit, Zaqishtë; dhe
2. Fshati Hoçë e Madhe, Hoçë e Madhe.

2.11.2.1. DISPOZITAT E VEÇANTA PËR FSHATIN HOÇË E MADHE

Fshati i Hoçës së Madhe, i përshkruar në pikën m) paragrafi 1 i nenit 7 të këtij ligji do të ketë të drejtën, në konsultim me komunën e Rahovecit, që të ushtrojë autoritet të kufizuar mbi aktivitetet nga fusha e mbrojtjes dhe promovimit të trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe nga fusha e planifikimit rural duke respektuar Zonën e saj të Veçantë të Mbrojtur, në përputhje me dispozitat relevante të legjislacionit mbi Vetëqeverisjen Lokale dhe parimet e Deklaratës Universale të UNESCO-s mbi Diversitetin Kulturor.

KZM-ja do të lehtësojë konsultime të tilla.

Aplikimi i Nenit 6 të këtij ligji për çdo aktivitet të ri në Zonën e Veçantë të Mbrojtur për fshatin e Hoçë e Madhe do të përcaktohet me një Ligj.

Objektet e propozuara nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport:

- Sahat Kulla, Rahovec;
- Vendi i rënies se dëshmorëve Xhelal Hajda-Toni, Selajdin Mullabazi-Mici me shokë në Opterush;
- Varrezat e Dëshmorëve në Rahovec;

- Përmendorja e Tonit e Micit në Rahovec;
- Shtabi i UÇK-së në Drenoc;
- Shtabi i UÇK-së njësia "Arti" në Rahovec;
- Maja e Shkodranit në Rahovec;
- Xhamia e Çarshisë në Rahovec;
- Kulla e Meriqëve në Rahovec;
- Kroi i Haxhinjve në Rahovec;
- Kroi në Sheshin e Republikës;
- Kështjella (kalaja e Durmanit) në Rahovec;
- Arti në gur në Zatriq;
- Kisha Ortodokse në Rahovec;
- Varrezat Bizantine në Retijë;
- Kulla e Mahmut Pashës dhe varrezat Bizantine në Opterush;
- Ura e Shenjtë mbi Drinin e Bardhë;
- Shtëpia muze e Ukshin Hotit në Krushë të Madhe;
- Varrezat e Shtavicës;
- Bodrumi i Vjetër në Rahovec;
- Vendi ku u zhvillua beteja e Gradishit (Gexhe);
- Pika e vrojtimit të UÇK-së "Vlora" në Drenoc;
- Vendi i fushëbetejës së UÇK-së në Petkoviq (Guri të Kuq);
- Fushëbeteja në trekëndëshin Vrajakë - Bratatin-Ratkoc (12 maj 1998);
- Beteja në Fortesë (18 korrik 1998) në Bellacërkë (Fortesë);
- Shtabi i UÇK në Retijë;
- Beteja e Kramovikut (1998) në Kramovik;
- Shtatorja e Sheh Mehdinit Rahovec;
- Shtatoret e Tonit dhe Micit Parku i Qytetit Rahovec;
- Pllakat përkujtimore në rruga e tranzitit e UÇK –së;
- Pllaka përkujtimore tek pompa Teuta, Gzimë Mullabazi, Xhevat Kasapin dhe Samir e Xhafer Nurkasën;
- Pllaka përkujtimore e Dëshmorëve dhe Martirëve - Qendër Rahovec;
- Pllaka përkujtimore e Dëshmorit Myhedin Morina – Gexhe;
- Busti i Heroit Mensur Zyberaj;
- Pllaka përkujtimore e Dëshmorëve Hamovc;
- Pllaka përkujtimore e Dëshmorit Skender Kastrati – Radostë (Malësi e Vogël);
- Busti i dëshmorit Milaim Krasniqi – Pastaselë;
- Varrezat e martivëve dhe pllaka e dëshmorit Arben Bytyqi- Dejnë;
- Varrezat e martirëve – Pastaselë;
- Pllaka përkujtimore e dëshmorit Bedrush Gashit – Drenoc;

- Pllaka përkujtimore e katër dëshmorëve e viteve 90- Brestoc;
- Pllaka përkujtimore e dëshmorëve Visar Hoti e Safet Latifi – Zatriq; dhe
- Pllaka përkujtimore e Rifat Dina dhe Agron Fetahu – Celinë.

	Kalaja e Dermanit Shek. IV-V Rahovec Vranjishtë		Kulla e Mahmut Pashes Shek XIX Opterush
	Maja e Shkodranit Shek.XX Vranjishtë		Teqja e Madhe tarikati Halveti Viti 1732 Rahovec
	Sahat Kulla viti 1791 Rahovec		Teqja e madhe tarikati Rifai shek.XIX-XX.
	Kulla e Ismet Çmeges. Shek.XIX Rahovec		Xhamia në fshatin Zatriq
	Epitafe-pllaka mermeri nga koha romake në fshatin Reti.		Tyrbja e Dervish Ibrahimit (tarikati Sadi) Fshati Dejnë

	Kisha ortodokse e Shën Ilisë Hoçë e Madhe Shek..XIV		Kroi i Vjetër Sheshi i Republikës Shek. XVIII- XIX. Rahovec
	Bunari i Madh Ratkoc		Mulliri i Hoxhajve Rahovec
	Muzeu i qytetit Rahovec Viti 2009- 2010		Qendra Kulturore "Mensur Zyberaj" Viti 1960 Rahovec
	Shtëpia Muze Ukshin Hoti Krushë e Madhe Viti -2013		Kompleksi i dëshmorëve në Gradish Xërxë

2.12. VENDBANIMET

2.12.1. VENDBANIMET SIPAS KARAKTERIT URBAN/RURAL DHE FUNKSIONALITETI NDËRLIDHËS

Komuna e Rahovecit shtrihet në një sipërfaqe prej 275.89 km², në të cilin territor shtrihen 34 fshatra me 2 vendbanime dhe me vetëm një qendër urbane.

Territori i Komunës së Rahovecit, ndahet në 34 zona kadastrale, dhe të gjitha vendbanimet (fshatrat) janë me nga një zonë kadastrale, me përjashtim të 3 zonave: Retijë që në vete përfshinë dy vendbanime (Reti dhe Reti e Poshtme), zona kadastrale Çifllak, që përfshinë edhe vendbanimin e Saroshit si dhe zona kadastrale Dejnë, që në vete përfshinë edhe vendbanimin e Babocit.

Populllsia e Komunës së Rahovecit, jeton në Gjithsej 37 vendbanime, prej tyre 36 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime, kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të populllsisë. Në qytetin e

Rahovecit jetojnë rreth 15,892 banorë, që do të thotë se rreth 29% e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40,316 banorë apo rreth 71%.

Pjesa më e madhe e vendbanimeve të Komunës së Rahovecit, kanë më tepër se 1,000 banorë. Numër më të madh të popullsisë ka vet qyteti i Rahovecit (15,892b).

Sa i përket vendbanimeve rurale, numër më të madh të banorëve kanë vendbanimet: Krushë e Madhe (4,473b), Ratkoc (3,791b), Xërxë (3,184b), Radostë (Malësi e Vogël) (2,346b), Bellacërka (2,270b), Opterush (1,911b). Ndërsa vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë janë: Bërnjakë (40b), Kaznik (164b). Mrasor (191b), Nashpall (220b).

Nr.	Zona kadastrale	Vendbanimi	Nr. Popullsisë	Sipërfaqe km²	Sipërfaqe Ha	Banorë në 1km²
1.	Rahovec	Rahovec	15,892	48.9	48900	325
2.	Bellacërkë	Bellacërkë	2,270	11.0	1100	206
3.	Bërnjakë	Bërnjakë	40	4.5	4500	9
4.	Bratatin	Bratatin	396	3.1	3100	128
5.	Brestoc	Brestoc	1,288	5.8	5800	222
6.	Celinë	Celinë	1,903	5.7	5700	334
7.	Çifllak	Çifllak	1,292	4.8	4800	269
		Sarosh	6			
8.	Dabidol	Dabidol	799	3.5	3500	228
9.	Dejnë	Dejnë	1,757	6.4	6400	275
		Baboc				
10.	Xërxë	Xërxë	3,184	10.1	10100	315
11.	Gexhe	Gexhe	660	3.2	3200	206
12.	Hoçë e Madhe	Hoçë e Madhe	124	13.5	13500	9
13.	Hoçë e Vogël	Hoçë e Vogël	1,166	7.0	7000	167
14.	Kramovik	Kramovik	1,125	10.3	10300	109
15.	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe	4,473	10.0	1000	447
16.	Mrasor	Mrasor	191	3.2	3200	60
17.	Nagavc	Nagavc	743	3.1	3100	240
18.	Nashpall	Nashpall	220	0.6	600	367
19.	Opterush	Opterush	1,911	9.0	9000	212
20.	Pastaselë	Pastaselë	1,011	5.4	5400	187
21.	Pataqan i Epërm	Pataqan i Epërm	533	2.3	2300	232
22.	Pataqan i Poshtëm	Pataqan i Poshtëm	1,077	5.5	5500	196
23.	Petkoviq (Guri i Kuq)	Petkoviq (Guri i Kuq)	731	10.0	10000	73
24.	Polluzhë	Polluzhë	808	5.7	5700	142
25.	Radostë (Malësi e Vogël)	Radostë (Malësi e Vogël)	2,346	10.3	10300	228
26.	Ratkoc	Ratkoc	3,791	11.8	11800	321
27.	Retijë	Retijë	1,005	9.8	9800	103
		Reti e Poshtme				
28.	Sapniq	Sapniq	996	4.9	4900	203
29.	Senoc	Senoc	687	4.4	4400	156
30.	Vrajakë	Vrajakë	838	4.9	4900	171
31.	Zaqishtë	Zaqishtë	659	5.2	5200	127
32.	Drenoc	Drenoc	1,587	8.2	8200	194
33.	Kaznik	Kaznik	164	8.3	8300	20
34.	Zatriq	Zatriq	535	15.2	15200	35

Tabela 111 Vendbanimet në Komunën e Rahovecit

Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullues të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte. Pikërisht nga kjo arsye vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë populluese dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejmë të komunës apo edhe më gjerë.

Zonat e Komunës	Numri i vendbanimeve	Siperfaqja e zonës në km²	Numri i banorëve	Dendësia e popullsisë në km²
Nën 400m	22	112.2	46,290	412.7
400m-600m	11	108.44	13,362	123.2
600m-800m	1	38.59	167	4.33
Mbi 800m	1	16.91	535	31.63

Tabela 112 Vendbanimet sipas karakterit urban në Komunën e Rahovecit

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në: Vendbanime të vogla rurale, të mesme rurale, të mëdha rurale dhe vendbanimet e karakterit urban. Vendbanimet sipas madhësisë në komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në këto grupe të madhësisë:

Kategorizimi	Nr.	Vendbanimi	Nr. i banorëve
Vendbanim i vogël rural - deri 500 banorë	1.	Sarosh	6
	2.	Bërnjakë	40
	3.	Hoçë e Madhe	124
	4.	Kaznik	164
	5.	Mrasor	191
	6.	Nashpall	220
	7.	Reti e Poshtme	234
	8.	Bratatin	396
Vendbanim i mesëm rural - deri 1,000 banorë	1.	Pataqan i Epërm	533
	2.	Zatriq	535
	3.	Zaqishtë	659
	4.	Gexhe	660
	5.	Senoc	687
	6.	Petkoviq (Guri i Kuq)	731
	7.	Nagavc	743
	8.	Retijë	771
	9.	Dabidol	799
	10.	Polluzhë	808
Vendbanimet joformale janë vendbanime njerëzore, të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, në veçanti banim të përshtatshëm.

Bazuar në Planin për Zbatimin e Standardeve në Kosovë, vendbanimet joformale kategorizohen si vijon:

- Zotërimi joformal i pronësisë;
- Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare;
- Pjesëmarrja joadekuate ose mos pjesëmarrja në qeverisje dhe
- Rrezikshmëri e lartë

Në Komunën e Rahovecit, janë identifikuar 9 vendbanime jo formale, një nga të cilat ndodhet në zonën urbane dhe 8 në zonat rurale. Në këto vendbanime jetojnë kryesisht banorë të komunitetit rom, ashkali, egjiptian dhe shqiptar. Karakterizohen me mungesë të infrastrukturës fizike dhe infrastrukturë sociale si dhe kanë ndikim negativ në mjedis.

	Vendbanimet	Zona Urbane/ Rurale	Popullsia	Sipërfaqja	Dendësia	Ekonomitë familjare	Lartësia mbidetare	Kategoria
1.	Bellacërkë (Fortesë)	Rurale	2,270	10,96	207	252	310-350	lugina - rrafshina
2.	Xërxë	Rurale	3,184	10,08	316	288	310-350	lugina - rrafshina
3.	Gexhe	Rurale	660	3,23	204	165	310-350	lugina - rrafshina
4.	Radostë (Malësi e Vogël)	Rurale	2,346	10,33	227	206	310-350	lugina - rrafshina
5.	Ratkoc	Rurale	3,791	1182	321	380	310-350	lugina - rrafshina
6.	Çifllak	Rurale	1,292	4,76	271	104	310-350	lugina - rrafshina
7.	Dabidol	Rurale	799	3,46	231	138	310-350	lugina - rrafshina
8.	Drenoc	Rurale	1,587	8,19	194	161	350-600	kodrinore
9.	Rahovec	Urbane	15,892	48,49	328	3072	350-600	kodrinore
Totali			31,821	12,2	127,5	4766		

Tabela 144 Vendbanimet joformale në Komunë të Rahovecit

Vendbanim joformal i identifikuar, nuk rezulton të jetë i gjithë vendbanimi ose Zona, por një pjesë e qytetit ose e lagjes. Identifikohet një pjesë e qytetit të Rahovecit dhe pjesë apo lagje të fshatrave Bellacërk, Xërxë, Gexhe, Radostë, Ratkoc, Çifllak, Dabidol dhe dy pjesë të fshatit Drenoc, me karakteristikat si më poshtë:

1. **Bellacërkë** Zotërimi jo formal i pronësisë (janë një numër i vogël i objekteve që kanë ndërhyrë në pronën publike)
2. **Xërxë -** Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare (Kanalizimi jo funksional)
3. **Gexhe -** Nuk ka ndonjë karakteristikë që të jetë vendbanim jo formal. Më herët nuk ka pas qasje në infrastrukturën e kanalizimit, mirëpo kjo mangësi është përmirësuar dhe tani kanë qasje.
4. **Radostë (Malësi e Vogël) -** Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare (Nuk kanë qasje në Kanalizim)
5. **Ratkoc -** Zotërimi jo formal i pronësisë (janë një numër i vogël i objekteve që kanë ndërhy në pronën publike). Parcela me numër 1725-3 është pronë shoqërore me sip. 10942 m^2 dhe është e uzurpuar me objekte banimi në sip. Prej 4725m^2 (është veç si informatë nëse mundet me hy kjo si pjesë e vendbanimit jo formal).
6. **Çifllak -** Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare (Nuk kanë qasje në Kanalizim)
7. **Dabidol -** Pjesa e Vendbanimit Joformal të identifikuar është në pjesën e komasacionit.
8. **Drenoc -** Zotërimi jo formal i pronësisë (janë një numër i madh i objekteve që kanë ndërhyrë në pronën publike). *Sqarim*: në PZHK-në e vjetër është gabim i vendosur lokacioni, vetëm parcela me numër 377-10 duhet të trajtohet si vendbanim jo formal pasi është një parcelë me sipërfaqe bukur të madhe dhe në atë janë të vendosura një numër i madh i objekteve që e kanë uzurpuar këtë pronë. Pjesë të ndara brenda kësaj parcele, ka edhe që janë pronë private.
9. **Rahovec -** Zotërimi jo formal i pronësisë . Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare (kanë një numër i parcelave që nuk kanë qasje në rrugë publike).


Nr. i Vendbanimit VJF	Sipërfaqja e përgjithshme në ha e zonave	Numri i shtëpive (Ek. Familjare)	Nr. i ekonomive familjare	Numri i banorëve në nd. pa leje	Nr. i përgjithshëm i banorëve	Dendësia (b/ha)
9	12,2	293	4,766	1,556	31,821	127,5

Tabela 145 Vendbanimet Joformale në Komunën e Rahovecit

Prandaj, sipas shënimeve të prezantuara nga KK Rahovec, gjithashtu të prezantuara edhe në tabelën 54 të vendbanimeve joformale në Komunë të Rahovecit, sipërfaqja e përgjithshme e Vendbanimeve jo formale të identifikuara në Komunën e Rahovecit është 12,2Ha. Në vendbanimet e identifikuara joformale, nga numri i përgjithshëm i banorëve 31,821, në vendbanime joformale jetojnë 1,556 banorë dhe janë identifikuar 293 ekonomi familjare nga 4,766, sa është numri i përgjithshëm i tyre.

Dominimi i familjeve të mëdha dhe të zgjeruara, tregon gjithashtu shkallë mesatare të zhvillimit dhe arsimit dhe papunësi e varfëri të theksuar. Zotërimi joformal ose jo i sigurt i pronësisë të vendbanimeve joformale të identifikuara kërkon zgjidhje, ku komuna në bashkëpunim me komunitetin të mundësojë zgjidhjen e statusit pronësor të tokave në pronësi komunale ose shoqërore, në nivelin lokal ose të nivelit qendror.

Para rregullimit të çështjes pronësore të posedimit të tokës, komuna duhet të trajtojë parcelat përmes hartimit të Planeve Rregulluese të Hollësishme (PRrH).






Figura 26 Vendbanimet Joformale në Komunën e Rahovecit

Për disa nga Vendbanimet Joformale të identifikuara në Komunën e Rahovecit, janë punuar PRrH dhe ato janë prezantuar në hartën e bashkangjitur më poshtë. Janë punuar për njësitë: Bellacërkë, Xërxë, Radostë, Ratkoc dhe Zonë Urbane në Rahovec. Mirëpo, kërkohet të hartohen Plane Rregulluese të Hollësishme edhe për njësitë të cilat nuk kanë Plane Rregulluese të Hollësishme, kurse ato të cilat veçse janë punuar duhet tu përmbahen dhe ti përmbushin kriteret dhe zgjidhjet e ofruara përmes Planeve Rregulluese të Hollësishme. Ky proces duhet monitoruar me përpikëri nga Autoriteti përgjegjës, deri në implementimin përfundimtar, përndryshe, nëse nuk monitorohet implementimi i të njëjtave, atëherë nuk kanë kurrfarë efekti propozimet dhe zgjidhjet e ofruara në Plane Rregulluese të Hollësishme.

Vendbanimi		Prioriteti për intervenim			Plani që e rregullon			Madhësia			Konteksti urban/rural			Pronësia		
Nr.	Vendbanimi/ emërtimi	ASH / AM / AGJ			PZHK / HZK / PHRr			v / m / M			U / UR / R			SH / K / P		
1.	Bellacërkë	X					X		X				X		X	
2.	Xërxë	X					X		X				X		X	
3.	Gexhe	X							X				X		X	
4.	Radostë (Malësi e Vogël)	X					X		X				X		X	
5.	Ratkoc	X					X			X			X	X		
6.	Çifllak	X							X				X		X	
7.	Dabidol	X							X				X		X	
8.	Drenoc	X								X			X		X	
9.	Rahovec	X					X			X	U				X	

Tabela 146 Veçoritë e vendbanimeve joformale

ASH - Afat shkurtë - PZHK - Plani Zhvillimor Komunal - v - I vogël - U – Urban - SH – Shoqërore

AM - Afat mesëm - HZK - Harta Zonale Komunale - m - I mesëm - UR - Urban Rural - K – Komunale

AGJ - Afat gjatë - PHRr - Plani i Hollësishëm Rregullues - M - I madh - R – Rural - P – Private

Mungesa e shërbimeve elementare të infrastrukturës teknike dhe sociale është treguar të jetë arsyeja kryesore për pjesëmarrje joadekuate. Këto lagje, janë kryesisht të banuara me komunitetin RAE mbi 70% (romë, ashkalinjë, dhe egjiptian), kurse ai shqiptar në 30%.

Infrastruktura fizike nëpër këto lagje, edhe pse ekziston (uji, rryma, kanalizimi dhe grumbullimi i mbeturinave), është joadekuate. Posaçërisht rrugët, transporti urban dhe hapësirat publike janë ato të cilat e vështirësojnë gjendjen.

Gjendja e ndërtesave të banimit nuk është shumë e mirë dhe kjo tregohet nga gjendja ekzistuese e objekteve që janë marrë sa i përket kësaj çështje. Në total ka rreth 293 objekte me 1,556 banorë.

Kriteri i mbulueshmërisë me infrastrukturë sociale

Në bazë të informatave hapësinore lidhur më shtrirjen e përmbajtjeve publike, komuna e Rahovecit ka një shpërndarje relativisht të mirë të ndërtesave arsimore dhe shëndetësore. Sa i përket ndërtesave të çerdheve, nuk mund ta konsiderojmë si kriter për shkak se çerdhet - kopshtet sipas standardeve duhet të jenë në çdo 2,000 banorë. E njëjta gjë vlen edhe për shtëpitë e kulturës. Prandaj, duke i marrë për bazë këto informata, vijmë në përfundim që pothuajse të gjitha vendbanimet joformale e plotësojnë kushtin lidhur me qasjen në infrastrukturës sociale.

Kushti tjetër i plotësuar është edhe infrastruktura teknike. Viteve të fundit janë realizuar mjaft projekte, ku janë ndërtuar rrugët, janë ndërtuar rrjeti i ujësjellësi dhe kanalizimit.

Ndonëse, Harta Zonale e Komunës ka trajtuar infrastrukturën teknike, publike, sociale dhe të transportit për të gjitha Vendbanimet Joformale, gjithashtu janë punuar edhe PRrH për disa njësi ku ka pasur të identifikuara Vendbanime Joformale sikurse. Bellacërk, Xërxë, Radostë, Ratkoc dhe Zonë Urbane në Rahovec, gjithsesi që nevojitet të hartohen Plane Rregulluese të Hollësishme edhe për njësitë të cilat nuk kanë Plane Rregulluese të Hollësishme.

Në këtë kontekst, përmbushja e kritereve të ofruara përmes Planeve Rregulluese të Hollësishme lidhur me Vendbanimet Joformale, duhet monitoruar nga Autoriteti përgjegjës, deri në implementimin përfundimtar.

Përpos përmbushjes së kritereve të parashtruara në Udhëzimin Administrativ për Plane Rregulluese të Hollësishme, Planet Rregulluese të Hollësishme për Vendbanimet Joformale, duhet të përmbajnë planin e ri parcelimit dhe rregullojnë edhe çështjet vijuese:

- Përgatitja e profilit të gjendjes ekzistuese të vendbanimeve joformale në territorin e saj. - Kjo do të duhej të shërbente për përcaktimin e prioriteteve për rregullimin e vendbanimeve joformale, ndërsa do t'u shërbente donatorëve të mundshëm për ofrimin e informatave të nevojshme për përkrahje financiare, njerëzore dhe teknike në kuadër të këtij rregullimi.
- Çështjet pronësore – ekziston nevoja për angazhim intensiv të komunës për zgjidhjen e problemeve në lidhje me të drejtat pronësore. Çështjet e pazgjidhura pronësore duhet, të zgjidhen në mënyrë që të sigurohet baza ligjore për inicimin e procesit të planifikimit. Kadastra dhe departamentet pronësore, duhet të ofrojnë të dhëna dhe harta të përditësuara, në mënyrë që të shmangen problemet me të dhëna gjatë planifikimit.
- Procesi i planifikimit - respektivisht rregullimit të Vendbanimeve Joformale, duhet të realizohet përmes një procesi gjithëpërfshirës, në mënyrë që pjesëmarrësve t'u mundësohet shprehja e kërkesave dhe një vendimmarrje transparente.

Përmbushja e kritereve dhe zgjidhjeve të ofruara përmes Planeve Rregulluese të Hollësishme si dhe të cekurave si më lartë lidhur me Vendbanimet Joformale, duhet monitoruar me përpikëri nga Autoriteti përgjegjës, deri në implementimin përfundimtar, përndryshe, nëse nuk monitorohet implementimi i të njëjtave, atëherë nuk kanë efekt propozimet dhe zgjidhjet e ofruara në Plane Rregulluese të Hollësishme.

Për pronat e identifikuara me pronësi komunale, Komuna e Rahovecit gjatë trajtimit të VBJ, duhet të bashkëpunojnë me Drejtoritë përkatëse në Kuvendin Komunal Rahovec, në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi komunale, si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të VBJ.

Bashkëpunimi me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me qëllim të shmangies së problemeve në raport me tokën shoqërore nën menaxhimin e AKP, e nevojshme për vendosjen e infrastrukturës publike, sigurimin e hapësirave për shkolla, çerdhe dhe ndërtesa të tjera komunale.

Kushtet zhvillimore për vendbanimet joformale

Duke pas parasysh që tashmë një përqindje e konsiderueshme e njësive të banimit, janë ndërtuar dhe janë në ndërtim e sipër, me HZK rekomandohet që edhe pjesa e ngelur, nëse është e mundur të ndërtohen në përputhje me kushtet zhvillimore dhe masat të përcaktuara me zonë të banimit dhe zonat tjera relevante.

2.14.1. NDËRTIMET PA LEJE DHE TRAJTIMI I TYRE

Në Regjistrin Shtetëror të ndërtimeve pa leje, në Komunë të Rahovecit janë të regjistruara mbi 14, 822[31] raste, si ndërtesa të kategorisë I-rë dhe të II-të, sipas Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje Nr.04/L-188 të vitit 2014. Ky numër i ndërtimeve pa leje, pritet të trajtohet me Ligjin e ri në fuqi Ligji Nr. 06/L-02432.

Ligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Autoriteti zyrtar përkatës do ti trajtoj dhe legalizoj shumicën e ndërtimeve të kategorisë I-rë dhe II-të, mirëpo, përsëri do të mbetet një numër i konsiderueshëm i objekteve/ndërtesave, të cilat janë ndërtuar pas 30 Gushtit të vitit 2013 dhe vazhdojnë të ndërtohen akoma, e të cilat tutje do të trajtohen me Ligjin për Ndërtim 04/L-110.

Nr.	Zona kadastrale	Vendbanimi	Numri i objekteve pa leje	Nr. Popullsisë së vendbanimit	Sipërfaqja e vendbanimit km²	Banorë në 1km²
1.	Rahovec	Rahovec	2,533	15,892	48.9	325
2.	Bellacërkë	Bellacërkë	718	2,270	11.0	206
3.	Bërnjakë	Bërnjakë	33	40	4.5	9
4.	Bratatin	Bratatin	149	396	3.1	128
5.	Brestoc	Brestoc	354	1,288	5.8	222
6.	Celinë	Celinë	541	1,903	5.7	334
7.	Çifllak	Çifllak	390	1,292	4.8	269
		Sarosh		6		
8.	Dabidol	Dabidol	152	799	3.5	228
9.	Dejnë	Dejnë	375	1,757	6.4	275
		Baboc				
10.	Xërxë	Xërxë	927	3,184	10.1	315
11.	Gexhe	Gexhe	227	660	3.2	206
12.	Hoçë e Madhe	Hoçë e Madhe	515	124	13.5	9

[31] MMPH / DPHBN,Numri i ndërtimeve pa leje sipas Komunave nga Regjistri Shtetëror i Ndërtimeve Pa Leje, Prishtinë 09.09.2015

[32] Shënimet e prezantuara janë marrë nga të dhënat e Kuvendit Komunal Rahovec

13.	Hoçë e Vogël	Hoçë e Vogël	402	1,166	7.0	167
14.	Kramovik	Kramovik	298	1,125	10.3	109
15.	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe	515	4,473	10.0	447
16.	Mrasor	Mrasor	86	191	3.2	60
17.	Nagavc	Nagavc	235	743	3.1	240
18.	Nashpall	Nashpall	69	220	0.6	367
19.	Opterush	Opterush	584	1,911	9.0	212
20.	Pastaselë	Pastaselë	287	1,011	5.4	187
21.	Pataqan i Epërm	Pataqan i Epërm	113	533	2.3	232
22.	Pataqan i Poshtëm	Pataqan i Poshtëm	318	1,077	5.5	196
23.	Petkoviq (Guri i Kuq)	Petkoviq (Guri i Kuq)	201	731	10.0	73
24.	Polluzhë	Polluzhë	251	808	5.7	142
25.	Radostë (Malësi e Vogël)	Radostë (Malësi e Vogël)	801	2,346	10.3	228
26.	Ratkoc	Ratkoc	1,076	3,791	11.8	321
27.	Retijë	Retijë	360	1,005	9.8	103
		Reti e Poshtme				
28.	Sapniq	Sapniq	307	996	4.9	203
29.	Senoc	Senoc	208	687	4.4	156
30.	Vrajakë	Vrajakë	222	838	4.9	171
31.	Zaqishtë	Zaqishtë	226	659	5.2	127
32.	Drenoc	Drenoc	450	1,587	8.2	194
33	Kaznik	Kaznik	47	164	8.3	20
34	Zatriq	Zatriq	145	535	15.2	35

Tabela 147 Ndërtimet pa leje në Komunë të Rahovecit

Për ndërtimet pa leje, të identifikuara në pronat me pronësi komunale, Komuna e Rahovecit, gjatë trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe VBJ, duhet të bashkëpunojnë me Drejtoritë përkatëse në Kuvendin Komunal Rahovec, në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi komunale, si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të VBJ.


Për ndërtimet pa leje të identifikuara në pronat me pronësi shoqërore (nëse eventualisht ekzistojnë), Komuna e Rahovecit, gjatë trajtimit të ndërtimeve pa leje dhe VBJ, duhet të bashkëpunojnë me AKP-në (në nivel regjional dhe qendror), në lidhje me pronat që eventualisht gjinden në pronat me pronësi shoqërore, si dhe ti bashkërendojnë aktivitetet me rastin e rregullimit të ndërtimeve pa leje dhe VBJ. Ndërtimet pa leje të identifikuara në pronat me pronësi shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, Ligji Nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, menaxhohen dhe trajtohen nën mandatin e AKP-së.

Nr.	Zona kadastrale	Vendbanimi	Numri i objekteve pa leje	Nr.	Zona kadastrale	Vendbanimi	Numri i objekteve pa leje
1.	Rahovec	Rahovec	2,533	17.	Nagavc	Nagavc	235
2.	Bellacërkë	Bellacërkë	718	18.	Nashpall	Nashpall	69
3.	Bërnjakë	Bërnjakë	33	19.	Opterush	Opterush	584
4.	Bratatin	Bratatin	149	20.	Pastaselë	Pastaselë	287
5.	Brestoc	Brestoc	354	21.	Pataqan i Epërm	Pataqan i Epërm	113
6.	Celinë	Celinë	541	22.	Pataqan i Poshtëm	Pataqan i Poshtëm	318
7.	Çifllak	Çifllak	390	23.	Petkoviq (Guri i Kuq)	Petkoviq (Guri i Kuq)	201
		Sarosh		24.	Polluzhë	Polluzhë	251
8.	Dabidol	Dabidol	152	25.	Radostë	Radostë	801
9.	Dejnë	Dejnë	375	26.	Ratkoc	Ratkoc	1,076
		Baboc		27.	Retijë	Retijë	360

1.0	Xërxë	Xërxë	927			Reti e Poshtme	
11.	Gexhe	Gexhe	227	28.	Sapniq	Sapniq	307
12.	Hoçë e Madhe	Hoçë e Madhe	515	29.	Senoc	Senoc	208
13.	Hoçë e Vogël	Hoçë e Vogël	402	30.	Vrajakë	Vrajakë	222
14.	Kramovik	Kramovik	298	31.	Zaqishtë	Zaqishtë	226
15.	Krushë e Madhe	Krushë e Madhe	515	32.	Drenoc	Drenoc	450
16.	Mrasor	Mrasor	86	33.	Kaznik	Kaznik	47
				34.	Zatriq	Zatriq	145

Tabela 148 Numri i ndërtimeve pa leje në Komunë të Rahovecit

HARTA E REGJISTRIT TË NDËRTIMEVE PA LEJE NË KOMUNËN E RAHOVECIT



Legjenda

- Regjistri i ndertimeve pa leje
- Zonë urbane (ZU)
- Zonë rurale (ZR)
- Kufi kadastral
- Kufi komunal

MINUCIPALITY OF RAHOVEC
KOMUNA E RAHOVECIT
PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL
MUNICIPAL DEVELOPMENT PLAN

Figura 27 Harta e ndërtimeve pa leje

2.15. SHFRYTËZMI I TOKËS

Territori i Komunës së Rahovecit është i dominuar me pjesë kodrinore-malore që mundëson zhvillimin e ekonomisë pyjore, turizmit dhe blegtorisë, ndërsa sipërfaqet e rrafshëta shfrytëzohen për aktivitete tjera bujqësore dhe për ngritjen e vendbanimeve, me një sipërfaqe prej 27589.40. Komuna e Rahovecit, vlerësohet se 63.04% e kësaj sipërfaqeje është tokë bujqësore dhe 23.28% është tokë Pyjore, sipërfaqe këto më të mëdha sa I përket territorit. Në vazhdim janë të paraqitura të gjitha shfrytëzimet ekzistuese të territorit të komunës së Rahovecit në sipërfaqe për hektar si dhe në përqindje.

Në vijim janë paraqitur sipërfaqet e shfrytëzimit aktual i tokës sipas HILUCS:

Shfrytëzimi i tokës sipas HILUCS	Sipërfaqja(ha)	%
Sipërfaqe ujore	95.69	0.35%
Shfrytëzim tjetër/Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik/Tokë natyrore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	315.43	1.14%
Prodhim Tretësor/Shërbim i komunitetit	107.70	0.39%
Prodhim dytësor/industri e prodhimeve të lehta	256.64	0.94%
Prodhim Parësor/Bujqësi	17,540.28	64.13%
Prodhim Tretësor/Shërbim tregtar	449.70	1.63%
Prodhim Tretësor/Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ/Hapësirë e hapur rekreative	582.70	2.13%
Prodhim Parësor/ Pylltari/Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë	6,426.54	23.49%
Rrjetet e transportit, logjistikës dhe Infrastrukturës publike/Rrjetet e transportit	299	1.09%
Banim/Banim i përhershëm	1,279.36	4.68%

Tabela 149 Sipërfaqja dhe përqindja e sipërfaqeve të ndërtuara sipas kategorive të HILUCS

2.15.1. BANIM/BANIM I PËRHERSHËM

Zonat e banimit shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 1279.36 ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit me shfrytëzim banimi më të lartë dhe më të ulët se 100 ha:

ZONAT ME SIP > 100ha	ZONAT ME SIP < 100ha
Rahovec 279.13 ha	Bellacërkë 60.50
Krushë e Madhe 113.34ha	Mrasor 6.05
	Kramovik 28.33
	Petkoviq 14.71
	Kaznik 3.54
	Polluzhë 19.91
	Çifllak 28.91
	Dabidol 14.38
	Pastaselë 24.34
	Zatriq 7.66
	Senoc 14.83
	Dejnë + Baboc 35.23
	Bratatin 9.31
	Vrajakë 13.80
	Drenoc 40.64
	Nashpall 4.20
	Radostë (Malësi e Vogël) 59.78
	Sapniq 21.90
	Pataqan i Poshtëm 22.94
	Pataqan i Epërm 11.40

	Bërnjakë 17.80
	Hoçë e Madhe 29.00
	Hoçë e Vogël 28.14
	Brestoc 36.47
	Zaqishtë 11.32
	Opterush 45.66
	Retijë 25.88
	Nagavc 20.60
	Celinë 50.63
	Xërxë 83.62
	Gexhe 19.64
	Ratkoc 75.77

Tabela 150 Zonat e banimit sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale

2.15.2. PRODHIM PARËSOR/BUJQËSI

Zonat bujqësore shtrihen në një sipërfaqe të përgjithshme prej 18640.28ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit me shfrytëzim bujqësor më të lartë dhe më të ulët se 300 ha:

ZONAT ME SIP > 300ha	ZONAT ME SIP < 300ha
Bellacërkë 1009.00ha	Mrasor 182.84
Kramovik 707.29ha	Dabidol 295.47
Petkoviq 650.93ha	Bratatin 233.37
Kaznik 387.49ha	Nashpall 54.81
Polluzhë 346.34ha	Pataqan i Epërm 192.47
Çifllak 374.27 ha	Zaqishtë 273.47
Pastaselë 378.73ha	Nagavc 208.51
Zatriq 590.67ha	Gexhe 215.02
Senoc 327.82 ha	
Dejnë + Baboc 519.95ha	
Vrajakë 395.25ha	
Drenoc 581.16ha	
Radostë (Malësi e Vogël) 819.68ha	
Sapniq 450.95	
Pataqan i Poshtëm 457.89ha	
Rahovec 2732.33ha	
Bërnjakë 404.62ha	
Hoçë e Madhe 704.07ha	
Hoçë e Vogël 544.64ha	
Brestoc 400.99 ha	
Opterush 579.85 ha	
Retijë 683.94ha	
Celinë 479.72ha	
Xërxë 787.67ha	
Krushë e Madhe 722.02ha	
Ratkoc 947.05ha	

Tabela 151 Zonat bujqësore sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale

2.15.3. PRODHIM PARËSOR/ PYLLTARI/PYLLTARI E BAZUAR NË ROTACION TË MESËM APO TË GJATË

Zonat Pyjore shtrihen në një të sipërfaqe të përgjithshme prej 1168.04 ha. Në vijim janë të radhitura zonat kadastrale me mbulueshmëri të territorit me shfrytëzim për pyje më të lartë se 150 ha:


ZONAT ME SIP > 150ha	ZONAT ME SIP < 150ha
Mrasor 128.28 ha	Bellacërkë 26.00ha
Kramovik 242.75 ha	Çifllak 14.10ha
Petkoviq 344.00 ha	Dabidol 13.33ha
Kaznik 442.66 ha	Senoc 92.80ha
Polluzhë 197.56 ha	Dejnë + Baboc 58.52ha
Zatriq 913.31 ha	Bratatin 64.97ha
Drenoc 194.93 ha	Vrajakë 83.77ha
Rahovec 1895.57 ha	Nashpall 4.76ha
Hoçë e Madhe 617.18 ha	Sapniq 20.58ha
Zaqishtë 233.78 ha	Pataqan i Poshtëm 70.91ha
Opterush 273.30 ha	Pataqan i Epërm 26.70ha
Retijë 270.21 ha	Bërnjakë 27.90ha
	Hoçë e Vogël 128.06ha
	Nagavc 77.59ha
	Celinë 39.02ha
	Gexhe 84.06ha
	Krushë e Madhe 67.52ha
	Dabidol 13.30ha
	Pastaselë 134.17ha
	Radostë (Malësi e Vogël) 103.36ha
	Brestoc 141.94ha
	Xërxë 136.57ha
	Ratkoc 114.79ha

Tabela 152 Zonat pyjore sipas sipërfaqeve (ha) në zona kadastrale

3. VLERËSIMI I GJENDJES EKZISTUESE

3.1. TRENDET DHE PARASHIKIMET DEMOGRAFIKE

Popullsia dhe karakteristikat e saj luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimet e gjithmbarshme të territorit. Bazuar në dinamikën e popullsisë sipas vendbanimeve dhe strukturave demografike, është e mundur planifikimi hapësinor i territorit. Kosova dhe Komuna e Rahovec shikuar në retrospektivë kishte një trend të thjeshtë pozitiv të dinamikës së popullsisë mirëpo, ky trend në këto vitet e fundit ka filluar të ketë ndryshime, të cilat ndryshime qojnë në zvogëlimin e popullsisë. Edhe përkundër ndryshimeve demografike, Kosova sikurse edhe Rahoveci kanë pasur trend pozitiv të rritjes së popullsisë në nivel vendi. Ndërsa, sipas vlerësimit të ASK-së, në vitin 2018 Kosova ka shënuar rritje të popullsisë në 1,795,666 banorë. Në Komuna e Rahovecit, bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, ka gjithsej 56,208 banorë. Shtrirja e popullatës në komunë është më shumë në zonë rurale sesa urbane, me 15,892 banorë në zonën urbane (28.7%) dhe 40.316 (71.3%) në zonat rurale. Rahoveci si komunë ka një popullsi mjaftë të re ku rreth 50% e popullatës janë të moshës prej 0-35 vjet. Ndërsa në vitin 2019 komuna kishte gjithsej 56,414 banorë, dhe kjo tregon se ka rënie të numrit të popullatës krahasuar me vitin 2017 për 1,344 banorë për vit, dhe në total rreth 2,688 banorë. Sipas përllogaritjes së trendit të zvogëlimit të popullsisë, bazuar në parametrat e mësipërm, popullata e komunës së Rahovecit në vitin 2030 do të ketë rreth 62,860 banorë (ASK). Në këto dy dekadat e fundit, sikur Kosova ashtu edhe Komuna e Rahovecit nuk kanë pasur rritje të përgjithshme të popullsisë krahasuar me trendët në vitet e kaluara (tri dekada më parë). Kjo situatë na bënë të kuptojmë se kemi të bëjmë me zvogëlim apo stagnim të numrit të popullsisë në nivel vendi dhe komune.



Grafikoni 2 Numri i popullsisë dhe shkalla e rritjes (ASK 2020)

Sipas të dhënave nga tabelë, vërehet se deri në vitet e 60-ta komuna e Rahovecit ka shënuar rritje demografike, por shkallët e kësaj rritjeje kanë qenë më të vogla nga fakti se kishte shkallë të larta të natalitetit dhe mortalitetit dhe si pasojë kishte shtim të ulët natyror.

Nëse bëhet një analizë të strukturës së popullsisë në komunën e Rahovecit, mund të vërehet se popullsia është e shtrirë pothuajse në mënyrë të barabartë në të gjitha zonat. Mund të shihet një numër më i madh i shtrirjes së banorëve (71.6%) në pjesën rurale të komunës, gjegjësisht në distancat nga 3-9 km. Shpjegimi rreth shtrirjes është dhënë edhe në tabelën e mëposhtme

Pas viteve të 60-ta gjegjësisht viteve të 70-ta kemi një rritje më të theksuar të popullsisë si pasojë e zvogëlimit të shkallëve të mortalitetit dhe në anën tjetër shkalla e natalitetit mbetet ende e lartë dhe si pasojë kemi shkallë më të lartë të shtimit natyror. Popullsia e komunës së Rahovecit jeton në gjithsej 37 vendbanime,

prej tyre 36 janë fshatra dhe vetë qyteti i Rahovecit. Këto vendbanime kanë dallime të theksuara sa i përket numrit të popullsisë. Në qytetin e Rahovecit jetojnë rreth 15,892 banorë që do të thotë se rreth 29% e popullsisë së tërësishme jeton në këtë qytet, ndërsa në të gjitha vendbanimet tjera jetojnë rreth 40,316 banorë apo rreth 71%.

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Komuna	20,350	22,687	26,839	35,215	46,459	59,877	56,208
Bellacërkë	620	680	874	1,336	1,797	2,299	2,270
Bërnjakë	13	28	37	20	30	55	40
Bratatin	162	207	262	288	427	489	396
Brestoc	481	536	638	908	1,295	1,669	1,288
Celinë	547	637	757	1,105	1,553	2,081	1,903
Çifllak	187	386	435	541	872	1,158	1,292
Dabidol	228	249	290	368	421	518	799
Dejnë	530	611	684	835	1,228	1,581	1,757
Drenoc	442	470	564	814	1,217	1,663	1,587
Gexhe	292	334	396	423	480	557	660
Hoçë e Madhe	1,049	1,124	1,184	1,245	1295	1,288	124
Hoçë e Vogël	594	669	774	942	1,181	1,328	1,166
Kaznik	192	192	238	272	302	362	164
Kramovik	306	345	431	620	767	1,033	1,125
Krushë e Madhe	1,235	1,412	1,730	2,460	3,376	4,311	4,473
Mrasor	107	98	117	153	192	254	191
Nagavc	256	287	360	510	667	882	743
Nashpall	56	60	75	129	145	264	220
Opterush	912	1,011	1,097	1,345	1,841	2,177	1,911
Pastaselë	306	317	413	577	827	1,013	1,011
Pataqan i Epërm	194	138	182	271	352	425	533
Pataqan i Poshtëm	244	288	380	465	670	828	1,077
Petkoviq	429	277	324	455	477	615	731
Polluzhë	245	254	331	467	673	813	808
Radostë (Malësi e Vogël)	816	916	1,112	1,361	1,720	2,023	2,346
Rahovec	5,600	6,411	7,373	10,080	13,134	18,296	15,892
Ratkoc	1,224	1,350	1,673	2,075	2,730	3,342	3,791
Retijë	569	577	726	894	1,078	1,317	771
Reti e Poshtme	...	...	...	...	...	...	234
Sapniq	318	369	445	563	780	946	996
Sarosh	57	68	76	28	9	73	6
Senoc	184	217	271	357	529	689	687
Vrajakë	300	328	413	487	585	784	838
Xërxë	618	693	904	1251	1,959	2,805	3,184
Zatriq	457	483	560	597	721	810	535
Zaqishtë	580	665	713	973	1,129	1,129	659

Tabela 153 Popullsia e Komunën e Rahovecit sipas vendbanimeve (1948 – 2011)

Pjesa më e madhe e vendbanimeve të komunës së Rahovecit kanë më tepër se 1,000 banorë. Numër më të madh të popullsisë ka vetë qyteti i Rahovecit (15,892b). Sa i përket vendbanimeve rurale, numër më të madh të banorëve kanë vendbanimet: Krusha e Madhe (4,473b), Ratkoci (3,791b), Xërxa (3,184b), Radostë (2,346b), Bellacërka (2,270b), Opterusha (1,911b). Ndërsa vendbanimet që kanë numër më të vogël të popullsisë janë: Bërnjakë (40b), Kaznik (164b). Mrasor (191b), Nashpall (220b).

Viti	Popullsia	Indeksi Bazik	Indeksi Vargor
1948	20,287	100	100
1961	26,763	132	132
1971	35,188	173	131
1981	46,396	228	132
1991	59,625	294	128
2011	56,208	277	94
2021	55,391	281	98

Tabela 154 Numri i popullsisë sipas indeksit bazik dhe vargor në Komunën e Rahovecit (ASK)

Rritjen më të madhe popullsia në Komunën e Rahovecit e kishte në vitet e '70 – '90 – ta, pastaj ka vazhduar me një rënie të dukshme të numrit të popullsisë së përgjithshme. Ndërsa, nga viti 1991 – 2011, popullsia e Rahovecit ka pasur zvogëlim të numrit të përgjithshëm.

3.1.1. STRUKTURA E POPULLSISË SIPAS MOSHËS DHE GJINISË[33]

Struktura e popullsisë është e lidhur ngushtë me lëvizjen natyrore dhe mekanike të popullsisë. Kjo strukturë mund të shqyrtohet nga aspekti biologjik, ekonomik, social, nacional, fetar, etj. Komuna e Rahovecit ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë të zgjeruar sipas moshës, edhe pse periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë. Komuna e Rahovecit në aspektin e zhvillimit demografik ka veçoritë e saj edhe në përbërjen e popullsisë sipas moshës dhe gjinisë. Në këto struktura kanë ndikuar shumë faktorë demografik dhe socio-ekonomik dhe janë krijuar shumë karakteristika dhe efekte të tjera sasiore dhe cilësore në zhvillimin demografik. Komuna e Rahovecit ka popullsi kryesisht të re dhe me bazë të zgjeruar sipas moshës, edhe pse në periudhat e fundit kohore vërehen disa tendenca me ndryshime të vogla në zvogëlimin e grup-moshave të reja. Deri në vitet e 90-ta në komunën e Rahovecit ka dominuar plotësisht tipi progresiv i popullsisë, ku shkalla e lartë e natalitetit dhe rëniet e vazhdueshme të mortalitetit kanë ndikuar drejtpërdrejtë në krijimin e këtij tipi të popullsisë. Ndryshimi i rrethanave socio- ekonomike dhe politike pas viteve të 90-ta kanë ndikuar në zhvillimin e përgjithshëm demografik të komunës, njëkohësisht edhe me ndryshime në strukturën e popullsisë sipas moshës. Pothuaj gjatë gjithë pjesës së dytë të shekullit të kaluar, e popullsisë së komunës së Rahovecit kishte bazë të zgjeruar me dominimin e grup-moshave 0 deri 4 vjeç. Gjatë analizës së të dhënave demografike, vërehen ndryshime në strukturën e popullsisë. Këto ndryshime mund t'i dallojmë më qartë përmes piramidës së popullsisë.


Grup mosha	Meshkujt	Femrat
0-9	8.60%	7.53
10-19	11.10%	10.30%
20-29	9.06%	8.36%
30-39	7.68%	8.23%
40-49	6.06%	6.17%
50-59	3.84%	3.95%
60-69	60.47%	2.44%
70-79	1.39%	1.60%
80+	0.40%	0.48%

[33]Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK)

Tabela 155 Piramida e popullsisë në komunën e Rahovecit (ASK 2011)


Të dhënat për grup-moshën janë marr nga ASK-ja 2011 dhe gjithashtu janë analizuar edhe numri i lindjeve në periudhën e fundit ku vërehet një rënie e tyre në krahasim me vitet e mëparshme. Forma e piramidës ndryshon duke u ngushtuar baza e saj dhe kjo si pasojë e dy faktorëve: migrimeve dhe të tendencave të zvogëlimit të natalitetit. Nga tabela e popullsisë vërehet se grup-moshat e reja 0 deri 9 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël në popullsinë e përgjithshme në krahasim me grup- moshën 9 deri 19 vjeç.

Në përgjithësi grup-moshat e reja të popullsisë (0 deri 19 vjeç) dominojnë dukshëm në popullatën e përgjithshme të komunës, dhe kjo është një indikator mjaft i rëndësishëm që tregon se në të ardhmen do të ketë natalitet të lartë, nga fakti se këto grup-mosha në të ardhmen japin një përqindje të konsiderueshme të popullsisë fertile që konsiderohet si burim i lindshmërisë.



Grafikoni 3 Tri grup-moshat e popullsisë në komunës e Rahovecit

Mbi 40% të popullsisë së përgjithshme në komunë janë me moshë të re 0 deri 19 vjeç, ndërsa grup-moshat mbi 65 vjeç kanë pjesëmarrje më të vogël me 8.8% të popullsisë së përgjithshme. Struktura gjinore e popullsisë në komunën e Rahovecit ka karakteristikat e veta me dominim jo të madh të gjinisë mashkullore. Koeficienti i maskulinitetit është rreth 1,051, që do të thotë se mesatarisht ekzistojë 1,051 meshkuj në çdo 1,000 femra.



Grafikoni 4 Përqindja e popullsisë sipas gjinisë në komunën e Rahovecit (ASK 2011)

Siç shihet edhe nga grafiku, ekziston një de balans i vogël gjinor në popullsinë e komunës së Rahovecit, ku popullsia mashkullore dominon me 51% në krahasim me popullsinë femërore që ka 49% të popullsisë së gjithmbarshme.

3.1.2. STRUKTURA ETNIKE E POPULLSISË

Sa i përket përkatësisë etnike, në Komunën e Rahovec vërehet një dallim i lehtë i dominimit të etnisë shqiptare me 98.15% të numrit të përgjithshëm të banorëve dhe komuniteti i dytë më i madh është komuniteti Ashkali të cilët përbëjnë 0.72%.

	Shqiptarë	Serbë	Turq	Boshnjakë	Romë	Ashkali	Egjiptianë	Të tjerë	Preferojnë të mos përgjigjen	Nuk janë në dispozicion
Rahovec	55,166	134	2	10	84	404	299	11	15	83
%	98.15%	0.24%	0.00%	0.02%	0.15%	0.72%	0.53%	0.02%	0.03%	0.15%

Tabela 156 Pjesëmarrja e etniteteve në komunë (ASK 2011)

Sipas të dhënave nga regjistrimi zyrtar i ASK-së i bërë në vitin 2011, i cili është regjistrimi i fundit zyrtar për komunën e Rahovecit, popullsia shqiptare dominon me 98.15% ndërsa etnitetet tjera kanë pjesëmarrje shumë të vogël, Serbet me 0.24% dhe Romët me 0.15%, etj.

Vendbanimi, tipi i vendbanimit	Gjithsej	Gjinia		Etniciteti										
		Meshkuj	Femra	Shqiptar	Serb	Turk	Boshnjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Të tjerë	Preferoj të mos përgjigjem	Të dhënat nuk janë në dispozicion
KOMUNA E RAHOVECIT														
Total	**56,208**	**28,512**	**27,696**	**55,166**	**134**	**2**	**10**	**84**	**404**	**299**	**-**	**11**	**15**	**83**
Urban	*15,892*	*8,251*	*7,641*	*15,467*	*85*	*2*	*6*	*62*	*186*	*33*	*-*	*6*	*14*	*31*
Rural	*40,316*	*20,261*	*20,055*	*39,699*	*49*	*-*	*4*	*22*	*218*	*266*	*-*	*5*	*1*	*52*
1 Bellacrkë	2,270	1,141	1,129	2,231	-	-	-	-	20	17	-	-	-	2
2 Bërnjak	40	15	25	36	-	-	-	-	-	4	-	-	-	-
3 Bratotin	396	194	202	394	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
4 Brestovc	1,288	645	643	1,280	-	-	-	-	-	-	-	-	-	8
5 Celinë	1,903	971	932	1,852	-	-	-	-	49	-	-	-	-	2
6 Çifllak	1,292	623	669	1,250	-	-	1	-	-	37	-	2	-	2
7 Dubidol	799	423	376	739	-	-	1	-	30	29	-	-	-	-
8 Dejnë	1,757	886	871	1,754	-	-	2	-	-	-	-	-	-	1
9 Drenoc	1,587	812	775	1,583	-	-	-	-	-	-	-	-	1	3
10 Gexhë	660	341	319	645	-	-	-	-	15	-	-	-	-	-
11 Hoçë e Madhe	124	66	58	75	49	-	-	-	-	-	-	-	-	-
12 Hoçë e Vogël	1,166	584	582	1,165	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
13 Kaznik	164	82	82	160	-	-	-	-	-	-	-	-	-	4
14 Kramovik	1,125	576	549	1,110	-	-	-	8	-	-	-	2	-	5
15 Krushë e Madhe	4,473	2,210	2,263	4,440	-	-	-	8	21	-	-	-	-	4
16 Mrasor	191	109	82	191	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
17 Nagavc	743	369	374	740	-	-	-	-	-	-	-	-	-	3
18 Nushpal	220	111	109	220	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
19 Opterushë	1,911	917	994	1,905	-	-	-	-	6	-	-	-	-	-
20 Pastasellë	1,011	459	552	1,011	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
21 Pataçan i Epërm	533	278	255	533	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
22 Pataçan i Ulët	1,077	566	511	1,077	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
23 Petkoviq	731	386	345	731	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
24 Polluzhë	808	407	401	808	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
25 Radostë	2,346	1,202	1,144	2,310	-	-	-	-	25	7	-	-	-	4
26 Rahovec U	**15,892**	**8,251**	**7,641**	**15,467**	**85**	**2**	**6**	**62**	**186**	**33**	**-**	**6**	**14**	**31**
27 Ratkoc	3,791	1,916	1,875	3,676	-	-	-	-	13	100	-	-	-	2
28 Reti e Ulët	234	122	112	234	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
29 Retijë	771	356	415	771	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
30 Sapniq	996	511	485	995	-	-	-	-	-	-	-	-	-	1
31 Sarosh	6	1	5	6	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
32 Senoc	687	346	341	665	-	-	-	-	22	-	-	-	-	-
33 Vrajakë	838	397	441	838	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
34 Xërxë	3,184	1,653	1,531	3,080	-	-	-	6	17	72	-	1	-	8
35 Zatriq	535	260	275	535	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
36 Zoçishtë	659	326	333	659	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 157 Popullsia e Komunës së Rahovec sipas vendbanimit, gjinisë dhe etnicitetit[34]

3.1.3. POPULLSIA SIPAS PËRKATËSISË RELIGJIOZE

Sa i përket religjionit, në Kosovë dominon besimi mysliman/feja Islame (99.28%), katolik 0.158%, ortodoks 0.23%, etj., ndërsa në komunën e Rahovec feja Islame përfaqësohet me 50.37% meshkuj dhe 48.91% femra, ortodokse janë 0.12% meshkuj dhe 0.11% femra, etj.

	Islam		Ortodoks		Katolik		Të tjerë		Pa religjion		Gjithsej	
	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
Rahovec	28,314	27,496	69	65	46	43	4	1	4	2	28,512	27,696
%	50.37	48.91	0.12	0.11	0.081	0.076	0.0071	0.0017	0.0071	0.0035	50.72	49.27

Tabela 158 Popullsia sipas përkatësisë religjioze (ASK 2011)

3.1.4. DENDËSIA E POPULLSISË SIPAS VENDBANIMIT

Dendësia e popullsisë në komunën e Rahovecit është rreth 204 banorë në 1 km², ku rreth 56,208 banorë jetojnë në 275.9 km. Brenda territorit të komunës së Rahovecit ekzistojnë dallime për sa i përket dendësisë së popullsisë.35 Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël. Kjo është në raport edhe me hapësirën e vendbanimit, ku disa vendbanime që kanë hapësirë më të vogël (zona kadastrale e vendbanimit është e vogël), dendësia e popullsisë është më e madhe.

Nr.	Vendbanimet	Nr. i banorëve	Sipër. në km²	Dendësia në 1 km²	Nr.	Vendbanimet	Nr. i banorëve	Sipër. në km²	Dendësia në 1 km²
1.	Rahovec	15,892	48.49	328	19.	Nashpall	220	0.64	344
2.	Bellacërkë (Fortesë)	2,270	10.96	207	20.	Opterush	1,911	9.01	212
3.	Bërnjakë	40	4.51	9	21.	Pastaselë	1,011	5.40	187
4.	Bratatin	396	3.11	127	22.	Pataqan i Epërm	533	2.33	229
5.	Brestoc	1,288	5.80	222	23.	Pataqan i Poshtëm	1,077	5.53	195
6.	Celinë	1,903	5.72	333	24.	Petkoviq	731	10.02	73
7.	Çifllak	1,292	4.76	271	25.	Polluzhë	808	5.66	143
8.	Dabidol	799	3.46	231	26.	Radostë	2,346	10.33	227
9.	Dejnë + Baboc	1,757	6.43	273	27.	Ratkoc	3,791	11.82	321
10	Drenoc	1,587	8.19	194	28.	Reti e Poshtme	234	0	0
11.	Gexhe	660	3.23	204	29.	Retijë	771	9.84	78
12.	Hoçë e Madhe	124	13.52	9	30.	Sapniq	996	4.95	201
13.	Hoçë e Vogël	1,166	7.05	165	31.	Sarosh	6	4.95	1
14.	Kaznik	164	8.34	19	32.	Senoc	687	4.36	158
15.	Kramovik	1,125	10.31	109	33.	Vrajakë	838	4.94	170
16.	Krushë e Madhe	4,473	10.00	447	34.	Xërxë	3,184	10.09	316
17.	Mrasor	191	3.17	60	35.	Zatriq	535	15.15	35
18.	Nagavc	743	3.09	240	36.	Zaqishtë	659	5.21	127

Tabela 159 Dendësia e popullsisë sipas vendbanimeve

Dendësia më e lartë e popullsisë paraqitet në vendbanimin Krushë e Madhe me 447 banorë në km², kjo për shkak se ky vendbanim ka një sipërfaqe prej 10 km². Vendbanimet tjera me dendësi po aq të madhe janë Nashpall ku mesatarisht jetojnë rreth 344 banorë në një km², Rahoveci me 328 b/km², Celina me 333 b/km², etj. Vendbanimet me shkallë më të vogël të dendësisë së popullsisë janë: Sarosh (1 b/km²), Hoça e Madhe (9

[34] Agjencia e Statistikave të Kosovës, Popullsia Sipas Gjinisë, Etnicitetit Dhe Vendbanimit, Prishtinë, 2011


[35] ASK

b/km²), Bërnjak (9 b/km²). Shtimi natyror i popullsisë së Komunës së Rahovecit është se në tërë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore ishte faktor primar i rritjes së përgjithshme të numrit të popullsisë. Në periudhën e pasluftës, krahas shkallës së lartë të natalitetit, edhe mortaliteti ishte mjaft i lartë për shkak të mortalitetit të lartë infantil, si rezultat i nivelit të ulët të zhvillimit. Shkalla e natalitetit në komunën e Rahovecit është 14.1 promil apo 1.41%. Shkalla e mortalitetit është 1.9 promil apo 0.49%. Në bazë të këtyre shkalleve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 1.9 promilë apo 1.91%.

3.1.5. SHTIMI NATYROR I POPULLSISË

Veçori themelore e popullsisë së Komunës së Rahovecit është se shtimi natyror në tërë periudhën e pas Luftës së Dytë Botërore ishte faktor primar i rritjes së përgjithshme të numrit të popullsisë. Në periudhën e pasluftës, krahas shkallës së lartë të natalitetit, edhe mortaliteti ishte mjaft i lartë për shkak të mortalitetit të lartë infantil, si rezultat I nivelit të ulët të zhvillimit social e mjekësor.

Gjatë periudhës 1971 – 1981, krahas rënies së natalitetit, bie dukshëm edhe mortaliteti e me këtë zvogëlohet edhe shtimi natyror i popullsisë. Ndërsa, krahasuar me tri vitet e fundit 2017, 2018 dhe 2019 në komunën e Rahovecit në total janë shënuar 2665 lindje dhe 891 vdekje . Bazuar në këto të dhëna është llogaritur shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror në promilë dhe në përqindje për komunën e Rahovecit.



Grafikoni 5 Shtimi natyror i popullsisë (ASK 2020)

Ndërsa bazuar vetëm në vitin e fundit 2019, siç shihet edhe nga grafiku, shkalla e natalitetit, mortalitetit dhe shtimit natyror është në rënie. Nataliteti është 14.1 promilë apo 1.41%. Shkalla e mortalitetit është 4.9 promilë apo 0.49%. Në bazë të këtyre shkallëve të natalitetit dhe mortalitetit del se shtimi natyror i popullsisë në komunë është 9.1 promilë apo 10.91%.

Migrimet e popullsisë sot paraqesin një problem shumë dimensional hapësinor, demografik, ekonomik, social dhe politik, ndërsa i nxisin një varg faktorësh të ndërlikuar dhe shpeshherë reciprokisht të lidhur e të kushtëzuar[36]. Sipas vlerësimeve të ndryshme mund të thuhet se ka migrime të theksuar kryesisht nga viset me të thella rurale drejt qendrave urbane. Mirë po duhet theksuar se kemi të bëjmë edhe me migrimet jashtë vendit. Shkaqet qe i kanë shtyrë këto migrime janë të natyrave të ndryshme ekonomike-sociale, punësimi, sociale, familja, etj.

[36] Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008. fq. 255

Në vitin 2018 është vlerësuar se 8,967 personat ndërruan vendbanimin (komunën) e tyre kurse 6,762 migruan brenda Kosovës ndërsa numri migrimet ishte dukshëm me i lartë ku 28,164 persona migruan nga Kosova. Bilanci i migrimit ndërkombëtarë (migrimi neto) në Kosovë për vitin 2018 ishte -21,402, ndërsa popullsia e Kosovës gjatë vitit 2018 është rritur për 18,562 banorë apo rritje vjetore prej 1,02%. Popullsia e Kosovës për periudhën 01 janar -31 dhjetor 2018 vlerësohet të jenë 1,795,666 banorë rezident. Rahoveci si komunë bënë pjesë në pesë komunat e para, për numri i emigranteve me gjithsej 1,696 banorë të emigruar, numri i emigrimeve është mjaftë i ultë vetëm 102 banorë. Bilanci i migrimeve të përgjithshëm në komune të Rahovecit 50%, po ashtu edhe migrimi ndërkombëtar janë 40%, migrimet kombëtare 10%[37] Për kundër shtimit natyror prej 632 banorë, si pasojë e migrimeve Rahoveci ka një zvogëlim të popullsisë prej -1,079 personave në raporte me vlerësimin e fundit 2022.


Rahovec	Gjermani	Zvicër	Itali	Austri	Suedi	Amerikë	Francë	Angli	Belgjikë	Slloveni	Të tjerë
Gjithsej	3,879	4,615	806	1,396	158	97	166	64	70	305	685
Meshkuj	2,242	2,708	529	751	90	56	100	44	45	225	407
Femra	1,637	1,907	277	645	68	41	66	20	25	80	278
%	20.25	22.94	7.26	5.61	5.14	3.53	3.25	2.79	2.07	1.78	10.38

Tabela 160 Grup moshat migrimeve sipas gjinisë dhe vendeve ku kanë migruar banorët e Komunës (ASK, 2014)

Marrë parasysh të dhënat e ASK-së e vitit 2014 për migrimin e banorëve të Komunës së Rahovecit, gjatë këtij viti në Komunë jetonin Gjithsej 58,241 banorë rezident, gjersa 12,241 banorë shtesë jetonin jashtë shtetit, që rezulton se 17.37% e popullsisë jetojnë jashtë vendit. Bazuar në këto të dhëna vlerësohet që numri i përgjithshëm i banorëve, rezident dhe jo-rezident, rezulton të jetë 65,011.

	0-4	5-9	10-14	15-19	20-24	25-29	30-34	35-39	40-44	45-49	50-54	55-59	60-64	65-69	70-74	75-79	80+
Nr.	695	720	794	942	1,318	1,605	1,631	1,398	1,095	729	409	289	183	75	19	9	2
%	1.32	1.28	1.41	1.67	2.34	2.85	2.90	2.48	1.94	1.29	0.72	0.51	0.32	0.13	0.03	0.01	0.003

Tabela 161 Persona të cilët jetojnë jashtë Kosovës sipas komunës së lindjes dhe grup moshës, 2014



Grafikoni 6 Arsyeja kryesore që kanë migruar jashtë vendit

Duke i analizuar përqindjet e emigrantëve themi se shumica e imigrantëve kanë migruar për bashkime familjar 79% , ndërsa për të përfunduar trajnime apo arsim është 5%, ndërsa të tjera kemi si ikja nga lufta 3%, punësime 3% , të tjera janë 10%.

[37] ASK

3.1.6. EKONOMITË FAMILJARE

Një ndër karakteristikat e veçanta të zhvillimit demografik dhe shoqëror të Kosovës janë edhe numri, madhësia mesatare dhe përbërja e ekonomive familjare, të cilat janë të kushtëzuara nga ndikimi i faktorëve ekonomik, social, demografik, etj.[38] Siç dihet, ekzistojnë dallime sipas komunave në Kosovë sa i përket madhësisë së familjes. Komuna e Rahovecit kryesisht karakterizohet me numër të madh të anëtareve të familjes, që është karakteristikë për vise të pa zhvilluara rurale. Në bazë të të dhënave dhe vlerësimeve për numrin e popullsisë dhe ekonomive familjare në komunën e Rahovecit, del se mesatarja e madhësisë së familjes është 7.7 anëtar. Numri mesatar i anëtarëve për ekonomi familjare në Kosovë është 5.9 anëtar. Gjithsej 8,221 ekonomi familjare janë në komunën e Rahovecit (2011, ASK).

	1948	1953	1961	1971	1981	1991	2011
Bellacërkë (Fortesë)	89	94	105	113	178	210	318
Bërnjakë	4	9	5	3	3	7	5
Bratatin	19	21	24	28	27	37	52
Brestoc	62	68	70	84	114	151	187
Celinë	57	62	76	88	116	160	245
Çifllak	33	66	67	62	76	115	164
Dabidol	40	42	43	41	38	52	91
Dejnë	83	92	102	93	110	157	205
Drenoc	71	72	85	84	103	155	212
Gexhe	41	49	56	45	42	53	88
Hoçë e Madhe	179	194	223	236	251	247	27
Hoçë e Vogël	79	86	103	93	116	131	168
Kaznik	23	25	27	33	36	44	22
Kramovik	51	47	50	66	74	105	130
Krushë e Madhe	130	171	214	241	295	398	629
Mrasor	13	7	8	11	17	20	28
Nagavc	29	33	37	44	59	77	110
Nashpall	7	11	11	11	9	19	37
Opterush	129	132	144	149	180	226	249
Pastaselë	39	40	51	58	70	93	127
Pataqan i Epërm	27	15	18	25	24	33	78
Pataqan i Poshtëm	31	38	43	41	57	72	139
Petkoviq	65	36	41	50	44	62	85
Polluzhë	36	38	37	43	54	70	91
Radostë (Malësi e Vogël)	89	94	122	130	136	175	300
Rahovec	960	1,072	1,214	1,556	2,032	2,971	2,840
Ratkoc	150	164	227	240	251	342	526
Reti e Poshtme	:	:	:	:	:	:	36
Retijë	85	78	89	96	118	143	107
Sapniq	40	43	46	53	63	82	134
Sarosh	10	12	12	3	1	8	1
Senoc	31	31	39	38	45	65	90
Vrajakë	21	28	38	37	41	57	97
Xërxë	101	109	122	160	214	331	439
Zatriq	64	67	70	67	97	99	55
Zaqishtë	83	91	94	109	133	130	109

[38] Hivzi Islami, Studime Demografike, 100 vjet të zhvillimit demografik të Kosovës, Prishtinë 2008.

RAHOVEC	2,971	3,237	3,713	4,231	5,224	7,097	8,221

Tabela 162 Popullsia dhe ekonomitë familjare sipas vendbanimeve në komunën e Rahovecit, (ASK 1948-2011) Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës 2011

Trendet dhe parashikimet demografike

Shikuar në tërësi, në bazë të numrave absolut të banorëve, mund të thuhet që komuna e Rahovecit në vazhdimësi ka pasur rritje demografike deri në vitin e fundit. Në vitin e fundit të vlerësimit (ASK 2019) të popullsisë së Kosovës del se komuna e Rahovecit ka numrin e popullsisë 56,414 banorë. Krahasuar me vitin paraprak (në vitin 2018 kishte 58,023 banorë) rezulton të ketë një zvogëlim të numrit të përgjithshëm të popullsisë për 1,609b. Por nëse i krahasojmë në periudha gati dhjetëvjeçare, zvogëlimi i popullatës është me i vogël, për 518b. Në vitin 2011 komuna kishte 56,208 banorë, me strukturë gjinore të baraspeshuar. Struktura arsimore e popullsisë është në vlerat mesatare të Kosovës, ose edhe më e lartë siç është rasti me arsimin e mesëm të lartë, atë të lartë dhe universitar. Dendësia më e lartë e popullsisë paraqitet në vendbanimin Krushë e Madhe me 447 banorë në km², kjo për shkak se ky vendbanim ka një sipërfaqe prej 10 km². Ndërsa më e ulëta është në vendbanimet Reti e Poshtme dhe Sarosh ku arrin 1b/km².

Gjatë vlerësimit të popullsisë për komunën e Rahovecit deri në vitin 2030 janë llogaritur dy komponentët themelore që ndikojnë drejtpërdrejtë në rritjen demografike siç janë: shtimi natyror dhe migrimi. Sipas të dhënave për numrin e lindjeve dhe të vdekjeve për vitin 2020 në komunën e Rahovecit është llogaritur edhe shkalla e shtimit natyror që është 8.3 promil apo 0.83 për qind. Sipas të dhënave nga ASK për vitin 2014, kjo komunë kishte bilanc negativ të migrimit ndërkombëtar me -14.7 në 1,000 banorë. Gjithashtu, komuna e Rahovecit ka bilanc negative në migrimin e brendshëm me -4 në 1,000 banorë. Nëse llogaritet bilanci migrues kombëtar dhe ndërkombëtar së bashku, atëherë kjo komunë ka një bilanc migrues negativ me -18.7 apo shprehur në përqindje kemi -1.9 përqind.

Viti	1981	1991	2011	2020	2022	2030
Popullësia rezidente	46,459	59,877	56,208	57,047[39]	55,391[40]	53,225
Popullësia rezidente dhe jo-rezidente	55,750	71,852	67,449	68,456	65,011	67,553

Tabela 163 Parashikimet e popullsisë 2020 – 2030 Burimi: Për vitin 1981 – 2011 janë të dhëna të regjistrimit të popullsisë, ASK; për vitin 2030 bëhet parashikime.

Në projeksionet e popullsisë së përgjithshme janë marrë për objekt shqyrtimi dhe analize e popullsisë rezidente dhe jo rezidente të Komunës së Rahovecit, të shtjelluara si më lartë. Nga analiza dhe parashikimet e popullsisë, vlerësohet se popullsia e Komunës së Rahovecit në vitin 2030, do të ketë rënie të numrit të banorëve rezident në 53,225, gjersa rritje të numrit të popullsisë së përgjithshme, rezidentë dhe jo-rezidentë në 67,553.

Viti	1981	1991	2011	2022	2030
Ekonomitë familjare	5,224	7,097	8,221	8,316	8,413

Tabela 164 Numri i ekonomive familjare - vlerësimi i përgjithshëm (me diasporën) për vitin 2020 dhe parashikimet deri në vitin 2030. Burimi: Për vitin 1981 – 2011 janë të dhëna të regjistrimit të popullsisë, ASK

Në projeksionet e popullsisë së përgjithshme janë marrë për objekt shqyrtimi dhe analize e numrit të ekonomive familjare të Komunës së Rahovecit, të shtjelluara si më lartë. Nga analiza dhe parashikimet e numrit të ekonomive familjare, vlerësohet që në Komunën e Rahovecit numri i ekonomive familjare do të shtohet për 97 ekonomi familjare nga 8,316 sa janë tani në 8,413 në vitin 2030.

Pa=Po x [(Sn + Sm) x V/100] + 1

Shpjegimet e simboleve:

[39] VLERËSIM Popullsia e Kosovës (31 dhjetor 2020)

[40] VLERËSIM Popullsia e Kosovës (31 dhjetor 2021)

- P_a = parashikimi i popullsisë për vitin 2030
- P_o= vlerësimi i popullsisë për vitin 2020
- S_n = shkalla vjetore e shtimit natyror
- S_m= shtimi vjetorë nga migrimi
- V= vitet e llogaritura deri në vitin 2030

Kështu, parashikimi i numrit të popullsisë për komunën së Rahovecit për vitin 2030 është:

- Pa=Po x [(Sn + Sm) x V/100 + 1]
- Pa= 56,576 x [(0.83 – 1.9) x10/100 + 1]
- =56,576 x (-1.07) x10/100 + 1]
- =56,576 x 0.89 = 53,225 banorë

Sipas kësaj llogaritje, popullsia në komunën e Rahovecit deri në vitin 2030 do të shënojë rënie.

Shikuar në tërësi, në bazë të numrave absolut të banorëve, mund të thuhet që komuna e Rahovecit në vazhdimësi ka pasur rritje demografike deri në vitin e fundit. Në vitin e fundit të vlerësimit (ASK 2022) të popullsisë së Kosovës del se komuna e Rahovecit në vitin 2021 kishte 55,391 banorë rezident. Krahasuar me vitin paraprak (në vitin 2020 kishte 57,047 banorë rezident) rezulton të ketë një zvogëlim të numrit të përgjithshëm të popullsisë për 1,656 banorë. Por nëse i krahasojmë në periudha gati dhjetëvjeçare, zvogëlimi i popullatës është më i vogël për 2,254 banorë. Në vitin 2011 komuna kishte 56,208 banorë, me strukturë gjinore të baraspeshuar. Struktura arsimore e popullsisë është në vlerat mesatare të Kosovës, ose edhe më e lartë siç është rasti me arsimin e mesëm të lartë, atë të lartë dhe universitar. Dendësia më e lartë e popullsisë paraqitet në vendbanimin Krushë e Madhe me 447 banorë në km², kjo për shkak se ky vendbanim ka një sipërfaqe prej 10 km². Ndërsa më e ulëta është në vendbanimet Reti e Poshtme dhe Sarosh ku arrin 1b/km².

SWOT Analiza

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Popullsia me moshë mesatare të re Popullsia me moshë ekonomikisht aktive Popullsia relativisht mirë e arsimuar, e orientuar drejt vlerave arsimore	Papunësia e lartë Shkalla e varfërisë Shenja të rënies në trendin e rritjes së popullsisë Aktivitete jo të mjaftueshme socio-kulturore Migrimi
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Programe speciale-profesionale për të papunët sipas kërkesave të tregut, Zgjerimi i edukimit para fillor në të gjitha shkollat fillore Dërgesat e bashkatdhetarëve (remitencat)	Kriza ekonomike Dukuritë negative në shoqëri Largimi i popullsisë ekonomikisht aktive jashtë vendit Largimi i fuqisë punëtore të kualifikuar jashtë vendit

SFIDAT KRYESORE TËIDENTIFIKUARA
Rritja e nivelit të punësimit Ulja e varfërisë Përfshirja e të rinjve në sferën socio-kulturore

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Përkrahja e të rinjve dhe femrave në zhvillimin e aftësive për punësim Adaptimi i kurrikulave arsimore sipas potencialeve zhvillimore lokale Vlerësimi i kapaciteteve njerëzore dhe aftësimi sipas kërkesave në tregun e punës

3.2. ZHVILLIMI EKONOMIK

3.2.1. EKONOMITË FAMILJARE

Në vitin 1948 pas qytetit të Rahovecit i cili merr pjesë me 5,600 banorë, vendbanimi Krusha e Madhe zënë vendin e dytë me 1,235 banorë, ndërsa vendin e fundit vendbanimi Bërnjak me 13 banorë. Në vitin 1991 në krahasim me vitin 1981 rritjen me të madhe të numrit të popullsisë e kishte vendbanimi Rahovec me 5,162 banorë, ndërsa rënie nuk pësoi asnjë vendbanim.

1948	1953	1961	1971	1981	1991	2008
2971	3237	3713	4231	5224	7097	7624

Tabela 165 Numri i ekonomive familjare në Rahovec ndër vite

Sot komuna e Rahovecit ka rreth 3000 ekonomi familjare. Arsyeja e këtij numri qëndron në faktor të ndryshëm si rënia e natalitetit, emigrimi, rritja e standardit jetësor, etj.

3.2.2. BIZNESET

Karakteristikat e popullsisë, fuqisë punëtore dhe bazës ekonomike të komunës së Rahovecit luajnë një rol të madh në zhvillimin ekonomik. Rahoveci është me fat që ka biznese të mëdha dhe partnerë të rëndësishëm që punojnë së bashku për të forcuar zhvillimin ekonomik brenda komunitetit.

Tre industritë kryesore të komunës së Rahovecit janë: prodhimtaria, tregtia me shumicë dhe pakicë si dhe shërbimet.

Sektori i tregtisë me shumicë përfshin ndërmarrjet e angazhuara në tregtimin e mallrave me shumicë, përgjithësisht pa transformim të shërbimit, që ofrojnë shërbime të atypëratyshme të shitjen e mallrave. Mallrat e përfshira në këtë sektor përfshijnë prodhimet e bujqësisë, prodhimit industriale të caktuara, si dhe shërbime. Numri i bizneseve të reja në komunën e Rahovecit çdo vit ka shkuar duke u rritur, me një shpërndarje të llojit të veprimtarive.

Numri i bizneseve sot në komunën e Rahovecit është afër 2,000 të tillë.


Në përgjithësi, komuna e Rahovecit gëzon një masë suksesi në lidhje me zhvillimin ekonomik. Ashtu si të gjitha komunitetet urbane dhe rurale, ka sfida, por këndvështrimi ekonomik i Rahovecit është ndikuar pozitivisht vitet e fundit edhe përmes turizmit dhe fabrikave lokale të verërave. Një nga sfidat e komunës është gjetja e një ekuilibri midis tërheqjes së një shumëllojshmërie të industrisë dhe prodhimit, duke mbrojtur gjithashtu zonat e ndjeshme mjedisore. Revitalizimi i pronave të braktisura ose të pashfrytëzuara brenda kufijve të qytetit është një fushë për përmirësim.

3.2.3. PUNËSIMI DHE PAPUNËSIA

Forca e punës është shtytësi prapa ekonomisë së komunës së Rahovecit. Përderisa popullsia në moshë pune në Komunën e Rahovecit sipas statistikave numëron 36,984 individë në vitin 2021, të papunë janë 1,043 persona, 47.0% femra dhe 52.9% meshkuj.

Sipas disa të gjeturave nga një hulumtim, mungesa e kualifikimit të punëtorëve është njëra nga sfidat kryesore të papunësisë në Rahovec, por mungon edhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe bizneseve.

Vendet më të kërkuara të punës në vitin e kaluar ishin ndërtimtarët, shoferët dhe arkëtarët, ndërsa profesionet më të kërkuara në të ardhmen parashihet të jenë menaxherët, teknologët ushqimor e kontabilistët.



Harta 32 Zonat me potencial turistik

3.3. KAPACITETET FINANCIARE TË KOMUNËS RAHOVEC

3.3.1. PERFORMANSA NË TË KALUARËN

Gjatë analizimit të kapaciteteve investive të kaluara të komunës së Rahovecit janë konsultuar zyrtar përkatës komunal. Kishte shumë çështje në lidhje me raportet e auditorit, që shkaktuan probleme dhe çështje në lidhje me matjen e saktë dhe raportimin e të hyrave vetanake nga komunat. Tjetër, për shkak të faktit se kompanitë kontraktuese për auditim janë ndërruar më së shumti gjatë kësaj kohe, ka mospërputhje në mes të raporteve të auditorit për të njëjtën komunë për vite financiare të ndryshme, duke përfshirë edhe rastet kur totalet e ndryshme të së kaluarës janë raportuar si të krahasuara me raportet origjinale nga viti financiar i veçantë.

Kategoria ekonomike:	Buxheti i shpenzuar - viti:			
	2018	2019	2020	2021
Rroga dhe paga:	7,226,131.22	7,330,406.30	7,716,938.32	7,602,730.06
Mallëra dhe shërbime:	975,105.46	1,352,072.18	1,664,862.25	1,721,163.89

Shpenzime komunale:	248,822.91	246,469.32	263,903.66	280,322.36
Subvencione dhe transfere:	171,932.00	1,216,728.26	320,532.48	476,200.00
Shpenzime kapitale:	4,442,957.18	4,542,925.76	5,163,679.35	4,961,170.17
Gjithsej:	13,064,948.77	14,688,601.82	15,129,916.06	15,041,586.48

Tabela 166 Buxheti (€) i shpenzuar nëpër vite

Siç mund të shihet nga të dhënat, gjatë viteve 2018-2021 ka pasur një ngritje mesatare prej 5% të buxhetit shpenzuar nëpër vite, më saktësisht prej +12% (2019), +3% (2020) dhe -1% (2021).

Gjatë analizimit të trendeve në të kaluarën të të hyrave vetanake në komunën e Rahovecit, mund të vërejmë si në vijim grupet kryesore të të hyrave vetanake.


Komuna e Rahovecit ka shënuar një rritje në gjenerimin e të hyrave vetanake prej +13% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018, prej +7% në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, në vitin 2021 të hyrat vetanake të gjeneruara janë rritur për +7% krahasuar me vitin 2020.


Kategoria e të hyrave vetanake:	Të hyrat - viti:			
	2018	2019	2020	2021
Tatimi në pronë:	419,493.69	459,286.37	456,977.38	577,233.31
Regjistrimi i automjeteve:	88,910.00	90,850.00	90,801.00	100,646.00
Lejet e ndërtimit:	63.00	174.00	38,833.07	42,441.31
Regjistrimi i trashëgimisë:	24,975.00	25,318.00	22,289.00	27,140.00
Ndërrim i destinimit të tokës:	1,263.00	11,829.90	937.18	21.00
Dokumentet e gjendjes civile:	81,924.00	80,918.00	60,740.00	74,724.00
Veprimtaritë afariste:	108,692.00	85,650.50	91,950.79	78,686.62
Shfrytëzimi i pronës publike:	14,935.51	13,560.61	4,452.88	1,911.85
Participimet në Arsim dhe Shëndetësi:	44,274.20	49,360.70	52,460.00	85,206.50
Tjera:	375,650.00	491,529.51	576,226.25	509,861.93
Gjithsej:	1,160,180.40	1,308,477.59	1,395,667.55	1,497,872.52


Tabela 167 Mbledhja (€) e të hyrave vetanake në të kaluarën 2018-2021

Krahasuar me buxhetin e përgjithshëm vjetor, pjesëmarrja të të hyrat vetanake të gjeneruara gjatë vitit financiar 2018 ishin 7%, 2019 ishin 8%, në vitin 2020 ishin 8%, në vitin 2021 ishin 9% që përbëjnë një mesatare 4 vjeçare prej 8 % të buxhetit të përgjithshëm vjetor.

Siç mund të shihet nga të dhënat, të hyrat vetanake janë pjesë e buxhetit të Komunës së Rahovecit.







Të hyrat nga donacionet e jashtme ka pasur ndryshime të mëdha gjatë viteve, në vitin 2018 me shumën rreth 100,000.00 Euro, rreth 65,000.00 Euro në vitin 2019, rreth 2,100.00 Euro në vitin 2020 dhe rreth 411,000.00 Euro. Të hyrat nga donacionet e brendshme nuk ka pasur gjatë periudhës 2019-2021. Pra, në total pjesëmarrja e donacioneve të jashtme dhe të brendshme ishin në rënie gjatë viteve, -35% në vitin 2019, -97% në vitin 2020 dhe +19264% në vitin 2021 (rritje nga 2,123.32 € në 2020 në 411,164.98 € në 2021 – donacionet janë të hyra që pësojnë ndryshime të mëdha gjatë viteve); Në aspektin e pjesëmarrjes në krahasim të të hyrave vetanake ishte 8.6% në 2018, 5% në 2019, 0.2% në vitin 2020 dhe 27.4% në vitin 2021.

Niveli i pjesëmarrjes i të hyrave tjera në të hyrat vetanake të përgjithshme në vitet 2018-2021 ishte afro 42.1% dhe paraqet kontribuuesin më të madh nga të gjitha kategoritë tjera të të hyrave vetanake. Gjatë analizimit të kategorive specifike të të hyrave vetanake, ekziston një rritje prej 30.8% në të hyrat nga të hyrat tjera në vitin 2019 në krahasim me vitin 2018, një rritje prej 17.2% në të hyrat nga të hyrat tjera në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019, dhe në vitin 2021, të hyrat nga kjo kategori ka shënuar një rënie prej -11.5%.

Niveli i pjesëmarrjes i tatimit në pronë në të hyrat vetanake të përgjithshme në vitet 2018-2021 ishte afro 41.2% dhe paraqet kontribuuesin e dyte më të madh nga të gjitha kategoritë tjera të të hyrave vetanake.

Kategoria e dytë e lartë e hyrave vetanake janë nga tatimi në pronë, e cila në vitin 2018 ishte 36.2%%, në vitin 2019 ishte 39.6%, në vitin 2020 ishte 39.4% dhe në vitin 2021 ishte 48.8% e të hyrave vetanake të përgjithshme.

3.3.2. SUPOZIMET PARASHIKUESE

Këshilluesi ka marr supozimet në vijim kur ka llogaritur të hyrat vetanake për periudhën 2023-2031:

Tatimi në pronë

Gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021; në 2019 ka rritje prej 9.5%, në vitin 2020 ka përsëri rënie prej -0.5% dhe në vitin 202 ka përsëri rritje prej +26.3%. Pra, parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje mesatare prej 4% prej 2022 deri 2024 dhe 3% në vitin 2025 dhe çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
606,095	636,400	668,220	701,631	736,712	773,548	812,225	852,836	895,478

Tabela 168 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga tatimi në pronë për vitet e ardhme

Të hyrat nga regjistrimi i automjeteve

Supozimet parashikuese e të hyrave nga taksat për regjistrimin e veturave bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë tre viteve të kaluara 2018 – 2021, ku në 2019 ka rritje prej 2.2%, në vitin 2020 ka rrënje prej -0.1% dhe në vitin 2021 ka rritje prej +10.8%. Pra, parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje mesatare prej 4% prej 2022 deri 2024 dhe 3% në vitin 2025 dhe çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
104,672	108,859	113,213	117,742	122,451	127,349	132,443	137,741	143,251

Tabela 169 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga regjistrimi i automjeteve për vitet në vijim

Të hyrat nga lejet e ndërtimit

Gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021, ku në 2019 ka rritje prej +176.2%, në vitin 2020 ka rritje prej +22217.9% dhe në vitin 2021 ka rritje prej +9.3%.

Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje në 2022 prej +7% dhe pastaj një rrënje në +6% në vitin 2023, 5% në vitin 2024 dhe 3% në vitin 2025 dhe çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
45,412	48,591	51,992	55,632	59,526	63,693	68,151	72,922	78,027

Tabela 170 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga lejet ndërtimore për vitet në vijim

Të hyrat nga regjistrimi i trashëgimisë

Supozimet parashikuese e të hyrave nga taksa për regjistrimin e trashëgimisë bazohen në mesataren e përgjithshme të gjeneruara gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021, ku në 2019 ka rritje prej +4%, në vitin 2020 ka rritje prej +1.4% dhe në vitin 2021 ka rrënje prej -12%. Pra, parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje në 2022 prej +7% dhe pastaj një rrënje në +6% në vitin 2023, 5% në vitin 2024 dhe 3% në vitin 2025 dhe çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
29,040	31,073	33,248	35,575	38,065	40,730	43,581	46,632	49,896

Tabela 171 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga regjistrimi i trashëgimisë për vitet në vijim

Të hyrat nga ndërrimi i destinimit të tokës

Gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021, në 2019 ka pasur një rritje prej +216%, në vitin 2020 ka pasur rritje prej +836.7% dhe në vitin 2021 ka pasur rënie prej -92.1%. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të

jetë në rritje në 2022 prej +7% dhe pastaj një rënie në +6% në vitin 2023, 5% në vitin 2024 dhe 3% në vitin 2025 dhe çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
22	24	26	28	29	32	34	36	39

Tabela 172 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga ndërrimi i destinimit të tokës për vitet në vijim

Të hyrat nga dokumentet e gjendjes civile

Gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021, në 2019 ka zvogëlim prej -1.2% në vitin 2020 ka zvogëlim prej -24.9% dhe në vitin 2021 ka rritje prej +23.0%. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje në 2022 prej +1% çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
75,471	76,226	76,988	77,758	78,536	79,321	80,114	80,915	81,725

Tabela 173 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga dokumentet e gjendjes civile për vitet në vijim

Tatimet në veprimtaritë afariste

Gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021, në 2019 ka pasur rënie prej -21.2%, në vitin 2020 ka pasur një rritje prej +7.4% dhe në vitin 2021 ka pasur një zvogëlim prej -14.4%. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje në 2022 prej +1% çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
79,473	80,268	81,071	81,882	82,700	83,527	84,363	85,206	86,058

Tabela 174 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga tatimet e veprimtarive afariste për vitet në vijim

Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës publike

Gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021, në 2019 ka pasur një rënie prej -9.2% dhe në vitin 2020 ka zvogëlim prej -67.2% dhe në vitin 2021 ka zvogëlim prej -57.1%. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje në 2022 prej +1% çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
1,931	1,950	1,970	1,989	2,009	2,029	2,050	2,070	2,091

Tabela 175 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga shfrytëzimi i pronës publike për vitet në vijim

Të hyrat nga participimi në arsim dhe shendetësi

Gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021, në 2019 ka pasur rritje prej +11.5%, në vitin 2020 ka rritje prej +6.3% dhe në vitin 2021 ka rritje prej +62.4%. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje në 2022 dhe 2023 prej +6% dhe pastaj një rënie në +5% në vitin 2025, dhe 3% në vitin 2026 dhe çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
90,319	95,738	101,482	107,571	114,026	120,867	128,119	135,806	143,955

Tabela 176 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga Drejtoria e Shëndetësisë për vitet në vijim

Të hyrat nga ngarkesat tjera

Gjatë katër viteve të kaluara 2018 – 2021, ku në 2019 ka rritje prej +30.8%, në vitin 2020 ka rritje prej +17.2% dhe në vitin 2021 ka zvogëlim prej -11.5%. Parashikimi i gjenerimit vjetor supozohet të jetë në rritje në 2022 dhe 2023 prej +5% dhe pastaj një rrënje në +4% në vitin 2025, dhe 3% në vitin 2026 dhe çdo vjet në vijim deri në vitin 2030.

2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
535,355	562,123	590,229	619,740	650,727	683,264	717,427	753,298	790,963

Tabela 177 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) nga ngarkesat tjera për vitet në vijim

Grantet

Supozimet parashikuese e të hyrave nga donacione të jashtme dhe të brendshme janë mjaftë vështira të parashikohen. Nga e kaluara mund të vërehet që komuna e Rahovecit ka qenë e suksesshme ne fitimin e granteve të ndryshme, por gjithsesi këto fonde janë të paparashikueshme dhe mund të shtohen apo bijën ne mënyre drastike. Supozimi është që Komuna e Rahovecit do mund të arkëton 100,000.00 € në vitin 2022 dhe pastaj çdo vit me rritje prej 1% deri në vitin 2030.


2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
100,000	101,000	102,010	103,030	104,060	105,101	106,152	107,214	108,286

Tabela 178 Parashikimi i të hyrave vetanake (€) grantet për vitet në vijim

Kategoria e të hyrave vetanake:	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Tatimi në pronë:	419,494	459,286	456,977	577,233	606,095	630,339	655,552	675,219	695,475	716,340	737,830	759,965	782,764
Regjistrimi i automjeteve:	88,910	90,850	90,801	100,646	104,672	108,859	113,213	116,609	120,108	123,711	127,422	131,245	135,182
Lejet e ndërtimit:	63	174	38,833	42,441	45,412	48,137	50,544	52,060	53,622	55,231	56,887	58,594	60,352
Regjistrimi i trashëgimisë:	24,975	25,318	22,289	27,140	29,040	30,782	32,321	33,291	34,290	35,318	36,378	37,469	38,593
Ndërrim i destinimit të tokës:	1,263	11,830	937	21	22	24	25	26	27	27	28	29	30
Dokumentet e gjendjes civile:	81,924	80,918	60,740	74,724	75,471	76,226	76,988	77,758	78,536	79,321	80,114	80,915	81,725
Veprimtaritë afariste:	108,692	85,651	91,951	78,687	79,473	80,268	81,071	81,882	82,700	83,527	84,363	85,206	86,058
Shfrytëzimi i pronës publike:	14,936	13,561	4,453	1,912	1,931	1,950	1,970	1,989	2,009	2,029	2,050	2,070	2,091
Participimet në Arsim dhe Shëndetësi:	44,274	49,361	52,460	85,207	90,319	95,738	100,525	103,541	106,647	109,846	113,142	116,536	120,032
Tjera:	375,650	491,530	576,226	509,862	535,355	562,123	584,608	602,146	620,210	638,817	657,981	677,721	698,052
Gjithsej:	1,160,180	1,308,478	1,395,668	1,497,873	1,567,791	1,634,446	1,696,817	1,744,521	1,793,624	1,844,168	1,896,195	1,949,751	2,004,879


Siç mund të shihet nga tabela e parashikimit të të hyrave vetanake , THV për komunën e Rahovecit mund të rriten deri në ~16.1M Euro në fund të vitit 2030. Kur të shikojmë të hyrat e përgjithshme vetanake qartazi ekziston një trend pozitiv. Kjo rritje mund më mirë të shihet ne tabelën e ardhshme.

Komuna e Rahovecit – THV në të kaluarën dhe të parashikuara nga viti në vit me ndryshimin e përqindjes.




Grantet dhe donacionet kanë kontribuar ne të të hyra tek Komuna e Rahovecit gjatë viteve. Sidoqoftë, duhet të jetë shumë i kujdesshëm në parashikime lidhur me grante dhe donacione sepse Komuna mund te përjetoj një ngritje apo zvogëlim te këtyre fondeve në çdo vit.


Siç mund të shihet nga grafiku më lart, lëvizësit kryesorë të THV gjatë periudhës në vijim mbeten të jenë te hyra tjera dhe tatimi në pronë. Këto janë fushat ku komuna duhet të përpiqet të arrijë ngritje sa i përket të hyrave vetanake nëpërmjet efikasitetit të shtuar në menaxhimin e tyre financiar dhe zbatimin. Rritja e secilës kategori të të hyrave vetanake të parashikuara është siç është paraqitur në grafikun më poshtë :




Të hyrat nga tatimi në pronë vazhdojnë të rriten për shkak të regjistrimit të përmirësuar, menaxhimit të bazës së të dhënave, faturimit të përmirësuar dhe zbatimit më të mirë. Të hyrat nga ky tatim gjithashtu do të ngritën për shkak të rritjes së natyrshme të komunës si dhe rritjes së ekonomisë. Më në fund, gjithashtu mund të llogaritet në mbledhjen e të hyrave të detyrimeve tatimore nga vitet e kaluara, e cila duhet të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me departamentin e tatimit në pronë në Ministrinë e Financave.



Tatimet në biznes kanë një zvogëlim të madh potenciale për shkak të rritjes ekonomike (shkaku pandemisë, Covid-19 ne fillimin te vitit 2020). Potenciali i rritjes po ashtu mund te behet përmes regjistrimit më të mirë, shërbimit të bizneseve dhe zbatimit të përmirësuar. Grumbullimi i shtuar i tatimit të biznesit gjithashtu mund të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi më të mirë me komunat dhe Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (njësia e regjistrimit të biznesit). Më në fund, prania e përmirësuar e zyrtarëve komunalë brenda komunitetit të biznesit dhe zbatimi më i mirë i rregulloreve komunale mund të ndihmojë në përmirësimin e të hyrave nga bizneset.



Të hyrat nga shfrytëzimi i pronës komunale nuk përbëjnë një përqindje të madhe të të hyrave vetanake të përgjithshme, sidoqoftë, me menaxhimin e përmirësuar të aseteve komunale, rritja e të hyrave nga kjo kategori mund të ketë rritje të qëndrueshme.



Të hyrat tjera, që përbëjnë mesatarisht afro 40% të të hyrave vetanake, siç janë gjobat e lëshuara nga gjykatat, policia dhe komuna janë dhe vazhdojnë të jenë kontribuues të mëdhenj të të hyrave vetanake komunale. Komuna duhet të përpiqet të rris pjesëmarrjen në këto tarifa duke rritur kontributin në këtë kategori që vijnë nga gjobat komunale nëpërmjet përmirësimit të efikasitetit të shërbimeve komunale të inspektimit.



3.3.3. Fushat potenciale për intervenim dhe përkrahje

Tatimi në pronë, duke qenë njëri nga kontribuuesit më të mëdhenj, mesatarisht 41% të të hyrave vetanake, është një fushë që duhet të përkrahet. Kjo do t'i mundësojë komunës që të kenë një pasqyrë më të qartë të bazës së tatimit të tatueshëm dhe përmirësimit të politikave të tatimit që ata aplikojnë, si dhe përmirësimin e efikasitetit në zbatim dhe reagimin e komunës në dërgimin e projekteve të investimeve kapitale në zona kadastrale përkatëse që paguajnë tatimin në pronë dhe të promovojë efektin e grumbullimit të përmirësuar në jetën e përditshme të qytetarëve të zonave përkatëse.

Komuna gjithashtu mund të përkrahet në gjenerimin e të hyrave nga bizneset. Kjo mund të bëhet në dy drejtime. Njëra është që ti ndihmojë ata në përmirësimin e regjistrimit të bizneseve dhe klasifikimin dhe si

rezultat të prodhojë politika më të mira tatueshme për bizneset. Gjithashtu, Komuna duhet të përpiqet që të përmirësojë lidhjet në mes të komunave dhe Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë në shkëmbimin e informatave për bizneset e regjistruara dhe funksionimin e tyre aktual. Një bazë e të dhënave të tatimeve të pa grumbulluara mund të krijohet në komunë dhe të freskohet në baza vjetore, kështu që mund të eliminohen bizneset që janë mbyllur, bankrotuar apo që nuk janë aktive, gjersa në të njëjtën kohë mundëson shënjestrim më të mirë të bizneseve ekzistuese, funksionale dhe të suksesshme. Duhet të përdoren politika për kushtëzimin e shërbimeve komunale për bizneset që kanë taksa dhe tatime të pakryera.

Një rekomandim është që komuna të fillojë të vendosë tarifa në rregulloren komunale dhe t'i zbatojë ato në baza të barabarta për të gjitha bizneset dhe ofruesit e hapësirave për reklamim. Grumbullimi i tarifave për shfrytëzimin e pyjeve dhe zbatimi i përmirësuar i këtyre tarifave, i përkrahur nga nivelet më të larta politike për lobim në mënyrë që komuna të menaxhojë tarifat dhe tatimet që vijnë nga shfrytëzimi i pyjeve, mund të rezultojë në një burim të mirë të të hyrave për komunën.

Dhënia me qira e tokës komunale, ndërtesave dhe hapësirave është një burim tjetër i mirë i të hyrave nëse menaxhohet si duhet. Shfrytëzimi i aseteve komunale mund të bëhet më atraktiv nëpërmjet investimeve strategjike, vendimeve dhe politikave stimuluese.

Kompletimi i dokumentacionit të planifikimit hapësinorë, duke përfshirë Hartën Zonale të Komunës dhe Planet Rregulluese të Hollësishme, do t'i lejojë komunës që të inkurajoj zhvillimin, posaçërisht në sektorin e ndërtimtarisë. Kjo do të ndihmonte komunën të rriste të hyrat nga lejet për ndërtim, si dhe shërbimet tjera, duke stimuluar aktivitetin e ndërtimit të ri dhe legalizimin e pronave të paregjistruara dhe pa leje.

Komuna po ashtu duhet të identifikojë me shume donatorë potencial dhe fushave që mund të përfitojnë nga grantet dhe format e tjera të përkrahjes nga donatorët. Kjo përkrahje më tutje mund të përfshijë asistencë dhe aftësim në planifikimin e projekteve, shkrimin e propozimeve, ngritjen e fondeve dhe teknikat për monitorim dhe vlerësim. Kjo do t'i mundësonte komunës të trokiste në grante potenciale dhe në dispozicion dhe kështu të ndihmohej në rritjen e të hyrave vetanake në dispozicion.

Ky raport është përgatitur me informatat që mbulojnë performancën financiare deri në vitin financiar 2021 dhe kjo analizë të freskohet në baza të rregullta dhe të akordohen kur informatat e reja dhe më të detajuara të jenë në dispozicion.

3.3.4. KAPACITETET DHE FORMAT E FINANCIMIT

Ne përgjithësi, K. Rahovecit, nga nevoje për fondeve për realizimin e investimeve kapitale për përmirësimin e infrastrukturës dhe të shërbimeve tjera për qytetarët e Komunës së Rahovecit. Një pjesë e madhe e fondeve priten të sigurohen nga grantet qeveritare.

Sipas ligjit Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, burimet financiare të një komune përbëhen nga

(i) të hyrat vetanake të komunës,
(ii) grantet operative,
(iii) grantet për kompetencat e shtuara,
(iv) transferet për kompetencat e deleguara,
(v) grantet e jashtëzakonshme,
(vi) ndihma financiare nga Republika e Serbisë, dhe
(vii) të hyrat nga huamarrjet e komunës.

Opsionet e financimit të investimeve kapitele për Komunën e Rahovecit janë:

a) **Huamarrje/ borxh nga tregu kombëtar i kapitalit –** Komuna e Rahovecit mund ta përdorë këtë metodë financimit. Huamarrja për komuna rregullohet me ligjin Nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, më saktësisht Neni 30.

b) **Partneritet Publiko Privat –** model investimeve kapitale ku shërbimi për qytetarët në mënyrë të kontratës koncesionare kalon tek sektori privat për një periudhë afatmesme apo afatgjate. Sektori ndërmerr financimin, ndërtimin, menaxhimin e një shërbimi publik për të cilën shfrytëzuesit paguajnë. Nëse Komuna e Rahovecit dëshiron ta ndjek këtë zgjidhje, ka nevojë që t'i shikojë te cilat investime kapitale/shërbime publike mund t'ia lejon t'i siguroj sektori privat. Për këtë duhet të ndjekin hapat e nevojshme sipas ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, ku si pikënisje kërkon kryerjen e fizibilitetit për kryerjen e një shërbimi të tillë nga sektori privat.

c) **Incentiva Private e Financimit –** lloj i Partneritetit Publiko Privat ku sektori privat ka eksperiencë dhe ndërmerr financimin, ndërtimin, menaxhimin e një shërbimi publik, por nuk mund të kërkojnë pagesë tek shfrytëzuesit e shërbimit, kështu që Komuna paguan për atë shërbim në formë të pagesave vjetore tek sektori privat. Nëse Komuna e Rahovecit dëshiron ta ndjekë këtë zgjidhje, ka nevojë që t'i shikojë te cilat investime kapitale/shërbime publike mund t'ia lejon t'i siguroj sektori privat. Për këtë duhet të ndjekin hapat e nevojshme sipas ligjit Nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, ku si pikënisje kërkon kryerjen e fizibilitetit për kryerjen e një shërbimi të tillë nga sektori privat.

d) **Donatorët -** Mbajtja e kultivimi i komunikimit të mirëfilltë me donatorët. Kjo do të thotë një seri aktivitetesh përmes të cilave donatorët mund të shohin përmirësim të dukshëm lidhur me ndihmat të cilat dëshirojnë t'i shpërndajnë. Një komunikim i tillë dhe fleksibilitet në punë ndihmon në sigurimin e mjeteve për investime kapitale. Sa më shumë investime kapitale të suksesshme, ndihmon në zgjerimin e rrjetit të donatorëve me të cilat Komuna e Rahovecit do mund të bashkëpunoj. Sidoqoftë, nevojitet koha për sigurimin e fondeve të tilla dhe Komuna duhet të jetë e angazhuar vazhdimisht në këto lloje të përpjekjeve.

Potencialet natyrore dhe të trashëgimisë kulturore me të cilat disponon komuna e Rahovecit ofrojnë mundësi konkurruese për zhvillimin e një oferte të larmishme turistike dhe tërheqjen e vizitorëve vendas dhe të huaj. Duhet të theksohet se turizmi ka një efekt shumëfishues në ekonomi, sepse kontribuon në mënyrë indirekte në krijimin e të ardhurave të përgjithshme të komunës përmes zhvillimit të sektorëve tjerë si tregtia, bujqësia, transporti dhe ndërtimi.

SWOT Analiza

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Resurset natyrore për bujqësi dhe blegtori Komunë tradicionalisht e pasur me ndërmarrje bujqësore; Traditë shumëvjeçare në kultivimin dhe përpunimin e rrushit dhe verës; Afërsi e Rahovecit/Kosovës me tregun e Evropës; Trashëgimi e pasur kulturore dhe arkeologjike;	Humbje e vullnetit për vazhdimin e aktivitetit për kultivim të bujqësisë; Mungesë e mbështetjes së vazhdueshme financiare për fermerët dhe përpunuesit e prodhimeve bujqësore;
MUNDËSITË	RREZIQET
Mbështetje financiare në ngritjen e kapaciteteve private përpunuese në bujqësi, industri ushqimore; Përdorim i metodave të reja shkencore në rritjen e prodhimtarisë; Plasim i sigurtë në tregun Evropjan i prodhimeve bujqësore, produkteve ushqimore të gatshme, prodhimeve të rrushit; dhe	Degradimi i tokës bujqësore; Mosmbështetje e vazhdueshme nëpërtëritjen e teknologjisë së vjetëruar; Mungesa e strategjisë për gjenerimin e investimeve nga burimet e vendit; Vazhdim i parcializimit të tokës; dhe Mos trajtimi adekuat i mbetjeve që dalin nga Bodrumet e

Partneriteti publik-privat.	Verarisë.

SFIDAT KRYESORE TËIDENTIFIKUARA
Promovimi i potencialeve turistike Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme Stimulimi i prodhimit bujqësor dhe blegtorisë

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Konsolidimi dhe zgjerimi i kapaciteteve lokale bujqësore, vreshtari -verari dhe blegtorale Zgjerimi i gamës së prodhimeve dhe promovimi i tyre. Shqyrtimi i mundësive për zhvillimin e kapaciteteve agro-industriale. Mbrojtja dhe promovimi i potencialeve lokale natyrore dhe kulturore, si dhe zhvillimi i kapaciteteve turistike të ndërlidhura. Zhvillimi dhe konsolidimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

3.3.5. SEKTORI I BUJQËSISË ANALIZA E GJENDJES

Bujqësia është një ndër degët bazë të ekonomisë dhe si e tillë luan rrol të rëndësishëm në zhvillimin e një regjioni apo komune. Komuna e Rahovecit gjendet në pjesën qendrore të Kosovës.

Bujqësia është dega më e rëndësishme e zhvillimit ekonomik i komunës së Rahovecit, por për kundër këtij fakti vërehet një rënie e interesimit për tu angazhuar në këtë veprimtari, përkundër kushteve të favorshme natyrore dhe traditës. Shumica e prodhuesve janë ekonomi bujqësore familjare, dhe vetëm një numër i vogël i prodhuesve janë të organizuar në ndërmarrje bujqësore.

Përkundër potencialit, sektori i bujqësisë përballet me sfida dhe pengesa zhvillimore, një pjesë e të cilave janë potencuar në vazhdim. Barrierat mund të grupohen në produktivitetin e ulët, çmimet e ulëta dhe kosto të larta. Trendi i humbjes së tokës bujqësore, madhësia e kufizuar e parcelave të tokës se punueshme, papunësia e lartë, zhvillimi i pabarabartë ekonomik, si dhe mungesa e shkathtësive profesionale në shfrytëzimin e makinerisë dhe teknologjisë bujqësore paraqet një pengesë kryesore në zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu, edhe blegtoria ballafaqohet me kufizime zhvillimore për tu përballur me kushtet dhe konkurrencën e tregut, për shkak të ekzistimit të fermave të vogla. Me madhësinë e fermës ndërlidhet shumë edhe mundësia e shfrytëzimit të teknologjive të reja, implementimi i teknikave dhe të arriturave të reja shkencore, faktorë që ndikojnë drejtpërdrejtë në zvogëlimin e kostos dhe në shtimin e prodhimit bujqësor.

Aspekt tejet kufizues i bujqësisë është mungesa e shkathtësive profesionale në përgatitjen dhe zbatimin e politikave dhe projekteve në sektor. Për këtë qëllim, Ministria e Bujqësisë ka hartuar strategjinë për këshillime, që koordinon ofrimin e këshillave me institucione dhe akterë në nivel vendi. Strategjia këshilluese ka synuar rritjen e numrit të fermerëve dhe palëve tjera me interes që marrin këshilla për bujqësi dhe zhvillim rural. Nevoja për këshillime dhe përkrahje teknike është e vazhdueshme.

Kjo gjendje e përgjithshme për pasojë ka produktivitetin e ulët meqë nuk ka parakushte për aplikimin e teknologjive të avancuara në sektor:

- Sistemet e ujitjes dhe kullimit janë të vjetërsuara dhe nuk arrijnë të sigurojnë kontroll përkatës të ujit;
- Qasja e dobët e fermerëve në tregje;
- Mungesa e magazinimit dhe ftohjes shtynë prodhuesit vendorë të shesin prodhimet e tyre gjatë, apo menjëherë pas vjeljes me çmime të ulëta;
- Mungesë e zinxhirit industrial prodhues i produkteve blegtorale;
- Përveç inputeve të shtrenjta, shkalla e vogël e operacioneve shkakton kosto të larta prodhimi;

- Sektori i bujqësisë nuk është rentabil sa duhet në mënyrë që të financojë rritjen e ardhshme përbrenda dhe ka qasje të kufizuar në fonde të jashtme.
- Kamata të larta - kreditë komerciale dhe mikrofinanciare nuk mund të përballohen financiarisht;
- Struktura dhe infrastruktura e dobët e fermës, që si pasojë karakterizohet me humbje të tregjeve për prodhime dhe pamjaftueshmëri të resurseve financiare të ndara për përkrahjen e bujqësisë;
- Shfrytëzimi jo adekuat i tokës dhe mungesa e konsolidimit;
- Numri i kufizuar i shoqatave të prodhuesve dhe mungesa e rregulloreve;
- Cilësia e ulët e prodhimeve bujqësore;
- Të hyrave të ulëta në dispozicion të ekonomive shtëpiake;
- Niveli i ulët i edukimit të fermerëve ndërmjet moshës madhore të fermerëve dhe popullatës që jetojnë në viset rurale;

3.3.6. STRUKTURA E FERMËS APO SHFRYTËZIMI RACIONAL I TOKËS

Struktura e përdorimit të tokës dëshmon të jetë pengesa kryesore kur bëhet fjalë për përdorimin e tokës përkundrejt politikave për zhvillim bujqësor në vend. Më pas, ekziston një sektor i polarizuar bujqësor me disa prona të mëdha dhe një sektor të madh të pronave të vogla. Struktura e shpërndarjes së madhësisë ilustrohet me rreth 60% të numrit të fermave që janë më pak se 5 ha dhe të fragmentuara.


Vetëm 9.5% e fermave janë më shumë se 20 ha. Për këtë mund të shtohet se procesi i nënndarjes në trashëgimi po vazhdon. Madhësia mesatare e një ferme për një ekonomi familjare është 2-3 ha tokë bujqësore e punueshme, zakonisht e fragmentuar në 6- 8 parcela kadastrale. Madhësia mesatare e parcelës kadastrale është 0.3 ha[41]

Bazuar në madhësinë e sipërfaqes së tokës së punueshme struktura e fermave klasifikohet në katër kategori kryesore:

- Fermat që kishin madhësi shumë të vogël, më pak se 1 ha përbëjnë 9.9% të fermave dhe kishin sipërfaqe prej 18,519 ha.
- Fermat me madhësi nga 1 deri në më pak se 5 ha kishin pjesëmarrjen prej 50.90%, dhe përfaqësojnë rreth 95,138 ha.
- Fermat me madhësi prej 5 deri në më pak se 20 ha, kishin një përfaqësim prej 29.70% që përfshijnë sipërfaqe prej 55,432ha, dhe

[41] ASK (Agjencioni i statistikave të Kosovës)

- Fermat me madhësi prej 20 e më shumë hektarë merrnin pjesë me 9.5% që përfshinë sipërfaqen prej 17,918 ha.



Grafiku 6. Numri i ekonomive bujqësore sipas sipërfaqes së tokës së punueshme nivel Kosovës, 2018, ASK

Sa i përket numrit të ekonomive bujqësore rreth 31,648 prej tyre, që paraqesin 30.30%, prej gjithsej ekonomive bujqësore, posedojnë ferma me madhësi prej 0 deri më pak se 0.5 ha sipërfaqe të tokës së punueshme. Grupim tjetër më i madh i ekonomive bujqësore paraqitet me madhësi të fermës nga 0.5 deri më pak se 1 dhe 1 deri më pak se 2 që përfshin 44,030. Sa i përket numrit të ekonomive bujqësore rreth 31,648 prej tyre, që paraqesin 30.3%, prej gjithsej ekonomive bujqësore, posedojnë ferma me madhësi prej 0 deri më pak se 0.5 ha sipërfaqe të tokës së punueshme. Grupim tjetër më i madh i ekonomive bujqësore paraqitet me madhësi të fermës nga 0.5 deri më pak se 1 dhe 1 deri më pak se 2 që përfshin 44,030.

3.3.7. PRODHIMI DHE PËRPUNIMI I PRODUKTEVE BUJQËSORE

Bujqësia dhe industria tradicionalisht janë konsideruar si dy sektorë të ndarë, si nga karakteristikat e tyre ashtu edhe nga roli i tyre në rritjen ekonomike. Një ndër sektorët që mund të ndihmojë në nxitjen e zhvillimit socio-ekonomik në vitet e ardhshme vlerësohet të jetë bujqësia dhe industritë e lidhura me agro-përpunimin. Zhvillimit të agro-industrisë i është dhënë vëmendje e veçantë përmes Politikave Programore të zhvillimit, duke e konsideruar si një sektor të industrisë që gjeneron vende pune, ku një numër i madh njerëzish varen drejtpërdrejtë ose në mënyrë indirekte për mirëqenien e tyre. Kjo vlen sidomos për vendin tonë ku në degët tjera të industrisë duhet bëhen shumë investime për revitalizimin e tyre.

Për këtë arsye janë bërë avancime të shumta në teknologjinë e industrisë agro-ushqimore, meqenëse teknologjitë e vjetra nuk kanë mundur të përdoren për shkak të shkatërrimit të tyre gjatë luftës por edhe për arsye të vjetrimit të tyre. Bazuar në të dhënat e ASK-së shohim se, duke filluar nga viti 2012 deri në vitin 2014 mesatarja e pjesëmarrjes së aktiviteteve bujqësore të regjistruara në regjistrin e biznesit ndaj aktiviteteve tjera ishte 7.6%. Filluar nga viti 2015, kemi një rritje prej 9.6%, pasuar me rritje të pjesëmarrjes në 10.4% në vitin 2016. Ndërsa në vitin 2017 kjo pjesëmarrje ishte 8.9%.


Vreshtaria - Vreshtaria në Rahovec është një nga sektorët me potencial për zhvillimit socio–ekonomik të qytetit. Zhvillimi i këtij sektori mundëson shfrytëzim racional të tokës, rritje të punësimit si dhe ruajtje të kulturës dhe traditës së kultivimit të hardhisë së rrushit. Ndër problemet me të cilat përballet zhvillimi i këtij sektori janë: fragmentimi i parcelave të vreshtave, mungesa e sipërfaqeve me kultivarë cilësor, materialit fidanor nga prodhimi vetanak, varieteteve autoktone, sistemeve të mirëfillta të ujitjes, kontrollit të inputeve bujqësore si dhe mungesa e promovimit, marketingut të verës. Duke marr parasysh potencialin e zhvillimit të këtij sektori është e nevojshme që të vazhdoj mbështetja në ngritjen e sipërfaqeve të reja

më rrush të tryezës dhe rrush të verës. Rritja e sipërfaqeve do të rriste prodhimtarinë e kjo do të ndikonte në plotësim të nevojave për konsum dhe do ulte sasinë e rrushit të importuar, sidomos për rrush tryeze ku kemi një shkallë të vetëmjaftueshmërisë më të ulët dhe do të shtonte potencialin prodhues për verëra me cilësi të lartë. Mbështetja duhet të fokusohet edhe në prodhim të materialit fidanor, ku ngritja e sipërfaqeve të reja gradualisht do të përmirësonte shkallën e plotësimit të nevojave vendore për fidane të hardhisë së rrushit. Përveç ngritjes së sipërfaqes së kultivuar me rrush është e rëndësishme për këtë sektor që të krijohet një grup kërkimor-shkencor për krijimin e varieteteve të reja.

Për zhvillim të qëndrueshëm të këtij sektori është e nevojshme konsolidimi i tokave në zonat vreshtare, të ketë drejtime profesionale për vreshtari dhe verëtari në shkollat e mesme profesionale, të rritet në vazhdimësi mbështetja financiare nga niveli qendror por edhe ai lokal, të avancohen shërbimet këshillimore si dhe të organizohen panaire vendore dhe pjesëmarrja në panaire ndërkombëtare dhe vizita studimore ku prodhuesit dhe përpunuesit do përfitonin nga përvoja e vendeve të tjera. Më tejkalimin e sfidave dhe arritjen e objektivave për zhvillim të këtij sektori do të përmirësoheshin të ardhurat në familje, do të krijohej vetëpunësim në fermë, të ulej kosto e prodhimit, të rritej eksporti i produkteve të ambalazhuara, të zhvillohej agroturizmi dhe të minimizohet erozioni demografik.

3.3.8. PRODHIMI DHE PËRPUNIMI I PEMËVE DHE PERIMEVE


Prodhimi vendas i pemëve dhe perimeve është rritur në mënyrë të vazhdueshme ndër vite, në fillimin e rimëkëmbjes ekonomike në përgjithësi edhe sektori i pemëve dhe perimeve ka filluar një rritje graduale ndër vite ku sipas të dhënave të DBPZHR momentalisht në Rahovec ekzistojnë rreth 158 ha të kultivuara me pemë dhe me perime 1761 ha.



Grafiku 7. Trendët e prodhimit të pemëve

Prodhimi i arrorëve dhe pemëve të imëta është rritur gjithashtu ndjeshëm dhe pritet të rritet ende si rezultat i mbjelljeve së fundmi, të nxitura nga skema e mbështetjes nga qeveria dhe donatorë të ndryshëm.

Shumica e prodhimeve të freskëta mblidhen nga grumbullues/shitës shumice dhe shiten në tregjet e pemëve-perimeve dhe dyqanet tradicionale të pakicës. Krijimi i një rrjeti tregjesh shumice ka përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme kapacitetin e prodhuesve që ndodhen larg zonave kryesore urbane për të tregtuar produktet e tyre. Qarkullimi i produkteve të freskëta të vendit në zinxhirët e super-marketeve është relativisht i vogël.



Grafiku 8. Trendët e kultivimit të perimeve

Infrastruktura dhe shërbimet përkatëse të pasvjeljes (ambientet e dhomave frigoriferike, linjat e ambalazhimit/paketimit, etj.), janë të kufizuara, por megjithatë ka pasur rritje të numrit të tyre si rrjedhojë e mbështetjes së ministrisë së bujqësisë dhe donator të ndryshëm. Ndërsa ambientet e kufizuara të dhomave frigoriferike dhe humbjet e mëdha të produkteve si rrjedhojë e mungesës së tyre kanë qenë për vite me radhë shkaku kryesor i deficitit të lartë në tregtinë e produkteve pemëtarë dhe perimtare, kapacitetet e ruajtjes në dhoma frigoriferike janë rritur në vitet e fundit. Skemat e subvencionit të qeverisë dhe forcimi i konsoliduesve, një kategori tregtarësh më afër fermerëve (e përfshirë si në shitjen e inputeve bujqësore fermerëve, ashtu edhe në grumbullimin e produkteve nga fermerët), po kontribuon ngadalë në përmirësimin e situatës. Aktualisht, grumbulluesit janë akterët më aktivë në zinxhirin e vlerës.

Industria e përpunimit të frutave dhe perimeve përbëhet nga disa ndërmarrje formale dhe disa punishte in formale gjysmë industriale që ofrojnë një gamë të gjerë frutash dhe perimesh të përpunuara.

Sektori ka një fokus të qartë të plotësimit të kërkesës së brendshme dhe të zëvendësimit të importeve. Megjithatë, nisur nga mundësitë që ekzistojnë, prioritet duhet të marrë gjithashtu promovimi i eksporteve.


Sektori i pemëve dhe perimeve karakterizohet nga kushte të përshtatshme klimatike që mundësojnë prodhimin e hershëm të disa lloje frutash dhe perimesh, të cilat përbëjnë gjithashtu një **potencial** të rëndësishëm për sa i përket mundësive të eksportit; ky është sot një realitet i prekshëm i provuar me eksporte në rritje të pemëve dhe perimeve.

Prodhimi i pemëve dhe perimeve përballet ende me **sfida** të ndryshme, përfshi informalitetin e sektorit të materialit mbjellës, kostot e larta të inputeve të blera dhe lëndës djegëse (që prekin veçanërisht serrat me ngrohje), produktivitetin e ulët dhe humbjet e mëdha të pasvjeljes, sidomos në rastin e pemëve. Standardet e sigurisë ushqimore të pemëve dhe perimeve janë gjithashtu një sfidë për t'u adresuar që të rriten eksportet drejt tregjeve të shteteve anëtare të BE.

Zhvillimi i industrisë së përpunimit të pemëve dhe perimeve është penguar nga vështirësitë për të siguruar lëndën e parë për industrinë e përpunimit në sasi të mjaftueshme dhe cilësinë e kërkuar. Me rritjen e ofertës nga ferma, kjo vështirësi është më pak e rëndësishme se në të kaluarën, por industritë në këtë sektor po ndeshen akoma me mjaft vështirësi; menaxhimi i dobët i zinxhirit të vlerës - kontratat formale ose joformale mes industrisë dhe fermave - nuk ka ndihmuar për sa i përket sigurimit të ofertës së lëndës së parë nga ferma për industrinë e përpunimit. Çmimet e larta të energjisë dhe lëndës djegëse dhe të ambalazhimit (kryesisht i importuar) janë një shqetësim i madh për përpunuesit. Ndërkohë që zinxhirët

e shkurtër të vlerës kanë qenë një avantazh deri tani, zgjerimi i zinxhirit të supermarketeve pritet të transformojë zinxhirin e vlerës duke shkaktuar konkurrencë më të drejtpërdrejtë nga furnizuesit e huaj, çfarë nënkupton se prodhimi dhe përpunimi në komunën e Rahovecit ka nevojë për mbështetje të mëtejshme në rritjen e kapaciteteve dhe krijimin e zinxhirit zhvillimor të sektorit të bujqësisë.

DRITHËRAT – Drithërat një ndër veprimtarit kryesore e bujqësisë në komunë Rahovecit, rreth 9,060 ha të tokës së punueshme janë të mbjella me drithëra apo rreth 39% e tokës së punueshme, grurë 4500 ha (50%), misri me 4300 ha (47%), thekër 140 ha (1.5%) dhe më pak tërshërë dhe elb.42 Prodhimtaria në përgjithësi është e kënaqshme por nuk ka pasur rritje të dukshme të rendimentit ndër vite. Prodhimtarinë më të madhe në vitin 2019 e ka pasur misri me 5.0 t/ha, dhe pas tij gruri me 3.5 t /ha.



Grafiku 9. Trendët e kultivimit të drithërave

Edhe pse në nivel të vendit statistikat tregojnë një trend pozitiv sa i përket sipërfaqeve të kultivuara me drithëra, rendimenti mesatar për hektar mbetet ende i ulët në krahasim me shtetet e BE-së. Si faktor i rëndësishëm i shtimit të sipërfaqeve me këtë kulturë mund të jenë politikat mbështetëse përmes pagesave direkte për sipërfaqe të kultivuar me këtë kulturë (175 EUR/ha në 2021). Rendimentet ulëta mund të jenë kryesisht për shkak të mungesës së njohurive mbi teknikat moderne të prodhimit dhe trajtimit të sëmundjeve, për shkak të shërbimeve joadekuate të këshillimit dhe trajnimit si dhe për shkak të qasjes jo të mirë në inpute me cilësisë të mirë.

Ndryshueshmëria e çmimeve të tregut, sidomos për grurin dhe misrin gjatë viteve të fundit ka bërë që këto kultura të jenë të paqëndrueshme, prandaj fermerët nuk mund të planifikojnë investime të mëdha në to për shkak të ndryshimeve të çmimeve. Përveç faktorëve të sipër cekur, madhësia e fermave që kultivojnë grurë dhe misër është dukshëm më e vogël dhe shumë e fragmentuar në krahasim me vendet e BE-së, gjë që mund të ndikojë ndjeshëm në ekonominë e shkallës së efikasitetit të këtyre fermave. Prodhimit të drithërave duhet t'i jepet rëndësi më e madhe për shkak të kërkesave ekzistuese, zvogëlimit të importit (36.3 milion EUR për vitin 2016), sigurimit të ushqimit për kafshë, si dhe sigurimit të lëndës së parë për industrinë e ushqimit, etj., (MBPZHR, Green Report 2018, 2019).

3.3.9. SEKTORI I BLEGTORISË (QUMËSHTI)

Qumështi i lopës është prodhimi më i rëndësishëm blegtoral në Rahovec. Vitet e fundit janë themeluar disa ndërmarrje tregtare të cilat veprojnë në grumbullimin dhe përpunimin e qumështit, të cilat kanë gjetur shtrirje të mirë të produkteve të tyre në nivel lokal por edhe me gjere, këto ndërmarrje në bashkëpunim me fermerët janë duke bërë përpjekje që prodhimi i qumështit të kalojë nga prodhimi për konsum familjar


[42] ASK, regjistrimi i bujqësisë 2014

DBZHR, Komuna e Rahovecit

në prodhim për treg, që të përmirësohen kushtet e mbarështimit, të zbatohen praktikat e mira bujqësore në fermat prodhuese të qumështit dhe të rritet kapaciteti i bujqve për prodhimin e qumështit me cilësi të lartë.

Prodhimi i qumështit nga ripërtypësit e vegjël (dele, dhi) është kryesisht një cikël i mbyllur, nga prodhimi i qumështit, te përpunimi i djathit dhe shitja (marketingu) në fermë. Vetëm disa ferma janë komerciale, ndërsa shumica e prodhuesve që mbajnë ripërtypës të vegjël janë ferma të vogla me praktika kryesisht tradicionale të mbarështimit të kafshëve. Ka nevojë të madhe për investime në modernizimin e stallave, objekteve përcjellëse infrastrukturore, për përdorimin e sistemeve të mjeljes, etj.

Shumica e qumështit prodhohet nga prodhues shumë të vegjël gjysmë të specializuar që kanë më pak se 50 dele apo dhi dhe ferma gjedhi me më pak se 10 lopë qumështore. Shumica e fermave të gjedhëve kanë 3-9 krerë gjedhë dhe rreth 48% e tyre. Sidoqoftë, vihet re një prirje drejt konsolidimit: numri i fermave me më shumë se 5 lopë është trefishuar në krahasim me vitin paraprake, ndërkohë që numri i fermave me mbi 10 gjedhë është 38%.[43]



Grafiku 10. Madhësia e fermës sipas numrit të krerëve në Rahovec

Industria e përpunimit të qumështit kohët e fundit është përmirësuar dhe pasuruar me disa fabrika moderne, por megjithatë një pjesë e saj mbetet akoma e fragmentuar, për kundër disa të cilat kanë filluar të përdorin teknologji të avancuar në përpunim të qumështit.

Këto kompani po zëvendësojnë gjithnjë e më shumë importin dhe po fitojnë tregun vendas. Veçori tjetër e tyre janë kapacitet optimale të prodhimit dhe shumëllojshmëria e artikujve.

Aktorët e zinxhirit të vlerës (veçanërisht fermat dhe përpunuesit e vegjël) duhet të bëjnë më shumë për të arritur standardet mjedisore dhe ato të sigurisë ushqimore. Mbledhja dhe transporti i qumështit është një nga pikat më të dobëta në zinxhirin e vlerës. Mbledhja e qumështit të papërpunuar kryhet më së shumti direkt nga përpunues qumështi dhe nga grumbullues qumështi privatë të pavarur. Shpesh qumështi nuk ruhet në tank ftohës në fermë dhe as gjatë transportit për në fabrikën e përpunimit.

Fabrikat të përpunimit të qumështit kanë investuar për teknologji moderne dhe kanë përmirësuar ndërtesat dhe ambientet për të shmangur ndotjen. Për sa i përket kërkesës, produktet e qumështit janë pjesë e rëndësishme e shportës ushqimore për konsumatorët dhe ka një preferencë të përgjithshme për produkte qumështit të vendit.

[43] ASK (Agjencioni i statistikave të Kosovës)

Sektori përballet me sfida të ndryshme. Në bazë të analizave sfidat kryesore në kuadër të sektorit të industrisë së përpunimit të produkteve bujqësore është decentralizimi i ndërmarrjeve përpunuese, zgjidhja me e mirë në aspektin e funksionimit të këtyre veprimtarive është centralizimi përmes krijimit të politikave dhe strategjive zhvillimore duke krijuar hapësira dhe infrastrukturë të përshtatshme për zhvillimin e këtyre veprimtarive, standardet e sigurisë ushqimore dhe të mjedisit duhet që të përmirësohen dhe të respektohen. Cilësia e qumështit të papërpunuar dhe gjendja mikrobiologjike është problematike, ndërkohë që kushtet e transportit janë të papërshtatshme, shpesh pa përdorur tanke ftohës. Në shumicën e rasteve nuk ka trajtim të ujërave të përdorura dhe të mbetjeve të përpunimit të qumështit (p.sh. laktozës). Mungesa e specialistëve të kualifikuar (teknologjia e përpunimit të qumështit, laboratori, etj.) në zonat rurale është një nga faktorët që ka penguar dhe do të vazhdojë të pengojë, përveç zbatimit të dobët të ligjit, zbatimin e standardeve të sigurisë dhe të mjedisit.

Për sa u përket aspekteve ekonomike të sektorit, ka disa kufizime, përfshirë përmasën e vogël të fermave, konkurrueshmërinë në rritje nga importet (pjesë e liberalizimit të tregtisë dhe zgjerimit të zinxhirëve të supermarketeve).

Prioritet për këtë sektor do të jetë krijimi i strategjisë për centralizimin e ndërmarrjeve prodhuese dhe përpunuese, rritja prodhimi për plotësimin e kërkesës së tregut të brendshëm, investime në zinxhirin e ruajtjes dhe përpunimit në fermë, mbështetja do të synojë edhe përmbushë standardet e sigurisë së ushqimit, edhe ato të mjedisit.

Analiza SWOT - BUJQËSIA	
Përparësitë	**Dobësitë**
Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike shumë të favorshme për zhvillimin të agrobiznesit; **Resurset natyrore: tokë bujqësore e kualitetit të lartë, dhe resurse ujore të bollshme;** **Ndërmarrje për përpunim dhe grumbullim të produkteve bujqësorë.** **Potenciale të mjaftueshme njerëzore me përgatitje profesionale dhe me moshë të re;** **Kapacitetet të konsiderueshme për kultivimin e prodhimeve bujqësore dhe blegtorale;** **Kapacitetet e prodhimit të fidanëve të pemëve, analizimi dhe kontrolli i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale;** **Sipërfaqe e konsiderueshme e tokës bujqësore nën sistemin e ujitjes;** **Potencial për zhvillim të agroturizmit;** **Qasja në rrugë nacionale dhe regjionale;**	Humbje e konsiderueshme e tokë bujqësore çdo vite; Ndotje e tokave bujqësore; Mungesa e organizimit të fermerëve (kooperativa bujqësore); Prodhimtaria e ulët dhe cilësia jo e kënaqshme e produkteve bujqësore; Edukimi i pamjaftueshëm i fermerëve në përputhje me trendët dhe mënyrat e reja të prodhimit; Aplikimi i teknologjisë së vjetruar në prodhimin e produkteve bujqësore; Pamjaftueshmëria e përkrahjes teknike për fermerë; Menaxhimi jo i mirë i tokës bujqësore - fragmentimi i tokave bujqësore; Ndotja e kanaleve të ujitjes; Mungesa e qasjes në tregje – mos funksionimi i pikave grumbulluese në tërë territorin e komunës; Mungesa e kompetencave në menaxhim të resurseve pyjore;
Mundësitë	**Rreziqet**

Mundësi të shumta për prodhime finale; **Futja e teknologjive të reja;** **Hapja e tregjeve të reja;** **Konsolidimi i tokës bujqësore;** **Mundësi qasje në programe e projekte për përfitim nga fondet dhe skemat mbështetëse të qeverise dhe donatorëve;** **Mundësi e plasimit të mallrave në tregun e jashtëm;** **Organizimi i fermerëve (bashkërendimi, koordinimi);** **Bashkëpunimi me nivelin qendror në ripyllëzim;** **Mbrojtja e ekosistemit dhe biodiversitetit;** **Ngritja e kapaciteteve të pronarëve të pyjeve për menaxhim të pyjeve (Dhënia në menaxhim të pyjeve shoqërore banorëve të zonës);**	Ndotja e tokës dhe resurseve të ujit; Braktisja e fshatrave, interesimi i ulet i rinisë për veprimtari bujqësore; Mungesa e kredive të favorshme afatgjata; Fuqia blerëse e popullsisë është e ulët; Prerja e pakontrolluar e pyjeve; Shndërrimi i tokës bujqësore në tokë ndërtimore; Qasja e kufizuar në mjete financiare për investime në Agrobiznes; Pasiguria e efikasitetit afatgjatë të investimeve në bujqësi; Konkurrenca e tregut nga importi; Mungesa e mbrojtjes së prodhimeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera;

Të gjeturat kyçe në kuadër të fushës së bujqësisë janë radhitur në vazhdim:

- Humbja e tokës bujqësore e kualitetit të lartë;
- Fragmentim i ekonomive bujqësore;
- Vërshime të shpeshta të tokave bujqësore dhe humbje të mëdha të produkteve bujqësore nga ky faktor;
- Sipërfaqe të vogla të kultivuara me pemë;
- Numër i vogël i pikave për grumbullimin, ruajtjen dhe përpunimin e pemëve dhe perimeve;
- Fond i vogël blegtoral përkundër potencialeve që posedon komuna e Rahovecit
- Numër i vogël i qumështoreve dhe përpunuesve të qumështit dhe mishit;
- Sipërfaqe të vogla të kultivuara me vreshta përkundër potencialit dhe traditës së fermerëve të kësaj ane.
- Potenciale të mira për zhvillim të bletarisë.

3.4. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

3.4.1. INFRASTRUKTURA E UJËSJELLËSIT

3.4.1.1. RRJETI I UJËSJELLËSIT, MBULUESHMËRIA DHE MATERIALET E RRJETIT TË UJËSJELLËSI

Komuna e Rahovecit ka rrjetë shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 29 vendbanime që kanë qasje e ujësjellës kolektiv.

Bazuar në të dhënat zyrtare Nga tabela mund të shihet se rreth 81% e popullatës së Rahovecit kanë qasje në sistemin e ujësjellësit kolektiv, derisa vetëm 19% e popullatës nuk kanë qasje në këto sisteme.

Gjatësia e përgjithshme e rrjetit të sistemit për furnizim me ujë të pijshëm L=, prej të cilave 56% PE, 26% AÇ, 17% Zn dhe vetëm 1% PVC. Qe do të thotë se 26% të rrjetit në zonë urbane kemi ende gypa të Asbest Cement.

3.4.1.2. CILËSIA DHE FURNIZIMI ME UJË

Përkundër resurseve të saj të kufizuara qendra e ujit e IKSHPK-së aktualisht e përmbush rolin e saj parësor të pavarur për monitorimin e përputhshmërisë së cilësisë së ujit të pijshëm nga kompanitë publike rajonale të ujësjellësit në Kosovë në pajtim me standardet e mëhershme të BE-së dhe OBSH-së për cilësinë e ujit të pijshëm me qëllimin parësor të mbrojtjes së shëndetit publik.

Këto tema të propozuara si më kryesoret nuk do të shikohen si përfundimtare, por ato do vazhdojmë ti zhvillojmë deri në arritjen e qëllimit.

Sipas Raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë së Kosovës për vitin 2017, rezulton se gjatë analizave të bëra, uji është i standardit të lartë dhe i plotëson kriteret 100% me cilësi të mirë[44].

3.4.1.3. KËRKESAT PËR UJË/ VLERËSIMI I NEVOJAVE NË TË ARDHMEN

Sipas udhëzimit Administrativ për norma dhe standarde të planifikimit hapësinor janë përcaktuar kërkesat për ujë për kokë banori, ujë për shfrytëzim për nevojat konsumuese/ ujë për pije dhe amvisëri janë radhitur sipas kategorisë:

- për vendbanime ≥ 100,001 banorë: ≥ 300 litra/banorë;
- për vendbanime ≥ 20,001- 100,000 banorë: ≥ 250- 300 litra/banorë;
- për vendbanime ≥ 20,001- 100,000 banorë: ≥ 200- 250 litra/banorë;
- për vendbanime ≥ 5,001- 20,000 banorë: ≥ 150- 200 litra/banorë;
- për vendbanime < 5,000 banorë: ≥ 100 - 150 litra/banorë.

Qyteti i Rahovecit, në bazë të numrit të banorëve është 15892 banorë dhe sasia e nevojshme ditore e ujit për qytetin të Rahovecit në bazë të numrit të banorëve është Q=150-200 l/b/d për periudhën e tanishme. Ndërsa, më poshtë në mënyrë tabelore do të paraqiten edhe shpenzimet minimale të ujit për periudhën projektuese.

Vendbanimet tjera të Rahovecit hyjnë në normën e shpenzimeve minimale Q=100-150l/b/d në bazë të numrit të banoreve sipas normave teknike nuk e kalojnë numrit më shumë se 5,000 banorë.

Norma e shpenzimeve për Rahovec është marrë Q=200l/b/d, ndërsa për vendbanime të tjera është marrë Q=150l/b/d.

Aktualisht qyteti i Rahovecit, ka numrin e banoreve prej 15,892.

Sipas prognozave të skenarit realist demografike 2030 komuna e Rahovecit duke përfshirë zonën urbane dhe rurale sipas këtij numri të banorëve institucionet përkatëse duhet të sigurojë një sasi të ujit prej Q= 452.0 l/s.

Bazuar në kapacitetet ekzistuese të burimeve të ujit, kapaciteteve të konservimit të rezervuarëve, kapacitetet e stacioneve të pompimit, numrit të prognozuar të banorëve për vitin 2030, përfshirë edhe banorët jo rezident apo diasporën, analizës së shpenzimeve me kërkesën mesatare prej q=452 l/ për banorë Komuna ka nevojë për rritje të kapaciteteve të konservimit të ujit prej së paku 8-10 vitet e ardhshme.[45]

Për përllogaritjen e kërkesës për ujë janë bërë supozimet si vijon:

1) Është parashikuar ngritja e shkallës së mbulimit me shërbime të ujësjellësit

2) Është parashikuar zvogëlimi i shkallës së ujit të pa faturuar (UPF)

3) Është parashikuar rritja graduale e normës së konsumit të ujit nga 110 litra/ditë/banorë (sa faturohet aktualisht) në 130 litra/ditë/banorë në vitin 2028.

Kjo rritje e normës së konsumit pritet të ndodhë si rezultat i zvogëlimit të humbjeve komerciale të ujit (vjedhja e ujit, pasaktësitë e matjes dhe faturimit, etj.). Si alternativë, kërkesa për ujë do të mund të vlerësohej edhe duke marrë (i) normën e konsumit prej 155 litra/ditë/banorë dhe duke ia shtuar asaj (ii)

[44] Plani i biznesit KRU_GJAKOVA 2019-20210

[45] Analiz profesionale

sasinë e ujit të faturuar për konsumatorët komercial dhe institucional (14%) si dhe (iii) sasinë e humbjeve fizike të ujit (rreth 25%) të zvogëluar sipas planifikimit të Kompanisë për zvogëlimin e humbjeve të ujit.

Kjo nënkupton që për përmbushjen e nevojave për furnizim me ujë të popullsisë dhe ekonomisë së komunës së Rahovecit, KRUGJ dhe Komuna duhet të orientohen në eliminimi e humbjeve teknike dhe komerciale.

3.4.1.4. VLERËSIMI I KAPACITETEVE TË NEVOJSHME TEKNIKE TË INFRASTRUKTURËS SË ZGJERUAR APO TË RE NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT

Sipas **gjendjes aktuale** parashihet që shkalla e mbulimit me shërbime gjatë 10 viteve të ardhshme për rritjen e banorë sipas kërkesave të normave teknike të planifikimit hapësinor të përshkruar me lartë, nënkupton që duhet që të parashihen investime në zgjerimin e infrastrukturës së ujësjellësit që nevojitet për furnizim me ujë të këtyre banorëve.

Humbjet e ujit kanë efekt negativ ekologjik, ekonomik dhe social dhe janë pjesë përbërëse e pashmangshme çdo sistemi të ujësjellësit. Shkalla e ujit të humbur është një indikator i mirë i jo-efiçencës së sistemit dhe në korrelacion me indikatorët tjerë siç janë efiçenca financiare dhe efiçenca operative. Reduktimi dhe kontrollimi i qëndrueshëm i UPF në një sistem të ujësjellësit është një problem kompleks i cili kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe shumëdimensionale. Kjo për faktin se humbjet e ujit kanë tendencë natyrale të ngritjes nëse nuk ndërmerren masa adekuate për ndaljen/zvogëlimin e tyre: rrjedhjet nga gypat shtohen vazhdimisht, numri i ujëmatësve që nuk matin saktë rritet, të dhënat për konsumatorët vjetrohen, etj.

Në rastin e rrjetit të ujit në Rahovec, reduktimi i humbjeve të ujit (UPF) paraqet padyshim një prej sfidave më të mëdha për faktin se aktualisht më tepër se gjysma e ujit të trajtuar të cilin KRUGJ e distribuon në sistem nuk faturohet si pasojë qoftë e humbjeve fizike (rrjedhjet nga gypat) apo humbjeve komerciale (gabimet në matje dhe lexim, vjedhjet, etj.). Shkalla kaq e lartë e humbjeve të ujit jo vetëm që shkakton humbje substanciale financiare për Kompaninë KRUGJ por ndikon drejtpërdrejt në cilësinë furnizimit të konsumatorëve (ndërprerjet e rregullta në furnizim) që ka për pasojë rrezikimin e cilësisë së ujit dhe rrjedhimisht paraqet kërcënim permanent për shëndetin e popullatës.

Është e qartë se KRUGJ nuk mund ti eliminojë në tërësi humbjet e ujit, megjithatë, Kompania mundet dhe është e vendosur që ti reduktojë substancialisht ato.

Me qëllim të eliminimit të konfuzionit eventual lidhur me terminologjinë e cila përdoret kur bëhet fjalë për humbjet e ujit (përdorimi jo-konsistent i termave si: humbjet teknike, humbjet fizike, humbjet administrative, humbjet komerciale, etj.), në këtë dokument është përdorur terminologjia standarde e adaptuar në metodologjinë për llogaritjen e bilancit ujor të Asociacionit Botëror të Ujërave (IWA), ku humbjet e ujit ndahen në:

- Humbjet aparente (komerciale), dhe
- Humbjet reale (fizike).

Megjithatë, tri janë identifikuar të jenë shkaqet kryesore për shkallën e lartë të humbjeve të ujit:

• **Mos menaxhimi i duhur** - Edhe pse humbjet e ujit janë identifikuar si prioritet i KRUGJ, deri tani nuk ka pasur strategji të zhvilluar për menaxhimin e tyre.

• **Problemet kulturore dhe sociale** - Problemet me sundimin e ligjit janë reflektuar edhe në rritjen e humbjeve të ujit në formën e kyçeve ilegale, dëmtimin e rrjetit të ujësjellësit, manipulimin me ujëmatësa, etj.

• **Problemet teknike** - Për shkak të resurseve të limituara financiare, investimet në rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të ujësjellësit kanë qenë minimale, dhe ato kryesisht të financuara nga donatorët.

Për më tepër rrjeti i shpërndarjes nuk i ka të përcaktuara zonat hidraulike gjë që e vështirëson tej mase menaxhimin efektiv të humbjeve të ujit.

Për arritjen e caqeve të përcaktuara KRUGJ, do të përqendrojë aktivitetet e veta në katër shtylla kryesore:

(i) Matja e plotë dhe e saktë e ujit të konsumuar;

(ii) Eliminimi i të gjitha parregullsive të lidhura me faturimin e saktë në bazë të konsumit real të konsumatorëve;

(iii) Identifikimi dhe legalizimi/shkyçja e të gjitha kyçjeve të paligjshme;

(iv) Detektimi dhe riparimi sistematik i të gjitha rrjedhjeve si dhe monitorimi i rrjetit distributor në kuadër të sektorëve të përcaktuar (Zonat e Matura-DMA).

Reduktimi i këtyre humbjeve nuk kërkon investime financiare të larta por para se gjithash përkushtim maksimal të menaxhmentit, prandaj mund të arrihen rezultate të konsiderueshme përmes ndërmarrjes së masave si:

- inspektimi dhe detektimi i kyçjeve ilegale dhe vjedhjeve të ujit,
- shkyçja/legalizimi i personave të kyçur ilegalisht ose që vjedhin ujin,
- instalimi i ujëmatësve aty ku mungojnë,
- kalibrimi i ujëmatësve të dyshimtë,
- inspektimi i rregullt dhe zëvendësimi i ujëmatësve jofunksional,
- ngritja e saktësisë dhe përgjegjësisë në leximin e ujëmatësve,
- kontrollimi i leximeve nga kontrolla, etj.

Sfidat kryesore në menaxhimin dhe shpërndarjen e ujit:

- Ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme me ujë të pijes për gjithë qytetaret e komunës;
- Mbajtja e qëndrueshmërisë dhe përmirësimi permanent i furnizimit me ujë gjatë gjithë kohës;
- Ndërtimi i DMA zonave dhe menaxhimi i humbjeve teknike e komerciale duke rivitalizuar rrjetet ekzistuese, duke përdorur praktikat më të mira;
- Kalimi i menaxhimit të rrjetit ujësjellësit në kuadër të KRU Gjakova.

Nevojat zhvillimore për të ardhmen për furnizim me ujë

- Rritja e kapaciteteve prodhuese të ujit;
- Rritja e kapaciteteve të rezervarëve;
- Ndërtimi i rezervuarëve të rinj në zonat e reja të zhvillimit të qytetit dhe fshatrave; (Vend Lokacioni, vëllimi i nevojshëm i rezervuarit).
- Hapje e puseve të reja për rritje të kapaciteti të ujit në zonat rurale;
- Ndërtimi i stacioneve të pompave
- Mbrojtjen e burimeve sipërfaqësore dhe nëntokësore të ujit;
- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të reja në qytet;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në gjitha fshatrat ku nuk ka rrjet të ujësjellësit;

Për Zvogëlimi dhe monitorimi i humbjeve të ujit të pijshëm në rrjetin ekzistues për 5% çdo vit:

- Krijimin e zonave dhe nën zonave për vendosjen e matëseve të ujit (DMA) për menaxhimin e humbjeve teknike dhe financiare të ujit;

- Mbrojtja e zonave të burimeve të ujërave nëntokësorë dhe sipërfaqësor;

Si dhe rritjen e mbulueshmërisë me shërbime të furnizimit me ujë në zonat pa shërbime:

- Ndërtimi dhe zgjerimi i rrjeteve të reja në qytet;
- Ndërtimi i rrjeteve të reja në gjitha fshatrat ku nuk ka rrjet të ujësjellësit.

Bazuar në projektet e planifikuara si dhe vlerësimin teknik si parashikimet e planit të veprimit, komuna në bashkëpunim me KRUGJ përmes hartimit të projekteve do të bëjnë edhe zhvillimin e të gjitha projekteve sipas planit të veprimit të komunës, planit të biznesit të KRUGJ dhe për të gjitha projektet e parapara do të zhvillojë proceduarat në hartimin e projekteve detale dhe zbatimin e tyre në territorin e Komunës se Rahovecit.

Vlerësimi financiar

Për gjitha projektet e parapara komuna e Rahovecit në bashkëpunim me KRU Gjakovën dhe Donatorët e ndryshëm janë specifikuar në kapitullin Prioritetet e veprimit strategjik dhe Plani i veprimit.

3.4.2. RRJETI I KANALIZIMIT

Shërbimi aktual ofron shërbime të kanalizimit rreth 95% të popullsisë (zona e përgjithshme e furnizimit), banorë janë të lidhur me sistemet e kanalizimeve urbane në Rahovec dhe zona rurale. Ujërat e ndotura nga qyteti i Rahovecit rrjedhin pa u trajtuar në rrjedhat ujore përreth. Në qytetin e Rahovecit shkalla e kyçjes në sistemin e kanalizimeve është në masën 95%.

Vlen të theksohet se përafërsisht 95% e banorëve që jetojnë në qytet, ujërat fekale i derdhin në rrjetin e kanalizimit fekal publik.

Gjendja e kanalizimeve ekzistuese është e dobët dhe besohet se ndodhin rrjedhje të mëdha. Njohuria e sistemit të kanalizimeve në të kaluarën kryesisht u mbajt nga operatorët e sistemit shumica e të cilëve nuk janë më në dispozicion për të ndihmuar me detajet e vendndodhjes së sistemit apo funksionimit të tij. Prandaj, informacioni është jo i plotë dhe duhet bërë shumë punë për të rimarrë atë njohuri. Sistemi i kolektorëve lokal sekondar dhe kyçjeve të konsumatorëve nuk është planifikuar të rehabilitohet ose zëvendësohet në asnjë prej nismave të financuara nga donatorët aktualisht.

Sasia e ujërave të zeza do të rritet me shpejtësi në të ardhmen, e njëjtë sikur nevoja për ujë të pijes. Rritja e nevojës për ujë për pastrim, gjendja e pjesërisht e vjetërsuar e rrjetit të kanalizimit, dhe nga vet fakti se Rahoveci nuk ka pajisje të punës për trajtimin ujërave të zeza, është domosdoshmëri që sistemi për menaxhimin e ujërave të zeza duhet të riparohet.

Me zgjerimin e sistemit të kanalizimit, do të jetë i nevojshëm një menaxhim me gjithëpërfshirës i ujit. Elementi kryesor i menaxhimit modern të ujit është ndarja e grumbullimit të ujërave nga reshjet dhe ujërat e zeza. Përderisa ujërat e zeza duhet të grumbullohen dhe trajtohen brenda një sistemi të mbyllur, ujërat e reshjeve duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë sikurse cikli i ujërave natyrore, por edhe të mbyllura. Kjo përfshinë ruajtjen dhe infiltrimin e ujërave nga reshjet brenda zonave banuese dhe komerciale. Ruajtja dhe infiltrimi i ujërave nga reshjet e redukton shkarkimin e ujërave të zeza gjatë kohëve të rënies dhe ndihmon në reduktimin e investimeve të nevojshme. Këto masa janë shumë të nevojshme në zonat urbane siç është qyteti i Rahovecit.

Masa me urgjente është impiant i ri i ujërave të zeza i cili nuk ka filluar të ndërtohet ende për qytetin dhe komunën. Ujërat e ndotura të kanalizimit, të pa trajtuara, shkarkohen direkt në lum apo përrenj, me ç'rast po ndikon edhe në ndotjen e lumenjve, përrenjve dhe në përgjithësi ambientin.

Përveç ndërtimit të impiantit kryesorë komuna ka nevojë për ndërtimin e mini impianteve në zonat rurale të cilat mund të shërbejnë për trajtimin e ujërave të zeza për disa vendbanime rurale. Për ndërtimin e tyre, komuna duhet të parasheh në planifikimet e saj një studim fizibiliteti për ndërtimin e impianteve

dhe kolektorëve kryesore, në mënyrë që të ketë një pasqyrë më të çartë të investimeve në të ardhmen për infrastrukturën e kanalizimeve.

3.4.3. DRENAZHIMI-KANALIZIMI I UJËRAVE ATMOSFERIKE

Deri më tani kanalizimit atmosferik ballafaqohet me probleme, dhe problemet më të shpeshta me të cilat ballafaqohet ky rrjet janë: mungesa e një plani gjithëpërfshirës; mungesa e mirëmbajtjes së duhur; uzurpime të ndryshme nga qytetarët e papërgjegjshëm; kyçja e ujërave të zeza në këto kanale, etj. Të gjitha problemet e përmendura më sipër janë shkaktarë të drejtpërdrejtë të dëmtimit të vazhdueshëm të kanaleve ekzistuese. Një pjesë e trajtimit të ujërave atmosferikë ka filluar të trajtohet që nga viti 2020 në disa pjesë të qytetit dhe do të vazhdohet edhe në pjesë të tjera sipas nevojës në vitet në vazhdim. Në këtë situatë, edhe reshjet më të vogla atmosferike janë rrezik permanent për derdhjen e pa kontrolluar të ujërave nga kanalet, duke vërshuar dhe dëmtuar seriozisht rrugët dhe hapësirat e ndryshme të qytetit.

3.4.3.1. VLERËSIMI I NEVOJAVE NË TË ARDHMEN PËR NJË INFRASTRUKTURË TË TILLË-KANALIZIMI I UJËRAVE TË NDOTURA

Bazuar në gjendjen ekzistues të rrjeteve të kanalizimit të ujerave të ndotura dhe atmosferike dhe numrit të prognozuar të banorëve, në pjesë të qytetit dhe vendbanimeve (fshatrave) të cilat kanë nevojë për rrjetë të reja të ujerave të ndotura si dhe Kolektorët kryesor të cilat dërgoj ujit deri te FTUZ.

Ndërtimi i kanalizimeve të reja në zonën urbane të Rahovecit për të unifikuar rrjetet e fragmentuara ashtu që i tërë kanalizimi të rrjedhë në një pikë të vetme.

3.4.3.2. VLERËSIMI KAPACITETET E NEVOJSHME TEKNIKE TË INFRASTRUKTURËS SË ZGJERUAR APO TË RE NË RRJETIN E KANALIZIMIT

Bazuar në vlerësimin e gjendjes ekzistuese të infrastrukturës së kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike, numrit të prognozuar të banorëve për secilin vendbanim deri në vitin 2028, përfshirë edhe banorët jo rezident, ndërtimit të hovshëm të njësive banesore si dhe ndërtimit të lagjeve me ndërtime individuale janë identifikuar disa vendbanime të cilat kanë nevojë për rrjete të reja të ujërave të ndotura.

Komuna ka nevojë për secilin vendbanim që do të rritet, do të duhej planifikuar edhe një dimensionim i ri i tërë sistemit të kanalizimit të ujerave të ndotura duke u bazuar në UA për Normat Teknike të Planifikimit.

Infrastruktura e dobët e kanalizimit ka nevojë për investime të reja kryesisht në zonën Urbane dhe në disa zona rurale:

1. Ofrimi i shërbimeve me rrjet të kanalizimit për gjithë qytetaret e komunës;
2. Eliminimi i pikave shkarkuese të ujërave të zeza;
3. Mundësia e ndërtimit të impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe kolektorëve;
4. Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në zonat problematike;
5. Mundësia e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja e tyre nga ato fekale;

Ndarja duhet të bëhet me identifikimin dhe hartimin e një projektit kryesor i cili do të bëhet në bashkëpunim me Komunën e Rahovecit dhe KRU Gjakova.

Sfidat kryesore në menaxhimin kanalizimit:

- Ofrimi i shërbimeve me rrjet të kanalizimit për gjithë qytetaret e komunës;
- Eliminimi i pikave shkarkuese të ujërave të zeza;
- Mundësia e ndërtimit të impiantit për trajtim të ujërave të zeza dhe kolektorëve;
- Rehabilitimi i rrjetit të kanalizimit në zonat problematike;

- Kalimi i menaxhimit të rrjetit të kanalizimit në kuadër të KRU Gjakova;
- Mundësia e shtrirjes së rrjetit të kanalizimit atmosferik dhe ndarja e tyre nga ato fekale;

Nevojat zhvillimore për të ardhmen

- Përfundimi impiantit dhe kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza në komunën e Rahovecit;
- Ndërtimi i kolektorëve në qytet dhe zonat përreth;
- Ndërtimi i mini impianteve në zonat rurale
- Ndërtimi i kolektorëve në zonat rurale;
- Kyçja e të gjitha rrjeteve të kanalizimit në kuadër të kolektorëve;
- Zgjerimi dhe rehabilitimi i rrjeteve të reja dhe atyre ekzistuese;
- Zgjerimi i shërbimeve me kanale për largimin e ujërave atmosferik;

Bazuar në projektet e planifikuara si dhe vlerësimin teknik si parashikimet e planit të veprimit, komuna në bashkëpunim me KRUGJ përmes hartimit të projekteve do të bëjnë edhe zhvillimin e të gjitha projekteve sipas planit të veprimit të komunës, planit të biznesit të KRUGJ dhe për të gjitha projektet e parapara do të zhvillojë proceduara në hartimin e projekteve detale dhe zbatimin e tyre në territorin e Komunës së Rahovecit.

Vlerësimi financiar:

Për gjitha projektet e parapara komuna e Rahovecit në bashkëpunim me KRU Gjakovën dhe Donatorët e ndryshëm janë specifikuar në kapitullin Prioritetet e veprimit strategjik dhe Planin e veprimit.

Situata elektroenergjetike në komunën e Rahovecit është mjaft e mirë sa i përket furnizimit me energji elektrike. Në disa zona të caktuara rrjeti duhet të përmirësohet dhe të shtohen kapacitete energjetike duke shtuar numrin e transformatorëve 10(20)/0.4kV.

Pra rrjeti i energjisë elektrike të tensionit të lartë dhe të mesëm në komunën e Rahovecit është mjaft mirë i mbuluar, shikuar nga aspekti i furnizimit me energji elektrike, edhe pse në disa pjesë të caktuara të komunës nevojitet shtimi i kapaciteteve, pra transformatorë të rinj, në mënyrë që të përmirësohet edhe më tej rrjeti elektrik.

Ndërsa për menaxhimin dhe grumbullimin e mbeturinave në komunën e Rahovecit ato sillen sipas grumbullimit brenda një dite rreth 20-30 tonë, kurse sipas raporteve të dy kompanive që operojnë në Komunën e Rahovecit, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët. Pavarësisht mbulueshmërisë prej 100%, prapë se prapë haset në deponi ilegale si dhe hedhje e mbeturinave në mënyrë të pa kontrolluar, po ashtu janë të evidentuara edhe “hot-spotet” (pikat e ndjeshme) të ndikimeve mjedisore në këtë komunë me theks të veçantë në sektorin e mbeturinave.

Investimet në infrastrukturës teknike të parapara me Buxhetin e Kosovës deri në vitin 2025

Sipas Buxhetit të Kosovës, nga Granti Qeveritar, Komuna e Rahovecit deri në vitin 2025 në infrastrukturën publike do të investojë 7,354,618 €. Ndërsa, nga të hyrat vetanake, në Komunën e Rahovecit do të investohen 2025: 1,162,444 €. Nga këto të investime në kuadër të infrastrukturës publike, në infrastrukturën teknike, duke përfshirë rregullimin e shtretërve të lumenjve në fshatrat Hoçë e Madhe, Brestoc, Nagavc dhe Krushë e madhe (370,556 €), ndriçimin publik dhe mirëmbajtjen e rrjetit ekzistues (890,173 €), përmirësimin e kanalizimeve në Pastaselë dhe vendbanime tjera në Komunën e Rahovecit (421,573 €), ndërtimin dhe rregullimin e kanalizimeve fekale (375,000 €), ndërtimin dhe trajtimin e ujërave atmosferik në qytet (330,000 €), ndërtimin dhe rregullimin e infrastrukturës në stacion të autobusëve në


Rahovec (43,326 €) dhe ndërtimin dhe zgjerimin e ndriçimit publik në Komunën e Rahovecit (589,526 €). Deri në vitin 2025 në total planifikohet të investohen 3,020,154 €.

Analiza SWOT

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Lidhje të mira përmes rrugëve nacionale dhe regjionale, si dhe atë të rrjetit hekurudhor; **Qasja e vendbanimeve në infrastrukturë të asfaltuar; dhe** **Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit.**	Menaxhimi i dobët i linjave të transportit publik në viset rurale; Mungesa e qasjes së vendbanimeve rurale të thella në menaxhim të mbeturinave; Mosfunksionimi i linjave hekurudhore; Mirëmbajtja jo adekuate e rrugëve; dhe Mosmirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Shtrirje e internetit në të gjitha vendbanimet, aty ku nuk ka. **Ndriçimi i rrugëve në zona të frekuentuara me popullsi të dendur.**	Degradimi i mjedisit si pasojë e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht. Ndikimet shëndetësore nga cilësia e ujit të puseve.

SFIDAT KRYESORE TËIDENTIFIKUARA
Trajtimi i ujërave të zeza. **Përmirësimi i infrastrukturës energjetike.** **Menaxhimi adekuat me mbeturinat.**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Përfshirja e të gjitha vendbanimeve me shërbimin e rregullt për menaxhimin e mbeturinave. **Përfshirja e të gjitha vendbanimeve në sistem të ujit të pijshëm.**



Harta 33 Harta e numrit të ekonomive familjare

3.5. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

Gjendja e trafikut është relativisht në nivel të kënaqshëm. Konfiguracioni i terrenit është kodrinor dhe karakterizohet me dendësi shumë të madhe të vendbanimeve në disa lagje të qytetit, si rezultat i kësaj i kemi edhe rrugët shumë të ngushta të cilat përdoren nga të gjithë pjesëmarrësit në trafik.

Rrjeti hekurudhor në komunën e Rahovecit është i karakterit regjional dhe ka shtrirje në pjesën perëndimore të komunës së Rahovecit, përkatësisht i takon kategorisë së komunikacionit regjional i cili e lidh Prizrenin - kalon në territorin e komunës së Rahovecit dhe e lidh Klinën me Fushë Kosovë.

3.5.1. INVESTIMET NË INFRASTRUKTURËN RRUGORE TË PARAPARA ME BUXHETIN E REPUBLIKËS SË KOSOVËS DERI NË VITIN 2025

Sipas Buxhetit të Republikës së Kosovës, nga Granti Qeveritar, Komuna e Rahovecit deri në vitin 2025 në infrastrukturën publike do të investojë: 7,354,618.00 €. Ndërsa, nga të hyrat vetanake, në komunën e Rahovecit do të investohen: 1,162,444.00 €. Nga këto investime në kuadër të infrastrukturës publike, në infrastrukturën rrugore, duke përfshirë shtruarjen e rrugëve lokale në fshatin Retijë (22,286.00 €), asfaltimin e rrugës Bellacërkë (Fortesë) – Hamoc - Rahovec (997,930.00 €), rrugën Rahovec -Suharekë, lidhjen në autostradë (1,024,568.00 €), ndërtimin e rrugës me katër korsi nga Rahoveci deri në Xërxë (3,600,160.00 €), meremetimin e rrugëve dhe trotuareve (970,278.00 €), ndërtimin e trotuareve (716,838.00 €) dhe krijimin e parkingjeve të reja në qytet (74,450.00 €), deri në vitin 2025 planifikohet të investohen në total 7,406,510.00 €.

Analiza SWOT

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Lidhjet e mira rrugore lokale; **Pozita e mirë gjeografike; dhe** **Rekonstruimi dhe mirëmbajtja e rrjetit rrugor.**	Mungesa e shtigjeve/korsive për qarkullim jomotorik; Ndërtimet afër rrugëve regjionale dhe lokale jashtë rregullave ndërtimore; dhe Sistemi i dobët i sinjalizimit.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Përmirësimi i shërbimeve të transportit publik; dhe **Zhvillimi i rrjetit të transportit të jo motorizuar.**	Kufizimi i sigurisë në trafik nga ndërtimet afër rrugëve; Siguri e pamjaftueshme në komunikacionin rrugor; dhe Ndotja e mjedisit nga transporti i motorizuar.

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA
Përmirësimi i sigurisë në trafik; **Krijimi kushteve për qarkullim jomotorik;** **Përmirësimi i rrjetit të transportit publik; dhe** **Zgjidhje e çështjes së parkimit në qendrën komunale.**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Kompletimi i rrjetit të infrastrukturës me elementet që mundësojnë qarkullim për të gjithë pjesëmarrësit në komunikacion, duke përfshirë edhe qarkullimin jo motorik; **Sinjalizimi si nevojë për rritjen e sigurisë në trafik rrugor; dhe** **Kompletimi/konsolidimi i rrjetit rrugor në të gjitha lagjet e vendbanimeve rurale.**

3.6. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

3.6.1. QENDRA PËR PUNË SOCIALE DHE SHËNDETËSIA

Qendra për Punë Sociale (QPS), si institucion profesional i Komunës, e cila përbëhet nga personeli profesional me kualifikim përkatës si nëpunës të shërbimeve sociale. QPS-ja është një përparësi e madhe për ushtrimin e kompetencave ligjore për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare në emër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Ndërsa shëndetësia është e organizuar në sektorin publik, ku ofrohen shërbime të nivelit parësor dhe në sektorin privat i cili ofron shërbime parësore të lëmive të specializuara mjekësore edhe pse ka mungesë të kuadrit mjekësor.

Bazuar në sipërfaqet e përgjithshme aktuale prej 6,641m² dhe numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2030 prej 53,225 banorë rezident, rezulton se Komuna nuk ka përmbushur kërkesat minimale hapësinore të përcaktuara sipas Normave Teknike për Planifikim Hapësinor për infrastrukturë të institucioneve shëndetësore dhe ka nevojë për sipërfaqe shtesë prej së paku +4,004m².

Numri i parashikuar i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet me NTPH (m²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²)
53,225	6,641	0.2	10,645	-4,004

Tabela 179 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve shëndetësore

3.6.1.1. VLERËSIMI I KAPACITETEVE FINANCIARE PËR PUNË SOCIALE DHE SHËNDETËSI

Bazuar në investimet kapitale prej 2,027,902 € në infrastrukturë sociale apo shëndetësore për periudhën paraprake 6-vjeçare 2016 – 2021, parashikimi i investimeve kapitale për vitet 2023 – 2031 është 5,868,612 €.

	2016 - 2018	2019 - 2021	PARASHIKIMI 2023 - 2025	PARASHIKIMI 2026 - 2028	PARASHIKIMI 2029- 2031
Grantet Qeveritare	€ 977,094	€ 1,050,808	€ 1,218,306	€ 1,279,221	€ 1,343,182
Të Hyrat Vetanake				€ 0	€ 0
Financim i Jashtëm	€ 0	€ 0		€ 0	€ 0
Financimi nga Huamarrja	€ 0	€ 0		€ 0	€ 0
Gjithsej	€ 977,094	€ 1,050,808	€ 1,218,306	€ 1,279,221	€ 1,343,182

Tabela 180 Vlerësimi i kapaciteteve financiare përinfrastrukturë sociale dhe shëndetësore

Analiza SWOT

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Funksionimi i qendrës për punë sociale; **Ofrimi i shërbimeve sociale sipas standardeve minimale të përcaktuara nga MPMS-ja;** **Infrastruktura e mirë shëndetësore;** **Stafi i mjaftueshëm dhe profesional në QPS-të; dhe** **Ofrimi i shërbimeve shëndetësore primare 24 orë.**	Mungesë e kuadrit mjekësor në disa QMF dhe AMF; Mungesa e hapësirës së nevojshme të Objektit ekzistues të QPS-së; Mungesa e shtëpisë për qëndrim ditor të të moshuarve; Mungesa e qendrës për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme QFAKP; dhe Mungesa e grantit specifik për Shërbimet Sociale.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Mundësitë për programet e trajnimit për stafin shëndetësor; **Ndërtimi i Objektit të ri të QPS-së;** **Sigurimi i fondeve nga niveli qendror dhe donatorët për zhvillim të infrastrukturës teknike dhe profesionale; dhe**	Përkujdesja e kufizuar shëndetësore në disa pjesë rurale në mungesë të kuadrit profesional shëndetësor. Mungesa e grantit specifik për Shërbimet Sociale, rrezikon zbatimin e veprimeve ligjore për disa kategori të ndjeshme sipas standardeve minimale.

Hapja e një njësie të qendrës së Shëndetit Mendor.	

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA
Zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike dhe mirëmbajtja e tyre; **Ofrimi i shërbimeve cilësore shëndetësore dhe shërbimeve sociale; dhe** **Zhvillimi i aktiviteteve dhe orientimi i të rinjve drejt sportit, rekreacionit dhe kulturës.**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Sigurimi i stafit profesional shëndetësor dhe shërbimeve adekuate shëndetësore nëpër të gjitha vendbanimet; **Zgjerimi i mëtejmë i aktiviteteve kulturore;** **Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës sportive; dhe** **Zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike duke i shfrytëzuar potencialet në qendrën komunale dhe pjesët rurale.**

3.6.2. ARSIMI

Struktura organizative e sistemit arsimor në komunën e Rahovecit është e organizuar në katër nivele: arsimin parashkollor (fëmijët e moshës 0-3 vjeç, 3 – 5 vjeç dhe 5 - 6 vjeç), arsimin fillor (klasët I – V), arsimin e mesëm të ulët (klasët VI – IX) dhe arsimin e mesëm të lartë (klasët X – XII).

Numri i prognozuar i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet me NTPH m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
53,225	3,585	1.3	69,193	-65,608

Tabela 181 Kërkesat minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale për arsimin parashkollor

Bazuar në sipërfaqet e përgjithshme aktuale prej 3,585m^2 dhe numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2030 prej 53,225 banorë rezident, rezulton se Komuna ka nuk ka përmbushur kërkesat minimale hapësinore të përcaktuara sipas Normave Teknike për Planifikim Hapësinor për infrastrukturë të institucioneve të arsimit parashkollor dhe ka nevojë për sipërfaqe shtesë prej së paku +65,608m^2.

Nga këto vlerësime mund të konstatohet se në këtë komunë kemi mungesë të konsiderueshme të hapësirave për çerdhe/kopshte dhe përcaktimi i hapësirave të nevojshme duhet të shpërndahet kryesisht në vendbanimet me më shumë banorë (mbi 2,500 banorë).

Në komunën e Rahovecit aktualisht mësimi fillor dhe i mesëm i ulët zhvillohet në 25 objekte shkollore. Hapësira ekzistuese e këtyre objekteve shkollore është gjithsej 182,132.6m^2. Prej tyre 133,745.6 m^2 janë sipërfaqe të parcelave që përmbajnë objekte të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, ndërsa 48,387 m^2 janë sipërfaqe të parcelave që përmbajnë objekte të arsimit të mesëm të lartë.

Numri i prognozuar i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet me NTPH (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
53,225	291,700	2.80	149,030	142,670

Tabela 182 Kërkesat minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale për arsimin fillor dhe shkolla të mesme të ulëta

Nga këto llogari vërehet se komunën e Rahovecit tejkalon normat teknike për sipërfaqet e përcaktuara për objektet e arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë.

Numri i prognozuar i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet me NTPH (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
53,225	39,700	1.00	53,225	-13,525

Tabela 183 Kërkesat minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale për arsimin të mesëm të lartë

Bazuar në sipërfaqet e përgjithshme aktuale prej 3,585m² dhe numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2030 prej 53,225 banorë rezident, rezulton se Komuna ka nuk ka përmbushur kërkesat minimale hapësinore të përcaktuara sipas Normave Teknike për Planifikim Hapësinor për infrastrukturë të institucioneve të arsimit parashkollor dhe ka nevojë për sipërfaqe shtesë prej së paku +13,525m².

3.6.2.1. VLERËSIMI I KAPACITETEVE FINANCIARE PËR ARSIM

Bazuar në investimet kapitale prej € 2,908,632 në infrastrukturë arsimore për periudhën paraprake 6-vjeçare 2016 – 2021, parashikimi i investimeve kapitale për vitet 2023 – 2031 është € 2,853,164.

	2016 - 2018	2019 - 2021	PARASHIKIMI 2023 - 2025	PARASHIKIMI 2026 - 2028	PARASHIKIMI 2029 - 2031
Grantet Qeveritare	€ 764,823	€ 1,515,678	€ 845,048	€ 887,300	€ 931,665
Të Hyrat Vetanake	€ 340,000	€ 288,131	€ 60,000	€ 63,000	€ 66,150
Financim i Jashtëm	€ 0			€ 0	€ 0
Financimi nga Huamarrja	€ 0			€ 0	€ 0
Gjithsej	€ 1,104,823	€ 1,803,809	€ 905,048	€ 950,300	€ 997,815

Tabela 184 Vlerësimi i kapaciteteve financiare për infrastrukturë arsimore

Analiza SWOT

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Kuadri i kualifikuar arsimor. **Trajnimet kurrikulare për stafin mësimor.** **Bashkëpunimin profesional ndërkomunal.** **Ekipet profesionale për monitorim dhe vlerësim.** **Ndërtimi i shkollave dhe çerdheve të reja.**	Mungesa e rrjetit të mjaftueshëm dhe të nevojshëm të institucioneve parashkollore; Pajisja jo e mjaftueshme e shkollave me mjete konkretizimi dhe laboratorike; dhe Zhvillimi i mësimit në dy ndërrime në disa shkolla.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Mundësitë për programet e trajnimit për stafin arsimor. **Sigurimi i fondeve nga niveli qendror dhe donatorët për zhvillim të infrastrukturës teknike dhe profesionale në sistemin arsimor.**	Siguria e duhur në shkolla; dhe Zvogëlimi i numrit të nxënësve nëpër shkolla (Braktisja, migrimi, rënia e lindshmërisë).

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA
Arritja e cilësisë dhe gjithëpërfshirjes në arsim. **Zgjerimi i rrjetit të objekteve sportive dhe rekreacionit në hapësirat shkollore.** **Ofrimi i shërbimeve cilësore pedagogjike dhe psikologjike nëpër shkolla.** **Ofrimi i mundësive të qasjes së nxënësve me kohë në hapësirat shkollore.**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Sigurimi i arsimit adekuat për të gjitha moshat shkollore nëpër të gjitha vendbanimet. **Ndërtimi i objekteve shkollore, për mësim në një ndërrim.** **Zgjerimi i mëtejmë i aktiviteteve arsimore dhe kulturore.** **Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës sportive nëpër shkolla.** **Aplikimi i masave të efiçiencës së energjisë.** **Pajisja i shkollave me mjete konkretizimi, laboratorë dhe kabinete.**

3.6.3. ADMINISTRATA PUBLIKE

Hapësirat për veprim të institucioneve të administratës në komunë në aspektin hapësinor i plotëson kërkesat për hapësirë/parcela kadastrale të destinuara dhe ndërtesa me hapësirë të mjaftueshme të

ndërtuar. Sa i përket vlerësimit të plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së prej 0.62m² për parcela kadastrale mund të vërejmë se në këtë komunë ka hapësirë të mjaftueshme administrative.

Numri i prognozuar i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m²)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m²)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet me NTPH (m²)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m²)
53,225	35,768	0.62	33,000	2,769

Tabela 185 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve administrative

3.6.3.1. VLERËSIMI I KAPACITETEVE FINANCIARE PËR ADMINISTRATË PUBLIKE

Bazuar në investimet kapitale prej € 240,000 në infrastrukturë arsimore për periudhën paraprake 6-vjeçare 2016 – 2021, parashikimi i investimeve kapitale për vitet 2021 – 2031 është **€ 268,842**.

	2016 - 2018	2019 - 2021	PARASHIKIMI 2023 - 2025	PARASHIKIMI 2026 - 2028	PARASHIKIMI 2029 - 2031
Grantet Qeveritare	€ 145,000	€ 37,000	€ 60,479	€ 63,503	€ 66,678
Të Hyrat Vetanake	€ 40,000	€ 18,000	€ 24,800	€ 26,040	€ 27,342
Financim i Jashtëm		€ 0		€ 0	€ 0
Financimi nga Huamarrja	€ 0	€ 0		€ 0	€ 0
Gjithsej	€ 185,000	€ 55,000	€ 85,279	€ 89,543	€ 94,020

Tabela 186 Vlerësimi i kapaciteteve financiare për infrastrukturë arsimore

Analiza SWOT

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Mbulueshmëria e mirë me objekte të administratës publike; **Çdo nën-qendër i ka zyret e vendit funksionale;** **Qasja e mire në objektet e administratës publike; dhe** **Gjendje relativisht e mirë e objekteve të administratës publike.**	Mungesa e hapësirave më të mëdha për zyrat e bashkësive lokale. Mungesa e buxhetit për mbulimin e pagesës së stafit të BL.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Legjislacionin aktual mundëson funksionimin e BL; dhe **Shfrytëzimi i qendrave rinore për funksionimin e zyrave të BL.**	Largimi i stafit

SFIDAT KRYESORE TËIDENTIFIKUARA
Sigurimi i hapësirave / kushteve për punë për funksionimin e bashkësive lokale; dhe **Grumbullimi i objekteve administrative në një vend.**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Sigurimi i buxhetit për kompensimin e përfaqësuesve-stafit të këshillave lokale.

3.6.4. INFRASTRUKTURA SOCIALE

Muzeu dhe shtëpia e kulturës gjenden në qytetin e Rahovecit që shërbejnë për aktivitete të ndryshme kulturore dhe rinore. Në Krushë të Madhe gjendet edhe Shtëpia Muze e Ukshin Hotit me sipërfaqe kadastrale 677.4m^2 ndërsa edhe 4 shtëpi të kulturës me sipërfaqe totale prej 11,020.2m^2 në vendbanimet Xërxë, Ratkoc, Dranoc dhe Krushë të Madhe. Në vazhdim është paraqitur hapësira dhe kërkesat sipas NTPH-së për infrastrukturën e institucioneve kulturore:

Numri i prognozuar i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme e që kërkohet me NTPH (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
53,225	13,343	0.20	10,645	2,698

Tabela 187 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të institucioneve kulturore

Siç shihet edhe nga tabela mund të konstatojmë se hapësira për shtëpi të kulturës në këtë komunë është e mjaftueshme.

Në qytetin e Rahovecit stadiumi ka një sipërfaqe kadastrale prej 1,160.6m^2, ndërsa palestra sportive ka një sipërfaqe kadastrale prej 1,742.7m^2. Fushat e hapura sportive janë të shpërndara në vendbanimet Krushë e Madhe, Celinë, Brestoc, Opterush, Zoqishtë, Hoçë e Madhe, Rahovec, Bellacërkë, Xërxë, Radostë, Ratkoc, Dejnë, Dabidol dhe Çifllak me sipërfaqe totale prej 42,748.7m^2.

Bazuar në vlerësimin e gjendjes aktuale dhe kërkesave sipas Normave minimale Teknike për Planifikim Hapësinor dhe numrin e parashikuar të banorëve për vitin 2030, janë paraqitur hapësirat e nevojshme sportive dhe rekreative në komunën e Rahovecit.

Numri i prognozuar i banorëve rezident 2030	Sipërfaqja aktuale e parcelave kadastrale (m^2)	Sipërfaqja e kërkuar me NTPH për kokë banori (m^2)	Sipërfaqja e përgjithshme që kërkohet me NTPH (m^2)	Sipërfaqja e nevojshme shtesë (m^2)
53,225	45,652	2.50	133,063	-87,411

Tabela 188 Vlerësimi i plotësimit të kërkesave minimale hapësinore të NTPH-së për parcela kadastrale të hapësirave sportive dhe rekreative

Sipas këtyre llogarive, në komunën e Rahovecit ka nevojë të destinohen +87,411m^2 sipërfaqe shtesë për hapësira sportive dhe rekreative, të cilat duhet të shpërndahen në vendbanimet tjera.

3.6.4.1. VLERËSIMI I KAPACITETEVE FINANCIARE PËR KULTURË, RINI DHE SPORT

Bazuar në investimet kapitale prej € 1,205,373 në infrastrukturë kulturë, rini dhe sport për periudhën paraprake 6-vjeçare 2016 – 2021, parashikimi i investimeve kapitale për vitet 2023 – 2031 është € 6,325,890.

	2016 - 2018	2019 - 2021	PARASHIKIMI 2023 - 2025	PARASHIKIMI 2026 - 2028	PARASHIKIMI 2029 - 2031
Grantet Qeveritare	€ 395,000	€ 465,106	€ 1,194,272	€ 1,253,986	€ 1,316,685
Të Hyrat Vetanake	€ 150,000	€ 195,267	€ 430,000	€ 451,500	€ 474,075
Financim i Jashtëm	€ 0			€ 0	€ 0
Financimi nga Huamarrja	€ 0			€ 0	€ 0
Gjithsej	€ 545,000	€ 660,373	€ 1,624,272	€ 1,705,486	€ 1,790,760

Tabela 189 Vlerësimi i kapaciteteve financiare për infrastrukturë arsimore

Analiza SWOT

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Kultura dhe arti	Kultura dhe arti
Ekzistenca e objekteve: Shtëpitë e kulturës dhe Muzeu i qytetit.	Mungesa e bibliotekës së qytetit.
Sporti dhe rekreacioni	Sporti dhe rekreacioni
Objektet sportive: Palestra e sporteve, stadiumi i qytetit, fushat sportive në oborret e shkollave dhe sallave të edukatës fizike dhe qendra rinore; dhe	Mungesa e objekteve dhe terreneve sportive nëpër disa fshatra; dhe
Mbulueshmëri e mirë e hapësirave për rekreacion dhe lodra për fëmijë.	Mungesa e hapësirave rekreative në kuadër të objekteve shumë-banesore.
Hapësira publike dhe të gjelbërta	Hapësira publike dhe të gjelbërta
Projekti i sheshit qendror bashkë me hapësirat e gjelbërta përcjellëse.	Hapësirat publike jashtë zonës urbane nuk janë të

Objektet e religjionit dhe varrezat **Objekte të mjaftueshme të xhamive dhe kishave për të kryer ritualet fetare; dhe** **Posedimi i hapësirës së lirë në fshatra për varreza.**	inventarizuara dhe nuk mirëmbahen sa duhet; dhe Vetëdija e ulët për ruajtjen e hapësirave publike.
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Kultura dhe arti **Krijimi i më shumë hapësirave të gjelbërta.** **Sporti dhe rekreacioni** **Shfrytëzimi i fushave sportive në kuadër të shkollave për përdorim nga komuniteti.** **Hapësira publike dhe të gjelbërta** **Stimulimi i shtimit të sipërfaqeve të gjelbërta.** **Objektet e religjionit dhe varrezat** **Shfrytëzimi i objekteve fetare të cilat gjenden në listën e objekteve të trashëgimisë kulturore për zhvillim të turizmit.**	Kultura dhe arti De kulturimi i popullatës. Sporti dhe rekreacioni Rritja e delikuencës dhe ekstremizmit tek të rinjtë. Hapësira publike dhe të gjelbërta Uzurpimi i hapësirave publike dhe sipërfaqeve të gjelbëra. Objektet e religjionit dhe varrezat Pengesat eventuale në qasjen dhe vizitimin e hapësirave dhe objekteve rreth zonës së mbrojtur të Hoçës së Madhe

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA
Ndërtimi i objekteve të reja të kulturës, artit, sportit e rekreacionit dhe përmirësimi i qasjes në këto objekte për të gjithë banorët e komunës së Rahovecit; **Mirëmbajtja adekuate e objekteve të artit, sportit, kulturës, rekreacionit, komunitetit në nën qendra;** **Sigurimi i hapësirave të reja publike për nën qendrat dhe për zonën urbane dhe standardizimi i mirëmbajtjes; dhe** **Mirëmbajtja e objekteve fetare dhe objekteve përcjellëse.**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Në përgjithësi, zhvillimi i mëtejmë i sektorit të infrastrukturës sociale, është i lidhur me planifikimin e objekteve të reja të kulturës dhe në disa raste renovimin e atyre ekzistuese për t`i adaptuar ato për përdorim të mëtejshëm në funksion të aktiviteteve në fushën e kulturës.

3.7. MJEDISI DHE SIPËRFAQET ME RREZIKSHMËRI

Rahoveci, si shumica e qyteteve të tjera, përballet me një sërë problemesh mjedisore, si p.sh. Cilësi e dobët e ajrit, Nivel i lartë i trafikut, Nivel i lartë i zhurmës së ambientit, Mjedis i ndërtuar me cilësi të ulët, Toka të braktisura, Emetime të gazrave, Shtrirje të gjerë urbane, dhe Trajtimi i mbeturinave e kanalizimeve, etj. Këto probleme lidhen me një zhvillim urban që nuk është i orientuar drejt mjedisit.

Gjendja e përgjithshme mjedisore e qytetit të Rahoveci nuk mund të cilësohet ndryshe, veçse një gjendje jo e kënaqshme si në gjithë Republikën e Kosovës, qoftë në pjesët urbane, rurale apo përreth zonave industriale. Nder problemet mjedisore që janë evidente për Komunën e Rahovecit Janë; qasja akoma e ultë në kanalizime, furnizimi me ujë të pijshëm , ujërat urbane, rurale e industriale pa trajtim adekuat, menaxhim i kufizuar i mbeturinave, ndotja enorme e ajrit, zhurma e lartë, antena të telefonisë mobile, kujdesi jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa e vendeve për pushim e rekreacion, janë indikator kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësimin e Mjedisit në Komunën e Rahovecit.

3.7.1. MJEDISI

3.7.1.1. NDOTJA E AJRIT

Normativat e cilësisë se ajrit në Kosovë janë të rregulluara me Udhëzimin administrative për Vlerat Kufitare- Normat e cilësisë së Ajrit, Nr.02/2011 dhe Direktivën 2008/50/EC për Cilësinë e ajrit mjedisor dhe ajrit të pastër për Evropë.

Komuna e Rahoveci sa i përket ndotjes së Ajrit përballet me probleme dhe sfida jo të pakta sa i përket kësaj fushe. Ndër problemet dhe sfidat më të theksuar në Komunën e Rahoveci mundë ti radhisim si më poshtë.

Si rezultat i kësaj gjendje nuk mund të flasin me kompetencë për nivelin aktual të ndotjes dhe cilësinë e tij. Bazuar në njohuritë e përgjithshme mbi situatën në Kosovë dhe sondazheve në terren, burimet kryesore të ndotjes në komunën e Rahovecit mund të konsiderohet se janë:

- Pluhuri, si pasoj e gurëthyesve
- Ndezja e mbetjeve të plastikës dhe gomës
- Ndezja e mbetjeve në deponi të egra

Probleme tjera te cilat e shoqërojnë komunën e Rahovecit saj përket ndotjes së ajrit janë:

1.Ndotja e ajrit qe vjen nga veturat e vjetra. Që Paraqet një problem kritik mjedisor për komunën e Rahovecit. Cilësia e ajrit është veçanërisht e ulët në zonën Urbane të Rahoveci. Burimet kryesore të kontaminimit janë dyoksidi i sulfurit (SO_2), oksidet e azotit NO dhe NO_2 (NOx), ozoni (O_3), plumbi (Pb), dyoksidi i karbonit (CO_2).

2.Stacionet për monitorimin e cilësisë së ajrit në komunën e Rahovecit. Institucioni i mandatuar për monitorimin e cilësisë së ajrit në Kosovë është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor përmes Institutit Hidro-Meteorologjik të Kosovës (IHMK).

Në bazë të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit, Nr.03/L-025, Ligjit i mbrojtjes së ajrit nga ndotja, Nr.03/L-160 dhe Ligjit për veprimtarinë hidrometeorologjike, Nr.02/L-79, IHMK është i obliguar që të bëjë monitorimin e cilësisë së ajrit në tërë territorin e Kosovës.

Por në territorin e komunës së Rahovecit nuk ka pika monitoruese të cilësisë së ajrit, andaj në një të ardhme të afërt do duhej të vendosen instrumente monitoruese në disa pika. Mungesa e të dhënave nga monitorimi i cilësisë së ajrit si pasqyrim i plotë i nivelit të vërtetë të ndotjes së ajrit pamundëson edhe marrjen e veprimeve për zvogëlimin apo parandalimin e ndotjes.

3.7.1.2. NDOTJA E UJIT

Burimi kryesor i ndotjes së lumenjve në komunë janë ujërat e kanalizimit, si pasojë e sistemit të pakompletuar dhe joadekuat të menaxhimit të tyre

Ku shkaktohen derdhjen e ujërave të zeza pa trajtim paraprak, me një ndikim negativ në cilësinë e ujit si dhe në jetën bimore dhe shtazore. Pasojat e kësaj ndotje mund të shkojnë edhe më tej duke shkaktuar ndikime negative në tokë dhe në ajër.

Rrjedhja e ujërave më të ndotura që përshkojnë territorin e qytetit të Rahovecit dhe vendbanimeve përreth janë Rimniku, Duhllo, Sapniq, Bellaja si rrjedhojë e hedhjes së mbeturinave dhe shkarkimit të ujërave të zeza. Shfrytëzimi i zhavorrit kryesisht nga shtrati i lumit Drini i Bardhë është veprim shumë negativ, i cili krahas dëmtimit të peizazhit, dëmton edhe biodiversitetit e lumit dhe përreth tij. Shfrytëzimi i zhavorrit nga shtretërit e lumenjve apo ngushtimit të shtratit të tyre me ndërtime buzë bregut apo hedhjes së mbetjeve ndërtimore, çrregullon rrjedhën e tyre dhe për pasojë kemi edhe vërshime të vendbanimeve

dhe tokave bujqësore përgjatë këtyre rrjedhave pothuaj çdo vit në pranverë apo vjeshtë kur rritet intensiteti i reshjeve të shiut apo shkrirja e shpejt të borës.

Ndotjet industriale nga operatorë si Veraria dhe Termoventi si dhe operatorë tjerë më të vegjël, gjithashtu kontribuojnë në ndotjen e burimeve ujore.

Mungesa e infrastrukturës për trajtimin ujërave sanitare apo industriale të shkarkuara në trupa ujore edhe në të ardhmen do të jetë burim i ndotjes së ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësorë si burime që përdorin për nevoja të qytetarëve. Një burim tjetër i ndotjes është edhe hedhja e mbeturinave urbane apo atyre ndërtimore në shtretër të lumenjve apo afër rrjedhave të tyre.

Komuna e Rahovecit përballet me probleme dhe sfida jo të pakta sa i përket Ndotjes së ujit. Nder problemet dhe sfidat më të theksuar në Komunën e Rahovecit Janë.

1.Problemi i shkarkimit të ujërave të ndotur në lumenj apo hapësira sipërfaqësore: Rahovecit si shumë komuna tjera në Kosovë ka problem dhe sfidë të lartë në menaxhimin e ujerave te kanalizimeve te cilat derdhen ne lumenj pa trajtim paraprak dhe qe paraqesin ndotje për ujërat.

2.Ruajtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit dhe mungesa e impiantit për trajtimin e ujerave të zeza. Lumi më i madh që kalon në territorin e komunës së Rahovecit është Drini i Bardhë. Edhe pse nuk buron në komunën e Rahovecit, ai është ujëmbledhës të gjitha rrjedhave dhe lumenjve të komunës. Nëpër komunën e Rahovecit, ky lum rrjedh me një gjatësi prej 30 km dhe pjesën më të madhe është edhe si kufi administrativ i komunave: Prizrenit, Gjakovës, Malishevës dhe Klinës.

Lumenjtë-përroskat që derdhen në Drinin e Bardhë janë: lumi Drinas, Rimnik, Polluzhë, Hoçë, etj.

Lumi Drini i Bardhë në Anadrini ka prerë masivin gëlqeror Gradishin ashtu që ka formuar Grykën (Kanionin) eupegjenik atraktiv në gjatësi prej 450 m. Në kanion është ndërtuar Ura e Fshenjtë e cila është e gjatë 70 m dhe thellësia prej harkut deri te shtrati i ujit është 30 m.

Lumi i Hoçës buron në fshatin Hoçë të Madhe në lartësi mbidetare 420 m dhe rrjedh nëpër fshatin Brestoc, por para fshatit Brestoc bashkohet me përroskën e Babindollit dhe disa burimet të tjera dhe derdhet në Drinin e Bardhë. Lumi Bellaja është dega e majtë e Drinit të Bardhë dhe është e gjatë 3 km prej fshatit Fortesë deri te fshati Rogovë.

Lumi Duhllo buron në Rahovec dhe është i formuar nga tri burime (Duhllo, Vrella dhe Sopoti) dhe në kilometrin e 4 bashkohet me lumin e Rimnikut. Në harta topografike ky lum është i shënuar me emrin Gjegoja, që do të thotë për popullin e kësaj ane është i pa njohur.

Lumi Rimnik buron në rrëzë malet Gërgavicë dhe në rrjedhjen e tij i merr disa burime të tjera. Ky lum ka rëndësi të madhe ekonomike për këtë anë. Lumi Rimnik gjatë rrjedhjes së vetë bashkohet me lumin Duhllo dhe në fshatin Fortesë bashkohet me lumin e Sopniqit dhe formojnë lumin Bellaja.

Lumi Sopniq burimin e ka në rrëzë të malit të Drenocit dhe kalon nëpër fshatin Nashpall, Sopniq. Ky lum gjatë stinës së verës ka pak ujë dhe shtrati i tij është kryesisht i thatë dhe mund të quhet si Lumi i Thatë. Vlen të përmenden edhe disa lumenj -përroska siç janë: i Drinasit, Kramovikut, Polluzhës e tjera.

Në tabelën vijuese pasqyrohet rrjeti hidrografik i disa burimeve ujore me karakteristika fizike të tyre. [Burimi PZHK].

Emërtimi	Lartësia mbidetare	Lit./sek.	Temp.
Burimi i Rahovecit	390	5 – 8	**13**
Burimi i Zatriqit	920	5	**13**
Burimi i Opterushës	400	40	**13**
Burimi i Zoqishtit	415	15	**13**
Burimi i Hoçës së Madhe	420	10	**14**
Burimi i Sopotit	**380**	**6**	**13**

Tabela 190 Rrjeti hidrografik i ujërave sipërfaqësorë në komunën e Rahovecit




Figura 28 Harta hidrografike e komunës së Rahovecit

Nga analiza e gjendjes në komunë e bërë nga grupet punuese sa i përket cilësisë, resursit dhe burimeve ujore është konstatuar se shqetësimi kryesor ka të bëjë me mbrojtjen e cilësisë, resursit dhe burimeve të ujit. Parashikohet edhe zhvillimi dhe menaxhimi i burimeve të ujit për plotësimin nevojave për të sotme dhe të ardhmen.

Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës, sikurse edhe në Komunën e Rahovecit, është si pasoj e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në ambientet ujore. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në viset e ulëta fushore aty edh ku ka shtrirje aktiviteti njerëzor.

Në shkallën e parë që, nuk ka ndotje kimike dhe biologjike, janë lumenjtë që shtrihen nga burimet deri në vendbanime.

Shkallës IIa të ndotjes i takojnë të gjithë lumenjtë dhe përroskat e komunës së Rahovecit dhe shkallës i takon Drini i Bardhë.

Shkarkimi i ujërave të zeza në rrjedhjet lumore pa trajtim paraprak rritë shkallën e ndotjes së lumit. Mesatarisht çdo banor shkarkon 16.46 m^3/vit ujëra të zeza.

Në bazë të statistikave demografike numri i banorëve në Komunë është 56208 banorë, atëherë 56208 x 16.46=925183m^3/vit ujëra të zeza ose 49 litër/sek pa llogaritur objektet industriale.

Vendbanimet nuk kanë të rregulluar kanalizimin, përveç 9 prej tyre, por fatkeqësisht edhe ato vendbanime pa trajtim paraprak ujërat e zeza i shkarkojnë në mjedise të pastra.

Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka.

Përveç ndotjes kimike të ujërave, ku ndotësit hynë si përbërës i ujit, është ndotja fizike nga mbeturinat që nuk treten dhe përhapen në shtratin e lumit, e disa transportohen. Mbeturinat e ngurta që janë organike, ndikojnë në ndotjen biologjike, që pas dekompozimit të tyre krijohen dëmshëm për jetën e njeriut, florën dhe faunën që shtrihet përgjatë shtratit të lumit. Të gjitha këto lloje të ndotjeve i zvogëlojnë kushtet për botën e gjallë natyrore të ujërave.

Shkarkimi i mbeturinave të ngurta është dukuri tjetër negative e lumenjve të Kosovës, por edhe të vendbanimeve të komunës së Rahovecit. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime ku nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave.

3.7.1.3. NDOTJA E TOKËS

Administrimi efikas i tokës, mbrojtja e tokës bujqësore nga degradimi i mëtejshëm, mbrojtja e mjedisit dhe arritja e zhvillimit te qëndrueshëm është një sfidë e madhe jo vetëm për Rahovecin. Gjate viteve të fundit, është arritur një përparim i madh, megjithatë degradimi i tokës në zonat rurale dhe përreth zonave urbane si rrjedhojë e zgjerimit të pa kontrolluar urban, ndotja mjedisore dhe dëmtimet në burimet natyrore janë vetëm disa nga problemet qe duhet trajtuar për një menaxhim të mirë të këtij resursi jetik të ardhmen. Si çdo resurs tjetër natyror edhe toka duhet trajtuar seriozisht dhe në mënyrë të integruar për një zhvillim të qëndrueshëm. Trajtimi i integruar, kërkon zbatimin e politikave ekonomike, sociale dhe mjedisore ne një mënyre të përforcuar reciprokisht.

Megjithatë, duhet gjetur një ekuilibër midis nivelit të shfrytëzimit te tokës dhe mbrojtjes se mjedisit. Vonesat në përshtatjen e këtij trajtimi të integruar dhe vazhdimësia me veprimtari, të cilat e dëmtojnë se tepërmi mjedisin, rrezikojnë shëndetin publik dhe pakësojnë cilësinë e jetës, dhe qojnë në një rritje te madhe të kostos se përgjithshme te zhvillimit ekonomik.

Tokat sikur në shumicën e Komunave të Kosovës kryesisht në pjesët urbane dhe zonave për rreth shfrytëzohen kryesisht për aktivitete jo bujqësore siç janë ndërtimet për qëllime banimi apo objekte afariste dhe industri, ndërsa në zonat rurale toka kryesisht shfrytëzohet për aktivitete bujqësore.

Në Rahovec, zonat më të ndjeshme ndaj degradimit të tokën gjenden në zonat ku kemi ndërtime dhe zonat me erozion dhe vërshime.

Nga aspekti i ndotjes degradimi nënkupton futjen e përbërësve negative kimik të cilët shkaktojnë jo vetëm uljen e kapacitetit prodhues por edhe efektet negative në shëndetin e njeriut ndërsa nga aspekti i peizazhit degradimi i tokës nënkupton edhe pamjen e keqe të sipërfaqes së tokës dhe erozionin.

Llojet e degradimit të tokave janë:

- ***Erozioni*** i shkaktuar nga uji apo era;
- ***Ulja e pjellorisë*** si pasojë e zvogëlimit të materies organike, degradimit të vetive fizike, zvogëlimit të materieve ushqyese, ndotjeve (plehra, pesticide, me ujë të ndotur);
- ***Moçalizimi*** si pasojë e ngritjes së niveli të ujërave nëntokësor, kullimit jo të mirë apo ujitjes jo përkatëse;
- ***Kripëzimi*** me rritjen e koncentrimit të kripërave në tretjen tokësore si pasojë ujërave të ndotura apo të kripëzuara;
- ***Sedimentimi*** i shkaktuar nga vërshimet përmes bartjes së materieve të ndryshme nga uji;
- ***Ulja e nivelit të ujit nëntokësorë*** si pasojë e shfrytëzimit të madh të ujërave nëntokësorë;
- ***Zhveshja nga vegjetacioni*** i tokave si pasojë e prerjeve të pyjeve, ndërrimit të destinimit të tokës me çka shkaktohet erozioni;

3.7.1.4. NDOTJA NGA ZHURMA

Sa i përket ndotjes nga akustike nuk ka të dhëna në dispozicion për nivelin e ndotjes në komunë, andaj mund të jepen vetëm vlerësime të përgjithshme.

Fakti që përmes territorit të komunës kalon rruga Magjistrale M-9.1 Gjakovë – Klinë, si dhe rrugët regjionale ,: Rruga R-107 , Prizren-Xërxë- Gjakovë – me një gjatësi prej 11 km, Rruga R-110, Malishevë – Rahovec-Xërxë me një gjatësi prej 16.3 km, Rruga R111 , Xërxë –Ratkoc-Kramovik me gjatësi prej 17 km, Rruga R117 , Rahovec-Opterushë – deri në kufirin e KK të Suharekë me gjatësi prej 7.6 km, Rruga R204, Rahovec – Krushë e Madhe me gjatësi prej 12.4 km.

Kjo do të thotë se komuna është e ndikuar nga zhurma . Gjithashtu ndotësit tjerë janë veprimtaritë përpunuese/industriale siç janë fabrikat e betonit/çimentos pranë vendbanimit dhe gërmimet grumbulluese (gurthyesit) brenda territorit të komunës.

3.7.1.5. BIODIVERZITETI

Në pjesën kodrinore dominojnë pyjet me mjaft lloje dhe janë të përziera. Prej drunjëve dallohen pyjet gjetherënëse si: qarri (quercus cerris), dhe bungu me rreth 80 %, ahu (fagus sylvatica), shkoza (carpinus orientalis). Përhapje më të kufizuar kanë llojet tjera që paraqiten si të vetmuara si: brekia, bliri (tilia kordata), frashri, dëllinja, etj. Janë prezentë edhe tipet tjera që janë të ulëta, lloji i shkurreve, si: thana (cornus mas), murrizi (crataegus monogyna), kaça (rosa canina), manaferra e egër (rubus fruticosus), shtogu (sambocus nigra), kulumbria (prunus spicosa), lajthia (corylus avellana), në vise të larta fieri shqiponje (pteridium aquilinium), etj. Prej bimëve barishtore ka lloje të ndryshme, si ato që rriten në ambient të hapur pa prezencë të drunjtëve, si dhe ato që rriten brenda pyjeve. Këtu rriten edhe bimë të çajit që njihen si çaji i malit (origanum vulgare), kantarioni (hypercium perforatum), kamomili (matricaria chamomila), dredhëza (fragaria vesca), etj. Në territorin e kësaj komune ka fare pakë pyje gjethembajtëse. Hapësira e rrafshët e komunës është shumë pak e mbuluar me drunjë, ndërsa zakonisht rritet shelgu (salix alba) në brigje të lumenjve. Bimë të ulëta ka mjaft si: lulëkuqja që rritet zakonisht në grunaja (papaver rhoeas), hithi (urtia dioica), formacionet e livadheve (tërfilli) dhe shkurre të rralla. Livadhe ka pakë në këtë komunë. Fauna është me mjaft lloje që nuk janë karakteristike vetëm e këtyre hapësirave. Në pyje jetojnë ujku (canis lupus), dhelpra, lepuri (lepus europaeus), iriqi (ernaceus europeus), etj. Jeton gjarpri i ujit (natrix natrix), gurit (vipera ammodytes), bollujca (tropidonatus natrix), kërmilli i vreshtës (helix pomatia), breshka e rëndomtë (testudo bermanni). Llojet e peshqve janë të shumtë. Në lumin Drini i Bardhë jetojnë 18, ndërsa llojet më kryesorët janë: trofta, mustaku , mlyshi, ngjala, krapi, etj. Insekte ka shumë lloje si janë: fluturat, milingonat që bëjnë koloni dhe janë disa lloje, merimanga, kaçadreri (lucanus cervus), etj. Prej shpezëve jetojnë mjaft lloje si: trishtili kokëzi (parus major), zogu i malit, pëllumbi i egër (columbia livia), qukapikthi (dryobates major), laraska (pica pica) qyqja (cuculus canorus), etj. Shpezët grabitqarë që jetojnë në këtë territor janë shqiponja e zezë (aquilachyretos), petriti (malco tinnunculus). Shpezët shtegtare që jetojnë janë dallëndyshja, lejleku, etj.

SWOT Analiza

PERPARËSITË	DOBËSITË
Toka bujqësore për kulturën e vreshtarisë, pemëtarisë	Degradim i shtretërve të lumenjve
Cilësia e ajrit	Shfrytëzimi i pa kontrolluar i inerteve,
Burimet natyrore	Deponitë joformale të mbeturinave,
Cilësia e tokës bujqësore	Shkarkimi i ujërave të zeza të pa trajtuara,
Trashëgimi natyrore,	Ngrohja individuale me thëngjill dhe dru e objekteve, në
Zvogëlimi i deponive ilegale	mungesë të ngrohjes qendrore ne pjesën urbane,
Përgatitja dhe angazhimi maksimal i Drejtorisë për	Mbrojtja jo e mirë nga vërshimet dhe erozioni
Mbrojtje dhe Shpëtim për përballje me situata emergjente	Ndërrim destinimi i tokave bujqësore në ato ndërtimore

Plnet e hartuara si masë preventive në raste të reagimit në situata emergjente	Shtrirja e vendbanimeve përgjatë lumenjve
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Shfrytëzim i qëndrueshëm I tokave bujqësore, **Largimi i deponive ilegale** **Promovimi i vlerave mjedisore,** **Masat anti-erozion,** **Peizazhe të përshtatshme për pushim dhe rekreacion (Ura e Fshejtë dhe Kanioni i Mirushës)** **Favorizimi i vreshtarisë, perimtarisë dhe pemëtarisë** **Vetëdijesimi i qytetarëve për mbrojtje mjedisore** **Infrastruktura për mbrojtje nga rreziqet hidrometeorologjike**	Degradimi i tokave bujqësore përgjatë shtratit të lumit Drini I Bardhë Ndikimi negativ në biodiversitet, Dëmtimi i pyjeve nga faktori njeri Rreziku nga vërshimet, Përhapja e epidemive për mungesë të sistemit të kanalizimit qendror fekal, të ujërave të zeza dhe mbeturinave. Prania aktuale dhe zgjerimi i vendbanimeve në zona me ekspozim të lartë ndaj fatkeqësive sizmike. Vendbanime të rrethuara së paku në tri anë me sipërfaqe pyjore, si rrezikshmëri e zjarreve të pa kontrolluara Sizmologjia e shkallës 7^{o} dhe 8^{o} të Rihterit, në Komunën e Rahovecit

3.7.2. Sipërfaqet me rrezikshmëri

3.7.2.1. Erozioni

Erozioni në territorin e Rahovecit rrezikon natyrën dhe pasuritë shoqërore dhe private të krijuara dhe të planifikuara nga njerëzit. Erozioni manifestohet me degradimin e tokës bujqësore, pyjore, rrjetit rrugor dhe hekurudhor si dhe me degradimin e objekteve ndërtimore dhe vendbanimeve.

Andaj komunës i rekomandohet:

Reduktimi i shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identifikuar me erozion të lartë dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrolli i duhur i zhvillimeve të reja është një sfide tjetër. Territoret me erozion të dobët kapin sipërfaqe 8118.4 ha. Shtrihen në pjesën qendrore të komunës dhe përfshijnë vendbanimet, Rahovec, një pjesë Brestoc, një pjesë Hoçë e Vogël, Bërnjakë, Sapniq, Pataqan i Poshtëm dhe i Epërm, Nashpallë, Vrajakë, Bratatin, Drenoc, një pjesë, Senoc, Pastaselë, Polluzhë, Guri i Kuq, etj. Erozioni i mesëm shtrihet në sipërfaqe prej 11350/ha. Ka shtrirje të madhe në hapësirë. Ky lloj erozioni shtrihet kryesisht në Veri dhe në Perëndim të komunës.

Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Rahovecit kapin sipërfaqe prej 581.6 ha. Ka shtrirje në pjesën Jug-Lindore të komunës. Shtrirje më të madhe ka në lokalitetet Hoçë e Madhe, Hoçë e Vogël dhe Brestoc.

Kategoria erozive	Sip. (Ha)
Sipërfaqet pa erozion	831.7
Erozion shumë i dobët	6905.0
Erozion i dobët	8118.4
Erozion i mesëm	11350.0
Erozion shumë i fortë	581.6

Tabela 191 Shkalla e erozionit në komunë

3.7.2.2. RRËSHQITJET E TOKËS

Rrëshqitjet e tokës janë karakteristik e të gjithave Komunave në Kosovë e sidomos në Komunën e Rahovecit ku ditë e më shumë po ndërtohen ndërtime të larta andaj saj përket rrëshqitjes së tokës Komunën e Rahovecit e përcjellin këto probleme: Më rrëshqitjen e tokë ne lokacionet si; Fortesë, Sapniq,

Krushë e Madhe, Celinë, Çifllak, Dejnë, Xërxë, Gexhe, Radostë, Ratkoc dhe pjesa jugore e qytetit të Rahovecit (Nën qyteti), etj.

3.7.2.3. TËRMETET

Pasi rajoni i komunës së Rahovecit gjendet në pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit ku reliefi është rrafshinë – luginor – kodrinore – malore, nga një tërmet eventual i goditur varësisht nga shkalla e goditjes do të jetë edhe me pasoja të ndryshme.

Në bazë të një harte seizmologjike të Kosovës, territori i komunës sonë gjendet në zonën me intensitet maksimal në mes 7º d+ he 8º (shkallë) të Riterit. Tërmeti mes 7º e 8º të intensitetit është shkatërrues, do të dëmtonte këto zona: Rahovecin me zonën, luginën e lumit Drini i Bardhë dhe Malësinë e Zatriqit. Tërmeti i tillë mund të shkaktoj fatkeqësi të mëdha deri te dëmtimi i pendës së liqenit artificial "Radoniqi". Po të ndodh një tërmet i tillë për rajonin e Anadrinisë e më gjerë, kishte me u shkaktua katastrofë natyrore d.m.th., një vërshim me dimension të gjerë të paparashikuar në vendbanime e fusha buzë lumit Drini Bardhë.

Cilësia dhe mjeshtëria

Është e zakonshme të thuhet se ndërtesat që janë ndërtuar mirë do të jenë më të qëndrueshme sesa ato që nuk janë ndërtuar mirë. Përdorimi i materialit të cilësisë së mirë dhe i teknikave të mira të konstruktimit, do të garantonte ndërtesë mirë të ndërtuar, që mund t`u bëj ballë lëkundjeve sesa ajo që është ndërtuar me material më të dobët.

Në rastin e strukturave të ndërtuara me inxhinieri të dobët, mund të ndodhë që strukturat e konstruktuara të mos i përmbushin siguritë e kodit përkatës sizmik të ndërtesës.

Intensiteti dhe epiqendra

Shkatërrimet dhe dëmtimet do të jenë varësisht nga intensiteti dhe epiqendra e tërmetit në një rajon.

Në se intensiteti i tërmetit është më i madh edhe dëmtimet e objekteve do të jenë më të forta. Por, kjo do të varet edhe nga epiqendra e tërmetit. Nëse vendbanimet do të jenë më afër ose në epiqendrën e tërmetit edhe rrënimet e objekteve do të jenë më të mëdha dhe me pasojat e katastrofave si në jetën e njerëzve dhe në mjetet materiale.

Rrokullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës

Pasi që Rahoveci nuk ka një lartësi mbidetare të lartë dhe nuk është e rrethuar me male të larta mundësia e rrezikimit të popullsisë nga dëbora klasifikohet e mundshme, me periudhën e rrezikut shumë të rrallë (1 herë në vit ose më pak), me dëme të vogla për popullsinë dhe në dëme materiale. Rrugët më të rrezikuara gjatë sezonit dimëror janë rrugët kodrinore – malore të fshatrave . Ortekët e borës dhe ngricat të cilat në një masë të konsiderueshme pengojnë funksionimin e përshtatshëm në mundësinë e furnizimit me prodhime vitale, ndërprerjen e komunikacionit, pamundësinë e ofrimit të ndihmës mjekësore në pjesët rurale të komunës.

3.7.2.4. ERËRA

Erërat Në Rahovec më së shpeshti fyejnë erërat prej veri-lindjes (62 %), perëndimit (50%), nga lindja (17%), jugut (14 %) dhe ndërsa më së paku fryjnë nga veriu (11,8 %), dhe jug-lindja (4 %)Shpejtësia mesatare e erës në m/sek në Rahovec Është me rëndësi të theksohet se ky territor është nën ndikimin e klimës mesdhetare e cila depërton përmes luginës së lumit Drini Bardhë. Klima është mjaftë e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturën e ajrit gjatë vitit.

3.7.2.5. DIELLOSJA

Insolacioni ose Diellosja është ndriçimi i Diellit brenda kohës së caktuar (ditë, muaj, vit).Vlera e diellosjës zakonisht shprehet në orë me diell mesatarisht në vit.

Diellosja varet nga shumë faktorë. Disa prej tyre janë të qëndrueshëm dhe quhen faktorë klimatik (gjerësia gjeografike, lartësia mbidetare, përhapja e masave tokësore dhe ujore, etj.), ndërsa të tjerët u nënshtrohen ndryshimeve dhe quhen elemente klimatike (lagështia e ajrit, retë, temperatura e bazës dhe e ajrit, erërat, etj.)Ditët me diell zgjasin rreth 44 % prej ditëve të mundshme që është një vlerë e lartë. Mesatarisht numri i ditëve me diell mbi 9 orë në Prishtinë është 90 ditë gjatë vitit, e mbi 1200m.lartësi mbi detare ka 112ditë

Në bazë të vrojtimeve të diellosjes në katër stacionet metrologjie (Prishtinë, Ferizaj, Prizren, Pejë), Kosova ka mesatarisht 2079 orë me diell gjatë vitit ose mesatarisht 5,7 orë në ditë. Vlera më e lartë e diellosjes e regjistruar në Prishtinë është 2140 orë /vit (h/v) dhe më e ultë në Pejë: 1958 orë /vit (h/v). Gjatë vitit në muajin korrik ka më së shumti diellosje, kurse në dhjetor më së paku.

3.7.2.6. SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LART (HOT-SPOTET)


Sasia e mbeturinave e cila grumbullohet brenda një dite sillet 20-30 ton, kurse sipas raporteve të dy kompanive që operojnë në Komunën e Rahovecit, shërbimi i grumbullimit të mbeturinave zhvillohet në të gjitha vendbanimet e komunës, megjithatë një pjesë e amvisërive nuk pranon të bëjë marrëveshje me operatorët. Pavarësisht mbulushmerisë prej 100%, prapë se prapë haset në deponi ilegale si dhe hedhje e mbeturinave në mënyrë të pa kontrolluar, po ashtu janë të evidentuara edhe “hot-spotet” (pikat e ndjeshme) të ndikimeve mjedisore në këtë komunë me theks të veçantë në sektorin e mbeturinave, sipas raportit për mbeturinat i botuar më 2014, i cili është përgatitë nga Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit i Kosovës (AMMK). Komuna e Rahovecit cilësohet të ketë ndikim prej 3-5ha të hapësirës komunale të mbuluar me deponi ilegale. Komuna e Rahovecit i eliminon të gjitha deponitë ilegale të mbeturinave.

Arsyet kryesore për grumbullimin jo të plotë të mbeturinave janë të ndryshme, si:

- Niveli i ulët i vetëdijes në mesin e banorëve;
- Kapacitetet e kufizuara të Ndërmarrjes Publike për menaxhimin e mbeturinave;
- Mos pagesa e një pjesë të përfituesve të shërbimit;
- Mos zgjidhja e çështjes së mbeturinave ndërtimore (demolimeve);
- Problemi i pazgjidhur i menaxhimit të mbeturinave nga mbetjet shtazore;
- Shkalla e ulët dhe informale e ndarjes dhe riciklimit.

Aktualisht, operatori më i madh është KRM “EKO Regjioni”, e cila sipas shënimeve ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme, dhe atë 100% të zonës urbane dhe rreth 27% në zonat rurale. Kurse operatori tjetër “Ekodrinia", shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Me gjithë përparimet e shënuara, disa kategori të mbeturinave paraqesin një sfidë jo të lehtë për komunën, në veçanti mbeturinat ndërtimore/demolimit, mbeturinat shtazore, etj.



Harta 34 Harta e menaxhimit të mbeturinave

3.7.2.7. MBETURINAT NDËRTIMORE/DEMOLIMET

Komuna e Rahovecit ka deponi legale për deponimin e materialeve inerte. Kjo deponi gjendet rreth 5km nga qyteti i Rahovecit. Në raste të caktuara hedhja e pakontrolluar e këtyre mjeteve mund të krijojë deponi të egra dhe hedhjen e mbeturinave të ndryshme nga ana e banorëve dhe bizneseve. Përpos kësaj, nuk ekziston lidhja në mes të dhënies së lejeve ndërtimore dhe sistemit të monitorimit të hedhjes së mbeturinave.

3.7.2.8. MBETURINAT NGA MBETJET SHTAZORE:

Menaxhimi i mbetjeve shtazore në komunën e Rahovecit nuk është në harmoni me dispozitat respektive, në rend të parë për shkak të mungesës së impiantit të trajtimit të mbetjeve shtazore. Në komunë ekzistojnë 8 subjekte që merren me prodhimin, përpunimin dhe konservimin e mishit, prej tyre 3 mishtore dhe 5 thertore. Me disa prej tyre operatori aktual ka kontrata të shërbimit dhe i grumbullon mbeturinat, ndërsa një pjesë e subjekteve i hedh këto mbeturina në formë ilegale. Për më shumë, edhe mbeturinat me prejardhje shtazore që grumbullohen nga ana operatorit te licencuar nuk është e qartë si trajtohen meqë deponia regjionale nuk pranon që ky lloj i mbeturinave të deponohet në këto lokacione të veçanta.

3.7.2.9. LOKACIONET KRITIKE TË ZJARREVE PYJORE DHE PËRCAKTIMI I SHKALLËS SË RREZIKSHMËRISË

Në bazë të parametrave të deritashëm dhe shpeshtësisë së rënies së zjarreve dhe funksionalitetit në pikëpamje planifikuese dhe reaguese sipërfaqet pyjore i kemi ndarë në 4 njësi pyjore kritike me karakteristika afërsisht të njëjta të vlerësimit dhe reagimit. Zonat që shtrihen përgjatë paraleleve Opterushë, Rahovec, Zatriq, Kaznik për shkak se kanë konfiguracion tejet të vështirë për shkak të thellësisë për qasje në vendngjarje, ato konsiderohen si zona me rrezikshmëri të lartë.

Uji është mjet më efikas për shuarjen e zjarreve pyjore, andaj është e domosdoshme pajisje e Njësisë Zjarrfikëse me automjete tanker me ujë për terrene malore, ndërsa për terrene ku nuk mund të ketë qasje këmba e njeriut në zona të thepisura malore përmes nivelit qendror të angazhohen fluturake nga ajri.

Nr.	Njësitë pyjore	Sipërfaqe	Lloji i drunjëve
1.	Kaznik	2.052.6 ha.	Pisha, shkoza, bungu
2.	Zatriq	3.029.6 ha.	Shkozë, bung
3.	Rahovec	1.227.7 ha.	Shkoza, bungu, dushk
4.	Opterushë	1.129.7 ha.	Shkozë, bung
5	Çifllak, Xërxë, Krushë	252.4 ha.	Shkozë, bung
	Gjithsej	7692 ha.	

3.7.3. PËRMBYTJET

Në Rahovec përmbytjet e Lumenjve dhe Përmbytjet nga reshjet e shiut paraqesin një rrezik mjaft te madh. Faktori njeri me aktivitetin e vetë ka shkaktuar dëme të mëdha përgjatë shtratit lumor në rrjedhjen e mesme dhe të poshtme ku në disa raste janë edhe të pariparueshme. Nxjerrja ilegale e inerteve përgjatë pellgut lumor pa kritere ka shkaktuar degradim të shtratit lumor ku pasojat janë të mëdha gjatë periudhave të lagështa të vitit që manifestohen me vërshime. Ndërtimi i objekteve të banimit, objekteve ekonomike dhe objekteve tjera përgjatë shtretërve të lumenjve si dhe hedhja e mbeturinave te ngurta dhe shkatërrimi i botës bimore përgjatë brigjeve lumore ka ndikuar që ato regjione te jenë te ekspozuara rrezikut permanent nga vërshimet. Andaj komuna e Rahovecit duhet te bej një studim te veçantë për vërshimet dhe rezultatet e këtij studimi duhet te jenë determinuese dhe te inkuadrohen ne këtë plan.

Zonat që mund të goditen më së shumti: Fshatrat - Fortesë, Sapniq, Krushë e Madhe, Celinë, Çifllak, Dejnë, Xërxë, Gexhë, Radostë, Ratkoc dhe pjesa jugore e qytetit të Rahovecit (Nën qyteti).

-Periudhat e rrezikut nga vërshimet: Në Komunën e Rahovecit janë dy periudha sezonale gjatë vitit që karakterizohen me vërshimet:

- Sezona dimërore që manifestohet me reshjet të shumta të borës, dhe
- Sezona pranverore dhe vjeshtore që manifestohet me sasi më të shumta të reshjeve të shiut.

Në bazë të dhënave historike gjatë dhjetë viteve të fundit nga statistikat e stacioneve meteorologjike rezulton se reshjet më të dendura të borës gjatë vitit është dimri në muajt janar dhe shkurt, kurse stinët me reshje të dendura të shiut janë pranvera (prill- maj) dhe vjeshta (shtator-tetor).

Vërshimet e fundit në Komunën e Rahovecit:

- Qershor 2018, janë të prekur 129 ekonomi familjare në këto lokacione: Rahovec, Krushë e Madhe, Nagavc, Hoçë e Vogël, Brestoc, Sapniq, Fortesë, Celinë, Radostë, Ratkoc dhe Xërxë, ku janë shkaktuar dëme materiale në vlerë prej 248,560.00 €;
- Në periudha kohore nga viti 2018 deri në vitin 2021 kanë ndodhur vërshime, breshëri dhe shembje të dheut në sipërfaqe të mbjella me kulturat bujqësore në sipërfaqe prej 3,055.48 ha në vlerë prej 9,151,758.37 €;
- Sipas shënimeve statistikore që kemi për të reshurat e shiut mund të konstatojmë që sasia mesatare vjetore e të reshurave është afër 87,98 mm/m², kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të 4-9) afër 56,17 mm/m², mirëpo kjo është variabile varësish nga viti.
- Në muajin maj 2020, janë të prekura 42 ekonomi familjare dhe dëme të shkaktuara në vlerë 97,244.00 €, lokacione të atakuara janë: Rahoveci, Pataqan i Poshtëm, Pataqan i Epërm, Drenoc dhe Kramovik;

- Në muajin janar 2021, janë të prekura 201 ekonomi familjare dhe dëme të shkaktuara në vlerë 530,948.00 €. Bizneset të cilat janë dëmtuar nga vërshimet janë 7, në vlerë prej 48,425.00 €. Lokacionet në të cilat kemi pasur vërshime janë: Rahovec, Fortesë, Xërxë, Dabidol, Çifllak, Sopniq, Krushë e Madhe, Celinë, Opterushë, Denjë, Ratkoc, Hoçë e Vogël dhe Radostë. Në janar 2021, ka pas dëme të konsiderueshme materiale në infrastrukturë publike duke përfshirë rrugë, trotuare, kanalizim, rrugë fushore, të cilat kapin shumën prej 199,783.50.



Figura 29 Vërshimet në Rahovec

3.7.3.1. MASAT PREVENTIVE NGA VËRSHIMET

Si masë preventive për parandalimin e vërshimeve, Drejtoria për Mbrojtje dhe Shpëtim rekomandon masat parandaluese afatgjata, afatmesëm dhe afatshkurtër.

Të vazhdohet me pastrimin dhe rregullimin e shtratit të lumit Drini i Bardhë nga Kramoviku deri në Krushë të Madhe, si dhe shtratin e disa përrenjve të cilët janë të mbushura me material të ngurtë.

Po ashtu si masë tjetër parandaluese për zvogëlimin e dëmeve nga vërshimet në rrugët e qytetit në Rahovec, është edhe pastrimi i kanalizimit për ujërat atmosferikë që shpesh bllokohet dhe paraqet problem gjatë reshjeve të shiut dhe shkrirjes së borës.

Masë tjetër parandaluese është edhe vetëdijesimi i popullatës për mos hedhjen e mbeturinave pranë brigjeve të lumit dhe përrenjve, si dhe ndëshkim i të gjithë atyre që bëjnë hedhjen e mbeturinave larg vendeve të caktuara.

Sipas shënimeve statistikore që kemi për të reshurat e shiut mund të konstatojmë që sasia mesatare vjetore e të reshurave është afër 87,98 mm/m², kurse në sezonin e vegjetacionit (prej muajit të IV – IX)afër 56,17 mm/m², mirëpo kjo është variabile varësish nga viti . Është bërë rregullimi i shumë shtretërve të lumenjve dhe përroskave në komunën e Rahovecit. Rregullimi i shtratit të lumit Duhllo në Rahovec, dhe rregullimi i shtretërve të përrenjve në fshatra: Opterush, Pataqan dhe Radostë. Janë duke u rregulluar shtretër të lumenjve në fshatrat: Hoçë e Madhe, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagavc, Krushë e Madhe dhe Fortesë. Rregullimi i kanaleve të kullimit në fshatrat: Sapniq, Celinë, Dejnë.




Figura 30 Harta e planit për mbrojtje nga rreziqet natyrore

PËRPARSITË	DOBËSITË
Pjesa më e madhe e territorit të Komunës së Rahovecit është e mbuluar me Vegjetacion **Komuna ka një plan për mbrojtjen nga zjarri** **Zvogëlimi i deponive ilegale** **Përgatitja dhe angazhimi maksimal i Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim për përballje me situata emergjente** **Planet e hartuara si masë preventive në raste të reagimit në situata emergjente**	Mungesa e rezervarëve te ujit në vendet ku janë të rrezikuara potencialisht nga zjarret Sipërfaqe të Shpyllëzuara Humbja e tokës bujqësore nga erozioni Shtretër të ngushte të lumenjve që rrit mundësinë për erozion dhe vërshime Rrugë të ngushta për intervenimin e zjarrfikëseve Rrjeti i vjetër i ujësjellësit që qon shpesh në vërshime sipërfaqësore në disa lagje të Rahovecit Mungesa e zbatimit të ligjeve në fuqi Shfrytëzimi jo racional i hapësirës Zgjerim i qytetit me ndërtime, zënia e tokës Bujqësore Zjarr vënia nga faktori Antropogjen (njeri) Përmbytja si rezultat I mungesës së rrjetit të drenazhimit
MUNDËSITË	**RREZIQET**

Organizimi i trajnimeve, mbi vetëdijesimin e popullatës për rrezikun dhe pasojat që mund të vijnë nga veprimtaria e erozionit, ortekut, rrëshqitjet e dheut zjarret, etj. **Pyllëzimi i hapësirave ku janë të afektuara nga erozioni, rrëshqitjet e dheut** **Komuna e Rahovecit duhet të përkrahë përdorimin e lëndëve djegëse me cilësore.** **Të pajisen dhe mbështeten zjarrfikësit me pajisje adekuate për menaxhim të zjarreve** **Sigurimi i brezave mbrojtës për largpërçuesit elektrik në fshatrat malore për zvogëlimin e mundësisë së zjarreve** **Shfrytëzimi i ujërave nëntokësorë për ujitjen e parqeve, rrugëve** **Krijimi i akumulimeve artificiale-** **Aplikimi i metodave SMART për këtë fushe.** **Lagunave me destinime mbrojtjen nga vërshimet dhe shfrytëzimi e ujit për ujitje dhe rekreacion** **Përcaktimi i zonave të evakuimit në rast të tërmetit**	Degradimi i tokave bujqësore përgjatë shtratit të lumit Drini I Bardhë Ndikimi negativ në biodiversitet, Dëmtimi i pyjeve nga faktori njeri, rreziku nga vërshimet, Përhapja e epidemive për mungesë të sistemit të kanalizimit qendror fekal, të ujërave të zeza dhe mbeturinave. Prania aktuale dhe zgjerimi i vendbanimeve në zona me ekspozim të lartë ndaj fatkeqësive sizmike. Vendbanime të rrethuara së paku në tri anë me sipërfaqe pyjore, si rrezikshmëri e zjarreve të pa kontrolluara Sizmologjia e shkallës 7^{o} dhe 8^{o} të Rihterit, në Komunën e Rahovecit.

Tabela 192 SWOT Analiza për sipërfaqet me rrezikshmëri

3.7.4. Identifikimi i sfidave

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar disa sfida të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.

Sfidat e identifikuara në gjitha komponentët mjedisore janë:

- Sigurimi i fondeve për projektet mjedisore
- Parandalimi i ndotjes së ajrit;
- Menaxhimi i mbeturinave është ndër sfidat më të mëdha mjedisore në Komunën e Rahovecit
- Edukimi mjedisor
- Trajtimi i zonave ku ka deponi të Mbeturinave
- Parandalimi i humbjes së tokës bujqësore nga ndërtimet
- Trajtimi i ujerave të zeza
- Ruajtja e cilësisë së ujit dhe burimeve ujore
- Parandalimi nga degradimi i tokave dhe ndotja e tyre përmes masave dhe politikave specifike për mbrojtjen e tokave
- Parandalimi i ndotjes nga zhurma
- Parandalimi Erozionit
- Vetëdijesimi i faktorit njeri për ruajtjen pyjeve nga zjarret

3.7.5. GJETJET KYÇE

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar gjetjet kyçe të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit, si:

- Mungesa e një trupe koordinuese nga nivelet e ndryshme qendrore dhe lokale për marrjen e masave për zvogëlimin e ndotjes së ajrit dhe komponentëve tjera në kohët e pikut dimëror dhe pikut veror.
- Ndotje e Ajrit, Ujit dhe Tokës.
- Sfida me parandalimin e vërshimeve ne zonën urbane dhe ne zonat rurale sidomos ne tokat me bonitet të lart.

3.7.6. IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE

Gjatë analizës së gjendjes ekzistues në fushën e Mjedisit dhe sipërfaqeve me rrezikshmëri janë identifikuar problemet të cilat vijnë si rezultat i problemeve administrative, ekspertizës dhe mungesës së investimeve në lëmin e mbrojtjes së mjedisit.

3.7.6.1. NDOTJA E AJRIT

- Përdorimi i vazhdueshëm i lëndëve djegëse fosile dhe drusore në qytet nga banorët dhe bizneset.
- Ndotja e ajrit, zhurma e lartë, prania e valëve elektromagnetike nga transmetuesit e ndryshëm, kujdesi jo i duhur ndaj gjelbërimit në qendër të qytetit dhe mungesa hapësirave të gjelbërta në zona banimi sidomos gjelbërimit të lartë të përshtatshëm dhe qëndrueshëm për zona të caktuara, janë indikator kyç që alarmojnë për veprime të ngutshme në financim dhe përmirësim të mjedisit në Qytetin e Rahovecit.
- Një trafik shumë i dendur, me numër të madh automjetesh, vende të pakta për parkim dhe cilësi Jo e duhur e karburanteve, që drejtpërdrejt ndikojnë në ndotjen ajrit dhe rrezikimin e shëndetit të popullatës.
- Monitorimi i cilësisë së ajrit.

3.7.6.2. NDOTJA UJIT

- Qasja akoma e ultë në kanalizime,
- Menaxhim i dobët i mbeturinave,
- Shkarkimi i ujerave të zeza në lumenj
- Përdorimi i pesticideve të tepërta dhe pa kritere në afërsi të zonave ujore;
- Deponitë e mbeturinave përgjatë shtratit të lumenjve
- Monitorimi i pamjaftueshëm i cilësisë së ujërave të zeza (detergjentet, sapunët, vajrat, pesticidet, metalet e rënda, radioaktiviteti, etj.);
- Kontrolli i dobët i lejeve ujore dhe pëlqimeve Mjedisore.

3.7.6.3. NDOTJA E TOKËS

- Humbja e Tokës Bujqësore me bonitet të Lartë nga ndërtimet,
- Humbja e tokës nga erozioni,
- Mos Mbulesa e gjithë hapësirës ku ka tokë bujqësore me kanale të ujitjes për ta rritur bonitetin e tokës,
- Përdorimi i pesticideve të tepërta dhe pa kritere.

3.7.6.4. NDOTJA NGA ZHURMA

- Niveli i lartë i zhurmës si ditën, ashtu edhe natën,
- Mungesa e dokumenteve për parandalimin e ndotjes nga zhurma.

3.7.6.5. BIODIVERZITETI

- Humbja e sipërfaqeve pyjore, habitateve kryesore të llojeve shtazore dhe bimore,
- Rrezikimi i specieve të rralla nga zhdukja,
- Gjuetia e pa kontrolluar në zonat rurale.

3.7.6.6. VËRSHIMET

- Shtretër të ngushtë të lumenjve,
- Mbeturina në përroska dhe lumenj.

3.7.6.7. EROZIONI DHE SHKARJET E DHEUT

- Shpyllëzimi i hapësirave,
- Nxjerrja e rërës dhe zhavorrit,
- Ndërtimet pa kriter dhe ne mos përputhje me planet e Komunës.

3.7.6.8. TËRMETET

- Mungesa e Analizave Mikro-sizmike për Komunën e Rahovecit,
- Cilësi jo e duhur e ndërtimeve.

3.7.6.9. RROKULLISJA E MASAVE SHKËMBORE DHE ORTEKËT E DËBORËS

Pasi që Rahovecit nuk ka lartësi të lartë mbidetare nuk është e rrezikuar ose me mirë të themi që është pak e rrezikuar nga Rrokullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës. Dhe në Bazë te të dhënave që janë analizuar nuk ka pas bllokime të rrugëve, dëmtime në njerëz ose dëme materiale.

3.7.6.10. ERËRAT

Mungesa e një plani për gjelbërim mbrojtës dhe plan për peizazhe natyrore brenda qytetit

3.7.6.11. SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LARTË (HOT-SPOTET)

- Mungesa e Lokacionit për mbeturinat e ngurta,
- Mos riciklimi i mbeturinave.

3.7.6.12. SIPËRFAQET E RREZIKUARA NGA ZJARRI

- Rrugët e ngushta si ne zonën urbane po ashtu dhe ne zonën Rurale,
- Zjarr vënia e qëllimshme.

3.7.7. Konstatimet kryesore

3.7.7.1. Ndotja e ajrit konstatimet

- Menaxhimi i rrjetit rrugor,
- Promovimi i teknologjive të pastërta,
- Nxitja e çiklizmit,
- Rritja e sipërfaqeve të gjelbra.

- Bizneset të cilat përdorin lënde djegëse të kontrollohen dhe të obligohen të pajisen me LMK (përmirësimi i ventilimit dhe cilësisë së lëndës djegëse).
- Vendosja e brezave dhe shiritave të gjelbër me kapacitete për absorbim të aerosolëve, gazrave azotike, të sulfurit dhe karbonike, metaleve të rënda për gjatë rrugëve kryesore të Rahovecit.
- Rivitalizimin e parqeve ekzistuese dhe ngritjen e parqeve të reja në hapësirat e identifikuara si te lira dhe të mundshme për ngritjen e këtyre parqeve
- Mbrojtja, zhvillimi e sidomos kultivimi i pyjeve të reja edhe me kapacitete për thithje të Gazrave që e Ndotin Ajrin.
- Përcaktimin e kritereve për sipërfaqet e gjelbra të detyrueshme në lejet e reja të ndërtimit, me prioritet në qytetin e Rahovecit dhe nën – qendrat.
- Përmirësimin e qarkullimit rrugor për shmangien e fluksit të madh të automjeteve nëpër qendra të vendbanimeve, ku është e përqendruar dhe pjesa më e madhe e popullsisë;
- Pengimi i shkarkimeve të ndotësve në ajër nga Industria dhe makinat lëvizëse me vendosjen e katalizatorëve dhe rregullimeve tjera në aspektin teknik dhe largimin e të vjetrave nga trafiku.
- Shfrytëzimin e energjive alternative (kryesisht energjia diellore, rrjedhat e ujit, e erës dhe energjia gjeotermale)
- Promovimin e lëvizjeve jo të motorizuara duke planifikuar edhe stazat për çiklist dhe ecje në këmbë.
- Rikonstruktimi rrugëve (çark orëve dhe bajpaseve në qendrën urbane, kanalizimeve dhe mënjanimi i deponive të mbeturinave që janë burim i ndotjes së ajrit nga djegiet dhe oksidimet e mbeturinave, etj.

3.7.7.2. NDOTJA E UJIT KONSTATIMET

- Të gjitha burimet e ujërave natyrale, dhe ujërave tjerë nëntokësorë dhe sipërfaqësor të mbrohen, bashkë me caktimin e zonës së mbrojtjes së obligueshme rreth burimeve, kaptazheve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve, me regjim te caktuar të mbrojtjes, varësisht nga destinimi i objektit. Në këto zona nuk mund të ndërtohen objekte e të zhvillohen punime tjera, as të shfrytëzohet toka në mënyrën e cila rrezikon sasinë dhe kualitetin e ujit.
- Merren masat për mos lejimin e ndotjes së lumenjve, ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore nga ujërave të përdorura dhe ndyta prej vendbanimeve duke rekomanduar trajtim në dalje me gropa septike dhe forma tjera vendosja e aparateve për pastrim deri te impianti.
- Në të ardhmen është e domosdoshme të merren masa afatshkurtra dhe afatgjatë që ujërat e përdorura, të ndyta (urbane, industriale) para se të lëshohen, të pastrohen në pikëpamje fizike biologjike dhe kimike. Për këtë qellim, është e nevojshme:
- Dokumentacioni investivo-teknik për industritë e reja duhet të përmbajë edhe vendimin e pastrimit të gjitha ujërave të përdorura, të ndyta. Puna e kapaciteteve të reja industriale nuk duhet të lejohet pa u montuar më parë aparatet të cilat do të sigurojnë pastrimin e ujërave të ndyta në mënyrën e duhur.
- Nevojat e popullsisë për ujë do të rriten vazhdimisht. Në periudhën e ardhshme Sigurimi i sasisë së nevojshme të ujit të shendosh të pijes për popullsinë e Rahovecit do të jetë edhe në të ardhmen probleme seriozë. Disa zgjidhje për qendrën komunale dhe vendbanimet për rreth janë paraparë edhe në këtë dokument, për sigurimin e sasive të parapara të ujit dhe të sasive plotësuese rezervë është e domosdoshme mbrojtja e disa burimeve, rrjedhave të lumenjve dhe akumulacioneve. Pos kësaj shfrytëzimi racional i ujërave në këtë komunë është detyrë me rëndësi e të gjithë faktorëve të planifikimit dhe të shfrytëzimit të ujit dhe hapësirës.

- Mbrojtje e veçantë e ujërave duhet ti kushtohet edhe nga përdorimi i pa kontrolluar i plehrave artificiale për bujqësi (nitratet, nitritet, fosfatet dhe nutrient tjerë.)
- Mbrojtje tjetër parashikohet edhe nga mbeturina (të gjitha tipat e mbeturinave) duke planifikuar deponi që janë të organizuara dhe të cilat kanë marr parasysh ketë faktor deri te planifikimi i varrezave kolektive të kafshëve në raste emergjente.

3.7.7.3. NDOTJA E TOKËS KONSTATIMET

- Parashikohet mbrojtja në kuptimin e hapësirës së tokës dhe resurseve tokësore nga tjetërsimi për qëllime jobujqësore me kufizim të shtrirjes së ndërtimeve vetëm brenda kufijve ndërtimor të planifikuar.
- Planifikohet të bëhen në mënyra të vazhdueshme monitorimi dhe kontrolla e plleshmërisë së tokës bujqësore.
- Parashikohen ujitje e tokës bujqësore dhe masa tjera për të ngritur shkallën e bonitetit te toka e cila ka bonitet më të ulët.
- Parashikohet mbrojtja nga vërshimet përmes rregullimit të shtretërve të lumenjve dhe përroskave te toka e cila ka bonitet të lartë dhe masa tjera për të mbrojtur dhe ngritur shkallën e bonitetit.
- Parashikohet në zonat të cilat janë destinomë (për pos banimit) tjera dhe ndërtime të përkohshme të hartohen projekte ri kultivimi të tokës bujqësore.
- Parashikohet mbrojtja nga erozionet nga në shpëlarja e elementeve përbërëse të tokës, me anë të pyllëzimit dhe meliorimit të zonave të degraduara.
- Parashikohet mbrojtja nga degradimi natyror ose ndikimi i njeriut.
- Parashikohet mbrojtja e pjellorisë natyrore të tokës, përmes qarkullimit bimorë në tokat bujqësore dhe kthimit të materieve organike (të mos digjen sërrishtat ose mbetjet bimore)
- Parashikohet ri-zhvillimi i tokës në zonat e mbuluara nga deponitë.

3.7.7.4. NDOTJA NGA ZHURMA KONSTATIMET

Për zvogëlimin e zhurmës në Komunën e Rahovecit parashikohet planifikimi i nivelit të tolerueshëm të ndotjes dhe zhurmës sidomos në zonat me veprimtari të ndjeshme (ne qendër, afër shkollave, spitaleve, etj.).

3.7.7.5. BIODIVERZITETI KONSTATIMET

- Shumë lloje bimore kanë vlera të jashtëzakonshme shëndetësore, andaj zhdukja e tyre do të thotë zhdukje e kësaj vlere.
- Proceset natyrore biologjike janë rregullatorët më të mirë të ruajtjes së mjedisit të pastër dhe të jetës në komunën e Rahovecit.
- Biodiverziteti dhe llojllojshmëria biologjike e natyrës, paraqet një potencial të lartë për zhvillimin e turizmit dhe rekreacionit të një vendi.
- Dhe mbi të gjitha, vetë jeta e njerëzimit në tokë është e varur nga biodiversiteti- shfrytëzimit të bimëve dhe kafshëve.
- Parashihet pasurimi i florës dhe faunës në të gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mund shfrytëzohet.

- Parashikohet revitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore në territorin e komunës së Rahovecit. Pra, duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës, etj.

3.7.7.6. EROZIONI

- Reduktimi i shkallës së erozionit përmes pyllëzimit në zonat e identifikuar me erozion të lartë dhe ndërgjegjësimi i qytetarëve për mbrojtjen e pyjeve nga shpyllëzimet e mëtejshme dhe kontrolli i duhur i zhvillimeve të reja.

3.7.7.7. RRËSHQITJA E TOKËS

- Ndërtimi i mureve mbrojtëse në fshatrat që janë sado pak të rrezikuara nga kjo dukuri
- Studim i detajuar për rrëshqitjen e dheut

3.7.7.8. TËRMETET

- Analizat Mikrozonike për qytetin e Rahovecit

3.7.7.9. RROKULLISJA E MASAVE SHKËMBORE DHE ORTEKËT E DËBORËS

- Pasi që Rahovecit nuk ka lartësi të lartë mbidetare nuk është e rrezikuar ose me mire të themi që është pak e rrezikuar nga Rrokullisja e masave shkëmbore dhe ortekët e Dëborës. Dhe në Bazë te të dhënave që i kemi analizuar nuk ka pas bllokime të rrugëve, dëmtime në njerëz ose dëme materiale.

3.7.7.10. ERËRAT

- Komuna duhet pasur në konsideratë në procedurat e dhënies së kushteve të ndërtimit për objektet të etazhi tetit të lartë si dhe objekteve të infrastrukturës teknike, të transportit dhe objekteve energjetike.
- Hartimi i Planit për gjelbërim Mbrojtës

3.7.7.11. SIPËRFAQET ME NDOTJE TË LARTË (HOT-SPOTET)

- Caktimi i lokacionit për mbeturina të ngurta
- Riciklimin e mbeturinave
- Trajtimi i mbeturinave duhet të bëhet me metoda që mundësojnë ripërdorimin e plotë ose të pjesshëm të mbeturinave
- Gjithashtu duhet parë mundësinë e shfrytëzimin i vlerave të dobishme të mbeturinave (përfshirë kompostim, shfrytëzimin e mbeturinave si burim energjie, etj.).
- Masat e zbatuara nga ndërmarrja, me qëllim të pakësimit të mbeturinave në procesin punës, në veçanti pakësimin e mbeturinave të rrezikshme;
- Ndarjen e mbeturinave, në veçanti mbeturinave të rrezikshme dhe mbeturinave që përsëri mund të përdorën, me qëllim të pakësimit të mbeturinave të cilat duhet deponuar

3.7.7.12. SIPËRFAQET E RREZIKUARA NGA ZJARRI

- Zgjerimi i Rrugëve në qytet dhe fshatrat ku janë të rrezikuara nga zjarri
- Nderimi i rezervarëve të ujit ne zonat rurale për zjarrfikësit
- Trajnimi i faktorit njeri për rendësin e pyjeve

3.7.7.13. PËRMBYTJET

- Zgjerimi i shtretërve të Lumenjve dhe përroskave

- Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit në qytet që shpesh në rast defekti vërshojnë rrugët e qytetit
- Ndërtimin e argjinaturave mbrojtëse.
- Studime te detajuara për vërshimet ne komunën e Rahovecit.

3.8. ASETET E TRASHËGIMISË NATYRORE, KULTURORE DHE TURISTIKE

Asetet e trashëgimisë kulturore për mbrojtje janë përzgjedhur nga DB e trashëgimisë kulturore të MRKS, në të cilën janë të vendosur të dhëna e inventarizimit të realizuar nga institucionet e trashëgimisë kulturore që prej vitit 2001.[46] Përfshirja e aseteve në lista të mbrojtjes së përkohshme dhe të përhershme janë bërë sipas përzgjedhjes dhe propozimeve nga institucionet e trashëgimisë kulturore (Qendra Rajonale të Trashëgimisë Kulturore/QRTK, Instituti Arkeologjik i Kosovës/IAK dhe Muzeu i Kosovës/MK), me vlerësime nga Komisioni i Ministrisë së Kulturës/MKRS/Departamenti i Trashëgimisë Kulturore/DTK dhe shqyrtim nga Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore/KKTK. Ky i fundit, në nivel vendi ka përcaktuar vetëm 23 asete në mbrojtje të përhershme, nga mija asete të vendosur në listën e mbrojtjes së përkohshme dhe 100 asete të paraqitur prej MKRS për mbrojtjen e përhershme që në vitin 2016.

Listat e aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme janë krijuar dhe zgjeruar në vazhdimësi që nga viti 2011. Ndërkaq, me status të mbrojtjes së përkohshme, asetet mund të qëndrojnë në afat prej një viti. Por, statusi i aseteve në mbrojtje të përkohshme zgjatet ndër vite për çdo vit.

Megjithatë, nisur nga kërkesat ligjore të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, përveç mos përfshirjes në Listë të asnjë aseti të trashëgimisë shpirtërore/jo materiale dhe peizazhi kulturor, asetet në mbrojtje nuk kanë të përcaktuar vlerat atribuese që duhet ruajtur dhe asnjë kriter të regjimit të mbrojtjes së tyre sipas parametrave që kërkohen me legjislacionin në fuqi për trashëgimi kulturore dhe planifikim hapësinor. Në këtë relacion, mungon përcaktimi i autenticitetit apo veçorive të dallueshme të aseteve; konturat e sipërfaqeve të hapësirave në mbrojtje, përfshirë kufiri i perimetrit të bërthamës/hapësirës së asetit dhe zona e mbrojtjes rreth tij; funksioni dhe përdorimi aktual i ndërtesave dhe parcelave; gjendja teknike me kërkesat për mirëmbajtje, riparim apo restaurim; si dhe kushtet e përdorimit dhe limitet/ndalesat ndaj zhvillimeve bashkëkohor.

Në mungesë evidente të përmbushjes së detyrimeve ligjore sipas kërkesave themelore të mbrojtjes, hapësirat e aseteve të trashëgimisë kulturore arkitekturore dhe arkeologjike ende nuk janë të regjistruar në planet kadastrale apo dhe, as përcaktuar sipërfaqe të mbrojtura në Planin Hapësinor të Kosovës, Harta Zonale dhe Planin Zhvillimor të Komunës, përveç 6 asetet në mbrojtje të përhershme dhe zonës së veçantë të mbrojtur të përcaktuar në Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

Sipas analizës së hollësishme të gjendjes aktuale, potenciali i trashëgimisë kulturore të Komunës së Prishtinës, kryesisht paraqitet në situatë të pafavorshme, larg përkujdesjes së duhur ligjore, institucionale dhe profesionale. Monumentet dhe lokalitetet me vlerat atribuese të tyre janë të nënshtruar proceseve degraduese nga vjetërsia e ndërtimeve, përdorime të papërshtatshme, braktisja, ndërhyrjet restauruese me adaptime jocilësore, si dhe ngufatja e mjediseve rreth tyre nga ndërtimet e reja të pa harmonizuar me kriteret dhe kërkesat e mbrojtjes së aseteve të trashëgimisë kulturore.

IKMM, IAK, MMK dhe QRTK-të, përfshirë edhe atë të Prishtinës, janë institucionet përgjegjëse për veprimtari sistematike të inventarizimit (identifikim, dokumentim dhe regjistrim), vlerësimit, përzgjedhjes, propozimit të aseteve të trashëgimisë kulturore për mbrojtje, si dhe për konservim dhe restaurimin e tyre. Inventarizimi, vlerësimi, përzgjedhja e aseteve për mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme, konservimi dhe restaurimi duhet zhvilluar sipas kritereve dhe procedurave të përcaktuar në legjislacion të trashëgimisë kulturore, si dhe në përputhje me standarde profesionale. Në këtë kuadër, përcaktohen vlerat atribuese me karakteristikat që duhet mbrojtur dhe deklarata e rëndësisë së aseteve të trashëgimisë kulturore, lokacioni me konturat e perimetrit të hapësirës së asetit dhe zona e mbrojtjes rreth perimetrit, gjendja, kushtet dhe kriteret me regjimin e mbrojtjes. Asetet e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohshme i përcakton MKRS, të cilat paraqiten në KKTK për shqyrtim dhe vendosje në mbrojtje të përhershme.

[46] Databaza e Trashëgimisë Kulturore të Kosovës https://dtk.rks-gov.net

Lokacionet e aseteve të trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohshme dhe të përhershme, duke përfshirë territorin brenda konturës së perimetrit të hapësirës së asetit dhe zonës së mbrojtjes rreth perimetrit, regjistrohen në Agjencionin Kadastral të Kosovës.

Mirëpo, fatkeqësisht konturat e perimetrit të hapësirës së asetit dhe zona e mbrojtjes rreth perimetrit, gjendja, kushtet dhe kriteret me regjimin e mbrojtjes ende nuk janë përcaktuar.

SWOT Analiza

PERPARËSITË	DOBËSITË
Resurset natyrore, kulturore; **Diversiteti dhe toleranca fetare;** **Lokalitet i pasur me trashëgimi arkitektonike: Arkitekturë e veçantë e banimit, objektet fetare, urat; dhe** **Lokalitet i pasur Arkeologjik: Arti në gurë, festivali i rrushit, festivali folklorik.**	Mungesa e politikave zhvillimore për shfrytëzimin e resurseve; Degradimi dhe shkatërrimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore dhe natyrore; Zhdukja e Artizanateve; dhe Niveli i ulët i vetëdijes së njerëzve për vlerat e trashëgimisë kulturore, sidomos i gjeneratave të reja.
MUNDËSITË	RREZIQET
Zhvillimi i rrjetit për turizëm kulturor me komunat përreth; **Ngritja e kapaciteteve njerëzore për trashëgiminë kulturore;** **Përkushtimi i qeverisë lokale për ruajtje të trashëgimisë kulturore;** **Muaji dhjetor "Festivali i rakisë dhe verës";** **Zhvillimi i agroturizmit; dhe** **Adoptimi i shtëpive për bujtina dhe zhvillimi i turizmit fshatar.**	Gjendja e rëndë ekonomike; Ndërtimet e egra në zonat e veçanta dhe zhvillimet e pakontrolluara; Mos respektimi i ligjeve për mbrojtje të trashëgimisë kulturore; Zhdukja graduale e monumenteve nga mungesa e përkujdesjes institucionale; dhe Fatkeqësitë natyrore.

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA
Mbrojtja e trashëgimisë natyrore; **Mbrojtja e trashëgimisë kulturore; dhe** **Promovimi i vlerave të trashëgimisë natyrore dhe kulturore.**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Ngritja e vetëdijes dhe arsimimi për trashëgiminë kulturore; **Subvencionet e grupeve që ushtrojnë veprimtari tradicionale;** **Promovimi dhe forcimi i brendit të Rahovecit në Kosovë dhe rajon; dhe** **Integrimi i zonës së veçantë të mbrojtur të Hoçës së Madhe, në zhvillimin e turizmit.**

3.9. VENDBANIMET

Komuna e Rahovecit shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore. Ky territor, përfshin pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit dhe është i ndarë në tri tërësi ose mikro regjione. E këto janë: rrafshi-luginor, kodrinor dhe malor. Territori i komunës së Rahovecit përfshihet në regjionin e Gjakovës dhe ka një pozitë të mirë gjeografike. Shtrihet në pjesën qendrore të gadishullit Ballkanik dhe i takon Evropës juglindore.

Vendbanimet në komunën e Rahovecit, janë të koncentruar në lartësitë mbidetare prej 310 m. (Krusha e Madhe pjesa e re e vendbanimit, pjesa lindore të bregut të lumit Drini i Bardhë) deri në 920 m. lartësi mbidetare që është i koncentruar vendbanimi i Zatriqit. Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lugina ose rrafshina janë këto :

(310 – 350 m.) Xërxa, Fortesa, Gexha, Malësia e Vogël, Drinasi, Denji, Dabidoli, Çifllaku, Nagavci, Hoça e Vogël dhe Retia.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m qe i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senoci, Pastasela, Polluzhë, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Opterush, Zaçishti, Pataqani i Poshtëm, Pataqani i Epërm, Nashpalla, Bratatini, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimëve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshirave). Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 – 1.000 m. e këto janë: Zatriqi, Kazniku dhe Guri i Kuq.

Lashtësia, llojllojshmëria me tipologjinë gjenetike, fizionomike-morfologjike, funksionale dhe demografike e vendbanimeve, e bëjnë komunën e Rahovecit rast për hulumtim. Komuna e Rahovecit ka një spektër të larmishëm të vendbanimeve rurale. Ekzistimin e lokaliteteve të banuara e kanë kushtëzuar kushtet e përshtatshme natyrore (relievi, klima, hidrografia dhe kushtet tjera shoqërore), që kanë mundësuar dhe kanë lehtësuar komunikimet nëpërmjet popullsisë dhe civilizimeve. Kjo dëshmon për një vazhdimësi të një hapësire të banuar shekuj me radhë, si dhe ndërtim e zgjerim vendbanimesh të reja, me tipologji dhe cilësi që i përgjigjen kohës, kushteve dhe rrethanave të reja.

Si pasojë e shkatërrimeve nga luftërat dhe si rrjedhojë të emigrimeve të herëpashershme, rrjedhimisht një numër i konsiderueshëm vendbanimesh kanë pasur stagnime dhe rënie të numrit të popullsisë dhe disa të tjera rritje të lehtë. Duhet theksuar veçmas se ditë më ditë, disa nga vendbanimet, në aspektin fizionomik dhe morfologjik, janë duke u larguar nga tiparet e fshatit të dikurshëm patriarkal dhe duke marrë pamje që i përgjigjet kohës dhe kushteve të reja. Sot vërehen gërshetime ndërmjet asaj që ka trashëguar popullsia dhe së resë që ndjek trendët e kohës.

3.9.1. VENDBANIMET SIPAS KARAKTERIT URBAN/ RURAL

Tipizimi i vendbanimeve sipas madhësisë është njëra ndër metodat më të rëndësishme për të pasqyruar karakteristikat e sistemit popullativ të hapësirës së caktuar si dhe mënyrën dhe cilësinë e jetës në vendbanimet e asaj hapësire, sepse vendbanimi më i madh nënkupton mënyrën e jetës më cilësore në shumë aspekte.

Pikërisht nga kjo arsye vendbanimet kategorizohen sipas madhësisë populluese dhe në bazë të shumë analizave të kësaj problematike përcaktohen pikat strategjike për zhvillim të mëtejmë të komunës apo edhe më gjerë.

Zonat e Komunës	Numri i vendbanimeve	Sipërfaqja e zonës në km²	Numri i banorëve	Dendësia e popullsisë në km²
Nën 400m	22	112.2	46290	412.7
400m-600m	11	108.44	13362	123.2
600m-800m	1	38.59	167	4.33
Mbi 800m	1	16.91	535	31.63

Tabela 193 Vendbanimet sipas karakterit urban në Komunën e Rahovecit

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në Komunën e Rahovecit, mund t'i kategorizojmë në: Vendbanime të vogla rurale, të mesme rurale, të mëdha rurale dhe vendbanimet e karakterit urban. Vendbanimet sipas madhësisë në komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në këto grupe të madhësisë:

Kategorizimi	Nr.	Vendbanimi	Nr.i banorëve
Vendbanim i vogël rural - deri 500 banorë	01	Sarosh	9
	02	Bërnjak	40
	03	Hoçë e Madhe	124
	04	Kaznik	164

	05	Mrasor	191
	06	Nashpallë	220
	07	Reti e Poshtme	234
	08	Bratatin	396
Vendbanim i mesëm rural - deri 1000 banorë	01	Pataqan i Epërm	533
	02	Zatriq	535
	03	Zaqishtë	659
	04	Gexhë	660
	05	Senoc	687
	06	Guri i Kuq/Petkoviq	731
	07	Nagavc	743
	08	Retijë	771
	09	Dabidol	799
	10	Polluzhë	808
	11	Vrajakë	838
	12	Sapniq	996
Vendbanim i mesëm i madh rural - deri 2500 banorë	01	Pastaselë	1,011
	02	Pataqan i Poshtëm	1,077
	03	Kramovik	1,125
	04	Hoçë e Vogël	1,166
	05	Brestoc	1,288
	06	Çifllak	1,292
	07	Drenoc	1,587
	08	Dejnë	1,757
	09	Celinë	1,903
	10	Opterush	1,911
Vendbanim rural i madh - deri 5000 banorë	01	Fortesë/Bellacërkë	2,270
	02	Malësi e Vogël/Radostë	2,346
	03	Xërxë	3,184
	04	Ratkoc	3,791
	05	Krushë e Madhe	4,473
Vendbanim i vogël urban- deri 25000 banorë	01	Rahovec	15,892


Tabela 194 Vendbanimet sipas madhësisë, në Komunën e Rahovecit

Në bazë të këtij kategorizimi, në grupin e vendbanimeve të vogla rurale, me më pak se 500 banorë janë vetëm 8 vendbanime, ku Saroshi ka më së paku banorë (9b) e deri te Bratatini me 396b.

Pastaj, si kategori e dytë ku përfshihen vendbanimet me numër të banorëve nga 500 banorë deri 1,000 banorë janë gjithsej 12 vendbanime: Pataqan i Epërm me 533 banorë deri te Sapniqi me 996 banorë.

Si kategori e tretë me numër të banorëve deri në 2,500 banorë, janë 15 vendbanime: Pastasela me 1,011 banorë, deri te Krusha e Madhe me 4,473 banorë. Ndërsa, si vendbanim me karakter urban është Rahoveci me 15,892 banorë.

Vendbanimi Rahovec, si qendër komunale, shtrihet rrëzë shpateve të malit Opterushë, afër rrugëve të rëndësishme që lidhin dy qendrat më të rëndësishme të Kosovës; Prishtinën e Prizrenin dhe më gjerë. Pozita e volitshme e vendbanimit rrëzë kodrinave duhej të ishte atraktive për banim që nga lashtësia.



Në aspektin hapësinor, Rahoveci si vendbanim i takon tipit të grumbulluar të vendbanimeve. Ndërsa në aspektin funksional është qendër e rëndësishme për territorin administrativ prej 275.89 km ^{2} dhe gravitimin e popullsisë prej 56,414 banorë, të shpërndarë në 36 vendbanime.

Zona kadastrale e Rahovecit, shtrihet në sipërfaqen prej 4894 ha, ndërsa zona e ndërtuar arrin në 255 ha, duke mbuluar 5.2% të territorit kadastral, me dendësinë e banimit prej 62.32b/ha.

Për nga numri i banorëve, madhësia mesatare e vendbanimeve në komunën e Rahovecit është 1,561 banorë, ndërsa nëse llogarisim vetëm numrin e popullsisë së vendbanimeve rurale, pa qytetin e Rahovecit, atëherë madhësia mesatare e vendbanimeve për nga numri i popullsisë është 1,151 banorë.

Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve.

3.9.2. VENDBANIMET SIPAS MADHËSISË DHE NUMRIT TË BANORËVE

Qyteti i Rahovecit është qendra më e madhe sipas numrit të banorëve dhe dendësisë (15,822 banorë/km²), pasuar nga vendbanimet për-rreth qytetit. Karakteristikë për komunën e Rahovecit, është numri më i madh i vendbanimeve, i grupit të vendbanimeve të mëdha me rreth 93% dhe të kategorisë së mesme me rreth 72,7%, ndërsa rreth 20% e territorit (viset kodrinore-malore mbi 600 m) është e banuar më rrallë dhe me vendbanime të vogla.

Kategorizimi	Nr.	Vendbanimi	Karakter urban/rural	Nr.i banoreve	Sipërfaqja (ha)	Dendësia
Vendbanim i vogël rural - deri 500 banorë	01	Sarosh	Vend i vogël rural	9		
	02	Bërnjak	Vend i vogël rural	40	4.5	9
	03	Hoçë e Madhe	Vend i vogël rural	124	13.5	9
	04	Kaznik	Vend i vogël rural	164	8.3	20

	05	Mrasor	Vend i vogël rural	191	3.2	60
	06	Nashpallë	Vend i vogël rural	220	0.6	367
	07	Reti e Poshtme	Vend i vogël rural	234	9.8	103
	08	Bratatin	Vend i vogël rural	396	3.1	128
Vendbanim i mesëm rural - deri 1000 banorë	01	Pataqan i Epërm	Vendbanim i mesëm rural	533	2.3	232
	02	Zatriq	Vendbanim i mesëm rural	535	15.2	35
	03	Zaqishtë	Vendbanim i mesëm rural	659	5.2	127
	04	Gexhë	Vendbanim i mesëm rural	660	3.2	206
	05	Senoc	Vendbanim i mesëm rural	687	4.4	156
	06	Guri i Kuq/Petkoviq	Vendbanim i mesëm rural	731	10.0	73
	07	Nagavc	Vendbanim i mesëm rural	743	3.1	240
	08	Retijë	Vendbanim i mesëm rural	771	9.8	103
	09	Dabidol	Vendbanim i mesëm rural	799	3.5	228
	10	Polluzhë	Vendbanim i mesëm rural	808	5.7	142
	11	Vrajakë	Vendbanim i mesëm rural	838	4.9	171
	12	Sapniq	Vendbanim i mesëm rural	996	4.9	203
Vendbanim i mesëm i madh rural - deri 2500 banorë	01	Pastaselë	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,011	5.4	187
	02	Pataqan i Poshtëm	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,077	5.5	196
	03	Kramovik	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,125	10.3	109
	04	Hoçë e Vogël	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,166	7.0	167
	05	Brestoc	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,288	5.8	222
	06	Çifllak	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,292	4.8	269
	07	Drenoc	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,587	8.2	194
	08	Dejnë	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,757	6.4	275
	09	Celinë	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,903	5.7	334
	10	Opterush	Vendbanim i mesëm i madh rural	1,911	9.0	212
Vendbanim rural i madh - deri 5000 banorë	01	Fortesë/Bellacërkë	Vendbanim i mesëm i madh rural	2,270	11.0	206
	02	Malësi e Vogël/Radostë	Vendbanim i mesëm i madh rural	2,346	10.3	228
	03	Xërxë	Vendbanim rural i madh	3,184	10.1	315
	04	Ratkoc	Vendbanim rural i madh	3,791	11.8	321
	05	Krushë e Madhe	Vendbanim rural i madh	4,473	10.0	447
Vendbanim i vogël urban - deri 25000 banorë	01	Rahovec	Vendbanim rural i madh	15,892	48.9	325

Tabela 195 Ndarja e vendbanimeve sipas karakterit urban/rural

Zonat Kadastrale që në vitin 2011 kanë pasur deri në 500 banorë, renditen sipas tabelës:

Nr.	Vendbanimi	Karakter urban/rural	Nr. i banorëve	Sipërfaqja (ha)	Dendësia
01	Sarosh	Vend i vogël rural	9		
02	Bërnjakë	Vend i vogël rural	40	4.5	9
03	Hoçë e Madhe	Vend i vogël rural	124	13.5	9
04	Kaznik	Vend i vogël rural	164	8.3	20
05	Mrasor	Vend i vogël rural	191	3.2	60
06	Nashpallë	Vend i vogël rural	220	0.6	367
07	Reti e Poshtme	Vend i vogël rural	234	9.8	103
08	Bratatin	Vend i vogël rural	396	3.1	128

Tabela 196 Ndarja e vendbanimeve sipas karakterit urban/rural deri në 500 banorë

Zonat Kadastrale që në vitin 2011 kanë pasur 500 – 1,000 banorë, renditen sipas tabelës:

Nr.	Vendbanimi	Karakter urban/rural	Nr.i banoreve	Sipërfaqja (ha)	Dendësia
1.	Zatriq	Vendbanim i mesëm rural	535	15.2	35
2.	Zaqishtë	Vendbanim i mesëm rural	659	5.2	127
3.	Gexhë	Vendbanim i mesëm rural	660	3.2	206
4.	Senoc	Vendbanim i mesëm rural	687	4.4	156
5.	Guri i Kuq/Petkoviq	Vendbanim i mesëm rural	731	10.0	73
6.	Nagavc	Vendbanim i mesëm rural	743	3.1	240
7.	Retijë	Vendbanim i mesëm rural	771	9.8	103
8.	Dabidol	Vendbanim i mesëm rural	799	3.5	228
9.	Polluzhë	Vendbanim i mesëm rural	808	5.7	142
10.	Vrajakë	Vendbanim i mesëm rural	838	4.9	171
11.	Sapniq	Vendbanim i mesëm rural	996	4.9	203

Tabela 197 Ndarja e vendbanimeve sipas karakterit urban/rural deri në 500 - 1000 banorë

Zonat Kadastrale që në vitin 2011 kanë pasur më shumë se 1,000 banorë, renditen sipas tabelës:

Nr.	Zona Kadastrale	Karakter urban/rural	Nr. i banorëve	SIP	Dendësia
1.	Pastaselë	Vendbanim i mesëm i madh rural	1011	5.4	187
2.	Pataqan i Poshtëm	Vendbanim i mesëm i madh rural	1077	5.5	196
3.	Kramovik	Vendbanim i mesëm i madh rural	1125	10.3	109
4.	Hoçë e Vogël	Vendbanim i mesëm i madh rural	1166	7.0	167
5.	Brestoc	Vendbanim i mesëm i madh rural	1288	5.8	222
6.	Çifllak	Vendbanim i mesëm i madh rural	1292	4.8	269
7.	Drenoc	Vendbanim i mesëm i madh rural	1587	8.2	194
8.	Dejnë	Vendbanim i mesëm i madh rural	1757	6.4	275
9.	Celinë	Vendbanim i mesëm i madh rural	1903	5.7	334
10.	Opterush	Vendbanim i mesëm i madh rural	1911	9.0	212
11.	Fortesë/Bellacërkë	Vendbanim i mesëm i madh rural	2270	11.0	206
12.	Malësi e Vogël/Radostë	Vendbanim i mesëm i madh rural	2346	10.3	228
13.	Xërxë	Vendbanim rural i madh	3184	10.1	315
14.	Ratkoc	Vendbanim rural i madh	3791	11.8	321
15.	Krushë e Madhe	Vendbanim rural i madh	4473	10.0	447
16.	Rahovec	Vendbanim rural i madh	15892	48.9	325

Tabela 198 Ndarja e vendbanimeve sipas karakterit urban/rural me mbi 1000 banorë

3.9.3. VENDBANIMET SIPAS FUNKSIONALITETIT DHE RRJETIT NDËRLIDHËS

Brenda përbrenda territorit të komunës së Rahovecit ka ende fshatra të cilët nuk kanë lidhje të mira me qendrën. Atje kemi të bëjmë kryesisht me fshatrat malore, e sidomos në periudhat kohore kur mbretëron mot i ftohtë , me rreshje të borës.

Mobiliteti brenda qytetit është shumë i hendikepuar në mungesë të një sistemi të transportit urban. Në këtë mënyrë banorët e qytetit janë të varur nga transporti individual. Një vështirësi shtesë këtu paraqet edhe rrjeti i rrugëve dhe shtigjeve të cilat nuk janë të përshtatshme për këmbësorë dhe çiklistë.

Në territorin e komunës së Rahovecit, në kuadër të infrastrukturës hidrologjike, ka disa qindra burime periodike dhe të përhershme. Numri i madh i burimeve janë ato burime që burojnë në luginat e përroskave – përrojeve dhe rrëzë kodrinave. Më së shumti ka burime në luginën e Rimnikut, lumit të Hoçës, Zaqishtës, Opterushës, Vrellën në qytetin e Rahovecit, etj. Shtrirja e vendbanimeve është kryesisht përgjatë ujë

rrjedhave si dhe burimeve ujore si: Rahoveci, Hoça e Madhe, Zaqishti, Opterusha, Zatriqi, Drenoci, Senoci, Pastasela, Kramoviku e tjerë.

Ndotja e ujërave sipërfaqësore në lumenjtë e Kosovës, sikurse edhe në Komunën e Rahovecit, është si pasoj e shkarkimit të ujërave të zeza dhe atyre industriale të pa trajtuara paraprakisht si dhe hedhja e mbeturinave të amvisërisë në ambientet ujore. Këto dukuri negative janë të shprehura sidomos në viset e ulëta fushore aty edhe ku ka shtrirje aktiviteti njerëzor.

Vendbanimet nuk kanë të rregulluar kanalizimin, përveç 9 prej tyre, por fatkeqësisht edhe ato vendbanime pa trajtim paraprak ujërat e zeza i shkarkojnë në mjedise të pastra.

Lumenjtë janë pjesa më e atakuar nga ndotja ngase dominon logjika se lumi me masën e vet ujore bartë dhe largon gjithçka.

Shkarkimi i mbeturinave të ngurta është dukuri tjetër negative e lumenjve të Kosovës, por edhe të vendbanimeve të komunës. Kjo dukuri është e shprehur sidomos në ato vendbanime ku nuk është e organizuar mbledhja e mbeturinave.

Qytetarët e komunës së Rahovecit furnizohen me ujë të pijshëm në tri forma:

- Sistemi qendror i furnizimit-ujësjellësi i KRU Gjakova
- Sistemet e vogla -ujësjellësit lokal (sistem të pompimit)
- Puset individuale

Furnizimi i banorëve të komunës së Rahovecit me ujë të pijshëm, momentalisht përcillet me probleme të mëdha. Me probleme përcillen edhe fshatrat që kanë sistemin e ujësjellësit e sidomos gjatë periudhës së nxehtë kur në shumë raste uji pijes keqpërdorët edhe për ujitjen e tokave.

Komuna e Rahovecit nuk ka rrjetë shumë të zhvilluar të furnizimit me ujë të pijes, i cili ka shtrirje në 29 vendbanime kanë ujësjellës kolektiv, respektivisht në 81% të vendbanimeve, derisa 19% e vendbanimeve nuk kanë qasje në këto sisteme.

Sistemi i ujësjellësit të Radoniqit e furnizon me ujë qytetin e Rahovecit dhe vendbanimet Ratkoc, Radostë, Gexhë, Xërxë, Bellacërkë, Bërnjakë, Krushë e Madhe, Celinë, Brestoc, Hoçë e Vogël, Hoçë e Madhe, Dejnë, Nashpallë, Sapniq, Pataqan i Epërm, Pataqan i Poshtëm, Reti e Poshtme, Vrajakë dhe Nagavc dhe tash së fundi fshatrat Dabidol, Çifllak, Kramovik, Polluzhë dhe Pastaselë (në përqindje 87% e popullatës së përgjithshme). Në komunën e Rahovecit, shumica e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim të ujërave të zeza, ndërsa mungon trajtimi i ujërave të zeza. Në kanalizim 89 % e popullsisë se komunës kanë qasje, me kanalizim pjesërisht të vendosur janë 6,019 ose 8 % dhe pa kanalizim janë 164 banorë ose 3%, prej nga shihet se një përqindje e madhe e vendbanimeve kanë qasje në kanalizim, por shkarkimi i këtyre kanalizimeve është kryesisht pa trajtim adekuat por janë të derdhura në mënyra të egra në lumenj ose përroska.

Në fshatra dhe regjion ekzistojnë disa vija autobusësh të cilat u ofrojnë shërbime transporti qytetarëve.

3.9.4. VENDBANIMET SIPAS LLOJIT DHE LARTËSISË MBIDETARE

Rrjetin e vendbanimeve në Komunën e Rahovecit e përbëjnë 36 vendbanime, nga të cilat dallohet Zona urbane dhe 7 qendra tjera lokale, në të cilat qendra gravitojnë 27 vendbanime, prej të cilave vetëm Rahoveci është vendbanim i karakterit urban me 21,354 banorë, ose rreth 30% e popullsisë së komunës, ndërsa vendbanimet tjera janë rurale, me numrin e popullsisë rurale prej 50,168 banorë ose rreth 70% të popullsisë së Komunës.

Vendbanimet në Komunën e Rahovecit shtrihen në lartësitë mbidetare prej 310 m Krusha e Madhe deri në 920 m. lartësi mbidetare Zatriqi. Për kah lartësia mbidetare këto vendbanime ndahen në luginore-rrafshorë, kodrinore dhe malore.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lugina ose rrafshina në lartësitë mbidetare prej 310 deri 350 m janë: Xërxa, Bellacërka (Fortesa), Gexha, Malësia e Vogël, Ratkoci, Dejnë, Dabidoli, Çifllaku, Nagavci, Hoça e Vogël, Bërnjakë, Guri i Kuq, Brestoci, Sapniqi dhe Retija.

Vendbanimet të cilat janë të përfshira në lartësitë mbidetare prej 350 – 600 m. që i takojnë kategorisë së vendbanimeve kodrinore janë: Rahoveci, Drenoci, Senoci, Pastasela, Polluzha, Kramoviku, Mrasori, Hoça e Madhe, Opterusha, Zaqishti, Pataqani i Poshtëm, Pataqani i Epërm, Nashpalla, Bratatini, Baboci, Vranjaka, Celina dhe Krusha e Madhe (16 vendbanime - edhe pse disa pjesë të reja të vendbanimeve të këtyre fshatrave u takojnë pjesës së kategorisë së luginave ose rrafshinave).

Vendbanimet malore shtrihen në lartësitë mbidetare prej 600 – 1.000 m. e këto janë: Zatriqi, Kazniku dhe Drenoci.

3.9.5. RAPORTI NË MES TË SIPËRFAQEVE TË NDËRTUARA DHE TË PA NDËRTUARA

Në Komunë shtrihen 15 zona kadastrale, sipërfaqja ndërtimore e të cilave është e ndërtuar 5 - 10% të territorit.

Vendbanimi	Nr. Populls ise	Sipërfa qja (Ha)	Zona e ndërtuar (Ha)	Përqindja e sip. Së ndërtuar (%)	Dendësia aktuale neto -njësi banimi /Ha	Kategoritë e sipërfaqeve sipas dendësisë së parashikuar
Rahovec	15892	48,900	255.38	5,22	10	Sipërfaqe urbane qendrore
Fortesë/Bellacërkë	2270	11,000	58.09	5,28	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Brestoc	1288	5,800	36.47	6,28	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Celinë	1903	5,700	53.38	9,36	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Çifllak - Sarosh	1292	4,800	29.03	6,04	6	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Dejnë	1757	6,400	47.27	7,38	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Xërxë	3184	10,100	82.29	8,14	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Gexhë	660	3,200	19.44	6,07	4	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Krushë e Madhe	4473	10,000	116.78	11,6	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Nagavc	743	3,100	20.60	6,64	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Opterush	1911	9,000	45.72	5,08	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Pataqan i Epërm	533	2,300	11.81	5,13	6	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Malësi e Vogël/Radostë	2346	10,300	58.47	5,67	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Ratkoc	3791	11,800	75.89	6,43	7	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Senoc	687	4,400	25.35	5,76	4	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë

Tabela 199 Ndarja e vendbanimeve sipas karakterit urban/rural me sipërfaqe ndërtimore e të cilave është e ndërtuar 5 - 10% të territorit

Në Komunë shtrihen 20 zona kadastrale sipërfaqja ndërtimore e të cilave është e ndërtuar nën 5% të territorit.

Vendbanimi	Nr. Populls isë	Sipërfaqja Ha	Zona e ndërtuar (Ha)	Përqindja e sip. së ndërtuar (%)	Dendësia aktuale neto - njësi banimi /Ha	Kategoritë e sipërfaqeve sipas dendësisë së parashikuar
Bërnjakë	40	4,500	17.83	3,96	1	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Bratatin	396	3,100	9.31	3,00	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Dabidol	799	3,500	15.48	4,42	7	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Hoçë e Madhe	124	13,500	29.00	2,14	1	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Hoçë e Vogël	1166	7,000	28.24	4,03	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Kramovik	1125	10,300	28.38	2,75	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Mrasor	191	3,2	6.03	1,88	4	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Nashpallë	220	600	4.21	0,07	7	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Pastaselë	1011	5,400	25.35	4,69	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë

Pataqan i Poshtëm	1077	5,500	22.93	4,16	6	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Guri i Kuq/Petkoviq	731	10,000	14.65	1,46	7	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Polluzhë	808	5,700	19.83	3,47	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Reti e Poshtme	234	9,800	10.42	1,06	3	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Retijë	771	9,800	15.44	1,57	7	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Sapniq	996	4,900	21.96	4,48	6	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Vrajakë	838	4,900	13.79	2,81	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Zaqishtë	659	5,200	11.32	2,17	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Drenoc	1587	8,200	40.65	4,95	5	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Kaznik	164	8,300	3.55	0,42	6	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Zatriq	535	15,200	7.65	0,50	9	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë

Tabela 200 Zonat Kadastrale me sipërfaqe të ndërtuar nën 5%

3.9.6. VENDBANIMI URBAN

Vendbanimi urban/ zona urbane- është zona e cilat fizikisht formon pjesën e një qyteti dhe karakterizohet me pjesë të rëndësishme të sipërfaqeve të ndërtuara, densitetit të lartë të popullsisë dhe banimit, punësim dhe transport të konsiderueshëm dhe infrastrukturë tjetër.[47]

Komuna e Rahovecit shtrihet ne pjesën qendrore dhe jugore të rrafshit të Dukagjinit, në një lartësi mesatare mbidetare rreth 550 m ; dhe është i ndarë në tre mikro-regjione : 80,6 km² (ose 29,17 %) rrafshirë-luginore me lartësi mbidetare 310–350 m ; 162,2 km² (58,7 %) terren kodrinor me një lartësi mbidetare nga 350 në 600 m dhe ; 33,5 km² (ose 12.13 %) terren malor me një lartësi mbidetare nga 600 m.

Vendbanimet sipas madhësisë demografike në Komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në: Vendbanime të vogla rurale, të mesme rurale, të mëdha rurale dhe vendbanimet e karakterit urban. Vendbanimet sipas madhësisë në komunën e Rahovecit mund t'i kategorizojmë në këto grupe të madhësisë:

- Vendbanimet e vogla deri 500 banorë.
- Vendbanimet e madhësisë së mesme 500 – 999 banorë
- Vendbanimet e madhësisë 1000-1999 banorë.
- Vendbanimet e mëdha rurale 2000-4999 banorë.
- Vendbanimet e karakterit urban

Në bazë të këtij kategorizimi, në grupin e vendbanimeve të vogla, me më pak se 500 banorë janë vetëm 8 vendbanime, ku Saroshi ka më së paku banorë (9b) e deri te Bratatini me 396b. Pastaj si kategori e dytë ku përfshihen vendbanimet me numër të banorëve nga 500 banorë deri 999 banorë janë gjithsej 12 vendbanime: Pataqan i Epërm 533 banorë deri në Sapniq 996 banorë.

Si kategori e tretë me numër të banorëve nga 1000 banorë 1999 banorë janë 10 vendbanime: Pastaselë me 1,011 banorë deri te Opterusha me 1,911 banorë.

Kategoria e katërt ajo me vendbanime që kanë numër të banorëve nga 2,000 banorë deri në 4,999 banorë janë vetëm 5 vendbanime: Bellacërka me 2,270 banorë deri te Krusha e Madhe me 4,473 banorë.

Ndërsa si vendbanim me karakter Urban është Rahoveci me 15,892 banorë.

[47] *Nënkapitulli 2.1. 1. Vendbanimet formale, Kapitulli 2. Vendbanimet. Shtojca Normat teknike të Planifikimit Hapësinor. MMPH 2017.*

Vendbanimi Rahovec, si qendër komunale, shtrihet rrëzë shpateve të malit Opterushë, afër rrugëve të rëndësishme që lidhin dy qendrat më të rëndësishme të Kosovës; Prishtinën e Prizrenin dhe më gjerë. Pozita e volitshme e vendbanimit rrëzë kodrinave duhej të ishte atraktive për banim që nga lashtësia.

Çdo vendbanim do të zhvillohet bazuar në potencialet për zhvillim dhe shërbimet bazë të cilat duhet t'i ofrojë. Duke marrë parasysh edhe parashikimet për trendin e uljes - zvogëlimit të popullsisë, vendbanimet në vijim do të zhvillohen sipas këtyre funksioneve: qyteti-qendër rajonale dhe komunale; dhe Opterush, Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc, Drenoc dhe Çifllak si nën qendra komunale.

Qyteti është qendra komunale e cila bartë të gjithë barrën e zhvillimit të komunës me funksionet e saja përcjellëse. Nën-qendrat do të ofrojnë shërbime bazë për vendbanimet përreth duke mundësuar mbulim të përgjithshëm të komunës dhe rrjedhimisht të ofrojnë zhvillim të balancuar. Të gjitha vendbanimet tjera do të ofrojnë vetëm hapësirë për banim dhe bujqësi me intensitet të ulët. Në tabelë do të paraqesim funksionin dhe madhësinë e çdo vendbanimi në komunë.

Vendbanimi	Funksioni	Klasifikimi sipas madhësisë
Rahovec	Qendër rajonale / komunale	Vendbanim i vogël urban
Opterush	Nën-qendër	Vendbanim i mesëm i madh rural
Krushë e Madhe	Nën-qendër	Vendbanim i madh rural
Ratkoc	Nën-qendër	Vendbanim i madh rural
Xërxë	Nën-qendër	Vendbanim i madh rural
Drenoc	Nën-qendër	Vendbanim i mesëm i madh rural
Çifllak	Nën-qendër	Vendbanim i mesëm i madh rural
Malësi e Vogël/ Radostë	Banim	Vendbanim i mesëm i madh rural
Bellacërkë, Celinë, Dejnë + Baboc, Brestoc, Hoçë e Vogël, Kramovik, Pataqan i Poshtëm, Pastaselë,	Banim	Vendbanim i mesëm i madh rural
Sapniq, Vrajakë, Polluzhë, Dabidol, Retijë, Nagavc, Guri i Kuq, Senoc, Gexhë, Zaqishtë, Pataqan i Epërm	Banim	Vendbanim i mesëm i vogël rural
Bratatin, Reti e Poshtme, Nashpallë	Banim	Vendbanim i vogël rural
Mrasor, Kaznik, Hoçë e Madhe, Bërnjak, Sarosh	Banim	Vendbanim shumë i vogël rural

Tabela 201 Klasifikimi I vendbanimeve sipas madhësisë dhe funksionit




Tabela 202 Shpërndarja e popullsisë

3.9.7. MORFOLOGJIA URBANE

Karakteristikë për komunën e Rahovecit është numri më i madh i vendbanimeve, i grupit të vendbanimeve të mëdha dhe të kategorisë së mesme, ndërsa rreth 20% e territorit (viset kodrinore-malore mbi 600 m) është e banuar më rrallë dhe me vendbanime të vogla. Në zonën e ulët nën 400 m ka më së shumti vendbanime që i takojnë kategorisë së vendbanimeve të mëdha (2,000-5,000 banorë) 12 vendbanime , ose 92.3% të kësaj kategorie dhe vendbanimet e kategorisë së mesme (1,000-2,000 banorë) 8 vendbanime ose 72.7% e kësaj kategorie të vendbanimeve shtrihen në këtë zonë. Zona kodrinore-malore mbi 600 metra karakterizohet me vendbanime të vogla të kategorisë 500-999 banorë, në të cilën zonë shtrihen vetëm 3 vendbanime: Kazniku, dhe Zatriqi, ndërsa vetëm Drenoci i takon kategorisë së vendbanimeve të mëdha me 2098 banorë që shtrihet në këtë zonë. Pothuajse të gjitha vendbanimet në komunën e Rahovecit kanë pasur rritje nga viti 1991-2010 (përveç vendbanimit Zatriq që ka zvogëlim të numrit të popullsisë, ndërsa disa vendbanime që kanë terren të pa volitshëm kanë rritje të ngadalësuar të popullsisë.

Pra në përgjithësi vërehet një rritje e përgjithshme e numrit të popullsisë pothuaj se në të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit. Ky trend i zhvillimit është brenda rrjedhave normale të zhvillimit demografik bazuar në shkallën pozitive të shtimit natyror të popullsisë.

Pothuajse të gjitha vendbanimet e komunës së Rahovecit janë formuar në mënyrë spontane. Ndërsa forma e tyre e parregullt është si pasojë e kushteve natyrore në terren, por edhe faktorëve shoqëror-ekonomik dhe historik.

Rahoveci si qendër komunale dhe i vetmi vendbanim i karakterit urban, vetëm me një pjesë të vogël mund të konsiderohet me plan. Në aspektin hapësinor, Rahoveci si vendbanim urban i takon tipit të grumbulluar të vendbanimeve. Ndërsa në aspektin funksional është qendër e rëndësishme për territorin administrativ prej 275.89 km^2 dhe gravitimin e popullsisë prej 56,208 banorë, të shpërndarë në 36 vendbanime.

Zona kadastrale e Rahovecit zë sipërfaqen prej 4,894 ha, ndërsa zona e ndërtuar arrin në 255ha, duke mbuluar 5.2% të territorit kadastral, me dendësinë e banimit prej 62.32 b/ha. Për nga numri i banorëve, madhësia mesatare e vendbanimeve në komunën e Rahovecit është 1,561 banorë, ndërsa nëse llogarisim vetëm numrin e popullsisë së vendbanimeve rurale, pa qytetin e Rahovecit, atëherë madhësia mesatare e vendbanimeve për nga numri i popullsisë është 1,151 banorë.

Përfaqësimi i disa vendbanimeve të kategorive të mëdha në rrjetin e vendbanimeve ka ndikim të rëndësishëm në organizimin e hapësirës dhe sistemin funksional të vendbanimeve.

3.9.8. VENDBANIMET RURALE - SHTRIRJA, STRUKTURA DHE MADHËSIA

Janë ato vendbanime të cilat i bashkojnë dy e më tepër fshatra primare në një tërësi shoqëroro-ekonomike dhe hapësinore. Në këto vendbanime, përveç funksioneve interne, janë të zhvilluara edhe funksionet e jashtme të cilat u shërbejnë edhe popullsisë së vendbanimeve përreth. Këto vendbanime njëkohësisht paraqesin njësitë polarizuese të zonës në hapësirë. Nga funksionet shoqërore, në këto vendbanime ndodhet bashkësia lokale dhe zyra e vendit, shkolla fillore, ambulanca, shitoret me shumicë e pakicë për furnizimin e popullsisë, ndonjë veprimtari zejtare, etj.

Këto vendbanime paraqesin tip kalimtar nga ato tradicionale-bujqësore, në të përziera, sepse në to jeton një numër i konsiderueshëm i popullsisë jobujqësore.

Një numër i konsiderueshëm i këtyre vendbanimeve ndodhet jo larg qytetit. Ato i karakterizon një shkallë mjaft e lartë e transformimit po edhe degradimit. Numri i këtyre vendbanimeve në komunë arrin në 8, duke përfshirë edhe qytetin e Rahovecit, ose 23.5% nga numri i përgjithshëm i vendbanimeve rurale. Vendbanimet me funksione qendrore në komunën e Rahovecit janë: Çifllaku, Drenoci, Hoça e Vogël, Krusha e Madhe, Opterusha, Ratkoci dhe Xërxa. Në këto vendbanime tani janë paraqitur shenjat e semi-urbanizimit si pasojë e veprimit të faktorëve urban, në një anë dhe prodhimtarisë së modernizuar të bujqësisë në anën tjetër.

Shumica e këtyre vendbanimeve i takojnë kategorisë së vendbanimeve të mesme ose të mëdha (mbi 2,000 banorë) Ratkoci, Krusha e Madhe, Drenoci, Opterusha, Xërxa, Hoça e Vogël, ndërsa i kategorisë së mesme është vetëm Çifllaku me 1,292 banorë. Në këto vendbanime gravitojnë mesatarisht 7,166 banorë. Ndërsa, nëse e llogarisim edhe Rahovecin si qendër komunale atëherë në këto qendra gravitojnë mesatarisht 8,940 banorë.

Në grupin e vendbanimeve urbane bën pjesë vetëm Rahoveci si qendër komunale në të cilën janë të vendosura funksionet shoqërore-ekonomike.

3.9.9. TRENDËT, NEVOJAT, PROJEKSIONET DHE PROGNOZAT

Trendi i zhvillimeve dëshmon se një pjesë e komunës së Rahovecit është zhvilluar në mënyrë të pa kontrolluar. Zona urbane ka pasur koncentrim më të madh të ndërtimeve, ndërkohë që në zonat rurale zhvillimi ka qenë i shpërndarë në të gjithë territorin dhe rrjedhimisht i pa balancuar. Intensitet më të madh zhvillimi dhe më të shpërqendruar ka pësuar pjesa qendrore e komunës, në veçanti vendbanimet përreth zonës urbane.

Tabela më poshtë jep në detaje për secilën zonë kadastrale karakteristikat kryesore të tyre, ku dhe do të bazohen gjetjet kyçe.

Zona Kadastrale	Kategori e rendit hapësinor	Strukturë e vendbanimit	Morfologjia hapësinore	Reliefi (m)	Identiteti ekonomik
Sarosh	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Bërnjak	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Hoçë e Madhe	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	Kodrinore 350-600	Përzier
Kaznik	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	Malore 600-1000	Bujqësor
Mrasor	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Nashpall	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Reti e Poshtme	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Bratatin	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Pataqan i Epërm	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Zatriq	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	Malore 600-1000	Bujqësor
Zoqisht	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Gexhë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Senoc	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Guri i Kuq/Petkoviq	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I grumbulluar	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Nagavc	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Retijë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë		I rrafshët 310-350	Bujqësor
Dabidol	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Polluzhë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I dendur	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Vrajakë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I dendur	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Sapniq	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I dendur	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Pastaselë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Pataqan i Poshtëm	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I dendur	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Kramovik	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I dendur	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Hoçë e Vogël	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Brestoc	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Çifllak	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I dendur	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Drenoc	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	Malore 600-1000	Bujqësor
Dejnë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Celinë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të mesëm	Linear	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Opterush	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I dendur	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Fortesë/Bellacërkë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	I dendur	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Radostë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të ultë	Linear	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Xërxë	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të mesëm	Linear	I rrafshët 310-350	Përzier /Industriale
Ratkoc	Hapësirë Rurale		Linear	I rrafshët 310-350	Bujqësor
Krushë e Madhe	Hapësirë Rurale	Qendër e rendit të mesëm	Linear	Kodrinore 350-600	Bujqësor
Rahovec	Hapësirë Urbane	Qendër e rendit të lartë	I grumbulluar	Kodrinore 350-600	Përzier /Industriale

Tabela 203 Zonat kadastrale dhe karakteristikat kryesore

Zhvillimi i shpërqendruar ka ndodhë për shkak të ndërtimeve në qytetin e Rahovecit, gjë që ka ndikuar që ndërtimet të kalojnë përtej kufirit aktual të zonës urbane në vendbanimet përreth. Në këtë mënyrë, vendbanimet rurale pothuajse janë bashkëngjitur me zonë urbane duke marr parasysh shkallën e zhvillimit. Te këto vendbanime kohët e fundit vërehet një formë e re e ndërtimit, sidomos përgjatë vijës së asfaltuar të vendbanimit me karakter rendor të objekteve. Kjo ndodh kryesisht për t'u liruar nga dendësia e madhe dhe afrimi me rrugën kryesore. Ky proces mund të quhet transferimi i fshatit nga tipi grumbullor në tip rendor ose zbritja e fshatit në rrugë.

Te këto vendbanime në disa raste vërehet edhe procesi i aglomerimit ose bashkimit të tyre për shkak të zgjerimit dhe afërsisë së tyre, varësisht nga kushtet gjeomorfologjike të terrenit: Brestoc - Hoçë e Vogël -

Nagavc-Krushë e Madhe - Celinë, pastaj Xërxë –Gexhë – Radostë – Ratkoc – Dejnë - Dabidol, si dhe Drenoc – Senoc - Pastaselë. Për shkak të zgjerimit dhe formës aglomerative në hapësirë këto vendbanime në të ardhmen nuk mund ta ruajnë kuptimin e fshatit.

Lidhur me vendbanimet e tipit të dendur, mund të konstatohet se ky tip i vendbanimeve, në krahasim me tipin e shpërndarë të fshatit është shumë më i përshtatshëm sepse ato paraqesin mundësitë për përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së jetës me pajisje urbane dhe objekte të standardit shoqëror.

3.9.10. SFIDAT, GJETJET KYÇE DHE SUPOZIME TË PRANUARA, IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE DHE KONSTATIMET KRYESORE

3.9.10.1. SFIDAT, IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE DHE KONSTATIMET KRYESORE TË VENDBANIMEVE

Gjatë vlerësimit të gjendjes ekzistuese të vendbanimeve janë identifikuar sfidat vijuese:

- Mungesa e lidhjes së mire mes zonës urbane me vendbanimet rurale malore;
- Qasja e dobët nga vendbanimet sub- urbane në zonë urbane;
- Shuarja e vendbanimeve malore dhe dyndja e tyre ne zonë urbane;
- Mungesa e qasjes në infrastrukturë teknike-ujësjellës e kanalizim për disa nga vendbanimet;
- Mungesa e infrastrukturës përkatëse si dhe shpërndarja jo e balancuar e infrastrukturës publike dhe sociale;
- Mobiliteti brenda qytetit është shumë i hendikepuar në mungesë të një sistemi të transportit urban;
- Numër i lartë I ndërtimeve pa leje, që duhet integruar dhe urbanizuar;
- Zhvillime të paplanifikuara me mungesën konsekuente të shërbimeve dhe hapësirave të gjelbër publike;
- Morfologji dhe strukturë urbane jo konsistente në pjesët sub- urbane të qytetit;
- Mungesë e infrastrukturës dhe shërbimeve publike në lagjet sub- urbane;
- Zgjerime të mëdha me densitet të ulët të cilat konsumojnë dhe copëtojnë kualitetin e tokës bujqësore më shumë se që është e arsyeshme me të njëjtën popullsi të caktuar;

3.9.10.2. GJETJET KYÇE DHE SUPOZIME TË PRANUARA

- Qyteti i Rahovecit paraqet qendrën administrative, ekonomike e kulturore për gjithë territorin e komunës, por edhe për komunat fqinje, si qytet i madh në rajon.
- Qyteti i Rahovecit i takon tipit të koncentruar të vendbanimeve.
- Shumica e vendbanimeve janë të tipit të shpërndarë (14) me dendësi të ulët të banimit, dhe mungesë të infrastrukturës, pastaj ato të tipit të grumbulluar dhe të dendur (14), e që tregon drejtë për drejtë mungesën e një planifikimi të mirëfilltë para zhvillimit të vendbanimeve, dhe në fund në një numër shumë të vogël vendbanimet lineare (6), që janë vendbanime të zhvilluara për-rreth rrugëve kryesore te komunës.
- Kjo shpërndarje e banimit brenda vendbanimeve ka rezultuar edhe me një dendësi të ulët apo mesatare tek shumica e vendbanimeve, me përjashtim të zonës urbane dhe vendbanimeve rreth saj, që vjen si rezultat i kërkesave të shumta për banim për shkak të zbrazjeve të vendbanimeve rurale drejt zonës urbane.
- Rahoveci karakterizohet me tri lloje të relievit, zonë e rrafshët, zonë kodrinore dhe zonë malore.

- Edhe karakteri ekonomik në komunë mund të themi se në një masë dirixhohet nga relievi dhe afërsia me qendër. Zona qendrore që përfshinë zonën urbane me vendbanimet për-rreth zhvillojnë aktivitete të ndryshme ekonomike; zona rurale zhvillon bujqësi.
- Rritja e vogël e dendësisë për shkak se numri i banorëve në zonën urbane është i vogël dhe shihet qartë që një zbehje e qytetit, e kufizon rritjen e zonës urbane.

SWOT Analiza - Përparësitë, dobësitë, mundësitë rreziqet

PËRPARËSITE	DOBËSITË
Lidhja e mirë e vendbanimeve me qendrën komunale **Shpërndarje relativisht e mirë e shërbimeve shkollore dhe shëndetësore** **Ekzistimi i vendbanimeve me pozitë të përshtatshme për organizim të subqendrës**	Dendësia e ulët e ndërtimit Përqendrimi i shërbimeve administrative në qendrën komunale Niveli i pamjaftueshëm i shtrirjes së infrastrukturës teknike në zonat rurale (ujësjellës, kanalizim) Zgjerimi i ndërtimit në tokë bujqësore
MUNDËSITË	**RREZIQET**
Hartimi i planeve hapësinore **Krijimi i nën qendrave të zhvillimit të vendbanimeve në raport me qendrën e Rahovecit.**	Vazhdimi i trendit të zgjerimit të vendbanimeve pa kritere Humbja e tokës bujqësore Kapacitetet e pashfrytëzuara si pasojë e migrimit rural-urban

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA
Ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara hapësinore **Ofrimi i kushteve më të mira të planifikuara brenda zonave të ndërtuara** **Zhvillimi i vendbanimeve me dendësi adekuate** **Menaxhimi i migrimit rural-urban**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Përforcimi i mëtejmë i karakterit shumë funksional të qendrës komunale **Konsolidimi i strukturës së ndërtuar të vendbanimeve tjera brenda zonave aktuale të ndërtuara, duke e ruajtur karakterin e tyre lokal** **Ofrimi i shërbimeve adekuate sociale dhe publike në të gjitha vendbanimet rurale**

3.10. BANIMI

Objekte të vjetra banimi ka fare pak sepse materiali i dobët i tyre nuk ka mundur t'i përballojë kohës. Objektet e banimit dhe oborret kanë dallime, varësisht nga vendi i ndërtimit, si: qyteti, vendbanimet pranë qytetit, vendbanimet kodrinore-malore.

Shumica e objekteve të banimit janë të rrethuara me mure, ndërsa në oborre dallohen edhe objektet tjera ekonomike bujqësore.

Deri vonë objektet e banimit ndërtoheshin me material të dobët; qerpiçi dhe druri, që zakonisht forma e objekteve i ngjante shkronjës L. Në këto dekadat e fundit objektet e banimit kanë ndryshuar tërësisht si në formë ashtu edhe në cilësi. Tani objektet e banimit ndërtohen me një e më shumë kate, që zakonisht kanë kulmet në dy ujëra, ndërsa janë të ndërtuara me material të fortë ndërtimor si: tulla, blloqe të pjekur, betoni e hekuri. Kështu që objektet e ndërtuara të banimit në fshat fare pak dallojnë me ato në qytet. Nuk ka ndonjë stil unik të ndërtimit të objekteve të banimit.

Dendësia e banimit brenda zonës së ndërtuar, në vendbanimet rurale, është mjaft e lartë dhe është e përafërt me shumë qytete të vogla të Kosovës dhe këto vlera sillen rreth 50 banorë në ha.

Ndërsa, në qendrën e vetme urbane, në Rahovec, dendësia e banimit arrin në 85 banorë në ha, me mundësi të rritjes në të ardhmen, për të arritur në rreth 100 banorë për hektarë. Ndërsa në vendbanimet rurale dendësia maksimale e planifikuar do të jetë 50 banorë për hektarë.

Gjendja e banimit në vendbanimet rurale dhe në vet qytetin e Rahovecit u dëmtua rëndë në luftën e fundit, gjatë së cilës u shkatërruan një numër i madh i objekteve të banimit dhe ekonomike, ndërsa pasojat po evitohen me kalimin e kohës.

Hapësira e banimit në raport me sipërfaqet e ndërtuara është dominante, me rreth 90% në raport me zonën e ndërtuar në nivelin komunal, ndërsa në qytet ajo dominon me rreth 80%. Kjo tregon se aktivitetet tjera janë në nivel shumë të ulët të zhvillimit, sidomos për qytetin, ndërsa në vendbanimet rurale, përveç objekteve të banimit, janë prezentë edhe një numër i konsiderueshëm i objekteve përcjellëse ekonomike.

Numri i anëtarëve për ekonomi familjare lëvizë nga 7.7 anëtarë në vendbanimet rurale, në 6.3 anëtarë në qendrën urbane. Këto parametra tregojnë për një gjendje jo të favorshme të standardit jetësor.

Sipërfaqja e banimit për banorë është me sa vijon: 18.8 m² për anëtarë në nivel të komunës, 19.5m² për anëtarë në vendbanimet rurale dhe në 17.1 m² për anëtarë në qytet. Kjo gjendje është e pavolitshme në këto tre nivele.

Në komunën e Rahovecit ka familje me kushte ekonomike që nuk janë në gjendje të kenë shtëpi të përballueshme. Duke u referuar të dhënave mbi varfërinë, sipas paragrafit të mësipërm 12,35% e popullsisë jeton me 1$ në ditë/për person dhe 69,57% e popullsisë jetojnë me 2$ në ditë/për person. Përveç kësaj 590 familje janë nën asistencë sociale (përafërsisht 37% e popullsisë). Të dhënat e përmendura më sipër tregojnë nevojën për ofrimin e programeve e veçanta të banimit.

3.10.1. NEVOJAT PËR BANIM

Komuna e Rahovecit në vitin 2029 parashihet t'i ketë rreth 56,150 banorë. Bazuar në parashikime, deri në vitin 2029 parashikohet një zvogëlim i popullatës për 300 banorë. Andaj, krahasuar edhe me numrin e ekonomive familjare në qytet, parashikohet që të zvogëlohen përafërsisht për 30 ekonomi familjare, ndërsa në fshatra për 30 ekonomi familjare.

Duke marrë parasysh projeksionet e rënies së popullsisë dhe dendësinë neto për qytet dhe zonat rurale - fshatra, kërkesa për tokë për të akomoduar zhvillimet në dhjetë vitet e ardhshme brenda këtyre zonave nuk parashikohet të rritet. Përpos në zonat ku ka pas një zhvillim (rritje të kufirit me vendime komunale) të kufirit ndërtimor.

Ashtu siç u theksua më lartë, kërkesa për tokë për të akomoduar zhvillimet e ardhshme është kalkuluar bazuar në dendësinë neto të zonës urbane dhe rurale. Është detyrë e Hartës Zonale të Komunës që të përcaktojë saktësisht sasinë e tokës për zhvillim duke u bazuar në rritjen e numrit të ekonomive familjare dhe dendësive neto të çdo bashkësie territoriale në veçanti.

Bazuar në vlerësimin e Planit Hapësinor të Kosovës (PHK) 2010-2020+, ekziston sipërfaqe banimi prej 18,65 m^2 për kokë banori ndërsa madhësia mesatare e familjes është 6.5 anëtare për familje. Plani raporton se 93,7% e sipërfaqes ekzistuese të banimit është i zënë me banim individual dhe 6,23% nga banimi kolektiv. Sigurimi i sipërfaqes së mjaftueshme të banimit është një nga sfidat kryesore të identifikuar nga PZHK-ja.

Në Komunën e Rahovecit nga sipërfaqja ekzistuese për banim, gjejmë 6,23% banim kolektiv dhe 93,77% individual (sipas listës së tatimpaguesve, 2018). Me një zgjerim shumë pasiv të fondit publik të banimit, fondi i banimit është duke u zgjeruar kryesisht nga sektori privat; dhe shpesh karakterizohet me parregullsi dhe mungesë të kritereve. Andaj, janë identifikuar problemet dhe potencialet në sektorin e banimit.

Zona Kadastrale	Kategoria e shfrytëzimit	Numri	Sipërfaqja (m^2)	Përqindja
Zona Urbane	Apartament	90	5,712	2.83 %
	Shtëpi	3,093	459,863	97.17 %
Zona Rurale	Apartament	0	0	0 %
	Shtëpi	7,278	1,176,144	100 %

Tabela 204 Të dhënat për numër dhe sipërfaqe të banimit[48]

Për të analizuar sipërfaqen e shfrytëzuar për banim në kuadër të sipërfaqes së ndërtuar në komunën e Rahovecit, janë marrë për bazë vetëm objektet, pa infrastrukturën rrugore.

Tipi i vendbanimit	Shtëpi e veçuar, e ndarë në vete	Shtëpi gjysmë e ndarë	Rresht apo varg shtëpish	Ndërtesë ose blloqe apartamentesh	Tjetër
Urban	3,093	/	/	90	/
Rural	7,278	/	/	0	/
Gjithsejtë	10,371	/	/	90	/

Tabela 205 Të dhënat për numër dhe sipërfaqe të banimit

Në bazë të analizës së shfrytëzueshmerisë së tokës, por edhe të vetë ndërtimeve në komunën e Rahovecit, është evidente se banimi i ulët përbën pjesën më të madhe të të gjithë sektorit të banimit. Kjo tendence është në rënie viteve të fundit, ku kërkesa për banim është më shumë e orientuar në banim të lartë. Mirëpo sa i përket numrit të njësive të banimit, profili komunal i referohet regjistrimit të popullsisë së vitit 2011.

Bazuar në të dhënat e ASK-së[49], del se komuna e Rahovecit ne vitin 2011 ka 56,208 banorë të cilët jetojnë në 8,221 ekonomi familjare, 2,840 prej të cilave janë në zonën urbane ndërsa 5,381 në zonën rurale.

Numri i përgjithshëm i njësive të banimit në Kosovë është 412.884, prej të cilave 175.942 (43%) janë në zonën urbane, ndërsa 236.942 (57%) në zonë rurale. Në komunën e Rahovecit, numri i gjithmbarshëm i njësive të banimit është 10,461 që përbën 2.53% të numrit të përgjithshëm të njësive të banimit në Kosovë. Ndryshe nga Kosova, pjesa më e madhe e njësive të banimit gjenden në zonën rurale të komunës 7,278 (69.57%), ndërsa në atë urbane 3,183 (30.43%).

Numri i banorëve		Ekonomitë familjare	Njësitë e banimit	Ndërtesat e banimit		
	Nr.	Nr.	Nr.	Tipologjia	Nr.	%
Komuna e Rahovecit	56,208	8,221	10,461 (100%)	ndërtesa banimi me një njësi	10,371	99.14%
				ndërtesa banimi me shumë njësi	90	0.86%
Zona urbane	33,904	2,840	3,183 (30.43%)	ndërtesa banimi me një njësi	3093	56.39%
				ndërtesa banimi me shumë njësi	90	43.61%
Zona rurale	38,005	5,381	7,278 (69.57%)	ndërtesa banimi me një njësi	7,278	100%
				ndërtesa banimi me shumë njësi	0	0%

Tabela 206 Fondi i banimit në raport me njësitë e banimit dhe tipologjinë e ndërtesave të banimit

[48] Nga Lista e tatimpagueseve te TP VITI 2018

[49] ASK, vjetari statistikor i Republikës së Kosovës 2018

Banimi në ndërtesa banimi me shumë njësi, natyrisht se është më i koncentruar në zonën urbane, ku të gjitha ndërtesat e tilla gjenden brenda zonës urbane në komunën e Rahovecit.

Bazuar në parashikimet për rritje të popullsisë (kapitulli për demografi-trendet dhe prognozat demografike), deri në vitin 2030, në krahasim me prognozat e vitit 2020, parashikohet kemi ngritje te popullsisë deri në 53,225 banorë rezidentë ndërsa 67,553 banorë jo rezident. Ndërsa numri i ekonomive familjare parashikohet të rritet përafërsisht për 193 ekonomi familjare.

3.10.2. SHFRYTËZIMI I FONDIT TË BANIMIT

Analiza e fondit të njësive të banimit në dispozicion, tregon se vetëm 78% prej tyre në komunë të Rahovecit janë të shfrytëzuara, përderisa 22% mbesin të pa-shfrytëzuara. Ndërsa, në bazë të analizës demografike ndër vite dhe trendëve të përgjithshme në Kosovë, del se ekonomitë familjare në komunën e Rahovecit janë duke u zvogëluar sa i përket numrit të anëtarëve. Ndërsa, nga totali i ekonomive familjare, më shumë se 69% banojnë në zonën rurale. E gjithë kjo jep indikacion që planifikimi i njësive të reja të banimit në Komunën e Rahovecit në të ardhmen duhet të bëhet me kujdes duke u bazuar në parashikimet demografike por duke e përcjellë trendin e ekonomive familjare. Në veçanti kjo është me rëndësi për zonën rurale duhet që, në të ardhmen të planifikojë njësi të reja të banimit në bazë të parashikimeve demografike, mirëpo edhe duke përcjellë trendin e ekonomive familjare.

	Gjithsej njësi të banimit nga viti 2011			Të pabanuara	Gjithsej të pabanuara
Kosova	412.884	Zona urbane	175.942	42.340 (42%)	99.808 (24%)
		Zona rurale	236.942	57.468 (58%)	
Rahovec	11,258	Zona urbane	3,934	998 (41%)	2,448 (22%)
		Zona rurale	7,324	1,450 (59%)	

Tabela 207 Shfrytëzueshmëria e fondit të banimit

Gjithashtu, në llogaritjen dhe planifikimin e përdorjes së fondit të banimit të pashfrytëzuara për planifikime të reja, duhet pasur parasysh edhe vjetërsinë e banesave të pashfrytëzuara, dhe se a mund te inkuadrohen ato në këtë planifikim.

3.10.3. KUSHTET E BANIMIT

Ndërtesat e banimit më shumë njësi thuaja se që nga ndërtimi i tyre në vitet 1970 janë relativisht të mirëmbajtur. Posaçërisht fasadat janë në një gjendje jo të kënaqshme. Pos kësaj duhet që instalimet elektrike dhe të ngrohjes, ashensorët, etj., të rinovohen.

Rrethina e këtyre blloqeve të banimit ofron shumë pak kualitete pushimi, veçanërisht vendet për lojëra të fëmijëve mungojnë. Në mënyrë që të gjitha këto të mund të bihen në nivelin e kënaqshëm, përgjegjësia nuk do të duhej të mbetej vetëm te qeveria. Pikërisht banorët, që edhe posedojnë këto banesa, duhet të luajnë një rol qendrorë në procesin e rinovimit të tyre.

Nëse analizohet vjetërsia e ndërtesave të banimit në komunën e Rahovecit, atëherë del se fondi i banimit në Rahovec është relativisht i ri. Rreth 60 % prej tyre janë ndërtuar pas luftës së fundit në Kosovë dhe vetëm 40% e të gjitha ndërtesave të banimit të Rahovecit janë ndërtuar para vitit 1980.

Si rezultat i aplikimit të materialeve termoizoluese dhe atyre për mbrojtje nga zhurma në objektet e reja, konsiderohet se në këto ndërtesa ofrohet banim më cilësor dhe më i rehatshëm. Gjithsesi, komuna duhet të ketë një qasje pro aktive sa i përket trajtimit të ndërtesave të vjetra të banimit marrë parasysh nevojën e për masa shtesë të sigurisë, pajtueshmërinë me kërkesat e kodit të ndërtimit apo edhe përmes regjenerimit urban të këtyre zonave.

Mbi 60% e ndërtesave të banimit janë të lidhura në rrjetin publik të kanalizimit, 25 % të lidhura me gropa septike private dhe 15% në mënyra tjera të shkarkimit. Ndërsa sa i përket furnizimit me ujë rreth

90% e objekteve janë të kyçur në sistemin publik të ujësjellësit, ndërsa rreth 10% e objekteve furnizohet nga burimet e tjera.

Sa i përket furnizimit me ngrohje, në komunën e Rahovecit nuk ekziston fare sistemi i ngrohjes publike ndërsa 2.16% të njësive të banimit kanë të instaluar sistem të ngrohjes qendrore brenda banesave ose ndërtesës. Mënyra tjetër e ngrohjes së objekteve të banimit është më stufë 95.90 % dhe 1.94% oxhak ndërsa lloji i energjisë është druri 98%.

Në mungesë të legjislacionit përkatës, objektet e banimit rrallë here janë të ndërtuara duke u bazuar në parimin e energjisë efiçiente. Ndërtesat nuk kanë izolime të duhura që ta ruajnë energjinë, si dhe nuk përdorin elemente shtesë për prodhim të energjisë si panele solare apo të ngjashme.

3.10.4. TRENDET E NDËRTIMIT TË NDËRTESAVE PËR BANIM DHE ÇMIMET MESATARE TË NDËRTESAVE PËR BANIM;

Pavarësisht ndryshimeve në numër të popullsisë në Rahovec, sipas kërkesave për leje, trendi është mesatar., sidomos në zonën urbane. Rritja modeste e popullsisë nuk është faktori kryesor që ndikon në kërkesën për njësi të reja banimi. Migrimi i brendshëm (fshat – qytet), ndryshimi i numrit të anëtarëve të familjes i cili është në zbritje, krijimi i çifteve të reja dhe diaspora janë faktorët tjerë kryesor që ndikojnë në rritjen e kërkesës për njësi të reja të banimit.

Në vitin 2020, janë dorëzuar 59 kërkesa për leje ndërtimore, prej tyre 53 janë aprovuar, ndërsa në vitin 2021 janë dorëzuar 68 kërkesa për leje ndërtimore, prej tyre 54 janë aprovuar. Aktualisht lëshohen rreth 50-60 leje për ndërtime të reja në vit. Në krahasim me komunat tjera, ky numër është i ulët. Në pjesën rurale taksa për leje të ndërtimit të objekteve është vlerë prej 1.70€/m^2.

Çmimet mesatare të një njësie banimi në objektet kolektive rezulton të jetë nga 450€ deri në 600€ për m^2. Sigurisht që çmimet ndryshojnë varësisht nga lokacioni i njësive të banimit. Qendra e qytetit është pjesa më e kërkuar për banim, dhe rrjedhimisht çmimet janë më të larta.

3.10.5. IDENTIFIKIMIN E TOKËS SË MJAFTUESHME PËR BANIM

Banimi për kategoritë e veçanta

Nevojat për banim janë më tepër se sa të rasteve sociale, duke marrë parasysh se çmimi mesatar i një njësie janë në pamundësi që të ndërtojnë shtëpi apo të blejnë banesë dhe kanë nevojë për një mundësi më të përballueshme të sigurimit të banesës me një qira të përballueshme.

Banimi Social

Sipas kërkesave zyrtare në Komunën e Rahovecit gjatë 5 viteve të fundit, numri i familjeve të cilat kërkojnë strehim, merremetim dhe ndërtim të shtëpisë deri më tani është 232.

Gjithsej 40 kërkesa të familjeve për zgjidhjen e çështjes së strehimit. Numri i përgjithshëm i aplikantëve që kanë kërkuar ndërtim të shtëpive është 30 kërkesa, ndërsa për material ndërtimor 162 kërkesa. Ndërsa në komunë aktualisht gjendet vetëm një ndërtesë e banimit social.

Në identifikim e tokës së mjaftueshme për banim duhet të futen së paku kategoritë:

Banimin për familjet me të ardhura të ulëta, Të moshuarit, Personat me aftësi të kufizuara, Çifte të reja.

3.10.6. NEVOJAT PËR BANIM

Sipas projeksioneve parashihet që në vitin 2030, në komunën e Rahovecit do të ketë 67,553 banorë rezident dhe jo-rezident, rrjedhimisht nëse kalkulohet për secilin banorë nga 40m^2, rrjedh së nevoja e ardhshme për banim në komunën e Rahovecit është: 2,702,120 m2. Raporti banim në shtëpia dhe banim në banesa merret 20/80%.

Duke marrë parasysh projeksionet e popullsisë dhe të ekonomive familjare, nga 8,316 ekonomike familjare në vitin 2020 në 8,413 ekonomike familjare në vitin 2020, del se kemi një rritje prej 97 të ekonomive familjare në komunën e Rahovecit.

Kërkesa për tokë për të akomoduar zhvillimet e ardhshme duhet kalkuluar bazuar në dendësinë neto të zonës urbane dhe rurale. Është detyrë e Hartës Zonale të Komunës që të përcaktojë saktësisht sasinë e tokës për zhvillim duke u bazuar në rritjen e numrit të ekonomive familjare dhe dendësive neto të çdo zone territoriale në veçanti.

3.10.7. SFIDAT, GJETJET KYÇE DHE SUPOZIME TË PRANUARA, IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE DHE KONSTATIMET KRYESORE.

3.10.7.1. SFIDAT, IDENTIFIKIMI I PROBLEMEVE DHE KONSTATIMET KRYESORE TË VENDBANIMEVE

Sfidat:

- Kontrollimi i zhvillimit jashtë zonës urbane, në zonat rurale;
- Zhvillimi i pa balancuar i vendbanimeve;
- Ruajtja e zonave të banimit brenda vendbanimeve përkitazi me planet hapësinore;
- Koncentrimi i kontrollit të zhvillimeve për industri në zonën industriale ekzistuese
- Mungesa e politikave lokale fiskale për rregullimin e banimit të përballueshëm;
- Mos balancimi i kërkesës për banim me ndërtimet e reja në dispozicion (fondi aktual banesor);
- Menaxhimi i presionit në zona të caktuara për ri-zhvillim - Kërkesat e mëdha të qytetarëve dhe ndërtuesve/investitorëve për objekte shumë banesore në zonën urbane,
- Moszbatimi i politikave dhe strategjive për banim në nivel qendror dhe lokal.
- Mungesa e harmonizimit të nevojave për banim në raport me kërkesën.
- Menaxhimi dhe mirëmbajtja e dobët e ndërtesave të banimit në bashkëpronësi.
- Nevoja për formimin e Divizionit për Banim, në kuadër të Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm.
- Sigurimi i banimit të përshtatshëm (social dhe i përballueshëm) për familjet me të ardhura të ulëta dhe familjet tjera.
- Mungesa e Fondit të Banimit në nivel qendror.
- Vendbanimi joformale, brenda dhe jashtë zonave urbane.
- Rritja e banimit përgjatë rrugëve - shfrytëzimi jo racional i hapësirës.
- Lidhja ndërmjet banimit individual dhe kolektiv në zonat urbane.
- Rritja e nivelit të punësimit.
- Ulja e varfërisë.
- Përfshirja e të rinjve në sferën socio-kulturore

Potencialet:

- Hartimi i Ligjit për Banim.
- Politikat për banim dhe zhvillim urban.
- Rritja e banimit për t'i përmbushur kërkesat.
- Interesi i sektorit privat për investime.
- Krijimi dhe menaxhimi i politikave të qerasë për banesa, lokale dhe tokë ndërtimore (prona komunale).

3.10.8. GJETJET KYÇE DHE SUPOZIME TË PRANUARA

Sa i përket njësive të banimit në dispozicion, del se 22% e tyre janë të pa-shfrytëzuara, prandaj është e domosdoshme që në të ardhmen planifikimi i njësive të reja të banimit të bëhet në bazë të parashikimeve demografike, por edhe duke përcjellë trendin e zvogëlimit të ekonomive familjare.

Në Komunën e Rahovecit, në aspektin e banimit social, përveç faktit që kemi mbi dyqind kërkesa të reja për strehim, situata është relativisht e mirë. Në komunë aktualisht gjendet vetëm një ndërtesë e banimit social.

Dendësia mesatare e banimit në territorin e komunës së Rahovecit arrin në 204 banorë në 1km^2, brenda territorit të komunës së Rahovecit ekzistojnë dallime për sa i përket dendësisë së popullsisë.4 Në disa vendbanime që kanë numër më të madh të popullsisë edhe dendësia është shumë më e lartë dhe e kundërta në vendbanimet që kanë numër të vogël të popullsisë edhe dendësia është shumë më e vogël.

Kjo është në raport edhe me hapësirën e vendbanimit, ku disa vendbanime që kanë hapësirë më të vogël (zona kadastrale e vendbanimit është e vogël), dendësia e popullsisë është më e madhe.

Vlerësimi i përparësive, dobësive, mundësive dhe rreziqeve – Analiza SWOT

PËRPARËSITË	**DOBËSITË**
Ndërtimi i banesave të reja **Popullsia me moshë mesatare të re** **Popullsia me moshë ekonomikisht aktive** **Popullsia relativisht mirë e arsimuar, e orientuar drejt vlerave arsimore**	Papunësia e lartë; Shkalla e varfërisë; Shenja të rënies në trendin e rritjes së popullsisë; Aktivitete jo të mjaftueshme socio-kulturore; Migrimi; Një numër i njësive të banimit nuk i plotësojnë standardet hapësinore të banimit; Sektori i banimit me qira i pazhvilluar; Ndërtesat e banimit në bashkëpronësi që janë në gjendje të keqe dhe me nevojë për riparim;
MUNDËSITË	**KËRCËNIMET**
Planifikimi kompakt i zonave të banimit **Hartimi i politikave nga niveli qendror për banim të përballueshëm;** **Potenciali i sektorit privat për banim;** **Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe profesionale nga niveli qendror** **Mundësia e aplikimit të PPP-së me qëllim të rritjes së numrit të banesave sociale** **Shkëmbimi i përvojave me komunat dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Programe speciale-profesionale për të papunët sipas kërkesave të tregut,** **Zgjerimi i edukimit para fillor në të gjitha shkollat fillore** **Dërgesat e bashkatdhetarëve(remitancat)**	Tendenca për ndërtimin e banimit pa planifikim përkatës dhe pa leje ndërtimore Mos respektimi i legjislacionit Rritja e vazhdueshme numrit të kërkesave Kriza ekonomike Dukuritë negative në shoqëri Largimi i popullsisë ekonomikisht aktive jashtë vendit Largimi i fuqisë punëtore të kualifikuar jashtë vendit

Tabela 208. Analiza SWOT për banim

SFIDAT KRYESORE TË IDENTIFIKUARA
Sigurimi i banimit financiarisht të përballueshëm; **Ndalimi i zhvillimeve të pakontrolluara/paligjshme të banimit;** **Përmirësimi i kushteve të banimit dhe ofrimi i shërbimeve adekuate; dhe** **Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe të tjera.**

NEVOJAT ZHVILLIMORE
Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese të banimit dhe nevojave për banim;

Sigurimi i banimit adekuat për kategoritë në nevojë, të përcjellë edhe me masa konkrete për integrim social dhe aftësim për punë;
Monitorimi dhe menaxhimi i vazhdueshëm i zhvillimit hapësinor të banimit; dhe
Ofrimi i shërbimeve adekuate publike dhe sociale që mbështesin zhvillimin e qëndrueshëm të banimit.

3.11. SHFRYTËZIMI I TOKËS

Territori i Komunës së Rahovecit është i dominuar me pjesë kodrinore-malore që mundëson zhvillimin e ekonomisë pyjore, turizmit dhe blegtorisë, ndërsa sipërfaqet e rrafshëta shfrytëzohen për aktivitete tjera bujqësore dhe për ngritjen e vendbanimeve. Në vazhdim është paraqitur një tabelë, në të cilën janë të rreshtuara shfrytëzimet dhe sipërfaqet e tyre sipas shfrytëzimit të tokës të vitit 2022, si dhe shfrytëzimi i Tokës nga Plani Zhvillimor Komunal 2013 – 2023.

Duke pasur parasysh mangësitë që ka Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023 në sipërfaqet e planifikuara apo projeksionet për zhvillim brenda periudhës 2013 – 2023 kemi marrë për bazë edhe disa nga sipërfaqet nga Urban Atlas Copernicus të vitit 2012 në mënyrë që të kompletojmë mungesat e sipërfaqeve të lartcekura.

Në tabelë janë nxjerrë diferencat në hektar dhe në përqindje:

Kategoria e shfrytëzimit	Shfrytëzimi ekzistues i tokës bazuar në të dhënat nga Plani Zhvillimor Komunal 2013-2023 si dhe nga Urban Atlas Copernicus 2012	Shfrytëzimi Aktual 2023 sip/ha	**Diferenca ha**	**Diferenca %**
Banim/Banim i përhershëm	1,279.36	1,311.00	31.64	2.41%
Prodhim Parësor /Bujqësi	18,970.8	18,640.28	-330.52	-1.77%
Rrjetet e transportit, logjistikës] dhe Infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit	157.1	299	141.90	47.46%
Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë	5,720	6,426.54	706.54	10.99%
Prodhim Dytësor / Industri e prodhimeve të lehta	204.12	256.64	52.52	20.46%

Tabela 209 Analiza krahasuese në mes shfrytëzimit të Tokës së Planit Zhvillimor 2013-2023 dhe Shfrytëzimit aktual të Tokës 2023.

3.11.1. GJETJET KYÇE

Gjatë analizës së profilit për komunën e Rahovecit kemi disa gjetje kyçe në disa fusha të shfrytëzimit të Tokës duke bërë krahasimin e sipërfaqeve nga viti 2013 kur është hartuar Plani Zhvillimor Komunal në fuqi 2013 – 2023 e deri më sot.

Kjo analizë na mundëson që të bëjmë krahasimin si dhe vlerësimin e projeksioneve të Planit zhvillimor Komunal 2013 – 2023 dhe për të ardhur në përfundim se deri në çfarë pike ka arritur zbatimi i këtij plani.

Gjithashtu vlen të theksohet që përmes krahasimit të shfrytëzimeve të Tokës 2013 – 2023 ne nxjerrim edhe nevojat e reja për pjesën e planifikuar.

Në tabelën më poshtë kemi të përshkruara gjetjet kyçe të shfrytëzimit të Tokës.

Nr.	Përshkrimi
1.	Shfrytëzimi i Tokës për Banim/Banim i përhershëm: Duke analizuar trendin e rritjes së sipërfaqeve të banimit nga 2013 deri 2023, për nëntë vite kemi 31.64ha apo 2.41% rritje.
2.	Shfrytëzimi i Tokës si Prodhim Parësor /Bujqësi: Në komunën e Rahovecit kemi një humbje të konsiderueshme të tokës bujqësore, ku nga viti 2013 e deri në vitin 2023 kemi -330.52ha apo -1.77% të humbura.
3.	Shfrytëzimi i Tokës si Prodhim Parësor / Pylltari / Pylltari e bazuar në rotacion të mesëm apo të gjatë: Në komunën e Rahovecit kemi një rritje të Tokës pyjore ku nga viti 2013 e deri në vitin 2023 kemi 1564.95 ha.
4.	Rrjetet e transportit, logjistikës dhe Infrastrukturës publike / Rrjetet e transportit: Në komunën e Rahovecit kemi një rritje të Tokës pyjore ku nga viti 2013 e deri në vitin 2023 kemi 52.52ha apo 20.46%.
5.	Prodhim Dytësor / Industri e prodhimeve të lehta : Në komunën e Rahovecit kemi një rritje të zonës Industriale ku nga viti 2013 e deri në vitin 2023 kemi 52.52ha apo 20.46%.

Tabela 210 Gjetjet kyçe gjatë vlerësimit të profilit të shfrytëzimit të tokës

PËRPARËSITË	DOBËSITË
Qendra e qytetit është e fuqishme. **Rritje e territorit të sipërfaqeve të infrastrukturës rrugore për 141.90ha.** **Zgjerim i zonave rekreative turistike.** **Sipërfaqe e konsiderueshme me tokë bujqësore.** **Sipërfaqe të mjaftueshme me potenciale për zhvillim të turizmit rural.** **Sipërfaqe e konsiderueshme me tokave pyjore.** **Sipërfaqe e konsiderueshme e sipërfaqeve ujore.** **Potencial për zhvillim të bujqësisë kryesisht vreshtarisë dhe shumë produkteve të tjera bujqësore.**	Shpërndarja urbane dhe shfrytëzimi joefikas në periferi. Ndërtimet ilegale në tokë bujqësore Fragmentimi i tokës bujqësore në parcela të vogla. Vendbanime me shtrirje të shpërndarë në toka bujqësore. Krijimi i korridoreve të zonave ekonomike në mënyrë të pa kontrolluar Humbje e tokës bujqësore me sipërfaqe -330.52ha brenda viteve 2013 – 2023.
MUNDËSITË	RREZIQET
Ndërprerja e ndërtimeve në zonat bujqësore **Densifikimi i fondit ndërtimor në zonat urbane si masë për ruajtjen e tokës bujqësore.** **Përcaktimi dhe mbrojtja e zonave bujqësore.** **Përcaktimi i zonave për konsolidim të tokave bujqësore** **Planifikim i sipërfaqeve për zhvillim të zonave turistike verore dhe dimërore.**	Ndërtimet pa leje përgjatë rrugës mund ta bllokojnë në zhvillimin e ardhshëm. Krijimi i vendbanimeve të shpërndara Ndërtimet mbi zonat arkeologjike dhe dëmtimi i zonave arkeologjike Humbje e Tokës pyjore. Rritje e pakënaqësisë qytetare

Tabela 211 SWOT analiza e shfrytëzimit aktual të tokës

4. KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Korniza e Zhvillimit Hapësinor të Komunës së Rahovecit paraqet vizionin dhe nevojat e përgjithshme dhe të veçanta, të cilat komuna dëshiron t'i realizojë në zhvillimin e saj socio-ekonomik në të ardhmen. Orientimet afatgjata strategjike të zhvillimit janë përcaktuar gjatë një procesi pjesëmarrës gjithëpërfshirës, bazuar në nevojat e identifikuara gjatë analizës së gjendjes në komunë, të paraqitura në mënyrë të strukturuar në analizën SWOT dhe në kontekst të kapaciteteve financiare të komunës.

4.1. VIZIONI PËR TË ARDHMEN E KOMUNËS, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT NGA PLANI HAPËSINOR I KOSOVËS

Plani Hapësinor i Kosovës (PHK) është dokument i cili jep orientimet dhe përcakton shtrirjen hapësinore të zhvillimeve në të ardhmen në gjithë territorin e Republikës së Kosovës. PHK-ja shërben edhe si udhëzues në hartimin e planeve zhvillimore komunale.

Me qëllim të paraqitjes së kaheve të zhvillimeve hapësinore, duke marrë parasysh edhe karakteristikat gjeografike, natyrore, veprimtaritë socio- ekonomike, etj., PHK-ja identifikon katër zona të cilave u janë dhënë ngjyrat dhe emrat në bazë të tipareve karakteristike të zonës.


- Thesari i Kosovës ,,Zona e gjelbër'' zonë industriale, shërbyese tregtare, agroindustriale me qendër kryesore Mitrovicën.
- Porti i Kosovës ,,Zona e kaltër '' zonë administrative, arsimore, shërbyese, tregtare, agroindustriale, turistike me qendër kryesore Prishtinën
- Kopshtet e Kosovës ,,Zona e portokalltë'' zonë kulturo-turistike, agro-industriale dhe shërbyese tregtare.
- Urat e Kosovës,,Zonat e verdha''.

Karakteristikat për zonën e verdhë

Kjo hapësirë zë pjesën jugperëndimore të Kosovës dhe përbëhet nga komunat: Deçani, Rahoveci, Malisheva dhe Gjakova si qendër më e madhe komunale. Kjo zonë shtrihet në pjesën e mesme të rrafshit të Dukagjinit të rrethuar me male, lartësi mbidetare prej 365m – 2,656m, klimë të mesme kontinentale me ndikim të dobësuar të klimës mesdhetare, kohëzgjatje të vegjetacionit 200-250 ditë, rrjet të pasur hidrografik, trashëgimi natyrore dhe kulturore, tokë bujqësore të kualitetit të lartë, kullosa, livadhe, traditë në kultivim të pemëve e vreshtave, bletarisë e shpezëtarisë, e dalluar për kultivimin e zejeve tradicionale. Rahoveci si komunë i takon zonës së verdhë.

Vizioni për Zonën e Verdhë

Urë e zhvillimit të lidhjeve të Kosovës me rajonin, rrjet funksional i qyteteve të fuqishme dhe fshatrave dinamike, atraktive për të jetuar dhe punuar në to. Duke shfrytëzuar kapacitetet e infrastrukturës, pozitën gjeografike dhe pasuritë e shumta natyrore, kulturore dhe humane, të zhvillohet në një hapësirë të qëndrueshme ekonomike agroindustriale, tregtare, shërbyese dhe turistike.



Harta 35 Strategjia e zhvillimit hapësinor – Hapësira e verdhë

Qëllimet e përgjithshme për zonën e verdhë:

- Zhvillimi i rrjetit të vendbanimeve, me qeverisje e shërbime publike në favor të qytetarit, me rritje të kualitetit të jetesës së qytetarëve, punësimit, barazisë sociale.
- Mbështetje ZHEL për ZHEK – shfrytëzimi i përparësive konkurruese,
- Zhvillimi i lidhjeve efikase brenda-urbane, ndër-urbane me 6 hapësirat e tjera dhe më gjerë në rajon përmes rrjetit të zhvilluar të infrastrukturës (rrugore, hekurudhore, ajrore dhe TIK).
- Përkrahja e zhvillimeve për arsim bashkëkohorë e përkrahës të kërkesave të tregut;
- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore, turizmit kulturor e rekreativ;
- Zhvillim të lidhjeve tregtare e shërbyese ndërkufitare me Shqipërinë;
- Aeroporti civil i Gjakovës si mundësi për zhvillim ekonomik; dhe
- Zhvillimi i shërbimeve tregtare, agroindustriale dhe turistike, me intensifikim të politikave për mbrojtje dhe rimëkëmbje të mjedisit.

Përparësitë dhe mundësitë	Mangësitë
Burimet njerëzore, mosha e re e popullsisë (55% nën 26 vjet);	Nivel i ulët i decentralizimit fiskal komunal;
Vetëdije kolektive e lartë;	Mungesa e vetiniciativës;
Përvoja në udhëheqje;	Vonesa e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore nga AKM;
Pozita e mirë gjeografike, zonë kufitare;	Migrimi i popullatës – posaçërisht të moshës së re;
Shndërrimi dhe shfrytëzimi i aeroportit ushtarak të Gjakovës në atë civil;	Ndërmarrjet e mëdha industriale në pronësi shoqërore jo aktive;

Tradita në kultivimin e zejeve tradicionale;	Degradim i konsiderueshëm i resurseve natyrore (shfrytëzimi i rërës dhe prerja e pyjeve); dhe
Përvoja në industri;	Mungesa e kooperimit socio-kulturor.
Sektori joqeveritar dhe diasporë e fortë dhe përkrahëse e zhvillimeve;	
Sipërfaqet e punueshme dhe nën ujitje;	
Resurset natyrore dhe kulturore për zhvillimin e turizmit;	
Zhvillimi i tregtisë, shërbimeve;	
Zhvillimi i eko-bujqësisë;	
Kooperimi me qytete tjera brenda dhe jashtë Kosovës;	
Hapja e shkollave profesionale;	
Shfrytëzimi i TIK në shërbime; dhe	
Zhvillimi i sektorit të shëndetësisë.	

Tabela 212 Përparësitë, mangësitë dhe mundësitë e zhvillimit të ardhshëm të hapësirës së verdhë

Konfliktet dhe sinergjitë në skenarin e zhvillimit të Hapësirës së Verdhë:

Konfliktet:

- Shtrirja e vendbanimeve në tokën bujqësore;
- Zhvillimi i industrisë ndërtimore me degradimin e lumenjve dhe pyjeve; dhe
- Zhvillimi i zonës së aeroportit me tokën bujqësore.

Sinergjitë:

- Zhvillimi i turizmit kulturor, rekreativ, tradicional fshatar me ruajtjen dhe zhvillimin e trashëgimisë natyrore e kulturore.

Zonat hapësinore me interes të veçantë për Kosovën

- Aeroporti i Gjakovës;
- Kanioni i Drinit të Bardhë me Urën e Fshejtë;
- Parku rajonal i Mirushës;
- Miniera e kromit në Devë;
- Liqeni akumulues – Radoniqi;
- Manastiri i Deçanit;
- Çarshia e Madhe – Gjakovë;
- Kullat e Dukagjinit; dhe
- Kalimet kufitare (Prush e Morinë).

4.2. VIZIONI

Vizioni për zhvillimin e ardhshëm të komunës së Rahovecit shpreh qëllimet afatgjata të synuara për tu arritur, të përcaktuara përmes procesit pjesëmarrës të palëve të interesit dhe analizave shumë-sektoriale, duke u nisur nga gjendja aktuale, sfidat e identifikuara, nevojat për zhvillim, si dhe potencialet lokale.

Gjatë përshkrimit dhe vlerësimit të gjendjes ekzistuese – profilit komunal, janë grumbulluar dhe analizuar të dhëna të shumta për fusha të ndryshme. Në bazë të këtij vlerësimi janë identifikuar edhe sfidat kryesore të komunës.

Faza e dytë e planit parasheh zgjidhjen e problemeve dhe konflikteve hapësinore, me të cilat përballet komuna e Rahovecit.

Vizioni, parimet dhe caqet, përfshijnë parashikimet e favorshme të zhvillimeve të ardhme në fusha të ndryshme si:

- Ekonomike;
- Infrastruktura teknike;
- Infrastruktura e transportit;
- Infrastruktura publike dhe sociale;
- Mjedisi dhe sipërfaqet me rrezikshmëri;
- Asetet e trashëgimisë natyrore;
- Vendbanimet;
- Banimi;
- Vendbanimet joformale; dhe
- Shfrytëzimi i tokës.

Komponenta këto sipas udhëzimit administrativ për PZHK dhe programit të hartimit të PZHK-së së komunës së Rahovecit.

Përmes kësaj deklarate prezantohet zhvillimi i ardhshëm i komunës në formë të përmbledhur si në vijim:

"Rahoveci komunë lidere në mbrojtje të trashëgimisë kulturore e natyrore si dhe zhvillim të hovshëm në bujqësi, ndërmarrësi dhe arsim."

Përmes këtij vizioni, njëkohësisht ofrohen zgjidhje për sfidat e identifikuara në fazën e parë.

Vizioni për Komunën e Rahovecit parasheh zhvillime konkrete dhe të realizueshme si:

- Zhvillim të hovshëm në të gjithë sektorët e bujqësisë;
- Avancim të administratës publike;
- Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë;
- Ngritje të nivelit në arsim dhe shëndetësi;
- Zhvillim të vendbanimeve dhe ndërtime me plan;
- Mbrojtjen e mjedisit dhe trashëgimisë kulturore;
- Ekonomi të zhvilluar; dhe
- Infrastrukturë e planifikuar bashkëkohore.

4.3. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT ZHVILLIMORE

Përcaktimi i qëllimeve për fusha përkatëse paraqet hapin e mëtejmë dhe më specifik drejt arritjes së vizionit, gjithmonë duke i pasur parasysh çështjet e identifikuara, nevojat dhe kërkesat, si dhe potencialet e mundshme në dispozicion.

Për secilin qëllim janë përcaktuar edhe objektivat përkatëse, si elemente më specifike, të matshme dhe të arritshme, në mënyrë që të jepet një kornizë më konkrete për zbatimin dhe monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal të Rahovecit.

QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi 1 –Përmirësimi i mirëqenies sociale

Objektivat

- Zhvillimi i aftësive për punësim, me fokusim te femrat dhe të rinjtë;
- Zhvillimi i programeve për punësim;
- Sigurimi i punës sezonale;
- Zhvillimi i skemave të përkrahjes financiare dhe sociale për kategoritë në nevojë; dhe
- Përkrahje të bizneseve të vogla dhe të mesme.

Qëllimi 2 – Përmirësimi i nivelit të shërbimeve shëndetësore

Objektivat

- Përmirësimi i infrastrukturës fizike në shërbimet shëndetësore;
- Përmirësimi i infrastrukturës teknike në objektet shëndetësore; dhe
- Krijimi i kushteve për edukim të vazhduar të personelit profesional në shëndetësi.

Qëllimi 3 – Përmirësimi i nivelit të arsimit

Objektivat

- Investime në përmirësimin e kushteve infrastrukturore të shkollave në funksion të rritjes së cilësisë në arsim dhe ndërtimin e shkollave të reja.
- Nga shtatori i viti 2018-2019 do të bëhet funksionalizimi i plotë dhe i përhershëm i organeve drejtuese të shkollave dhe këshillave drejtues të shkollave.
- Ofrimi i shërbimeve profesionale pedagogjike dhe psikologjike, dhe trajnimeve profesionale të mësimdhënësve.
- Sigurimi i edukimit parashkollor , sipas nevojave të identifikuara.
- Sigurimi i qasjes në arsim për të gjitha moshat shkollore.
- Kompletimi i infrastrukturës shkollore , sipas nevojave të identifikuara.

Qëllimi 4 – Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të ndërtesave të kulturës

Objektivat

- Funksionalizimi i ndërtesave ekzistuese të kulturës;
- Shfrytëzimi i vazhdueshëm i ndërtesave të kulturës; dhe
- Shfrytëzimi i infrastrukturës ekzistuese në zonat rurale për zhvillimin e ngjarjeve kulturore – shkollat, hapësirat publike.

Qëllimi 5 – Përmirësimi dhe zgjerimi i infrastrukturës për sport dhe rekreacion

Objektivat

- Funksionalizimi i objekteve ekzistuese sportive; dhe
- Shfrytëzimi i vazhdueshëm i objekteve sportive.

Qëllimi 6 – Përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të hapësirave publike

Objektivat

- Përmirësimi i hapësirave ekzistuese publike;
- Krijimi i hapësirave të reja publike; dhe
- Mirëmbajtja e hapësirave publike.

Qëllimi 7 – Ofrimi i banimit të qëndrueshëm

Objektivat

- Ofrimi zgjidhjeve të qëndrueshme të banimit për familjet në nevojë.

Qëllimi 8 – Rritja e densitetit në qendrën komunale

Objektivat

- Konsolidimi i lagjeve të qendrës komunale; dhe
- Konsolidimi i qendrës dhe përmbajtjeve shumë funksionale.

Qëllimi 9 – Zhvillimi i vendbanimeve në mënyrë kompakte

Objektivat

- Konsolidimi i lagjeve të vendbanimeve duke e ruajtur karakterin;
- Lidhje funksionale me qendrën urbane;
- Formimi i qendrave të reja sekondare; dhe
- Zgjidhje për ndërtimet ilegale dhe vendbanimeve joformale.

Qëllimi 10 - Rritja dhe zhvillimi i sektorit të bujqësisë, me theks vreshtaria, perimekultura si dhe kapaciteteve përpunuese në komunën e Rahovecit

Objektivat

- Përkrahje e vreshtarëve në përmirësimin e infrastrukturës dhe ngritjen e kapaciteteve prodhuese;
- Ngritja e kapaciteteve prodhuese në sektorin e perimekulturës;
- Nxitja e konkurrushmerisë dhe qëndrueshmërisë të zingjirit agro-ushqimor;

Përkrahja e fermerëve në rritjen e fondit blegtoral dhe përmirësimin racor.

Qëllimi 11 – Zhvillimi i kapaciteteve turistike

Objektivat

- Shfrytëzimi i qëndrueshëm i potencialeve natyrore dhe kulturore;
- Zhvillimi i turizmit rural;
- Zhvillimi i kapaciteteve shërbyese dhe hoteliere; dhe
- Zhvillimi i turizmit bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore.

Qëllimi 12 – Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme si dhe industrisë së lehtë

Objektivat

- Zhvillimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme sipas kërkesave në tregun vendor dhe regjional; dhe
- Bashkëpunimi ndër-sektorial në nivel komunal dhe ndër-komunal.

Qëllimi 13 – Zhvillimi i transportit dhe infrastrukturës së mobilitetit

Objektivat

- Përmirësimi i qarkullimit në qendrën komunale;
- Kompletimi i rrjetit rrugor në zonat rurale;
- Rrugë të asfaltuara të kualitetit të lartë dhe qasje për të gjithë banorët;
- Rritja e shfrytëzimit të transportit publik;
- Sigurimi i kushteve për qarkullim jo-motorik; dhe
- Përmirësimi i sigurisë së qarkullimit.

Qëllimi 14 - Menaxhimi adekuat me ujëra

Objektivat

- Sigurimi i burimeve të mjaftueshme të ujit për nevojat e banimit dhe të zhvillimit;
- Ofrimi i sistemeve funksionale të ujësjellësit për të gjitha vendbanimet;
- Ofrimi i sistemeve funksionale të kanalizimit për të gjitha vendbanimet;
- Trajtimi i ujërave të zeza; dhe
- Zhvillimi i sistemit për menaxhimin e ujërave atmosferik.

Qëllimi 15 – Menaxhim adekuat i mbeturinave

Objektivat

- Parandalimi dhe largimi i mbeturinave në trupat ujor dhe mjedise tjera si deponi ilegale; dhe
- Mbulimi i të gjitha vendbanimeve me shërbimin e mbledhjes së mbeturinave.

Qëllimi 16 – Mbrojtja e mjedisit

Objektivat

- Parandalimi i shkarkimit të ujërave të zeza dhe industriale në lumenj si dhe ndërtimi i impiantit për trajtim të ujërave të zeza;
- Reduktimi i ndotjes së ajrit;
- Mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i tokës bujqësore;
- Mbrojtja e pyjeve dhe ripyllëzimi;
- Rregullimi i shtretërve të lumenjve për parandalimin e vërshimeve;
- Shfrytëzimi racional i zhavorrit dhe gurthyesve për një zhvillim të qëndrueshëm; dhe
- Zvogëlimi i impakteve negative nga kafshët.

Qëllimi 17 – Mbrojtja nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Objektivat

- Mbrojtja nga zjarret; dhe
- Reduktimi i zonave të rrezikuara nga vërshimet.

Qëllimi 18 – Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, natyrore

Objektivat

- Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë natyrore dhe peizazhit;
- Mbrojtja e vlerave të trashëgimisë kulturore; dhe
- Promovimi i vlerave të trashëgimisë lokale.

PRIORITETET STRATEGJIKE

- Avancim të administratës publike;
- Krijimi i parqeve të reja dhe hapësirave për rekreacion;
- Zhvillimi i bujqësisë, vreshtarisë, pemëtarisë dhe perimtarisë si dhe plasim i sigurt në tregun evropian dhe më gjerë;
- Mbrojtje e mjedisit dhe shfrytëzim racional i resurseve natyrore;
- Planifikimi i më shumë se një kolektorëve për trajtimin e ujërave të zeza;
- Infrastrukturë e planifikuar bashkëkohore si në zonën urbane ashtu edhe në zonat rurale;

- Zhvillim të vendbanimeve , trajtim të vendbanimeve joformale si dhe ndërtimeve me plan;
- Ngritje të nivelit në arsim dhe shëndetësi;
- Rënie të vazhdueshme në shkallën e papunësisë dhe varfërisë; dhe
- Zhvillimi i turizmit bazuar në resurse të trashëgimisë natyrore, historike dhe kulturore.

4.4. Koncepti i zhvillimit hapësinor të komunës

4.4.1. Koncepti i zhvillimit hapësinor

Koncepti i përgjithshëm i zhvillimit hapësinor të komunës së Rahovecit bazohet në vlerësime reale të përparësive krahasuese të komunës si pozita e saj gjeografike dhe mundësive reale të zhvillimit konkurrues të potencialeve të saja zhvillimore: ekonomike, turistike, infrastrukturore dhe resurseve njerëzore. Planifikimi i shpërndarjes hapësinore të zhvillimeve mundëson arritjen e qëllimeve të përcaktuara për arritjen e vizionit, përmes një zhvillimi të balancuar dhe të qëndrueshëm hapësinor të komunës, duke i vënë në funksion të zhvillimit potencialet e saj konkurruese.

Toka bujqësore kualitative, bujqësia si veprimtari tradicionale e popullatës si dhe kapacitetet ekzistuese agroindustriale paraqesin potenciale të rëndësishme zhvillimore për komunën.

Zhvillimi i bujqësisë, në veçanti vreshtarisë dhe perimtarisë, pemëtarisë e blegtorisë, do të jenë nxitëse të themelimit të kapaciteteve të ndryshme përpunuese *("zinxhiri i shkurtër i furnizimit").* Ky zhvillim mbështetet në avancimin e strukturës agrare, aseteve fizike dhe pajisjeve teknike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, zhvillimin e bizneseve dhe edukimin e prodhuesve bujqësorë për prodhimin organik.

Prioritet i komunës së Rahovecit është rritja e sipërfaqeve bujqësore dhe i kontributit dhe cilësisë së prodhimeve bujqësore. Kjo do të thotë edhe të hyra më të larta për të gjitha familjet që merren me bujqësi dhe blegtori. Politikat bujqësore do të orientohen edhe ndaj rritjes së kapaciteteve industriale - përpunuese me synim rritjen e eksportit dhe do të krijojnë prodhime me vlerë më të lartë të shtuar.

Objektivat më të rëndësishme në fushën e bujqësisë janë: orientimi i subvencioneve bujqësore drejt ekonomive bujqësore fitimprurëse dhe të orientuara ndaj tregut, përveç kësaj mbështetje financiare do të ketë edhe për zmadhimin e sipërfaqeve bujqësore dhe të fermave blegtorale duke investuar në ngritjen e fermave moderne.

Do të përkrahet ndërtimi i depove magazinuese bashkëkohore në zonat prodhuese për produkte specifike të bujqësisë, në ruajtjen dhe konservimin e tyre, sidomos gjatë kohës kur përfundon plasmani i produkteve të gatshme në treg.

Në sektorin e kultivimit të perimeve avancimi i procesit të kulturave perimtare duke tejkaluar prodhimin tradicional të fidanëve në prodhimin intensiv përmes fidanishteve moderne dhe me standarde bashkëkohore.

Përkrahja për zhvillimin e industrisë së përpunimit do të realizohet nëpërmjet bashkëfinancimit të ndërtimit të objekteve prodhuese, furnizimit të pajisjes për bodrumet e verës, pajisje për përpunimin e pemëve dhe perimeve, përpunimit të qumështit dhe prodhimit të produkteve të qumështit.

Krijimi i fondit emergjent, dedikuar për raste emergjente, ku dihet që komuna e Rahovecit përballet çdo vit me fatkeqësi natyrore, që të gjithë fermerët e komunës që dëmtohen nga këto fatkeqësi të kompensohen për humbjet e tyre.

Në bashkëpunim me shoqatat bujqësore dhe organizatat e ndryshme, fokusi i komunës së Rahovecit në të ardhmen do të jetë sensibilizimi i përdorimit të sigurimeve bujqësore për produktet kryesore.

Një objektiv i rëndësishëm i komunës së Rahovecit do të jetë rritja e sipërfaqeve të pyjeve duke pyllëzuar hapësira të reja, ruajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga prerja e paligjshme.

Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme si një sektor i fuqishëm në komunë (në veçanti në turizëm, agroindustri, tregti dhe shërbime, transport) dhe mikro-bizneset në veprimtarinë e zanateve, do të jenë gjeneratorë të punësimit. Për këto ndërmarrje do të sigurohet hapësira e nevojshme për zhvillim në kuadër të zonave ekzistuese dhe zonave të reja të planifikuara për këtë qëllim.

Turizmi si sektor prioritar bazohet në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit natyror dhe kulturor, që nënkupton mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, natyrës dhe aseteve të shumta të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me të cilat disponon komuna e Rahovecit. Në fokus do të jetë zhvillimi i hapësirave turistike të Kanionit të Drinit të Bardhë, të përcjellë me ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe aktiviteteve ndihmëse përcjellëse, të cilat do të tërheqin vizitorë gjatë tërë vitit.

Investimi i vazhdueshëm në infrastrukturën bujqësore, me theks në rrugët fushore-vreshtare, do të na krijojë kushte të favorshme për rritjen e turizmit rural. Ndërtimi i bujtinave të reja dhe restaurimi i shtëpive ekzistuese do të jetë objektiv thelbësor në të ardhmen. Trajtimi me kujdes i vendbanimeve me specifika të veçanta dhe shpallja e tyre *"Zona me Interes të Veçantë"* duke koncentruar edhe produktet dhe shërbimet specifike në atë zonë.

Zhvillimi i sektorit terciar të ekonomisë – shërbimeve duhet të intensifikohet dhe të diversifikohet në përputhje me funksionet e qendrave të caktuara në rrjetin e vendbanimeve. Lidhur me këtë, zhvillimi i ekonomisë krahas ngritjes së cilësisë së shërbimeve publike (arsim, shëndetësi, kulturë, etj.), do të ndikojë në zvogëlimin e migrimit të popullatës nga zonat rurale. Kjo krijon një shpërndarje më të balancuar të popullsisë në territorin e komunës dhe përmirëson lidhjet funksionale ndërmjet qendrës komunale – Rahovecit dhe nën-qendrave.

Ndërtimi i sistemeve dhe objekteve të infrastrukturës teknike dhe përmirësimi i asaj ekzistuese është i një rëndësie të veçantë për zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës. Kjo nënkupton zgjerimin dhe përmirësimin e rrjetit rrugor dhe shërbimeve të transportit; ri-aktivizimin e hekurudhës për bartjen e mallrave; zgjerimin dhe përmirësimin e sistemeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe për kullimin e ujërave atmosferikë përfshirë impiantet për trajtim të ujërave të zeza; ri-ndërtimin e rrjeteve ekzistuese të energjisë elektrike të vendbanimeve; dhe menaxhim efikas të mbeturinave dhe zgjerimin e sistemeve të ujitjes.

Forcimi i lidhjeve ndër – komunale do të zhvillohet në përputhje me interesat ekonomike dhe socio-kulturore që nënkupton pjesëmarrje në projekte dhe programe të ndryshme të ndihmuara nga BE-ja.

Një nga përcaktimet themelore të PZHK-së është përdorimi racional dhe mbrojtja e burimeve natyrore, sidomos ruajtja e tokës bujqësore dhe burimeve të tjera natyrore, si asete të rëndësishme strategjike për komunën. Mbrojtja e burimeve ujore nga ndotja dhe shfrytëzimi i pakontrolluar është e një rëndësie të veçantë prandaj do të merren masa adekuate parandaluese.

Përcaktim tjetër i rëndësishëm i PZHK-së është shfrytëzimi racional i tokës ndërtimore. Dendësimi dhe zhvillimi i tokës së lirë ndërtimore brenda hapësirës ekzistuese të zonës urbane do të ketë prioritet para shfrytëzimit të zonave të parapara për zgjerim.

PZHK-ja angazhohet për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit dhe zonave të veçanta të trashëgimisë natyrore dhe biodiversitetit, të cilat janë edhe asetet kryesore të zhvillimit të turizmit. Në mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë arkitekturore do të aplikohet qasja e ri-përdorimit adaptive, i cili mundëson shfrytëzimin e këtyre ndërtesave pa i cenuar vlerat e tyre.

Duke u bazuar në ligjin e *Planifikimit Hapësinor (ligji nr. 04/l-174)* si dhe më konkretisht *Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 11/2015 MBI ELEMENTET DHE KËRKESAT THEMELORE PËR HARTIMIN ZBATIMIN*

DHE MONITORIMIN E PLANIT ZHVILLIMOR KOMUNAL, faza e tretë e planit përmban kornizën e zhvillimit hapësinor.

Në këtë fazë të planit shprehen parashikimet zhvillimore për territorin e komunës së Rahovecit. Ndërsa, njëkohësisht, përcaktohet edhe koncepti hapësinor i strategjive për implementim, planet e veprimit dhe të vendimmarrjes.

Korniza e zhvillimit hapësinor në Komunën e Rahovecit përmban strukturën dhe lokacionin hapësinor për zhvillimin dhe organizimin e ardhshëm, ku do të adresohen çështjet si:

- Zhvillimin ekonomik, turizmin, rekreacionin, tregtinë dhe veprimtaritë e tjera ekonomike.
- Infrastrukturën – transportin komunal, komunikimet.
- Popullsinë, banimin, vendbanimet, çështjet sociale, trashëgimia.
- Mjedisin, trashëgiminë natyrore dhe resurset, peisazhet, etj.
- Zonat urbane ekzistuese dhe të propozuara për të ardhmen dhe zonave tjera jashtë zonës urbane.
- Projektet strategjike ose zonave të veçanta, të cilat veç janë aprovuar në Planin Hapësinor të Kosovës.
- Vlerësimi i ndikimit socio-ekonomik dhe mjedisor i kornizës së propozuar.

Në komunën e Rahovecit, në bazë të kushteve fiziko-gjeografike, dallohen dy tërësi kryesore hapësinore që dallohen për nga morfologjia e terrenit dhe faktorët tjerë natyror, ndërsa në bazë të këtyre faktorëve kushtëzohet edhe niveli zhvillimor në hapësirë. Pra, dallohet hapësira e rrafshët me tokë bujqësore të cilësisë së lartë dhe hapësira kodrinore - malore me pyje e kullosa.

Hapësira kodrinore-malore, në anën veriore të komunës, paraqet ambient të përshtatshëm për pushim dhe rekreacion si dhe aktivitete tjera me karakter ekonomik, si blegtori, etj.

Hapësira veriore e komunës dallohet me karakteristika tjera natyrore dhe të aktiviteteve, dendësi të vogël banimi, rrjet të dobët të infrastrukturës lokale si dhe ambient të qetë dhe të pastër. Mbrojtja, zhvillimi dhe shfrytëzimi i resurseve natyrore dhe potencialeve të kësaj zone, mundëson hapjen e perspektivës për zhvillimin e komunës, me theks të veçantë në turizëm.

Zona Fushore, pjesa jugore e komunës ofron mundësi të mira për sektorin e agrikulturës, zhvillimin e bizneseve, vendbanimeve dhe infrastrukturës moderne. Vlerat e kësaj tërësie hapësinore ia shton lumi Drini i Bardhë me disa degë të tija që kalon në anën jugore.

Zona fushore paraqet perspektivë të mirë për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme ekonomike, ku dominon agrobiznesi si dhe aktivitetet e tjera tregtare, industriale dhe shërbyese.

Kjo zonë, karakterizohet me zhvillim të gjithmbarshëm të llojit të përzier, me përqendrim të madh të popullsisë, aktivitete tregtare-industriale, të cilat qëndrojnë ngushtë të lidhura edhe me zhvillimin e komunikacionit e transportit, si dhe zhvillimit të përgjithshëm të bujqësisë, por njëkohësisht edhe me ndikime të theksuara mjedisore.

Qyteti i Rahovecit ofron mundësi për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme. Ndërsa në zonat rurale propozohet ofrim i shërbimeve dhe infrastrukturës me qëllim të përmirësimit të kushteve dhe cilësisë së jetës. Kjo do të reflektohet në ngritjen e standardit jetësor të popullsisë dhe hapjen e mundësive të reja për zhvillim në fshat.

Në këtë rast, rëndësi të veçantë ka përcaktimi i pikave më të përshtatshme dhe të favorshme për ofrimin e shërbimeve, ndërsa kjo do të reflektohet në koncentrimin e popullsisë, e jo në dezintegrim të saj. Me formimin e disa qendrave sekondare dhe lokale, do të zvogëloheshin distancat mes banimit dhe shërbimeve.

Kushte të përcaktuara nga qeveria lokale mbi çështje të rëndësishme për zhvillimin dhe shfrytëzimin e tokës në komunë, kushtet për përcaktimin e destinimit të sipërfaqeve në territorin e komunës.

Parimet për zhvillim dhe mbrojtje, formulojnë bazën për përcaktimin e kushteve për çështjet e shfrytëzimit të tokës dhe zhvillimit.

Zhvillimi i ardhshëm duhet të jetë i planifikuar dhe i bazuar në vendime adekuate. Në PZHK-në për Rahovec, toka për zhvillim dhe rregullim është e destinuar për këto lloje të shfrytëzimit:

- Vendbanime;
- Korridore të gjelbëruara;
- Rekreacion;
- Toka bujqësore;
- Kullosa dhe livadhe;
- Pyje; dhe
- Lumenj.

Zonat ndërtimore për vendbanime

- Zonat e ndërtimit janë të përcaktuar me Planin Zhvillimor Komunal për Rahovec.
- Ndërtimi është i lejuar vetëm në zonat e përcaktuara për zhvillimin e vendbanimeve (tokën ndërtimore).
- Kufijtë e tokës ndërtimore në pjesën grafike të PZHK-së paraqesin kufijtë absolut për zhvillimin e vendbanimeve.
- Dendësimi i ndërtimit dhe metodat e ndërtimit për shfrytëzim më racional të tokës do të aplikohen më shpesh.
- Definicioni përkatës i veçorive dhe karakterit të ndërtesave në zonat kufizuese me peizazh të ndjeshëm ndaj ndikimit duhet përcaktuar me Planet Rregulluese të Hollësishme.
- Planet Rregulluese si instrument i planifikimit duhet përdorur po ashtu për të arritur përshtatshmërinë e ansambleve ndërtimore me rrethinën.
- Infrastruktura dhe shërbimet duhet të ofrohen në zonat e reja për ndërtim (rryma, sistemi i kanalizimit, ai i ujit).
- Zhvillimi i infrastrukturës duhet ofruar gradualisht bazuar në kërkesat dhe në përputhje me mundësitë financiare të komunës.
- Alternativat tjera sikur partneriteti publik - privat ose skemat private të financimit duhet dakorduar me komunën. Pronari i ndërtesës duhet të paguaj taksat për infrastrukturë ndërsa mënyra e shpërndarjes duhet të elaborohet.

Strukturat e ndërtuara jashtë vendbanimeve

Për zonat e përcaktuara në Planin Zhvillimor Komunal si të lira nga çdo lloj i zhvillimit dhe të mbrojtura nga ndërtimi duhet garantuar:

- Mbrojtjen e zonave për zhvillimin e vazhdueshëm të bujqësisë dhe pylltarisë;
- Zonat me vlera të veçanta; dhe
- Mbrojtjen e peizazhit natyror dhe lokacioneve të trashëgimisë, dhe po ashtu zonat e lidhura natyrore për rekreacion.

Jashtë zonës ndërtimore do të lejohet vetëm këto ndërtesa:

- Ndërtesat publike për mbrojtje ose mbrojtje civile;
- Ndërtesa për mbrojtje nga zjarri dhe materialet të dëmshme – eksploziv, etj.;
- Ndërtesat për menaxhimin e resurseve ujore;
- Infrastruktura;
- Ndërtesa për hulumtimin dhe shfrytëzimin e materialit mineral të eksploatuar; dhe
- Rekreacion dhe turizëm rural. Komuna nuk do të jetë përgjegjëse për ofrimin e infrastrukturës jashtë vendbanimeve.

Bazuar në shfrytëzimin e përcaktuar të tokës, ofrimi i infrastrukturës për zhvillimin e ri do të jetë përgjegjësi e pronarëve ose ndërmarrësve.

Masat për mbrojtjen e peizazheve, vlerave natyrore dhe tërësive kulturo - historike

Komuna, së bashku me Institucionet e nivelit Qendror, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Kulturës, rinise dhe Sporteve, duhet të përgatisin planin menaxhues për mbrojtjen e integruar të natyrës dhe monumenteve kulturore.

Plani duhet të mbroj çfarëdo zhvillimi që do të afektojë vlerat e monumenteve, përveç atyre që shërbejnë t`i mbroj ato.

- Komuna nuk do të lejojë asnjë zhvillim në tokën cilësore bujqësore, përveç atyre zhvillimeve që shërbejnë për mirëmbajtje të veprimtarisë bujqësore (drithërat, bletaria, mbjellja e barit).
- Komuna së bashku me Autoritetin Kosovar të Pyjeve dhe Autoritetin Kombëtar të Parkut Kombëtar, do të organizojë pastrimin sanitar të drunjëve në zonat pyjore.
- Komuna në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës , do të ndërmarrë masa për konsolidim të tokës në zonat e deponive ilegale.
- Komuna duhet të hartoj Rregulloren për hapësirat e gjelbërta dhe politikat për gjelbërim.

Masat për pengimin e ndikimeve të dëmshme në mjedis

- Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen gjithmonë nga komuna në mënyrë që të shmangen ndikimet në mjedis.
- Gjatë dhënies së lejeve për planifikim për objekte zhvillimore ekonomike, nëse është e nevojshme, në pajtim me rregullat mjedisore, të sigurohen masat parandaluese për ndikimet negative në mjedis si ndotja e ajrit dhe zhurma, vibrimet, rrezatimi, ndotja e ujit dhe ndikimet nga mbeturinat e ngurta.
- Vlerësimi i ndikimeve në mjedis është i nevojshëm për përmbajtjet prodhuese.

Mbrojtja e ujit

- Burimet e ujit duhet të mbrohen. Gjatë dhënies së lejeve për planifikim, është e nevojshme që të rregullohen masat për mbrojtje në mënyrë që uji nëntokësor të mbrohet:
- Ndërtimi i sistemit të ujërave të zeza me elemente të papërshkueshme nga uji;
- Ujërat atmosferik duhet të kanalizohen në sistem të veçantë të drenazhimit;
- Kujdes të veçantë duhet t'i kushtohet drenazhit të ujërave atmosferike në varreza; dhe
- Në mënyrë që të mbrohet rrjedha e lumenjve, është e nevojshme të kontrollohet të gjitha shkarkimet dhe të bëhet një inventar i ndotësve.

Mbrojtja nga zhurma

Në mënyrë që vendbanimet të mbrohen nga ndotja e zhurmës është e nevojshme të ndërtohen pengesa dhe të zhvillohen breza të gjelbër në mes të korridoreve për motoçikleta dhe vendbanimeve.

Mbrojtja e ajrit

Që të mbrohet ajri është e nevojshme që të kontrollohet lokacioni për prodhimin e pajisjeve dhe llojin e teknologjisë, llojin e energjisë dhe të stimulohet energjia e pastër dhe energjia ripërtëritëse.

Mbrojtja e shtazëve

Rahoveci është i pasur edhe me pyje dhe me peizazhe kodrinore, prandaj është e nevojshme të kontrollohet gjuetia në mënyrë që të mbrohet zhdukja e specieve shtazore.

4.4.2. SKENARËT E ZHVILLIMIT HAPËSINOR

Në bazë të analizës së gjendjes ekzistuese –profilit, ofrohen edhe skenarët e mundshëm të zhvillimit hapësinor, sipas kritereve dhe standardeve të planifikimit, (sociale, ekonomike, koncentrimit, fuqisë gravituese të qendrave, pozitës, infrastrukturës, produktivitetit të tokave, etj.), që do të vlerësohen si alternativë e zhvillimit dhe organizimit të ardhshëm të komunës.

Krijimit të konceptit të zhvillimit hapësinor i kanë paraprirë analizat e mundësive të ndryshme në lidhje me mënyrën dhe formën e zhvillimit hapësinor të komunës. Për më shumë *"skenarët janë përshkrime të një apo disa të ardhme të mundshme duke u bazuar në trendët e të së kaluarës, të tashmes, dhe të ardhmes" (Van Notten, 2003)*. Vendimet të cilat i marrim sot do të ndikojnë në kahe të zhvillimit të komunës sonë. Në këtë kontekst bëhet edhe analiza e skenarëve që shërben për të menduar në mënyrë kritike se si do të duket e ardhmja e komunës. Hartimi dhe vlerësimi i skenarëve është punuar duke përdorur të dhëna nga gjendja ekzistuese - organizative, kërkesat për të ardhmen si nevojë imediate si dhe potencialet e komunës për zhvillim.

Komuna e Rahovecit është duke ndërtuar zhvillimin e saj mbi potencialet e saja natyrore dhe të krijuara për zhvillim të mirëfilltë: natyra, toka bujqësore, bizneset dhe industria. Bujqësia, konkretisht vreshtaria dhe pemëtaria në njërën anë por edhe zhvillimi turistik, në anën tjetër, konsiderohen si sektor kyç për të udhëhequr këtë zhvillim. Trashëgimia kulturore që ka rajoni, mund të pasurojë dhe integrojë përvojën turistike që ofron Rahoveci. Sektorë të tjerë të ndërlidhur, sidomos agroindustria kanë rol të rëndësishëm në këtë kornizë të re të zhvillimit. Duke u bazuar në trendet e kaluara të zhvillimit dhe gjendjes së tashme urbane dhe hapësinore në komunë, janë analizuar tre skenarë të zhvillimit.

- Skenari 1: zhvillimi i centralizuar i komunës – Skenari i zhvillimit monocentrik;
- Skenari 2: zhvillimi përgjatë Drinit të Bardhë drejt qendrës Urbane – Skenari i zhvillimit linear; dhe
- Skenari 3: zhvillimi i shpërndarë në nën qendra si praktikë bashkëkohore - Skenari i zhvillimi policentirk.

Pika kyçe për të mbajtur nën kontroll këtë rrugë të zhvillimit është duke siguruar se të gjitha fushat (çështjet) e duhura të planifikimit të merren parasysh në mënyrë të integruar gjatë trajtimit të skenarëve


Skenari i zhvillimit monocentrik

Me këtë skenar, qendra urbane zhvillohet si e veçantë, gjithnjë e më tepër në raport me rrethinën, ndërsa vendbanimet rurale edhe më tej ngecin në zhvillimin ekonomik dhe social.

Veprimtaritë ekonomike koncentrohen kryesisht në qytet dhe në disa vendbanime tjera më të mëdha, ndërsa zona urbane dhe vendbanimet tjera shtrihen kryesisht përgjatë korridoreve të rëndësishme rrugore.

Tokat bujqësore të cilësisë së lartë, vazhdimisht mbulohen dhe humbin nga ndërtimet e pakontrolluara.

Zonat rurale vazhdon t`i përcjellë edhe më tej një niveli i ulët i zhvillimit ekonomik dhe me infrastrukturë të zhvilluar dobët. Niveli i shërbimeve mbetet i ulët për shkak të lidhjeve të dobëta me qendrën kryesore. Qendrat lokale mbesin të dezintegruar në sistemin urban. Vendbanimet rurale stagnojnë dukshëm në të gjitha aspektet e zhvillimit.




PËRPARËSITË	DOBËSITË
Bizneset do të zhvillohen në mënyrë spontane.	Centralizimi i institucioneve; Lidhje e dobët e vendbanimeve rurale me zonën urbane; Qasja e dobët e fshatrave në infrastrukturën sociale; Fluksi i shtuar i migrimit të popullsisë nga zonat rurale drejt qytetit; Zhvillim i pakontrolluar i vendbanimeve në tokat bujqësore; Zhvillim i pakontrolluar i ndërtimeve në zonën urbane; Vështirësi në përcjelljen e trendeve të urbanizimit në zonën urbane nga zgjerimi i pakontrolluar; Humbje e kontaktit dhe lidhjeve me peizazhet e bukura malore; dhe Humbje e mbështetjes së shfrytëzimit të pasurive natyrore në viset malore.

Konkluzion: Bazuar në trendet bashkëkohore të zhvillimeve dhe vlerësimin e përparësive dhe dobësive, ky skenar nuk është i favorshëm për t`u aplikuar.

4.4.2.1. SKENARI I ZHVILLIMIT LINEAR

Koncepti linear i zhvillimit në këtë rast përcjell kryesisht linjat ose korridoret rrugore, por edhe të disa rrugëve të rëndësishme lokale që lidhin vendbanimet mes veti.

Zhvillimet përgjatë rrugëve marrin karakter linear më të theksuar, por kanë edhe një lloj kombinimi linear – koncentrik, duke mos lënë anash edhe zhvillimet lineare përgjatë rrjetit brenda vendbanimeve. Kjo formë e zhvillimit linear ka të bëjë me shtrirjen gjatësore të vendbanimeve, aktiviteteve ekonomike-shërbyese, përqendrimit të popullsisë, etj.



PËRPARËSITË	DOBËSITË
Qasje e mirë në infrastrukturë rrugore; dhe Zhvillimi i zonave rurale përgjatë korridoreve.	Disa zona të komunës mbeten të pazhvilluara, jashtë shtrirjes lineare; Zhvillimi i dobët i qendrës urbane; Zhvillimi i vendbanimeve përgjatë rrugës; Zënia e tokës bujqësore; Shpenzime të larta për kyçje në infrastrukturë; Rritje e distancave ndaj shërbimeve; dhe Rrezikim i banorëve nga zhvillimi i komunikacionit.

Konkluzion: Ky skenar nuk është i favorshëm për t`u aplikuar dhe nuk është i përshtatshëm sepse krijon shumë probleme, duke rritur shkallën e investimeve, rrezikon sigurinë e banorëve, ndikon drejtpërdrejtë në keqësimin e mjedisit jetësor të banorëve, rritë koston e transportit, etj.

4.4.2.2. SKENARI POLICENTRIK

Skenari i tretë, ai policentrik, ofron mundësi më të mira dhe më bashkëkohore për zhvillim të mëtejmë të komunës. Koncepti i zhvillimit të ardhshëm i komunës është koncepti i qëndrueshëm. Ky koncept për qëllim kryesor ka zhvillimin e tërë hapësirës komunale, bazuar në shfrytëzimin racional të të gjitha mundësive dhe resurseve lokale, si dhe në ruajtjen e vlerave mjedisore për gjeneratat e ardhshme.

Zhvillimi policentrik ka për qëllim shpërndarjen e aktiviteteve brenda vendbanimit ose disa vendbanimeve, ndërtimin, rehabilitimin dhe pajisjen me infrastrukturë të nevojshme, qasje në transport, qasje të mirë në shërbime sociale dhe krijimin e kushteve të favorshme për punë dhe rekreacion në të gjitha vendbanimet.

Gjithashtu ka për qëllim që stagnimi i zhvillimeve në vendbanimet malore të ndërpritet përmes ofrimit të infrastrukturës elementare dhe shfrytëzimit të resurseve lokale për zhvillim të mëtutjeshëm.


Zhvillimi i qëndrueshëm është model i shfrytëzimit të resurseve që ka të bëjë, jo vetëm me plotësimin e nevojave të tanishme, por edhe për gjeneratat e ardhshme. Me fjalë të tjera, zhvillimi i qëndrueshëm tenton t`i kënaq nevojat apo kërkesat e tanishme, duke mos rrezikuar mundësitë dhe perspektivën e gjeneratave që vijnë.

Përmes këtij koncepti do të realizohen zhvillime të dëshiruara në fushat, si:

- Administratë efikase dhe të decentralizuar;
- Infrastrukturë adekuate me qasje të mirë;
- Ekonomi të zhvilluar dhe të balancuar;
- Mbrojtje efikase e tokës bujqësore dhe zhvillim i bujqësisë në zonat malore;
- Vendbanime kompakte dhe funksionale; dhe
- Mjedis të pastër dhe atraktiv.

Efektet konkrete të këtij skenari janë:

- Zhvillim i balancuar në mes qytetit dhe zonave rurale të komunës;
- Qendrat sekondare; Opterush, Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc, Drenoc dhe Çifllak zhvillohen vazhdimisht;
- Ato duhet të sigurojnë tokë të mjaftueshme për banim, industri të lehtë dhe tregti;
- Në vendbanimet me funksione qendrore duhet të vendosen shërbimet kryesore publike: administrata publike, shkollat dhe qendrat shëndetësore;
- Qendrat duhet të ofrojnë shërbime dhe produkte të nevojshme për përdorim afatshkurtër dhe afatmesëm;
- Qendrat sekondare do të jenë nyje të rrjetit të infrastrukturës rrugore lokale;
- Qendrat sekondare dhe lokale u ofrojnë të gjitha vendbanimeve tjera shërbime institucionale, infrastrukturë teknike dhe sociale;
- Zonat rurale fitojnë perspektiva zhvillimore në bazë të qendrave sekondare dhe resurseve natyrore që disponojnë;
- Fluksi i largimit të banorëve nga fshatrat do të zvogëlohet; dhe
- Zonat e rrafshëta zhvillojnë bujqësinë moderne, ndërsa në viset kodrinore – malore zhvillohet blegtoria dhe turizmi.



PËRPARËSITË	DOBËSITË
Avancim dhe zhvillim i qendrave sekondare; **Zhvillim ekonomik i zonave rurale;** **Zvogëlim i distancave brenda vendbanimeve;** **Lidhje e mirë e vendbanimeve me qendrën urbane;** **Shpërndarje e volitshme e institucioneve dhe e infrastrukturës teknike dhe sociale;** **Koncentrim i burimeve përmes qendrave sekondare;** **Zhvillim kompakt dhe dendësim i ndërtimeve; dhe** **Ruajtja e tokës bujqësore.**	Zonat urbane dhe qendrat sekondare ndiejnë nevojë për plane rregulluese; dhe Ngadalësim i zhvillimit të qytetit nga se vjen në shprehje ndarja e mjeteve në mënyrë të barabartë.

Konkluzion: Në bazë të vlerësimeve dhe nevojave për zhvillim të komunës, rezulton se ky skenar konsiderohet i favorshëm për zhvillim të mëtejmë.

4.4.3. SKENARI I PËRCAKTUAR PËR ZHVILLIM HAPËSINOR

Skenari i Zhvillimit Hapësinor për Komunën e Rahovecit, i bazuar në Planin Hapësinor të Kosovës, (Korniza e Zhvillimit Hapësinor), vizionin për të ardhmen e Rahovecit, parasheh si zonë të zhvilluar bujqësore, me theks të veçantë në Vreshtari dhe Perimtari, që merr rolin udhëheqës në industrinë

përpunuese të verërave dhe perimeve duke respektuar standardet për mjedis, zhvillim të agrobiznesit, tregtisë e industrisë shërbyese, rritjen e cilësisë së jetës, punësimit dhe barazisë sociale, përmes qeverive lokale aktive, transparente dhe efikase.

Me qëllim të arritjes së një zhvillimi gjithëpërfshirës të Rahovecit si dhe zhvillimit të koncepteve të mundshme - zhvillimi monocentrik, zhvillimin linear si dhe zhvillimi policentrik, gjatë shqyrtimit dhe krahasimit të këtyre opsioneve është bërë edhe shkrirja e elementeve pozitive të secilës në një koncept të vetëm që parasheh një zhvillim të qëndrueshëm të Rahovecit, i cili i përfshin dimensionet ekonomike, sociale dhe hapësinore.

Rrjeti i vendbanimeve dhe hierarkia brenda tij në Qendër Urbane si dhe në 6 Nën qendra, që do të jenë bartës të zhvillimit, në varësi të potencialeve dhe rolit që e merr secili vendbanim në zhvillim ekonomik, social dhe ofrim të shërbimeve.

Ndërlidhja e Qendrës Urbane me Nen qendrat, krijon korridore potenciale të zhvillimit të bizneseve përgjatë akseve të rrugëve regjionale si: Rahovec – Xërxë – Gjakovë (R 110); Rahovec – Krushë e Madhe (R 204), si dhe lidhja rrugore e Nen qendrave: Krushë e Madhe – Xërxë – Ratkoc – Çifllak (R 111).


Rahoveci si qendër komunale, si zonë urbane bashkë me vendbanimin e afërt Bërnjakë, do të ofrojnë shërbime sociale dhe publike të nivelit komunal, ndërsa do të mbështes edhe zhvillimin ekonomik komunal.

Duke e pasur parasysh dendësinë e ulët të banimit në zonën Qendër, zhvillimin hapësinor të saj, do të jetë e nevojshme që të bëhet konsolidimi i pjesëve periferike dhe kompaktësimi i pjesëve qendrore, drejt zhvillimit të mëtejmë të karakterit urban.


Ndërkaq, nën qendrat së bashku me fshatrat në mënyrën e planifikuar të organizimit, përbëjnë rrjetin bartës të zhvillimit rural. Me qëllim të ofrimit të zhvillimit të qëndrueshëm, fshatrat do të jenë të mbështetura me shërbime të kompletuara publike e sociale, si dhe infrastrukturë adekuate të forcimit dhe zhvillimit të mëtejmë në sektorin e bujqësisë, e në veçanti në Vreshtari, Perimtari e Pemëtari.

Në aspekt të zhvillimit hapësinor parashihet konsolidimi i strukturave të ndërtuara, deri në pikën ku karakteri i fshatit nuk ndryshohet dukshëm. Zgjerimet e mëtejme në toka bujqësore do të kontrollohen deri në atë masë që lejojnë kushtet dhe trendet zhvillimore, apo edhe riorientimi në kahe të kundërt të kufirit ndërtimor me sipërfaqet bujqësore.

Ky skenar i zhvillimit hapësinor të komunës së Rahovecit, është përzgjedhur pas diskutimit publik me qytetarë në zonë urbane dhe zonën rurale të Rahovecit.



Harta 36 Skenari III - I përzgjedhur për zhvillimin hapësinor



4.5. Zhvillimi sipas sektorëve

4.5.1. Zhvillimi ekonomik

Aktivitetet kryesore ekonomike të cilat e shquajnë komunën e Rahovecit janë: Aktivitetet Bujqësore si: Vreshtaria, Industria e përpunimit të rrushit; Perimtaria; Industria përpunuese ushqimore; Tregtia; Industria e turizmit rekreativ dhe turistik; veprimtaritë industriale dhe bizneset NVM.

Komuna e Rahovecit njihet edhe si komunë Vreshtare dhe Perimtare. Dhe si e tillë, ka si potenciale kryesore mbi të cilat mbështetet zhvillimi ekonomik dhe gjenerimi i punësimit.

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, Rahoveci bën pjesë në zonën e Verdhë të Kosovës. Kjo zonë shtrihet në pjesën e mesme të rrafshit të Dukagjinit të rrethuar me male, lartësi mbidetare prej 365m – 2656m, klimë të mesme kontinentale me ndikim të dobësuar të klimës mesdhetare, kohëzgjatje të vegjetacionit 200-250 ditë, rrjetë të pasur hidrografik, trashëgimi natyrore dhe kulturore, tokë bujqësore të kualitetit të lartë, kullosa, livadhe, traditë në kultivim të pemëve e vreshtave, bletarisë e shpezëtarisë, e dalluar për kultivimin e zejeve tradicionale.

4.5.1.1. Agrikultura

Për zhvillimin dhe përforcimin e agrikulturës nevojitet ri-organizimi dhe ri-strukturimi i strukturave dhe njësive të kësaj veprimtarie në komunën e Rahovecit. Ka nevojë për trajnim dhe informim të bujqve aktual dhe atyre të rinj me risitë në prodhim dhe marketing në fushën e agrikulturës dhe zhvillimin e agrobiznesit në përgjithësi.

Aplikimi i risive si dhe përpunimi i mëtejmë i produkteve agrare është me rëndësi për zhvillim të komunës. Kushtet klimatike dhe toka mundësojnë kultivimin e bimëve të ndryshme mjekësore, të rëndësishme për industrinë farmaceutike.

Rritja e bimëve mjekësore dhe luleve është e rëndësishme edhe për bletarinë, prodhimin e mjaltit dhe produkteve tjera bletare. Livadhet dhe kullosat si burim dhe potencial për blegtori, janë të pranishme në këtë zonë. Kualiteti i tokës nuk favorizon zhvillimin e agrikulturës në shkallë të lartë, megjithatë toka bujqësore duhet të konsiderohet një resurs për zhvillimin e perimtarisë në shkallë më të ulët dhe mund të paraqesë një veprimtari komplementare për turizmin duke krijuar pamje të peizazheve skenike për vizitorët.

4.5.1.2. Apikultura (bletaria)

Zhvillimi i apikulturës (bletarisë) është ngushtë i lidhur me prodhimtarinë bujqësore dhe pemëtarinë. Pasi që në territorin e komunës shtrihet një sipërfaqe e mjaftueshme e livadheve dhe kullosave, që janë potencial për zhvillimin e blegtorisë si njëra nga veprimtaritë kryesore ekonomike të kësaj zone. Shumëllojshmëria e prodhimeve bujqësore, veçanërisht e pemëve, siguron kushte të mira për zhvillimin e bletarisë. Krijimi i një emri, brendi – etikete të mbrojtur të përbashkët të prodhimeve të mjaltit të Rahovecit, do të përmirësonte pozitën në treg të prodhuesve të mjaltit në komunë.

4.5.1.3. Bujqësia

Bujqësia ka qenë dhe është një nga aktivitetet të rëndësishme të Rahovecit. Një fakt tjetër që tregon për kërcënimet në fushën e bujqësisë është humbja e tokës bujqësore e cila shkaktohet nga ndërtimet e pakontrolluara si rezultat i mungesës së planeve dhe nevojës së madhe për ndërtime të reja. Si masë preventive për ndërtimet e pakontrolluara në fushat bujqësore, komuna e Rahovecit në Planin e saj të zhvillimit urban parasheh masa mbrojtëse për rivitalizimin e sektorit të bujqësisë.

Zhvillimi i sektorit të Bujqësisë në komunë kishte një kalim të popullsisë bujqësore në veprimtari jo-bujqësore ku kjo vazhdimisht rritej. Transferimi i popullsisë nga bujqësia dhe të shumtën edhe nga fshati

në veprimtari jo-bujqësore dhe në qytet zhvillohej në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa përgatitje profesionale dhe arsimore, në një anë dhe në mënyrë indirekte, përmes shkollimit të gjeneratës së re dhe të ndryshimit të pozitës socio-ekonomike të popullsisë, në anën tjetër.

Është karakteristikë e përgjithshme se bujqësinë e braktis popullsia e re, vitale dhe e arsimuar. Por është e vështirë të konstatohet numri i saktë i kalimit të popullsisë agrare në veprimtari joagrare.

Ndryshimet në strukturën profesionale dhe në atë të moshave të popullsisë ndikojnë në rritjen e pjesëmarrjes së popullsisë së aftë për punë, që paraqet ofertën disponuese të fuqisë punëtore.

4.5.1.4. Industria dhe ekonomia

Plani Hapësinor i Kosovës - Strategjia e Zhvillimit Hapësinor 2010-2020+ përkatësisht Dispozitat për zbatim pika 5.3, Kushtet e vendosjes së veprimtarive ekonomike në hapësirë. Hapësira për veprimtari ekonomike duhet të plotësojnë të gjitha standardet e mbrojtjes së mjedisit, të ketë infrastrukturë teknike si qasja e lehtë përmes rrugës, energjia elektrike, telekomunikacioni, ujësjellësi dhe kanalizimi.

Zona ekonomike do të duhej të funksionojë nga prodhimi vetanak i energjisë që për këtë zonë do të sjell avantazh të madh në krahasim me zonat tjera. Pozita e zonave ekonomike është planifikuar të jetë në pjesën Veri-lindore të Qytetit të Rahovecit duke vazhduar në pjesën Veriore dhe Veri-lindore të fshatit Hoçë e Madhe, vazhdon në pjesën Veriore të fshatit Zaqishtë dhe përfundon deri në fshatin Opterush. E gjithë kjo zonë është e shtrirë përgjatë rrugës Rahovec - Suharekë dhe ka një sipërfaqe prej 196.54Ha.

Zonë tjetër Ekonomike planifikohet të ketë edhe në lokalitete tjera. Është në procedurë themelimi i Zonës Ekonomike në fshatin Krushë e Madhe në një sipërfaqe prej 100 Ha. Njëkohësisht është duke u analizuar edhe hapësira prej 70 ha në fshatin Xërxë, që është e shtrirë përgjatë rrugës Xërxë – Gexhe, afër Kanionit të Drinit të Bardhë, po ashtu varësisht prej llojit të pronësisë së tokës do të trajtohet në mënyrë specifike secili vendbanim i komunës së Rahovecit.

4.5.1.5. Ndërmarrjet dhe biznesi

Pozita e Komunës së Rahovecit është e volitshme për ndërmarrësi NVM, si dhe biznes.

Veprimtaritë e përshtatshme për zhvillimin e ekonomisë regjionale mund të jenë:

- Industria dhe bizneset me ndotje të vogël;
- Industritë/bizneset të cilat prodhimin e bazojnë në lëndën e parë nga resurset vendore si industria e Verarisë; dhe
- Prodhimtaria dhe bizneset e përqendruara në produktet bujqësore.

Më poshtë janë listuar disa koncepte themelore të cilat duhet të zhvillohen nga komuna për ta përkrahur zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme:

- Ndërmarrësit e rinj - kapaciteti i njohurive në teknologjinë informative ka hapur dyert për shumë njerëz të rinj të jenë të suksesshëm në nismën e bizneseve të reja;
- Diaspora - një numër i madh i banorëve të Rahovecit punon në vendet e BE-së, në SHBA, etj. Komuna duhet ta ketë në konsideratë këtë si një potencial për zhvillimin e NVM-ve, përmes lidhjeve të bizneseve vendore dhe ndërkombëtare.
- Investimet e huaja, nevoja për ekonominë shërbyese dhe të bazuar në dije, zhvillimi i turizmit mund të kontribuojnë në shtimin e bizneseve. - Të mbrohen interesat e NVM-ve.
- Roli i femrës - NVM-të janë mundësi e mirë për ato femra të cilat kanë kualifikime superiore dhe iniciativë.

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme do të kenë shtrirje përgjatë akseve kryesore, si dhe potencial për zhvillimin përgjatë rrugëve regjionale Rahovec – Gjakovë, Rahovec- Suharekë, pastaj përgjatë rrugës Krushë e Madhe - Brestoc, si dhe rruga regjionale Prizren – Klinë, që kalon përgjatë Nën qendrave: Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc dhe Çifllak.

4.5.1.6. POTENCIALET TURISTIKE

Territori komunal i Rahovecit ka potencial të mjaftueshëm për tërheqjen e vizitorëve me pasurinë e saj natyrore, kulturore, historike dhe në të ardhmen – sipas planit zhvillimor.

Zhvillimi i veprimtarive turistike duhet të organizohet në nivel komunal e po ashtu duhet të sigurojë mbështetjen edhe të nivelit qendror. Duhet të sigurohet infrastruktura rrugore e teknike për zhvillimin e këtyre formave të turizmit. Turizmi duhet të orientohet në shfrytëzim të qëndrueshëm të potencialeve turistike dhe programet turistike duhet të përshtaten me kërkesat e grupeve të interesit – vizitorëve të ndryshëm. Për këtë sugjerohet të themelohet bordi komunal për menaxhimin e turizmit. Aktorët kryesor të cilët duhet ta zhvillojnë turizmin duhet të jenë agjencionet publike, ndërmarrjet komerciale dhe individët e aftë në këtë veprimtari.

Komuna e Rahovecit dhe një Bord Menaxhues i Turizmit duhet të zhvillojnë fushatë të gjerë dhe të studiuar mirë mbi potencialet turistike dhe pikat atraktive në komunë, duke shfrytëzuar të gjitha mediumet për këtë qëllim. Përveç kësaj, duhet të sigurohet edhe mundësia e qasjes në këto pika turistike me mjete të ndryshme transporti, si mjete motorike, biçikleta, etj., të cilat duhet të jenë konform me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe me mbrojtjen e ambientit. Kjo formë e transportit do duhej të stimulonte edhe shfrytëzimin e të njëjtave në jetën e përditshme të banorëve të kësaj komune.

Turizmi rural bujqësor - Komuna e Rahovecit ka analizuar potencialet e mundshme të zhvillimit të agro-turizmit, këto potenciale janë akomoduar në skenarët zhvillimor të komunës për vitet në vazhdimësi duke e mbështetur me objektiva dhe veprime konkret në arritjen e zhvillimit të këtij turizmi mjaft aktual në vend dhe me gjerë. Se si do të arrihet fuqizimi dhe zhvillimi i turizmit rural komuna ka paraqitur disa objektiva kryesore:

- Promovimi i politikave dhe sistemeve të qëndrueshme dhe të përqendruara në ushqim cilësor;
- Të promovohen dhe të zgjerohen mundësitë që konsumatorët dhe turistët të blejnë ushqim vendor, përfshirë tregjet lokale;
- Ruajtja dhe promovimi i traditave të veçanta lokale të ushqimit dhe pijeve në këtë rast Vera e Rahovecit si traditë e vjetër.
- Ritmi i diversifikimit ekonomik bujqësor është dhe do të jetë e nevojshme në komunitetin bujqësor;
- Ndërlidhja e bujqësisë prodhuese me turizëm rural.

Për ta përmbledhur gjithë këtë, mund të thuhet që rritja e prodhimeve agro-kulturore dhe rritja e agroturizmit mund të bëhet përmes ndihmës së ndërtimit të një kulture ushqimore vendore, përmes sigurimit të një përfshirjeje më të madhe lokale në prodhimin dhe përpunimin vendore dhe krijimin e tregjeve për fermerë.

4.5.1.7. Peizazhi

Peizazhi është informatë e parë dhe plotësuese për vizitorët që nisen drejt vizitimit të pikave turistike. Peizazhi duhet t'i forcojë cilësitë e vizitës turistike në komunën e Rahovecit. Zonat e kategorizuara në këtë plan duhet të theksojnë atraktivitetin e tyre peizazhor duke forcuar kualitetet e tyre malore - natyra, fushore - agrikultura dhe kodrinore - rurale respektivisht.

Format e identifikuara të turizmit në komunën e Rahovecit janë:

Turizmi natyror - Zona malore e komunës shquhet me potencial të madh të zhvillimit të turizmit të bazuar në natyrë. Zonat duhet të pajisen me përmbajtje për sporte malore si shtigje të ecjes dhe shëtitje, vrapime dhe çiklizmi malor, kalërim. Këto aktivitete të rekreacionit mundësojnë zhvillimin e shërbimeve të akomodimit privat nëpër fshatra duke dhënë me qira shtëpitë në fermat të cilat mund të sjellin të ardhura shtesë për fermerët.

Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore paraqesin pikat e atraksioneve turistike të cilat e zgjerojnë ofertën turistike. Prandaj gjatë procesit të planifikimit të shtigjeve, ato duhet të merren në konsideratë për të ndërtuar një rrjet të pikave atraktive turistike të lidhura mirë në mes veti.

Turizmi historik/kulturor

Komuna e Rahovecit ka vlera të trashëgimisë natyrore dhe kulturore ku në bashkëpunim me institucionet vendimmarrëse të Republikës së Kosovës t`i vë nën mbrojtje dhe të njëjtat të shfrytëzohen për zhvillimin e turizmit.

Turizmi historik/kulturor mund të funksionojë ndaras ose në kombinim me turizmin natyror.

Turizmi shëndetësor - Ajri i pastër, mjedisi i qetë dhe peizazhet e bukura në zonën malore veriore të komunës, janë të përshtatshme për zhvillimin e turizmit shëndetësor.

Lokacionet me lartësi mbidetare të larta, me peizazhe të bukura mund të shfrytëzohen për rehabilitimin e personave që vuajnë nga problemet kardiovaskulare, të frymëmarrjes, diabeti, sëmundjet e gjakut, depresioni dhe problemet tjera shëndetësore.

Zona e mbrojtur turistike “Kanioni i Drinit të Bardhë”

Është e zhvilluar në kuadër të këtij tipi të turizmit. Ky kompleks vizitohet pandërprerë nga të interesuarit për historinë e vendit por edhe te vetë objekti siç është Ura e Fshejtë dhe me aktivitetet tashmë të rregullta që zhvillohen, siç janë kërcimet nga Ura e Fshejtë.

Zona e mbrojtur “Hoça e Madhe”

Në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve do të hartohet plani rregullues për trashëgiminë historike të Hoçës, me qëllim të ruajtjes së vlerave të trashëgimisë historike-kulturore.

Sipas UA MMPHI 08/2015, kapitulli II, në zonat natyrore me vlera të mbrojtura të natyrës ndalohen apo kufizohen aktivitetet në vijim:

1. ndërtimi i ndërtesave të infrastrukturës;
2. ndërtimi i ndërtesave të reja transite, komunale, energjetike, të telekomunikacionit dhe rrugëve;
3. mihja ose mbulimi i terrenit, mihja dhe nxjerrja e gurëve, mineraleve, shtresimeve ose fosileve;
4. deponimi i mbeturinave dhe lëshimi i ujërave të ndotura;
5. ndryshimi i regjimit të ujërave;
6. përdorimi i të mirave të natyrës për qëllime ekonomike;
7. kryerja e veprimtarive përmirësuese, mënjanimi i mureve të gjalla dhe përbërësve tjerë të natyrës;
8. mbjellja e monokulturave;
9. grumbullimi i kërpudhave, bimëve dhe pjesëve të tyre;
10. shqetësimi, vrasja ose kapja e shtazëve, gjuetia, peshkimi;
11. veprimtaritë rekreative- sportive;
12. vendosja e reklamave dhe shenjave të tjera; dhe
13. aktivitete të tjera të cilat mund të rrezikojnë vlerën e mbrojtur të natyrës.

Kushtet dhe masat për mbrojtje të natyrës do të përcaktohen në dokumentet e planifikimit hapësinor si dhe në planet për menaxhimin dhe shfrytëzimin e të mirave të natyrës.

Sipas këtij udhëzimi administrativ që përcakton Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, në sipërfaqet e zonave dhe sipërfaqeve të mbrojtura të trashëgimisë kulturore ndalohen aktivitetet në vijim:

1. ndërtimi i ndërtesave më të larta dhe atyre që nuk janë në harmoni me ndërtesat

ekzistuese fqinje;

2. ndërtimi i auto-udhëve, rrugëve nacionale dhe rajonale;

3. zhvillimi i veprimtarisë së industrisë së rëndë; dhe

4. instalimi mbitokësor i furnizimit të rrymës elektrike, telekomunikacionit, përçuesve digjital.

Ndërsa, po sipas kësaj baze ligjore, në zonat e veçanta të mbrojtura ndalohen apo kufizohen aktivitetet në vijim:

1. Aktivitetet e ndaluara janë si në vijim:

1.1. ndërtimet apo zhvillimet industriale, si gërmimi dhe shfrytëzimi i burimeve minerale, ndërtimi i pendëve, centraleve elektrike apo linjave të tensionit, furrave, fabrikave dhe rrugëve transite; dhe

1.2. ndërtimet apo zhvillimet që çojnë në shpyllëzimin apo ndotjen e mjedisit.

2. Aktivitetet e kufizuara janë si në vijim:

2.1. strukturat ose godinat më të larta se monumenti kulturor që duhet të mbrohet;

2.2. ndërtimi i rrugëve, magazinave, punëtorive, shitoreve, restoranteve, bareve, kafeneve, hoteleve/moteleve, tezgave dhe kioskave ushqimore, stacioneve të karburanteve dhe riparimit të automjeteve, 'supermarket'-eve, klubeve të natës, apo ndonjë ndërtimi tjetër;

2.3. tubimet, argëtimi dhe zbavitja publike; dhe

2.4. transformimi i tokës bujqësore.

Në sipërfaqet apo hapësirat në të cilën ekzistojnë vlera arkeologjike, historike dhe zona tjera të mbrojtura ndalohet ndërtimi i deponisë për mbeturina. Në lokacionin ku ndërtohet apo planifikohet deponia e mbeturinave, paraqitet zona neutrale (së paku 50 m) përreth deponisë e cila duhet të jetë 600 m në distancë nga zonat e veçanta të mbrojtura.

VSM - Sugjeron disa veprime operacionale konkrete si dhe përfshirja e tyre në planifikim:

- Pyllëzimi dhe ripyllëzimi i zonave të reja së paku për aq sa dëmtohet zona e pyllit;
- Vendosja e korridoreve të reja ekologjike sipas planit të ri dhe zonave të Rahovecit; dhe
- Kthimi i zonave të ndotura industriale në sipërfaqe të gjelbëruara.

4.5.2. INFRASTRUKTURA PUBLIKE DHE SOCIALE

Zhvillimi social i Rahovecit, për vazhdimin e mëtejmë përmes ofrimit të shërbimeve përkatëse, është parakusht për ngritjen e mëtejme të potencialit njerëzor dhe mundësimit të një jetë cilësore. Si pjesë e këtij zhvillimi parashihen masa brenda sektorëve të arsimit, shëndetësisë, kulturës, sportit dhe shërbimeve tjera publike, që ofrohen në kuadër të rrjetit të vendbanimeve.

4.5.2.1. ARSIMI

Në përgjithësi, shtrirja e rrjetit të ndërtesave shkollore të nivelit në të dy nivelet (në atë fillor dhe të mesëm) në Rahovec, konsiderohet e kënaqshme. Hierarkia e institucioneve shkollore përputhet edhe me hierarkinë dhe rolin e vendbanimeve.

Tre institucione të shkollimit të mesëm parashihen të mbesin në Rahovec. Numri i institucioneve të shkollimit fillor mbetet i njëjtë. Në aspekt të infrastrukturës shkollore parashihen përmirësime në kapacitete dhe cilësi.

Duke e pasur parasysh rolin institucional, zhvillimi i mëtejmë i rrjetit të institucioneve parashkollore në qytet dhe në vendbanimet tjera, do të bëhet sipas nevojave të identifikuara.

Në nivel të shkollimit fillor parashihet renovimi i objekteve shkollore. Me qëllim të kompletimit të infrastrukturës shkollore, parashihet që terrenet sportive të kompletohen në të gjitha shkollat, duke përfshirë edhe shkolla që aktualisht nuk i kanë. Sa i përket laboratorëve shkollore dhe hapësirave për punë praktike, ato do të bëhen kryesisht në shkollat ku ka gravitim më të madh të nxënësve.

Përveç zhvillimit të kapaciteteve hapësinore dhe përmbajtjesore të infrastrukturës shkollore, arsimi do të avancohet më tej si platformë e zhvillimit social dhe rrjedhimisht edhe atij ekonomik. Në këtë mes rol të veçantë do të kenë kurrikulat e shkollimit të mesëm.

4.5.2.2. SHËNDETËSIA

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), e vendosur në zonën urbane të Rahovecit mbulon me shërbime gjithë territorin e saj. Gjendja momentale e saj është e kënaqshme dhe aktiviteti i saj vazhdon të jetë edhe më tutje.

Ndërsa Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) - 7 Qendrat e Mjekësisë Familjare në: Ratkoc, Bellacërkë (Fortesë), Çifllak, Drenoc, Krushë e Madhe, lagja e Arave dhe Opterush, kanë kapacitet zhvillimi dhe mbulimi të këtyre nën qendrave.

AMF - 7 Ambulanca të Mjekësisë Familjare në: Lagja e Epërme, Hoçë e Madhe, Zaqishtë, Brestoc, Radostë, Polluzhë dhe Xërxë. Ambulancat gjithashtu mund të vendosen në të gjitha fshatrat me popullatë mbi 2,000 banorë dhe përkohësisht në fshatrat me më pak banorë, deri sa të përmirësohet rruga për qendrën e bashkësisë lokale ose fshatin më të afërt me ambulancë.

4.5.2.3. KULTURA

Zhvillimi i kulturës në Rahovec bëhet përmes rrjetit ekzistues të ndërtesave të kulturës, si dhe ndërtesave shkollore.

Në qendrën komunale do të bëhet përmirësimi i kushteve në ndërtesën e kulturës - në Shtëpinë e Kulturës. Sa i përket shtëpive të kulturës në vendbanimet tjera do të rinovohen dhe funksionalizohen për të ju shërbyer vendbanimeve ku ato gjenden.

Në vendbanimet tjera, zhvillimi i aktiviteteve kulturore do të bëhet në kuadër të rrjetit të shkollave. Duke qenë se ky rrjet është mirë i përhapur nëpër vendbanimet e Rahovecit, roli i objekteve shkollore do të zgjerohet edhe në shërbim të komunitetit, në periudhat kohore kur nuk pengohet procesi mësimor. Komuna, në radhë të parë drejtoritë përgjegjëse për kulturë dhe arsim, me përfshirjen e shoqërisë civile dhe komunitetit, do të vazhdojnë dhe zgjerojnë më tej mbështetjen për zhvillimin e aktiviteteve dhe ngjarjeve kulturore.

Përveç rolit të këtyre aktiviteteve në zhvillim të shëndoshë social, ato kanë rol edhe në njohjen dhe avancimin e identitetit lokal, si dhe promovimin e vlerave kulturore.

4.5.2.4. INSTITUCIONET FETARE

Për sa i përket vlerave fetare, Rahoveci është i pasur me ato vlera. Në nivel të trendit dhe kërkesave të banorëve për nevoja të objekteve fetare, ku vetëm në zonën urbane të Rahovecit janë të ndërtuara 5 Xhami ku mbulojnë shërbimet në gjithë qytetin. Pastaj, Rahoveci njihet edhe për Objektet e Teqeve si ato të ndërtuara mbi 400 vite: Teqja e Madhe –Helvetive, Teqja Rufai; Teqja Melami.

4.5.2.5. SPORTI

Ndërtesat e sportit në qendrën komunale, së fundmi edhe kompletimi dhe përurimi i Palestrës së Sporteve "Mizahir Isma"si dhe rrjeti i përhapur i institucioneve shkollore, ofrojnë një strukturë të mirë për zgjerimin e mëtejmë të rrjetit të hapësirave të sportit në komunë.

Me qëllim të përmirësimit të kushteve për shfrytëzimin e këtyre ndërtesave, është e nevojshme të rregullohet qasja dhe hapësirat përreth tyre.

Ndërkaq stadiumi ka nevojë për përmirësim të kushteve edhe brenda tij. Sa i përket rrjetit të hapësirave sportive në zonat rurale, do të shfrytëzohen kapacitetet ekzistuese dhe ato të planifikuara në kuadër të shkollave. Rrjedhimisht, këto hapësira do të ju shërbejnë komunitetit. Natyrisht, ky shfrytëzim i zgjeruar duhet të menaxhohet ashtu që të mos cenohet procesi i rregullt mësimor. Në këtë mënyrë do të mundësohet një shtrirje e gjerë e hapësirave sportive për të gjithë banorët, duke mbetur brenda kufijve të arsyeshëm të investimeve financiare.

Përveç zgjerimit dhe përmirësimit të kapaciteteve hapësinore për sport, ky sektor duhet të zhvillohet edhe përmes vetëdijesimit për jetë të shëndetshme dhe mbështetjes së aktiviteteve sportive. Këto aktivitete do të përkrahen në radhë të parë nga drejtoritë komunale përgjegjëse për sport dhe arsim, me pjesëmarrjen e klubeve sportive dhe grupeve të komunitetit.

Komuna e Rahovecit ka mbulueshmëri me infrastrukturë publike dhe sociale. Duke pasur parasysh faktin se sipas parashikimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës si dhe parashikimeve të dala nga ky dokument i planifikimit hapësinor, komuna e Rahovecit do të ketë ulje të numrit të popullsisë për periudhën deri në vitin 2029, kjo infrastrukturë publike është e mjaftueshme për komunën e Rahovecit. Në të ardhmen, nëse paraqiten nevoja të reja për infrastrukturë publike shtesë, komuna mund ta adresojë këtë tematikë përmes dokumenteve tjera të planifikimit hapësinor.

VSM - Sugjeron disa veprime operacionale konkrete si dhe përfshirja e tyre në planifikim:

- Veprime operacionale për shtimin e hapësirave të gjelbëruara në Rahovec duke përfshirë edhe projektin për dislokimin e stadiumit dhe këtë hapësirë të dedikuar për Park të Qytetit, të vazhdohet edhe më tej për gjetjen e lokacioneve të tilla duke e përmbushur së paku minimumet e hapësirave të gjelbërta për kokë Banori në 9 m²; dhe
- Krijimi i parqeve në zonat e reja të banimit në distanca të arritshme për banorë 500-1,000m distancë.

4.5.3. INFRASTRUKTURA TEKNIKE

Infrastruktura teknike përfshin sistemet përkatëse të menaxhimit me ujëra, menaxhimit me mbeturina dhe furnizimit me energji.

Kapacitetet e këtyre sistemeve dhe cilësia e shërbimit do të përmbushin nevojat e banimit, si dhe do ta mbështesin zhvillimin ekonomik.

4.5.3.1. MENAXHIMI I UJËRAVE

Komuna e Rahovecit me gjithë fshatrat përreth është e njohur në nivel të Kosovës për kultivimin e kulturave bujqësore. Duke pasur parasysh që kultivimi i tyre është në sasi shumë të madhe, atëherë edhe niveli i sigurisë së bujqve duhet të jetë në nivel kundrejt fatkeqësive të ndryshme natyrore.

<u>Vërshimet dhe Erozioni</u>

Rreziku më i madh i tokave bujqësore janë vërshimet dhe erozionet. Për këtë arsye komuna do të krijojë bazën e të dhënave për rrjedhat lumore dhe erozionet dhe t'i vendosë ato në GIS Harta, për të treguar zonat ku vërshimet mund të ndodhin. Këto të dhëna do të shërbejnë për mbikëqyrje të vazhdueshme të lumenjve si dhe për analiza hapësinore për nivelin e ndikimeve nga vërshimet.

- Komuna, në bashkëpunim me institucionet përkatëse të nivelit qendror – MMPHI, MBPZHR, SHPK, FSK dhe KFOR duhet të krijojë sistem të paralajmërimit për vërshime. Duhet të hartohet plani i veprimeve emergjente dhe masave zbutëse për përgjigje të menjëhershme ndaj rreziqeve nga vërshimet. Ky plan duhet të përcaktojë veprimet dhe përgjegjësitë për menaxhimin e krizave në rast të fatkeqësive. Masat dhe veprimet e cekura më poshtë janë të nxjerra nga objektivat e cekura në Planin hapësinor të Kosovës. Çdo masë specifike, që mund të dalë si shkak i rreziqeve që mund të ndodhin, janë subjekt i konsultimeve dhe koordinimeve me institucionet përkatëse.

Vërshimet

Komuna, në kuadër të planifikimeve duhet të parasheh masa mbrojtëse të vërshimeve dhe përmbytjeve. Si zona që rrezikohen nga përmbytjet janë: Celina, Bellacërka (Fortesa), dhe Krusha e Madhe.

Në Celinë janë të ndërtuara disa kanale sipërfaqësore, të cilat bartin ujërat sipërfaqësor që vijnë nga rrjedhat e diktuara nga relievi.

Komuna, në kuadër të kapaciteteve të veta, duhet të ndërmarrë masat vijuese hidrologjike në mënyrë që të parandalojë apo të zvogëlojë ndikimet nga rreziku i vërshimeve:

- Largimi nga shtretërit e lumenjve barrierat natyrale apo të krijuara nga njeriu;
- Të bëhet meliorimi dhe pyllëzimi i brigjeve të lumenjve si masa parandaluese;
- Ndërtimi i kanaleve/ose mureve mbrojtëse;
- Komuna do të ndërmarrë masat e nevojshme për kontrollimin e zhvillimit në tokat bujqësore përgjatë lumit, sidomos për ndërtimet dhe veprimet tjera që mund ta rrisin rrezikun nga vërshimet; dhe
- Çdo ndryshim i rrjedhës së lumit do të ndalohet nga komuna dhe veprimet që mund të çojnë deri në rritjen e rreziqeve për vërshime do të kontrollohen në mënyrë strikte po ashtu.

Vlerësim: Parandalimi i vërshimeve do të duhej të jetë qëllim i komunës, institucioneve qendrore relevante dhe shfrytëzuesve (komunitetit) të tokës bujqësore. Parandalimi i vërshimeve është i nevojshëm me qëllim të mbrojtjes së tokës dhe prodhimtarisë bujqësore, peizazhin natyror, por po ashtu edhe asetet e krijuara nga njeriu, vendbanimet dhe infrastruktura rrugore.

Erozioni

Me qëllim të parandalimit të erozionit dhe zvogëlimit të ndikimeve, komuna duhet të ndërmarrë hapat e menjëhershëm vijues:

- Parandalimi i prerjes dhe degradimit të pyjeve;
- Parandalimi i kullosjes së tepërt; dhe
- Parandalimi i shfrytëzimit joracional të resurseve natyrore që mund të shkaktojnë erozion.

Duke i përcjellë objektivat nga Plani Hapësinor i Kosovës, komuna do të ndërmarrë masat vijuese mbrojtëse ndaj erozionit:

Masat hidraulike janë të njëjta sikurse për vërshime duke qenë se vërshimi është një nga shkaktarët kryesorë të erozionit.

Masat bujqësore janë:

- Mbrojtja dhe shfrytëzimi i tokës bujqësore;
- Përdorimi i përvojave të mira bujqësore; dhe
- Rritja e investimeve për mbrojtjen e tokave përgjatë brigjeve të lumenjve.

Masat biologjike janë:

- Mbrojtja e pyjeve ekzistuese nga prerjet e pakontrolluara dhe zjarret;

- Parandalimi i kullotjes në zonat me bimësi të varfër;
- Pyllëzimi i zonave të zhveshura apo të degraduara;
- Krijimi i brezave të gjelbër në zonat ku mundësia e erozionit është më e lartë; dhe
- Mbjellja përgjatë lumenjve, përrenjve dhe rrjedhave ku erozioni është aktiv.

Vlerësim: Parandalimi i erozionit duhet të jetë qëllim i institucioneve përkatëse, banorëve, shfrytëzuesve të tokës bujqësore, tokave malore, pyjeve, ujërave dhe aseteve tjera natyrore. Parandalimi i erozionit është i dobishëm për mbrojtjen e resurseve natyrore si toka bujqësore, rrjedhat e lumenjve, pyjeve, peizazhit natyror por po ashtu edhe për asetet e krijuara nga njeriu, vendbanimeve, infrastrukturës rrugore.

4.5.3.2. SISTEMI I KANALIZIMIT

Kanalizimi i ujërave të ndotura është i zhvilluar, përkatësisht ky sistem është i shtrirë në zonën urbane dhe në të gjitha vendbanimet. Duke u bazuar nga gjendja ekzistuese e rrjetit të kanalizimit, përqindje e fshatrave që kanë rrjet kanalizimi është mbi 95%, pra gjendja me rrjet kanalizimi është e mirë, me disa riparime në fshatra si dhe në vendbanimet ku janë bërë ndërtime të reja të mbulohen me rrjet kanalizimi. Shkarkimi i këtyre kanalizimeve është kryesisht pa trajtim adekuat, por janë të derdhura në lumenj ose përroska.

Pra mungesa e trajtimit të ujërave të ndotura në Komunë, çon në ndotje të lumenjve, tokës dhe sigurisht edhe ujit nëntokësor. Një ndotje e tillë paraqet kërcënim serioz për shëndetin e popullatës e po ashtu edhe për mjedisin në tërësi.

Të gjitha kanalizimet ekzistuese pikë shkarkimin e tyre e kanë në lumenjtë ose në përroska, pa asnjë trajtim paraprak.


Parashikimet e rrjetit të kanalizimit për qytetin e Rahovecit me fshatrat përreth janë në ndërtimin e kolektorëve rreth lumenjve dhe përroskave. Me ndërtimin e kolektorëve do të eliminohet ndotja e ambientit dhe të gjitha rreziqet që shkaktohen nga papastërtitë e kanalizimeve.

Për shkak të konfiguracionit të terrenit nuk mund të përfshihen të gjitha vendbanimet me një kolektor dhe të trajtohen në një impiant por duhet të parashihen dy kolektorë dhe dy impiante për trajtimin e ujërave fekale që shkarkohen në lumin Drini i Bardhë dhe një kolektor që përfshin Opterushën, Zaqishtën dhe Retijën, që shkarkohen në lumin Toplluha.

Kolektori i parë përfshin gjithsej 15 vendbanime me 35,496 banorë me pjesëmarrje 63.15% . Lokacioni ku do të ndërtohet impianti është në fshatin Krushë e Madhe.

Kolektori i dytë përfshin gjithsej 15 vendbanime me 12,856 banorë me pjesëmarrje 27.74%.

Ndërsa kolektori 3 përfshin gjithsej 4 vendbanime me 3,575 banorë me pjesëmarrje 6.36%.



Grafiku 11 Planifikimi i kolektorëve dhe kapaciteti i tyre në %

Kolektori 1	35,496
Kolektori 2	15,591
Kolektori 3	3,575
Mini impiante	1,546

Grafiku 12 Planifikimi i kolektorëve dhe përfshirja e numrit të popullatës

Strategjia 1: Përmirësimi i rrjetit ekzistues dhe ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimit

Përmirësimi i rrjetit ekzistues të kanalizimit dhe ndarja e tij nga ai atmosferik.

- Ndërtimi rrjetit të ri të kanalizimit në zonat ku ai mungon dhe në vendet ku bëhet zgjerimi i vendbanimeve.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja e vazhdueshme e rrjetit të kanalizimit.
- Ndërtimi i kolektorëve të kanalizimit fekal dhe ndërtimi i impianteve.

Vlerësim: Rrjetet ekzistuese të kanalizimit, në qytet dhe fshatra, janë zakonisht të përziera me ujëra atmosferike, andaj komuna duhet të ndërtojë rrjet të ri aty ku mungon dhe të bëjë ndarjen e kanalizimit në dy sisteme.

Strategjia 2: Ndërtimi i sistemit të ri të shkarkimit të ujërave atmosferike

- Sistemi i shkarkimit të ujërave atmosferike duhet të jetë i ndarë nga kanalizimi i ujërave të zeza.
- Rrjeti duhet të zgjerohet deri në fshatra.
- Çdo fshat duhet ta ketë sistemin e vetë të veçantë. Ujërat atmosferikë do të shkarkohen në lumin më të afërt.

Vlerësim: Vërshime nga ujërat atmosferike ndodhin edhe në qytetin e Rahovecit. Kjo ndodh si pasojë se qyteti është buzë kodrës, e cila ka një sipërfaqe të madhe ujëmbledhëse dhe duke pasur parasysh që kodra është kryesisht gurore pa vegjetacion edhe sasia e reshjeve që bie, mbi 90% rrjedh pa infiltrim, mundësia e vërshimeve në qytet është e madhe rrugëve të qytetit e sidomos rruga kryesore.

Strategjia 3: Ndërtimi i kanaleve të hapura dhe kolektor nga betoni në qytet

Propozohet ndërtimi i disa kanaleve të hapura rreth kodrës dhe shkarkimi i tij në lumë. Gjithashtu, si rezultat i reshjeve të shumta, propozohet ndërtimi i kolektorit nga betoni në rrugën kryesore dhe shkarkimi i tij në lumin Duhllo.

Vlerësim: Nëse ujërat atmosferike nuk shkarkohen si duhet, mund të shkaktojnë vërshime në qytet. Situata bëhet më rëndë kur ato shkarkohen në sistemin e ujërave të zeza. Ujërat atmosferike mund të

mblidhen në rezervuare nëntokësore dhe me mençuri të shfrytëzohen për ujitje apo të shkarkohen në lumenj. Andaj, komuna duhet të ndërtojë një rrjet të ri të ujërave atmosferikë në qytet si dhe në zona rurale.

Kanalizimi atmosferik

Për të përmirësuar mirëmbajtjen dhe funksionalizimin e rrjetit ekzistues të kanalizimit atmosferik në komunën e Rahovecit, duhet të investohet në rehabilitimin e kanaleve, pastrimin e kanaleve të mbyllura dhe funksionalizimin e tyre, identifikimin e kyçjeve ilegale të kanalizimit fekal në sistemin e kanalizimit atmosferik dhe mirëmbajtjen e vazhdueshme të tyre.

Si pikë shqetësuese në komunën e Rahovecit, por mund të themi edhe në tërë Kosovën, është mirëmbajtja jo e mirë, apo mund të themi gati që mungon e tëra.

Në çdo reshje shiu ujëmbledhësit e ujërave atmosferike mbushen me gjësende të ndryshme dhe mbi gjysma janë jo funksional si pasojë e mos mirëmbajtjes së duhur. Mbetet që komuna të ndërmarrë hapat e duhur, që sikurse mirëmbajtja të jetë e vazhdueshme për funksionim të duhur.

4.5.3.3. SISTEMI I UJËSJELLËSIT

Strategjia: Renovimi i sistemit ekzistues të ujit dhe krijimi i sistemit të ri të ujësjellësit për tërë komunën

- Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit ekzistues dhe ngritja e rrjetit të ri për furnizim të të gjitha vendbanimeve;
- Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në vendet ku bëhet zgjerimi i vendbanimeve;
- Mirëmbajtja e vazhdueshme e rrjetit të ujit;
- Ndërrimi i gypave të vjetër që kërkojnë intervenim të shpeshtë me gypa të rinj;
- Mbrojtja e burimeve ekzistuese;
- Zonimi i rrjetit ekzistues, parashikimi i ujëmatësve zonal; dhe
- Largimi i të gjithë gypave të vjetër AC dhe zëvendësimi me gypa PE 100-RC.

Vlerësim: Si pasojë e mirëmbajtjes së dobët, është i nevojshëm renovimi i sistemit që është në përdorim. Andaj, duhet të konsiderohet intervenimi, renovimi afatshkurtër. Sistemi i integruar i ujësjellësit mund të furnizojë vendbanimet me ujë të pastër dhe të kontrolluar dhe t'i përmirësojë shërbimet e kompanisë së ujësjellësit.

Strategjia 1. Krahas zgjerimit të qytetit dhe vendbanimeve duhet të bëhet edhe zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit.

Gjithashtu, edhe rrjeti ekzistues i vjetërsuar duhet të bëhet ndërrimi i tij me gypa të rinj me cilësi të mira, siç janë gypat PE100-RC-HDPE ose me cilësi të ngjashme.

Strategjia 2: Të gjithë rezervuarët, kaptazhat dhe stacionet e pompave duhet të rinovohen apo edhe zgjerimi sipas kërkesave të konsumatorëve për ujë.

Strategjia 3: Në rrjetin ekzistues, por edhe një rrjetin e ri duhet të planifikohet vendosja e ujëmatësve zonal, për zonimin e sipërfaqeve të ndryshme në qytet dhe në fshatra.

Përmes ndërtimit të rrjetit të ri të ujësjellësit dhe me anë të ndarjes së sipërfaqeve zonale mundësojmë kontrollimin dhe zvogëlimin e humbjeve.

Si pikë negative në rrjetin e ujësjellësit por edhe të kompanisë që e menaxhon ujësjellësin, janë humbjet në rrjet, të cilat janë të paidentifikuara, me ndarjen e sipërfaqeve dhe vendosjen e ujëmatësve, kjo pikë negative eliminohet dhe krijohet mundësia për furnizim me ujë pa humbje të mëdha.

4.5.3.4. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Bazuar në Ligjin për mbeturina (Ligji 04/L-60), komuna e ka të krijuar sistemin për menaxhim të mbeturinave për territorin e vet. Për më tepër, në vitin 2016 ka miratuar "Planin për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021" zbatimi i të cilit bëhet përmes Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Inspektoratit Komunal për Mjedis.

Menaxhimi aktual nga operatori më i madh është NJP "Ambienti", i cili sipas shënimeve ofron shërbim primar të grumbullimit të mbeturinave për 66% të popullatës së përgjithshme dhe atë 100% të zonën urbane dhe rreth 27% në zonat rurale. Operatori tjetër "Ekodrinia", shërben kryesisht në pjesën rurale dhe rurale të thellë me përqindje të përgjithshme prej 34%.

Me gjithë përparimet e shënuara, disa kategori të mbeturinave paraqesin një sfidë jo të lehtë për komunën, në veçanti mbeturinat ndërtimore/demolimet, mbeturinat shtazore, etj.

Përveç masave të drejtpërdrejta për largimin e mbeturinave, do të aplikohen edhe masa për reduktimin e sasisë së mbeturinave që hedhen. Në këtë kuadër, parashihet të zhvillohen projekte për klasifikimin e mbeturinave në mënyrë që të mundësohet reciklimi i tyre. Po ashtu, do të shqyrtohen mundësitë për zhvillimin e projekteve për kompostimin e mbeturinave organike.

4.5.3.5. FURNIZIMI ME ENERGJI

Në bazë të analizës dhe verifikimit të gjendjes së Sistemit Elektro Energjetik (SEE) në komunën e Rahovecit, tregohet se rrjeti shpërndarës është i vjetërsuar dhe se është shkaktari kryesor i problemeve me furnizim me energji elektrike në komunë. Prandaj, duhet të bëhet përmirësimi i rrjetit ekzistues për të rritur cilësinë dhe sigurinë e furnizimit, si dhe për të reduktuar humbjet teknike në zona të caktuara të komunës, si dhe në fshatra. Kjo nënkupton kalimin nga rrjeti shpërndarës ajror 10kV në rrjetin shpërndarës kabllor 20kV si dhe zëvendësimin e linjave ajrore 230/400 me kabllo gërshetë apo edhe kabllo nëntokësore.

Përveç rrjetit, edhe stabilimentet elektro-energjetike janë të vjetruara. Prandaj, parashihet eliminimi gradual i trafo stacioneve TS 35/10 kV dhe kalimi në TS 110/20kV. Gjithashtu, parashihet ndërtimi i nënstacioneve prej 110/(20)10 kv dhe zëvendësimi i atyre TS 10/0.4 kV me 20/0.4 kV.

Efiçienca e energjisë elektrike

Në drejtim të përmirësimit të efiçiencës së energjisë, parashihen masa për rritjen e efiçiencës së energjisë, së pari në ndërtesat publike dhe sistemin e ndriçimit publik, për të vazhduar më tutje në ndërtesat private. Zëvendësimi i poqave të ndriçimit publik me trupa ndriçues LED, do të luaj një rol të rëndësishëm në kursimin e energjisë elektrike.

Gjithashtu, duhet të përkrahen dhe stimulohen projekte të energjisë efiçiente si energjia solare në sektorin publik e privat, pastaj energjia me erë dhe ujë si dhe projekte tjera që ndikojnë në kursimin e energjisë elektrike.

4.5.3.6. TELEKOMUNIKACIONI

Edhe pse rrjeti i telekomunikacionit si ajo publike ashtu edhe private në komunën e Rahovecit është mjaft e mirë dhe bëhen investime të vazhdueshme me qëllim të përmirësimit të tij. Sërish duhet të bëhen planifikimet afatgjata për shtrirjen dhe zgjerimin e rrjetit të kabllove optike për qëllimin e përmirësimit të telekomunikacionit. Në këtë aspekt, duhet shtrirë rrjeti i kabllove optike (KO) në qytetin e Rahovecit dhe në fshatrat më të mëdha si: Çifllak, Ratkoc, Drenoc, Xërxë, Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Opterush si dhe në fshatrat tjera. Gjithashtu, në fshatra në të cilat KO nuk përmbush kapacitetin e duhur, planifikohet rritja e tij.

Propozimet për zgjerimin e infrastrukturës së telekomunikacionit janë planifikuar si në vijim:

- Ndërtimi i rrjetit të ri GPON në fshatrat tjera; dhe

- Përmirësimi e shtimi i rrjetit të ri në të gjitha vendbanimet.

VSM - Sugjeron veprime operacionale konkrete si dhe përfshirja e tyre në planifikim:

- Për projekte të mëdha të ndërtimit, Impiante të trajtimit të ujërave të zeza dhe të ngjashme, e përcaktuar sipas ligjit të VNM-së.

4.5.4. INFRASTRUKTURA E TRANSPORTIT DHE TRANSPORTI

Rrjeti funksional i trafikut është një kusht i domosdoshëm për zhvillim ekonomik. Faktor përcaktues për vendosjen e rrjetit të trafikut është lidhja e vendbanimeve me rrjet rrugor dhe mundësia e udhëtimit, qarkullimit mes pikave të zhvillimit të komunës. Kategoritë e rrugëve dhe përgjegjësia për to është e përcaktuar me Ligjin mbi rrugët (2003/11). Shkoqitja e rrjetit të rrugëve brenda komunës në bazë të rëndësisë së lidhjeve funksionale në mes tyre, përbën bazën e diferencimit të standardeve kualitative të nevojshme për llojet e ndryshme të rrugëve dhe për përcaktimin e prioriteteve të përmirësimit të domosdoshëm dhe vendimet për ndërtimin e rrugëve të reja.

Rrjeti i trafikut brenda konceptit kryesor të zhvillimit ka për qëllim përcaktimin e hierarkisë së lidhjeve të rrjetit të vendbanimeve, sigurojë qasje dhe mobilitet – lëvizshmëri për banorët dhe përmirësojë funksionimin e sistemit të transportit publik brenda komunës së Rahovecit.

Rruga nacionale M9.1 Rahovec-Gjakovë do të zgjerohet dhe në aksin e saj do të ketë mundësi zhvillimi zona e biznesit të vogël.

Rruga regjionale R107 Prizren - Klinë, e cila kalon nëpër komunën e Rahovecit, konkretisht përgjatë lumit Drini i Bardhë në aksin e saj do jetë zona e biznesit të mesëm dhe të lartë. Është një korridor, i cili përmes rrugëve regjionale lidh komunën e Rahovecit me komunat fqinje.

Rruga regjionale R204 Rahovec - Suharekë do të zgjerohet dhe në aksin e saj do të ketë mundësi zhvillimi zona e biznesit të vogël dhe të mesëm, ndërsa Rruga Krushë e Madhe – Brestoc po ashtu do të zgjerohet dhe në aksin e saj do të ketë mundësi zhvillimi zona e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Rrugët kryesore lokale duhet të lidhin bashkësitë lokale me nën qendrat më të afërta dhe bashkësitë lokale në mes veti.

Krijimi i këtij rrjeti do të mundësojë një lëvizshmëri më të madhe në zonat rurale të komunës së Rahovecit, do të kursejë kohë në lëvizjen e banorëve të këtyre trevave dhe do të kontribuojë në ndërprerjen e migrimit – shpopullimit të fshatrave.

Nën qendrat tjera janë të lidhura, por kualiteti i rrugëve duhet të kontrollohet dhe në raste të caktuara të përmirësohet. Disa vendbanime për shkak të pozitës së largët ose topografisë së terrenit, nuk mund të kenë qasje të drejtpërdrejtë në rrugët kryesore lokale. Prandaj për t'u mundësuar lidhjen në rrugën kryesore lokale shërbejnë rrugët lokale. Të gjitha lidhjet tjera që lidhin vendbanimet - fshatrat rangohen si rrugë të fshatrave.

Krijimi i lidhjeve të mira funksionale në mes të vendbanimeve do të duhej të pengojë zgjerimin e panevojshëm të vendbanimeve dhe të ruajë tokën bujqësore dhe peizazhet me vlerë në tërë territorin e komunës së Rahovecit.

4.5.4.1. TRANSPORTI PUBLIK

Shërbimi i transportit publik do t'i përfshijë të gjitha vendbanimet e Rahovecit. Cilësia e ofrimit të shërbimit, në kuptim të frekuencës, infrastrukturës përcjellëse dhe mjeteve të transportit, do të jetë e nivelit të kënaqshëm. Si shërbim i mirëfilltë, transporti publik do të ofrohet si alternativë ndaj qarkullimit me automjete individuale.

Komuna duhet të marrë masa për përmirësimin e qasjes së personave më aftësi të kufizuar si dhe do të ndikojë në rritjen e numrit të çiklistëve dhe këmbësorëve. Këto masa përfshijnë edhe sigurimin e hapësirave dhe objekteve për çiklistë dhe këmbësorë. Shtigjet e sigurta për çiklistë dhe këmbësorë që të stimulojnë zvogëlimin e përdorimit të automjeteve në trafik.

4.5.4.2. KËMBËSORËT

Promovimi i ecjes ka rëndësi të veçantë, posaçërisht për shëndetin si formë e aktivitetit fizik, pastaj zvogëlimit të emetimit të gazrave nga trafiku i reduktuar me vetura dhe shtimin e sigurisë në trafik.

Komuna duhet të ndërmarrë masa për përmirësimin e sigurisë dhe komoditetin e këmbësorëve me kalime në udhëkryqe, të përmirësojë ndriçimin, mirëmbajtjen e shtigjeve.

Shtigjet janë posaçërisht të rëndësishme në zonat me potenciale turistike - peizazhet e hapura, komplekset përkujtimore, etj.

4.5.4.3. PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Autoritetet komunale duhet t'i kushtojnë rëndësi edhe nevojave të njerëzve me aftësi të kufizuar të lëvizjes duke i trajtuar këto nevoja gjatë menaxhimit të trafikut, ndërtimit të rrugëve, transportit publik dhe projekteve tjera.

4.5.4.4. ÇIKLISTËT

Komuna do t'i kushtojë rëndësi të madhe zhvillimit të çiklizmit si pjesë integrale e sistemit të transportit. Rrjeti i shtigjeve të çiklistëve duhet të planifikohet me kujdes duke u bazuar jo vetëm në nevojat e udhëtimit, por kërkesat e turizmit si në pjesën rrafshinore, po ashtu edhe në atë kodrinore-malore. Deri tani janë ndërtuar disa shtigje për çiklizëm e në të ardhmen parashikohen të ndërtohen edhe shtigje të tjera për çiklizëm.

4.5.4.5. TRANSPORTI I MALLRAVE

Transporti i mallrave duhet të përqendrohet në unazat e jashtme dhe të brendshme të qytetit si rrugë transite dhe në rrugët kryesore lokale përmbledhëse.

Duhet të shmanget transportimi i mallrave me shumicë në brendi të qytetit dhe vendbanimeve.

4.5.4.6. PARKIMI

Parkimi duhet të zgjidhet sipas standardeve dhe duhet të plotësoj nevojat e banorëve në vendbanime. Më hollësisht, parkimi përcaktohet me Hartën Zonale të Komunës dhe duhet të jepet për zonat veç e veç, si dhe për rrugët e lagjet e vendbanimeve.

VSM - Sugjeron veprime operacionale konkrete si dhe përfshirja e tyre në planifikim:

- Për çdo projekt ideor të rrugëve mbi 2 km të bëhet VNM-ja.

4.5.5. MBROJTJA E MJEDISIT DHE TRASHËGIMISË NATYRORE DHE KULTURORE

Në bazë të Ligjit Nr.03/L-025 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT si bazë e nevojshme për masat mbrojtëse në funksion të mbrojtjes së Mjedisit, do të merren dhe planifikohen edhe masat konkrete konform situatës së paraqitur në terren. Ku në bazë të gjendjes ekzistuese, pjesa veriore dhe veri-lindore përbëjnë pjesën më të madhe të sipërfaqes pyjore në tërë sipërfaqen e komunës, si dhe pjesët tjera të gjelbëruara së bashku me lidhjet e korridoreve të gjelbra përgjatë rrjedhave ujore, përbëjnë rrjetin e gjelbër të shpërndarë përgjatë tërë territorit komunal.

Në kuadër të masave për reduktimin e ndotjes, do të bëhet monitorimi i burimeve të ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës. Përmes masave konkrete do të bëhet eliminimi i ndotësve - deponive joformale përmes

menaxhimit të mbeturinave; ujërave të zeza për sisteme të kanalizimeve; ndalimit të emetimeve të pluhurit sidomos nga gurthyesit si, dhe aplikimit të tamponëve të gjelbërimit përgjatë rrugëve si masa mbrojtëse.

Toka bujqësore, si aset ekonomik dhe mjedisor, bazuar edhe në aspektet e planifikimit gjeneral shtetëror, do të mbrohet nga degradimet dhe ndërtimi i shpërhapur. Kjo shpërfillje e madhe ndodh sidomos në pjesët rurale, ku toka bujqësore degradohet dhe bëhet tokë ndërtimore. Dhe, si masë veçantë në këtë drejtim do të jetë respektimi i kufijve të zonave ndërtimore.

Toka bujqësore do të ketë trajtim të veçantë edhe sa i përket mbrojtjes nga ndotja. Në kuadër të këtyre masave përfshihen edhe monitorimi dhe kufizimi i përdorimit të pesticideve dhe plehrave kimike.

Pyjet do të jenë të mbrojtura nga degradimet dhe prerjet ilegale. Ndërsa pjesët e degraduara do të ri-gjenerohen përmes ri-pyllëzimit. Përveç rolit mjedisor dhe zhvillimit të biodiversitetit, mbrojtja dhe rehabilitimi i pyjeve do të ketë ndikim pozitiv edhe në shmangien e erozioneve.

Masa të veçanta mbrojtëse do të aplikohen edhe për mbrojtjen e biodiversitetit dhe peizazhit. Në kuadër të masave mbrojtëse, do të aplikohen edhe masat ndaj fatkeqësive natyrore apo atyre të shkaktuara nga njeriu, me qëllim të mbrojtjes së jetës së qytetarëve, mjedisit, pasurisë, si dhe aseteve zhvillimore.

Masat e mbrojtjes nga përmbytjet përfshijnë rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtretërve të rrjedhave ujore, kanaleve të kullimit si dhe përmirësimin dhe menaxhimin brezave hapësinor përgjatë rrjedhave ujore.

Mbrojtja nga zjarret do të bëhet përmes aplikimit të masave organizative dhe teknike.

Masat mbrojtëse në bazë të Ligjit Nr. 03/L-233 PËR MBROJTJEN E NATYRËS, janë në funksion edhe të zhvillimit të turizmit si dhe në funksion të mbrojtjes së natyrës. Mbrojtja e monumenteve natyrore është përgjegjësi e komunës dhe MMPHI nga se vlerat e veçanta të natyrës në këto pika janë vlera të trashëguara me gjenerata të tëra dhe janë në funksion të zhvillimit të mëtutjeshëm si në aspektin mjedisor ashtu edhe atë ekonomik.

VSM - Sugjeron disa veprime operacionale konkrete si dhe përfshirja e tyre në planifikim:

- Studimin e hartave të tërmeteve, hartat e vërshimeve, hartat gjeologjike, bonitetit të tokës, të rrëshqitjeve të tokës, etj.
- Hartimi i hartave të zhurmës për zonën urbane.

4.5.6. VENDBANIMET DHE TRAJTIMI I VENDBANIMEVE JOFORMALE

Vendbanimet e shpërndara, tendenca në rritje e tyre, krijojnë shpenzime të mëdha me rastin e shtrirjes së infrastrukturës teknike po edhe asaj sociale. Një pjesë e madhe e këtyre vendbanimeve marrin tokë të mira bujqësore. Prandaj, për të siguruar një shfrytëzim racional dhe efikas të tokës, banimi duhet të zhvillohet në mënyrë të përqendruar duke shfrytëzuar parimet e densifikimit dhe shfrytëzimit të zbrazëtirave brenda zonave të ndërtuara.

Për rritjen e vendbanimeve janë marrë parasysh:

- Parashikimet demografike;
- Dendësia e popullsisë;
- Zona ekzistuese e ndërtuar; dhe
- Toka bujqësore.

Rritja e vendbanimeve është planifikuar ashtu që të mbushen zbrazëtirat në vendbanimet ekzistuese kryesisht të shpërndara, me qëllim të ruajtjes së tokave bujqësore dhe uljes së kostos së furnizimit me infrastrukturë.

Shtimi i popullsisë është brenda kapaciteteve të zbrazëtirave ekzistuese nëpër vendbanime dhe shkalla e dendësisë nuk do të tejkalojë standardet për vendbanime të tilla. Principet e shfrytëzuara gjatë planifikimit janë:

- Mbrojtja e tokës bujqësore kualitative;
- Mbrojtja e peizazhit; dhe
- Shfrytëzimi racional i tokës.

Hierarkia e vendbanimeve në lidhje me dendësinë e popullsisë janë marrë në përputhje me rrethanat. Komuna do të ndjekë konceptin e qytetit të propozuar nga PZHK-ja për zhvillimin e ardhshëm përbrenda qytetit duke e rritur dendësinë banimore dhe fizike në zonën qendrore, të cilat do të specifikohen me Hartë Zonale dhe Planet Rregulluese të Hollësishme të qytetit të Rahovecit.

Zona urbane planifikohet që do të ketë këtë densitet prej 100 ban/ha.

Vendbanimet rurale do të kenë një densitet të vogël prej 50 b/ha.

Rritja e vogël e dendësisë planifikohet për shkak se numri i banorëve në zonën urbane është i vogël dhe shihet qartë një zbehje e qytetit kufizon rritjen e zonës urbane.

4.5.6.1. FUNKSIONI DHE MADHËSIA E VENDBANIMEVE

Mungesa e kontrollit të zhvillimit, sidomos në zonat rurale, ka ndikuar që të ketë zhvillim të shpërqendruar. Plani synon të adresojë këtë çështje duke rekomanduar zhvillim kompakt dhe të balancuar, duke filluar nga zona urbane e deri tek vendbanimet në zonën rurale. Në këtë kontekst rritja e popullsisë dhe investimet publike për të ofruar shërbime bazë në funksion të këtij zhvillimi janë elemente shumë me rëndësi.

Çdo vendbanim do të zhvillohet bazuar në potencialet për zhvillim dhe shërbimet bazë të cilat duhet t'i ofrojë. Duke marrë parasysh edhe parashikimet për trendin e uljes - zvogëlimit të popullsisë, vendbanimet në vijim do të zhvillohen sipas këtyre funksioneve: qyteti - qendër rajonale dhe komunale dhe Opterush, Krushë e Madhe, Xërxë, Ratkoc, Drenoc dhe Çifllak si nën qendra komunale.

Qyteti është qendra komunale e cila bartë të gjithë barrën e zhvillimit të komunës me funksionet e saja përcjellëse. Nën-qendrat do të ofrojnë shërbime bazë për vendbanimet përreth duke mundësuar mbulim të përgjithshëm të komunës dhe rrjedhimisht të ofrojnë zhvillim të balancuar. Të gjitha vendbanimet tjera do të ofrojnë vetëm hapësirë për banim dhe bujqësi me intensitet të ulët. Në tabelë do të paraqesim funksionin dhe madhësinë e çdo vendbanimi në komunë.

Emri	Funksioni	Klasifikimi sipas madhësisë
Rahovec	Qendër rajonale/ komunale	Vendbanim i vogël urban
Opterush	Nën-qendër	Vendbanim i mesëm i madh rural
Krushë e Madhe	Nën-qendër	Vendbanim i madh rural
Ratkoc	Nën-qendër	Vendbanim i madh rural
Xërxë	Nën-qendër	Vendbanim i madh rural
Drenoc	Nën-qendër	Vendbanim i mesëm i madh rural
Çifllak	Nën-qendër	Vendbanim i mesëm i madh rural
Radostë (Malësi e Vogël)	Banim	Vendbanim i mesëm i madh rural
Bellacërkë, Celinë, Dejnë + Baboc, Brestoc, Hoçë e Vogël, Kramovik, Pataqan i Poshtëm, Pastaselë,	Banim	Vendbanim i mesëm i madh rural
Sapniq, Vrajakë, Polluzhë, Dabidol, Retijë, Nagavc,	Banim	Vendbanim i mesëm i vogël rural

Petkoviq (Guri i Kuq), Senoc, Gexhe, Zaqishtë, Pataqan i Epërm		
Bratatin, Reti e Poshtme, Nashpall	Banim	Vendbanim i vogël rural
Mrasor, Kaznik, Hoçë e Madhe, Bërnjakë, Sarosh	Banim	Vendbanim shumë i vogël rural

Tabela 213 Klasifikimi i vendbanimeve sipas madhësisë dhe funksionit

4.5.6.2. AKOMODIMI I ZHVILLIMEVE TË ARDHSHME

Akomodimi i zhvillimit të ardhshëm në komunë planifikohet konform kërkesave për zhvillim, duke u bazuar në rritje të popullsisë dhe ekonomisë. Kjo rritje duhet të përkthehet në sipërfaqe të tokës që duhet të planifikohet për të akomoduar kërkesat për zhvillim.

Duke pasur parasysh që në bazë të parashikimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, si dhe parashikimeve të PZHK-së për vitin 2030 komuna e Rahovecit do të pësojë ulje të numrit të popullsisë, në këtë rast përcaktimi i sipërfaqeve për zhvillimet e ardhshme të vendbanimeve nuk është bazuar në këtë kriter, por në vendimmarrjen e mëhershme të komunës përmes vendimeve të miratuara në Kuvendin e Komunës për kufijtë ndërtimorë të vendbanimeve.

Dendësia e banimit është faktor përcaktues i sasisë së tokës për zhvillim. Bazuar në UA MMPHI 08/2015 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, përkatësisht kapitullin III, Neni 2, ku në bazë të klasifikimit të vendbanimeve formale komuna e Rahovecit hyn në kategorinë e vendbanimit të mesëm të madh urban dhe bazuar në kapitullin IV të po këtij udhëzimi administrativ, dendësia banimore për zonën urbane të Rahovecit planifikohet të jetë jo më e madhe se 100 banorë për hektar, ndërsa për vendbanimet rurale të komunës së Rahovecit planifikohet të jetë jo më e madhe se 50 banorë për hektar.

Vendbanimi	Nr. Popullsisë	Zona e ndërtuar (Ha)	Njësitë e banimit (Nr. Pop./madhësia e ekonomisë familjare)	Dendësia aktuale neto -njësi banimi /Ha	Dendësia e planifikuar neto - njësi banimi /Ha	Kategoritë e sipërfaqeve sipas dendësisë së parashikuar
Rahovec	15,892	255.38	2,523	10	16	Sipërfaqe urbane qendrore
Bellacërkë (Fortesë)	2,270	58.09	295	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Bërnjakë	40	17.83	5	1	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Bratatin	396	9.31	51	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Brestoc	1,288	36.47	167	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Celinë	1,903	53.38	247	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Çifllak - Sarosh	1,292	29.03	168	6	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Dabidol	799	15.48	104	7	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Dejnë	1,757	47.27	228	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Xërxë	3,184	82.29	414	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Gexhe	660	19.44	86	4	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë

Hoçë e Madhe	124	29.00	16	1	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Hoçë e Vogël	1,166	28.24	151	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Kramovik	1,125	28.38	146	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Krushë e Madhe	4473	116.78	581	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Mrasor	191	6.03	25	4	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Nagavc	743	20.60	97	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Nashpall	220	4.21	29	7	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Opterush	1,911	45.72	248	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Pastaselë	1,011	25.35	131	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Pataqan i Epërm	533	11.81	69	6	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Pataqan i Poshtëm	1,077	22.93	140	6	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Petkoviq (Guri i Kuq)	731	14.65	95	7	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Polluzhë	808	19.83	105	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Radostë (Malësi e Vogël)	2,346	58.47	305	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Ratkoc	3,791	75.89	492	7	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Reti e Poshtme	234	10.42	30	3	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Retijë	771	15.44	100	7	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Sapniq	996	21.96	129	6	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Senoc	687	25.35	89	4	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Vrajakë	838	13.79	109	8	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Zaqishtë	659	11.32	86	8	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Drenoc	1,587	40.65	206	5	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Kaznik	164	3.55	21	6	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë
Zatriq	535	7.65	69	9	8	Sipërfaqe rurale me intensitet të lartë

Tabela 214 Veçoritë hapësinore të vendbanimeve

4.5.6.3. VENDBANIMET JOFORMALE

Sipas LIGJIT NR. 04/L-174 PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR "vendbanimet joformale" janë "vendbanime ku banorët nuk gëzojnë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës, të banimit dhe nuk kanë zotërim ligjor të pronës ose qasje adekuate në shërbimet publike dhe qeverisje, si dhe jetojnë në një mjedis me rrezikshmëri të lartë".

Në komunën e Rahovecit janë identifikuar 10 vendbanime jo formale, një nga të cilat ndodhet në zonën urbane dhe 9 në zonat rurale.

Vendbanimet jo formale gjenden në këto vendbanime: Një pjesë e qytetit të Rahovecit, dhe pjesë apo lagje të fshatrave: Bellacërkë (Fortesë), Xërxë, Gexhe, Radostë (Malësi e Vogël), Ratkoc, Çifllak, Dabidol dhe dy pjesë të fshatit Drenoc.

Këto vendbanime duhet të trajtohen sipas udhëzimeve të Strategjisë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për Vendbanimet Joformale dhe sipas UA 08/2018 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, përkatësisht kapitullit III, Neni 2.

Komuna, me qëllim të rregullimit dhe përfshirjes së vendbanimeve joformale parasheh zbatimin e kushteve zhvillimore dhe ndërtimore të cilat do të përcaktohen me dokumente të nivelit më të ulët të planifikimit hapësinor, siç është Harta Zonale e Komunës, përkatësisht, rregullimi dhe zhvillimi i këtyre vendbanimeve do të bëhet në bazë të kushteve zhvillimore të zonës përkatëse në të cilën ndodhet ai vendbanim.

Ky përmirësim i gjendjes ekzistuese do të arrihet pikërisht përmes rregullimit të infrastrukturës rrugore, infrastrukturës teknike, asaj sociale, si dhe do të paraqiten kushte zhvillimore adekuate, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e gjendjes në këto zona. Një prej mundësive të rregullimit të vendbanimeve joformale është edhe zbatimi i bonuseve të ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, ku përcaktohet që komuna pas hartimit dhe miratimit të Hartës Zonale të Komunës të hartojë një rregullore ku do të përcaktojë mënyrën e zbatimit të bonuseve.

Udhëzuesit e planifikimit hapësinor të vendbanimeve joformale, edhe pjesë tjera të vendbanimeve, pa marrë parasysh përbërjen etnike, të cilat shquhen me karakteristikat e cekura më lartë, duhet t'i nënshtrohen rregullimit të çështjeve pronësore si dhe do të përmirësonin kualitetin e jetës në vendbanim. Vendbanime joformale të cilat duhet ta trajtohen në mënyrë të posaçme, mirëpo mënyra e zhvillimit të disa pjesëve të zonës urbane kërkon një qasje pothuaj identike për hartimin e planeve rregulluese në zonat të cilat janë zhvilluar pa plan dhe ku mungon infrastruktura themelore dhe këto plane rregulluese duhet të përcaktohen në Hartën Zonale të Komunës.

4.5.7. SHFRYTËZIMI I PLANIFIKUAR I TOKËS

Harta e shfrytëzimit të tokës përcakton llojin e shfrytëzimit të tokës bazuar në vizion, qëllime dhe objektiva. Shfrytëzimi i planifikuar i tokës në mënyrë direkte rrjedhë nga koncepti i zhvillimit hapësinor.

Duke synuar zhvillimin e ardhshëm të komunës, PZHK-ja duhet të sigurojë tokë të mjaftueshme ndërtimore për banim, biznese, industri, infrastrukturë publike dhe sociale dhe shfrytëzim të përzier. Sipas PZHK-së qyteti i Rahovecit do të dendësohet, do të plotësohen hapësirat e pa zhvilluara brenda kufirit ndërtimor. Është me rëndësi të potencohet fakti se zgjerimi ekzistues i ndërtimeve në toka nën komasacion nuk do të lejohet në asnjë pjesë të territorit të komunës së Rahovecit.

Duke marrë parasysh potencialin bujqësor të Rahovecit e posaçërisht në Vreshtari dhe Perimtari, planifikohet një zonë e posaçme për ekonominë. Zona ekonomike, një pjesë e madhe e saj, planifikohet të jetë në rrugën regjionale Rahovec – Suharekë. Ndërsa do të ketë edhe pjesë të tjera si në: Krushë të Madhe, Xërxë dhe Zatriq.

Zhvillimi i ndërtimeve të reja në toka bujqësore në sistem të ujitjes nuk lejohen, gjersa ndërtimet ekzistuese janë zona të ngrira, dhe konsiderohen subjekt i "ngrirjes së zhvillimit" deri në trajtimin e tyre me ligjet gjegjëse apo programe të veçanta.

Ky Plan Zhvillimor Komunal parasheh shfrytëzimin vijues të tokës:

1. 21247.30 ha për prodhim parësor
2. 1616.26 ha për prodhim dytësor
3. 939.80 ha për prodhim tretësor
4. 547.38 ha për rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike
5. 2757.30 ha për banim
6. 399.07 ha për shfrytëzim tjetër

Në vijim janë paraqitur zonat planifikuara të shfrytëzimit të tokës sipas vendbanimeve.

	HILUCS 1	HILUCS 2	HILUCS 3	Sipërfaqja ha
Ballacerkë	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	878.12
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	21.14
	2. Prodhim dytesor	23. Industri e prodhimeve të lehta	231. Prodhim i pijeve, ushqimeve dhe produkteve të duhanit	12.05
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	341. Shërbim kulturor	0.14
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	5.03
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	21.87
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	146.6
	5. Banim	52. Banim me funksione të tjera të përputhshme	/	11.29
Bërnjak	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	357.52
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	27.15
	2. Prodhim dytesor	23. Industri e prodhimeve të lehta	235. Prodhim i produkteve tjera të lehta	37.39
	3. Prodhim tretesor	31. Shërbim tregtar	311. Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake	8.92
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	14.84
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	4.62
	5. Banim	52. Banim me funksione të tjera të përputhshme	/	1.65
Bratotin	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	216.17
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	63.94
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	2.68

	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	5.5
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	22.76
Brestovc	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	371.7
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	141.83
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	1.33
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	9.09
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	56.74
Celinë	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	436.95
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	35.42
	2. Prodhim dytesor	23. Industri e prodhimeve të lehta	235. Prodhim i produkteve tjera të lehta	0.58
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	332. Shërbim arsimor	3.64
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	343. Infrastrukturë sportive	1.2
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	9.73
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	85.06
Çiflak	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	367.35
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	14.29
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	3.62
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	343. Infrastrukturë sportive	0.35
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	13.83
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	66.86
	6. Shfrytezim tjeter	63. Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	632. Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	10.07
Denjë	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	505.23
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	58.47
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	6.78
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	344. Hapësirë e hapur rekreative	0.84
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	12.16
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	54.21

	6. Shfrytezim tjeter	63. Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	632. Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	5.69
Dobidol	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	284.8
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	13.33
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	1.25
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	344. Hapësirë e hapur rekreative	0.8
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	8.76
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	32.09
	6. Shfrytezim tjeter	63. Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	632. Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	4.56
Drenoc	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	537.23
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	193.63
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	2.51
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	344. Hapësirë e hapur rekreative	0.93
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	14.55
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	70.65
Gexhë	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	154.38
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	76.99
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	3.75
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	343. Infrastrukturë sportive	1.57
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	7.55
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	44.13
	6. Shfrytezim tjeter	63. Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	631. Tokë natyrore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	34.53
Hoçe e Madhe	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	570.44
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	599.56
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	3.35
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	343. Infrastrukturë sportive	0.09

	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	20
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	39.17
	3. Prodhim tretesor	31. Shërbim tregtar	311. Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake	120.54
Hoqçe e Vogel	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	502.62
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	127.64
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	3.37
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	343. Infrastrukturë sportive	0.14
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	9.72
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	61.33
Kaznik	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	366.52
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	434.52
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	0.12
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	13.41
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	10.11
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	9.58
Kramovik	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	500.93
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	216.27
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	1.93
	2. Prodhim dytesor	24. Prodhim i energjisë	244. Prodhim i enërgjisë së ripërteritshme	192.42
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	0.05
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	28
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	68.92
	5. Banim	52. Banim me funksione të tjera të përputhshme	/	8.69
	6. Shfrytezim tjeter	63. Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	632. Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	12.92
K r	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	615.84

	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	26.86
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	10.7
	3. Prodhim tretesor	31. Shërbim tregtar	311. Shërbim tregtar me shumicë dhe pakicë dhe riparimi i automjeteve dhe mallrave personale dhe shtëpiake	70.5
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	2.12
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	25.79
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	207.45
	5. Banim	52. Banim me funksione të tjera të përputhshme	/	25.79
	6. Shfrytezim tjeter	63. Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	632. Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	15.58
Mrasor	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	158.54
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	112.55
	3. Prodhim tretesor	33. Shërbim i komunitetit	335. Shërbim tjetër i komunitetit	2.22
	3. Prodhim tretesor	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	34. Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ	10.17
	4. Rrjetet e transportit, logjistikës dhe infrastrukturës publike	4.1 Rrjetet e transportit	4.1.1 Infrastrukturë e transportit rrugor	10.91
	5. Banim	51. Banim i përhershëm	/	17.81
	6. Shfrytezim tjeter	63. Tokë natyrore e cila nuk është nën ndonjë shfrytëzim tjetër ekonomik	632. Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik	4.74
Nagavc	1. Prodhim paresor	11. Bujqësi	111. Prodhim bujqësor komercial	164.56
	1. Prodhim paresor	12. Pylltari	123. Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme	75.6
